REZISTENCA

GRATË E PAQES DHE TË DREJTËSISË NË ISH-JUGOSLLAVI DHE SHQIPËRI

PRISHTINË 2025

REZISTENCA

Gratë e paqes dhe të drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri

forumZFD – (Forum Civil Peace Service / Forum Ziviler Friedendienst e.V)
Prishtinë, 2025

Drejtues të projektit:
Korab Krasniqi
Rina Kadiri
Vjollca Islami Hajrullahu

Redaktimi dhe lektura:
Artan Sadiki
Blerim Gashani
Fatushe Haliti
Korab Krasniqi
Vladimir Arsenić

Intervistat dhe hulumtimi:
Korab Krasniqi
Vjollca Islami Hajrullahu

Transkriptimi:
Alma Hamza
Anita Susuri
Donjet Behluli
Miona Dinić
Renea Begolli
Xherardo Nikjari

Fotografia:
Korab Krasniqi

Ballina:
Lendita Zeqiraj

Për botuesin:
Nehari Sharri

Dizajni dhe faqosja:
Rita Tërstena

Përkthimi:
LBG Communications
Bruno Translate LLC

Shtypi:
Prograf

Publikuar nga:
forumZFD – (Forum Civil Peace Service / Forum Ziviler Friedendienst e.V)
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS)

320

Ajna Jusić,
Bosnje dhe Hercegovinë

18

Fatbardha Mulleti-Saraçi,
Shqipëri

220

Feride Rushiti,
Kosovë

102

Katarina Kruhonja,
Kroaci

190

Nora Ahmetaj,
Kosovë

254

Sabiha Husić,
Bosnje dhe
Hercegovinë

48

Savka Todorovska,
Maqedoni e Veriut

84

Sonja Biserko,
Serbi

132

Staša Zajović,
Serbi

288

Tea Gorjanc Prelević,
Mal i Zi

162

Vesna Teršelič,
Kroaci

REZISTENCA

Gratë e paqes dhe të drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri

***

Ky projekt realizohet nga forumZFD programi në Kosovë dhe Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS), me mbështetje nga Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

***

Libri është botuar për qëllime jo-komerciale dhe nuk është në shitje. Ndalohet shtypja, shitja apo çfarëdo shfrytëzimi i paautorizuar fitimprurës i librit. Libri distribuohet falas në kopje fizike (dhe digjitale) në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze dhe mund të gjendet në
zyrat e publikuesve.

REZISTENCA

Gratë e paqes dhe të drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri

Shpërbërja e Jugosllavisë dhe kthimi në etnonacionalizëm

Dekada e fundit e mijëvjeçarit të kaluar shënoi shpërbërjen e Federatës Jugosllave, duke e kthyer atë nga një shtet socialist unitar në disa republika të pavarura, të përfshira në konflikte etnike dhe politike.

Në fund të viteve 1980, shtimi i nacionalizmit dhe kriza ekonomike destabilizuan Jugosllavinë. Një nga figurat më polarizuese të kësaj kohe ishte ajo e Slobodan Milošević-it, i cili u bë lider i Serbisë më 1989. Milošević-i forcoi kontrollin mbi institucionet federale dhe ndryshoi kushtetutën serbe, duke i hequr autonominë Kosovës dhe Vojvodinës. Këto veprime shkaktuan protesta të ashpra në Kosovë dhe rritën tensionet mes republikave federative.

Në vitin 1991, Sllovenia dhe Kroacia shpallën pavarësinë, duke shkaktuar luftëra të shkurtra, por të ashpra. Ndërkohë, konflikti në Bosnjë dhe Hercegovinë (1992-1995) u shndërrua në një nga tragjeditë më të mëdha humanitare në Evropë pas Luftës së Dytë Botërore. Lufta në Bosnje e Hercegovinë, e karakterizuar nga masakra të përgjakshme (përfshirë rastin tragjik të Srebrenicës), nga përdhunime sistematike dhe spastrime etnike, përfundoi me nënshkrimin e Marrëveshjes së Dejtonit në vitin 1995. Kjo marrëveshje përcaktoi ndarjen e Bosnjes e Hercegovinës në dy entitete – Federatën Boshnjako-Kroate dhe Republikën Srpska – si mënyrë për të ruajtur paqen e brishtë (Holbrooke, 1998). Në maj 2024, Asambleja e Përgjithshme e Kombeve të Bashkuara miratoi një rezolutë, duke shpallur 11 korrikun si Ditë Ndërkombëtare të Përkujtimit të Viktimave të Gjenocidit në Srebrenicë.

Pas një dekade represioni në Kosovë, më 1998 shpërthyen luftimet mes Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK) dhe forcave ushtarake, policore dhe paramilitare serbe. Reagimi brutal i regjimit serb u shoqërua me krime të rënda kundër njerëzimit, përfshirë spastrime etnike, masakra dhe përdhunime të kryera ndaj popullsisë civile shqiptare. Në mars të vitit 1999, NATO-ja ndërhyri përmes bombardimeve ajrore dhe operacioneve mbështetëse për të ndalur dhunën në Kosovë dhe për të detyruar forcat serbe të tërhiqeshin. Në atë kohë, një raport e përshkroi ndërhyrjen si më shumë sesa një lëvizje strategjike, duke e quajtur “krizë morale për të ndaluar gjenocidin” (Judah, 2000).

Shpërbërja e Jugosllavisë, e cila u bë gradualisht përgjatë dy dekadave, shënoi fundin e një federate socialiste që kishte ekzistuar që nga Lufta e Dytë Botërore. Pas shpërbërjes së Jugosllavisë, u krijuan shtatë shtete të pavarura: Sllovenia, Kroacia, Bosnja

e Hercegovina, Maqedonia e Veriut, Serbia, Mali i Zi dhe Kosova.

Arti i rezistencës transformative

Krahas shpërbërjes së përgjakshme të Federatës Jugosllave, gratë në gjithë rajonin u mobilizuan dhe luajtën një rol kyç në kundërshtimin e politikave të dhunshme dhe në promovimin e paqes dhe të drejtësisë. Ato ndërmorën nisma simbolike dhe praktike për të kontribuar në ndërtimin e dialogut, për të dokumentuar krimet e luftës dhe për të nxitur pajtimin ndërmjet komuniteteve. Në Serbi, gratë nisën protesta kundër luftës dhe dhunës duke përdorur simbole si heshtja dhe ngjyra e zezë, për të bashkëndjerë dhe bashkëndarë pikëllimin për viktimat dhe humbjet. Gratë në rajonin tonë nuk luftuan vetëm për paqe, por edhe për të përgënjeshtruar gënjeshtrat nacionaliste dhe për të nxjerrë në pah të vërtetën mbi krimet" (Zajović, 2002).

Në Bosnje e Hercegovinë, gratë luajtën rol të rëndësishëm duke dokumentuar krimet e luftës dhe duke ofruar mbështetje për të mbijetuarit e torturës dhe të dhunës seksuale të ushtruar në rrethana lufte. Në Kosovë, ato nisën lëvizje të shumta shoqërore, të prira nga vizioni për drejtësi dhe paqe. Ato protestuan, bënë thirrje për paqe dhe dokumentuan krimet e luftës, duke u ofruar mbështetje të mbijetuarve, sikurse edhe në Bosnje e Hercegovinë. Në Kroaci, gratë kundërshtuan politikat e dhunshme përmes rezistencës dhe solidaritetit, duke krijuar platforma bashkëpunimi mes kroatëve, serbëve dhe boshnjakëve, me qëllim nxitjen e kujtesës historike dhe edukimin për paqen.

Luftërat në ish-Jugosllavi dhe krimet që i sollën ato lanë gjurmë të thella në mbarë rajonin. Në Mal të Zi dhe Maqedoninë e Veriut, gratë u angazhuan në ofrimin e ndihmës humanitare, psikosociale dhe ligjore për refugjatët që largoheshin nga luftërat në Bosnje e Hercegovinë dhe Kosovë. Përveç kësaj, ato morën pjesë aktive në proceset rajonale të pajtimit, duke mbështetur përpjekjet për paqe dhe drejtësi.

Ndërkohë, në Shqipëri, aktivizmi i grave përqendrohej te pasojat e shtypjes dhe të persekutimit komunist, duke dokumentuar shkeljet e rënda të të drejtave të njeriut dhe duke amplifikuar zërin e viktimave të këtij regjimi. Përveç kësaj, gratë në Shqipëri luajtën rol të rëndësishëm humanitar duke pritur dhe ndihmuar refugjatët shqiptarë nga Kosova, të cilët u dëbuan nga shtëpitë e veta gjatë viteve 1998-1999.

Angazhimi i grave para, gjatë dhe pas dhjetëvjeçarit të luftërave ishte vendimtar për promovimin e drejtësisë për viktimat dhe të mbijetuarit, edukimin e brezave të rinj mbi vlerën e paqes dhe dialogut, si dhe për rritjen e vetëdijesimit ndërkombëtar mbi krimet e luftës dhe rëndësinë e drejtësisë tranzicionale e të paqes së qëndrueshme.

Metodologjia dhe përgjegjshmëria

Intervistat e përfshira në këtë vëllim janë realizuar përmes metodës kërkimore të historisë gojore dhe janë regjistruar me zë, me pëlqim të shkruar prej të intervistuarave. Secila intervistë ka zgjatur mesatarisht 4-5 orë, dhe brenda kësaj kohe janë shqyrtuar një gamë e gjerë përvojash personale, përfshirë: historikun familjar, familjen, fëmijërinë, edukimin, realizimin profesional, formimin intelektual e angazhimin qytetar politik, veprimtarinë, luftën, jetën pas luftës, etj. Në proces, subjektet kanë ndarë materiale nga arkivat e tyre fotografikë familjarë ose personalë, prej të cilave disa i kemi paraqitur në libër. Fotografi të tjera të paraqitura janë ato të realizuara gjatë intervistimit. Për më shumë, subjektet kanë ofruar materiale shtesë që lidhen me përvojat e tyre; materiale nga veprimtaritë e veta, letërkëmbime, dekorata e përkthime, të cilat i posedojmë por që nuk japin kontribut të theksuar në plotësimin e rrëfimtarisë.

Materiali audio i intervistave është transkriptuar e redaktuar, dhe për secilin rrëfim është përgatitur një tekst i shkurtër udhëzues ose përshkrues. Intervistat e redaktuara janë ndarë me të intervistuarat, të cilat kanë bërë korrigjime, shtesa, ose kanë kërkuar eliminimin e pjesëve të caktuara. Rrëfimet e përfshira në libër përfaqësojnë versione të shkurtuara dhe të aprovuara nga të intervistuarat.

Intervistat janë organizuar në formatin e tregimeve jetësore, duke eliminuar pyetjet, nënpyetjet, plotësimet, pohimet dhe bashkëbisedimet që dilnin jashtë kontekstit. Përmbajtja e rrëfimeve në këtë vëllim mbetet autentike, e sistemuar në një strukturë koherente, duke ruajtur natyrën dhe frymën dialektore të gjuhës së rrëfimtareve.

Ky libër përmbledh historitë personale të njëmbëdhjetë grave aktiviste nga lëvizjet për paqe dhe kundër dhunës: dy nga Bosnja e Hercegovina, dy nga Kosova, dy nga Kroacia, një nga Mali i Zi, një nga Maqedonia e Veriut, dy nga Serbia dhe një nga Shqipëria. Në kushte të ndryshme sociale, politike dhe ekonomike, këto gra sfiduan shtypjen dhe dhanë kontribut të rëndësishëm në proceset e zbulimit të së vërtetës dhe pajtimit.

Rezistenca: Gratë e paqes dhe drejtësisë

Pas përfundimit të luftërave, gratë luajtën një rol kyç në nisjen e proceseve për drejtësinë tranzicionale dhe ndërtimin e paqes. Ato u angazhuan në iniciativa si REKOM, e cila kishte për mandat hetimin dhe dokumentimin e krimeve të luftës dhe shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut të kryera gjatë periudhës së konflikteve (1991-2001). Kjo nismë bashkoi qindra organizata të shoqërisë civile dhe mijëra aktivistë, të cilët punuan për të mbledhur prova mbi krimet e kryera, për të vetëdijesuar publikun rreth të kaluarës së vështirë, për të mbështetur procesin e pajtimit dhe për të krijuar hapësira ku zëri i viktimave të dëgjohej në mbarë rajonin.

Libri “Rezistenca” sjell zëra të grave që pasqyrojnë një periudhë të përcjellë me trazira dhe sfida, një epokë në historinë moderne të Ballkanit të shënuar nga konflikte, shtypje dhe dhunë, por që edhe nxiti një rezistencë të fuqishme, një luftë për drejtësi

dhe një aspiratë për paqe. Ky libër është një testament i qëndresës së grave, të cilat me kurajë sfiduan shtypjen, stigmën dhe dhimbjet personale, duke vënë në qendër të vëmendjes të drejtat e njeriut dhe dinjitetin njerëzor.

Gratë që ndajnë historitë e tyre në këto faqe përfaqësojnë një forcë morale të jashtëzakonshme. Ato vijnë nga përvoja të ndryshme: fëmijëri të rrënjosura në tradita familjare, vuajtje nga persekutimi politik, plagë të pashëruara të luftës, stigma dhe paragjykime, etj. Secili rrëfim është unik, por së bashku ato krijojnë një mozaik – historinë e grave që qëndruan të pathyeshme.

Në Kosovë, Nora Ahmetaj sjell në pah përpjekjet e një populli për të ruajtur identitetin dhe dinjitetin nën represion dhe diskriminim, ndërsa Feride Rushiti përshkruan mbështetjen e dhënë për mijëra viktima të torturës dhe të dhunës seksuale, duke theksuar se humanizmi dhe altruizmi janë forca të jashtëzakonshme për ndryshim. Në Bosnje e Hercegovinë, Ajna Jusić dhe Sabiha Husić dëshmojnë se stigma dhe trauma nuk mundën të ndalonin vullnetin për të jetuar dhe për të ndihmuar të tjerët. Ndërkohë, në Shqipëri, Fatbardha Mulleti Saraçi pasqyron dhimbjen e heshtur të një familjeje të persekutuar nga regjimi komunist, duke u shndërruar në zë të kujtesës historike.

Në Kroaci dhe Mal të Zi, Vesna Terselić, Katarina Kruhonja dhe Tea Gorjanc Prelević ndajnë përvojat e tyre mbi përpjekjet për pajtim dhe drejtësi tranzicionale, duke nënvizuar rëndësinë e ruajtjes së kujtesës kolektive si mburojë kundër harresës dhe mohimit të së kaluarës. Në Serbi, Staša Zajović dhe Sonja Biserko tregojnë se si rezistenca ndaj nacionalizmit dhe dhunës mund të shfaqet në mënyra të guximshme, nga protestat simbolike e deri te angazhimi për të drejtat e njeriut në forume ndërkombëtare. Ndërkohë, në Maqedoninë e Veriut, Savka Todorovska është angazhuar për fuqizimin ekonomik dhe social të grave, duke theksuar rolin vendimtar të barazisë gjinore në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë e më të barabartë.

“Rezistenca” ofron një pasqyrë të qartë të sfidave, dhimbjeve dhe guximit të këtyre grave. Çdo histori përcjell mesazhin se edhe në momentet më të errëta ekziston një shpresë, një mundësi; se drejtësia dhe paqja nuk janë thjesht ideale abstrakte, por qëllime konkrete që kërkojnë guxim dhe përkushtim të palëkundshëm.

Ky libër i ofron lexuesit një burim të pasur frymëzimi dhe reflektimi. Gratë e portretizuara nuk janë vetëm dëshmitare të historisë, por edhe protagoniste, duke dëshmuar me veprimet dhe fjalët e tyre se historia mund të jetë udhërrëfyes, jo pengesë. “Rezistenca” është një homazh për këto gra të jashtëzakonshme dhe thirrje për ne të gjithë që të dëgjojmë, të mësojmë dhe të veprojmë për një botë më të drejtë e më humane.

T’i hapim këto faqe me respekt dhe kureshtje, duke u bërë pjesë e një udhëtimi që tejkalon kufijtë gjeografikë dhe shkon drejt thelbit të asaj që do të thotë të jesh njeri.

Korab Krasniqi
Vjollca Islami Hajrullahu

forumZFD programi në Kosovë

Nga rezistenca te paqja

Vitet 1990-të në ish-Jugosllavi përbënin një periudhë komplekse të karakterizuar nga shumë ndryshime të cilat shkruan fatet e shumë vendeve në përbërjen e saj. Ato u vunë para një përshkallëzimi të konflikteve të dhunshme, shembjes së një federate multi-etnike dhe ngritjes së agjendave nacionaliste që përpiqeshin të rimodelonin gjithë peizazhin gjeopolitik të Evropës Juglindore. Midis masakrave dhe thyerjeve të thella shoqërore që pasuan, gratë u shfaqën si dëshmitare të këtyre zhvillimeve, por edhe si agjente aktive në sfidimin e narrativave dominuese të nacionalizmit, militarizmit dhe ndarjeve etnike. Pjesëmarrja e tyre në aktivizmin kundër luftës dhe roli i tyre kritik në proceset e drejtësisë tranzicionale pas konfliktit ishin thelbësore për zhvillimin e një identiteti më të nuancuar në rajonin e pas luftës.

Ndër qëllimet parësore të këtij libri është analizimi i mënyrave të ndryshme dhe transformuese me të cilat gratë formësuan rezistencën ndaj luftës edhe përpjekjet për të ndërtuar paqen pas saj. Në shumë raste, aktivizmi i tyre doli si një sfidim i drejtpërdrejt i normave tradicionale për gjininë, strukturat patriarkale që dominonin jetën politike dhe tendencën e pasluftës që të evitohej gjykimi ndaj shkeljeve dhe padrejtësive. Megjithatë, në diskursin kryesor mbi historinë e konfliktit dhe pajtimit, kontributi i tyre shpesh mbetet i panjohur, jo në vendin meritor. Një pjesë e kësaj përqasjeje në këtë libër shqyrton rolin e grave pikërisht në lëvizjet kundër luftës në ish-Jugosllavi. Gratë e intervistuara për këtë libër, por dhe të gjitha kontribueset e tjera kishin rol thelbësor në mobilizimin e një opozite që dënonte luftën, që bënte organizimin e protestave dhe krijimin e një platforme për gratë që të flisnin kundër dhunës. Këto organizata formuan një pjesë integrale të kundërshtimit më të gjerë qytetar ndaj militarizmit dhe krimeve të luftës. Kështu, duke ofruar një zë alternativ ndaj ideologjive nacionaliste që udhëhiqnin konfliktin, këto gra aktiviste pozicionuan veten në krye të thirrjeve për paqe, drejtësi dhe ballafaqim me të kaluarën.

Pas luftës, faza e dytë e aktivizmit përqendrohej në drejtësinë tranzicionale, një fushë në të cilën pjesëmarrja e grave doli sërish po aq e rëndësishme. Drejtësia tranzicionale ka për qëllim të trajtoj shkeljet e të drejtave të njeriut nga e kaluara, duke ndërtuar bazat për një të ardhme më demokratike dhe paqësore. Ndërkaq, derisa rajoni përballej me pasojat shkatërruese të dhunës etnike, përfshirë dhunën seksuale të përdorur si një armë lufte, gratë sërish ishin në krye të iniciativave për kërkesa për drejtësi. Organizatat e udhëhequra nga gratë, nuk u angazhuan vetëm në dokumentimin e krimeve, por gjithashtu avokuan për reforma ligjore dhe përfshirjen e krimeve me bazë spcifike gjinore në gjykata ndërkombëtare të krimeve të luftës. Krijimi i iniciativave si “Gjykata e Grave” në Sarajevë, e mbajtur në vitin 2015, e konsolidoi edhe më tej rolin e grave në kërkesat për llogaridhënie për dhunën seksuale dhe nxitjen e një qasjeje më të nuancuar karshi gjinisë në proceset e drejtësisë dhe pajtimit. Megjithatë, aktivizmi i grave nuk ishte një proces që kaloi pa sfida. Përveç përballjes me kundërshtimin e thellë politik dhe shoqëror, gratë përballeshin me margjinalizim të konsiderueshëm si në sferat politike të shteteve të tyre përkatëse, ashtu edhe në procesin e ndërtimit të paqes. Pavarësisht këtyre pengesave, këmbëngulja e tyre rezultoi në arritje konkrete: në një ndërgjegjësim më të madh ndërkombëtar të dimensioneve gjinore të luftës dhe konfliktit, përfshirjen e dhunës seksuale si një krim lufte të njohur në sistemin ndër-

kombëtar të drejtësisë dhe krijimin e rrjeteve të qëndrueshme që vazhdojnë ende edhe sot të kenë ndikimin e tyre në përpjekjet për ndërtimin e paqes në regjion. Për më tepër, një nga sfidat kryesore që gratë përballeshin në kontekstin e konfliktit ishte heshtja sistematike e përvojave të tyre, si gjatë luftës ashtu edhe pas saj. Zërat e grave, veçanërisht të mbijetuarave të dhunës seksuale dhe krimeve të tjera gjinore, shpesh ishin të margjinalizuara ose të injoruara brenda narrativeve dominuese të luftës, të cilat ishin formësuar kryesisht nga elitat politike dhe ushtarake të dominuara nga burrat. Kjo ishte shtuar edhe nga një tendencë më e gjerë brenda ligjit ndërkombëtar humanitar dhe përpjekjeve për ndërtimin e paqes që i shihnin gratë si viktima pasive ose si periferike në vendosjes së stabilitetit politik. Dokumentimi i përvojave të grave në këto kontekste nuk është vetëm një akt i domosdoshëm i ruajtjes historike, por edhe një hap i rëndësishëm për të siguruar që perspektivat e grave të jenë në qendër të drejtësisë dhe proceseve të pajtimit pas luftës.

Duke vendosur kontributet e grave në thelb të analizës, ky libër fton lexuesit të rishikojnë natyrën e aktivizmit dhe rezistencës në kontekstin e shoqërive të luftës dhe pas luftës. Këtu shqyrtohen ndërthurja e gjinisë, luftës dhe drejtësisë dhe se si gratë në ish-Jugosllavi e kanë sfiduar dhe transformuar botëkuptimin e rajonit për paqen, drejtësinë dhe pajtimin. Duke bërë këtë, libri thekson pasojat më të gjera të punës së tyre për lëvizjet bashkëkohore për ndërtimin e paqes në nivel global. Kur reflektojmë për trashëgiminë e tyre, duhet të kemi parasysh që qëndresa dhe vizioni i grave aktiviste të viteve 1990 janë jo vetëm thelbësore për të kuptuar historinë, por gjithashtu të domosdoshme për avancimin e kauzave të barazisë gjinore, drejtësisë shoqërore dhe paqes në mbarë botën. Tutje, angazhimi i rinisë në proceset e kujtesës nuk është thjesht për ta kujtuar historinë, por gjithashtu për të sfiduar praktikat të cilat theksin e vendosin në tregimet zyrtare mbi luftën. Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut në Kosovë (YIHR KS) qëndron e pozicionuar midis ndërthurjes së angazhimit të të rinjve, kujtesës dhe të drejtave të njeriut. Si një organizatë që ka qenë thellësisht e angazhuar në proceset e pajtimit post-konflikt dhe lëvizjet për të drejtat e njeriut në Kosovë dhe Ballkanin më të gjerë, YIHR KS është e angazhuar për të siguruar që brezi i ardhshëm të mos harrojë historinë e dhimbshme të luftërave të viteve 1990, por, më e rëndësishmja, të mësojë prej saj. Një nga misionet kryesore të YIHR KS është të krijojë hapësira ku të rinjtë mund të angazhohen në mënyrë kritike me të kaluarën, të përballen me traumën kolektive dhe të punojnë drejt ndërtimit të një të ardhme më të drejtë dhe gjithëpërfshirëse.

Enis Bytyqi
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS)

***

Falënderime: Ky publikim nuk do të ishte i mundur pa kontributin e miqve dhe mikeshave, bashkëpunëtorëve e bashkëpunëtoreve, të cilët pa hezitim ndihmuan punën rreth realizimit të këtij libri.

Faleminderit Ana Pejovic, Bjeshka Guri, Bruno Neziraj, Enis Bytyqi, Gazmend Bërlajolli, Jonila Godole, Kristen Schubert, Luca Tesei Li Bassi, Marigona Shabiu, Martin Filipovski, Natasa Govedarica, Neal Raimi, Nehari Sharri, Njomza Mala Halilaj, Slaven Raskovic, Vjera Ruljić, Vjollca Krasniqi, Sunita Dautbegović Bošnjaković

***

Gjuha e përdorur dhe pikëpamjet e paraqitura në këtë publikim janë ato të grave aktiviste të ndërtimit të paqes dhe drejtësisë tranzicionale, të intervistuara për këtë projekt, dhe nuk pasqyrojnë ato të organizatorëve dhe partnerëve, të bashkëpunëtorëve apo të mbështetësve të këtij projekti.

Jam mësue me jetue edhe me të mirën, edhe me të keqen

Një tregim në veten e parë nga një pinjolle e një familjeje atdhetare e nacionaliste të Shqipërisë, që sikur e tërë klasa e vet, e vuajti më së shumti goditjen e luftës së klasave në Shqipërinë komuniste.

Fatbardha kishte bërë një fëmijëri të lumtur dhe ishte formuar e edukuar si është më së miri nga familja e njohur Mulleti, por fundi i Luftës së Dytë Botërore për të e për familjen e saj solli fillimin e një kalvari vuajtjesh të paimagjinueshme me parë në jetën e shqiptarit. Dhe, tani vuajtjen e shqiptarit, e shkaktonte shqiptari. Njeriu i Ri i diktaturës staliniste.

Për shkak të përvojës e dijenisë që kishte fituar gjatë jetës, babai i Fatbardhës, që herët e kishte kuptuar se diktatura do të zgjaste dhe do ta mjeronte e shkatërronte jetën e shqiptarit dhe çdo gjë të fisme të qenies së tij. Prandaj, duke mos pasur tjetër mundësi, e kishte përgatitur e kalitur Fatbardhën për jetën nën diktaturë dhe, çfarë është më e rëndësishme, ia kishte dhënë porosinë jetësore “mbaji në mend, mbaji edhe në zemër, edhe do t’i shkruesh” ato çfarë vuajti shqiptari, sidomos shqiptari që mendon me kokë të vet e nuk i bashkohet turmës linçuese.

Fatbardha i mbajti në mend e në zemër dhe i shkroi librat e saj që janë monument kujtese për ata që duan të lexojnë dhe të kuptojnë krimet e klasës enveriste kundër atdhetarëve shqiptarë. Vetë Fatbardha, në tregimin e saj, na thotë se librat e saj nuk janë kryevepra botërore, por janë kryevepra kujtese.

Dhe, të tilla janë.

Fatbardha Mulleti-Saraçi

Unë quhem Fatbardha Haki Mulleti, e lindur në nandor 1939, nga babai tiranas e nga nana Përfete Dan Muka nga Shkodra. Kam lindur në Tiranë në një familje qytetare tiranse, trashëgimtarë brez mbas brezi qi kanë jetue në Tiranë, ose, si me thanë, vazhdues të themeluesit të qytetit të Tiranës. Një familje e thjeshtë qytetare, që është përbërë nga 4 vajza dhe një djalë, qi lindi më 30 shtator 1944. Po ç'ndodhi me familjen time? Unë kujtesën historike e filloj pa mbushë moshën 5-vjeçare. Lufta në Tiranë, çlirimi i Tiranës, barrikada afër rrugës së shtëpisë sonë, mitralozi majë minares që gjuente. Provuem strehimet, provuem edhe pushkët e partizanëve qi ngatërrojshin atëherë dhe pata mbresa të mëdhaja. Fëmijët nuk e harrojnë luftën. M'vjen keq që të mëdhejtë e harrojnë luftën. Por, përjetova çlirimin t'u kujtue se po lirohena, por për ne, familjen time dhe një pjesë të familjeve qi njerëzit e tyne kishin punue në administratën shtetërore 1939-44, për ne qe nji trajtim tjetër, shumë i veçantë. Tashti, unë po tregoj se kush qe njeriu që punoi nga viti 1939-44. Ishte xhaxhai im, Qazim Reshit Mulleti. Një aktivist shqiptar, një djalë i ri, një student i shkëlqyer që kishte mbaruar shkollën me medalje ari. Ka qenë i vogël kur ka kontribue dhe ka mbajtë flamurin e pavarësisë. Pastaj, ka qenë adjutant i Princ Vidit në moshë të re, atëherë kur u largue Princi iu akordue nga Trolman nji bursë që të vazhdonte studimet e larta për diplomaci ushtarake. Ka kontribue në mbrojtjen e trojeve shqiptare, por në Shqipëri ndodhin gjëra të çuditshme. Ishte nip i Këlliçëve, i Mytesin Këlliçit, që ishte kryemyftiu i qeverisë së Durrësit, dhe i Marshal Këlliçit. Pra, dajat e tij ishin parlamentarë, politikanë e edhe ky vazhdoi atë rrugë. Ai donte demokraci, nuk qe dakord me bamjen e Shqipërisë nga Republikë në Mbretni. Këtu u nda rruga e tij me Ahmet Zogun. Pastaj vijon me grupin e Nolit që punoi 6 muej, por prapë u detyrue të largohej nga Shqipnia, dhe provoi 5 vjet migracion politik. I vetmi që qëndroi në Shqipni ishte babai im, se xhaxhai tjetër vazhdonte studimet në Paris, jetonte në Francë. Por edhe diktaturat, edhe monarkitë kanë ato grupet e veta, e për ta pësue, e pësoi babai im. Babai im u internua tre vjet në Gjirokastër se nuk kishte çfarë t'i bënin xhaxhit tim që ishte në Vjenë dhe në Paris, dhe kështu mbajtën babain tim të izoluem. Babai im ishte beqar, pastaj u martue e erdhi në Tiranë. Mandej ndodhi pushtimi i Shqipnisë. Vetëm mbasi u largue mbreti, xhaxhai pat të drejtë të kthehej në Shqipni, mbas 15 vitesh. U kthye, puthi tokën, gjeti djalin 9-vjeç dhe tha se nuk do të merret ma me politikë. Por, si të them, qe dhe nji rast që Jakomoni pa nji person që po zbriste nga vapori dhe po e prisnin me qindra njerëz. Mori vesh se kush ishte ky njeri. Por, kur erdhi në Tiranë nuk e lanë rehat tiranasit. I thanë: "Na mbro, na drejto". Politikan ai dhe kështu, pranoi të bëhej kryetar bashkie i Tiranës në korrik 1939. Babai im i hyri në dhomë dhe i tha, 'pse po pranon, kanë me të quejt fashist', atëherë ai iu përgjigj (këtë histori po ua tregoj si ma ka treguar babai im): "Ç'bën një kryetar bashkie? Një kryetar bashkie mbron qytetin, ngre institucione, hap kanalet, bën puseta, bën punime arti, hap shkolla. Por pavarësinë e kemi humb, pavarësinë nuk e bie unë. Pavarësinë do ta sjellë mbarimi i luftës që ka fillue. Do të punojmë për pavarësi." Kjo ishte ideja e tij.

Kur u ndanë prindërit e mi, shtëpitë asokohe ishin shtëpia të vjetra tiranase dykatëshe dhe me short babait tim i takoi pjesa e re. Me të ardhurat që i takuen babait tim, ai mundi të bante një shtëpi të vogël dykatëshe. Mirëpo, kur ban shtëpi të re, nuk të mjaftojnë të ardhurat. Tani çfarë ndodhi me xhaxhain tim, kryetar bashkie, i cili kishte aktivitet, kuptohet aktivitet antikomunist? Sepse e njihte mirë ideologjinë ko-

muniste-staliniste dhe e dinte se ç'po vinte në Shqipni. E dinte se ishte ideologji që pushtonte mendjet e reja.

U shifte që Partia Komuniste me Luftën Nacional-Çlirimtare ishte kamuflue dhe të gjithë të rinjtë hynë në luftë, dhe shumë mirë banë që hynë në luftë, por aty brenda ishte ideologjia komuniste-staliniste. Dihej se çfarë donte, por megjithatë xhaxhai mbronte qytetin nga atentatorët. Ka shpëtue jetë të rinjsh. Për shembull, i kapte italiani ose gjermani, ky kishte të drejtë të hynte garant. Hynte garant dhe kishte të drejtë t'i çonte për studime në Itali, në Firence, me ba studime. Një pjesë e tyre u kthyen, por kishin të drejtë të shkonin në mal, jo të rrinin në qytet për me ba atentate, sepse atentatet vazhdonin. Edhe, ka qenë pjesë e qeverisë që ka mbrojtë çifutët. Babai më tregonte se si ka marrë familje me nga katër anëtarë, i çonte në Priskë për me iu ba dokumentat, bile edhe me iu mësue lutje fetare islame, se i kontrollonin. Pra, janë mundue me ba mirë. Ma gjatë nuk vë dorën në zjarr për me tregue aktivitetin, sepse asht aktivitet nën pushtim. Por me kohën që vjen, duke u plakë dhe duke u moshue, njeriu vjen duke arsyetue, domethanë paska njerëz që sakrifikojnë gjithë karrierën e tyre të shkëlqyeshme atdhetare për me i shërbye nji qyteti ose vendit të vet edhe nën pushtim. Historia ka tregue që edhe kjo ka pasë nji sukses. Pse? Mund të bësh atentate. Kur? Kur të sulmon ty gjermani? Kur të sulmon ty italiani?

E, atentatet i bënin këta të rinjtë e grupeve komuniste. Ata i bënin në emër të komunizmit, gjoja në emër të lirisë. Ata u bënin atentate fashistave, njerëzve që punonin në administratë, ose që drejtonin shtetin, ose që u dukej atyre se kishin bërë keq. Por, në këtë periudhë kur vrisje një gjerman apo italian: çfarë të bënte gjermani? Sa ka vra gjermani për nji gjerman? Ka vra 100, ka vra 200. Duke ditur këtë, si mund ta bësh këtë në një qytet, në një zonë ose në ndonjë fshat pasi ti të vrasësh tre gjermanë dhe gjermanët t'i vrasin me qindra veta nga fshati? Domethënë, nji superfuqi që nuk po mundet me e përballue Evropa, komunistët shqiptarë donin ta nënshtronin duke sakrifikue njerëzit e tyre. Nuk e di si mund ta konceptonin.

Hebrenjtë erdhën nga Kosova dhe xhaxhai, që ka qenë kryetar bashkie, ka kontribue, por edhe babai im ka strehue njerëz. Edhe ka hyrë garant dhe ka shpëtue njerëz. Bile, ka qenë mamaja ime që ka shpëtue Ramiz Alinë. Po cila ka qenë lidhja? Mamaja më thoshe se ai ishte rritur tek familja Vuçitërni, që ishin dhëndër të familjes së mamës. Mamaja e Ramiz Alisë i qahet mamasë sime duke i thënë se i kishin kapur të birin, që ishte student. Mamaja ime i thotë se ishte ndarë prej kunatit. Por, megjithatë, mamaja u mundua të bënte diçka e shkon tek xhaxhai dhe i thotë se na kanë kapur një ilaka, që në Shkodër i thojnë kushëri. Xhaxhai kërkon që të takohet me të atin e tij. I ati i Ramiz Alisë i thotë "ky është një i ri, që i ka hyrë rrugës së komunizmit, por ma shpëto". Xhaxhai i thotë se ka vetëm një të drejtë, që të dalë garant për të, ta nxjerr nga burgu dhe ta nis me studime në Romë. Por ai iu kishte futë rrugëve e nuk do të qëndronte aty shumë gjatë. Dhe kështu, e shpëtoi. Mbas një mueji, vjen adjutanti, një djalë gjigand i nji familjeje të nderueme të Matit. Dhe i thotë: "Zonjë, ju kërkon zotëria". Ky i fundit i thotë zonjës t'i çojë fjalë babait se djali i tij është larguar nga Roma dhe është fshehur gjetkë. Domethanë, mundësitë e xhaxhait tim ishin këto. Por se çfarë u bë më vonë Ramiz Alia dhe si e vijoi karrierën e tij, kjo është tjetër gja. Por mjafton që ka ba mirë. Mamaja ime e ka shpëtue, por nëpërmjet firmës së xhaxhait. Ka ba mirë sa ka muejt. Ka strehue njerëz e të tjera.

Në vitin 1944, bahem motër e një djali të vogël, që lindi në një shtëpi në Tiranë, kur

kërciste pushka. Babai ndodhej në Shkodër me dy motrat e tjera dhe në këtë kohë e pritën shkodranët. Por kur xhaxhai u bë gati të largohej i thotë: “Nuk je largue nga Shqipnija ti?” Ai i thotë: “Po ku të iki unë me katër vajza? Po pres të vijë fëmija i pestë.” Xhaxhai i kthehet: “Shiko, atë që s’kanë muejt me m’ba komunistët mue kanë me ta ba ty.” Babai im tashti bashkohet me tregtarët e Durrësit e të Shijakut dhe nisen e shkojnë në Selanik. Në Selanik vendosen në hotel, por shoqëruesit shkojnë tek njerëzit që njihnin. Fatkeqësia e babait tim ishte se komunistët grekë, duke mendue se ky ishte ndonjë pushtetar, e kapën dhe ia dorëzojnë komunistëve shqiptarë. Domethanë, babai im ngeci se ngeci në Shqipëri. E morëm vesh se e kishin kapur dhe se e kishin prurë në Tiranë. Kur e prunë në Tiranë ata që s’e njihnin thanë se ky “s’ka gja”, por të tjerët që e njohën se vëllai i kujt ishte, e çuen për gjyq. Kam përjetue gjyqet komuniste të 1945-s si fëmijë dhe kam pa si e trajtonin dhe çfarë s’thonin për babën. Lloj-lloj gënjeshtrash. Nga dënimet ma të nalta që ishin me pushkatim, me 20 vjet, me 15 vjet, me 5 vjet, zbriti dënimi i babait tim me 3 vjet burg. Tre vjet me shpronësim pasurie se i thonin “ke ba shtëpi në kohën e fashizmit”. Por ai u mundue t’u shpjegonte se “kjo ishte një shtëpi e bërë me trashëgimi dhe me mundin e jetës sime që kam punue në administratë”. I morën me pasuni, me të gjitha. Mandej unë vijova klasën e parë në Tiranë në shkollën “Avni Rustemi” dhe mbaj mend se recitonim bukur atë këngën “Gështenja e vogël që zbret nga malet”.

Por ç’na ndodhi ne? Ne jena trajtue shumë keq. Na nxorrën nga shtëpia. Në shtëpi futën partizanët, njerëzit që ishin në pushtet. Ne na hoqën nga Tirana. Nuk na lejuen me jetue në Tiranë. Na morën çdo gjë, vetëm mobiljet e mamës nuk i morën. Pra, jorganët, shtretërit, dyshekët që kishte prue shkodranja pajë nga prindërit e saj. Përfunduem në bodrumet e Kavajës. Kjo ishte shumë e vështirë për mue dhe motrat e mia, 10 dhe 12-vjeçe, sepse ma përpara kishim jetue përs’mbari, kurse tani në ato bodrume, jetonim pa të ardhura jetike dhe kur mbaroi burgun babai, ishim në një gjendje shumë të keqe.

Fëmijëria

Tirana ka qenë nji qytet i vogël, por që mori vlerë kur u ba kryeqytet. Qeveria e Durrësit nuk u pranue të hynte në Durrës nga anti-shqiptarët dhe u çuen tiranasit, edhe xhaxhai im që ishte i ri, me dajat e vet, për të hapur dyert e shtëpive për qeverinë e Tiranës. Njëra nga shtëpitë e familjes Mulleti, u bë Ministri e Bujqësisë. Domethanë, këta tiranas pranuen që të vinte qeveria dhe kryeqytet u ba Tirana. Tirana ishte me shtëpia të vogla dykatëshe. Kishte dhe një lagje të re të kohës së Mbretit Zog, ku kishin fillue ndërtimet e reja, por ne mbetëm si familje e vjetër tiranase me ato shtëpitë e vjetra. Se ne kemi qenë një familje që kena provue emigracionin. Gjyshja ime i ka pa djemtë e saj vetëm kur udhëtonte në Paris dhe vdiq pa i pa fëmijët. Pra, jo nji familje shumë e kamur. Se edhe ne Mbreti Zog na i mori pronat me çmime të çuditshme. Gjyshja s'e vuni firmën, por me dokumente u morën. Pra, kjo ishte gjendja jonë. Por baba im ishte nëpunës punëtor në administratë, njeri besimtar mysliman, besonte në Zot shumë dhe qysh të vogla na edukoi me iu lutë Zotit, në gjuhën shqipe. Në familjen time flitej gjuha shqipe zyrtare, që ishte caktue qysh në Kongresin e Gjuhës Shqipe të Elbasanit. Nuk kena folë atë gjuhën e randë tiranase, por kena folë në familje gjuhën zyrtare që ishte në Shqipni para çlirimit.

Unë kam lindë në shtëpitë e vjetra të Mulletit, shtëpi të cilat më vonë i takuan xhaxhit të vogël, Hysni Mulleti. Ishte një shtëpi me komoditet, me sobë që ngrohte, me poltrona, me shtretër, hanim në tryezë dhe jetonim në një mënyrë të mirë. Visheshim bukur dhe kishte mjaft dashuri. Kaq. Unë nuk e kam arritur gjyshen nga babai. Por gjyshja ime jetoi në zemrën time nëpërmjet tregimeve të babait. Tregonte për nji nanë heroinë. Jo si nënat e tjera tiranase, ajo e harxhoi pasurinë e vet me i shkollue fëmijët. Por dëshira e saj me i kulturue fëmijët ishte antagoniste me shoqërinë që ishte në atë kohë. Kjo i kushtoi shumë. Këta djemë që u rritën, donin një qeverisje evropiane. Nuk donin monarki a diktaturë. Kjo tashti ka qenë ndryshimi në familjen tonë.

Babai i babait tim, Reshit bej Mulleti, kishte vdekë në fillim të shekullit. Një burrë i ndershëm, një burrë i urtë qi ishte kapë nga serbët në kohën kur këta kanë hyrë si pushtues. Babai e pësoi për shkak të aktivitetit patriotik të të birit. Serbët besonin se i pari ishte aktivisti. Vdiq i ri, më 1916. Edhe gjyshi ishte tiranas. Tiranasit e quanin "bej" me respekt. Babai ka pasur edhe një vëlla të vogël, Hysni Mulletin. Ai studio në liceun e Korçës dhe ka qenë student në të njëjtën periudhë me Enver Hoxhën. Aty janë njoftë. Kurse xhaxhai i madh ka pasur bashkënxënës Zogun në Stamboll Edhe ky i fundit ka pasur bursë nga Trolman. Kanë qenë bashkë në ato klasat elitare. Xhaxhi im ka vazhdue edhe në Zosimenë e Janinës. Janë djem që kanë marrë disa gjuhë të huaja.

Për qytetin e Tiranës unë kam kujtesë fëmijërie, që aty kah mosha 5-vjeçare. Sheshi i Pazarit të Ri, i cili bahet në kohën kur xhaxhai ishte kryetar bashkie, ishte pranë shtëpisë sonë. Mbaj mend aty edhe banjot nëntokë. U ba nji planimetri e re në kohën e Italisë. Atëherë xhaxhai thirri kushërinjtë dhe neve. Shteti pushtues, na njohu të drejtën e shpërblimit që na kishte marrë Zogu. Ky shpërblim i erdhi familjes Mulleti, edhe kushëririt Ali Mulleti, dhe u vendos që të baheshin dyqane. Domethanë, aty ku filloi shtëpia jonë e re, e babait tim, vazhduan dyqanet që vijojnë të jenë prapë sot. Dhe ishin me radhë: 4 dyqane Qazim Mulleti, 4 Hysni Mulleti, 4 Haki Mulleti e pjesën tjetër e kishte djali i vetëm i xhaxhait, Ali Mulleti. Sa kishin këta të tre, ai kishte vetëm. Ky qe

aktiviteti i parë që familja ime u ba me pronë. Një pronë qytetare dhe ishte perspektiva të bëheshin shtëpitë sipër. Familja ime hyri në shtëpinë e re o në korrik, o në gusht. Mbaj mend që kam bajtur ato jastikët e bukur për të shkue tek shtëpia e re. Babai bani nji mevlud, si thuhet nji lutje të madhe me klerikët, kur u fut në shtëpi. U ba një festë madhështore me ato lutjet fetare që i luten Zotit për mirëqenie e paqe, për drejtësi e jetë. Ka qenë moment i paharrueshëm.

Rrugët u patën shtrue, u pat ba edhe sheshi i Tiranës, u patën ba edhe institucionet. Kam shkue në kinema. S'dishim me dalë prej kinemaje, qëndronim 4 orë. Shikonim filma për fëmijë, shëtisnim mandej. Kam provue shtegtimin në kohën e luftës në Tiranë. Kam shkue me jastikë në kokë për me u strehue te një hallë e imja që ishte tek familja Kazazi, por që atje sa ra bomba, u kthyem edhe njëherë tek familja jonë dhe u futëm në bodrumin që kishte shtëpia. Tashti, në atë bodrum është strehue gjithë kjo pjesa e lagjes. Ishin rrobaqepës grekë që jetonin tek familja Mulleti, në bodrum. Kur dilnin nga shkallët, me luejt në oborrin e familjes, na takonte që ne të hidheshim te shkallët nën bodrum sa herë që dëgjonim plumbat. Domethënë këto kanë qenë momentet që me luejt në oborrin e familjes, na takonte që ne të hidheshim te shkallët nën bodrum sa herë që dëgjonim plumbat. Domethënë këto kanë qenë momentet që mbaj mend unë nga lufta. Mbaj mend edhe një moment tjetër, të zorshëm, ishte koha kur kalonin partizanët. Një nga këta rrobaqepësit grekë se ç'i tha koka me thanë "Halt", e na morën dhe na nxorrën nga bodrumi dhe na arrestojnë. Kapin nëna dhe fëmijë të vegjël. Aty kishim edhe një familje kosovare, Basha. Ajo kishte kushërirën e babait, që unë i thoja hallë. Ajo nana gatuante bukën, kurse babai i asaj familjeje siguronte vaj, miell, kripë. Ky ka qenë strehimi në Tiranë. Mandej, mbaj mend se jena gëzue kur u çlirue Tirana. Festë! Pastaj për ne filloi një vuejtje tjetër; për ne nuk mbaroi lufta. "U çliruam", kështu e quejtën se ne i kena pasë thanë "liri'. Komunistët i shtuan një "ç" përpara. Që më kujtonte fjalën "çnjerëzore", ishte e çuditshme. Atëherë kur u dënue babai, shkonim për ta parë në burgun e Tiranës dhe kishte fshatarë të burgosur, të cilët me bërthamat e pjeshkëve na bënin unaza të vogla dhe i vinim në gisht.

Por ç'ndodhi tjetër? Babai financoi dhe bleu 500 sahata "Zenith". I kishte nën një valixhe të vogël dhe e kishte strehu dikund. Mamasë sime ia sjellin një natë, që mamaja s'dinte ku ta fshihte. Të nesërmen, futën një djalë të ri për me shitë sapun (sapuni ishte i ndaluem të shitej në atë kohë) dhe rojet futen në shtëpi për të ba kontroll. Domethanë, ishte gjithçka e përgatitun. Gjetën valixhen që mama e kishte vënë poshtë krevatit të fëmijës. Pastaj burgosën edhe mamën. Pasi u kthyem nga shkolla, gjetëm një fëmijë të vogël duke qarë. Motra ime e madhe ishte 12-vjeçe. Fëmijën e vogël e çonim tek biruca për të pirë. Mamanë e mbajtën për disa ditë. Morëm avokat Benusin. Mama doli e pafajshme. Sahatat duhet të ktheheshin, por asnjë nuk u kthye ma. U grabitën. Çfarë kishte ruejt babai për jetën tonë, u grabit. Nuk u kthyen ma në asnjë periudhë. Na dëbuen në Kavajë, së bashku me disa familje të tjera nga Korça dhe nga jugu. Kavaja ishte një vend i vogël, si me qenë fshat. Ai bodrumi ishte karshi xhamisë së Kavajës, me spirale sipër. Ne vazhdonim shkollën. Por ç'provova unë në atë shkollë? Kur flitej për 4 shkurtin, përmendej edhe xhaxhai, sikur kishte vrarë edhe ai më 4 shkurt. I thosha vetes sikur të bëhej një gropë këtu dhe të hyja brenda. Ishte shumë e zorshme. Edhe emri i xhaxhait nga 4 shkurti është heq vetëm pas viteve 1970. Në këtë kohë që ne po jetonim në Kavajë, në vitin 1949, u prezantue dhe u shfaq komedia "Prefekti", por gërmat e Qazim Mulletit, ishin dyfish të zmadhuara. Nji komedi e shkruar nga Besim Levonja, i cili në komedi vuri emrat realë të zonjës së tij dhe të djalit minoren. Një komedi groteske, butaforike, çnjerëzore. Ajo ka qenë gjaja ma e tmerrshme që i ka ndodhë familjes sonë. Në çdo hap që hidhnim në jetën tonë, na thonin "mbesat e

Qazim Mulletit". Kuptohet, jo për mirë.

Në këtë periudhë, kur djali i xhaxhait ishte në gjimnaz, bashkë me motrën time, Donikën, pas natës që u shfaq komedia "Prefekti", kur ka shkue kushëriri në klasë, mësuesja e orës së rusishtes bëri apelin. Ajo lexon me të madhe: "Reshit Qazim Mulleti", dhe shton "Po, pse emër i vërtetë është ky?" Kushëriri më ka rrëfyer se 'mësuesja më mori pranë vetes dhe më thotë se ishte diçka që s'kishte ndodhë as në vendin e saj'. Të nesërmen vjen nji kamion dhe i dërgon, nanë e bir, në kampin e Tepelenës. Motra ime që mbeti pa strehë, erdhi tek gjyshja në Shkodër. Një vajzë e bukur, e talentueme dhe e mendshme. Por, atë kohë ulej në bankë veç dhe nxënësit e tjerë komunistë nuk i flisnin, për arsye se e dinin se mbesa e kujt ishte. Ajo nuk e mohonte dot. Ishte një nxanëse e shkëlqyeshme, por me atë tronditje që pat, pa mbarue vitin e tretë të shkollës së mesme, ju ngjit një menengjit akut dhe motra ime vdiq pa bërë 18-vjeç. Kushëriri im, djali i Qazim Mulletit, u izolue gjithë jetën nëpër kampe internimi.

Edukimi

Unë vazhdova shkollën 7-vjeçare “24 Maji” në Kavajë dhe aty kisha mësues të shkëlqyer. Më qëlloi të kisha profesorë të mrekullushëm. Njëri prej tyre ishte mik i babës, Zoi Xoxa. Jeta e tij është bërë edhe libër. Më ka bërë letërsi. E mbaj mend në klasë se si më tregonte historitë e lisit plak. Ai ishte një profesor që kishte punue për Shqipni, për atdhetari, për gjuhën shqipe. E kishin internue në Kavajë, pasi ia kishin marrë shtëpinë tek blloku i udhëheqësve dhe e kishin çuar me djalin e vdekun që i vdiq nga menengjiti. Pra me e internue, bashkë me kufomën. Ai na donte dhe mue më kishte vënë epitetin “kokrra e grurit”, sepse kam qenë e vogël, por edhe kam falë shumë. Mbarova klasën VII, por Kavaja s’kishte gjimnaz.

Tashti, në Kavajë kam pësue tronditjet e para. Shtëpia jonë ndodhej pranë xhamisë, por mbas xhamisë ishin disa mana të mëdhenj, si ato të Prizrenit, dhe ishte pazari. Gjëja më tronditse ishte kjo. Kur kapeshin djemtë antikomunistë vareshin tek mana, se ishte instalue diktatura dhe mbështilleshin me një çarçaf të bardhë. Mandej u vinin një tabelë “armik”. Ne vajzat e vogla i shihnim dhe vinim duart në fytyrë. Edhe me qerre na i kanë prue njerëzit e pushkatuem në oborrin e shkollës, që t’i shikonin nxënësit, me i tmerrue. I kam pa tek oborri i shkollës “24 Maji”. Me rritjen tonë si fëmijë bënim koleksione insektesh, herbore, merrsha pjesë në grupet e vizatimit, merrsha pjesë në balet, etj. Por më mbeti dashnia e madhe për babain. Po pse mbeti në zemrën time e të familjarëve kjo figurë madhore? Ai i kishte vue vetes detyrë me më msue historinë e vërtetë të Shqipnisë, se në shkollë mësonim histori tjetër.

Shih çfarë ndodhi me Shqipërinë. Eh, në këtë periudhë ndodhi një demarkacion, një ndamje. Shkrimet, romanet, përkthimet çfarë ishin para 1944-s u mohuen dhe filluen të rejat, ku komunistët lartësoheshin si çlirimtarë dhe si ata që kishin “ba Shqipninë”. Kurse ne të tjerët kishim gabue. Ne mësonim për reaksionarët, për fashistët, për ballistët. Duhej t’i urrenim. Nuk tregohej si kishin vrarë njëri-tjetrin. Por atë le ta zgjidhë historia, nuk hyj aty unë. Babai na kishte borxh me na mësue historinë dhe ai na thoshte: “Unë kam provue se ç’ishte komunisti grek. Ai më kapi mue dhe më dorëzoi tek komunistët shqiptarë në Korçë. Po të ishte për të fitue komunizmi, duhej të fitonte në Greqi dhe jo në Shqipni.” “Por Greqia”, thoshte babai im, “mbahej nga anglo-amerikanët. Kishin interesa në Suez.” Babai kështu më edukonte dhe më tregonte edhe këto historitë e tjera të Shqipnisë. Na mësoi që t’i luteshim Zotit dhe na përgatiti që të duronim atë që na shoqëroi gjithë jetën, “luftën klasore”.

Po, ç’ishte kjo? Tashti, udhëheqësi jonë me gjithë kupolën e vet, me gjithë komunistët që e shoqëronin, me gjithë pjesën e popullit që e duartrokiste, na quejtën familje reaksionarësh. Domethanë, na quejtën të padenjë për shoqërinë shqiptare dhe kjo quhej “luftë klasore”. Pra, mbaroi lufta e madhe botnore, tek ne vazhdoi një luftë e madhe në Shqipni. Një luftë midis shqiptarëve. Ne quheshim të deklasuem, ata quheshin triumfatorë. Ne quheshim të poshtënuem, ata quheshin të mrekullueshëm. Ne na vunë gjithë epitetet poshtënuese, deri pronar, fashist, ballist dhe kulak (quheshin fshatarët e pasur). Klerikët, edhe profesorët që kishin studiue jashtë, i vrau Enver Hoxha dhe klika e tij. U vranë vajza që kishin studiuar në Evropë dhe kishin ardhë në Shqipëri që të kontribuonin. Kështu vazhdoi jeta ime duke dëgjuar për vrasje. Më 1949 isha në vitin e 10-të të jetës sime. Daja i kushëririt tim erdhi në Kavajë dhe po udhëtonte që të shkonte në Tepelenë, që të shihte motrën me nipin. Udhëtimi asokohe ka qenë shumë

i zorshëm në Shqipëri, sepse nuk ka pasë mjete. Fjeti atë natë nga ne. Kur u kthye nga Tepelena, erdhi prapë në Kavajë. Ne ulur në një dhomë dëgjonim nga daja histori se ç'ishte "Tepelena". Aty mësuam që Tepelena ishte kamp internimi, i vumë aty ku Italia fashiste kishte pasë ngrit garnizonet dhe ishin strehue me mijëra familje shqiptare antikomuniste, tue fillue nga foshnjat e deri tek 90-vjeçarët. Kjo na tronditi shumë. Unë si fëmijë fillova të qaj. Vaji im e preku babën. E më tha: "ç'ke picirruke?", kështu më thoshte se isha e shkurtër, "Pse po vajton?". "Po vdiska ai vëllai." (kështu i thonim kushëririt). "Shiko Fatbardhë, mbaji këtu (tregon kokën dhe zemrën) se do të vijë një kohë që do t'i shkruesh." Unë isha 10-vjeçe në atë kohë.

Baba na tregonte mjaft histori, daç historitë shqiptare, daç familjare. Na ka tregue një histori tronditëse se si xhonturqit na rrethuen shtëpinë dhe gjyshja kishte frikë mos i vrisnin një nga djemtë. Na tregonte historitë e lashta greke me filozofët, na fliste për prrallat e çmueshme arabe që ishin shumë edukative. Dhe mbas romaneve që më ka tregue babai, kujtoj të parin që ka qenë "Kasollja" e Ibanezit. Ishte i përkthyem në shqip dhe fliste për një familje spanjolle që i kishin marrë pronat dhe që u shkatërruen. Ishte ngjarje e zhvilluar në Spanjë.

Por megjithatë unë e doja shkollën shumë. Jemi në vitin 1951, që më ndërron jetë motra. Jam në klasën VII. Motra ime ndodhej në Shkodër dhe mamaja ime shkon me i shërbye. Niset edhe babai. Ne fëmijët s'dinim gjë, vetëm kur një ditë vjen mamaja e veshur me të zeza, 36-vjeçe se ishte plakë para kohe. Kjo ishte humbja e parë, shpirtnisht. Doja shkollë dhe i kërkoja me insistim shkollë babës. Ai më thotë: "S'kam ku të t'çoj. Më fut në dhe." Nga kjo gjendje më nxori daja im, Zija Muka. Kush ishte daja im? Kishte qenë një gjimnazist nga Shkodra, i cili kishte punue në kohë të Zogut për reformën agrare. Ai kishte sistemue shumë kosovarë të ardhun në bregdetin e Kavajës dhe në vitet 1939-44, punoi në administratën e Kosovës në Prizren. Por pastaj shteti shqiptar ia dorëzon Kosovës, sepse drithin e Kosovës e kishte çue në Gjirokastër, në kohën kur ishte e rrethueme. U dënue 6 vjet në burgun e Nishit. Ai po aty provon torturat e burgjeve jugosllave, ku gurët ishin të mbuluar me gjak. Lirohet mbas 6 vitesh. I vonohet e drejta për të shkue në Evropë se i çonin për t'u ba spiuna dhe në fund, daja im kthehet në Shqipni. E kanë survejue dhe e kanë kontrollue gjithë jetën. Ai erdhi dhe më mori. Babai më përcolli tek treni, i kishte mbetë ende nji kapele dhe nji kostum. Më thotë: "Ndigjo Bardhë. Po të merr daja. S'kisha dashtë me çue fëmijë në Shkodër." "Pse?" i them unë. "Gjithë të mirat i kanë shkodranët, vetëm se janë "vetanë" dhe janë pak fanatikë." Femnat në atë kohë mbaheshin ende të mbulueme, kurse në Tiranë ka qenë ndryshe. Por në Shkodër, shtëpia kishte një tarabë të madhe dhe oborr të bukur. Gjyshja ime ishte një ulqinake e bukur. Babai i saj, Oso Bilali, kishte ikë nga Ulqini kur iu dorëzue Malit të Zi dhe solli në Shkodër këtë bukuroshe ulqinake. Ajo u martue në familjen Muka, ku lindën dajat, tezet dhe mamaja ime. Gjyshja, pasi më pa thotë: "ç'na ke sjellë! Po ba me vdekë si na ka vdekë ajo tjetra?" Daja i thotë se unë do të vdisja po të qëndroja atje në Kavajë. Ishte familja shkodrane që më hapi dyert e më mori. Këtu u rrita unë me dajat, tezen dhe gjyshen. Vazhdova gjimnazin "29 Nëntori", që sot quhet "28 Nëntori". Kam qenë nxanëse që kam mësue shumë, kam pasë pasion për letërsinë dhe isha e aftë edhe në landët e tjera. Veç në matematikë s'kam qenë e fortë. Jetoja me shpresën se mund të shkollohem. Por e dija se kush jam.

Pra, shkollën fillore e bëra në Kavajë, kurse gjimnazin në Shkodër. Për pushimet verore shkoja në Kavajë. Ku shkova atje, e gjeta familjen jo tek bodrumi, por në kasolle. Kishin lëviz afër stacionit të trenit, i kishte marrë një familje, për mirë, sepse babai i kishte shpëtue dy djemtë e saj nga gjermanët. Por ajo ishte kasolle pulash.

Aty gjeta një shtrat portativ dhe ca rroba. Një mjerim. Qëndrova një muaj për pushimet e verës. Aty banonte mamaja, motrat dhe vëllai i vogël. Të gjithë jetonin aty. Imagjinojeni me çfarë dhimbjeje kthehesha në Shkodër. Kur mbarova gjimnazin këtë herë i gjeta tek familja Durraj, në një barakë me katër rrota. Të gjithë bashkë aty, vetëm baba flinte në një shtrat portativ. Kuptohet, unë isha e mërzitun, se edhe unë doja të filloja shkollën e lartë si gjithë shoqet e mia, por mua nuk m'u dha mundësia. Atë vit u hap në Shkodër Instituti Pedagogjik 2-vjeçar. Këta që përfunduen me mue vazhduen në Institut, o për gjuhë-letërsi, o për matematikë-fizikë. Tashti kam mbushë të 18-at dhe jemi në vitin 1959. Punova sa munda në bujqësi por s'isha e aftë me punue në orizore. Përfundova në spital. Babai më thotë këtë kohë: "Pse nuk shkon në Shkodër, Bardha? Ndoshta gjen mundësi të fillosh shkollë ose të hysh në ndonjë punë se është qytet i madh." Por unë mendoja: "A kam të drejtë t'ua kërkoj këtë tezeve?" Në atë periudhë babai më vuante nga zemra. Mbaj mend që zgjohesha natën nga dhimbjet e babait në krahun e majtë dhe kishte kokrra të mëdhaja djerse. I fërkonim krahët të trija ne (unë dhe dy motrat). Mjekët nuk i jepnin një ditë pushim. Punonte në ndërtim. Më thoshte: "Mos u mërzit, se do të më kalojë". Tani, kur u ndava nga baba dhe isha në tren më kapi nji siklet. Kisha marak për babën. Por ai më tha se do të marrë një 15-ditësh dhe do të takohej në Shkodër. Ai besonte se Shkodra do të më ndihmonte në punësim. Erdha në Shkodër dhe në kohën që po prisja të vinte babai, më erdhi lajmërimi se babai kishte ndërruar jetë në Tiranë, ndërkohë që po qëndronte tek kushëriri. Tashti, mbas shumë viteve një person thotë se atij i bënë një gjilpërë jashtë rregullit. E humbën kështu babain në spital. Babai na kishte shkrue me kaligrafinë e tij të bukur, ku thoshte se nuk mund të vinte, por do të shiheshim. Atë letër e mora pas funeralit të babës. Atë letër e futa në një libër. Kjo qe humbja më e madhe në familjen time. Pas dy vitesh, na vdiq xhaxhai në Romë, Qazim Mulleti. Familja e tij mbeti pa ndihmë, sepse ai i sillte ndihmë ekonomike familjes në internim. Kurse ne na ndihmonte xhaxhai i vogël me ushqime. Por këtyre ushqimeve dhe rrobave komunistët u vinin një çmim aq të lartë sa gjysmën e merrte babai im dhe gjysmën shteti. Domethënë, nuk ishte një ekonomi me të cilën mund të jetonim.

Babai vdiq në shtator të 1959-s e kur e mora letrën pas funeralit, mbani edhe me qa, por edhe me i dhanë forcë vetes. Ai më kishte shkrue: "Uroj që të mbarosh shkollën, por edhe po të mos mbarosh shkollën, të gjesh ndonjë punë. Mos na harro!" Porosi që baba m'i kishte dhënë qysh në fëmini. Edhe pse po shkoj sot 85-vjeçe, ai mbetet udhërrëfyesi në zemrën time. Lum ata prindër që fusin tek fëmijët dashurinë prindërore. Atëherë shumë njerëz që na njihnin ndërhynë për punë, por ishte e pamundur. Bile në një letër i pata thanë babait më kanë premtue garderobiste tek Teatri i Shkodrës, që po hapej. Por aty kisha frikë se vinin sekretarët komunistë. Doli një variant. Rrethi i Lezhës kishte nevojë për mësues. Bana nji lutje. Isha nji gjimnaziste e shkëlqyer, e kur aplikova u prezantova si Fatbardha Mileti dhe Mulleti. Plotësuam një formular të madh, ku kishte pytje të tipit: a ke qenë partizane, a ke qenë në Luftën Nacional-Çlirimtare, prindërit e tu a kanë marrë pjesë, etj. Im atë nuk kishte marrë pjesë kurrkund. Komunistët e dinin që kishte marrë pjesë veç xhaxhai. Megjithatë më pranuen. Shefi im ishte mësuesi i letërsisë Faik Qatipi nga Elbasani. Unë kisha qenë 13-vjeçe, kur ai më kishte bërë mësim. Mandej më thotë: "E dimë kush je, por të kemi marrë provizore për 6 muej. Të kemi dërgue në fshatin Kallmet." Fshati Kallmet ndodhej rrëzë malit të Velës. Më thotë tjetër: "Je me 8 djem. Të shohim si do të sillesh." Unë me 8 djem, 19-vjeçe. Kolegët erdhën, më morën dhe rrobat m'i vunë sipër një gomari. Kaluem Drinin me trap. Ecëm e ecëm e na zuri nata në hyrje të Kallmetit, ku kishte qenë kuvendi i murgeshave.

Sepse institucionet fetare ishin prishë dhe shumë klerikë nga të gjitha fetë ishin dënue. Por ata që banë bujë të madhe ishin klerikët katolikë, sepse ishin shumë. Unë hyra tek dhoma e murgeshës së madhe (brenda ish-kuvendit), që ishte kthyer në kabinet ku kishte mjete didaktike. Aty do të fleja unë, me llampë vajguri. E më thonë: "Bardhë mos u mërzit se këtu ka minj." Ky ka qenë takimi i parë. Këtu kam filluar karrierën si mësuese e klasës së parë. Një mrekulli! Kur fëmijët filluen me lexue shqip, për mue si mësuese ishte mrekullia e mrekullive. U mora me aktivitetet artistike, ku u mësoja fëmijëve valle e këngë. Atë vit fituam çmimin e parë në Lezhë, në maj të vitit 1959. Në këtë kohë marr vesh nga kolegët se ata studionin në universitet, pa shkëputje nga puna, në degët e pedagogjisë. Aty u hap një dritare.

Mua nuk më kishin pranuar në Institutin Pedagogjik? Për mospranimin tim thonin se është kompetencë e qeverisë. Hyra tek Ramiz Alia, më thoshte e ka në dorë universiteti. Babai më pat thënë: "Ti i the Ramizit se kush je?" Nuk kisha pranue me i kallxue. Domethanë ia linin portën njëri-tjetrit, ishte e kotë. Mora vesh nga një koleg i imi se në rrethin e Lezhës mungonin mësuesit e kimisë. Mësuesit ekzistues nuk kishin fort njohuri për kiminë dhe biologjinë. Unë duke qenë se kisha qenë një nxanëse e shkëlqyeshme në këto landë, vendosa të marr këtë degë që të siguroja punën. Tani kisha problem vëllain, të cilin ma la baba 14-vjeç. Nana ishte e sëmurë. Një motër ishte minorene. Atëherë mora këtë degë, e cila nuk ishte e hapur në Shkodër. Ishte e hapur në Tiranë, në Institutin "Aleksandër Xhuvani". Dega ishte biologji-gjeografi-kimi. M'u dha e drejta. Studioja vetë. Njëherë në 3 muej, kur ishin pushimet, shkoja në Tiranë dhe jepja nga 2-3 provime.

Ishin provime të vështira se ishte biologji-gjeografi-kimi me terma latine, por studimi nuk ka vështirësi kur je i ri. Studioja me dy llampa vajguri 11-she, lexoja në katedër dhe kisha vendosë të studioja deri në orën 1:00 të natës. Pa mbarue atë programin me 30 faqe nuk bija me fjetë. Çdo ditë me i mësue 30 faqe. I lesha vetes edhe një afat tjetër më i mësue, me i përsërit. Edukata ime ishte të mësoja sistematikisht. Më detyronte orari.

Gjatë kohës së verës bëja punët laboratorike. Unë pata fatin që motra e madhe të martohej në Tiranë. Mori një djalë me babë të pushkatuem më 17 nëntor, në ditën kur u çlirue Tirana, kur u vranë shumë njerëz. Ndër këta, u vra edhe babai i dhëndrit nga familja Dine. Sot e kësaj dite nuk i dihet varri, si shumë të tjerëve. Ky djalë mori motrën time. Kështu që, kisha një qendër në Tiranë, ku flija në konvikt, pra përgjatë viteve 1957-1963. Kryesisht, jepja provime dhe bëja punë laboratorike. Në majin e vitit 1963, kam dhënë 6 provime. Likuidova vitin e parë, gjë e cila u bëri përshtypje kolegëve në Lezhë. Pastaj kalova në 7-vjeçare. Kështu, mbarova Institutin Pedagogjik për shkollat 7-vjeçare. Vazhdon jeta. Unë punoja me nxanësit e shkollës, nuk ju hyja në hak as për orë të mësimit, as për kurrgja. Kam punue aq shumë, por kurrë në jetë nuk më kanë shpërblye aq shumë. Një vit marr vesh se shkolla jonë nuk kishte marrë shpërblim. Mora vesh se shpërblimi u ishte hequr mësuesve të tjerë sepse në listë ndodhej emri im. Drejtorit i thashë të dërgonte listat e mësuesve të tjerë se ishte gjynah. Në fund ai i çoi emrat. Lufta klasore erdhi duke u forcue. Luftën klasore e përdorte Enver Hoxha sipas interesave të veta. Kur kishte nevojë merrte nga shtresa jonë me punue, kur s'kishte nevojë i dënonte në mënyrat ma poshtënuese. Brezi i ri i komunistëve që begeniste në shkollë, nuk na jepte as dorën. U indoktrinue shoqnija. Unë vazhdoja punën time, edhepse, me thanë të drejtën, kisha frikë se mos do të më hiqnin. U ba nji fushatë e madhe në vitin 1966, por në atë periudhë, unë me dy kolegë të mi, një profesor i mrekullueshëm, Nush Radovani, që kishte studiue në Firence dhe me një koleg tjetër,

Muhamet Kastratin, bamë një grup artistik në fshatin Manati. Hera e parë që nxorrëm vajzat mirditore më kërcye, me fustanet e bukura. Bëmë një orkestër me çifteli. Zbulova një valle të vjetër nga një zonjë 90-vjeçare: “Hypa majë lisit o-o, bum u rrzova”, dhe shoqërohej me kërcim. Nji mrekulli!

Fituam çmim të parë në Lezhë! Unë u vesha si mirditore. Erdhi grupi i xhirimit, për grupin artistik. Atyre u thojnë në vesh: “E dini kush janë këta mësuesit?” Një i ri kishte dalë nga burgu, unë isha mbesa e Qazim Mulletit, tjetri e kishte babën në burg. Grupi ikën dhe nuk e xhiruen punën e atyne nxanësave, që kishin zhvillue atë aktivitet për kënaqësinë e tyne. Por këtë periudhë nuk më hoqën nga arsimi, se në qytetet e tjera kishte fushatë. Por gjatë kësaj kohe ndodhem në fshatin Blinisht të Zadrimës. Kjo ishte një zonë që mbytej nga lumi Drin dhe Gjadër. Në këtë periudhë, pra 60-vjet përpara, më 1963 dhe 1964, unë isha mësuese në atë fshat. Janari i vitit 1963 ka qenë i tmerrshëm, me shira të mëdhenj. Kur morëm me shkue në fshat, pas pushimeve të dimrit, autobusi na linte aty ku rruga ishte e mbulueme me ujë. Mandej u kthyem për t’u paraqit në arsim. Nuk kishim muejt me shkue për 5 ditë me radhë. Kishte ardhë një shef i ri nga Leskoviku, ai s’donte me ditë që rruga ishte e xanun. “S’keni shkue 5 ditë në fshat,” na tha. “Do të keni 5 ditë ndalim nga rroga. Si dhe vërejtje paralajmërim me ju heq nga puna.” M’u desh të kaloja mespërmes ujit të Zadrimës, gjë e cila e shqetësoi nënën time. Ne ishim 5 veta, miku im i ngushtë Simon Gazulli, që kishte ba shkollë për prift, por ishte mësues nga Gazullorët e Zadrimës; Aqif Plaku me babë në burg, kishte qenë nip i Dan Hasanit në Shkodër; një djalë Rroji, nga familja tregtare Rroji; një vajzë tjetër, Maria Dabërdaku, me vëlla e babë të pushkatuem; e pesta isha unë. Mendoni tani që të gjithë neve ecnim nëpër ujë me orë, për të mbërritur në Blinisht. Lageshim, binim nëpër kanale, por në fund mbërrinim në fshat. Një ditë, një vajzë zadrimore na sjell një gjym me ujë të nxehtë. Ajo më thotë: “Zonjushë, ka thanë nana, përvlojini ato kambë me ujë të përvluem.” Ne ishim krejt të lagun. Kështu që, jetuem në këtë fshat të izoluem me ditë të tana. Sepse uji u ba akull, ai kishte qenë një dimër i tmerrshëm. Temperatura e dhomës ku flinim shkonte -9 gradë celsius. Flinim dy vajzat bashkë dhe hidhnim dyshekun tjetër sipër. Edhe për ushqime mbetëm keq, se s’na mbeti asgja. Fshati merrte 1 kg miell për me e ba qull, se çfarë do të hanin të tjerët. Në një natë të këtillë, kur po hapej rruga, ai inspektori i zonës që ishte nga Lezha, Jak Smaçi, një djalë xhevahir, që më vjen keq që ndërroi jetë i ri, i thotë shefit: “Shoku shef, a din gja ku i ke këta 5 mësuesit. Se mësuesat e tjerë shkodranë, nuk shkuen në fshatrat e tyne. Ata s’i gjeti gja.” Sapo kishte ra nata, kur hapet dera. Ishte shefi i arsimit dhe ky inspektori. Na gjeti t’u hangër nga një copë bukë kallamboqe me çaj dhe një supë në një pjatë llamarine që brenda kishte bokla, koçana i thojnë në gjuhën letrare. Ato ndezeshin, nxehej stufa, bahej e kuqe, mandej stufa ftohej nga sipër. Kështu na gjeti shefi. Fjeti atë natë me ne. Të nesërmen thotë: “Ato ditët që të kam heq nga rroga, s’kam si me t’i heq. Edhe vërejtjen me paralajmërim, s’kam si me ta heq. Ke ba nji lutje që don me vazhdue universitetin, nuk ta kena dhanë, por po ta jap kyt herë.” Nuk ja kam harrue kurrë Paskal Ristanit, m’u dha e drejta me vazhdue universitetin në Tiranë, tani bio-kimi, se dega ku përfshihej edhe gjeografia ishte institut tjetër. Por për fat të keq më kapi regjistrimi i vitit 1964, jo i 1963-shit. Doli nji rregullore e re që këto provimet qi kisha dhanë unë në botani, zoologji, kimi, u mohuen. Në kohën e komunizmit, për të privilegjuarit, për fëmijët e tyre, komunistët ngrinin ca institute njëvjeçare, që merrte diplomën filani njësoj si unë. Unë edhepse kisha shkue në vitin e tretë, u ktheva me ba provimet e vitit të parë si botani e zoologji. Nuk asht gja e vogël t’u hysh edhe njëherë. Megjithatë kam studiue shumë. Kjo ishte meritë e rinisë, e vullnetit dhe asaj që i kisha vue vetit detyrë me u ba me shkollë të naltë. Kjo bëhej që të siguroja punën, se e dija se do të mbesja në fshat. Kam punue shumë. Kaluan vitet, u rrita,

u moshova, se në fshat 20-vjeçe më quheshin të moshueme, se ishin mësue me marrë minorene. Mendo të rritesh në fshat tue të thanë: “Je e madhe në moshë”. Imagjino kur kapje moshën 25 apo 30-vjeç.

Pastaj u regjistrova në fakultet. Ka shumë peripeci fakulteti. Ishte me provime, me punë laboratorike. Por, kur erdhi koha për provimet e shtetit aty më ka ndodhë diçka. Herën e fundit që kam shkue me dhanë provim në universitetin e Tiranës, ka qenë viti 1969. Ishte provimi “Fiziologjia e trupit të njeriut”, profesor i të cilit ishte fiziologu i madh i Shqipnisë, profesori Bajazit Shehu, që kishte studiue në Budapest. Ra shi si të më ndiqte e keqja gjithkund. U nisa, kalova buzë Drinit, i kishte marrë Drini ato vigjet (urat) me vete. Po mbaronte pasditja, kur dëgjova një trokth kali. Kthej kokën, kur shoh kryetarin e kooperativës së zonës, të Mabës (Lezhë). Ishte agronom, shkodran me origjinë, Tonin Alimhilli, ishte i gjatë. Mora gaz, sikur pashë Don Kishotin e Mançës majë kalit. Më thotë: “Dëgjo Bardhë, të kisha marrë në kalë. Por kali, na hedh në ujë dhe po mbytena.” I thashë: “Jo, jo nuk po hipi as në kalë, as në biçikletë, as në motorr.” Bana gati teshat dhe hyra në kanal vaditës. Një fshatar po gjuente peshk në anën tjetër : “Shiko ti mësuese,” më thotë, “ai kanali ka ujë e ti je e shkurtë. Mundohu të kapesh në të dyja anët dhe shiko se si janë gurët e vuem, që të të bien uji në gojë.” U kapa unë, zgjatem e tërhiqem. Por ai guri ishte hedhë për një djalë që ishte 1.90 metër, e jo për Bardhën që ishte 1.60 metër. Megjithatë kalova. Shkodrani (agronomi) kur u largue nga kanali më dha dorën: “Tash nuk kam ça me t’ba Bardhë, se do të kthehem në fshat për mos me m’zanë nata.” Dola në rrugë të makinës dhe më mori një makinë. Shoferët na njihnin. Mbas tri kilometrash ndal shoferi. “Bardhë je ti?” më pyet. “Po.” i tham unë. “Po si je nxi kështu?” “Ec, ec”, i thashë. Unë isha komplet e lagun, vetëm kisha pallton sipër. Të nesërmen nisem për Tiranë. Më dhimbte gjithë muskulatura e trupit, se unë kam shkue për Tiranë me lundër edhe kur u prish ura e Bunës. Vazhdonte shiu. Hyra në provim.

Pyetja e parë ishte për zemrën dhe aortën, pyetja e dytë ishte për mëlçinë, e treta për tiroiden. Flas për zemrën e aortën dhe profesori më sheh e thotë: “Moj çupë e mbarë, si ke ardhur nga Zadrima, që është e mbuluar me ujë?” Profesorët më mbanin mend. I thashë: “Profesor, këtë herë kam heq keq, kam kalue një kanal vaditës. Ishte hera e parë dhe e fundit që një profesor nuk pyeti ma, por më vuni notë. Universiteti u krye dhe tashti kishin mbetë vetëm provimet e shtetit. Mirëpo, ç’ndodhi kur u regjistrova për provimet e shtetit? Një sekretare aty, e familjes Dume, që kishte përfaqësues në instanca të larta të shtetit, kishte qenë sekretare në Institutin e Shkodrës, ku ka vazhdue vëllai për matematikë me mbiemrin Mileti, më pyeti: “çfarë e ke ti Tanush Miletin?” I them me vrik: “Po, vëllai.” Mandej, thotë: “Po e dini kush është kjo? Është mbesa e Qazim Mulletit, armikut të popullit.” Kjo bëri bujë, jo s’e nuk e dinin profesorët. Profesorëve të mi iu bënë presion. Ai i biologjisë, profesor Lame Zeka, që e mbytën hajdutët mbas demokracisë, më thotë: “Shiko çupë e mbarë, ne nuk pranojmë që mos të të japim provim.” Por u thye profesori i kimisë, një shkodran që kishte qenë mësuesi im i gjimnazit. Dy herë më rrëzoi në kimi. Kur shkova herën e tretë, e kisha mësuar aq mirë sa mund t’i thoja të gjitha. Por këtë herë rrezikohej gjithë puna ime. Më vjen një ditë një djalë përmetar, i martuem me tiranase dhe më thotë se donte të hynte në provim me mue se i prihej mbarë. Unë i thashë të hynte më dy shkodranë të tjerë: njëri ishte djali i kryetarit të lagjes sime dhe tjetri ishte djali i një profesori. Unë hyra në treshen e parë. Mirëpo, gjithmonë ka pasë njerëz të mirë Shqipnija. Osman Kraja, dekani që drejtonte aty e kishte marrë vesh këtë punë dhe më çon fjalë përmes një personi tjetër. Porosia e tij ishte: “asaj vajzës thueji t’i shkruej përgjigjet e plota që në rast se nuk e merr provimin, ia japim ne me komision.” Ky qe favor i madh.

Studentët dolën mbasi dhanë provimin. Unë e mora provimin. Po prisja këtë kolegun tjetër, vonoi 2 orë. E pyes si i shkoi. Kishin kalue të gjithë, si ata të dy shkodranët, edhe Luli. Mandej i çoj një mesazh atij profesorit tim të nderuem: “Si e ngele Bardhën dy herë, dhe kalove ata dy shkodranët me të parën?” Ka thanë: “Më fal.” Paçin dritë se kanë vdekë të gjithë. Shkova me marrë diplomën mbas nji mueji, por më kishte ndryshue sekretarja emrin e babës nga Haxhi e kishte ba Haki. “Kjo s’është diploma jote,” tha sekretarja. Profesorët protestuan duke thanë se kjo është studentja jonë që ka studiue pesë vjet tek ne. Kjo ishte një humbje e madhe. Kthehem në fshat. Më thonin: “Ata s’kanë me ta dhanë” etj. Vajtova mundim tim të aq viteve. Shkova në Lezhë, mora dokumentin e lejes së arsimit, librezën e notave dhe shkoj te dekani. Ky i fundit dhe profesor Popa ishin tue ecë, unë isha dy metra pas tyre, pranë korpusit kryesor. Dekani kthen kokën dhe thotë: “Po ju Bardha?” “Kam punë me ju,” i them. Hyra tek dekanati, hera e parë që flisja me dekanin. Ishin edhe dy asistentë, djem të rinj, si drita. I them se jam Fatbardha Mileti ose Mulleti, kam punue kaq vite në arsim, kam studiue me korrespondencë pa shkëputje nga puna, kam mbarue provimet dhe nuk më japin diplomën për shkak se kanë ndryshue, me vetëdije ose pa vetëdije, emrin e babait. Më pyeti nëse dokumentet që i lashë në zyrë donte t’i firmoste. Nuk pranova, pasi më dukej fymje kërkesa që po i bëja për marrjen ose jo të dokumenteve. Më porositi që të vija pas dy javëve në Tiranë për të marrë diplomën. Pas dy javësh mora diplomën time, që ishte aq e bukur, por nuk u gëzova shumë. Më shumë isha gëzue kur kisha marrë provimet. Isha në kategorinë për mësuese gjimnazi, por mue nuk më çuen në gjimnaze, më lanë në 8-vjeçare dhe e gëzova vetëm 4-5 vjet atë diplomë. Kam ba punë laboratorike në shkollat ku kam shkue, se biologjia s’mund të bahet pa eksperimente. Kisha ba një laborator të shkëlqyeshëm në Manati, që u prish shpejt.

Si e bana laboratorin? Laboratori bahet me ndihmën e nxanësve. Për shembull, të bësh diseksionet e kafshëve, për më pa organet e brendshme, i përgatisnim me ditë, i fusnim në kavanoza, i izolonim dhe i plotësonim raftet me preparatet tona simbas klasave, tue fillue nga peshqit, amfibët, reptilët e më lart. Kjo punë u vlerësue shumë në Lezhë. Por më hoqën nga ai fshat dhe më çuen në Zadrimë, prunë një mësuese tiranase që kishte mbarue universitetin. Gjithashtu, diçka tjetër për laboratorin. Më patën caktue mue dhe një koleg tjetër, Anton Benusin, me përgatit këto preparatet që kisha ba në shkollën time, për 13 shkolla të rrethit të Lezhës. Kemi punue ai dhe unë një muej në Shëngjin. Unë flija tek konvikti i vajzave i shkollës ekonomike në Lezhë dhe e drejtonte një Ndue Lala, lezhjan. Unë punoja gjithë ditën atje me formalinë. Kishim futur nëpër kavanoza me etiketë shumë peshq të zonës së Shëngjinit. Kushtet e punës ishin të vështira, punonim pa mjete sepse me atë formalinë mund të të ikte zani. Ç’më ndodh në ditët e fundit? Më thotë përgjegjësja të dal jashtë. “Më ka urdhërue Ndue Lala që ti të mos flesh këtu,” më thotë. Ishte ora 8:00 e darkës. Unë i them: “Këtu jam me urdhër të Komitetit Ekzekutiv. Jam tue punue për shkollat e Lezhës.” “Dëgjo Bardha,” më thotë, “o ti, o unë? Mue më heqin prej pune.” Të dilje në orën 8:00 natën në Lezhë ishte si të dilje në orën 12:00 a 1:00 në Shkodër. Hipa në konviktin e gjimnazit të Lezhës. Atje ishte shkodrani i mrekullueshëm, drejtori Ferid Ramadani. I shpjegoj situatën dhe më futi tek maturantet. Pastaj ika, nuk vazhdova ma. Domethanë, ta bante luftën e klasës njeriu ma i humbun, jo ma ma i madhi. Kështu vazhdova jetën.

Nisa mësuese në Dajç të Zadrimës. Aty punova 8 vite. Edhe aty bana nji laborator të shkëlqyeshëm, me nxanësa të pasionuem, nxanësa zadrimorë të urtë që e kanë dashtë shkollën dhe më kanë dashtë jashtë mase. Punova gjithë jetën me ta.

Fundi erdhi, më 7 maj 1975. Filluen me të madhe fjalimet e Enver Hoxhës, “lufta klasore”. U përgatitëm shpirtnisht. Sepse filluen duke fut mësues nëpër burgje. Por përsëri thoja se me gjithë këtë punë prej 17 vitesh që kisha ba në rrethin e Lezhës do të kursehesha. Isha gati 36-vjeçe. Më 7 maj më thirrën. E mbaj mend diçka, me datën 5 maj, “Dita e Dëshmorëve”. Erdhi sekretari i parë i Lezhës, njëfarë Mentor dhe banë një lapidar majë kodrave të Dajçit për partizanin e panjohur. Ndërkohë që aty s’kishte pasë luftime. E gjithë shkolla rreshtohet, unë isha në rreshtin e fundit. Kur kam pa shikimin e tij, unë e mora vesh që më kishin heq nga arsimi. Ishte një shikim i tmerrshëm, urrejtjeje. Më 6 maj lajmërohem të shkoj në Komitetin Ekzekutiv, e dija se po më thërrisnin për këtë punë. Aty ishte një burrë i shëndoshë, Baki Karalliu, zëvendëskryetari i Komitetit Ekzekutiv, i cili kishte dosjet tona. Mësuesit hynin brenda e dilnin duke qarë. Hyj unë dhe më thotë: “E kupton vetë, e din vetë. Nuk ke punë ma në arsim.” Dola. Por e keqja ime ishte diçka tjetër. Makina e fshatit më mori dhe më çoi në fshat, ku lajmi ishte marrë vesh. Të nesërmen shkoj në shkollë dhe i lutem drejtorit nëse kishte mundësi që t’u jepja orën e fundit të mësimit të lëndës së kimisë klasës VIII, për kapitullin e kimisë inorganike. Ishte pjesa ku do të mësonin për hekurin dhe vetitë e tij fizike. Më lejoi. Bana orën e fundit të kimisë me klasën VIII. Në fund iu them nxënësve: “Për kaq kimi sa ju kam ba, në çdo shkollë që të shkoni keni me dalë shumë mirë.” U përshëndeta me kolegun tim Ndue Biba, që atij i shkonin lotët, por unë nuk qava dhe dola. Drejtori nuk la asnjë koleg timin me m’përcjell. Por unë nuk ika në Shkodër. Unë qëndrova në fshat tue mendue se do të gjendej një njeri në fshat që do të më jepte një qerre a karrocë për të marrë me vete bibliotekën, se kisha shumë libra.

Për këtë moment, e kam një fotografi të fundit, e ruej si relike. Fotoja e fundit me nxënsit e mi. Nuk më dhanë karrocë. Të nesërmen, pra me 9 maj, unë po prisja që të takoja një zonjë të familjes Gazullori, që e doja shumë, kur vjen një nxanës. Ai ishte Angjelin Gazulli, nuk ia harroj emrin se ishte i pari në rreshtin e regjistrit, kishte ikë nga klasa dhe ndodhej në luginë. Më thotë: “Ua-a, mësuese gjallë je, nuk të kanë vra?!” I them: “Po pse flet kështu?” “Se kanë ardhë ata të partisë e të rinisë me na rraf”, përgjigjet ai. Kjo kishte ndodhë sepse nxanësit e 8-vjeçares kishin dalë me m’përshëndet. Nxanësit e klasës VIII, 15-vjeça, më thanë kështu kur u largova: “Ne mësuese ishim ba gati me ba nji letër që t’ua dërgonim institucioneve ku t’i kërkonim që ti me shkue në qytet se ke qëndrue boll këtu tek ne.” Unë u thashë: “Mos u mërzisni se unë do të gjej punë.” Kjo qe ndamja e fundit. Atë ditë nxanësave ju tregoj historinë e Hygoit se si torturojnë vajzën që i shkruen Febës, e cila kishte pësue dhimbë kur shkruante emrat e njerëzve që donte dhe në fund e quajtën shtrigë. Eh, paralelizma. Kur e pashë se çfarë po bëhej në klasë, mendova se po bëheshin gati të më arrestonin. Kthehem, marr çantën dhe detyrohem të digjja dorëshkrimet. I dogja.

Dorëshkrimet e mia që i kisha ba gjatë leximit të romaneve dhe librave artistikë. Sepse po t’i kishin hapë librat do të më akuzonin për agjitacion e propagandë. Vetëm me librat e Hygoit edhe do të ishte shumë. Mora çantën dhe librat e teshat e mia, i sistemova nëpër kuti, i vuna në një qoshe dhe zbrita. Me kalue nga fshati duhej të kaloja nga ura kryesore, por duhej t’u bije gjithë zyrave të kooperativës për me dalë në anën tjetër të fshatit. Ishte shtegu tjetër. Janë dy tubacione uji përmbi Gjadër, që janë hala. Aty përbri ndodhej edhe jerevia e kishës, edhe një familje e varfër, një Pjetër Lomshi, me 9 fëmijë. Shpeshherë u sillja gjëra nga Shkodra dhe Tirana se ishin shumë të varfër. Kalova këto tubacionet, pa humbur ekuilibrin dhe largohem nga Zadrima, ku kisha punue 8 vjet dhe nga Lezha që kisha kontribue 17 vjet. Erdha në Shkodër. Ishte mëngjes dhe ma hap derën nëna. Habitet që më shikon. Dita ishte e premte, 9 maj, përkonte me ditën ndërkombëtare të fitores ndaj nazizmit. Unë për vete mendoja se

kur do të vinte dita e fitores ndaj komunizmit. I them nanës që më kishin heq nga puna. Nana ma kthen: “S’kena me vdek Bardha.” Më ndoqi një depresion shpirtëror. Kolegët e punës, shoqet e shkollës të bënin sikur s’të njihnin. Ndërkohë që unë isha ajo që kisha kontribue në edukim për me i mësue si bahet një mësim model, një mësim i hapur. Unë kisha kontribute për arsimin në Lezhë. Për mue ajo heqja nga arsimi u shoqërue me shumë trauma, gjithashtu edhe në lidhjet e mia me njerëzit. Por familja mbeti e fortë. Lidhjet e mia miqësore me shumë persona si me të afërm apo me shoqet e mia të familjes Zadeja, mbetën të qëndrueshme. Kurse të tjerët jo. Kjo periudha e zorshme tre vjeçare pa punë qe një periudhë heshtjeje. Shkova me marrë librezën e punës. Hapi regjistrin nëpunësi, një njeri i nderuem. E udhëzuen mos të ma jepnin. Pastaj nuk shkova ma se nuk po gjeja punë. Më thanë t’i shkruaja një lutje Hysni Kapos. Më priti sekretari i tij, vëllain e të cilit gjermanët ia kishin varë në Tiranë. Por jo xhaxhai im. E dinte se mbesa e kujt isha, nuk e mohova. Lufta klasore ishte primare, pavarësisht kontributit dhe punës. Nuk u harrue asnjëherë që unë isha pjesë e familjes Mulleti. Unë vazhdoja të studioj. Lexoja romanet e dhimshme për kampet hitleriane.

E për mbiemrin tim, që ishte herë Mileti, herë Mulleti, ja si ishte puna. Familja ime është Mulleti. Por fatkeqësisht më 1930 kur iu ba atentati Zogut në Vjenë, në atë grup figuroi edhe xhaxhai im. Që s’kishte lidhje. Babai internohet prej Zogut dhe në atë kohë Zogu detyron popullsinë që të heq emrat e fshatrave nga mbiemrat. Kjo nuk u zbatue nga të gjithë. Baba im e ndryshoi në Milet, sepse kur këndohet në arabisht bahet Mullet. Dhe pse zyrtarisht përdorej ky mbiemër, për shembull mamaja ime këtë mbiemër mori kur u martue, të gjithë na thërrisnin Mulleti. Edhe ai personi që bani atë komedi, e bani xhaxhain të pavdekshme si figurë, por si figurë groteske. E bani të shoqen një grue të keqe. E bani djalin e vet, një njeri që shante babën e vet, gjë e cila nuk ka ndodhë kurrë në familjen tonë. Atij, që ka ba këtë komedi, i është shpëtue jeta nga firma e Qazim Mulletit. Ai ka qenë student. Por kushërira e babait, një mësuese me mbiemrin Këlliçi, kur e merr vesh që është kapë ky studenti kontakton kushërirën e vet. E lëvdon duke i thënë që studenti i saj është ekselent. Qazim Mulleti vendos të hyjë garant. Nga dokumentet që kanë dalë, vërtetohet se sa shumë herë ka hy garant xhaxhai im. Por këtë të mirë ia shpërbleu kështu. Këta janë mosmirënjohësit shqiptarë. Në botë ka, por edhe këtu tek ne ka plot.

Nuk tregova që kur u stabilizova mësuese, në vitin e dytë më dërguen mësuese të klasës I dhe III në një fshat tjetër të Zadrimës, në Mabë. Atëherë tërhoqa familjen. Motrën e nxorëm nuse nga daja dhe pruna mamën tek bodrumi i shtëpisë së nanës së vet. Aty kena jetue deri në vitin 1994. Vëllai ynë u rrit. U bë një mësues i shkëlqyeshëm fizike dhe matematike në Troshan. Por e morën ushtar. Mirëpo, djemtë e familjeve tona i çonin në reparte pune. Kishin detyrë të punonin në fusha patatesh. Mandej e çuen në bonifikimin e bregut të Liqenit të Shkodrës. Motra më e vogël bani gjimnazin në Shkodër. Edhe ajo ka punue mësuese. Ka qenë ndër mësueset e para të zonës së Dukagjinit. Mandej punoi në fshatrat e Lezhës, u martue me një djalë nga familja Batalaku që ishin gjakovarë, por ardhë në Shkodër, me nënë nga Prizreni. Djali ishte një shofer i talentuem. Po lufta e klasave shfaqet përsëri. Motrat e këtij djalit e mohuen dhe nuk i flasin ma. Sepse njëra ishte drejtoreshë, tjetra pedagoge dhe një tjetër punonte në bankë në Tiranë. Vetëm sepse ishte martue me motrën time, mbesën e Qazim Mulletit. Jetuen të lumtun dhe patën dy fëmijë. Më 1971 vjen Ansambli i Prizrenit “Agimi” me dhanë shfaqje në Shkodër. Daja i kunatit tem, Mate Vuçaj, ishte pjesëtar i orkestrës. Kishte ardhë me mendimin me pa nipin në Shkodër. Ishte një gëzim i papamë. Shkon kunati merr leje në Degën e Brendshme nëse daja i tij mund të flinte një natë tek shtëpia e vet. Leja i jepet. Oficerët e porosisin mos të tregojë gja,

pra se si ishte gjendja në Shqipni. Karshi shtëpisë ku daja i kunatit kaloi natën ndodhej dyqani i qumështit. Dajës i del gjumi nga njerëz që po vinin shishet e tamblit (qumështit si i themi në Shkodër) dhe po bisedonin. Ai pa radhët e qumështit. U trondit. Nipi iu lut që të mos tregonte gja sepse mund të futej në burg për agjitacion dhe propagandë. Gjithashtu, daja i tij donte të martonte vajzën në Shkodër, por ndryshoi mendje kur pa gjendjen këtu. Por donte që edhe vajza e tij, Antoneta, ta shihte gjendjen. Vajza e tij vjen pas disa javësh me shkollën në ekskursion në Shkodër. Mandej vajza e tij martohet në Prizren më 1972. Kunati njoftohet me telegram. Ata e kishin kuptue mirë gjendjen qysh në vitin 1972.

Kur mbeta 2-3 vite pa punë, jetoja me vëllain. Më ndihmonte vëllai dhe tezet. Merresha me ndonjë punë dore. Fillova me qëndis. Pastaj në Shkodër bahet një reformë. U hoqën të gjithë mësuesit me baballarë të pushkatuem dhe nëpër burgje. Mësuesit e Shkodrës ata ishin, fëmijët e intelektualëve. Komunistët kishin formuar një kuadër të ri që zëvendësuan ata që hoqën nga sistemi. Më thërrasin në Komitet të Partisë në Lezhë që të flisja për biografinë time të punës. Puna ime nuk ishte mohue. Bëhem gati të marr librezën. Nëpunësi hapi amzën dhe libreza ime kishte ngec tek gërma “F”. Ai shkruan tek libreza, ndërkohë që i dridhej dora, “e papërshtatshme për arsim”. Nuk mund të gjeja punë kështu në arsim, edhe pse isha kimiste e naltë. Disa kolegë të mi ishin rehabilitue, e kishin gjetë ndonjë vend pune. Kryetarja e lagjes sime më dha fletë pune, pas refuzimesh të mëparshme për të më dhënë fletë pune, që të punoja në një repart kapsash të rrobave. Ishte një ndërmarrje metalike që mandej kaloi me kombinatin e drurit. Aty mësova se si baheshin kapset. Në fillim isha nxënëse, mandej mora kategorinë e parë. Norma ishte 5 lekë. Me këtë punë sigurova bukën e gojës. Papunësia të prish, se një njeri që asht mësue me kontribue nuk mund të rrijë pa punë. Vitin tjetër më dhanë kategorinë e dytë, më morën në provim. Unë që kisha dy diploma. Vetëm këto dy kategori kishte reparti i kapsave. Norma këtu ishte 6 lekë. Kapsat i bëja mirë, por kur ishin kapsat e mëdhaja 12 centimetër, atëherë e kisha ma të zorshme. Por pata shpejtësi në ambalazh. Më ndihmoi një vajzë aty. Ato vajzat, me të cilat punoja aty më kanë dashur shumë. Edhe unë i doja, se ishin maturante. Lexonim bashkë libra artistikë. Aty nuk patëm luftën klasore, që Partia e bënte. Më janë gjendur për gëzime dhe hidhërime. Këtë periudhë, kur bana 37-38 vjet, nuk më afrohej kurrkush. U gjet një njeri, një djalë shkodran, që nuk më shkoi mendja se do të merrja atë. Ai vinte për vizitë tek kunati. Punonte argjendar në artistiken e Shkodrës, ndërmarrje shtetnore kjo. I kërkova të më rregullonte një unazë të mamës, që ma rregulloi pa përtesë. Kur e përfundoi, e vura në gisht dhe i them: “Do ta quaj gjithmonë unaza jote.”

Atë unazë baba ia kishte ba dhuratë mamës kur linda unë. Mbas disa vitesh vjen ai dhe më propozon. Ka qenë i vetmi njeri që më ndalonte në rrugë me m’përshëndet, kur isha pa punë. Në ndërmarrje kemi pasë një shprehje: “E pakta pastë bereqetin.” Sepse kur ke pak nuk pretendon gjana luksi. Në këtë periudhë m’u mbush mendja me e pranue kërkesën e këtij djali. Më vinte turp t’i thoja jo, vinte nga familja Saraçi. Me babë e me xhaja në burg, të gjithë kishin studiue në Vjenë. Ishte edhe humorist për nga natyra, kurse unë s’isha kurrkund me humorin. Ishim diametralisht të kundërt. Patëm peripeci, se edhe familja nuk deshi në fillim. U fejuem dhe mbas 4 vjetësh kena ba nji celebrim. E filluem nga A-ja, me një odë dhe me dy karrige. Ai 50-vjeç unë dhe vetë 43-vjeçe.

Në festën e martesës nuk më priti kurrkush. Familja ime bani një darkë, kaq. Asht kapitull më vete. Kam hy në një shtëpi, ku nuk pata ku me hy. Pastaj 3 muej pas celebrimit, u ktheva tek mama, bamë një kapanxhë për të kalue nga oda poshtë tek ajo lart. Më 1983 bahem nanë, kjo qe fitorja ime në jetë. Ishte një dhuratë e çmueshme. Sidomos për mue në këtë moshë. Mori emrin e gjyshit, Peter. Patëm vështirësi edhe ta regjistronim, sepse emra të tillë nuk lejoheshin. Ky asht një nga kapitujt më madhështorë të jetës sime. Siç thotë Hana Arendt: Lindi njeriu, lindi për një të ardhme. Lindja e njeriut mbetet kryevepra më e madhe. Gjatë kësaj periudhe, Shkodra ka pasur tronditje të mëdhaja. Filluen të iknin njerëzit, djemtë e rinj që i pushkatonin. Ndër dhimbjet ma të mëdhaja që kisha këtë periudhë, ishte kur njëra nga shoqet e mia më të ngushta me të cilën punoja, vritet në kufi bashkë me djalin që dashuronte. Po përpiqeshin që të arratiseshin nga Shqipëria. Ishin si drita, 25 dhe 26 vjeç. Kanë ba gjana makabre në këtë qytet komunistët, qysh prej vitit 1944-45 e deri në vitin 1990. Shkodra ka pasë burgje e kampe internimi. Por unë vazhdoja, rrisja djalin. Vjen viti 1990. Në kohën kur të gjithë po shpresonim për ndryshim, më 1 korrik burrin tim e len zemra. Djali im mbeti pa baba, ndërkohë që unë ngela me një pension qesharak. Lëvizjet demokratike i ndoqa nëpërmjet televizorit. Pashë edhe ranien e monumentit.

Rënia e diktaturës

Ndryshimet politike i përjetova me gëzimin ma të madh. Kurse Shkodra ka qenë e tmerrueme. Ka pasur vrasje e pushkatime. Nëpër piacën e Shkodrës janë shëtit me kamion djemtë e vramë, për me tmerrue popullin shkodran. Mund t'ua ketë ba serbi kosovarëve, por neve na e ka shqiptari shqiptarit. Ata ushtarët ishin shqiptarë që vrisnin vëllezërit e vet. Por çdo gja ishte heshtje. Ndodhi viti 1990. Një inxhinier që punonte në një stacion pranë kufirit, qëllon me pa në orët e vona disa njerëz që me batanije po groposnin diçka. Ky inxhinieri shkon atje dhe vendos një shenjë, për mos me harrue që aty ishte gropos diçka. Kur filluen proceset demokratike, në gazetën "Rilindja Demokratike", e cila lexohej shumë, inxhinieri në fjalë tregon këtë dëshminë e tij se në filan datë dhe në filan orë kishte parë disa ushtarë duke bërë groposje. Mora gazetën dhe shkoj tek një shoqe e imja, motra e djalit që përmenda më sipër. I thashë shko kërkoje vëllain dhe të fejuemen e vëllait. Ajo i gjeti trupat. Ishte një tmerr! Komunistët i kishin thënë familjes se djali me vajzën e re ishin gjallë! Ata ushtarët ikën dhe nuk u dënuen kurrë.

Si ishte izolue Shqipnija? Së pari iu mohue historia, e dyta gjithë që kishin ikë jashtë s'patën të drejtë me u kthye në atdhe, u izoluem nga bota perëndimore. Fatkeqësi e madhe. U mbush Shqipnija me burgje e me kampe internimi. Vetëm Shkodra ka pasë 20 burgje. Familjet shkodrane që nuk u nënshtruen, u kapën dhe u internuen. U çuen në kampe të ndryshme internimi, por kryesisht në kampin e Tepelenës. Nuk ka rrugë në Shkodër që s'ka të vramë, të pushkatuem ose të internuem. Unë jam rritë në një rrugë të bukur të Shkodrës, Parrucë, që asokohe quhej rruga "Teuta". Vetëm në rrugën teme janë familjet Kazazi që janë të gjithë me të pushkatuem dhe me të burgosun; familja Pipa ku njëri nga pinjollët e saj, avokat, vritet dhe vëllai i tij, Arshi Pipa, bëri 10 vite burg e mandej u arratis. Duke vazhdue me familjen e nanës teme Muka, me Gjyrezët e me radhë. Në fëmijëri në Kavajë kam pa njerëzit e varun, kurse në Shkodër në këtë moshë kam pa nanat e veshuna me të zeza që ecnin si hije. Nuk u hapte asnjë derë për to, ishin mbyllë tana dyert e Shkodrës. Shqipnija provoi heshtje, heshtje. Iu mbyll goja shqiptarëve.

Me ardhjen e sistemit demokratik, ne u gëzuem jashtë mase. Kujtuem se vinte demokracia përnjiherë. Mirëpo, kishte ardhë një shqiptar nga Australia. Kishte moshën që kam sot, mbi 80-vjeç. Sapo binte sistemi. Ai ishte një kushëri i kunatit, gjakovar. Burri i motrës, vdiq 52-vjeç dhe kishte lënë dy fëmijë. Kushëriri i tij nga Australia erdhi të shihte familjen e tij. Ai ishte dyshues për entuziazmin tonë. Ai më ka thënë diçka që edhe sot e mbaj mend: "Zonja Bardha, shumë po gëzoheni. Mirëpo, rrugët keni me i ba, pallatet keni me i ndërtue, ama njeriun keni me pasë shumë zor me e ba. Sepse unë i kam gjet njerëzit dhe nipat e mi të shpartalluem. Jo 10 vjet, si thue ti, mund të vijë ndryshimi, por as për 30 vjet." E vërtetë. Tridhjetë vjet kalunë edhe ne jena hala në procese shumë të zorshme. Pse? Politika këtu ka urrejtje të madhe. Edhe atje tek ju ka urrejtje të madhe. Shqiptarët duhet me gjetë një rrugë mirëkuptimi. Dua të fitojnë ata që u asht mohue e drejta, ata që humbën pronat, të cilëve ju burgosën prindërit. Por populli u instalue vetëm tek PD-ja. Skuadronet e komunistëve u kthyen në parti, morën flamuj shumë. Ishin krijue prej Ramiz Alisë. Por populli jonë u ngut. Ne mendonim se po fitonim gjithë të mirat. Por e mira nuk vjen përnjëherë. Kur fitoi PS-ja në Shkodër, në vitet e para të tranzicionit, u ba masakër, sepse fshatarët i dhanë votën Partisë Socialiste. Këto krime vazhdojnë të mohohen nëpër gazeta. Janë vra dhe dhunue djemtë

shkodranë. Këtu u kaluen periudha të zorshme. Nuk asht gja e vogël. Ma e keqja ndodhi mandej në vitin 1997. Ajo që s'na falet. S'duhej të shkonim në atë konflikt partitë parlamentare, që të egërsohej një qytet atje se humbën paret. Si humbën paret? U banë ato shoqatat që shqiptarët nuk e kanë ditë se ç'janë. Këto shoqatat grumbullojnë pare, të japin ty një përqindje, mandej s'të japin ma ty kurrgja. Edhe falimentuen njerëzit. Humbën paret. Po kur humbi lirinë, pse populli nuk reagoi? U dogj nji Shqipni. Nuk besoja se Shkodra do të përfshihej në këto trazira, por ja që ndodhi. Këtë kohë ndodhi një ngjarje; s'do ta harroj kurrë. Largohet SHIK-u nga godina e vet në Shkodër dhe nuk më lajmëroi mue që isha nanë e vetme me katër fëmijë (se kisha edhe fëmijët e vëllait). Pati edhe shumë grabitës, hajdutë që përfituen nga kjo situatë. Këto kanë qenë momente dëshpërimi të jetës sime pas '90-s. Kisha probleme me rrit djalin se ishte në klasat e para. Një periudhë çoroditëse, kur filluen mësuesat mos me punue fare. Megjithatë, njeriu gjen forca. Unë në vitin 1992, u bana pjesë e ekipit të Drejtorit të Muzeumit të Shkodrës, të nderuemit e mjedologut, pastë dritë, Mentor Quku. Ishim kolegë, kishim mbarue universitetet bashkë. Ai më ftoi dhe me ftesën e tij, ne u bamë një grup. Këtu filloi aktiviteti jonë, "Historia Ndryshe", për t'i ritrajtue figurat që ishin përdhosë. Tashti, unë u bashkova me gratë e përndjekuna politike. Një herë në muej, me datën 12, në orën 4:00 pasdite, grumbulloheshim tek Muzeu Historik së bashku me këto gratë. Aty lindi libri i parë. Filluen tregimet për nanat që iu ishin vra djemtë. Bile më kanë ardhë edhe aktorë me recitue, s'bashku me muzikanta. Por ishte me forca vullnetare, sepse s'kishim të ardhura.

E pashë të arsyeshme që ne të takoheshim. Por unë pata fatin që ato nana që kishin ba burgje dhe kampe internimi ishin gjallë atëhere. Varionin nga mosha 40-60 vjeç. Gjithashtu, kisha të burgosuna politike shkodrane. Tashti, në këto aktivitete lindi libri im i parë me jetët e këtyre grave. Po si lindi libri i parë? Në fillim kam shkruejt artikuj tek gazeta "Liria", sepse të përndjekurit politikë në Tiranë kishin gazetë. Ka qenë gazeta e shoqatës "Të përndjekurit politikë të Tiranës" që u krijue pas '90-s. Shkodra ka pasë gazetën "Pishtari". Unë te kjo gazeta në Tiranë shkrueja herë pas herë për jetët e nanave. Tregoja histori të tipit, për shembull, se si një nanë ka kalue 15 vjet duke ndjek të birin e vet nëpër burgje, ose nana që ishin nuse të reja duke çue fëmijët në kampin e Burrelit a në Spaç për me pa babain. Me përshkrimin e këtyre jetëve, u ba libri i parë. Nuk kisha si me e botue. U botue më 1996. Kur mora shpërblimin e parë nga burgu i babait, mue më takunë 100 000 lekë, se unë flas me lekë të reja. Botoj librin. Ishte një dhuratë nga ana ime për nanat e Shkodrës. Ishin mbi 60 jetë nanash shkodrane ose nga një qytet tjetër, të cilat ishin përndjekë politikisht.

Unë jam pjesë e kësaj shoqnije, unë e kam ditë qysh fëmijë se si janë këto histori. Tezet e mia më tregonin çdo natë dimri për djemtë e familjes Kazazi e të djemve të tjerë që ishin pushkatue. Tek tezet e mia vinin tanë ato nuse të bukura shkodrane, që përgatisnin ushqimet për me ua çue burrave që i kishin në kampet e punës. Sepse gjatë verës ata dërgoheshin në kampet e punës. Kryesisht në Maliq. Aty kanë punue për me tha kënetën. Kam dëgjue se ushujzat i hiqnin me sapun. Njerëzit që vdisnin i groposnin aty. Kjo ishte situata edhe në kampet e kanaleve. Unë në vitin 1992, isha e mbushur me euforinë e demokracisë. Mirëpo, kur e kuptova që nuk po kthehej prona, nuk po rehabilitohej shtresa jonë, atëherë nisa punën për librin e dytë që e fillova me internimet. Me materialet që kisha unë prej nanave, të cilat edhe i njihja, kam ba libra me dëshmi. Me tregue si i kanë çue këto gra në internim. Pa kushte, pa asgja. Me punue si kafshë pune dhe shteti nuk ia njihte. Është punë 15-vjeçare ai libër që kam ba. Nuk e kam ba për 1-2 ditë, e kam ba me studim. Nuk vlejnë fjalët, por vlejnë librat. Kujtesa historike asht e domosdoshme, për me dashtë me ba historinë e vër-

tetë. Kështu që u ba libri i parë. E kemi prezantue tek Universiteti i Shkodrës. Pjesë e audiencës ishin edhe disa burra në moshë që kishin qenë në burgje. U mbajtën shumë ligjërata, por një nuk e harroj. Ligjëratën e Zef Stakut, shkrimtar për librat e fëmijëve, i cili shkroi disa fjalë që i ka kopertina e librit të dytë. Ai kishte ba dy herë burg politik. Për arsye se ai kishte qenë pjesë e rinisë së Ballit Kombëtar, e kishte dashtë shkollën shumë, por edhe Kosovën.

Në këtë kohë, pra pas vitit 1997, nuk vazhdoi ma aktiviteti i takimit të grave tek muzeu. Filloi në Shkodër një tjetër përçarje. A je demokrat, a s'je demokrat? Duhej të ishe anëtar i Partisë Demokratike që të quheshe demokrat dhe jo në një parti tjetër që mund të kishte emër të djathtë. Kështu vazhdoi kjo çështje. Vetë të përndjekurit politikë nuk ishin unikë. Si është një shprehje, i keqi e la konopin jashtë. I thonin njëri-tjetrit spiuna. Reformat u banë, por nuk u banë për shtresën tonë.

Unë kisha punuar për mbledhjen e dëshmive nga vitit 1992 deri më 1997, por nuk vazhdova ma. Pse nuk vazhdova ma? Sepse filloi një përçarje e madhe. Më thonin që s'jam demokrate. Ç'do me thënë kjo? Unë s'jam demokrate, por jam e drejtë. Jam demokratike, jam pro-lirisë. Nuk synoj me ulë njeri, synoj demokracinë. Mbasandej, e pashë që për të ecë përpara shoqnija, po nuk u shkruejt historia mbetesh pa gja. Unë këtë punë vazhdova.

Nuk e tham unë, e kanë thanë disa të tjerë ma të mendshëm se unë se: "Nëse harrojmë të kaluarën ajo përsëritet." Si? Ajo përsëritet me forma të tjera. Mund të t'uzurpojë pushtetin, ose ka qejf të rrijë 20-30 vjet në pushtet, ose nuk zbaton kushtetutën. Demokracinë populli e do, por duhet ta mësosh atë ta respektojë. Të respektojë ligjet, gjykatat etj. Por këtu te ne janë të çoroditun. Tani ju pyes juve: çfarë quani ju pronë private atje në Kosovë? Pronë private ju quani një pronë të fitueme me djersë, pronë të trashëgueme prej të parëve dhe pronë të dhurueme nga dikush. Këto koncepte nuk ekzistojnë tek ne tash 80 vjet. Tek ne janë grabitë këto gjana. Doli një plejadë njerëzish që kënaqeshin kur merrnin gjënë e tjetrit, kur hynin në shtëpinë e tjetrit dhe kështu vazhdoi edhe post-diktatura. Kjo demokracia që ka ardhë te ne ka një çoroditje. Kaq shumë u transformue shqiptari, saqë zbriti e zuni tokat e tjerëve dhe qeveritë tona i legalizuen. E tani janë ba pronarë në Tiranë, në Shkodër etj. Asnjë nuk kujtohet që nuk është në pronën e vet, por ia kanë grabit dikujt tjetër. Njerëzve që u ishte marrë prona, nuk u rikompensuan. Qarkulloi një ide se ish-pronarëve do t'u jepej toka e kategorisë së parë. Por nuk ndodhi. Kështu që shumë të shtresës sonë o kanë vdekë fukarenj, o kanë lanë pasardhësit e tyne pa pronë. Shenjtëri prone nuk ka në Shqipni. Pra koncepti i pronës në Shqipni asht i prishun qysh më 1945. Komunizmi te ne filloi me dhunë tue vra njerëzit dhe vijoi me gënjeshtra. Tani del një pyetje: për çfarë krenohen këta pushtetarët tonë që shqiptarët kanë shpëtue hebrenjtë? Është e vërtetë. Po cila qeveri i shpëtoi? Ishte një qeveri që sot quhet "kuislinge" prej disave.

Këta qenë shqiptarët e vërtetë. Tani pse shqiptarët pas 1945-s i dorëzuen vëllezërit e tyre te komunistët edhe i vranë. Pra fajin e kanë qeveritë e jo shqiptarët! Nji qeveri përsëmbari e mëson popullin të jetë demokrat. Mua më vjen keq që u bana kaq dhe po e la Shqipninë në këtë gjendje. Shqipnisë nuk i mungon elita, por shumica janë tue ikë.

Unë jam kenë këshilltare në Bashkinë e Shkodrës, nga "E Djathta Shkodrane", kur ishte kryetar bashkie Bahri Boriçi.

Kam qenë vetë prezente me të, kur kemi shkue tek kapanonet kur njerëzit nga Kosova ishin strehue. Ka qenë një dashamirësi e madhe, shumë familje kanë ardhë këtu. Afër tek unë, te muri që na ndante, ishte një familje kosovare. Ishin në gjendje të mirë pasi kishin njerëz në Gjermani. Por ai zotnia kur i thashë që ju keni luftue dhe luftoni për tokën tuej, kurse këtu neve na është marrë toka, ai nuk e kuptonte se ç'kisha heq unë. Pasi ai më përpara mund të kishte takuar familje komuniste që mund t'i kishin thënë tjetër gja. Por shyqyr që u pritën aq mirë, domethanë shoqnia shqiptare edhe pse e varfër, i priti. Shumica e tyre ishin në gjendje të mirë, fëmijët e tyre nga jashtë i përkrahnin.

I kam ndihmue për dokumente, pasi kam qenë këshilltare. Bile-bile, një familje më ka çue të fala në fillim, por tani kemi humbur lidhjet, për shkak të këtyre dhjetëvjeçarëve. Por ju uroj gjithë të mirat. Mos vazhdofshi me të metat e Shqipnisë! Se ju keni mbrojt çështjen e pronës, që e çmoni aq shumë. Unë kam pa toka djerrë e shtëpia të prishme, që s'ka hy kush me i marrë aty tek ju, se unë e kam shëtitë Kosovën më 2003 e deri tash vonë, nga vitit 2014. Kurse këtu në Shqipni të pa dikush diçka të prishun, hyn tjetri e t'ban ndërtesën. Hajde merre! Kam pa nji dashni të madhe edhe atje tek ju. Kam bashkëpunue me "Trojet e Arbrit" nëpërmjet muzeumit dhe aty u publikuan punimet e mia që mandej u banë libër. Por sa herë që publikoheshin punimet e mia vija re një heshtje nga ata historianët e Kosovës. Një heshtje të çuditshme, nuk e kuptonin se për çfarë unë po flisja. Mandej, kur bana librin ua dërgova disa drejtuesve, edhe njërit në Amerikë dhe kur më mori në telefon më tha: "ç'është ky libër që më ke prue?" I them: "Libri që ju kam lexue pjesë-pjesë në çdo seminar tuejin."

Libri duhet kuptue, prandaj unë i jap atij rëndësi. Lum kush i lexon, se librat e mi nuk janë kryevepra botnore, por janë kryevepra kujtese. Pra këtë libër kush e vlerëson për mua është i çmuar, kush e transmeton është i veçantë, kush e pranon është hyjnor. Si t'ua them, kategoritë janë njësoj. Shpeshherë thuhet se nuk lexohet në Shqipni, por ka njerëz që hedhin në internet pjesë nga libri im. Ai që don me lexue, lexon, ai që don me kuptue, kupton. Në Shkodër, sa herë kam ba prezantimet e librave unë i kam ba në bibliotekën e qytetit "Marin Barleti". Kam thirrë njerëz dhe kanë ardhë vetë. Librat i kam dhurue, nuk i kam shitë. Unë ia kam dhanë Institutit të Krimeve të Komunizmit dhe ata më kanë dhanë 60 libra. Njëherë kur shkova me rregullue këpucët, këpucari më thotë: "Zonja Bardha, ju që keni ba gjithë këto libra vjen me rregullue këpucët?" I thashë: 'Në moshë me mue asht edhe kamba?" Por s'kam ba libra për fitesë, kam ba libra për kujtesë. Këtë kam ba. Këto lekë që ia kam heq familjes sime unë, i kam heq nga kontributi im. Pse? Nuk kam harrue atë thanien e babës tim që më ka thanë: "Fatbardhë, mbaji në mend, mbaji edhe në zemër, edhe do t'i shkruesh." Shkrimet i fillova në moshën 52-vjeçare. Një trashëgimi të vogël nga babai që ma ka sjellë vëllai, e kam ruejt dhe i kam ba libra. Është në kujtim të të parëve të mi. Kaq. Unë tjetër gja s'kam, sepse s'kam muejt kujt me iu lut. Nuk më ka pëlqye të kërkoj ndihmë tek partitë apo shoqatat. Do të më paragjykonin se kështu janë shqiptarët. I nderoj edhe ata që më kundërshtojnë. Partia Komuniste ndryshoi emrin në Parti e Punës dhe brenda nji minuti u ba Partia Socialiste. Vetëm Dritëro Agolli reagoi për këtë ndryshim. Kush të dojë, le të mësojë. Më 2014 kam shkue me djalin, me vëllain, me Agron Tufën, me ambasadorin gjerman Hofman, me drejtorin e shoqatës "Konrad Adenauer" në Tepelenë për të parë kapanonet. Ishin të shkatërrueme. Publikova një libër. Kishin ardhë edhe disa të moshuem që kishin qenë fëmijë në kampin e Tepelenës. Më takon që me m'çue përsëri në Tepelenë djali im, ai që u rrit me mue qysh në moshë të vogël nëpër aktivitete. Këtë herë ishin të moshuem nga Shkodra, që kishin qenë në kampin e Tepelenës, që i kishte çue bashkia. Unë isha në gjysë të sallës, kur më afrohet zonja

drejtoreshë e Autoritetit të Dosjeve dhe më thotë këtu: “Zonja Bardha, këta veteranët nuk e pranojnë që ka pasë kamp internimi këtu, por e quajnë Kampi V. Madje thonë mos ta krahasojmë me kampet gjermane.” Mirëpo, aktiviteti ishte gati duke fillue. Unë i them: “Shiko zonjë e nderueme ato mund të thojnë që s’ka pasë kamp Tepelena, po aty kanë vdekë foshnje, kanë vdekë fëmijë, kanë vdekë të moshuem. Këtë e thotë kujtesa e njerëzve të mi që kanë jetue këtu. Mandej ju mund ta quani Kampi V a Kampi X, por gjithmonë do t’i mbetet emri kampi shfarosës i Tepelenës nga viti 1949 deri më 1954. Këtu kanë përjetue tmerr me mijëra familje shqiptare.” Tashti çfarë t’i them unë atij veteranit? Koha do ta tregojë. Edhe në dëshmitë e mia e kam thënë, se nëpërmjet këtyre rrëfimeve asht ba i njoftun kampi i Tepelenës, nuk i baj me zor. Pastaj dolën të tjerët. Por dokumentet vazhdojnë me kenë të mbylluna. Ku i kanë vorret e fëmijëve që i zhdukën? Edhe për këtë më vjen keq. Sepse këtë librin e 5-të që kam ba, e kam realizue në kujtim të këtyre fëmijëve, foshnjave e të rritunve që sot janë 70 e ca vjeça. Libri ka elemente biografike, kujtesën e tyne, vuajtjet e përjetueme të këtyne fëmijëve. Si shpjegohen psherëtimat e këtyne fëmijëve dhe vaji i këtyne nanave me heshtje në Shqipni? Shteti komunist ishte shumë autoritar, nuk të linte të flisje as të tregoje. Sepse edhe ata vetë që kishin përjetue të tilla tmerre nuk kishin se kujt t’ia tregonin. Por edhe veshët e shqiptarëve nuk dëgjuan gja. Ky asht një tmerr! Pra kjo është memoria, rrëfimet e këtyne. Memoria nuk të len të biesh në gabim përsëri. Nuk është bërë ndonjë monument për fëmijët e vrarë gjatë diktaturës. Kur u ba monumenti i kujtesës në Shkodër, nuk isha anëtare e këshillit bashkiak, por vëzhguese kur u shpall konkursi. Por në këtë monument mungonin fëmijët dhe nanat. Pas 4 vjetësh pasi u ngrit, vunë nanat, por jo fëmijët. Tani, fëmijët janë ëngjëjt, e ardhmja e një kombi, për ata kam shkruejt. Një pjesë kanë vdekë, por shumica kanë jetue. Titaniku u mbyt, por historinë e tij e tregojnë ata që i shpëtuen përmbytjes. Komunistët shqiptarë, edhe pse nuk erdhi ushtria ruse këtu, por na zaptoi ideologjia marksiste-leniniste-staliniste, ua kaluan të gjithëve. Çoroditën popullsinë dhe e lanë të varfër. Si është popullsia e varfër? Për shembull e di si votonin fshatarët në fshatin tim kur u bashin votime? Sillnin një emër që nuk u dite se kush asht, bashin ca qendra votimi si me perde të kuqe dhe hidhnin fletën e votimit aty. Fillonin daullet qysh në orën 2:00 të natës, i çoshin në 5:00 t’natës dhe mbaronte votimi në fshatin tonë. Dilte 100% që ka fitue Partia e Punës.

Unë jam mësue me jetue edhe me të mirën, edhe me të keqen. Unë jetoj. Në fillim na ndihmuen ata nipa e mbesa që kanë qenë emigrantë politikë në Gjermani, që kanë hy në ambasada. Kanë qenë zogjtë e parë shtegtarë të Shqipërisë. Sa më kishte vdekë burri dhe nuk dijsha ke me qa, atë, apo fëmijët e motrës që kishin hy në ambasada dhe mund t’i vrisnin. Edhe fillon viti 1990 me dhurata, me paketa. Peteri është i vogël. Vëllai im ka qenë aktivist, ka punue me shoqatën e të përndjekurve politikë. Arritëm me marrë diçka nga babai. Shtëpia u lirue më 1998 dhe mama jeme jetoi aty nja dy-tre vjet dhe vdiq po aty, ku kishte dalë nuse e re. Pastaj ata që kishin qenë nëpër shtëpiat tona kishin qenë kryetar komitetesh dhe në këtë kohë i kishin njerëzit e tyre nëpër komitete donin të merrnin apartamente dhe të qëndronin në shtëpitë tona. U rregullue. Kështu që kur i morëm shtëpitë i morëm të dëmtueme dhe kur i morëm ato 4 dyqane i morëm vetëm me një faqe muri. Por megjithatë vëllai më ka ndihmuar në rritjen e Peterit. Unë isha në një moshë që nuk kisha çfarë të punoja, unë veç kam punue libra. Arrita me e rritë djalin, e shkollova. Kisha dëshirë ta çoja në Austri, aty ku kishin studio të parët tonë. Ishte e pamujtun, nuk disponoja pare. Mue më vinte nji dhuratë nga baba 15 dollarë. I ruejta, i ktheva në banka dhe kur ra dollari në atë kohë, kur e nisa student në Padova, me nja 2000 dollarë, nuk ishin asgja. Sepse neve nuk e kemi pasur konceptin e dollarit. Por u gjind një pjesëtar tjetër i familjes Saraçi, që e kishte çue Kisha me studime, ma priti djalin. Pra ishte fat.

Pastaj konkuroi, fitoi dhe doli i pari në kolegjin “Nicola Mazza’. Mori degën e financës, atë që kishin pasë gjyshat e vet që kishin studiue në Austri. Kjo qe fitorja ime. Por unë atëherë s’kisha të drejtë me shkue n Itali për shkak se nuk na jepeshin vizat. Asnjëherë nuk shkova atje me e pa djalin si student. Nuk pata mundësi. Tashti, n’vitin 2008 djali mbaron shkollën dhe më thotë: “Mamë, diplomohem në qershor 2008. Bëj një kërkesë te konsullata.” Por më refuzohet sepse nuk kisha lekë në bankë. I tregoj djalit për refuzimin e vizës. Ai më thotë se nuk donte të hynte në mbrojtje të diplomës po të mos vija unë, do ta shtynte për në nandor. Ia kishin shtyrë deri më 30 qershor nisur nga situata. Tashti, një ditë në kohën kur po punoja, gjej një kartvizitë në një fletore. Ishte kontakti i një nxanësit tim që kam pasur kur ai ka qenë në klasën VII, ishte kujdestari i klasës. Ai ishte ba kryetar bashkie në rrethin e Lezhës. Ishte Viktor Tusha. I rrëfej se më ishte refuzuar viza. Më rregulloi punë menjëherë. Harrova që ai kryetar bashkie kishte shpëtue jetë dikur. Për fund, asistova në universitetin në Itali, ku djali im mbrojti diplomën për financa bankare. Një gëzim i paparë. S’më besohej që djali im kishte dalë aq mirë më 2008, ishte një gëzim i madh. Kthehet në Shqipëri për mue. Bani letrat dhe e pranoi Universiteti i Shkodrës ku vazhdon të jetë pedagog. I kam thanë dy fjalë: “Në daç me punue për Shqipni, puno në universitet shtetnor që të mësosh ata fëmijët e shkodranëve, që e kanë ditë se ç’ishte tregtia. Se në universitetet private shkojnë ata që kanë lekë.” Ka 16 vite që është pedagog. Ka formue familje, është babë i dy fëmijëve, deri tashti më ka shoqnue gjithkund. Por tani e ka të vështirë se njëri prej fëmijëve është 1-vjeç e tjetri 5-vjeç, njëri në kopsht e tjetri në çerdhe. Edhe sot më solli këtu.

Asht mahnitëse ideja se si rezistuen këto nana nëpër kampet e internimit, ose nanat, nuset e gratë që kishin burrat nëpër burgje. Ky mund të quhet heroizëm. E di ç'do të thotë që një nanë me marrë fëmijën 6-vjeç e ta çojë në Spaç për me pa babën? Një nanë e tillë një natë, bashkë me fëmijën e bajnë rrugën për Spaç, flejnë nëj kasolle, e cila rrethohet nga ujqit. Diçka tronditëse, por libra të tillë nuk preken me dorë. Sepse të ishte kenë një kineast, do të bënte filma të klasit të parë, me tregue ç'ishte mbijetesa. Kjo është një rezistencë e madhe. Me tregue të vërtetën me anë të gjuhës, me tregue izolimin e Shqipnisë, izolimin brenda vetit, brenda Evropës. Edhe Evropa na harroi. Më vjen habi se si diplomatë, intelektualë dhe disa profesorë francezë që jepnin mësim në Tiranë nuk u bënte përshtypje ose nuk e dallonin mungesën e lirisë këtu. Këtu kanë ardhë edhe grupet marksiste-leniniste nga e gjithë bota. Mbaj mend që kur shkonim në plazh në kampet e pushimit, ata kishin rezidencat e tyre të posaçme. Vinin për të mësuar se Shqipnija socialiste ishte kalaja e pathyeshme e socializmit. Çuditem si nuk e kuptonin situatën. Unë kam pasur një mik timin nga Kosova, Shefqet Kaçanikun. Një ditë ai ishte në Gjadër dhe unë ecja për të shkue në Dajç. Unë e shikoja atë dhe mendoja si ka mundësi që një person që ka provue burgjet jugosllave qysh 16-vjeç me Marie Shllakun, At Bernardin Llupin me kompani, shkon e i mbushet mendja e vjen në Shqipërinë socialiste? Mandej përfundoi në burg. Shefqet Kaçaniku, alamet mësuesi biologji-kimi, vinte në grupet e shkencave biologjike me mue dhe e mora vesh nga nxënësit, kur po udhëtoja në tren, pasi më kishin heqë nga arsimi, që u fut në burg. E sa e sa kosovarë të tjerë kanë pësue këtë fat. Tmerr! Shqipëria, kjo është. Ne na quanin familje borgjeze dhe sot komunistët janë ba familje pasanike. Shyqyr që janë ba! Po si? Si e lanë këtë popull të ikë shumica e shqiptarëve? Lihen këto troje të bukura, për të cilat kena luftue gjithë jetën. Por ne jemi qëndrestarë. Shpresoj që rinia të hedhë hapa të matun dhe të hedhun për s'mbari. Do të ecë, por jo me hapa të vegjël. Ai xhaxhai im nuk e ka ditë që kur punoi gjatë periudhës së fashizmit, se do ta quenin fashist, megjithatë karrierë të mrekullueshme që kishte, hodhi karrierën e tij poshtë. Kurse unë kaq kam muejt me ba me kontributin tim. Më tepër nuk di a do të baj se mosha ban të veten. Kam qejf me ba, por nuk di a baj ma.

Unë kisha dashtë me thanë shumë, por janë shumë për t'u thanë. Por unë do të doja që kjo shoqëria shqiptare të përparojë drejt. Ne shpesh themi se kena hy në Evropë. Në Evropë hyhet o duke thanë ma të mirën e Evropës, o duke thanë ma të keqen e Evropës. Unë jam n'moshë dhe shoh disa programe televizive që janë çoroditëse. Një nga nipat e mi që kam në Gjermani më ka thanë se nga analizat e gjakut që janë ba, raca ma e pastër në Evropë janë shqiptarët. Mos ta përdhosim, të mbesim ata shqiptarët autoktonë, ata shqiptarët e mirë. Të mbajmë virtytet e mira që kena pasë, të heqim fanatizmat, të jemi të kujdesshëm, të mos gënjehemi, se politika të gënjen. Shkolla për këtë bahet. Unë u kam thanë njerëzve 'shkollohuni, se shkolla nuk të ban të pasur, por shkolla të jep mend për me dallue të mirën nga e keqja'. Unë si Bardhë, që kam punue në arsim, dua të transmetoj mesazhin e të gjithë mësuesave që kanë punue: të mësojmë, të edukojmë brezin e ri pa hile; nuk ka punë me pagat, lidhet me humanizmin. Humanizmi asht e kundërta e urrejtjes, e mizerjes, e totalitarizmit. Duhet dashni. Duhet të tregosh dashni me tanë njerëzit, jo vetëm me popullin tand. Unë isha fëmijë kur përjetova luftën e Tiranës, unë s'kisha dashtë luftë. E tani luftat po vazhdo-

jnë. Fëmijët po vriten egërsisht. Ku po shkon bota kështu? Ku janë gjithë këta liderë, këta dijetarë, këta filozofë? Domethanë, për mue, ata që drejtojnë shtetet nuk janë në naltësinë e duhun. Edukimi ka të bëjë shumë me këtë. Me të vërtetë në komunizëm kemi punue në arsim, por ka qenë e indoktrinueme. Historinë e ke pasë gabim. Unë kam qenë gjithmonë korrekte kur kam dhënë mësim, nuk e kam lanë nxanësin pa dije. Në atë kohë ka pasë dallime. Ai që ishte komunist herë bante mësim, herë s'bante mësim, herë shkonte nëpër mbledhje. S'e çante kokën për mësim. Për neve që bashim mësim, thonin 'këta punojnë prej frike'. Jo-o! Njeriu punon për humanizëm dhe për pasionin që ka për punën. Si do të quhesha unë mësuese nëse unë do t'u kisha hy në hak atyre nxanësve. Për këtë arsye shumë ish-nxanës të mi vijnë në promovimet e librave që botoj. Madje njëherë më ka pyet nusja e nipit që është pedagoge: "Ua-a! Do të arrij të më flasë një ish-studenti im kur të arrij moshën 80-vjeçare?"

Unë kam punue pa pasë nevojë për titull. M'u dha titulli Mësuese e Dallueme më 1993, kur iu dha të gjithë tjerëve që ishin heq nga puna. Mora edhe një titull nga Presidenca e Shqipërisë më 2017, "Kalorës i Skanderbeut", bashkë me një bashkëvujtës tjetër që vdiq në kohën e pandemisë. Këtë nuk e paraqiti as televizori, as kurrkush. Bëhet bujë e madhe kur dekorohen artistët e realizmit socialist. Ne mbetëm në heshtje.

Njeriu punon se do të afirmojë veten. Unë do të kisha dashtë që të gjithë të punojnë dhe jo të neglizhohen. Por duhet të drejtojnë njerëz të aftë, se një njeri i aftë i bën edhe të tjerët të aftë.

Kur shkoja në Kosovë, djem të rinj kujtoshin se bashkimi do të bahej përnjëherë. "Jo," u thashë. Bashkimi vjen ndryshe. Bashkimi vjen me anë të kulturës, të artit dhe mendërisht. Ju keni avancue në një mënyrë shumë të bukur se keni jetue nëpër Evropë. Unë lexoj një pjesë të madhe të shkrimtarëve tuej. Janë shumë të mrekullueshëm, si Ag Apolloni. Kurse Shqipnija ka pasur devijime, ishalla këto devijime nuk mbërrijnë tek ju. Megjithëse kanë mbërri se disa grupe në Kosovë festuen 100-vjetorin e Enver Hoxhës, e ndjek edhe Rexhep Qosjen me kompani, por dalin të tjerë. Është ky Kim Mehmeti që flet krejt ndryshe, ka shkruar një tregim të çuditshëm që nuk më pëlqeu kur e lexova. Flet për disa zonja Shkodre pranë bregdetit që vetëm shihnin andrra dhe njëna u mbyt. Zonjat e vërteta të Shkodrës janë heroina që i kanë mbijetue komunizmit prej 50 vjetëve dhe kanë lanë pasardhës po aq guximtarë sa janë ato vetë.

Historia skofiare e gruas së fortë: Një jetë kushtuar të drejtave të grave

Zonja Savka Todorovska, kryetarja e Këshillit Kombëtar për Barazi Gjinore (KKB-GJ), flet për atë se si ka qenë fëmijëria e saj dhe se si përvoja e saj e mëvonshme jetësore e vendosi atë që natyrshëm të bëhet një nga luftëtaret më aktive për të drejtat e grave në Maqedoni.

Duke folur për të kaluarën dhe sfidat nëpër të cilat ka kaluar si fëmijë i pasluftës, por edhe për afërsinë dhe lidhjen me familjen dhe të afërmit e saj, të cilët kanë luajtur një rol kyç në jetën dhe botëkuptimin e saj, ajo tregon se si përfundon historia e saj, dhe veprimtaria e saj e mëtejshme, plot afinitete të lindura për udhëheqësi.

Ajo tregon për aktivitetet e saj në Jugosllavinë socialiste, por edhe për fillimet interesante të organizatave të shoqërisë civile në Maqedoninë e pavarur, për kohët e vështira gjatë luftërave dhe shpërbërjen e federatës.

Së fundi, i referohet pikëpamjeve të saj për qëndrimet e rinisë së sotme dhe problemet bashkëkohore me pozitën e gruas në shoqëri.

E gjithë kjo në stilin e saj, me shumë besim dhe hijeshi, jep udhëzime, përfundime dhe këshilla të dobishme.

Savka Todorovska

Unë jam Savka Todorovska, kurse mbiemri im i vajzërisë është Savka Siljanova. Kam lindur në Veles, në vitin 1943, që do të thotë në mes të Luftës së Dytë Botërore.

Babai im është nga familja Siljanovski, nga lagja Potok në Tetovë, i cili me urdhër partiak u dërgua në Shkup, e pastaj mori detyrë nga partia për të shkuar në Veles, në stacionin hekurudhor, i cili ishte një qendër e njohur transporti, e cila ofroi mbështetje dhe ndihmë në transportin e hebrenjve, dhe për të mbështetur ilegalët.

Nëna ime është nga Velesi. Ata ishin pesë fëmijë - tre motra dhe dy vëllezër. Vëllezërit e saj, nëna e saj, gjyshja ime, gjithashtu ishin të përfshinë aktivisht në parti. Dhe kështu, me detyrë nga partia dhe duke marrë pjesë në mbledhjet e partisë, u takuan nëna ime dhe babai im dhe lindi dashuria mes tyre.

***

Meqenëse Velesi është në kodër, shumë shpejt mund të kalohej nëpër shtëpi dhe oborre për të ikur në pyllin e afërt, ose në kodrat e afërta të qytetit, kështu që nëna ime bënte roje, ajo në fakt shikonte që mos rastësisht të vijë ndonjë i huaj në mëhallën e vllahëve në Veles, ku kam lindur unë, dhe e cila, në një këngë popullore, njihet për shtëpitë e larta të verdha.

Në mes të luftës dhe angazhimeve partiake, shkëndija e dashurisë shkëlqeu fort. Kur u dashurua me babanë tim, nëna ime nuk ishte as tetëmbëdhjetë vjeç. Madje gjyshja ime i kishte thënë babait se nëna ime nuk mund të martohej me të, sepse nuk kishin çfarë t'i jepnin. Por, prapëseprapë ajo ishte një grua shumë e urtë dhe, sapo dhanë pëlqimin e ndërsjellë që të rinjtë e dashuruar të martoheshin, aty pranë, në të njëjtën mëhallë, ajo u gjeti atyre një hapësirë banimi për të jetuar atje. Meqë ishte shumë e re, ajo kishte nevojë të ndihmohej me mbështetjen e plotë të familjes dhe në fakt e mori atë.

Gjyshja ime, më tej vazhdoi të luante një rol të madh në jetën time, ajo më rriti.

***

Unë kam lindur në Veles, më 9 gusht të vitit 1943. Fatkeqësisht, babai im vdiq në shkurt të vitit 1944, kur unë isha foshnje shtatë muajshe dhe nuk e njoh fare. Pastaj, gjyshja ime e mori menjëherë nënën time me mua si foshnjë në krahë.

Ka një moment interesant për babanë tim, gjegjësisht për familjen e tij, në të cilën kishte pesë fëmijë. Ai ishte fëmija i dytë me radhë, e vëllai i tij i madh, i cili ishte floktar për burra dhe gra, kishte një shtëpi në Shkup dhe një dyqan në sheshin "Liria". Tek ata vija si fëmijë. Në atë hapësirë ishte shërbimi i zjarrfikësve.

Sot, e adhuroj zyrën time, sepse ma kujton fëmijërinë time, e që është afër dyqanit të

xhaxhait tim, ku i kaloja muajt e verës.

Këtu, në Shkup, mësova të ngas biçikletën, e rrethuar nga të afërmit e babait, sepse siç thashë, jam rritur me të afërmit e nënës sime, por ata mbanin lidhje të forta me të afërmit e mi nga ana e babait. Kisha dashuri dhe mbështetje të barabartë nga familjet e të dyja anëve. Unë kam qenë fëmijë shumë i dashur!

Nga vizitat e mia në Shkup mbaj mend një kujtim kur xhaxhai dhe gruaja e tij më prisnin në stacionin hekurudhor, i cili ishte një ndërtesë e mrekullueshme, madhështore, dhe më pas, më kujtohet në orën tre pasdite, xhaxhesha ime më futi në trenin e vogël për Tetovë dhe më dërgoi te xhaxhai tjetër.

Është interesant fakti se vëllai i babait tim, xhaxhai im, ishte vetëm shtatëmbëdhjetë vjeç kur shpërtheu Lufta e Dytë Botërore, dhe ai atëherë e solli babin tim nga Tetova në Veles, dhe iu bashkua partizanëve.

Gjyshja dhe nëna ime, si dhe familja e tyre, kujdeseshin edhe për të, njësoj si dhe dajat e mi kur ktheheshin nga partizanët, duke i larë, duke u gatuar, duke mbajtur roje prapa tyre, që pasi të mbaronte lufta, xhaxhai im të kthehej në Tetovë shëndoshë e gjallë.

E kur edhe ai u shkollua, ndonëse në atë kohë kishte një funksion të lartë, si në parti ashtu edhe në arsim, ai u martua me të zgjedhurën e tij nga Gostivari, dhe i kishte thënë se e kishte një vëlla në Tetovë, se kishte nënën, vëllain dhe motrën në Shkup, dhe se nuk kishte asnjë obligim ndaj askujt. Por, në Veles kishte vetëm një obligim, ndaj nuses së vëllait që i kishte ndërruar jetë, dhe gjithsesi edhe ndaj fëmijës që rritej pas largimit të tij nga kjo botë. Obligim ndaj meje!

Kështu, si nxënëse kam kaluar shumë verë dhe shumë pushime dimërore me ta në Tetovë. Unë isha fëmija më i madh në atë familje Siljanovski. Para kësaj, kur isha një fëmijë dy vjeçar, nënës sime, në baza partiake, iu ofrua të shkonte në Shkup. Atëherë nëna ime, e cila ishte ende duke mbajtur zi për shkak të vdekjes së babait tim, e pranoi ofertën dhe menjëherë pas çlirimit, erdhi në Shkup për të studiuar për infermiere. Ajo ka punuar si infermiere me uniformë në spital, por për shkak të lidhjes me gjyshen, sepse ende nuk kishte telefona, gjyshja ime nga Velesi çdo ditë i dërgonte ushqim nënës sime, edhe pse në spital kishte ushqim, por njëkohësisht edhe nga obligimi për ta informuar se si jam unë.

***

Xhaxhai im, vëllai më i madh i babait tim, siç e thashë tashmë, ishte i martuar, por ata nuk kishin fëmijë në martesën e tyre për gjashtëmbëdhjetë vjet. Kur vdiq babai im, unë isha një foshnjë shtatë muajshe, kurse nëna ime një e ve e re nëntëmbëdhjetë vjeçe, dhe ata erdhën dhe kërkuan të më merrnin dhe të përkujdeseshin për mua si fëmijën e tyre ose të më adoptonin, por dajat dhe gjyshja ime e respektuan vendimin e nënës sime. E pyetën: “Çfarë do ti, a dëshiron të rrish me fëmijën dhe ne do të të qëndrojmë pranë, apo do ta japësh përsëri në familjen e babait të saj?”, ndërsa përgjigja e saj ishte se donte të më mbante, dhe kjo u respektua nga të gjithë.

E kujtoj këtë gjithmonë emocionalisht. Mbështetja që mu dha u bë motiv që unë të kujdesem për popullatën e grave dhe përkon me qëndrimin tim se pavarësisht se çfarë do të kesh në jetë dhe çfarë do të ndodhë me ty, vetëm me një mbështetje dhe mirëkuptim të mirë mund të përparosh.
Dhe kjo është arsyeja pse unë i kushtoj kaq shumë rëndësi kësaj, prandaj ne sot kemi një telefon SOS në organizatën tonë, kemi edhe këshillues, sepse gratë edhe në shekullin e 21-të përballen me të njëjtat probleme, pavarësisht se të cilës natyrë janë ato.

Por, për shkak të mungesës së mbështetjes, apo të mos dijes se si duhet bërë diçka, gratë bëhen viktima ose vriten ose mbeten vetëm me veten dhe fëmijët e tyre, përsëri të palumtura.

Padrejtësi ose pamundësi për të kapërcyer pikëllimin

Nëna ime jetoi deri në moshën nëntëdhjetë vjeç dhe të gjithë ishim të lumtur me të. E kam pyetur shpesh veten, edhe si e re, edhe si e rritur, edhe kur u bëra nënë - po i bëj apo jo padrejtësi babait tim, që kurrë nuk e kam ndjerë se më ka munguar, sepse nuk e kam parë kurrë, as nuk e njoh.

Kam qenë e rrethuar me dashuri të madhe nga të gjithë, asnjëherë me ndonjë dozë keqardhjeje. Thjesht, ku ishin tre fëmijë, unë isha e katërta, ku ishin katër, unë isha e pesta, ku nuk kishte fëmijë, unë isha e para në familje. Gjithmonë e barabartë me fëmijët e tjerë.

Punësimi

Tani dua t'i kthehem periudhës kur ndodhi transicioni në vitin 1991. Unë, nuk u përcaktova në linja partiake, por në atë periudhë, më 28 shkurt të vitit 1991, në godinën e Lidhjes Socialiste u mblodhën 28 gra në një mbledhje dhe më propozuan mua të bëhem kryetare e organizatës së parë lokale të grave të Qytetit të Shkupit dhe komunave.

As unë nuk e dija, dhe mendoj se askush nuk e dinte, se çfarë do të ndodhte me organizatat e shoqërisë civile dhe çfarë roli do të luanin ato në të ardhmen.

Pse e potencoj këtë? U dhashë një ide se prej çfarë familjesh vij, por dua të theksoj se si nga ana e babait, ashtu edhe nga ana e nënës, mbetëm me një kredo - të jemi gjithmonë njerëz të ndershëm, të përgjegjshëm dhe punëtorë. Pa asnjë pëllëmbë tokë diku, sepse të mitë, si nga njëra anë ashtu edhe nga ana tjetër, vijnë nga qytetet dhe prandaj nuk kemi tokë. Ne nuk kemi trashëgimi, kemi qenë familje thjesht punëtore.

Por, ajo ndershmëri e ngulitur dhe puna e palodhshme më bëri lider në atë mjedis, në kushtet e asaj kohe.

Kur më propozuan të bëhem kryetare në vitin 1991, nuk e dija se çfarë ishte kjo, çfarë do të bënim, çfarë do të punonim... Jam e bindur se edhe ata që më propozuan të bëhesha kryetare, nuk e dinin se në çfarë drejtimi do të zhvillohen organizatat joqeveritare. E dija vetëm se duhej të punohej me ndershmëri dhe me unitet, me mbështetje reciproke nga të gjitha anët.

Pse e them këtë? Nuk kisha dikë të ma ruajë shpinën, nuk kisha dikë që të më mbështeste për funksion, babai më vdiq shumë i ri, nëna ime doli në pension si infermiere dhe jetoi deri në moshën 90 vjeçare. Dajat qëndruan në profesionet e tyre, por nuk u bënë funksionarë, nuk morën asnjë pension të luftës, as nga familja e babait, as nga ajo e nënës, mbetëm njerëz të popullit. Kjo do të thotë për mua ishte e përcaktuar, ndryshe as që duhet të jetë.

Lindi një yll

Kur rritesha, gjyshja më thoshte: ti ke lindur si yll! Ajo vazhdimisht më vajtonte, i vinte keq që mbeta pa baba kur isha ende shumë e re, por nga ana tjetër për mua thoshte fjalë inkurajuese - ajo ka një yll!

Gjyshja ime, jo vetëm që u dallua për aktivizmin e saj gjatë luftës, por edhe pas luftës mblidhte rroba për t'ua dhënë jetimëve. Ajo ishte një grua humane.

Kur isha fëmijë, jetonim në një shtëpi me oborr të madh, lart me hardhi e poshtë me pllaka të mëdha, gjegjësisht me gurë të mëdhenj dhe i fshinim të gjitha.

t'i shkëmbenim.

E lindur në një shtëpi që është në udhëkryq dhe shpesh kur shpjegoj pse nuk rri në shtëpi, pse jam shumë aktive, them se kam lindur e tillë, se duhet të jem diku në rrugë, ose lart, ose poshtë, ose drejt. Mirëpo, të jem në rrugë, si në fëmijëri.

Përndryshe, shtëpia në Veles kishte një derë të përparme dhe një të pasme dhe një kapixhik me fqinjët, sepse gjithmonë kishte nevojë që nëse dikush hynte nga njëra derë, e ti nuk doje ta takoje, të mundeshe të largohesh nga dera e pasme, ose të shkoje te fqinja në mes të natës pa të parë njeri.

Në shtëpinë e gjyshes sime, çezma ishte në portën e daljes, dhe ti duhet të dalësh i përgatitur, sepse shtëpitë sipër teje (meqë Velesi është i ndërtuar dhe i vendosur në një kodër), kanë pamje nga çardakët ose nga dritaret e tyre në oborrin tënd.

Dhe kjo është arsyeja që ndoshta kur më pyesin tani pse i ujis lulet në shtëpi e veshur bukur, njësoj sikur të dilja për të shkuar në zyrë, them se me gjasë kjo është e lindur, që do të thotë se ngrihem dhe e bëj të njëjtin ritual që në mëngjes, ose sikur të isha nisur për të shkuar ne kinema, më parë duhet të vishem bukur.

Meqenëse u rrita në lagjen vllahe, në të cilën edhe sot e kësaj dite ekziston Kisha Vllahe, oborri i kishës - ishte vendi ynë për të luajtur. Shkonim atje të dielave për të parë pagëzimin e foshnjave. Ato ishin rituale dhe ngjarje interesante për ne, përveçse shkonim në shkollë, i kishim edhe ato shfaqjet shkollore dhe lexonim libra, por edhe shfaqjet teatrale dhe kinemanë, ne i ndiqnim edhe dasmat e përditshme. Edhe pse në atë kohë shumë pak njerëz martoheshin në kishë.

Kur isha fëmijë 7-8 vjeç, gjyshet më të moshuara shkonin në kishë për liturgjinë e mëngjesit dhe pas liturgjisë vinin tek ne për kafe dhe ëmbëlsira. Gjyshja thoshte se është kjo një nder dhe fat i madh për shtëpinë, nga kisha të vinin gratë dhe që e zgjidhnin këtë shtëpi të parën për të pirë kafe. E mbaj mend, mua më jepte përparësi ndaj mbesave dhe nipave të tjerë, dhe mua ma jepte, jo obligimin, por nderin, t'u bëja kafe gjysheve.

E tani të them edhe diçka për fenë. Poshtë në Veles e kemi të ashtuquajturën Xhaminë e Zezë - sepse ajo xhami dikur është djegur, prandaj edhe quhet kështu, dhe prej saj e ka marrë emrin edhe mëhalla - Xhamia e Zezë. Ajo është "dy hapa" larg prej meje. Këtë ma kishin thënë gjyshja dhe gjyshi. Gjyshja ime ka lindur në vitin një mijë e nëntëqind e diçka, e gjyshi im ishte 12 vjet më i madh se gjyshja ime, kështu që ata kanë lindur, po, pikërisht në Perandorinë Osmane. Gjyshi im, që ishte qumështor, fliste turqisht dhe këndonte këngë turke, këtë e di. Në Veles, turqit i sillnin qumështin.

Gjyshja ime nuk shkonte në kishë, por dinte të sillte ikona në shtëpi. Kishte një thënie: "Unë besoj në Zot, por nuk besoj në priftërinjtë".

Nuk e di sa ka ndikuar kjo tek unë, por edhe unë jam diku aty. Madje mendoj se unë si gjeneratë nuk guxoj të them – kështu ndihem. Kjo na u imponua, kushtimisht thënë, sepse u pagëzova në Kishën Vllahe.

Shpesh herë i them vëllait tim, i cili është 10 vjet më i vogël se unë, se ndoshta ngaqë

jam kimiste dhe besoj në materie dhe shpirt, jam e bindur që trupi ynë është materie, dhe se shpirti nuk zhduket, por kalon nga një formë në tjetrën. E ai më respekton shumë, por më thotë “Po dadë, por duket se nuk je e kësaj feje”, duke aluduar se jam vllahe.

Por, sidoqoftë, kur shkoj në shtete të tjera, detyrimisht i vizitoj gjërat e famshme, qoftë kishë katolike, qoftë xhami, qoftë në Stamboll, qoftë në Prishtinë, qoftë në Zagreb, qoftë në Beograd, ku kam qenë edhe në kishën e madhe të Shën Savës, qoftë në Shkup në Hamamin e Daut Pashës...

Për këtë arsye mendoj se është e vërtetë kur themi se nuk jetojmë pranë njëri-tjetrit, por them “ne jetojmë me njëri-tjetrin”. Në mënyrën time të jetesës, e këtë e ndjej edhe te shoqet dhe mikeshat e mia të ngushta, që i përkasin ndonjë feje tjetër, nuk ia imponojmë bindjet tona fetare njëra-tjetrës.

Edhe sot e kësaj dite kam gjurmë në sjelljen time nga ajo që e kam parë tek ato gjyshe, respektin e tyre për gjithçka. Edhe sot e kësaj dite më kujtohet atë që e kam parë në fëmijërinë time, si janë sjellë të moshuarit. Dhe nuk e refuzoj këtë, ajo është thellë brenda meje, kjo mbetet përgjithmonë.

Gjyshja ime, sikur po e shoh tani, mbante ikona në shtëpi, megjithëse nuk shkonte kurrë në kishë. Edhe një gjë për gjyshen time. Pas luftës, 200 metra nga shtëpia jonë, nga kodra drejt pazarit poshtë, është një shkollë dhe pranë saj një konvikt i madh, i cili pas luftës ishte jetimore.

Aty u vendosën jetimët e luftës, mes tyre kishte edhe gjermanë. Unë u shoqërova me ata fëmijë. Gjyshja ime ishte shumë punëtore dhe pedante dhe e angazhuan si kuzhiniere dhe ajo pranoi. Gjithçka ishte humanitare, dhe unë kisha nderin që të dielën të shkoja në drekë me ta, dhe sikur po i shikoj tani, tavolinat e shtruara dhe në çdo tavolinë ka një ibrik me ujë dhe gota, gota, gota... Çdo fëmijë shkonte, shkoja edhe unë, për të marrë ushqim.

E pastaj unë, gjyshja ime dhe nëna ime, do të merrnim nga një vajzë në shtëpi për drekë. Nuk mund t’i merrnim të gjitha, sepse nuk kishim shtëpi aq të madhe - një dhomë të madhe, dhomë ngrënie dhe kuzhinë... Kështu që, ndoshta liria që kam në sjelljen time është pjesë e kësaj.

E gjithë kjo më bëri kjo që jam sot. Pra, tullë pas tulle, u ndërtuan ato shprehi të bashkimit, të gjitha këto ishin rrethana të dobishme...

***

Në Veles, fqinja jonë e parë ishte Grozda Patlixhankova, dhe dritaret e tyre shikonin në oborrin tonë. Ata kishin një çardak të ndërtuar në oborr dhe gjatë verës kur verat ishin shumë të nxehta, të gjithë fqinjët shkonim të flinim në çardakun e tyre.

Më kujtohet edhe oborri i tezes sime në Konjik, motrës së nënës sime, atje mblidheshin të gjitha fqinjat për të bërë jufka dhe tarhanë, ishte një sistem i përpunuar i

përgatitjes - njëra hollon, tjetra hollon, e treta hollon, pastaj i shtrijnë, e katërta i mbledh, dhe kështu përnjëherë për një ditë bëjnë për tre shtëpi. Dhe të gjitha të lumtura dhe të kënaqura, me atë jetë të përbashkët.

Kurse oborri i gjyshes në Tetovë, më kujtohet se kishte edhe man të zi. Dhe aty shtrihej një çarçaf, për ta tundur manin dhe mblidheshin të gjithë fqinjët.

Kur shkoja për t'i vizituar në Tetovë, xhaxhesha ime më dërgonte të shkoja të vizitoja edhe familjen e saj në Gostivar. Motra e saj më e vogël ishte disa vjet më e madhe se unë, dhe ne shoqëroheshim. Atje kishin bahçe me fruta për të cilat vinin fqinjët.

Kur shkoja për t'i vizituar në Tetovë, xhaxhesha ime më dërgonte të shkoja të vizitoja edhe familjen e saj në Gostivar. Motra e saj më e vogël ishte disa vjet më e madhe se unë, dhe ne shoqëroheshim. Atje kishin bahçe me fruta për të cilat vinin fqinjët.

Nuk i kuptoja si flisnin, në lagjen time në Veles kishim turq, kishim edhe romë, por ata flisnin maqedonisht, kështu që nuk e dija se kishte edhe gjuhë tjetër përveç maqedonishtes. Kur shkova në Gostivar, kuptova se kishte një gjuhë tjetër - ajo ishte shqipja. Në familjen e xhaxheshës sime, ishin kontaktet e mia të para me fëmijët që ishin të ndryshëm nga unë. Atëherë në bahçet e xhaxheshës sime shoqërohesha me ata fëmijë. Lojërat tona ishin të përbashkëta, mblidhnim fruta, si ato në strajcën e tyre, ashtu edhe ne në strajcat tona.

Shkupi - kapitull i ri

Në vitin 1962 erdha edhe të jetoj në Shkup. Burri im, i cili ishte i dashuri im që në Veles, u shpërngul në kryeqytet me familjen e tij. Në atë kohë, ne ishim, kushtimisht thënë, një çift i njohur. Ne u dashuruam që nga Velesi. Në atë kohë sindikata solli biçikleta ruse në spital, dhe nëna ime më qerasi, më bleu një biçikletë nga rroga e saj. Dhe në Veles në atë kohë në vitet e 50-ta, unë shkoja me biçikletë, nga mëhalla ime në Veles, për në shkollë.

Të dashurit tim, familja e tij i blenë një motoçikletë në vitet e '60-ta. Vija në Shkup për të, zakonisht në fundjavë. Edhe ai me motoçikletën e tij vinte shpesh në Veles për të më parë. Gjatë kohës që studioja, kam udhëtuar në Shkup për të shkuar në operë, për të shkuar me të në kinemanë "Kultura", kinema "Rinia".

Menjëherë u punësova në Shkup, pa i treguar nënës sime, u punësova sepse isha bursiste e fonderisë "Zhelezarnica" dhe të gjithë bursën ia dhashë nënës sime. Nuk kam marrë asnjë qindarkë nga familja ime, e kjo është kështu edhe sot e kësaj dite.

***

Së pari, kur erdha në Shkup, shkova të jetoja me gjyshërit e mi. Gjyshja ime kishte një motër të martuar në Shkup, por ata nuk kishin fëmijë, u vdiqën. Kur vdiq babai im, veçse xhaxhai erdhi të më kërkonte, erdhën edhe ata më kërkonin për të më marrë.

Burri i saj kishte një mobilieri, ata ishin njerëz të pasur, por ju thashë se nëna ime dhe familja ime ishin të vendosur - të mos më jepnin në asnjërën nga ato dy familje të afërta, të cilët mund të kujdeseshin për mua shumë më mirë materialisht dhe financiarisht, por dëshira e nënës sime ishte më e madhe. Dhe mendoj se unë isha shumë e lumtur me atë vendim dhe ata me mua. E për shkak se në Shkup kisha xhaxhain dhe tezen, dhe xhaxhain në Tetovë, si fëmijë, e po ashtu edhe pa u martuar, kam udhëtuar shumë shpesh andej-këndej gjatë pushimeve verore. Në verë, shkoja atje për vizitë - xhaxhai dhe xhaxhesha ime punonin, e fëmijët e tyre ishin dhjetë vjet më të vegjël se unë, ishin foshnja një vjeçare, e unë isha njëmbëdhjetë vjeçe. Por, rrinim bashkë në shtëpi, ato vraponin rreth tryezës, unë do t'u jepja një filxhan me qumësht, ata do ta derdhnin, lojëra fëmijësh.

***

Më lejoni të kthehem pak prapa tani. Nëna ime si infermiere duhej të ishte një shembull i sjelljes me fëmijën e saj në mjedisin ku jetonte. Unë jam gjenerata e parë që shkoi në kopsht dhe kur shkova në klasën e parë, isha një fëmijë i përgatitur me vjersha të mësuara, tregime, me shprehi për mbajtjen e higjienës, më kishin përgatitur tashmë në shtëpi, e më pas edhe në kopsht, në një kohë të re, në të cilën po ndërtohej shteti i pasluftës.

Pastaj, kur isha dhjetë vjeç, u shpërngulëm për të jetuar në Kumanovë. Aty fillova të shkoj në shkollën e muzikës. Dhe pasi vij nga Velesi, ku dialekti është me theks në

rrokjen e tretë nga mbrapa, dhe prandaj flasim një maqedonishte të pastër, kështu që unë u dallova nga të tjerët, por shokët dhe shoqet e mia nga mëhalla në qendër të Kumanovës, më thoshin – “vetëm nëse flet kumanovarçe, do të marrim në shoqëri”. Unë i kapa menjëherë disa fjalë “mavaçku, kude tebe, kude mene” [mavaçka, o te unë o te ti] dhe më besuan menjëherë.

Mirëpo, kur filluam klasën e tretë në shtator, dhe siç dihet, më 11 tetor u shkrep pushka e parë në Kumanovë, për nder të asaj feste, të gjithë fëmijët na mblodhën në sallën e fizkulturës dhe thanë se dikush duhej të lexonte. Mësuesja menjëherë ma dha tekstin mua, sepse dija të lexoja qartë dhe pastër në gjuhën letrare maqedonase. Kështu fillova të paraqitem në ngjarje publike, dhe të jem e mirë në këtë, sepse këtë e mësova që në kopshtin e fëmijëve.

Më pas kemi pasur shumë aktivitete. Në Kumanovë është një sallë, ku ushtroja në tra, në tapet, në rrathë, në tezgjah dhe pasuan garat. Në të njëjtën kohë kreva edhe shkollën e ulët të muzikës.

Në Kumanovë në sheshin afër katër tumbave të famshme kishte bibliotekë. Gjatë pushimeve verore biblioteka ishte e hapur nga ora 9 e mëngjesit deri në 12 dhe pasdite nga ora 16 deri në 18. Unë dhe shoqja ime nga e njëjta klasë, me të cilën shoqëroheshim në mëhallë, shkonim për të lexuar libra, sepse nga biblioteka nuk na jepnin libra për t’i marrë në shtëpi. Dua t’u jap një pasqyrë të kohës në të cilën kemi jetuar, gjegjësisht vitet ‘54, ‘55, ‘56. Pra, e lexonim librin, por e lexonim së bashku, dhe garonim se cila do ta kthente faqen e para. Nga njëra anë garon, kurse nga ana tjetër e ndjek cilësinë, sepse pastaj bisedonim për librin. Kjo ishte mënyra e të mësuarit, kjo ishte mënyra e shoqërimit. Kur në fund të vitit shkollor mbaheshin shfaqjet në Kumanovë, gjithmonë kishte një shfaqje dhe një dramë, dhe unë isha në rolin kryesor, por në të njëjtën kohë edhe luaja në pianon e vendosur në skenë.

Një herë gjyshi im nga Velesi erdhi për vizitë në Kumanovë dhe së bashku me gjyshin tjetër kishin ardhur së bashku në shfaqje, pa i njohur askush. Të gjithë kishin pyetur për mua: “Kush është kjo nxënëse?” sepse unë nuk kisha lindur në Kumanovë, dhe nuk isha fëmijë i njohur për ta. Luaja përmendësh në piano, sepse melodinë e mëson përmendësh duke ushtruar, kështu që e kur shoh Simon Tërpçeskin duke luajtur, më kujtohen ato momente. Përndryshe, e dua muzikën në përgjithësi dhe gjëja që më ngazëllen më shumë është muzika maqedonase. Gjithsesi, tradicionalja dhe ajo e kompozuar rishtazi, ndoshta sepse i njoh, e melosi mi kujton çallgitë e Velesit.

Nuk i kuptoja si flisnin, në lagjen time në Veles kishim turq, kishim edhe romë, por ata flisnin maqedonisht, kështu që nuk e dija se kishte edhe gjuhë tjetër përveç maqedonishtes. Kur shkova në Gostivar, kuptova se kishte një gjuhë tjetër - ajo ishte shqipja. Në familjen e xhaxheshës sime, ishin kontaktet e mia të para me fëmijët që ishin të ndryshëm nga unë. Atëherë në bahçet e xhaxheshës sime shoqërohesha me ata fëmijë. Lojërat tona ishin të përbashkëta, mblidhnim fruta, si ato në strajcën e tyre, ashtu edhe ne në strajcat tona.

Shkolla e mesme

Në vitin 1959 u kthyem në Veles. Në atë periudhë, më kujtohet, para se të filloja në shkollë të mesme, kishim një matine, diçka e ngjashme me diskotekën e sotme. Ajo mbahej të dielave nga ora 15 deri në orën 19, në një nga klasat e shkollës, dhe meqë atëherë nuk kishte magnetofon, kolegët që luanin në shkollën e muzikës, luanin në violinë dhe kitarë, e ne vallëzonim.

Edhe shkolla e mesme ishte një histori e bukur. Gjithmonë kam pasur dëshirë të bëhem mësuese. Isha nxënëse e fortë dhe mendoja se mësoj në shkollën për mësues, kështu më ka drejtuar gjyshja, por shkolla për mësues ishte në Shkup.

Nëna ime mbeti sërish vetëm, dhe bashkë me vëllain na rriste me një rrogë solide të infermieres, duke përfshirë edhe kujdestaritë. Jetonim në shtëpinë e gjyshes, nuk paguanim qira, e gjyshja ishte përsëri këtu pranë nesh, e ngarkuar për edukimin tonë, e për këtë e ndihmonin edhe nuset e dajave dhe tezet.

Në atë kohë, në vitet ’58-’59, në Veles u hap shkolla e mesme teknike dhe teknologjike-kimike. Ishte sfidë të ishe aty, ishte vetëm një klasë dhe unë u pranova në kimi. Mund të pranoheshin 28 nxënës, vetëm ata me që i kishin të gjitha notat pesa, ku bëja pjesë edhe unë. Atëherë e takova burrin tim, i cili u bë i dashuri im. Ishim të ndryshëm - unë lexoja shumë, argëtimi im në Veles ishte kinemaja dy herë në javë, të enjten dhe të shtunën, kishim kinema për nxënësit nga ora 10. Ishte nga 10 dinarë, pothuajse falas.

Argëtimi dhe teatri, gjithmonë ishin të lidhura me nënën time, së bashku i ndiqnim të gjitha shfaqjet teatrore dhe leximin e romaneve. Mund të lexoja romanin “Lartësitë e stuhishme” për 24 orë. Romanet thjesht i gëlltisja, edhe të mëdhenjtë - të Dostojevskit, Vladimir Sholohovit, Pasternakut, lexova “Ana Kareninën”, e gjithë kjo ishte një sfidë për mua, e lektyrat patjetër, ato ishin, si të thuash, një zamër. E për filmin!

Në kohën kur u rrita, filmat rusë ishin trendi. E di pse - sepse pas luftës duhej të jepnit diçka për shtetin, dhe meqë ne kishim një shtëpi të madhe te gjyshja ime, ata dhanë një dhomë për disa njerëz për të ardhura disa njerëz, kështu që në shtëpinë tonë u vendos një grua nga Vojvodina me katër vajza.

Në kinema shkoja bashkë me ta. Pamë një film rus. Isha shumë e vogël, por kjo mbeti në kujtesën time. E rusët mbajnë një nga ato kapelat si kazan, edhe gjyshi im mbante një kapele të tillë dhe gjatë filmit më thanë “Ta vranë gjyshin” dhe unë fillova të qaja. Kishte edhe filma me tatarët, por filmat me kaubojë dhe të dashurisë ishin më të njohurit në atë kohë. “Lady Chatterley”, “Iku bashkë me erën”, film që atëherë ishte në dy pjesë, fillimisht pjesa e parë, e pastaj duhej pritur 15 ditë që të vinte pjesa e dytë. Të gjithë prisnim ta shihnim pjesën e dytë me Scarlett O’Hara. E kemi parë edhe “Ana Kareninën”, të cilin e kisha lexuar edhe si libër.

Tani këtu, nga këndvështrimi i një gruaje, do t’ju themi pse nuk e respektoj Ana Kareninën - sepse ajo ishte viktima e vetme. Nuk dua që gratë të jenë viktima, për shkak të dashurisë së tyre, këtë e promovoj edhe tani në moshën 80 vjeçare. Këtë ua them

edhe grave që janë viktima – mos kini frikë nga dashuria, por jini të sinqerta, të hapura dhe të përgatitura në jetë.

Nga vërshimi në tërmet

Në vitin 1962 ndodhi një vërshim në Shkup, dhe deri në verën e vitit 1963 gjithçka u rinovua. U rinovua Shkupi, u rinovuan ndërtesat... E unë dhe burri im, ishim një çift i ri dhe shëtisnim nëpër Shkup, në Shtëpinë e APJ-së, në shesh, në kullën e vjetër përballë ndërtesës së vjetër në shesh... Pallatin e Ristiqit, shtëpinë e mallrave “Nama”, kinemanë “Vardar”, kinemanë “Rinia”, rrugën drejt stacionit hekurudhor, Stacionin hekurudhor, kinematë, teatrot, të gjitha këto i kemi ecur si të rinj.

Si rrugët ashtu edhe shëtitorja ishin të mrekullueshme. Mbrëmë me burrin shkuam në kinema dhe po ecnim nëpër rrugën përballë sheshit “Liria”. Mrekulli! Pas vërshimit, Shkupi i rinovuar dukej bukur. Kemi shëtitur nëpër çarshi, dhe mua në Shkup më pëlqen më së shumti Çarshia e Vjetër, sepse arkitektura e kohës së vjetër dhe osmane është ruajtur pak a shumë, dhe ma kujton shumë Velesin tim. Prandaj, kur dua të pushoj (nuk do të thosha të qetësohem, sepse kur dua të qetësohem rri në shtëpi, nuk shëtis nëpër çarshi dhe nëpër rrugica), shkoj atje, ulem, pi çaj dhe kështu pushoj. Më pëlqen shume që ka kalldrëm, e tjegulla, ma kujton shume vendlindjen time, dhe kur e krahasoj, me duket pak si Ohri, por Ohri nuk me motivon aq sa kjo Çarshi, dhe Ohri nuk ma kujton Velesin. E në Ohër, madje edhe kënaqja me çallgi, nuk më motivon aq sa kjo që e përmenda.

Tërmeti (1963)

Më kujtohet ajo ditë, 26 korriku… Ora katër e gjysmë e mëngjesit... unë tashmë jetoja me gjyshin dhe gjyshen në sheshin “Liria”, e aty ishte epiqendra e tërmetit, ku tani është ndërtesa te “Koço Racini”. Ne kishim një shtëpi këtu, dhe gjyshi u ngrit në mëngjes, edhe unë u zgjova, kisha nevojë, mbarova dhe shkova përsëri në shtrat dhe rashë në gjumë, ishte një gjumë i thellë.

Në orën pesë e shtatëmbëdhjetë, kur u zgjova, u zgjova në dysheme, jashtë dritares shihja pluhur, ashtu siç është muri i bardhë, e ngaqë kisha lexuar, mendova se kishte rënë bomba atomike. Por, meqenëse kisha lexuar duhet të qëndroni në skaj dhe të shihni se ku ka tub, vetëm këtë e mbaj mend se e kam bërë.

Gjyshja ime u zgjua dhe donte të dilte nga dera, mirëpo gjyshi po pinte kafe dhe nuk e lejoi. Atëherë, shtëpia pranë nesh u shemb dhe të gjitha tullat ranë dhe e bllokuan hyrjen. Dhe megjithëse dolëm, me inerci për të shpëtuar, nga ajo që kam lexuar, mua nuk më shkonte mendja se ishte tërmet. E dija për bombën atomike në Nagasaki dhe Hiroshimë, e kisha ende të freskët këtë...

Mirëpo, në shtëpinë përballë nesh erdhi ndihma e shpejtë, dhe ne me shpejtësi dolëm jashtë. Aty pranë ishte rruga aktuale “Maksim Gorki”, aty ishte “Vanilja”, aty ishte sheshi i vogël, dhe këtu ndaleshin kamionët me shishet e qelqit që sillnin qumësht dhe

jogurt nëpër shtëpi...

Dhe kur dolëm jashtë të gjithë, kuptohet nuk ishim të veshur, unë dola vetëm me pjesën e sipërme të pizhameve, sepse kur u ngrita në mëngjes më duhej të hiq-ja pjesën e poshtme. Gjyshi me pizhame, gjyshja me pizhame, i gjithë populli, me pizhame.

Në 5-10 minutat e para, ambulanca kalonte me foshnja të vdekura, fëmijët përpiqeshin të futeshin, disa të gjakosur, disa me dorë të prerë... E në ato momente, njerëzit që i sollën kamionët me qumësht, na jepnin qumësht dhe na thoshin “Shpërlajeni gojën”. E për të thënë diçka, i kërcëlloje dhëmbët për të nxjerrë pluhurin e rrënojave. Këtu në rreth ishte Batros, këtu ishte Radio Shkupi, këtu ishte shkolla fillore “Goce Dellçev”, gjithçka ishte rrënuar... Aty ishte ambulanca, e shtëpia jonë ku banoja me gjyshin dhe gjyshen ishte rrënuar. Rrinim ulur të hutuar pranë rrënojave. Më pas nëna më tregonte se edhe ata e kishin ndjerë tërmetin në Veles, por në Radio Shkup nuk kishte asnjë lajm. Dëgjohej vetëm “Radio Shkupi, Radio Shkupi...”. Për shkak se në atë kohë nuk kishte televizion, zgjoheshe, e ndizje radion dhe dëgjoje. Askush nuk e kishte idenë se çfarë po ndodhte. Nëna ime shkoi në spital në orën gjashtë e gjysmë dhe aty tashmë sheh kamionë të gatshëm, vetura, një ambulancë dhe vetëm i futin brenda dhe u thonë “Shkojmë në Shkup”.

Ishte një kohë e tillë në shoqëri, të gjithë shkojnë në Shkup dhe nuk pyesin pse. Por, pasi shkojnë me mjete dhe si ekip, pyesin “Çfarë ka ndodhur?”. Mjeku që ishte përg-jegjës për grupin i tha nënës sime se kishte një tërmet në Shkup dhe se shkojnë për të ndihmuar. Kur erdhën, shohin rrënoja: vijnë tek stacioni hekurudhor - i rrënuar, e nga stacioni hekurudhor në shesh shkohet vetëm përmes një rruge.

Nëna ime kishte qenë e veshur me uniformë mjekësore, thotë se i kishte thënë shoferit “Të lutem ndalo... Doktor, fëmija im është këtu, madje edhe nëse më largoni nga puna, duhet të shkoj ta kërkoj”. Fillimisht erdhi të më kërkonte, më pa, më pas u kthye të shërbejë në spital, por duke qenë se ajo nuk e përjetoi këtë, në atë moment nuk kishte frikë që të hynte në shtëpi nëpër rrënoja dhe t’i merrte rrobat e mia.

Për tre ditë ishim këtu në qiell të hapur, i dashuri im, që më vonë u bë burri im, erdhi me biçikletën time, mirëpo kur arriti tek rrënojat e pashë se u rrëzua pa ndjenja, duke menduar se shtëpia jonë ishte rrënuar. Kur i bërtita, iu kthye vetëdija dhe më pas më mori dhe më çoi në shtëpinë e tyre, ata jetonin mbi kishën “Shën Petka”, në lagjen Përzhinë. Edhe tek ata - vetëm rrënoja. Nuk kishte as autobusë.

Kemi fjetur në oborre, kurse gjyshi dhe gjyshja mbetën këtu. Ishte frikë dhe tmerr. Njerëzit flinin nëpër çadra së bashku, në park, pranë lumit, e kushdo që mund të punonte, punonte në mënyrë solidare mbi rrënojat. Pas tre ditësh kur u qetësua situa-ta, u tha se duhet pastruar rrënojat. Në atë kohë kishte solidaritet, menjëherë erdhën ekipet e ndihmës dhe na liruan neve femrave dhe të rinjtë, dhe na thanë se mund të largohemi nga Shkupi derisa të na thërrasin prapë. Sollën batanije, sollën edhe ushqime, unë nuk mora asgjë sepse do të shkoja në Veles, në shtëpinë e të mive, atje asgjë nuk ishte rrënuar dhe kisha gjithçka. Kjo t’u jepet të tjerëve. Epo, ky është ai solidaritet.

Pastaj shkuam në Veles. Më pas, kur situata u qetësua, në Kisella Vodë filluan të

Burri im dhe kolegët e tij të fakultetit ishin përgjegjës për marrjen e vendimeve dhe dhënien e barakave, dhe neve thjesht na lusnin të na jepnin një barakë, por ne u thamë “Jo, nuk kemi nevojë, nuk e duam”. Ajo vetëdije, nëse mund të kthehet, gjithçka do të jetë mirë, kjo është ajo që u ndërtua në socializëm. Shumë shkurtë, vetëm tre muaj pas tërmetit qëndrova në Veles, pastaj u shpërngulëm në Shkup dhe u punësova në fonderinë “Zhelezarnica”. U pastruan rrënojat dhe po ndërtohej qyteti, por ne mundëm të jetonim dhe kurrë nuk patëm krizë parash, kishim edhe para në librezë.

Njohja e ligjit

Tani le të flasim për gratë. Kur bëhet fjalë për gratë, një gjë e rëndësishme në fushën e të drejtave të grave është sa vijon - gratë nuk duhet vetëm të arsimohen, të kenë vetëm një diplomë fakulteti dhe doktoraturë (edhe pse më shumë gra kanë diplomë doktorature sesa burrat në vendin tonë), ato duhet t’i lexojnë edhe ligjet, të dinë të përballen me problemet dhe t’i mbrojnë të drejtat e tyre.

Për shembull, ndodhi që një intelektuale e re të më thotë se kishte qenë te një punëdhënës, dhe më thotë: “Kisha një intervistë për një punë dhe ai më pyeti nëse isha e martuar, nëse do të martohesha dhe a planifikoj të bëj fëmijë?”.

Ajo u habit, por po ta kishte lexuar Ligjin për Marrëdhënien e Punës, do të dinte si të përballej me këtë situatë. Jo të jetë e pasjellshme, por thjesht t’i thoshte atij: “Zotëri, nuk mund ta bëni këtë, nuk guxoni ta bëni këtë, unë kam të drejtat e mia”, dhe ai do ta kuptojë se sa di ajo, e pastaj bile edhe do ta punësonte atë. E ajo intelektuale me diplomë magjistrature u befasua. Le të mos e lejojmë këtë. Vetëm njohja e ligjeve do të na sjellë dobi neve grave.

Ose - para pak kohësh më telefonoi një grua e re, 27 vjeçe dhe më tha se për shkak se ka masa për gratë, ajo ka marrë një traktor në vlerë prej 40 mijë euro nga Ministria e Bujqësisë, mirëpo për ta marrë traktorin, burri i saj ia ka dhënë pronësinë e një pjese të tokës nga prona. Mirëpo, tani ajo duhet të kthejë 30 mijë euro nga llogaria e saj në Ministrinë e Bujqësisë. Tani burri i saj e frikëson dhe i thotë: “Ti do ti kthesh paratë, ti ke krijuar një situatë duke gënjyer”. Ajo duhet ta dijë se ai e ka gabim, dhe se po e manipulon, por për fat na thirri në telefonin tonë SOS dhe i thamë: “Lexoni dispozitat që vazhdimisht i përmendin. Nuk ke gënjyer ti, ai ka gënjyer”. Kështu e shpëtuam gruan.

Ne, si organizatë, avokojmë që gratë të jenë pronare të një prone të caktuar, qoftë makinë, traktor, truall, dhomë, ku ajo grua do të jetë në gjendje të jetë e pavarur, në mënyrë që në jetën e saj të sillet ashtu si do vetë. Në atë kohë kur isha duke u rritur, na mësuan se cilat ishin të drejtat tona dhe cilat ishin përgjegjësitë tona. Ajo ishte koha e zgjimit të vetëdijes.

Bardhë e zi

Me sa duket, ju nuk i mbani mend vitet ‘48 dhe ‘49? Ose je për Titon ose je për Stalinin, e pastaj “Goli Otok”. Kjo është ajo që unë ua them tani atyre që e shohin situatën si të zezë ose të bardhë dhe janë kundër meje në një situatë të caktuar. Në rregull, jini kundër meje, nuk më intereson, unë e them mendimin tim dhe kaq. E nëse duan të jenë kundër, le të shkruajnë edhe në rrjetet sociale.

Kjo më ka mbetur nga fëmijëria. Në shtëpinë tonë të gjithë së bashku i merrnim vendimet.

Nëse mblidhemi për një takim, edhe sot e kësaj dite, unë do t’ua them atë që e mendoj dhe më pas dua një bisedë konstruktive, një bisedë që do jetë me vend, me argumente dhe kundër-argumente, dhe kjo më ka mbetur si shprehi që në fëmijëri. Nuk dua të flas para çezmës, në erë apo të zihem në rrjetet sociale.

Barazia!

Në periudhën e pandemisë filluam ta përgatisim ligjin si tekst, unë thashë që në fillim se së pari jap propozim për ndryshimin e titullit, të mos quhet Ligji për Barazi Gjinore, por Ligji për Drejtësi Gjinore, dhe shpjegova se ne nuk duam që gratë dhe burrat të jenë të barabartë, sepse biologjikisht nuk jemi të barabartë, por të kemi të drejta të barabarta. Për mua këto nuk janë terme të ndryshme, por barazia është destinacioni përfundimtar. Ne duhet të arrijmë te barazia përmes rrugëve përmes të cilave do të kemi të drejta të barabarta, e ne jemi ende larg. Burrat e kanë vendin e tyre dhe duan ta ruajnë atë, dhe ne nuk i detyrojmë gratë që ta zënë vendin e burrave, por ato duhet ta gjejë vendin e tyre.

***

Para disa vitesh. Më bie telefoni dhe më thotë, unë jam Naumi, jam baba dhe dua të kujdesem për fëmijët njësoj, por Qendra për Punë Sociale dhe gjykata ia dha fëmijët nënës, dhe ajo e shfrytëzon çdo moment, kurse unë nuk mund t’i shoh fëmijët. E ftova të vinte në zyrën time, pasdite rreth orës 18:00, e ftova edhe presidenten e nënave vetushqyese, Biljana Straneshiq, e ftova edhe presidenten e prindërve të vetëm, Doroti Paçkovska, dhe pastaj u ulëm dhe biseduam. Ato i thanë të gjitha, e unë dëgjoja. Dhe unë mora vendim, edhe pse jam aktivist dhe e para ndër të barabartat për të drejtat e gruas, e mbështes edhe këtë lëvizje të zotërisë që e shtjelloi qëndrimin e tij në detaje. Ata u mblodhën dhe krijuan një shoqatë të baballarëve dhe mbajtën një kuvend, ku e prezantova qëndrimin tim. Por, organizatat e grave u zemëruan me mua dhe ma zunë për të madhe, pasi ato, ndoshta, kanë vetëm pikëpamje egoiste ose të njëanshme të gjërave. Më pas të njëjtën gjë e thashë në një seancë të Kuvendit, dhe online në një konferencë në Novi Sad, sepse jam e bindur se kur të dy partnerët kishin dashurinë për të krijuar fëmijë, e edhe atëherë kur më nuk ka dashuri dhe mirëkuptim mes tyre, fëmijët janë dhe do të mbeten të përbashkët, dhe për këtë arsye mendoj se fëmijët nuk duhet të traumatizohen dhe duhet gjetur zgjidhja më e mirë për ta.

Për fëmijët zakonisht i jepet prioritet nënës për shkak të përkujdesjes amtare, por gjithashtu e kam mbështetur edhe lëvizjen e baballarëve në Maqedoni. Ata, pas divorcit të martesës, duan trajtim të barabartë me nënat në kujdesin e fëmijëve dhe kjo është plotësisht e drejtë. Nëse më pyesni se çfarë pres dhe çfarë shoh, jam e zhgënjyer, gratë e reja 35 dhe 40 vjeçe më shumë vijnë tek unë për të kapur lidhje, që të shkoj dhe t'ua regjistroj fëmijën e tyre në kopsht. Por, kjo nuk është zgjidhje. Kur u propozoj ministrive si të arrihet barazia gjinore, sugjeroj që të mos u japin para grave individualisht, por t'i subvencionojnë shërbimet për të gjithë. Shërbimet për kopshte, shërbimet për kujdesin e të moshuarve, shërbimet për larje dhe pastrim, dhe për ushqimet e gatshme, por kjo të subvencionohet që një familje mesatare ta paguajë dhe ta shfrytëzojë. Duhet të subvencionohet, sepse mendoj se kemi pasur martesa të lumtura në socializëm për shkak të gjendjes së përgjithshme të rregulluar, sepse kishte kopshte dhe mund ta regjistroja fëmijën ku të doja, e merrja rrogën më datën 1 të muajit dhe nuk kisha shqetësime.

Socializmi ishte i mirë për gratë

Në socializëm, gratë ishin më të barabarta. Së pari, kishte rregullore se sa gra duhet të ketë në çdo organ vendimmarrës. Së dyti, të gjithë merrnin rrogë, ishin të pavarur dhe kishte kujdes për çdo grua dhe çdo fëmijë.

Unë linda në luftë, fillova të jetoj në socializëm dhe, kushtimisht, dola në pension në socializëm. Dhe hyra në epokën e re, në vitin 1991 si një pensioniste, tashmë e realizuar në jetë, me fëmijë të martuar.

Në socializëm, kur punoja në fonderinë "Zhelezarnica" nuk isha anëtare në parti, por isha e vetmja grua në nivel të fonderisë në sindikatë, e isha edhe në këshillin e punëtorëve. Por, ky ishte trajnimi im dhe kjo është arsyeja pse kjo degë është shumë afërt për mua, prandaj këtu angazhohem dhe këtu ndihem më e lirë të veproj dhe mendoj se kemi rezultate të shkëlqyera, ndonëse për momentin ndoshta të paplota. Por, në rregull. Nuk është e natyrshme, nuk është normale, duhet të ketë forca negative.

E tani do të thosha që kam vazhdimisht një përqindje të caktuar të grave, nga një fushë e caktuar, që janë kundër meje, për shkak të perceptimit të tyre të ndryshëm. E për sa i përket burrave, nuk kam burra për kundërshtarë. Gratë janë kundërshtaret më të mëdha të grave.

Le të themi, në vitin 1991, kundërshtaret tona të para ishin gratë - partizanet, sepse mendonin se organizatat joqeveritare janë kundër shtetit. Mosdija, botëkuptimi i ngushtë ishte motivi për këtë. Ato nuk vepronin kundër, sepse në atë kohë ne ishim të regjistruar si organizatë joqeveritare në SPB - Sekretariatin e Punëve të Brendshme, por megjithatë mendonin se do të punonim kundër shtetit.

Ndoshta jeta e mëparshme në atë sistem më mësoi të jem e hapur, sepse në atë kohë, në sindikata, në këshillat e punëtorëve, diskutonim hapur për të drejtat - të këtilla, të atilla. Në fonderinë "Zhelezarnica" kishte 13 mijë të punësuar, kishim seksione për ekologji, pastaj kishim seksione për biokimi, pastaj për situata krize, nëse ka zjarr... thjesht për gjithçka.

***

Ju tregova se prej çfarë familjesh vijmë. As unë, as burri im, nuk kemi asnjë pëllëmbë tokë, as që na ka dhënë njeri. Por, ne e dinim se me datë 1 të muajit do ta merrnin rrogën. Çdo tre vjet i kam ndërruar mobiliet, dhe kam dhënë të vjetrat për t'u shitur.

Me kredi, jo me para të gatshme. Do të merrja kredi, në "Zhelezarnicë" menjëherë ma vulosnin kërkesën, do të ma hiqnin këstin e kredisë nga rroga, dhe pas tre vitesh do të blija të reja.

Unë dhe fëmijët e mi dhe fëmijët e fëmijëve të mi, e dini ku është ndryshimi? Fëmijët e mi shkonin tre herë në vit për pushime verore, dy herë për pushime dimërore, u blinim ski dhe këpucë, jo më të mëdha që t'i mbajnë edhe vitin e ardhshëm, do t'i blinim të jenë tamam për sivjet, e vitin tjetër blinim të reja, e të vjetrat do t'ia jepnim një fëmije tjetër, i cili është i afërm. Jo fëmijëve të varfër, sepse nuk kishte të varfër... Po edhe do të merrnim nga të tjerët, nëse duhej.

Shoqërimet

Sot ka përcaktime të tjera dhe profesione të tjera mes vetë popullatës së re. Ne shoqëroheshim me kushërinjtë tanë. Nëna ime, kur më dërgonte në Tetovë, nuk brengosej se a do t'i pengoja familjes së xhaxhait, e xhaxhai dhe xhaxhesha ime nuk ngurronin që t'i linin fëmijët e tyre mua për të luajtur dhe për t'u zbavitur. Dhe kjo afërsi është ende e pranishme, edhe sot. Edhe sot e kësaj dite, kushërinjtë e mi më thërrasin "Dada Save". Këto janë marrëdhënie të forta familjare dashurie, bashkimi dhe respekti...

Dhe e gjitha kjo falë atij mendimi pozitiv në familjen time nga Velesi. E tani prindërit fëmijës ia japin celularin në dorë, ku e ka edhe lojën për ta luajtur dhe kaq. Më vjen shumë keq dhe nuk e di nëse do të kthehet ajo kohë, sepse sipas meje, pasuria, emocioni, dashuria, aq sa e ke në vete, aq edhe mund ta japësh. E kjo nuk krijohet artificialisht. Thjesht, ashtu është, ndërtohet dhe hyn në gjak dhe në tru.

Fillimet e organizatës

Para transicionit kam qenë kryetare e grave në Komunën e Karposhit, e cila përfshinte zonën nga Komunat Qendër e deri në Tetovë. Ne gratë mblidheshim në godinën e Partisë Socialiste, ku tani paguaj qira. Atë e kemi ndërtuar ne, me paratë e mia që kam punuar në fonderinë "Zhelezarnica". Mirëpo, në atë kohë, arrita që katër vjet të qëndrojmë pa qira, derisa partitë nuk i ndanë ndërtesat.

Në atë kohë, persona kyç ishin presidenti Kiro Gligorov dhe kryeministri Branko Cërvenkovski, ata më dhanë një barakë në Kapishtec, ku tani është shkolla "Kiro Gligorov". Barakën aty e ndanim me manifestimin "Vera e Shkupit", e më pas kur ata morën hapësirën e tyre, ne mbetëm vetëm në barakë, por pastaj e rrënuan për ta ndërtuar shkollën, dhe ne nuk arritëm të merrnim hapësirë tjetër. Por, edhe gjesti i Qeverisë dhe

dhe i kryetarit Todoroviq për të na dhënë një barakë, edhe ky është një lloj projekti.

***

Kur filloi transicioni, një ditë po pastroja sirtarët në shtëpi dhe gjeta 21 llogari kursimi me para. Kurrë nuk kam pasur krizë për para. Pastaj erdhën çeqet, nga 1.200 denarë.

Në atë kohë filloi kriza në Bosnje dhe me ato çeqe i mbulonim shpenzimet e grave refugjate që erdhën këtu, e të cilat ne i pranuam. Unë si drejtuese e organizatës, nuk e dija se çfarë është projekti, e dija fjalën projekt "për ura dhe për fabrika". Dhe kur shkova në Veronë, në konferencën e parë të paqes, deri në Zagreb me avion (aty na priste një kombi dhe erdhën edhe disa aktivistë të tjerë nga Zagrebi dhe Lubjana), njëra prej tyre, Nela, më pyeti nëse kishim ndonjë projekt. Unë heshta dhe nuk i thash gjë, nuk e dija se çfarë ishte kjo, por tani nga kjo distancë kohore nuk them që nuk kishim projekte, por nuk e dinim që i kishim.

Kam udhëtuar me aeroplanët e Paler pa paguar biletë, e kur na u desh të udhëtonim në Bosnje dhe Hercegovinë për një takim ndërkombëtar në Sarajevë, mblodha një autobus me gra dhe i kërkova drejtorit tim të atëhershëm në fonderi "Zhelezarnica", Minço Jordanov, që të më jepte një autobus. Minço më dha një autobus, para për karburant, dy shoferë dhe mëditje për shoferët. Kështu që të gjithë shkuam në Sarajevë, dhe atje dikush na priste dhe na dha ushqim, ja ky ishte një projekt, por unë nuk e dija që ishte projekt.

Lobimi

Disa gra, të cilat janë jashtëzakonisht cilësore dhe të afta, dinë të thonë "Po pse të punoj në organizatë kur nuk kam asnjë problem me të drejtat e mia". Çfarë bëj unë për gratë? Shkoj nëpër fshatra, mbledh gra dhe u them: "Hajde tani, çfarë të drejtash keni, apo çfarë problemesh keni, hajde të gjitha tregoni nga dhjetë probleme, e pastaj nga të gjitha këto dhjetë, zgjidhni pesë, shkruani dhe shkoni te kryetari i komunës, dhe avokoni dhe loboni që t'ua përmbushin". Pra, kjo është kyçe, praktikisht. Nuk mundet, nëse nuk e vëren dhe nuk shkon ta kërkosh, të mendosh se do të përmbushet vetvetiu. Nuk ka turp. Vetëm guxim dhe do t'i arrijnë qëllimet e tyre. Sa herë që më pyesnin a mund të bëhet një grua presidente e vendit, unë u them "Po!", por nuk mendoj për veten time. Kur më pyesin "A ka?", unë menjëherë u them se cila mundet, e me siguri ka edhe të tjera, që unë nuk i di. Por, duhen krijuar kushte, duhen dhënë mundësi që dhe vetë gratë të ndjejnë se munden, të mos kenë frikë, e patriarkati ende po i "vret" nënat, vjehrrat, fqinjet, të afërmet, shoqet, të gjitha ato nëna të reja. A e dini sa pushim lehonie kam shfrytëzuar? Vetëm 105 ditë. Djali im tani është një metër e nëntëdhjetë centimetra, e mua nuk më ka munguar asgjë, por kishte kushte.

Do të thotë, në atë kohë as që duhej ta linit fëmijën. Tani ne shkojmë në takime me gra biznesmene dhe me kompani të huaja, dhe ata shpesh mburren se sa gra janë të punësuara, sa rrogë marrin. Në rregull është gjithë ajo, e pranoj, por edhe i pyes: "A ju ka bërë kompania një dhomë për t'i sjellë fëmijët tuaj këtu? A ju ka bërë një kopsht fëmijësh? Kush ua ruan fëmijët tuaj? Epo, fabrika ime bëri një kopsht në kohën time, në ish-Jugosllavi".

Kur flasim me ministren e punës dhe politikës sociale (e cila u largua nga radhët tona), i sugjerova - kopshtet private me nga 12 e 15 mijë, pse nuk i subvenciononi? Numri më i madh, të mos them 100% janë pronare gra, së pari do t'i mbështesni gratë, së dyti do t'i mbështesni edhe më shumë për t'u realizuar në karrierën e tyre, së treti duam t'i heqim stereotipet dhe rolin patriarkal të gruas, që të mos ketë justifikime të tilla si, gruaja donte të rrinte në shtëpi tre vjet. Do të rijë, sepse nuk do të ketë kujt t'ia lë fëmijën, e kur t'i krijoni kushtet, do të shkojë në punë dhe do të dojë të përparojë në profesion.

Nuk e them këtë që të mos më etiketojnë. Kur them që ne gratë duhet t'i lexojmë vetë ligjet, duhet vetë t'i vëmë në funksion, mendoj se kjo është mënyra e vetme. Ja një shembull - punëtoret në Shtip, ku kemi fabrikat më të madhe të tekstilit në vend, janë pronare gra. A ankohen gratë punëtore në industrinë e tekstilit? Ankohen. Kush duhet të flasë? Ligjet janë në funksion të gruas, prandaj vetëm nëse i njohim ligjet dhe nëse dimë si t'i zbatojmë ato dhe të jemi solidarë, do të kemi efekt.

Para shumë vitesh morëm 100 makina për qepje nga qeveria japoneze, ato i morëm në fillim, e kur e panë që ishim cilësorë dhe të mirë, na dhanë edhe 100 të reja, por meqë nuk kishim ku t'i vendosnim, në Klubin e Pensionistëve, ku ishin hapësira të mëdha, m'i dhanë bodrumet, me atë që ne do t'i rinovonim dhe nuk do të paguanim qira.

Në rrjetin tonë kemi shoqatën Gratë e moshës së tretë. I sugjerova kryetares së grave të moshës së tretë ta nënshkruajë kontratën, i tillë është rrjeti ynë, nuk ka hierarki.

Kur erdhi koha për tjetërsimin e makinave, njerëz nga Shtipi vinin për të më lutur që të punojmë së bashku. U thashë jo, nuk do t'i keqpërdori gratë, dhe makinat ia dhashë një butiku, njërit, tjetrit, por nuk bëra fabrikë tekstili për gra.

Kështu që, ajo që dua të them është se, është më se e qartë se edhe gratë me diploma master dhe doktoraturë, të cilat janë jashtëzakonisht cilësore, nuk i kanë kushtet për t'u shprehur dhe për t'u bërë cilësore në pozicionet e tyre, sepse kushtet nuk e lejojnë këtë.

Pastaj, tani flitet për ulje të natalitetit, do t'i marr të dhënat e mia personale, nipi im është 32 vjeç, i pamartuar, mbesa ime është 27 vjeç, e pamartuar, dy të tjerat janë në vitin e tretë të fakultetit, të gjithë kanë të dashur, nuk janë vetëm, por askush nuk është i martuar dhe askush nuk ka fëmijë.

Nataliteti po bie.

Domethënë këtu e kam fjalën, nëse e kthejmë nevojën e shoqërisë në rolin e asaj për të cilën unë dhe shoqata ime angazhohemi, (sepse në rrjet kemi organizata të grave nga të gjitha zonat urbane dhe rurale që kanë të njëjtën kauzë), nëse nuk krijojmë kushte për tejkalimin e rolit patriarkal, humbet pozita e gruas.

Le të krijojmë kushte për ta, ashtu siç ata që ishin para nesh krijuan kushte për ne. Kishim rrogë të sigurt, punësim të sigurt, kopshte, nuk kishim banesat tona, por askush nuk ishte i pastrehë dhe nuk kishte krizë. Jo se s'kishte dallime, por në atë kohë dihej se cili ishte rendi për të gjithë. Tani kush mund t'i thotë privatit sa të punësojë kur privati vetë disponon me kapitalin e tij. Bëj krahasim.

Unë kam lindur në mes të Luftës së Dytë Botërore. Në atë kohë ndërtohej socializmi. U rrita, u bëra e re, u punësova, u martova, krijova familje, i bëmë dy fëmijë, i shkolluam, i edukuam. Thjesht përfundova dhe arrita me sukses gjithçka deri në vitin 1990, dhe hyra në transicion si një pensioniste e lumtur, sepse sistemi në atë kohë kujdesej për njeriun. Kur vendi hyri në transicion, fabrika ime e bleu stazhin e nevojshëm për mua prej 2-3 vjetësh. Kjo do të thotë se siç isha e pavarur dhe në gjendej të qëndrueshme gjatë socializmit, ashtu hyra, e qëndrueshme dhe e pavarur, në transicion.

Në vitin 1991 u themeluan organizatat e shoqërisë civile, ndër të parat në qytetin e Shkupit, dhe për shkak të aktivitetit tim në ato bashkësi lokale dhe komunale, dikush më propozoi, ndoshta duke parë se mund ta bëja. Pa e ditur, ne vetë e kemi ndjerë për detyrim, për përgjegjësi, për humanitet. E pranova postin e kryetares së asaj organizate lokale të grave të Qytetit të Shkupit dhe komunave të tij, që ishte pothuajse gjysma e Maqedonisë. E pranova si obligim, duke mos e ditur se çfarë duhej të ndodhte, por duke qenë se kontaktet me shumë njerëz të atij shteti të dikurshëm të përbashkët vazhduan me telefona fiks, me kontakte, me ardhje, me vajtje, i realizuam të gjitha planet e parapara.

Së pari, më 28 shkurt të vitit 1991, e themeluam organizatën, kurse në korrik mora një ftesë nga “Gratë në të Zeza” për punëtorinë e tyre të parë në Ribarsko. Me vete mora shumë gra nga këtu, duke menduar se do të shkonim në punëtori dhe se do të punojmë diçka, nuk më vjen turp ta them këtë, në të njëjtën kohë u rregulluam dhe kishim veshur marrë kostume, sepse mendonim se megjithatë do të kishte ndonjë konferencë. Dhe kur shkuam në ishullin Ribarsko dhe kur u ulëm në plazh për të ndarë përvojat, se si e ndjej unë transicionin, fillova të kuptoja se diçka e re po krijohej.

Dhe kjo është arsyeja pse unë gjithmonë them se në konotacionin politik të ndërtimit të grave, mësuesja ime është mësuesja Sonja Lokar nga Sllovenia, e për të drejtat e grave, Stasha nga “Gratë në të Zeza”, dhe nuk kalon viti që ato të mos kenë ndonjë takim, e ne të mos marrim pjesë.

Kur mundem, shkoj unë, por kurrë nuk shkoj vetëm për arsye se atje ka shumë për të mësuar, prandaj ftoj dhe marr me vete ndonjërën nga aktivistet nga cili do qoftë vend në Maqedoni, që të shohin se si bëhen punët, cili është stil i ri i punës... Atje takova shumë aktiviste të reja që punojnë në këtë fushë.

Në vitin 1991, kur u mbajtën zgjedhjet e para parlamentare në Maqedoninë e pavarur, unë e mbaja postin e kryetares së aktivit të atëhershëm të grave të Komunës së Karposhit. Lidhja Socialiste po shndërrohej në Partinë Socialiste.

Dhe Partia Socialiste në zgjedhje, në atë kohë ishin të përziera, sipas sistemit proporcional dhe të shumicës, më futi në listë në komunën time të Karposhit, pa më pyetur.

Por, fut edhe VMRO-DPMNE-ja, fut edhe LSDM-ja, e unë marr më shumë vota në atë listë se kandidati i LSDM-së. Në rrethin e dytë Partia Socialiste u bashkua me LSDM-në dhe Bllagoja sërish, pa më pyetur nëse dua apo heq dorë me më shumë vota se kandidati i LSDM-së, më lë anash dhe futi një burrë në LSDM. Nuk fitoi LSDM-ja dhe që atëherë, deri para pak kohe, LSDM-ja nuk fitoi në Karposh, përveç VMRO DPMNE-së.

Përsëri, për këtë “meritore” është pozita e gruas. Ata nuk kishin asgjë kundër meje, por nuk mund ta kuptonin se unë isha një kandidate e mirë, dhe si të tillë më njihte mjedisi. Në atë kohë Bllagoja më largoi, por atëherë nuk kam ditur për të drejtat, sepse nga koha e socializmit kam menduar se kjo duhet të jetë marrëveshje. Ata thjesht vendosën kështu, dhe unë nuk luftova më.

Prandaj edhe sot e kësaj dite, kur shpjegoj për fuqizimin politik të grave, u them - ne shkojmë me kuotë sepse duam ta tejkalojmë patriarkalin për sa i përket vendit dhe rolit të grave, por nëse ju jeni aktive, nuk ka parti që nuk do të ju angazhoj sepse partia gjithmonë dëshiron të fitojë, nuk sheh se a është grua apo burrë, ata i fusin burrat sepse mendojnë se burrat janë më të pranishëm në terren dhe se do të sjellin më shumë vota.

Unë ndërtoj politikë të grave

Me Illiën kemi momente pozitive. Kur shpërtheu konflikti në vitin 2001, ne arritëm t’i strehonim personat e zhvendosur në banesat kolektive dhe të blinim rrobalarëse që ata të mbijetonin. Atëherë Illia bleu 11 rrobalarëse.

Këtu dua të them këtë - kontakti me “Gratë në të Zeza” më bëri të kuptoj se mund të bëj aktivitete paqësore dhe t’i lidh njerëzit në interes të qytetarëve për paqe. Sepse ne në Maqedoni në atë kohë kishim aktivitete “Paqe në vend, paqe në botë” dhe së bashku me Vasill Tupurkovskin e kemi udhëhequr atë fushatë. Tupurkovski në atë kohë ishte i ri, bashkë me të ishte edhe i riu Shala nga Kosova. Të dy ishin të shquar.

Atëherë fillova edhe unë të ndërtoj aktivitete në atë plan. Sarajeva ishte e para që u godit nga lufta. Atëherë organizova një karvan. Erdhën nga Komiteti i Helsinkit nga Evropa në Shkup, i mblodhëm dhe së bashku me një grup nga Maqedonia shkuam në Sarajevë tek Alia Izetbegoviqi për të nënshkruar konventa.

Dhe më pas, kur u bë përsëri luftë, kuptova se përkundër aktiviteteve të tilla që po bënim, nëse politikanët kishin vendosur të bënin luftë, qytetarët nuk mund të ndihmonin dhe nuk mund të ndikonin në vendimet. Politika bën luftë ose paqe.

Prandaj, më vonë, 15 vjet pas tragjedisë së madhe, një autobus i plotë me gra nga Maqedonia, shkuam bashkërisht në Srebrenicë, ku iu përkulëm viktimave. Për fat të keq, atje vdiq një popullsi civile, pasi që, përsëri, ashtu vendosi politika.

Ndonjëherë u them edhe fëmijëve të mi në shtëpi, e po ashtu edhe kur flasim me aktivistet, se gjithmonë duhet të ndërtojmë ura bashkëpunimi, duhet të futemi sa më shumë në politikë. Ndonëse ato më pyesin “Pse nuk hyn në politikë?”, unë them që unë ndërtoj politikë, politikë vetëm të grave. Nuk hyj në parti sepse prapë se prapë nuk mund të ndikoj, e si politikane unë ndikoj në të gjitha ngjarjet politike. Ndihmoj, sepse kemi të njëjtin përcaktim politik - paqen.

Paqja është alternativa më e mirë në çdo shoqëri, pavarësisht se cilit ngjyrim politik dhe cilit besim i përkisni. E ne gjithmonë kemi qenë në këtë vijë.

Dorë e shtrirë në luftë

Kur shpërtheu lufta në Bosnje, gjëja e parë që ndihmuam ishin gratë kur zbritën nga avioni. Bëmë një listë dhe i pranuam. Në atë kohë, të gjitha kishim fuqi financiare, ende sundonte ajo fuqi nga socializmi. Në banesat tona strehuam gra me fëmijë dhe në supermarkete lamë nga një çek me vlerë 1.200 denarë, në mënyrë që gratë të blejnë lirisht gjithçka që u nevojitej. E po ashtu u dërgonim gjëra nga shtëpia, reçel, ajvar, gjithçka që kishim përgatitur dhe në atë mënyrë mbanim komunikimin, që ato të kërkonin më tej të drejtat e tyre dhe të lidheshin me njerëzit e tyre, për mbijetesë të mëtejshme dhe të shkonin atje ku duan.

Organizatat ndërkombëtare mbanin llogari se kush donte të shkonte në Amerikë, kush në Kanada, kush në vendet evropiane. Thjesht, kjo ishte për ato që nuk donin të kthe-heshin, por kishte edhe gra që mbetën në Sarajevë, dhe pastaj ne vendosëm një lidhje me ato gra dhe deri më sot ajo lidhje funksionon. Menuna Zvezdiq, e njohur më mirë si Nuna, është një nga aktivistet nga Sarajeva, e cila ka bashkëpunuar me ne që nga ajo kohë.

E me REKOM-in ka një histori tjetër. Për shkak të marrëdhënies sime me Nunën, me Sonja Biserkon, me Stashën, me të gjitha, e njoh mirë situatën dhe prej tyre kam mar-rë informacionin e saktë. Por, ato ishin të zgjedhura dhe të përzgjedhura, megjithëse nuk e di se kush i zgjodhi. Ne bashkëpunojmë në mënyrë të shkëlqyeshme, unë si njëra nga ndërtueset e para të paqes në Maqedoni dhe si një njeri i zakonshëm për të cilin paqja është më e rëndësishme.

Klubi 15.15

Në organizatën tonë numri më i madh i grave ishin të punësuara, përveç meje, e cila në atë kohë isha në pension, kështu që u morëm vesh që takimet tona të fillojnë në ora 15.15. Prandaj edhe e quajtëm Klubi 15 e 15. Të gjitha vendimet i morëm në sallë ad hoc. Ne nuk kemi shkruar strategji, nuk kemi shkruar programe afatgjata, por në socializëm kishte programe 10-vjeçare, pesëvjeçare dhe njëvjeçare dhe jemi ud-hëhequr nga kjo. Në atë kohë bënim plane ditë për ditë dhe menjëherë reaguam dhe u organizuam.

Do t'ju zbuloj edhe një ngjarje interesante. Një herë një zotëri me të cilin komunikojmë edhe sot e kësaj dite, punëtor i Kuvendit, më pyeti: "A mund të vij edhe unë në Sara-jevë?". Erdhi dhe na incizonte gjatë gjithë kohës, unë e kisha të qartë se e interesonte vetëm siguria, kur na duhej diku ai do të paraqitej. Ne atëherë shkonim me njerëz të panjohur, nëpër Sarajevë, edhe sot e kësaj dite nuk e di se kush ishin, madje edhe aktorja Vanessa Redgrave erdhi në atë kohë, e njeriu vetëm incizonte.

Mirëpo, mua më lidhte ideja se duam të bëjmë mirë që të mos ketë luftë në Sarajevë. Nuk e di sa kemi kontribuar për këtë, sepse pavarësisht se kemi shkuar te Izetbegov-iqi, edhe pse nuk e di se sa herë kam nënshkruar, megjithatë lufta filloi. Mbaheshim dorë për dore, me gra nga të tre konfesionet - ortodokse - katolike dhe myslimane, dhe kështu të kapura me njëra tjetrën i rrethuam tempujt katolik, islamë dhe ortodoksë, por

përsëri u bë luftë, e populli vuante.

Këtu, përveç që i mblodhëm gratë derisa po vazhdonte lufta, bëmë apel për ndihma humanitare. Në Komunën Qendër u thashë të gjithëve të sjellin fasule të lidhura veçmas dhe oriz të lidhur veçmas, kur ta marrin si pako, familja mund t'i gatuajë ato.

A dinë njerëzit për humanizëm? Dinë, por kanë nevojë për dikë që t'i organizojë. Njerëzit sillnin kamionë me ndihma. I mbushëm kamionët me ndihma të tilla nga populli, një qese me fasule, një qese me oriz, çdokush solli atë që pati... Kjo është njerëzore. Kjo është humanizëm! Dhe nuk mund të them që Shkupi nuk ka njerëz humanë, fakti që atmosfera tani është e tillë, këto janë vetëm momente. Por, në çdo kohë duhet të dini se si të ofroni ndihmë. Nëse dikush ka nevojë për ndihmë dhe nëse tani paraqitet kjo, njerëzit përsëri do të ndihmojnë.

SOS

Kur e hapëm linjën SOS, thashë se do të ketë gjashtë operatorë - dy në maqedonisht, dy në shqip dhe dy në gjuhën rome. Një nga operatoret shqiptare është me shami. Më pas kur postuam një fotografi të përbashkët në Facebook, lexova një koment në rrjetin social “Ekipi me vetëm një arnaute”. Vini re shprehjen, Arnaute. Ose kur shkruajnë Gjupe. Tani a duhet te zihem unë me atë që komentoi? Jo. Ai person nuk është faktor për mua. Por gazetarët janë faktor, faktor janë politikanët, ata duhet të reagojnë.

***

T’i kthehem vitit 1999 dhe kur dëgjova në televizor se kishte gra shtatzëna që qëndronin në kufi, çfarë mendoni se bëra? Telefonova disa prej grave tona dhe shkuam dhe i morëm. Atë natë erdha në shtëpi. Të nesërmen, e shoh burrin tim duke qarë këtu në oborr, ai zyrën e kishte këtu në shtëpi. Ai ishte një njeri shumë sentimental dhe i mirë, por nuk e kam kurrë të qante, bile edhe kur i vdiq babai. “Aco, çfarë është problemi?” “Shoku im Isa më tha se ka ardhur këtu në kamp me gjithë familjen, me fëmijët, me gruan. Ti nuk e di sa i mirë është ai njeri, tani ai ishte në kampin e Stenkovecit.” Unë i them: “Mos u shqetëso dhe mos qaj, unë do të shkoj tani dhe do t’i marr”. E ndez veturën dhe normalisht, me emrin Savka Todorovska, hyj në Stenkovec shkoj i gjej, ata dhe fëmijët, i mbledh dhe i çoj dokumentet në Kryqin e Kuq, pasi që e kam të lehtë t’i nxjerr. Ata thonë se nuk kanë nevojë për strehim, kanë teze këtu, duan vetëm të dalin prej atje. E pastaj, çfarë bëj unë? E kërkoj Igballen. Igballja ishte përgjegjëse për të vendosur se kush do të shkonte në tenda.

Me Igballen morëm leje nga Ministri i Punës dhe Politikës Sociale se mund t’i nxjerr të gjithë ata kur të donin të bënin dush, t’i dërgoja në shtëpi me autobus dhe t’i ktheja nën përgjegjësinë time. Kjo është ajo që kemi bërë.

Nuk bëhet kjo me diplomë vetvetiu, kjo bëhet vetëm me mendje të shëndoshë dhe me shpirt të shëndoshë, por jo të korruptuar nga politikanët.

Gjykata e grave

Në atë kohë, si aktiviste vinte edhe Vjosa Dobruna. Ajo punonte gjoja me gra të keqtrajtuara seksualisht, mirëpo unë nuk takova ndonjë grua të tillë. Me Vjosën shkova edhe në Tetovë, ku hapën qendra për kujdesin e grave. Bindja ime personale është se kjo nuk ishte gjithmonë e vërtetë. Pastaj me “Gratë në të Zeza” shkova në Gjykatën e grave, kam fjetur në të njëjtën dhomë me një grua nga Bosnja e cila ishte keqtrajtuar seksualisht. Thotë: “Unë jam kroate, por jam e martuar me një serb, dhe jam përdhunuar edhe nga serbët edhe nga kroatët. Fillimisht nga kroatët sepse jam serbe, pastaj nga serbët sepse jam e martuar me një kroat”.

Kur ishim bashkë në Pekin, flinim në një dhomë me Vjosën, në të njëjtin apartament. Ajo më thoshte çdo mëngjes: “Savçe do të bëhesh e jona”. Ajo është e re, më e re se unë, ajo kishte qenë eksperienca e saj e parë e madhe profesionale, ajo nuk ka aq përvojë jete sa unë, nuk e pyeta, e as që e kam pyetur deri më sot se çfarë donte të thoshte me këtë. Por, një njeri i tillë nuk mund të jetë humanist. Një njeri i tillë nuk mund të jetë krijues i paqes. E di meqë gjatë këtyre viteve nuk jam ulur në shtëpi. Kam shkuar kudo që më kanë thënë, si brenda edhe jashtë vendit, por asnjëherë nuk e kam tradhtuar misionin tim për gruan, nuk i kam bërë dëm askujt, as me fjalë bile, askujt nuk i kam thënë se do të jesh as jona, e imja, e jotja. Vjosa është politikane, unë gjithmonë kam një pikëpyetje për politikanët, për të vërtetën që e thonë.

Për dallim nga kjo, “Gratë në të Zeza”, ku janë Stasha dhe gratë e saja, le të themi, ai rrethi ku sillemi ne, atyre u besoj. Ne kemi punuar me gratë dhe fëmijët që ishin të vendosur nëpër familje, me të afërmit e tyre këtu në Shkup, dhe i kemi bashkuar, që të mos shpërndahen, të mos humbasin identitetin e tyre, këtu i kemi mbledhur, kemi bërë manxhë, kemi bërë çaj, qepnim, thurnim së bashku. E kemi bërë këtë me Betin, por nuk kam takuar gra të tilla që janë keqtrajtuar seksualisht.

Konflikti

Në mars të vitit 2001 kthehem nga Nju Jorku, ku për shkak të diferencës kohore nuk kisha dëgjuar se kishte ndodhur njëfarë konflikti në vend. Vij në shtëpi të dielën, e çdo të diel, që kur u martuan djali dhe vajza ime, i mbledh fëmijët për drekë familjare. Mblidhemi për drekë, nuk ka celularë, bie telefoni fiks në korridor, dhe më thonë - po të kërkojnë nga zyra e kryetarit të shtetit, që atëherë ishte Boris Trajkovski. Më thërret presidenti personalisht: “Nuk e di a e dini se kemi kështu e kështu problem në vend”.

Unë i them: “President, sapo jam kthyer nga Amerika, nuk kam dëgjuar asgjë dhe nuk di asgjë”. Ne, thotë, po të thërrasim ty, nga Tanushevci, janë larguar të gjitha gratë me gjithë fëmijët, nuk e dimë ku janë, ju lutemi na ndihmoni.

Dhe çfarë bëj unë, telefonoj në Kumanovë, kam atje një organizatë të grave shqiptare, kam një rome, turke, maqedonase dhe serbe, dhe të gjithave u paraqitem me telefon. Të dielën, pasdite, në orën 14, të gjithat i marr në telefon dhe më thonë “Na jep gjysmë ore”.

Nuk kanë kaluar 15 minuta, më thërrasin... I gjetëm. Do të na pranojnë! I telefonoj presidentit dhe i tregoj. Kishim pako, në to një batanije të vogël, një termometër, plus disa gjëra të nevojshme, kështu që e pyeta Rifatin, kujdestarin e ndërtesës ku është zyra jonë, që ta sjellë. - Do të vij menjëherë tha, Rifati tashmë e dinte situatën. I dërgova te gratë nga Tanushevci me fëmijët, ato ishin të vendosur në Çegran. Dhe bashkë me kryetaren e organizatës shqiptare, të asaj serbe, shkuam me pakot. Dhe më çoi burri në mes të fshatit Çegran, më futën aty ku ishin të gjitha gra, të gjitha në tokë të shtrira, në sfungjerë, fëmijët tashmë të ftohur dhe me temperaturë. Unë ua jap pakot, bëmë fotografi, na falënderuan me besim në mua. I telefonoj presidentit. “Shkoni dhe mos u shqetësoni”, na tha presidenti. E di që kanë dërguar njerëz për të na ruajtur, siguria e garantuar. E tani në kohën e sotme, askush nuk merr një përgjegjësi të tillë për të bërë diçka për të tjerët pa pritur që ajo t’i kthehet.

Jo vetëm në Tanushevc dhe Çegran, kur ikën edhe Neproshten, edhe ata i prita me pako në lagjen Gjorçe Petrov. Edhe ata i akomoduam, të njëjtën gjë e bëmë edhe për ta. Ata ishin maqedonas nga Neproshteni dhe Leshka, e gruaja nga Neproshteni tha haptazi edhe para gjykatës së grave, citoj: “Erdhën tek na dhe u dhanë burrave armë që të ikim, para kësaj askush nuk na dëbonte”, por asnjë parti politike nuk doli ta thotë këtë. Pas gjithë kësaj, populli nuk dëshiron të ketë konflikt në vendin e tij dhe nuk është çudi që kishte që ishin kundër Marrëveshjes Kornizë.

Bashkimi

Ne kemi nevojë për bashkim, jo për platformë. Unë, edhe kur flasin për rrjetëzimin, nuk jam plotësisht e kënaqur me të. Edhe pse e kam bërë rrjetin e parë në vitin ’94, nga ideja deri në rrjetëzim. Çfarë do të thotë rrjetëzimi? Hajde puno, bën diçka, njerëzit njihen nga veprat e tyre, e jo vetëm do të ndërtojmë platforma, e asgjë të mos kryhet.

Ju falënderoj sinqerisht, që megjithatë dëshironi ta dëgjoni historinë time nga dora e parë. Ta tregoj ndjenjën time, sepse mendoj se mund të mos më ketë mbetur shumë kohë për të jetuar. Ja le të jetoj sa nëna ime, 90 vjet, janë vetëm edhe 10 vjet të tjera. E çfarë janë 10 vite, kështu do të shkojnë, do të fluturojnë. Nuk mund të jem e kënaqur me të arriturat në përgjithësi, bëmë shumë, por mundet edhe më shumë. Përndryshe unë përkrah shumë gjëra, të gjithë më thërrasin në protesta, këtu, atje, nuk e fsheh që kur jam kundër një gjëje, shkoj si spektatore. Nuk fshihem, kam vendosmëri dhe e them atë që e mendoj.

Besimi

Ndodhi në vitin 2001, ishte e shtunë, kur i kisha mbledhur gratë kryetare nga qytetet e tjera dhe në orën 14 u nisën për të marrë autobusët për në qytetet e tjera, Kumanovë, Veles, Tetovë, Gostivar, Kavadar, Pehçevë... Mbeti vetëm një profesoreshë, psikologe dhe kolegia e zyrës. Kjo ishte në zyrën e vjetër, ku kishim edhe një televizor. Dhe befas e pashë në televizion rrugën për në Haraçinë. Shoh një furgon policie të ndalur dhe një automjet me njerëz, kalojnë me kuaj dhe i japin njëri-tjetrit diçka. Them: “Çfarë po ndodh këtu?”. Shkuam në vendngjarje, vozisja unë dhe e pyeta policinë, çfarë është kjo? Ata thonë se njerëzit po shpërngulen nga Haraçina. Dhe atëherë atyre u dhashë numrin e telefonit dhe u caktova një takim për të nesërmen në orën 10 në sallën tonë, që t’ua linim kontaktet dhe të mos humbnin njëri-tjetrin. E bëra këtë për ta, e në mesin e aktivisteve kishte gra shqiptare, rome, turke, maqedonase. Biseduam mes vete, çfarë kishin vënë re gratë shqiptare në mëngjes, çfarë ndodhi në të vërtetë? Pamë një burrë me një automatik që qëndronte në ndërtesën atje afër fqinjëve, thotë njëra, tjetra thotë. Unë jetoj në shtëpi, aq sa kemi burra në shtëpi, aq çanta shpine gjetëm me uniformë të UÇK-së dhe me armë... Më pas, çdo ditë në orën 13 ishim në shesh përballë një pëlhure ku shkruante “Ne jemi vullnetarë të paqes”. Këtë e bënim nën titullin “Mijëra biseda”.

Ajo që kemi bërë ne gratë nuk është bërë as nga politikanët apo njerëz të tjerë, këtë e kanë bërë edhe gratë shqiptare pavarësisht se kishin frikë nga liderët e tyre. E ne jo, ne nuk kishim frikë. Pastaj i shkruam letër Bodo Hombah-ut, i cili në atë kohë ishte

shefi i Paktit të Stabilitetit. Në shikim të parë ne jemi hallkë e parëndësishme, ndoshta po të kisha qenë më autoritare, ndoshta po të kisha qenë më e fuqishme, ndoshta po të kisha bashkëpunuar me njerëz të politikës, do të kishte pasur një efekt tjetër, por e këtë e bëmë qytetarisht, por shumë gra, edhe nga ana jonë edhe nga ana e tyre, dhanë gjithçka mundën si kontribut të tyre. Dhe më pas futa në organizatën tonë në një dhomë mësimin e gjuhës shqipe, diçka që nuk e bëri as shteti.

Pastaj, shkuam në BE ku unë bëra një propozim, pasi që në kohën time që në klasën e katërt kam mësuar gjuhën serbokroate, pse të mos mësojnë edhe fëmijët tanë shqip, kurse fëmijët shqiptarë të mësojnë maqedonishten letrare. Do të ishte e dobishme. Gratë e mia dhe të gjithë studentët që u regjistruan këtu për të mësuar gjuhën shqipe, të gjithë kaluan me notën më të lartë.

Dhuna

Tema është dhuna. Dhuna nuk njeh fe, por ne qëllimisht lamë mundësinë që të telefonojnë në më shumë gjuhë, në mënyrë që viktima të jetë më e lirë kur të telefonojë se dikush do ta kuptojë.

Mbrojtja e spitalit ushtarak

Edhe një gjë tjetër që ia vlen t'jua them - kur po shpërbëhej Jugosllavia, Spitali Ushtarak ishte i ushtrisë, i APJ-së. Unë atë të hënë e kisha takimin e rregullt në orën 15.15, e në orën 17 mbaja tribuna për masën e gjerë të popullit me tema të ndryshme, sociale, paqësore, ku mblidheshin nga 120 gra. Dhe më lajmërohen dhe më thonë se po i nxjerrin prizat ne Spitalin Ushtarak, dhe ne ashtu siç ishim të mbledhura, disa prej nesh, shkuam te dera e Spitalit Ushtarak për të bërë roje, e kërkova menjëherë Presidentin e vendit, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Shëndetësisë dhe të gjithë u bashkuan në ndërtesë. Shkova dhe u tregova. "Nga e dini ju?" më pyetën, "Verifikoni, u thashë, unë kam informacion". Ata verifikuan dhe u binden se ishte e vërtetë. Të nesërmen ishin ngritur në këmbë edhe Ministri i Mbrojtjes, edhe ai i Shëndetësisë, dhe i gjithë spitali, dhe unë kërkova të më pranonin në Shtabin e Përgjithshëm, e ata më thonë "Por, kjo është e Ushtrisë Jugosllave". Më falni, ajo ishte e ushtrisë dhe e popullit, sepse APJ do të thotë Armata Popullore e Jugosllavisë, por duhet t'i mbetet popullit.

Unë, me një ekip të tërë grash, me sheshirë në kokë, shkojmë atje. Në atë kohë, nëna ime nga Velesi ishte mysafire tek unë. Ajo ka lindur në vitin 1924 dhe ka parë luftë. Unë i tregova asaj, dhe ajo na mbështeti, tha se duhet të qëndroj në spital - t'i bind se ata mund t'i marrin armët, por se spitali është i popullit të Maqedonisë. E lanë dhe kështu mbeti. Pra, është bërë shumë, kemi bërë shumë.

Ne jemi organizatë joqeveritare, dhe do të them që nuk kemi qenë të mbështetur financiarisht.

Prandaj në takimin tonë, kur presidenti Stevo Pendarovski më pyeti "A u jep shteti para?", unë iu përgjigja: - Jo, asnjëherë nuk kemi marrë para nga shteti, edhe kur ka

qenë opozita, edhe kur ka qenë pozita, edhe kur ka qenë njëra parti, edhe kur ka qenë partia tjetër, vetëm nga Lotaria përmes MPPS-së, na e kanë mbështetur linjën tonë SOS... Nuk e kam të vështirë të punoj, sepse kudo që kam punuar, gjithmonë kam pasur rreth vetes gra të mira. Na gëzojnë sukseset dhe arritjet. Për shembull, do të marr rastin me rritjen e numrit të grave në Parlament, për të cilën gjë unë avokoj 100%. Në parlamentin e parë ishin vetëm 5 gra, ndërsa tani janë 45 gra. Po shkojmë drejt asaj që, dhe tashmë kemi dhënë iniciativën për të qenë 50-50%, edhe atë listat të jenë sipas sistemit zip, mashkull - femër, mashkull - femër...

Mbaj statistika dhe është dëshpërues fakti që në Parlament ka burra, që nuk kanë mbajtur asnjë fjalim, e gratë janë të shkëlqyeshme. Në asnjë mënyrë nuk mendoj se ka burra të këqij, sepse ka njerëz të mirë, cilësorë, të këqij dhe të pamoralshëm, pavarësisht se cilës gjini i përkasin, por unë angazhohem për barazinë gjinore edhe në strukturat vendimmarrëse, që të merren vendime të mirëfillta.

Kur futen në politikë, gratë nuk ndryshojnë nga burrat, por më vjen keq që nuk kemi ndryshime. Pres ndryshime nga gratë që do të hyjnë në strukturat vendimmarrëse, që të mund t'i sjellin ato ndryshime pozitive. Ose gratë gazetare, e njëjta storje, kjo është. Kjo është pakënaqësia ime në punën time, por nuk zhgënjehem që të mos vazhdoj të punoj në këtë plan. Vë re se me brezin e ri po bëhet më e vështirë, andaj duhet bërë ndonjë kthesë.

Bashkëpunimet

Mund të themi se që nga fillimi në vitin 1991, kur filluam të punojmë në planin e avancimit të grave në të gjitha strukturat dhe ndryshimit të statusit të grave në të gjitha nivelet, kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me organizatat e ngjashme të grave nga rajoni dhe nga hapësira e ish-Jugosllavisë. Thjesht sikur nuk jetojmë në vende të ndryshme, të gjithë kemi një ideologji dhe një qëllim, të gjithë e mbështesim njëritjetrin, të gjithë bashkëpunojmë, vlerësohemi shumë si organizatë dhe si shtet në këtë drejtim.

Madje bashkëpunojmë edhe me feministet e majta nga Greqia, me organizatat joqeveritare të grave nga Bullgaria, nga Rumania, të mos flas për ish-vendet e Jugosllavisë, Bosnja-Hercegovina, Serbia, Sllovenia, Kroacia, secila prej atyre organizatave, aty ku është më e fortë, aty edhe e jep kontributin e saj në ngritjen e kapaciteteve tona. Edhe me Kosovën kemi punuar një projekt ndërkufitar, kemi një bashkëpunim të shkëlqyeshëm me gratë refugjate.

Para do kohësh, shkova për të blerë ushqime e ca gjëra në shitore. Hyj me njërën nga koleget e mia, e hyjnë edhe dy zonja, njëra prej tyre, Beti. Ka ardhur për një dasmë dhe duhet të kthehet menjëherë me të afërmin e saj nga Prishtina, dhe nuk mund t'i ikësh, ky është fati, shkojmë për kafe, pimë, u ankuam nga pak, përndryshe jemi në komunikim të rregullt, si familjar, ashtu edhe miqësor. Këto janë thjesht marrëdhënie që nuk harrohen.

Ndonjëherë disa momente të këqija do t'ju bëjnë edhe më të afërt, kur viheni pa rezerva në pozicionin për të ndihmuar, për të bashkëpunuar.

Padrejtësinë, që i shpërngulën kur i kthyen, ua shëruam me dashuri dhe fjalë të mira. U kemi blerë rrobalarëse sepse do të duhej të laheshin në një legen, të përdornin një pastë dhëmbësh në moment, dhe tani i mësoni si të gjenden. Por, sheh një shembull nga Serbia, Bosnja dhe Hercegovina, dhe ua përcjell atë, kështu që edhe kjo ndihmon, edhe me to jemi bërë miq të mirë.

E kjo nuk është më, duhet të mundohemi ta mësojmë brezin e ri për këtë, që ata të fillojnë të kuptojnë, të investojnë, të besojnë në veten e tyre, të besojnë në vepra të mira, të mos shkojnë drejt asaj, ti më the diçka të keqe edhe unë do ta kthej me të keqe, dhe drejt asaj të më godet me njërën dorë, unë do të të godas me dy duart. Jo, por më thuaj çfarë të shqetëson, sepse vetëm kështu do të gjejmë zgjidhje.

Nju Jork, Nju Jork

Kam qenë edhe në Nju Jork, do gjej ku të fle në universitete për 5 dollarë në dyshek dhe do ta paguaj vetëm biletën e avionit. Kështu jemi mbështetur, duke u gjendur në situata të ndryshme, por ndoshta këtu ka një anë negative, që edukimi im nuk më lejon të shkoj te donatorët me projekte. Të shkoj në fabrikë dhe të kërkoj fonde, këtë nuk di ta bëj, e vetmja gjë që kam fituar më parë është nga Telekomi dhe A1 për linjën SOS falas. Por atje kam shkuar, i kam lutur, por nuk kam pasur turp të lus për një ndihmë të tillë. Mirëpo, të shkoj dhe t'u them "Më jepni kaq para", nuk e përballoj dot, sepse nëse biznesmeni m'i jep paratë, ato duhet t'i marrë nga punëtorët e tij.

Prandaj kam shumë mirënjohje për punën time, jam fituese e çmimit "13 Nëntori" të Shkupit, kartën më të lartë nga presidenti i shtetit, "Nënë Tereza" nga organizata "Nënë Tereza", mirënjohje nga SOS "Fshatrat e Fëmijëve", mirënjohje nga Shtëpia e Fëmijëve jetim "11 Tetori", e shumë të tjera.

Jugosllavia si fat

Sonja Biserko ka qenë një nga aktivistet më të rëndësishme kundër luftës në Beograd që nga fillimi i konfliktit në ish-Jugosllavi. Për shkak të veprimeve të saj, shpesh herë nga autoritetet nacionaliste quhej tradhtare, “autoshoviniste”, “serbe tjetër” dhe emra të ndryshëm nënçmues. Fatmirësisht, persekutimi i pushtetit nuk e lëkundi atë dhe ajo rezistoi në luftën e saj për të drejtat e të gjithë atyre që i persekutoi pushteti dhe që u persekutuan, pa dallim feje, kombësie apo orientimi seksual.

E rritur në një familje diplomatike jugosllave, ajo vetë e filloi karrierën e saj si diplomate praktikisht menjëherë pas përfundimit të studimeve, fillimisht në Londër e më pas në Gjenevë. Këto përvoja ndikuan në njohuritë e saj për marrëdhëniet ndërkombëtare, por edhe në kuptimin e nevojës që, nëse nuk ruhet Jugosllavia, të paktën të ndahet në mënyrë paqësore. Kur e kuptoi se lufta ishte e pashmangshme, bëri gjithçka për ta kundërshtuar atë dhe, së bashku me njerëz të tjerë vullnetmirë, ta ndalonte makinën gjakatare. Aktivizmi i saj paqësor është i njohur dhe ajo është aktive si paqebërëse në zona të tjera konflikti në botë.

Duke punuar për shumë vite si kryetare e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në Serbi, ajo ishte një zë që kundërshtoi narrativën mbizotëruese, jo vetëm me veprimet e saj, por edhe duke ndihmuar të gjithë ata që luftuan kundër urrejtjes dhe dhunës. Kjo është historia e saj.

Sonja Biserko

Fëmijëria dhe rinia

Unë kam lindur në Beograd në vitin 1948, prindërit e mi janë me origjinë nga Dalmacia. Në lëvizjen partizane u bashkuan kur ishin shumë të rinj, nën moshën 18 vjeç. Pra, ata i përkisnin atij trupi junior partizan, i cili erdhi në Beograd nëpërmjet Malit të Zi në vitin 1945. Pjesën më të madhe të shkollimit e kam kaluar në Beograd, përveç se kemi kaluar një periudhë prej katër vitesh si familje në Egjipt, ku kam mbaruar vitin e dytë të shkollës së mesme. Në Beograd u diplomova në Shkollën e Mesme të Pestë të Beogradit dhe më pas u regjistrova në Fakultetin Ekonomik.

Egjipti, gjegjësisht Kajro ishte sensacioni i parë i madh për ne, një takim me kultura të tjera, gjuhë, gjeografi, një takim me një qytetërim tjetër. Ne jetonim në Zamalek (një ishull në Nil). Mbaj mend kur mbërritëm në Kajro, natën vonë, rrugët ishin plot me njerëz, dyqanet ishin të hapura, ushqimoret ishin plot me fruta dhe perime të ndryshme që nuk i kishim parë më parë. Zhurmë, tinguj të ndryshëm, trafik i dendur. Impresionuese dhe konfuze. Isha 13 vjeçe por ende i mbaj mend ato erëra, ngjyra, tinguj... Kajro ishte një qytet kozmopolit ku jetonin komunitete të ndryshme fetare dhe etnike - greke, italiane, hebreje, palestineze, kopte...

Prindërit e mi besonin në Jugosllavi. Ata ishin entuziastë që u rritën dhe u maturuan me Jugosllavinë. Këtë e përcollën ata edhe te ne, fëmijët e tyre. Fëmijëria ime nuk dallon shumë nga fëmijëria e fëmijëve të tjerë, përveç se atëherë kishte më tepër siguri, jeta shoqërore dukej ndryshe. Ne ishim një familje jugosllave, një familje tipike socialiste e asaj kohe.

Besohej në përparim. Sidomos kur e ke parasysh nga ku filloi Jugosllavia në vitin 1945 dhe çfarë përparimi bëri gjatë njëzet viteve të para. Ndoshta modernizimi ishte shumë i shpejtë, por sigurisht që u arrit një hap i rëndësishëm në planin politik, ekonomik, kulturor dhe arsimor. Ishte një përparim i madh për shumicën e popullsisë. Kjo nuk do të thotë se nuk ka pasur padrejtësi, politika të gabuara e të ngjashme, por e kam fjalën për përparim të përgjithshëm. Sigurisht që problemet erdhën më vonë, sepse nuk kishte gatishmëri për reforma më serioze.

Beogradi ishte një qytet dinamik nga vitet gjashtëdhjetë deri në vitet tetëdhjetë. Ai shndërrohej në një kryeqytet të vërtetë dhe roli ndërkombëtar i Jugosllavisë brenda shteteve të painkuadruara i dha asaj një dimension të veçantë ndërkombëtar. Gjithashtu u profilizua si një qendër e rëndësishme kulturore që me kalimin e kohës u bë ndërkombëtarisht e rëndësishme (FEST, BITEF, BEMUS, festivale të tjera të shumta). Jugosllavia po hapej gjithnjë e më shumë ndaj botës. Kjo në veçanti u reflektua në jetën kulturore - nëpër programe të kinemasë, nëpër libra që përkitheheshin, nëpër paraqitje të ndryshme si të ftuar, ekspozita. Kjo hapje me kalimin e kohës vetëm rritej. Jugosllavët udhëtonin, dhe shumë shkuan për të punuar jashtë vendit, kryesisht në Gjermani. Qendra kulturore amerikane në Knez Mihailovë (e cila u dogj gjatë ndërhyrjes së NATO-s dhe nuk u rindërtua kurrë) ishte një lloj qendre grumbullimi - libra, pllaka, revista - ishte një pamje në botën perëndimore. Bursat Fulbright i kanë mundësuar komunitetit akademik të angazhohet në rrjedhat shkencore ndërkombëtare.

Jugosllavia ishte objekt i shumë seminareve dhe konferencave ndërkombëtare si një model i mundshëm zhvillimi. Në atë kohë, e majta evropiane dhe amerikane e shihnin veçanërisht Jugosllavinë si frymëzim. Madje, shumëkush e mbështeti Millosheviqin për një kohë, sepse besonin se ai po luftonte për mbijetesën e Jugosllavisë.

Lëvizja globale studentore, mbi të gjitha ajo e Parisit, u përhap edhe në qendrat jugosllave. Unë nuk isha në epiqendrën e asaj lëvizjeje, isha më shumë në margjina. Unë isha atëherë në vitin e dytë të fakultetit. Njihja shumë që ishin aktivë në atë lëvizje. Ishte një pasqyrim i asaj që po ndodhte në Paris dhe qendra të tjera botërore. Ishte një lloj emancipimi, fitimi i lirisë, madje edhe seksual në vete. Ishte një kohë emocionuese dhe vështirë se do të ndodhë përsëri së shpejti në atë mënyrë. Mund të thuhet se nënat dhe gjyshet e rinisë së sotme ishin më të emancipuara dhe të lira se ato. Kishte edhe rryma të ndryshme, njëra prej tyre në Beograd më vonë u identifikua me nacionalizmin serb. Rebelimi mbarëbotëror i të rinjve që kërkon më shumë barazi dhe drejtësi ndikoi në shumë tendenca të mëvonshme. Ishte koha kur rrinim nëpër kafene, rrinim gjithë natën rrugëve, ku flisnim e festonim. Shikonim të gjithë filmat në FEST, dhe shfaqjet në BITEF, shkonim në koncerte... Ishte kohë emocionuese, në çdo rast, një rini e bukur.

Verën e kalonim në bregdetin e Adriatikut nga Rovinji në Dubrovnik, udhëtonim me autostop, flinim në shatorre. Në atë kohë, Jugosllavia dukej kozmopolite në ato qendra më të mëdha kulturore. Me pasaportë jugosllave mund të shkoje kudo pa vizë. Jugosllavia perceptohej në botë si një vend që brenda lëvizjes së të painkuadruarve angazhohej për dekolonizimin dhe barazinë. Ai imazh i saj është i pranishëm edhe sot në vendet e Afrikës, Azisë dhe Amerikës Latine. Ende ekziston kujtimi i gjallë i atij vendi dhe i Titos. Filmat jugosllavë shikohen edhe sot në Kinë, Bata Zhivojinoviqi ishte një personazh i famshëm, veçanërisht për filmat e luftës. Ata kanë statusin e filmave “western” jugosllavë.

Atëherë na interesonte Perëndimi dhe kur ishte e mundur, udhëtonim atje. Një nga udhëtimet e para të pavarura, i neve tri shoqeve të shkollës së mesme, ishte në Paris. Shkuam me makinë, me një Spaçek të vogël. Më ka mbetur në kujtesë takimi i parë me Parisin, koha e verës, e ne ishim kureshtare dhe nuk dihej se ku të shkonim më parë.

Shkurt, Jugosllavia e dytë e nxori vendin nga prapambetja, vendi u modernizua dhe ajo që është më e rëndësishmja për mua, përmbushi misionin e saj historik, si kornizë për emancipimin e të gjithë popujve jugosllavë. U përcaktuan edhe kufijtë që tani njihen ndërkombëtarisht.

U punësova menjëherë pas mbarimit të fakultetit. Në atë kohë, gjenerata ime përgjithësisht lehtë gjente punë. Pata aplikuar në shumë adresa. Ndër përgjigjet e para pozitive ishte Invest-Import, ku punova për rreth një vit e gjysmë. Mirëpo, pas një viti mora përgjigje pozitive edhe nga Ministria e Punëve të Jashtme, kështu që iu bashkova Ministrisë. Dy vitet e para i kalova si praktikante. Nga ajo kohë kam kujtime të bukura për Ljubisha Sekuliqin, një veteran i multilaterales. Pas dhënies së provimit shtetëror, më transferuan në ambasadën jugosllave në Londër, ku kalova katër vjet si diplomate i re.

Londra në atë kohë, sikurse edhe është tani, ishte një metropol botëror jo vetëm diplomatik, politik dhe ekonomik, por edhe kulturor. Për mua personalisht kjo ishte periudhë maturimi. Gjatë këtyre katër viteve, kam takuar njerëz të panumërt, kam pasur akses në ngjarje të ndryshme. Në veçanti e shijoja jetën kulturore të Londrës. Kam pasur rastin të vizitoj forume të ndryshme ku ndër të tjera merrnin pjesë disidentë të ndryshëm rusë.

Fakti që punoja në ambasadë më dha akses në shumë gjëra që, nga këndvështrimi i sotëm, nuk kanë çmim. Sigurisht, ajo përvojë ndikoi në qëndrimet dhe këndvështrimin tim për botën. Unë ende e përjetoj Londrën si një pikë të rëndësishme referimi në jetën time.

Atëherë lindi seriozisht pyetja se çfarë do të ndodhë me Jugosllavinë pas vdekjes së Titos. Në Perëndim, kjo ishte diskutuar për një kohë të gjatë, veçanërisht në rrethet akademike. Më kujtohet në një rast në Wllton Park, mendoj se ishte viti 1977, ku Ministria Britanike që nga viti 1951 organizon Forumin Global për Diskutimet Strategjike, që një diplomat grek më pati pyetur se çfarë do të ndodhte me Jugosllavinë pas vdekjes së Titos. Sigurisht, u befasova nga kjo pyetje, por kjo më nxiti të lexoja më shumë literaturë të huaj për Jugosllavinë. Gjenerata ime dinte pak për atë që thoshte dhe shkruante, le të themi, Millovan Gjillasi. Ishte vetëm në Londër që librat e tij i kam, të cilat i kam lexuar qysh atëherë. Më kujtohet se në Londër në vitin 1978 u botua libri Lufta e Tretë Botërore, e shkruar nga Sir John Hackett me disa gjeneralë të tjerë të lartë amerikanë dhe gjermanë, e cila parashikonte luftën e tretë botërore në vitin 1985. Sigurisht që në ato parashikime dhe skenarë konsiderohej se Jugosllavia mund të ishte një nga pikat që BRSS-ja do të dëshironte ta kthente në sferën e saj të ndikimit.

Spekulohej se një pjesë e Partisë Komuniste Serbe do t'i bënte thirrje Moskës ta parandalonte një kundërrevolucion kapitalist në Slloveni dhe Kroaci. Në propagandën serbe të viteve të nëntëdhjeta, zgjedhjet e para demokratike në këto dy republika trajtoheshin si kundërrevolucion.

Në Londër pata rastin të takoj një pjesë të emigracionit, në radhë të parë atij serb si më të shumtin. Nuk kisha paragjykime ndaj askujt dhe ndiqja shtypin e emigrantëve që shitej në kioskat në Queensway.

Në klubin jugosllav takova princeshën Jelisaveta Karagjorgjeviq, një grua shumë e bukur, e njohur në atë kohë për marrëdhënien e saj emocionale me Richard Barton. Ajo më pyeti nëse mund të merrte një vizë jugosllave dhe unë e drejtova për në

konsullatë, e cila u trondit nga fakti vetëm që jam takuar me të. Natyrisht, ajo nuk u shfaq kurrë në derën e ambasadës por edhe po ta bënte, do ta kishin refuzuar. Më vonë mora vesh se disa anëtarë të ambasadës takoheshin me emigracionin tonë. Kështu, për shembull, Borisllav Pekiqi ishte në kontakt me këshilltarin tonë për shkencë. E kam takuar nëpërmjet Dragosllav Mihailloviqit dhe gruas së tij Nena, me të cilën kam studiuar. Ata ishin si antikomunistë, më shumë kundër Brozit (fjalë pezhorative drejtuar Presidentit Tito). Në atë kohë unë nuk e gjeja fort veten në ato biseda, por të gjitha ato përvoja më ndihmuan më vonë t'i kuptoja proceset që ndodhën dhe që patën një ndikim të rëndësishëm në shpërbërjen e Jugosllavisë.

Në ambasadë tashmë kishte përçarje, do të thosha, mes ambasadorit Zhivan Berisavljeviqit dhe Vllatko Jovanoviqit, i cili ishte njeriu i dytë në ambasadë. Berisavljeviqi ishte më fleksibil dhe një autonomist i dalluar, një ambasador shumë dinamik, ndërsa Jovanoviqi ishte gjithashtu një diplomat i aftë, por edhe një nacionalist serb, gjë që u bë shpejt e dukshme. Më vonë ishte ministër i jashtëm serb, një diplomat i aftë, por shumë konservator.

Vizita e Presidentit Tito në Londër (1978), shumë e shkurtër, pas Samitit të Painkuadruarve në Havanë, ishte për mua një tjetër përvojë që mbeti në kujtesën time për shkak të një sërë rrethanash që lidhen me atë vizitë. Para së gjithash, për shkak të protestës së emigracionit para hotelit ku qëndronte Tito, për çka ai e kishte anuluar darkën me Mbretëreshën. Sigurisht, ata i lëvizën protestuesit dy-tre blloqe dhe kryeministri Callahan erdhi personalisht për të marrë presidentin në hotel. Kjo ishte vetëm dy vjet para vdekjes së tij, por qysh atëherë ishin indikacionet e qarta se Jugosllavia, ndonëse ende me reputacion ndërkombëtar, dalëngadalë po largohej nga skena. Këtë ndjesi e pata edhe gjatë varrimit të tij, ku morën pjesë liderët kryesorë botërorë të asaj kohe. Në një dritare të vogël para parlamentit federal, ishte një grup me të gjitha figurat kryesore botërore, të cilat në një farë mënyre ilustronin rëndësinë që kishte ky vend gjatë dekadave të fundit.

Të gjitha këto po i përmendi sepse përmes kësaj mësova kompleksitetin dhe cenueshmërinë e Jugosllavisë, njëkohësisht rëndësinë dhe kufizimet e saja, veçanërisht në ato momente kritike. Në Beograd u ktheva në vjeshtën e vitit 1979, pikërisht në momentin kur gazetarët e huaj tashmë kishin rrethuar Beogradin në pritje të largimit të Titos. Vdekja e tij më gjeti në Dubrovnik, ku isha me disa nga miqtë e mi anglezë. Meqenëse ministria ishte përgjegjëse për një pjesë të organizimit të funeralit - shumica prej nesh morëm ndonjë përgjegjësi. Unë isha zyrtare ndërlidhëse e delegacionit nga Guatemala. Funerali i Titos ishte, natyrisht, një ngjarje botërore e klasit të parë, duke marrë parasysh se kush ishte i pranishëm. Nga perspektiva e sotme dhe me gjithë njohuritë e mëvonshme, ai i ngjante edhe varrimit të Jugosllavisë, gjë e cila u vërtetua shumë shpejt si e vërtetë me zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve, si në vend ashtu edhe në botë.

Pra, kthimi në Beograd ishte mjaft kthjellues, para së gjithash, atmosfera e pritjes për vdekjen e presidentit dhe atmosfera e përgjithshme në shoqëri. Shumë shpejt filluan diskutimet se ku po shkonte Jugosllavia, e cila shfaqi dy koncepte – atë që e përfaqësonte Serbia, një federatë e centralizuar dhe tjetrin që e përfaqësonin republikat e tjera - një federatë e lirshme. Ato vite ishin të dhimbshme, sepse treguan papjekurinë e elitave politike për të arritur një konsensus. Ndoshta nuk ishte as realiste duke pasur parasysh se Serbia ishte përgatitur për situatën e re shumë kohë më parë.

Diplomacia ende funksiononte, me probleme të shumta, dhe në vitin 1984 shkova në misionin jugosllav në OKB në Gjenevë. Multilateralja është një përvojë e veçantë për çdo diplomat, sepse jep gjerësi dhe pasqyrë në politikën botërore. Kryesisht ndoqa Komisionin Ekonomik Evropian të OKB-së, i cili ishte një forum i rëndësishëm për bashkëpunimin mes dy blloqeve gjatë Luftës së Ftohtë. Jugosllavia luajti një rol të rëndësishëm në atë forum, siç dëshmohet nga fakti se dy jugosllavë ishin sekretarë të përgjithshëm vazhdimisht për njëzet e një vjet (Vladimir Velebiti dhe Janez Stanovniku). Në atë kohë marrëdhëniet u relaksuan, në Lindje ndodhën ndryshime të mëdha, ardhja e Gorbaçovit dhe pritshmëri të mëdha. Evropa Lindore, si dhe Jugosllavia, kalonte një periudhë shumë dinamike, shfaqeshin nisma dhe lëvizje të ndryshme dhe kishte pritshmëri të mëdha për të ardhmen. Rënia e Murit të Berlinit dhe bashkimi i Gjermanisë dinamizuan raportet në Evropë dhe çuan në shumë ndryshime. Kishte shumë optimizëm, siç tregohet nga Karta për të Ardhmen e Evropës (1990), e cila u nënshkrua në Paris. Natyrisht, ajo atmosferë ndikoi në dinamikën në OKB-së, e veçanërisht edhe mbi Komisionin Ekonomik të OKB-së për Evropën. Gjeneva përndryshe në këtë drejtim është një qendër ndërkombëtare politike shumë dinamike, si publikisht ashtu edhe fshehurazi.

Gjeneva ishte një përvojë e veçantë jetësore, sepse atëherë veçse ishte e qartë se situata në Jugosllavi nuk po zhvillohej në drejtim shumë të mirë. Demonstratat e shqiptarëve para godinës së Kombeve të Bashkuara ishin të shpeshta. Disa prej tyre i njihja dhe ndonjëherë pija kafe me ta. Pas demonstratave në Kosovë të vitit 1981, një numër i madh i të rinjve dhe studentëve u arratisën në Perëndim, veçanërisht në Zvicër, ku shumë shpejt u aktivizuan dhe u bënë një burim i rëndësishëm informacioni. Kosova shërbeu për hapjen e çështjes serbe në Jugosllavi, e cila u reduktua vetëm në pretendimin se populli serb është i kërcënuar dhe se ai është humbësi më i madh në Jugosllavi. Këto teza u paraqitën edhe në Memorandumin e ASHAS-së (1986), vuajtjet e serbëve gjatë gjithë shekullit XX kanë qenë objekt i shumë shfaqjeve (Beteja e Kolubarës, Libri për Millutinin), forume, botime, histori të fabrikuara, fushata mediatike. Përgatitjet ishin duke u zhvilluar për atë që do të ndodhte në vitet e nëntëdhjeta dhe kultura u vu në punë për të mobilizuar masat. Rrethi rreth Dobrica Qosiqit punonte në atë drejtim që nga vitet shtatëdhjetë, ndoshta edhe më herët.

Në misionin në Gjenevë u krijua një hendek mes atyre që u deklaruan si serbë (në shumicë) dhe të tjerëve. Komuniteti jugosllav në Gjenevë u nda, vizitat e propagandistëve të Beogradit, si Brane Crnçeviqi dhe Moma Kapori, u bënë më të shpeshta. Botuesi i famshëm nga Lozana "L'age d'Homme" Vlladimir Dimitrijeviqi botoi në frëngjisht shkrimtarë të shumtë serbë, shumë të njohur për rolin e tyre në mobilizimin e popullit serb për luftë. Duke qenë se tashmë isha njohëse e mirë e ngjarjeve jugosllave, raporti brenda/jashtë ndaj shqiptarëve më prekte njerëzisht. Që atëherë, fillova t'i kushtoja gjithnjë e më shumë vëmendje këtij problemi. Në Beograd është botuar libri "Nyja e Kosovës", i cili adreson akuzat e shumta të Beogradit për dhunën e shqiptarëve ndaj serbëve në Kosovë. Ky hulumtim, në të cilin morën pjesë një grup juristësh nga Beogradi, tregoi se nuk kishte dhunë të motivuar etnikisht. Fatkeqësisht, ai hulumtim as nuk u promovua, e lëre më të merrte vëmendjen që meritonte. Branko Horvati e shkroi edhe librin "Çështja e Kosovës" me idenë për të nisur një debat për këtë temë, por përjetoi kontestime dhe kritika në Fakultetin Filozofik në Beograd.

Fillimi i konfliktit në Jugosllavi

U ktheva në Beograd në vitin 1988, në shtator. Më mirëpritën - euforia nacionaliste, një mendje e vetme dhe një lloj zemërimi. Ishte e vështirë të flisje me shumë miq dhe të njohur. Në atë kaos të përgjithshëm, u afrova më shumë me njerëz me mendje të njëjtë, të cilët ndiheshin të izoluar si unë. Këto ishin ndoshta vitet më dramatike të jetës sime, sepse shikoja sesi një vend po shpërbëhej dhe sesi shkatërrimi shkatërronte atë ndërtim çdo ditë, e cila, në fund të fundit, ishte megjithatë domethënëse për popujt që jetonin në të. Tre vitet e fundit i kam kaluar kryesisht në Grupin e Analizës dhe Strategjisë të Ministrisë, ku qëndrova deri në fund. Është një administratë ombrellë, sepse ishte e lidhur drejtpërdrejt me kabinetin e ministrit. Unë isha e angazhuar për çështje evropiane. Për shkak të dinamikës së ngjarjeve dhe ndryshimeve atë vit, mbaj mend që qëndroja në zyrë gjithë ditën. Drejtoreshë ishte Anna-Maria Beshker, një person jashtëzakonisht i aftë dhe i përgjegjshëm dhe shoqja ime e përjetshme. Përveç saj, i rëndësishëm për mua ishte edhe Miomir Udoviçki, i cili ishte i angazhuar për vatrat të krizës. Ne shpesh bënim shaka për atë temë dhe tashmë ishim bërë vetë vatër krize. Ne tre ishim një skuadër që prodhonte përditë përkujtues, analiza, teza për fjalime të ndryshme të ministrit... Qeveria ishte pro-evropiane, ashtu si ministria, por kishte edhe rezistencë të konsiderueshme ndaj atyre njerëzve. Pas luftës së shkurtër sllovene, sllovenët u larguan të shoqëruar me ofendime nga kolegët e tyre, disa prej tyre duke qarë. Ai zemërim dominonte mbi të gjithë të tjerët. Kroatët dolën fshehurazi gjatë verës së vitit 1991, por serbët nga Kroacia mbetën dhe në diplomaci kishte shumë prej tyre.

Në atë kohë u botuan me të madhe analiza të shumta nga qendra të ndryshme ndërkombëtare, që tregonin mundësinë e konfliktit në Jugosllavi. Një nga raportet përkatëse ishte ai i CIA-s, i cili u publikua pjesërisht nga korrespondenti i New York Times, David Binder.

Pra, gjatë atyre tre viteve, funksionononin dy politika - shpëtimi i Jugosllavisë dhe shkatërrimi i saj. Edhe komuniteti ndërkombëtar ishte bërë një faktor aktiv i krizës në përpjekje për të arritur një zgjidhje përmes ndërmjetësimit. Falë “trojkës” së Bashkimit Evropian, Stipe Mesiqi megjithatë u bë kryetar i Presidencës federale, me gjithë pengesat nga Beogradi. Meqenëse ndërmjetësimet e ndryshme dështuan, dhe konfliktet tashmë kishin filluar, Konferenca e Hagës (1991) u mbajt si përpjekja e fundit për të ruajtur kornizën shtetërore jugosllave. Serbia refuzoi të nënshkruajë dokumentin e ofruar.

Përveç që isha në ngjarje në ministri, isha e angazhuar edhe në nisma të tjera, siç ishte themelimi i lëvizjes evropiane në Jugosllavi (mars 1991), fatkeqësisht nismë e vonuar që tregonte të gjitha dallimet në perceptimin e Jugosllavisë. Me fillimin e konfliktit në Kroaci, tashmë në pranverën e vitit 1991, u themelua Qendra për Veprim Kundërluftës, një nga themeluesit e së cilës isha edhe unë, ndër të tjera, me Vesna Peshiqin. Pasi u largova nga ministria pas dështimit të Konferencës së Hagës, iu bashkova aktivisht asaj lëvizjeje. Pavarësisht se Qendra nuk e ndaloi luftën dhe as nuk ndikoi dukshëm në zhvillimin e mëtejshëm të ngjarjeve, ajo iniciativë ishte domethënëse, sepse u dha ndihmë refugjatëve, dezertorëve... Mendoj se është e rëndësishme të ktheheni në atë lëvizje si një fortesë e rëndësishme morale. Në librin e tij “Pamja ime për Jugosllavinë”, Veljko Kadijeviqi i akuzoi “ato grupe të ndryshme” për mobilizimin e dështuar. Kjo ishte arsyeja pse filloi mobilizimi i llumrave më të këqij të

mbledhur rreth Vojisllav Sheshelit dhe të tjerëve. Sigurisht, të gjitha nën kapuçin e APJ-së. Në shtator të vitit 1991, së bashku me Daniel Ivinin, organizova konferencën e parë dhe të vetme të opozitës jugosllave. Organizator zyrtar ishte Instituti Evropian në Gjenevë, i cili atëherë drejtohej nga Dushan Shigjanski. Më vonë mora vesh se pas saj qëndronin disa njerëz nga Londra (Ristiqi) dhe me deklaratën e miratuar nga ajo konferencë, ata kontaktuan FCO-në dhe aktorë të tjerë që tashmë ishin aktivizuar në krizën jugosllave.

Nga ministria u largova pas dështimit të Konferencës së Hagës, kur vendi pushoi së ekzistuari. Kjo ishte e qartë edhe më parë, por ky ishte fundi formal. Pasi Serbia e refuzoi dokumentin e Hagës, Komisioni i Badinterit përcaktoi kushtet dhe kriteret për njohjen e republikave (kërkesa e Kosovës në atë kohë nuk u pranua). Duke qenë se Serbia e kishte marrë tashmë ministrinë, kjo ishte edhe arsyeja që unë të largohesha nga aty, sepse nuk pajtohesha me politikën që tashmë e kishte çuar vendin në luftë. Dhe nuk jam identifikuar me nacionalizmin serb. Edhe para kësaj, kishte shumë presion mbi institucionet federale, por ministria megjithatë i rezistonte dhe arriti të përfaqësonte deri në fund politikën pro-jugosllave dhe pro-evropiane.

Tre vitet e fundit në ministri ishin në fakt shqelmat e fundit të atij vendi. Sado që qeveria federale u përpoq të gjente një lloj konsensusi, politika e shkatërrimit e Millosheviqit fitoi. Duhet pranuar se ngadalë u vendos për ndërkombëtarizimin e krizës jugosllave, sepse Serbia pengonte çdo përpjekje të tillë.

Ajo përvojë në institucionin federal ishte vendimtare për të kuptuarit tim të Jugosllavisë si një vend kompleks dhe shumë i ndërlikuar, i cili kërkonte pjekuri, përpjekje të jashtëzakonshme dhe nënkuptonte zgjidhje kompromisi. Ishte e qartë se Serbia kishte vendosur të ricentralizonte Jugosllavinë dhe të vendoste dominimin e saj. Ajo kishte në krah ushtrinë dhe shërbimet e sigurisë. Ajo kishte punuar për një kohë të gjatë për të fituar mbështetjen e tyre. Me njohuri dhe vështrime të tilla, unë iu bashkova lëvizjes kundër luftës. Jo të gjithë kishin të njëjtin kuptim për atë që po ndodhte, por ata ishin kundër luftës. Tashmë përpjekjet e para për të artikuluar publikisht përkufizimin e asaj lufte u ndeshën me rezistencë nga pothuajse të gjitha anët. Përveç disa ish-kolegëve të mi, ndjehesha krejt e vetmuar në atë kaos dhe konfuzion të përgjithshëm.

Jugosllavia, preokupim jetësor

Nga këndvështrimi aktual më duket se gjithë jetën jam marrë me Jugosllavinë. Preokupimi i jetës sime. Shpërbërja e saj brutale dukej shkatërruese. Përveç faktit që unë përfundova në rrugë, pjesë të ndryshme të familjes kaluan periudha dramatike, ashtu si edhe shumë familje të tjera të lidhura me Kroacinë dhe Bosnje Hercegovinën, por edhe me Kosovën. I kalova ato vite lufte duke udhëtuar nëpër botë, sepse ndjeva nevojën për të shpjeguar, shkruaja letra të shumta, bashkëpunoja me Tadesh Mazowieckin (e takova gjatë vizitës së tij të parë në Beograd në cilësinë e Raportuesit Special të OKB-së për Jugosllavinë në dhjetor 1992 dhe gjatë gjithë kohës ishte në atë pozicion bashkëpunova me të). Takova edhe shumë emisarë të tjerë që vinin në Beograd. Më dukej se nuk e kuptonin sa duhet, se ishin të ngadaltë, se reagimet e tyre vonoheshin. Beogradi i vendoste gjithmonë në një situatë fait accomlis, sidomos gjatë festave dhe fundjavave kur të huajt humbasin vëmendjen. Kam udhëtuar gjatë gjithë kohës për në Kroaci nëpërmjet Hungarisë. Isha në Sarajevë në vitin 1994, në fund të

qershorit, së bashku me avokatin Srgjo Popoviqin (për Komitetin e Avokatëve për të Drejtat e Njeriut, hetonim se çfarë po bënin komisionet rajonale të krimit).

Ai takim me Sarajevën e rrethuar u duk shkatërrues - shkuam nga aeroporti në motelin ku po qëndronim me një automjet ushtarak. Moteli ndodhej pak jashtë qendrës dhe ishte dëmtuar nga granatimet. Kishte një vrimë të madhe të hapur në banjo. Qyteti ishte i shkretuar, të gjitha xhamat ishin thyer dhe kishte plastikë mbi to, dyqanet ishin bosh, vetëm disa restorante. Ne ishim atje për dhjetë ditë. Takuam njerëz të ndryshëm - të gjithë ata i jepnin rezistencë heroike barbarëve të Karaxhiqit dhe të Mlladiçit. Njëlloj, serbët, boshnjakët, kroatët, hebrenjtë dhe të tjerët. Ishte një rezistencë civile mbresëlënëse që mohonte mantrën e nacionalistëve serbë se ne nuk mund të jetojmë së bashku. Snajperët ishin aktivë gjatë gjithë kohës. Kryesisht takoheshim në oborre dhe zona ku snajperët nuk arrinin dot. I vetmi komision (ishin edhe katër të tjerë - Zagrebi, Beogradi, Republika Srpska, Republika Srpska Krajina - këto dyja ndodheshin edhe në Beograd) për krime lufte që mblidhte të dhëna dhe prova në atë kohë ishte pikërisht komisioni i Sarajevës.

Luftërat jugosllave ekspozuan paaftësinë dhe mosgatishmërinë e bashkësisë ndërkombëtare për të ndalur luftën, gjegjësisht agresionin serb, krimet e luftës, spastrimin etnik dhe parandalimin e pushtimit territorial, gjë që vuri në pikëpyetje vlerat dhe standardet themelore të rendit ndërkombëtar. Kjo është arsyeja pse Qendra e Veprimit Humanitar organizoi tri konferenca për të trajtuar çështjet e së drejtës humanitare. Unë kam qenë koordinatore e atyre projekteve. U mbajtën tri konferenca (San Remo 1992, Freiburg 1993 dhe Bruksel 1994) mbi përgjegjësinë individuale për shkeljet e të drejtës humanitare.

Krahas “qarkullimit” të vazhdueshëm nëpër rajon, kam marrë pjesë edhe në konferenca të shumta, takime të mbyllura, kam vizituar ministri jashtë vendit. Në korrik 1993, mora pjesë në një nga takimet e para për Kosovën dhe Maqedoninë (Parandalimi i Konflikteve në Kosovë dhe Maqedoni) në afërsi të Uashingtonit (Airlie House, Warrenton, Virginia). Organizatori ishte Search for Common Ground. Ishte edhe Veton Surroi, ne dy të vetmit nga rajoni. Ishte një lloj brainstorming ku pjesëmarrës ishin pjesë të administratave dhe institute e individë të ndryshëm. Që atëherë, mund të them se në mënyrë aktive ndjek, marr pjesë dhe bëj gjithçka që ka të bëjë me Kosovën. Nuk është rastësi që Kosova dhe Maqedonia u shqyrtuan “në një paketë”. Gjatë Jugosllavisë, këto ishin pikat më të cenueshme, sepse Bashkimi Sovjetik përdorte Bullgarinë e cila gjithmonë e kontestonte Maqedoninë, si dhe popullin dhe gjuhën e saj. Nuk është rastësi që Jugosllavia investoi në kulturën maqedonase dhe identitetin e saj, gjuha u standardizua. Kjo është në thelb e vetmja pikë strategjike që përfundimisht çoi në ndërhyrjen e NATO-s për të ndaluar Millosheviqin, por edhe për të parandaluar përhapjen e konfliktit në krahun jugor të NATO-s.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

Meqenëse Komiteti Jugosllav i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u shpërbë si dhe Jugosllavia, në shtator 1994, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u krijua në Serbi, më parë në Zagreb (1993), dhe më vonë në të gjitha vendet e reja të krijuara. Komiteti i parë i Helsinkit u krijua në Kosovë në vitin 1992, për shkak të shkeljeve masive të të drejtave të njeriut në Kosovë. Tanja Petovar, kryetare e Komitetit Jugosllav, pati një ndikim të rëndësishëm në përfshirjen time atje. Që atëherë, angazhimi im lidhej kryesisht me Komitetin, megjithëse kisha ende angazhime të tjera personale. Komiteti ishte një nga komitetet më aktive brenda Federatës Ndërkombëtare të Helsinkit, drejtor ekzekutiv i së cilës ishte Aaron Rhodes, një humanist dhe mik i shquar, ende sot e kësaj dite.

Kishte situata kur mendoja se duhet të largohem, por pas marrjes së Komitetit të Helsinkit e kam ndjerë si një detyrim të madh moral. Rreth Komitetit u mblodhën shumë njerëz, shumë kolegë të mi si Novak Pribiçeviq, si dhe Ljubivoj Aqimoviq, një ekspert i shquar ndërkombëtar veçanërisht i KEBS-it, më vonë na u bashkua Latinka Peroviq. Seshka Stanojloviq, gazetare, ishte ndoshta mbështetja ime më e madhe dhe më e besueshme, edhe sot e kësaj dite.

Një nga aktivitetet e rëndësishme të Komitetit ishte puna me refugjatët. Ardhja e refugjatëve nga Kroacia në vitin 1995 ishte një sfidë e veçantë për organizatat joqeveritare. Ne u përcaktuam për kthimin e tyre. Dhe projekti ynë u emërua “Dua të shkoj në shtëpi”. Në muajt e parë, një mijë njerëz kalonin nëpër Komitet çdo ditë; 30,000 prej tyre nënshkruan kërkesën për kthim, të cilën Richard Holbrook ia dorëzoi personalisht Tugjmanit. Natyrisht, pengesat u shfaqën menjëherë nga të gjitha anët. Ne i zbuluam të gjitha këto dhe ia raportuam kujtdo që mbërritëm. Më së shumti Ambasadës Amerikane dhe UNHCR-së, që nuk kishte vesh për kthimin. Të kthyerit e parë në Kroaci kaluan përmes Komitetit. Në atë projekt punuam për dhjetë vjet. Ne masë të madhe kontribuuam në përshpejtimin e procesit të lëshimit të dokumenteve kroate. Shumë shkuan në vendet e treta me pasaporta kroate. Edhe sot, shumë nga ata refugjatë, veçanërisht të moshuarit, jetojnë në mes të Kroacisë dhe Serbisë. Jo të gjithë hoqën dorë nga pronat e tyre. Këtë verë kam dëgjuar një fakt interesant se shumë refugjatë serbë, për shembull nga Knini, janë varrosur në fshatrat e tyre. Ndërsa boshnjakët e ardhur në Knin janë varrosur në fshatrat e tyre në Bosnje. Kaq për “zhvendosjen vullnetare” të Dobrica Qosiqit dhe “patriotëve” të tjerë.

Kemi provuar të njëjtin projekt “Dua të shkoj në shtëpi – Prishtinë”, por shteti ndaloi ose pengoi regjistrimin e refugjatëve nga Kosova. Mirëpo ne kishim rreth dyqind persona të regjistruar në një kohë të shkurtër, por nuk u realizua.

Unë personalisht besoja dhe prisja shumë nga themelimi i Tribunalit të Hagës për Jugosllavinë. U njoha me Riçard Golstonin në Nju Jork, prokurorin e parë, para se të emërohej, dhe që nga dita e parë kam bashkëpunuar me atë institucion, sidomos gjatë gjykimit të Sllobodan Millosheviqit. Unë kisha nevojë të besoja në drejtësi dhe prandaj u lidha kaq shumë me atë bashkëpunim. Pavarësisht se trashëgimia e Tribunalit është margjinalizuar, mbi të gjitha në Serbi, unë besoj se Tribunali bëri më të mirën që mundi në rrethanat e dhëna. Deri më tani, është gjykata penale ndërkombëtare më e suksesshme, krahas asaj për Ruandën. Është një burim i vlefshëm dëshmish, dokumentesh, dokumentarësh - e gjithë kjo nuk do të ishte në një vend pa Tribunalin.

Kthimi i refugjatëve dhe bashkëpunimi me Tribunalin ishin arsyeja e fushatës dhe kërcënimeve më të egra ndaj Komitetit (dhe ndaj meje personalisht).

Një aktivitet i rëndësishëm i Komitetit është edhe aktiviteti i botimeve. Deri më tani janë botuar më shumë se 160 botime dhe libra, raporte vjetore për të drejtat e njeriut, si dhe raporte individuale për tema të ndryshme (minoritetet, mediat, institucionet e mbyllura...), revista Karta e Helsinkit ishte botuar për njëzet vjet. Puna me të rinjtë ishte dhe ende është një pjesë e rëndësishme e angazhimit tonë. Shumica e botimeve trajtojnë Serbinë dhe nacionalizmin serb. Në ndërkohë, të gjitha ato botime janë bërë referenca për të gjitha hulumtimet për Serbinë.

Komiteti ka qenë vazhdimisht i pranishëm në Kosovë që nga themelimi i tij. Në vend u organizuan dy konferenca të rëndësishme (në Ulqin në 1997 dhe në Beograd në 1998, në prag të ndërhyrjes). Organizuam edhe një konferencë në Prishtinë, ku morën pjesë anëtarë të "Serbisë tjetër", por ishte i pranishëm edhe lidershipi i Kosovës. Konferenca u transmetua drejtpërdrejt dhe u përsërit disa herë. U habitëm se sa ngrohtësisht dhe në mënyrë miqësorë na pritën njerëzit kur dolëm në qytet atë mbrëmje. Ndërhyrjen e prita në Beograd, për ta lënë pas njëzet ditësh, e nxitur nga kolegu Novak Pribiçeviq, sepse kishte frikë për sigurinë time. Para ndërhyrjes isha në Paris dhe gjatë kthimit për në Beograd takova Wolfgang Petriqin në aeroplanin që kthehej nga negociatat në Rambuje. Ai tha se nuk kanë arritur marrëveshje dhe se do të ketë ndërhyrje. Shumë nuk besuan në të, madje edhe diplomatë me përvojë. Në takimin e Forumit për Marrëdhënie Ndërkombëtare atë ditë, ata shprehën dyshime, me mendimin se ndoshta nuk do të ndodhë. Kur dolëm në rrugë rreth orës nëntë të mbrëmjes, njerëzit tashmë po iknin në panik, megjithëse Beogradi nuk ishte goditur. Megjithatë, paniku ishte i madh. Atë mbrëmje takova Sllobodan Iniqin, i cili vetëm tha: "E prisnim, apo jo?". Ne pimë nga një Coca-Cola në një kafene dhe u ndamë, ai u nis për në Sarajevë të nesërmen, dhe unë shkova në Zeleni Venac për të kapur një autobus ose taksi. Megjithatë, nuk kishte asnjë shenjë transporti askund. Panik në rrugë. Pas ca kohësh, erdhi një autobus që mblidhte pasagjerë nëpër qytet, dhe në platformën e pasme një pasagjer miqësor bërtet – "Tani do të vijnë rusët".

Gjashtë muajt e ardhshëm i kalova duke fluturuar nga një kryeqytet evropian në tjetrin. Isha në Uashington dhe Nju Jork. Ndoshta i vetmi person nga Beogradi në atë kohë. Janë botuar edhe disa nga artikujt dhe intervistat e mia, për këtë arsye kam marrë mesazhe të shumta urrejtjeje edhe nga disa anëtarë të sektorit joqeveritar. Një pjesë e një interviste time u përkthye (u shtuan disa fjali) dhe u fut në kutitë postare në hyrjen time të pallatit ku banoj. Pas mbërritjes në Beograd, të gjithë më shmangeshin, më shikonin me pakënaqësi në qytet, por edhe në sektorin civil.

Në Kosovë kam qenë menjëherë pas ndërhyrjes me një koleg gjerman nga Federata e Helsinkit (Fischer). Përsëri i njëjti imazh shkatërrimi dhe rrënimi, por një atmosferë krejtësisht e ndryshme. Do ta kujtoj gjithmonë atë atmosferë çlirimi. Shqiptarët e drejtuan kurrizin. Kudo kamionë plot me njerëz që këndojnë, me flamuj. Vizitova disa enklava serbe ku u përballa me një atmosferë krejtësisht të ndryshme, dëshpëruese. Serbët, si të thuash, si pakicë brenda natës e humbën pozitën e tyre dominuese dhe u bënë, në kuptimin e vërtetë të fjalës, një pakicë e rrezikuar. Komuniteti Ndërkombëtar (KFOR) nuk ishte i përgatitur për atë që do të pasonte. Në Prizren isha në manastir ku më thanë se serbët u larguan me kërkesë të ushtrisë dhe policisë serbe nga Suhareka. Rreth 60.000 prej tyre kaluan në veri dhe, siç theksoi historiani Dushan Batakoviq

në një artikull, “serbët u kantonizuan spontanisht”. Ajo situatë nuk ka ndryshuar deri më sot, Veriu është në një vakum total ligjor dhe Beogradi i mban nën kontroll serbët dhe kërkon një lloj kompensimi për humbjen e Kosovës dhe ndarjen e saj. Pra, edhe tridhjetë vjet pas luftës, as Bosnja dhe as Kosova nuk u konsoliduan. Ndërsa Mali i Zi po hyn në një krizë serioze pas zgjedhjeve të vitit 2020.

Viti pas ndërhyrjes ishte vërtet i tmerrshëm, në Beograd nuk kishte të huaj (vetëm ndonjë) deri më 5 tetor 2000. Kur filluan të kthehen z. Timonier, një diplomat nga Ambasada Franceze, erdhi për vizitë dhe gjëja e parë që më pyeti ishte: “A je i sigurt?” “Nuk e di”, i thashë dhe ia ktheva, “a di ti ndonjë gjë për këtë”. Pa ndërhyrjen e NA-TO-s, Millosheviqi nuk do të ishte larguar, kur u largua. Opozita mezi u organizua me mbështetjen e Perëndimit dhe fitoi zgjedhjet në vitin 2000.

Fatkeqësisht, shpejt u bë e qartë se Serbia nuk ka potencial për ndryshime thelbësore. Kryeministri i parë demokrat Zoran Xhinxhiq u vra dhe pyetja është nëse do t’ia kishte dalë edhe ai. Fitorja e tij më e madhe ishte dërgimi i Millosheviqit në Hagë, për të cilën gjë ai nuk u fal kurrë këtu. Mund të thuhet se Millosheviqi sot është rehabilituar dhe kriminelët e luftës ende glorifikohen.

Pas ndryshimeve në Serbi, vitin 2001 e kalova në Amerikë në Institutin për Paqe, ku punova në projektin: Nacionalizmi serb. Më vonë ajo vepër u botua si libër “Shpërthimi i Jugosllavisë - tërheqje fatale e nacionalizmit serb”. Ka qenë një periudhë shumë di-namike, kam takuar shumë njerëz të rinj dhe kam qenë në kontakt me të gjithë ata që kanë kaluar nëpër Beograd. Interesi për Ballkanin më pas bie dalëngadalë dhe pas 11 shtatorit 2001, Amerika i drejtohet Afganistanit, më vonë Irakut...

11 shtatori më gjeti në Uashington, në një ligjëratë që u ndërpre papritur për shkak të sulmit në kullat e qytetit të Nju Jorkut. Një avion ra edhe në Pentagon. Në ato ditë njerëzit ishin në rrugë, ende nuk dihej se çfarë ndodhi me ta. Për më tepër edhe An-traxi futi panik. Unë isha gjithashtu në rrugë, por disi nuk isha veçanërisht e frikësuar apo e befasuar. Gjithçka tashmë ishte parë dhe regjistruar në kujtesën tonë.

Një ditë më herët mbërrita nga Durbani (Afrika e Jugut), ku mora pjesë në konferencën e OKB-së për ksenofobinë dhe antisemitizmin. Ishin rreth gjashtëmbëdhjetë mijë pjesëmarrës nga e gjithë bota. Për shkak të mungesës së vendeve në hotele, ata na akomoduan në motele më të vogla përgjatë Oqeanit Indian. Unë isha e akomoduar në një motel të drejtuar nga një familje Zulu, një çift i ri i bukur, me rreth dhjetë amer-ikanë dhe kanadezë të tjerë. I kalonim netët duke diskutuar për Millosheviqin. Disa ishin ende në anën e tij. Antisemitizmi dhe antiamerikanizmi dominuan diskutimet në Forumin e OJQ-ve, ku Kastro foli për disa orë. Ai imazh, gjegjësisht atmosfera, lidhet me sulmin terrorist dhe atmosferën e frikës që pasoi në Uashington pas kësaj.

Aty mora lajmin për ekstradimin e Millosheviqit në Hagë. I gjithë ekipi, rreth pesëdhjetë veta, u takuan atë mbrëmje në një pab për një pije, për të ngritur dolli për fundin e një epoke.

Krahas aktiviteteve të shumta të Komitetit viteve të fundit, kushtuar politikave arsimore dhe kulturore, do të veçoja një me të cilën jam veçanërisht e lidhur, sepse besoj se ka rëndësi strategjike. Është fjala për një projekt që merret me historinë e Jugosllavisë dhe në të cilin marrin pjesë rreth pesëdhjetë historianë, politologë, sociologë dhe

studiues të tjerë nga i gjithë rajoni. Qëllimi i projektit është të kontribuojë në normalizimin rajonal dhe ndërtimin e një kulture të kujtesës, të bazuar në fakte, përmes narrativave historike multi-perspektive që motivojnë brezat e rinj, gjenerata të arsimuara, për të promovuar pajtimin, demokratizimin dhe modernizimin e të gjithë hapësirës post-jugosllave.

Ballafaqimi me të kaluarën

Procesi i ballafaqimit me të kaluarën e afërt rëndon pothuajse të gjithë hapësirën post-jugosllave, e cila në thelb ende nuk ka filluar, sepse qëllimet e luftës janë ende aktuale, tani me mjete të tjera. Serbia në thelb nuk i pranoi kufijtë e rinj dhe vazhdimisht përpiqet të rishikojë disfatën e saj.

Është një proces kompleks, një proces që do të vazhdojë për një kohë të gjatë dhe mbi të gjitha një proces transgjenerativ. Pajtimi rajonal vështirë se shihet, pavarësisht fakteve dhe dokumenteve të pamohueshme të grumbulluara jo vetëm nga gjykatat ndërkombëtare, por edhe nga gjykatat e brendshme të shteteve pasardhëse. Këto shtete - janë ende në proces transformimi dhe konsolidimi - pavarësisht se sa larg kanë arritur në kursin e tyre (të proklamuar apo të arritur tashmë evropian); vështirë se kanë filluar procesin e transformimit të vlerave të shoqërive të tyre. Në secilën prej tyre, identitetet e reja kombëtare ndërtohen kryesisht mbi stereotipe dhe shpesh mbi narrativa për “kombet viktima”. Ato rrëfime historike të sajuara u imponuan nga elitat kombëtare që përpiqen për homogjenizimin kombëtar dhe manipulimin e ndjenjave të njerëzve. Kështu, lufta praktikisht vazhdohet me mjete të tjera - kulturën e kujtesës, duke përfshirë kujtesën e të gjithë shekullit XX dhe shtetin dikur të përbashkët.

Shumë njerëz pyesin – prej nga vjen kjo që me rebelimin, lëvizjet paqësore dhe të gjitha veprimet që lidhen me luftën dhe aktivitetet kundër luftës dominojnë gratë në territorin e gjithë Jugosllavisë. Ky është një fakt për të cilin nuk kam një përgjigje të vërtetë, sepse kërkon hulumtime. Unë do të thosha që gratë janë më të guximshme, më empatike dhe më solidare. Burrat gjithmonë kanë justifikime që mund t’i përdorin edhe gratë, por nuk e bëjnë këtë.

Këto janë situata kur një person përballet me vetveten dhe më pas merr një vendim sipas disa shtysave, vlerave të tij të brendshme. Është një akt vërtet personal. Femrat duket se janë personalitete më të forta dhe kanë më shumë integritet se meshkujt. Vendimi për t’u larguar nga ministria ishte i shpejtë dhe pa menduar se çfarë do të ndodhë në të ardhmen. Gjithçka ishte e pasigurt, pa perspektivë me kthesa dramatike. Mund të pohoj sot se duket se më ka bërë jetën më kuptimplote, etike dhe të pasur.

Një paqebërëse në botë

Do ta përmend gjithashtu përvojën time si anëtare e Komisionit të OKB-së për Koreanë e Veriut, në të cilin u emërova në vitin 2013 (UN Commission of Inquiry for North Korea). Kjo më hapi një dritare drejt Lindjes së Largët, për të cilën kisha vetëm njohuri sipërfaqësore. Është një komision prej tre anëtarësh, në të cilin pranë meje ishin Michael Kirby nga Australia, kryesuesi dhe një personalitet i jashtëzakonshëm, Marzuki Darusman nga Indonezia. Përvoja e Ballkanit më ndihmoi të hyja më shpejt ose më mirë të kuptoj (përmes dëshmive të ndryshme të refugjatëve, raporteve të shumta tashmë ekzistuese, filmave, dokumentarëve dhe librave që kam lexuar) kontekstin dhe veçanërisht mentalitetin e shoqërisë koreano-veriore. Më vonë isha anëtare edhe e Grupit të Ekspertëve të Pavarur të Shëndetësisë, 2016 (Koreja e Veriut). Para pak kohësh kam marrë pjesë gjithashtu në Raportin e Panelit të Ekspertëve të Pavarur Ndërkombëtar (PIIE) i cili verifikonte informacionet në lidhje me shkeljet e supozuara të drejtës ndërkombëtare të kryera kundër myslimanëve në Indi që nga korriku 2019.

Jam fituese e bursës si hulumtuese të lartë në Institutin Amerikan të Paqes (Uashington, 2001) dhe e bursës Eric Lane në Kolegjin Clare, Kembrixh.

Jam autor i librave “Serbia në Lindje”, “Serbia e humbur në tranzicion”, “Shpërthimi i Jugosllavisë - tërheqja fatale e nacionalizmit serb”. Kam redaktuar dhe përgatitur për shtyp një sërë librash, ndër ta “Srebrenica: nga mohimi në rrëfim”, “Millosheviqi kundër Jugosllavisë”, “Tragjedia e Vukovarit”, “Bosnja - thelbi i projektit shtetëror serb”. Kam botuar artikuj në shumë revista të specializuara dhe të tjera. Shkruaj rregullisht editoriale dhe rubrika në revistën e Komitetit të Helsinkit “Karta e Helsinkit”.

Kam fituar një çmim për të drejtat e njeriut nga Komiteti i Avokatëve për të Drejtat e Njeriut në Nju Jork. Në vitin 2005 u nominova për Çmimin Nobel për Paqen si pjesë e projektit “Njëmijë Gra”. Në vitin 2009 mora çmimin Weimar dhe në vitin 2010 çmimin Oettinger të dhënë nga Universiteti i Oslos. Në vitin 2010 jam shpallur qytetare nderi e Sarajevës, kam marrë çmime nga presidenti kroat Mesiq për punën time në fushën e të drejtave të njeriut, si dhe nga presidentja e Kosovës, Jahjaga, për punë humanitare në vitin 2013.

Edhe pas më shumë se 30 vitesh aktivizim, nuk jam e sigurt se e gjithë kjo ka dhënë ndonjë rezultat. Unë personalisht zbulova një dimension në veten time që sigurisht nuk do të dilte në pah nëse Jugosllavia nuk do të shpërbëhej brutalisht me pasoja kaq të gjera. Në këtë kuptim, ishte një përvojë e vështirë, tragjike dhe sfiduese, por edhe e rëndësishme për atë që jam sot. Kam takuar njerëz të dashur, por kam njohur edhe Jugosllavinë me të gjitha të metat dhe arritjet e saj. Më vjen keq që bota nuk e mori më seriozisht përvojën me Jugosllavinë dhe që nuk mori disa mësime. Ata na trajtuan më shumë si një lajthitje sesa një trend që është dominues sot. Perëndimi u largua nga Ballkani 15 vite më parë, vetëm për t’u kthyer pas agresionit rus kundër Ukrainës nga frika e hapjes së një fronti të ri. Ndërkohë, pati një regres në të gjithë rajonin. Trashëgimia e konfliktit dhe ndërveprimi kompleks i etnisë, fesë dhe politikës vazhdojnë të formësojnë peizazhin socio-politik të rajonit. Përpjekjet për të promovuar pajtimin, dialogun ndërfetar dhe multikulturalizmin mbeten aktuale për të gjitha shoqëritë në rajon.

Guximi qytetar

Katarina Kruhonja ishte një nga themelueset dhe drejtoreshë e Qendrës për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut nga Osijeku. Qendra u themelua në vitin 1992, në mes të luftës, agresionit që Serbia me ndihmën e njësive të APJ-së bëri ndaj Kroacisë, në momentet kur në Kroaci po bëhej një luftë mbrojtëse dhe kur çdo kundërshtim ndaj logjikës së “ne ose ata” praktikisht nënkuptonte tradhti. Pavarësisht kësaj, së bashku me mikun e saj Krunosllav Sukiq, Katarina Kruhonja mendon dhe, që është edhe më e rëndësishme, vepron në kuadrin e jo-dhunës dhe rezistencës jo të dhunshme ndaj pakuptimësisë së luftës. Më vonë, pas përfundimit të luftës në vitin 1995, ajo u mor me riintegrimin paqësor të rajonit kroat të Danubit dhe u përkushtohet të kthyerve, si atyre nga pala serbe po ashtu edhe atyre kroate. Kjo e çoi atë drejt drejtësisë tranzicionale, sepse pajtimi nuk është i mundur pa një përballje të plotë dhe përfundimtare me autorët e krimeve të luftës.

E rritur në një familje zejtarësh, Katarina Kruhonja është brezi i parë në familjen e saj që merr arsim të lartë, madje edhe titullin magjistër i shkencave. Ajo ishte mjeke, primarius i mjekësisë bërthamore, por zyrtarisht e ndërpreu të merrej me profesionin e mjekësisë në vitin 1997 për t’iu përkushtuar plotësisht aktivizmit të paqes, që, siç thotë ajo vet, buron nga besimi i saj. Katolike dhe besimtare, ajo përqafoi plotësisht moralin origjinal të krishterë sipas të cilit ne duhet t’i puthim armiqtë tanë, sepse asnjë jetë nuk është më e vlefshme se tjetra.

Kjo grua e jashtëzakonshme është një shembull i guximit dhe përgjegjësisë qytetare, sepse në rrethana të vështira dhe të ndërlikuara historike ajo përqafoi bindjet e saja duke rrezikuar me vetëdije që ta vendosë veten në rrezik të jetës. Duke e kundërshtuar paligjshmërinë dhe dhunën, ajo bëri shumë për të gjithë të përndjekurit dhe njerëzit që përjetuan dhunën, e sidomos për ata që në një moment u persekutuan vetëm pse kishin emër e mbiemër tjetër, gjegjësisht i përkisnin një kombi tjetër. Kjo është historia e saj.

Katarina Kruhonja

Fëmijëria dhe familja

Unë jam Katarina Kruhonja. Kam hyrë në dekadën e tetë të jetës sime, në fakt jam 74 vjeçe. Unë kam lindur në Osijek, edhe pse prindërit e mi nuk janë Osijekas të lindur, ata janë shpërngulur nga zonat rurale. Babai im është nga Zagorja, nëna ime është nga një fshat i Sllavonisë, nga Mrzoviqi, por unë jam Osijekase e lindur dhe ja, qëndrova gjithë jetën në qytet. Dhe dy fëmijët e mi, kam një djalë dhe një vajzë, të rritur edhe ata kanë qëndruar në Osijek, dhe sot jetojnë këtu ne Osijek, kështu që disi mund të themi se jemi një familje Osijekase, sepse... do të thosha se lufta më ndryshoi jetën në një drejtim të rëndësishëm, që është nga ajo private te publike dhe politike, dhe mendoj se njerëzit dhe unë mund ta përshkruajmë veten time si dikush që përvoja luftës e ka vënë atë në një pozicion për të menduar për dhunën, për alternativat ndaj dhunës, për përgjegjësinë personale ndaj asaj sociale dhe politike, dhe kërkimin e përgjigjeve alternative dhe jo të dhunshme. Fatkeqësisht, ato janë ende sfida alternative sociale dhe politike, dhe se do të mund të jetonin në një kulturë tjetër dhe në një mënyrë tjetër t'i zgjidhnin problemet jetësore, sociale dhe politike. Pra, kam lindur në Osijek, ku kam kryer shkollën fillore dhe gjimnazin. Unë kam qenë e para në brezin e prindërve të mi që kam mbaruar shkollën e mesme dhe më pas fakultetin. Pas meje, në të njëjtin gjimnaz, ishin vajza dhe djali im. Ata kanë mbaruar të njëjtin gjimnaz, dhe nipi im më i madhi ka mbaruar të njëjtin gjimnaz, kështu që tashmë kemi një traditë familjare në këtë drejtim. Pra, aty mbarova shkollimin e mesëm, më ka mbetur në kujtesë edhe fëmijëria ime. Babai im ishte zejtar, kishte punëtorinë e tij për prodhimin dhe riparimin e peshoreve. Ai ishte i vetmi zejtar i këtij lloji në të gjithë Kroacinë tonë lindore, kështu që ne jetonim me punën e tij dhe jetonim relativisht mirë. Familja paksa përparoi sepse nëna ime menaxhonte mjaft mirë financat e familjes. "Duam të blejmë një shtëpi, duam të blejmë një makinë, duam të hapim diçka e kështu me radhë, kështu që kemi jetuar në mënyrë modeste. Por sipas një motoje të familjes sime që në fakt e kam marrë nga prindërit e mi: "Ji i sinqertë, jeto nga puna jote dhe solidarizohu me të tjerët – ndihmo të tjerët". Pra, kështu kemi jetuar. Për shembull, ishim tre fëmijë, një motër, një vëlla dhe unë dhe prindërit morën edhe dy fëmijë të tjerë, disa të afërm të largët kur mbetën jetimë. Të gjithë jetonim në një apartament me dy dhoma dhe të gjithë u ngritëm në këmbët tona, prandaj solidariteti ishte mjaft i rëndësishëm për ne.

Jetonim fillimisht në një apartament në oborr, ishte shtëpia e një hebreu, e cila nuk ishte konfiskuar, por, nuk e di si ndodhi, unë isha vërtet fëmijë në atë kohë, prindërit e mi e blenë atë shtëpi prej tij me pagesë. Kalonte me vite kjo, çdo vit paguhej dhe kishte një oborr të mahnitshëm, ashtu me verandë (gjegjësisht hije), me disa pemë të mëdha: kishim një qershi, dy kajsi, një vishnje, me verandë të lartpërmendur ...

Ishte i gjelbëruar, oborri në fakt ishte një kopsht i bukur dhe rruga në atë kohë ishte me kalldrëm. Tramvaji shumë shpejtë filloi të kalonte aty, edhe sot kalon tramvaji aty. Nuk më kujtohen tramvajet që lëviznin me kuaj, edhe pse Osijeku është qyteti që ka pasur tramvajin e parë me kuaj në Kroaci. Pra, kishte kalldrëm, dhe kishte një rresht të bukur blirësh japonezë që kanë gjethe të kuqe, ashtu gjethe të errëta bordo dhe lulëzojnë rozë në pranverë. Ishte një rrugë përrallore, shumë afër parkut të Zrinjevcit, nëpër

të cilën shkoja për në shkollën fillore. Aty luanim hajdutë e xhandar, aty prisnim djem e vajza që të na trembnin dhe disa rendez-vous ishin aty e kështu me radhë.

Mbaj mend që dimrat ishin të gjatë, të ftohtë dhe kishte shumë borë, gjë që më nuk ka, dhe atëherë rruga jonë do të ishte veçanërisht e qetë. Si fëmijë zgjohesha: “Oh, diçka është shumë qetë, qetë. Oh, me siguri ka rënë borë jashtë!” Në atë kohë kishte ende karroca dhe kuaj, kështu që dëgjoheshin kambanat kur shkonin në atë rrugë dhe ne luanim shumë në rrugë dhe në atë Zrinjevc. Fëmijët shoqëroheshin në atë mënyrë, kështu që ne patëm një fëmijëri shumë, shumë të bukur, sa i përket kësaj. Kështu ishte edhe në shtëpi për mua. Nuk mendoj se e kam merituar për ndonjë gjë të veçantë, por atë besim bazë e kam marrë gjithmonë nga prindërit e mi dhe kam pasur vërtet një-farë vetëbesimi përmes kësaj. Më pëlqente shumë të lexoja, mësova të lexoja dhe të shkruaja para shkollës, autodidakte, isha nxënëse e shkëlqyer në shkollën fillore. Në shkollë të mesme vitin e parë mungova paksa dhe ishte një tranzicion mjaft i vështirë për mua, sepse kishim një kujdestare klase të mrekullueshme në shkollën fillore, që nxiste shoqërimin dhe unitetin. Kur mbaroi, kur erdha në shkollën e mesme, në një mjedis të ri, pikërisht ai tranzicioni ishte i vështirë për mua. Qaja, shkoja në shtëpi, në shkollë fillore, te kujdestarja e klasës, e kështu.

Ne ishim shumë të paktë që nuk ishin nga familje intelektualësh, ose ishin të paktë që udhëtonim nga fshati. Pra, nuk kishte asnjë arsye që dikush, nuk e di, të më diskrimi-nonte, mendoj se nuk kishte asnjë arsye, por mendoj se ndjehesha e pasigurt për këtë dhe u desh pak kohë që të isha në gjendje të jem kjo që jam, dhe të mos reagoj në mënyrë reaktive ndaj asaj që nuk dua të jem. Për shembull, mami na mësoi dhe tha: “Ji ajo që je”. Nuk je ajo çfarë lloj atlete ke apo si vishesh, ji ajo që je dhe kjo është më e rëndësishmja. Dhe mos bëj grimasa, mos u pështjell, mos... nuk e di se çfarë. Dhe më vonë kur mësoja për identitetet, atëherë pashë se sa e rëndësishme është të jesh mirë me veten, do të thotë të shohësh që je i veçantë, unik, por në lidhje me të tjerët.

E di që kisha një pallto që fillimisht e vishte babai im, më pas u bë një pallto për nënën time dhe më pas nga palltoja e nënës sime më bënë një pallto (në anën tjetër të pël-hurës), blu e errët, me të cilin e përfundova shkollën e mesme dhe dy vitet e para të universitetit . Pra, ishim nga një familje mjaft modeste, por përsëri kishim gjithçka që na nevojitej. E kishim të parët televizionin në rrugën, lagjen tonë. Atëherë, në klasën e parë të gjimnazit, vendosa dhe i thashë mamit se doja një kutë (bluzë) të më qepte për shkollën. Shkoja në shkollë me kutë. Nuk doja të vishja asgjë tjetër, por vetëm kutën si një gjë: “Epo, nuk do ta bëni bash!”

Kam studiuar në Zagreb. Në fakt në vit të parë isha në Beograd, u regjistrova në gjermanisht dhe anglisht, sepse dështova në provimin pranues për mjekësi. Dështova sepse nuk mësoja asgjë, sepse thosha: “Epo, diplomova me notë 5 ... sigurisht që di mjaft”. Nuk doja asgjë, nuk u përgatita fare dhe rashë. Më pas u regjistrova atë vit në Beograd, që ishte një përvojë e mirë e ndarjes nga prindërit. Jo një përvojë e mirë, por një përvojë e rëndësishme. Ishte mjaft e vështirë për mua kur nëna ime më dërgoi, më la atje në Beogradin e Ri. Isha vendosur në një familje, shoqërohesha me banorët e Osijekut që ishin ende atje, por ishte mjaft e vështirë për mua.

Mbarova në kohë me një mesatare shumë të mirë, 4.3, nuk rashë kurrë në provim dhe linda një fëmijë në vitin e tretë. U martova me Krunën, burrin tim, linda një fëmijë në

vitin e 3-të dhe pavarësisht kësaj, isha një studente shumë e mirë dhe e mbarova mjekësinë në kohë, me rezultate shumë të mira. Më pëlqente shumë ta bëja atë punë. Dhe e bëja shumë mirë, mendoj se e kam bërë mirë. U ktheva në Osijek dhe aty përfundova...

Në fakt që në fillim kisha disa dyshime nëse do të ushtroja mjekësinë familjare, sepse më kujtonte më romantikisht: mjeku familjar, pastaj mjeku në fshat e kështu me radhë. Kam bërë praktikën për një vit në ambulancat e fshatit rreth Osijekut, por më pas vendosa për mjekësinë bërthamore.

Nuk kishte shumë interes për mjekësinë bërthamore, kështu që unë shkova aty pa asnjë, askush nuk më shtyri në veçanti dhe kështu, zura një vend në mjekësinë bërthamore dhe isha vërtet e kënaqur, sepse për mua është një përzierje e të dyjave, diagnostikës dhe fizikës bërthamore që është gjithashtu shumë interesante për mua. Diagnostika është një pjesë kyçe e mjekësisë, në fakt, në çdo proces mjekimi, por ne kemi bërë edhe terapinë e sëmundjes së tiroides, kështu që për mua ishte shumë, më pëlqente ta bëja.

Babai vdiq në vitin ‘89, 1989, e nëna në ‘97. Derisa babai nuk vdiq, ne kishim një lloj ndjenje se babi ishte shumë i butë, se nëna ishte shefi në shtëpi, jo babi. Dhe ne e dinim ashtu, mamasë i kishim inat më shumë, pse ajo duhet të thotë fjalën kryesore e kështu me radhë. E kuptuam më vonë, kur babai vdiq, se ai ishte në fakt shtyllë stabiliteti në familje. Ai ishte një njeri shumë i zgjuar, u shkollua si mjeshtër, por mund të fliste me çdo intelektual. Lexonte rregullisht gazetën, lexonte gazetën çdo ditë dhe ndiqte gjërat. Pra, ishte i zgjuar, intelektualisht dhe ishte një njeri shumë i arsyeshëm, kështu që ai sillej racionalisht në jetën e tij, sillej në mënyrë të arsyeshme dhe përveç kësaj, ishte shumë sharmant, gjë që e bënte mamin tim mjaft xheloze. Ai ishte sharmant, dhe ishte gjithmonë i gëzuar, gjithmonë i gëzuar, gjithmonë i gëzuar, modest. Asnjëherë nuk u ankonte shumë, nuk u ankua për asgjë për veten e tij, modest në njëfarë mënyre dhe ishte ai që na mblidhte familjen rreth këngëve dhe shoqërimit. Shkonim gjithmonë tek ai për kafe dhe... këndonim. Kemi kënduar shumë këngë, të paktën gjatë gjithë programit të mbrëmjes - babai im luante në kitarë, dhe familja e tij ishte e tillë. Ata ishin shumë të varfër, por ai dinte të tregonte që kur vinte si i vogël, mësonte zanatin, një çirak. Kur vinte në shtëpi i thoshin tre-katër fjalë: “Si je, çfarë je... çfarë kënge të re di?” Uleshin dhe këndonin. Ata të gjithë e donin këtë shumë.

Ne jemi një familje katolike. Mami na detyronte të shkonim në kishë të dielave. Ajo gatuante drekën dhe babi shkonte në kishë me ne! Por më tepër ishte se ishim tradicionalisht katolikë, jo nga ata që praktikojnë lutjet e përbashkëta, por më shumë ishte që shkonim në kishë një herë në të diel, të gjitha ato festa i festonim që më pas mbarojnë. Për krishtlindje, të gjithë këndonim vetëm këngët e krishtlindjeve, natyrisht. Këngët e krishtlindjeve përdornim për krishtlindje, e këngët tjera për raste të tjera.

Ai gjithmonë e thoshte lutjen e lirë. Nuk lutej vetëm “Ati ynë” , me këtë përfundonte. E bënte këtë pothuajse me të njëjtat fjalë të thjeshta, por të zgjedhura, të qeta falënderimi për Zotin, të cilin ne nuk e shohim, por praninë e të cilit në jetën tonë e njohim dhe e pranojmë. Me fjalët e tij, ai do ta falënderonte Zotin për atë që kishim dhe morëm në atë vit dhe në atë kohë, atë që na gëzonte dhe na rekomandonte për të ardhmen. Pra, ai për mua ishte, nuk e dija në atë kohë, një dëshmitar i besimtarëve, në fakt. Në këtë kuptim, më vonë kuptova se për mua do të thoshte shumë më tepër sesa, çka po di,

të shkoja në meshë. Pra, në këtë kuptim ai ndikoi shumë tek unë. E kam marrë edhe këtë nga ai dhe jam shumë mirënjohëse për këtë, po.

Ishim shumë të afërt, unë kam qenë e pranishme kur vdiq babai në 1989. Ai vdiq në spital, por unë isha me të pikërisht kur ai vdiq dhe pashë saktësisht, saktësisht. Në atë kohë isha disi i zhytur më thellë në fe, por nuk flisnim shumë për këtë, por babi kishte goditje në tru, nuk fliste, vdiq nga kjo, por ishte i vetëdijshëm. Më tha, në mënyrën e tij, sikur po bënte shaka dhe më tha: “Tani po ngjitem lart”. Unë po ngjitem lart..” Dhe kështu, i mbajta dorën derisa ai vetëm u qetësua. Kështu që unë e përjetova vdekjen e tij dhe e përjetova vdekjen e tij si një lidhje edhe më të ngushtë me të. Dhe pavarësisht se ai fizikisht nuk është aty, jam e vetëdijshme se sa është pjesë e jetës sime, që është i pranishëm në jetën time përmes disa qëndrimeve dhe mënyrave të mia.

Motra ime është njëmbëdhjetë vjet më e madhe se unë, ajo ka jetuar me të edhe më gjatë, dhe më afër. Domethënë ata ishin më të lidhur derisa erdhëm unë dhe vëllai im si fëmijë dhe gjithmonë motra dhe babi mbetën veçanërisht të lidhur. Kur babai vdiq, shumë shpejtë filloi lufta, ne pushuam së kënduari në vitet e nëntëdhjeta. Ne pushuam së kënduari në familje. Dhe kjo sepse motra ime nuk mund ta kapërcente dhimbjen për babin. Sepse, unë nuk di të këndoj, nuk mundja kurse ajo nuk kishte forcë për këtë. Ajo është e mirë, ajo i ka ngjarë babës, kështu që ajo kurrë nuk mori përsipër drejtimin e këngës, përsëri askush nuk e mori drejtimin që ai e kishte. Tani, ndoshta në pesë, gjashtë vitet e fundit, nuk e di, këndojmë herë pas here nga pak, por jo, nuk është si atëherë.

Mami ishte shumë e ngjashme me babin tim në disa pjesë. Ajo ishte gjithashtu një grua që kishte vetëm pesë klasë të shkollës fillore, shumë e zgjuar, shumë e arsyeshme. Kolegët e mi vinin në shtëpinë ku jetonim, natën e vitit të ri. Nuk kishte një person me të cilin ajo nuk mund të fliste në një fushë loje të barabartë, si të thuash. Ajo ishte shumë ndershme, si moto e përbashkët familjare kishim njohjen, që ishin vlerat e babait dhe nënës sime. Ajo që ishte dukshëm e ndryshme ishte se ishte shumë ambicioze në aspektin e sipërmarrjes. Aty të dy në një farë mënyre funksiononin mirë, sepse mami tërhiqte dhe babi ishte baza që fitonte në fakt para, por ishte edhe vend keqkuptimi, sepse ky ishte presioni i tij, kështu. Kështu që, përveç kësaj, mami, meqë ai ishte sharmant dhe si i tillë, person people oriented, mami në fakt ishte edhe qesharake, por ishte më serioze, nuk ka shaka, çfarë loje letrash, ne të luajmë letra, çfarë loje letrash nuk bëhet fjalë, ajo ishte e rreptë.

Për shembull, u martova si studente, linda dhe u divorcova, asgjë nuk ishte e mirë për të, as që u martova, as që u divorcova. Por ishte me mua. Ajo më tha: “Ja, është rruga jote, ti zgjidh, unë do të jem aty me ty, ti e di çfarë po mendoj, nuk kam pse të them”, por ajo ishte pranë meje.

Kur linda djalin e linda në një lidhje jashtëmartesore, e cila nuk ishte shumë e zakonshme në atë kohë, por nuk më tha kurrë: “Si do të kesh tani pa baba një fëmijë, por nuk ke”. Ajo nuk e përmendi kurrë këtë dhe ne të gjithë ndjeheshim që, edhe në vendime tona të tilla, ajo ishte me ne. Le të themi, një nga vajzat e motrës jetonte në një marrëdhënie lezbike për një kohë në jetën e saj. Ne jemi një familje katolike, e shtresës së mesme, ju e dini si ishte, sidomos në atë kohë, ishte dyzet vite më parë ose më shumë, ndoshta pesëdhjetë vite më parë. Nëna ime tha: “Kjo është çështje private e Zllatës. Ajo është gjithmonë e mirëseardhur në shtëpinë time, ajo është

gjithmonë e mirëseardhur". Pra, ajo ishte modeli moral për ne dhe kjo do të thoshte shumë.

Motra, që është më e madhe, vëllai, që është më e vogël, dhe unë ne jemi ende të lidhur edhe sot e kësaj dite. Motra ime mori një rol të caktuar si nënë – ajo shumë lumturohej që ne të lindnim, njëra dhe tjetra, dhe ajo disi e vendosi veten, dhe e vendos edhe sot, ndoshta jo më, si një nënë. Ai lloj raporti ishte se ajo kujdesej për ne, që na nxirrte, që ishim gjithmonë me të, sidomos vëllai im, edhe ai kishte disa kriza në jetë dhe kështu i tregonte gjithmonë gjithçka, edhe sot e kësaj dite.

Nuk ka ditë që të mos e shohim ose të paktën të dëgjojmë njëri-tjetrin, ndaj jemi të gjithë të lidhur. Unë me motrën kurrë nuk do të thosha se kemi pasur keqkuptime. Ajo më ndihmoi me vajzën time. Kur po mbaroja studimet, në vitin e fundit, Sonja ime ishte me të, ndërsa unë isha në Zagreb dhe vija vetëm në fundjavë. Kështu, ajo më ndihmoi të mbaroja studimet, dhe për një vit kujdesej për vajzën time. Në këtë kuptim, ne të dyja kemi qenë gjithmonë mirë, kemi qenë gjithmonë shumë të lidhura, bukur. E tash, kur unë jam në dekadën time të 8-të, dhe ajo është në të 9-tën, ajo ndjenjë që ajo është më shumë nënë është zhdukur, tani po i kthehet më shumë asaj, tani ajo është më pak e lëvizshme, kështu që ju duhet ta vozisim pak përreth e kështu. Kryesisht, tani është më shumë një marrëdhënie motrash.

Vëllai trashëgoi dyqanin e të atit. Ai ishte gjithmonë një fëmijë pak i ndërlikuar. I ndjeshëm, i përlotur. Do të thosha se nga ne të tre, ne dyja dolëm të forta, secila në mënyrën tonë dhe ai doli i brishtë. Për çfarë arsye dhe si nuk e di. Kryesisht, ai kishte probleme me alkoolin për një kohë të gjatë, dhe tani e ka. Ai nuk pi më, ka mbi 20 vjet që nuk pi, mendoj se nuk ka pirë për 26 vjet, por është ende, le të themi, pjesë e identitetit të tij. Ai është shumë aktiv në Alkoolistët Anonimë. Aty i ndihmon të tjerët dhe aty gjeti në fakt kuptimin e tij, rolin e tij në jetë, por vazhdimisht ishte në një lloj nevoje dhe krize etj. Por ne qëndruam, asgjë nuk na ndau dhe asgjë nuk do të na ndante në një mënyrë që të prishte marrëdhënien tonë. Ka qenë një periudhë mjaft e vështirë prej vitesh. Por ne qëndruam të lidhur dhe tani jemi të gjithë ende në një grumbull.

Në familjen tonë për Luftën e Dytë Botërore flitej ndryshe nga narrativi publik, ai socialist. Kështu që ne morëm më shumë informacion. Nënës sime i pëlqente të fliste. Babi më dobët, por mamasë sime i pëlqente të fliste për luftën dhe përmes tregimit të saj ne pamë shtresat e ndryshme, në fakt, të gjithë situatës. Ajo kishte historitë e saj për mbijetesën, si ajo me motrën time, motra ime lindi në '38, pra para luftës, ishte dy vjeçe kur filloi lufta...

Ata ishin në Osijek, ashtu është, dhe kur shpërtheu lufta, babai im ishte në shërbim të rregullt ushtarak, gjë që duhej ta bënin të gjithë të rinjtë në atë kohë. Ai ishte në Boka Kotorska duke kryer shërbimin ushtarak kur shpërtheu lufta. Dhe, ju e dini se lufta zgjati 6 ditë, Mbretëria e atëhershme e Jugosllavisë kapitulloi dhe ushtria e rregullt jugosllave u shpërbë. Babi, si rekrut i shpërbërë, po kthehej nga Boka Kotorska në drejtim të Osijekut, dhe ishte në Zagreb, jo vetëm ai, kishte më shumë ushtarë, rekrutë, që u shpërbënë, por askush nuk i shpërbeu zyrtarisht...

Ai po udhëtonte drejt Osijekut, dhe në Zagreb gjermanët bllokuan, gjegjësisht i mbyllën vagonët e tyre dhe atje në Osijek u deportuan përmes urës hekurudhore, përmes Hungarisë, në Gjermani, në kampet e burgut. Babai im ishte në Gjermani, në

kampet e burgut. Babai im ishte në Gjermani, në kampe, ndërsa nëna mbeti vetëm me fëmijën. Dhe mamaja tregonte ato histori se si mbijetoi. Si furnizohej me ushqime, si erdhën partizanët, si erdhën ustashët, si, kur ishte në Zagorje te prindërit e babait tim, bashkë, si erdhën partizanët atje, tani ustashët, e vranë këtë, atë. Aty dëgjuam histori jete se si udhëtohej, si jetohej, si ishte e gjitha bashkë.

Një nga historitë e nënës sime është se ajo fshehu një nga partizanët në shtëpinë e saj, por ajo gjithmonë thoshte, kur fliste, thoshte "djemtë tanë", dhe ne nuk e kuptonim me vite se çfarë do të thoshte "djemtë tanë" derisa ... Ajo e kishte fjalën në fakt për djemtë kroatë. Po, në fakt ajo nënkuptonte djemtë kroatë, mbrojtësit e atdheut, dhe ne mendonim "djemtë tonë partizanë", sepse dëgjonim një narrativë tjetër në atë kohë në shkolla e kështu me radhë. Gjithsesi, ne kemi dëgjuar për të.

Në vitin 1944, babait tim u kërkua nga gjermanët nga kampet e burgut se kush do të vinte në Kroaci për të mbrojtur Kroacinë. Kështu, në moshën 18-vjeçare ra në robëri dhe u mbajt aty dhe pas tre vjetësh, nga '44-ta u rekrutua nga gjermanët. Në fakt, ai u kthye nga kampi me uniformë gjermane në '44. në Osijek. I mobilizuan, i veshën, por ai u sëmur rrugës duke ardhur këtu. Aty u trajnua për teknik aeroporti, për shkak të profesionit të tij. Rrugës për në Osijek, mendoj se u sëmur, erdhi në Osijek, erdhi në spitalin ushtarak dhe aty priti përfundimin e luftës. Të gjithë "shërbimin ushtarak" dhe përfundimin e luftës e kaloi në një spital gjerman si ushtar gjerman, në fakt. Në atë kohë, të paktën unë dhe motra, nuk folëm shumë me vëllain, por na vinte keq, më vinte keq që ai nuk ishte në anën e duhur, në anën antifashiste. Edhe pse kemi folur për këtë në kuptimin se si ndodhi, pse ishte kështu dhe kështu. Babai im nuk e fshehu këtë kurrë. Ne kishim foto që e tregonin me atë uniformë, dhe ai menjëherë raportoi atje, kur partizanët e morën pushtetin, ishte në spital, këtu në Osijek. Domethënë, ndaj tij nuk u zhvillua procedurë gjyqësore apo nuk u gjykua. Ai këtë nuk e fshihte. E interpretova me vete këtë si një histori se ku mund të të çojë jeta gjatë luftës, si këtu dhe atje.

Tjetër gjë, prindërit tanë nuk na ngritën kurrë kundër antifashizmit, na edukuan të vlerësonim faktin që shteti ishte një shtet social dhe që në atë shtet u jepej mundësia të fitonin diçka dhe të punonin, dhe që fëmijët e tyre të shkolloheshin. Pra, kemi marrë një marrëdhënie pozitive, jo nga frika, jo nga ndonjë poltronizëm apo diçka tjetër, por në fakt nga ai qëndrim i arsyeshëm. Ata e panë me logjikë se ishte diçka e mirë për ne, pa u futur as në Parti... edhe pse morën ftesa për t'u anëtarësuar në Partinë Komuniste. E kanë ftuar edhe mamanë time. Kryesorja, asnjëri prej nesh nuk u përfshi kurrë në parti dhe nuk ishte aktiv, por nga sjellja dhe qëndrimet e prindërve dallonim se ata e vlerësojnë vendin ku jetojnë, se kjo do të thotë diçka për ta.

Nuk e kam parë kurrë, por kur ishte pranvera kroate e '71, babai im ishte anëtar i Amës Kroate (Matica Hrvatska) dhe më pas e vunë nën vëzhgim të posaçëm, e kontrollonin origjinën e pasurisë, si një lloj mbikëqyrjeje speciale mbi të, që ndoshta ta akuzonin. Ata nuk gjetën asgjë, do të thotë, ne vërtet nuk kishim ndonjë gjë të madhe. Babai im i mbajti të gjitha letrat me kujdes, kështu që ata nuk gjetën asgjë, por kishte një ndjenjë presioni dhe padrejtësie. I kërkuan p.sh., që ai të fuste në hartën e pronave të tij, apo si quhej atëherë, nuk e di, faktin që më ka shkolluar dhe që Sonja ime, fëmija im atëherë, që më ka ndihmuar financiarisht mua dhe vajzën time deri sa mbarova fakultetin, kështu që na goditi vërtet si presion dhe si e padrejtë, dhe si një goditje e ulët. Ja, kështu e kemi përjetuar të gjithë disi, ashtu si ai. Por jo, jo, nuk kam ndjerë

kurrë se prindërit e mi ndiheshin të kërcënuar ose më pak të vlefshëm ose diçka tjetër. Ne ishim një familje e respektuar. Ne fituam një reputacion shoqëror në qytet.

Babai foli për disa gjëra, se si ishte me ata polakët, si ishte, si mbijetuan, nëse arrinin të merrnin lakër nga dikush e kështu me radhë, më shumë për këtë. Ai foli për përvojat, për vështirësitë e vetë kampit, por nuk fola kurrë hapur me të që ta pyes, për shembull: “Babi, pse më në fund pranove të të rekrutonin?”. Ai ka thënë se kur i kanë mobilizuar, i kanë thënë se do t’i bashkohen ushtrisë kroate. Prisnin të merrnin edhe uniformat e mbrojtësve të atdheut dhe se u rebeluan, se nuk donin të merrnin uniformat gjermane, se u rebeluan të gjithë, se nuk donin të merrnin uniformat gjermane, por megjithatë u shfaq me uniforma gjermane. Nuk kam folur kurrë me të për këtë, në këtë kuptim, as si e rritur, mjaft e pjekur për të më thënë mendimet e tij politike në atë kohë: Mbi çfarë baze merrte ai vendime të tilla? Çfarë po mendonte? Kush e këshillonte? Apo çfarë dilema kishte apo...? Unë kurrë nuk e pyeta atë. Dhe gjithmonë më vjen keq që nuk e bëra.



Rinia, studimet, martesa, fëmija

Qëndrimi im ishte se lufta nuk është vetëm bardh e zi, vetëm krim dhe drejtësi, apo si të them, dhe mbrojtje, por është kaq e shtresuar, ka kaq shumë histori njerëzore dhe se është e rëndësishme të bëhet dallimi mes asaj historie njerëzore. Si mund ta dënoj tani nënën time se nuk ishte, nuk e di, antifashiste, kur e di që habitusi i saj ishte "ji i ndershëm" dhe ajo ndihmoi, ja, këtyre u ndihmoi, mbajti një luftëtar spanjoll për 2 muaj, ai u fsheh te ajo dhe kështu. Por ajo ndjeu më shumë përkatësinë e saj, për sa i përket identitetit, ndaj korpusit kroat.

Kur vëllai im u martua, e dashura e tij ishte nga një martesë e përzier. Edhe familjarët e saj ishin partizanë. Familjarët e saj ishin në partizanë. Babai i saj ishte serb dhe nëna kroate. Pra, ajo ishte ateiste, madje nuk ishte e pagëzuar. Pra, prindërit e mi nuk shfaqeshin që t'ia ndalonin vëllait tim këtë. Ose, motra ime u martua me një serb. Po kështu, s'kishte asnjë dyshim se kjo ishte arsyeja pse ata tani do të thoshin "mos", por ata e ndjenin, mund të them për veten time, unë ndjej se i përkas trupit kombëtar kroat. Unë jam kroate, por kjo nuk do të thotë se nuk i vlerësoj serbët apo të tjerët apo se do të ishte pengesë për mua të vlerësoja dhe respektoja këdo dhe të jetojmë së bashku dhe në mënyrë të barabartë. Kështu, kur gruaja e vëllait tim, kunata ime, ishte ulur me ne, ajo na paralajmëroi se kur nëna ime tregoi ato histori se si i mbijetoi luftës, se asaj iu deshën dy vjet për të kuptuar se çfarë donte të thoshte mami me "djemtë tanë". Dhe ne e kemi mësuar që në moshë të vogël këtë, kështu që ajo e përsërit gjithmonë se si ka udhëtuar me tren, dhe i erdhi, ajo thotë: "Mu deshën dy vjet të kuptoja se kur vjehrra thotë 'djemtë tanë ', ajo po mendon për kroatët – mbrojtësit e atdheut dhe ustashët".

Në vitin 1968, kur kishte demonstrata studentore, unë isha atje në Osijek, por kjo ndiqej. Kemi dëgjuar pak për atë që po ndodh në Zagreb e kështu me radhë. Unë isha në Osijek dhe pastaj, siç thashë, nuk u regjistrova në universitet në Zagreb, por në Beograd. Unë isha në Beograd atë vit, ishte në '68 në '69, por pothuajse gjithçka ishte tashmë aty. Në fakt, unë doja të përfshihesha, tashmë kisha vendosur që doja t'i bashkohesha asaj lëvizje studentore, por tashmë kishte marrë fund.

Ishte një lëvizje globale, erdhi nga jashtë, por edhe në Kroaci (RFSJ Jugosllavi), a po. Mendoj se ideja kryesore e atyre demonstratave ishte lufta për lirinë e universitetit, për pavarësinë e universitetit dhe të drejtat e studentëve. Në fakt që universiteti të ishte i pavarur, të kishte status të pavarur dhe të drejtën për të folur publikisht. Megjithatë, në atë kohë unë isha plotësisht e paangazhuar, e pavetëdijshme dhe kështu e paangazhuar. Unë absolutisht nuk i përcillja as, jo, isha vërtet anash nga kjo. E kam pak të vështirë të përgjigjem se tani, do të thosha, po, në vitet e mija të shkollës së mesme, absolutisht, kam jetuar për dashurinë time të parë.

Pas atij viti të parë në gjimnaz kur e kisha pak të vështirë të adaptohesha, kaluam mirë, pata dashurinë time të parë, platonike, të madhe. Kam pasur një pjesë kaq të shkujdesur, apolitike të rinisë sime. Pra, do të thosha që, nëse e mendoj tani, të rinjtë e sotëm janë shumë më të përfshirë.

Ose ndoshta jo i përfshirë, më mirë do të thosha të kontaminuar me politikë, politik-bërje, dhe për shkak të medias, sepse gjithçka shihet, dëgjohet në rrjete, rrjete

sociale e kështu me radhë. Atëherë nuk ekzistonin këto. Nëse nuk do të kishit një mjedis shtëpie ku të njiheshit me tema socio-politike, mund ta anashkalonit - pavarësisht nga indoktrinimi i pushtetarëve.

Nuk ndjeva presion, ndoshta ky është një tregues, nuk e di. E kam te vështire ta them tani, nuk e di a do ta firmos një ditë, kështu e mendoj tani, që askush nuk të detyroi, të bëri presion që të përfshiheshe në diçka. Thjesht, ju mund të ishit mënjanë, duke jetuar jetën tuaj. Në këtë kuptim, nuk kishte mbretërim terrori, ndonjë diktaturë që do të hynte në çdo pjesë të jetës suaj, në shtëpinë tuaj, në privatësinë tuaj. Unë nuk e kam përjetuar këtë. Mund ta kisha qëndruar anash kësaj dhe të ndihesha mirë, nëse do të kisha ditur për atë kontekst. Do të thosha se ajo që dija atëherë, si një person i tillë krejtësisht i pareferuar dhe i papërfshirë, ishte se nëse do të përparosh, duhej të futeshe në Parti. Por nëse vendos mos ta bësh këtë, atëherë përsëri, asgjë.

Ky ishte një problem, ashtu si me gratë. Nuk bëhet fjalë për diskriminim ndaj gruas, por nëse do një post dhe je grua, shanset e tua janë shumë më të vogla se të një burri dhe prapë duhet të hysh në Parti. Kështu ishte, në atë kuptim unë merrja vendimet: të shprehem lirshëm se isha besimtare edhe si nxënëse e klasës së tetë e më tej dhe si mjeke; dhe kur isha tashmë mjeke, se nuk do të hyja në partinë komuniste për të avancuar në postin e shefes. Pavarësisht se kam qenë, thoshin, specializantja më e mirë e të gjitha gjeneratave. Unë isha e para nga të gjithë në departament që magjistrova, edhe pse isha mjekja më e re. Kishte kolegë më të vjetër se unë. Por që të bëhesha shefe e departamentit më duhej të futesha në Parti. Por unë thashë se nuk më intereson kjo. Pra, i pranova ato rregulla loje në atë mënyrë që e vlerësova mundësinë për të zgjedhur dhe vendosa për lirinë time personale. U ndjeva mirë me këtë. Por kjo do të thotë se kam lejuar që rregullat e lojës të vazhdojnë.

Unë nuk u rebelova kundër atyre praktikave. Kisha mundësinë të zgjidhja, por nuk u rebelova kundër rregullave të tilla dhe në fakt e kuptova më vonë. Atëherë e mora qëndrimin në vijim: pra, nëse kam vendosur se do të zgjedh privatësinë dhe lirinë time dhe se nuk do të hyj në Parti për të avancuar, dhe nuk do të luftoj kundër atij sistemi, atyre rregullave, atëherë nuk kam të drejtë për të kritikuar. Nëse dua të kritikoj, duhet të luftoj kundër saj.

Gjëja e rëndësishme që mësova kur shkova për të studiuar në Beograd ishte se nuk është e lehtë të ndahesh nga prindërit. Në atë periudhë tranzicioni, miqtë e mi kishin shumë rëndësi për mua. Ne nga Osijeku mblidheshim atje, jo sipas linjave politike, por thjesht sepse, ja ku jemi, tani kemi ardhur në një qytet të madh, prandaj jemi bashkë, kjo do të thoshte shumë për mua. E pashë se sa shumë do të thoshte kjo miqësi dhe lidhje për mua.

Megjithatë, kuptova edhe diçka që në praktikë atë që dija, njerëzit flisnin dhe nuk mund të them nëse e besoja apo jo, por e përjetova atje në universitet. Unë, nga e folmja dhe gjithçka, dihej se unë vij nga Kroacia dhe se jam kroate. Ashtu edhe jam shkruar vetë. Por në lëndën e sociologjisë sipas disa deklaratave, tani nuk më kujtohet saktësisht se çfarë tha ai profesor, dhe si e tha, por kryesisht papritmas pashë se atje më shihnin si një kroate i ardhur në Beograd. Dhe kjo më befasoi. Sikur të jem dikush, jo tamam trup i huaj, por diçka që pranohet me habi: “Nga erdhe këtu te ne?”. Dhe kjo më bëri të vetëdijshme se sa ekziston, edhe pse unë nuk e perceptoja kështu. Kur shkova në Beograd, absolutisht nuk e mendoja “tani po shkoj, ku po shkoj, pse po

shkoj?". Shkova për shkak të lëndës që mund të regjistrohesha atje e nuk mundesha të regjistrohesha këtu. Por nuk kam pasur asnjë paragjykim apo frikë të tillë, "si do të vij në Beograd tani dhe si do të më presin se jam kroate?" Dhe vendosa të shkoj në Beograd sepse afatet e regjistrimit në Kroaci kishin përfunduar, dhe atje kishte vende dhe nuk doja të humbisja një vit, të humbisja kohë. Në çdo rast, është e dobishme të mësosh gjuhë. Kështu që erdha rastësisht, por nuk më shkoi mendja se mund të shkoja diku ku nuk përkas sipas habitusit tim. Kryesisht, mora atë mesazh se ishte, ha, befasuese. Madje mora notën e shkëlqyer atje, e përgatita mirë atë sociologji, por "nga erdhe këtu?" Epo, ky ishte në fakt një mësim për mua, pak hapje sysh. Unë e mbarova atë vit. Doja ta përfundoja vitin, por e dija që do t'i kthehesha mjekësisë. Për shkak të mjekësisë dhe të dashurit tim mjek.

Kam studiuar dhe kam jetuar në Zagreb pesë vjet dhe më pas kam jetuar edhe një vit kur kam qenë në specializim, viti i fundit i specializimit dhe pas diplomimit. Aty kam kryer edhe studimet pasuniversitare. Zagrebi ka qenë gjithmonë një qytet i dashur për mua, e kam njohur që më parë, sepse tezja dhe gjyshja ime, nga ana e babait, jetonin në Zagreb, kështu që shkoja atje për pushime e kështu me radhë. Pra Zagrebi ishte një qytet i dashur për mua. Mirëpo, unë nuk kam jetuar si student në Zagreb gjatë kohës që studioja, do të thosha se kam jetuar në një dhomë studentore.

Pra, kjo marrëdhënia ime, me burrin tim, ishte mjaft intensive dhe menjëherë fillova të studioj shumë seriozisht, dhe fakulteti i mjekësisë është shumë kërkues me shumë ushtrime dhe shumë kollokiume. Pra shkoja rregullisht në ligjërata, në ushtrime, shkoja rregullisht në provime, në kollokiume, gjithçka që kisha dhe nuk kam pasur realisht një jetë shoqërore. Unë nuk e kam jetuar Zagrebin. Unë në fakt isha vetëm me librin dhe kaq. Në fakultet, në klinikë, nga klinika e kështu në rreth. Gjithmonë më vjen keq për këtë. Nëse do të kisha qenë në një shoqëri tjetër, dikush që ishte më i orientuar nga kultura, të dilte jashtë, ndoshta do të përshtatesha, por burri im ishte më shumë i interesuar të ishim ne të dy vetëm, dhe unë isha e fokusuar në fakultet, kështu që thuajse nuk e kam përjetuar realisht Zagrebin si studente.

E takova burrin tim pas maturës. Ai ishte tashmë në Zagreb, ai ishte në vitin e 4-të të mjekësisë dhe unë vetëm atëherë erdha pas tij. Dhe kur e regjistrova vitin e 3-të, në vitin '71 lindi Sonja ime.

U martova zyrtarisht dhe bëmë dy dasma. E kishim një në Zagreb, ishin vetëm prindërit dhe kumbarët e mi. Nuk ishte madje as nëna ime, por vetëm babi dhe motra, kunati dhe tezja. Vetëm jemi regjistruam atje në zyrën e gjendjes civile, dhe hëngrëm darkë, dhe pastaj atë verë e kishim në Osijek, pastaj u martuam në kishë dhe kishim krushq. Po. Pas përfundimit të studimeve u ktheva në Osijek. Ndërkohë u ndava nga burri. Ai ishte një nga jashtëzakonisht të talentuarit, intelektualisht shkonte në nivelin më të lartë, por ishte gjithmonë në buzë, atë që njerëzit e quajnë "i çuditshëm". Mua më paraqiste presion të madh psikologjik dhe, si të them, më kushtoi shumë kjo. Pastaj ai shkoi në ushtri, duhej të shkonte, se atëherë ishte e detyrueshme. Kur ai u largua, në fakt unë, vetëm kur ai u largua, pashë se në çfarë presioni psikologjik dhe regjimi isha. Unë thjesht nuk mund ta detyroja veten të ishim bashkë kur ai të kthehej nga ushtria. Nuk mund të isha më aty. Më ngulfiste, më ngulfiste shumë. Nëse do të kisha qenë më e vjetër, nëse do të isha më me përvojë, mund ta përballoja, por në atë kohë më dukej e vetmja rrugëdalje për të mbrojtur veten dhe fëmijën. Unë insistova për këtë, kërkova divorcin.

Ai ma ka lënë mua kujdestarinë e vajzës, aty nuk ka bërë asnjë problem. Shpejt u zhvendos në Gjermani. Ne kemi qenë gjithmonë në marrëdhënie të mira, por ai ishte rrallë me vajzën e tij. I mbeti njëfarë lidhje, ndaj edhe ajo shkonte tek ai. Unë nuk e kam përjetuar kështu, as nuk e kam interpretuar ndaj fëmijës tim, në kuptimin që është keqdashës, se është njeri i keq apo diçka e tillë, por thjesht se mënyra dhe stili, mënyra dhe sjellja e tij në jetë, unë nuk mund ta duroja, dhe se unë për këtë arsye kërkova divorcin. Kështu ne mbetëm në marrëdhënie të mira dhe në këtë kuptim Sonja ime kishte kontakte me të atin. Ajo shkoi për ta marr në Gjermani kur vdiq. Ajo qëndroi me të një vit kur filloi lufta në Kroaci dhe si vajzë e vogël i shkonte për vizitë dhe u njoh me të.

Kryesorja, ne jetonim kështu që mami dinte të dërgonte me autobus, ose të sillte ushqime, të cilat ajo i përgatiste, që të ishte më lirë. Ne paguanim apartamentin, dhe unë vishesha shumë modeste, nuk kishte modë, thjesht të kisha gjithçka që më duhej. Domethënë e kisha atë pallton në universitet që më vjen keq që nuk e kam mbajtur, sepse e doja shumë dhe ndihesha shumë bukur në të, dhe ishte palltoja që e vishte babai, nëna ime, dhe në fund edhe unë.

U ktheva në Osijek, pastaj ekziston, duhet të bësh praktikë për një vit. E kam bërë në praktikën e përgjithshme, sepse kështu bëhet dhe shteti ka siguruar që ne të kemi një vend për të bërë praktikën. Do të thotë të bësh pak praktikë dhe më pas t'i nënshtrohesh provimit të shtetit. E këtë e kam bërë në ambulancat e fshatit. Kam qenë në Dardë, në Lug dhe në Beli Manastir, në ato tri ambulanca për bërë një vit si praktikante, dhe pastaj ndërkohë kam...

Merrja rrogë, por nuk ishte rrogë e vërtetë mjeku, pak më pak, shumë më pak, por gjithsesi diçka paguhej. Më pas fill pas praktikës, sapo mbaroi ai vit, fillova menjëherë specializimin që është në klinikë. Atëherë nuk ishte klinikë, por spital i përgjithshëm. Më vonë u bë klinikë. Tre vite specializim në departamentin kryesor të Mjekësisë Bërthamore në Spitalin e Përgjithshëm të Osijekut dhe vitin e fundit në Klinikën për Mjekësi Bërthamore në Rebro në Zagreb. Pas specializimit vazhdova në Osijek dhe mora titullin primarius, mendoj që ishte viti 1992. Unë në atë kohë tashmë isha shefe e Departamentit të Diagnostifikimit në Klinikën e Mjekësisë Bërthamore dhe Patofiziologjisë, kur Spitali i Përgjithshëm u shndërrua në klinikë. Për të pasur titullin primarius duhej të kishe 10 vite stazh dhe të kishe 20 punime profesionale apo shkencore. Pra, i kisha të dyja, kështu që mora titullin primarius.

Kam punuar në klinikën për mjekësi bërthamore dhe patofiziologji të Spitalit Klinik të Osijekut deri në vitin '97, pra kisha 17 vite stazh të punës, gjegjësisht më janë njohur 23 vite stazh të punës, sepse ishte punë në sferën e rrezatimit, prandaj ishte stazh i beneficuar. Kryesisht, deri në '97 kam punuar në Klinikë. Në vitin 1997, lashë punën time për të punuar ekskluzivisht për riintegrimin paqësor, për përfundimin paqësor të luftës, këtu në Kroacinë lindore.

Përgjithësisht, qëndrimi im ishte se, nëse mund të zgjidhja, nuk do të zgjidhja një rrugë të tillë, nuk do të hyja në partinë komuniste për arsye pragmatike, që do të thotë se ndoshta nuk do të isha shefe e departamentit e të ngjashme. Gjithashtu vendosa që të mos i bashkohem partisë komuniste me qëllim që të punoj për ndryshimin e sistemit dhe këtë e kam menduar disa herë. Ka dy arsye kryesore për qëndrimet e mia.

Së pari, për mua ishte e rëndësishme të kisha lirinë e zgjedhjes - askush nuk më detyroi të bëja atë hap të anëtarësimit në parti dhe nuk përjetova asnjë sanksion sepse nuk doja. Mund të isha besimtare, mund të isha mjeke, mund të isha shkencëtare, edhe pse nuk isha në Parti. Mund të ushtroja profesionin tim, mund të përparoja në profesionin tim, mund të studioja. Sapo erdha në departamentin e mjekësisë bërthamore, filloi formimi im profesional, u nxita të shkruaj punime shkencore dhe profesionale, shkoja çdo vit në kongrese, më jepej mundësia të regjistrohesha dhe të mbaroja studimet pasuniversitare. Kështu, përveçse isha specialiste e mjekësisë bërthamore, u bëra edhe Magjistër i Shkencave. Mora magjistraturën, sot nuk ka më diplomë shkencore dhe titull magjistër i shkencave pas së cilës pasonte doktorata në shkenca – sot shkon direkt në doktoraturë. Unë kisha fëmijën tim dhe më pas fëmijët, një punë që e doja dhe kjo më mjaftoi.

Së dyti, isha e vetëdijshme për dimensionin social të rendit politik në atë kohë - pasi prindërit e mi, të dy vinin nga fshati nga familje pa tokë, ne mundëm të fitonim pronë,

reputacion, arsim të lartë, kujdes shëndetësor me punën tonë...

Kur e mendoj sot - kështu do të prezantohesha jashtë vendit: vij nga Jugosllavia, nga Republika e Kroacisë - kështu që isha mirë me të dyja këto identitete. Por lufta më ndërgjegjësoi – dhe pyes veten edhe sot nëse isha naive apo nëse një drejtim dhe përfundim tjetër kishte një shans te ne njerëzit e thjeshtë?!

Nuk mendoj se mendimi im ndryshoi ndjeshëm pas vdekjes së Titos, por u ndërgjegjësova se nuk ka më asnjë autoritet që na mban të bashkuar, dhe se strukturat që trashëguam, se nuk funksionojnë realisht, se kishte një boshllëk pa autoritetin që kishte Tito.

Ai ma ka lënë mua kujdestarinë e vajzës, aty nuk ka bërë asnjë problem. Shpejt u zhvendos në Gjermani. Ne kemi qenë gjithmonë në marrëdhënie të mira, por ai ishte rrallë me vajzën e tij. I mbeti njëfarë lidhje, ndaj edhe ajo shkonte tek ai. Unë nuk e kam përjetuar kështu, as nuk e kam interpretuar ndaj fëmijës tim, në kuptimin që është keqdashës, se është njeri i keq apo diçka e tillë, por thjesht se mënyra dhe stili, mënyra dhe sjellja e tij në jetë, unë nuk mund ta duroja, dhe se unë për këtë arsye kërkova divorcin. Kështu ne mbetëm në marrëdhënie të mira dhe në këtë kuptim Sonja ime kishte kontakte me të atin. Ajo shkoi për ta marr në Gjermani kur vdiq. Ajo qëndroi me të një vit kur filloi lufta në Kroaci dhe si vajzë e vogël i shkonte për vizitë dhe u njoh me të.

Kryesorja, ne jetonim kështu që mami dinte të dërgonte me autobus, ose të sillte ushqime, të cilat ajo i përgatiste, që të ishte më lirë. Ne paguanim apartamentin, dhe unë vishesha shumë modeste, nuk kishte modë, thjesht të kisha gjithçka që më duhej. Domethënë e kisha atë pallton në universitet që më vjen keq që nuk e kam mbajtur, sepse e doja shumë dhe ndihesha shumë bukur në të, dhe ishte palltoja që e vishte babai, nëna ime, dhe në fund edhe unë.

Nuk isha në dijeni të mundësisë së luftës. Më vjen keq dhe më vjen turp ta them, por vërtet nuk e dija se do të bëhej luftë, ndërsa shikoja breshëritë që fluturonin nga drejtimi i vendbanimit periferik të Tenjës. Unë po shikoja, jo nga këtu, por nga shtëpia e prindërve të mi, dhe ende mendoja “Oh kuku”, kinse “po bëjnë shaka, e pamundur”. Lufta tashmë po vijonte, në fakt lufta tashmë po vijonte. Nuk e kuptova këtë. Vetëm sepse isha kaq e larguar nga gjithçka, për fat të keq.

Për herë të parë u përballa me një situatë të paraluftës në vitet ’90 kur kthehesha nga Sukoshani. Ne kemi një shtëpi atje në Sukoshan afër Zadras. Qëndrojmë atje gjithë verën dhe pastaj kthehemi, kemi shkuar përmes Kninit me tren, unë me fëmijët e mi, me ata të dy. Të armatosur me disa pushkësh të vjetra, serbët vendas ndaluan trenin. Ishte në vitin ‘90. Në stacionin lokal në Knin dëgjuam, në ato transistorë të vegjël, në kupe e kishte dikush, se ustashët po vinin me helikopterë, se ustashët po vinin për të sulmuar serbët dhe se serbët vendas po thërrisnin gratë dhe fëmijët të iknin diku, dhe ata do t’i mbronin.

Pastaj serbët filluan të vendosnin barrikada në hyrje të fshatrave të tyre. Rreth Osijekut ka fshatra serbë dhe kroatë. Përpara fshatrave të tyre, që të mos kalohet dot, pra i mbrojnë bashkëfshatarët nga ustashët që po vijnë. Pastaj 1 korriku ‘91. Në vitin

2010, kreu i policisë së Osijek-Baranjës, Josip Reihl-Kir, u vra kur shkoi për të negociuar me serbët vendas në vendbanimin periferik të Tenjes. Përshkallëzimi i mëtejshëm i papritur i tensionit dhe sa më sipër ishte pas vrasjes së policëve në afërsi të fshatit Borovë. Ja, kështu e pashë që shpërtheu lufta në “oborrin e shtëpisë”.

Po, atëherë më 1 korrik 1991, Josip Reihl-Kir u vra në Osijek. Reihl-Kir ishte kreu i policisë së Osijek-Baranjës. Ai ishte 36 vjeç. Ai u vra nga një pjesëtar rezervë i njësisë së tij policore kur shkoi për të negociuar me serbët vendas në Tenje. Ai tha se “përderisa unë jam shef policie, serbët nuk do të luftojnë kundër kroatëve këtu”. Nuk është se nuk ishte i vetëdijshëm se lufta po vinte, por nga pozicioni i tij i përgjegjësisë për sigurinë dhe bashkëjetesën paqësore të njerëzve për të cilën kujdesej si shef policie, tha se nuk do të lejonte gjakderdhje mes banorëve lokalë, të fqinjëve të deriatershëm.

Do të ishte tjetër çështje nëse Millosheviqi do të vinte dhe do të sulmonte, por që njerëzit të bëheshin armiq të njëri-tjetrit, nga dje e deri më sot, “përderisa unë jam këtu, kjo nuk do të ndodhë”. E ai shkonte në negociata edhe në fshatrat serbe, në fshatrat kroate. Përpjekja e tij për të parandaluar gjakderdhjen mes banorëve vendas, deri atëherë fqinjë, ishte arsyeja për ta larguar. Dhe si ndodhi që ai u vra nga vartësi i tij, një polic rezervë?! Kroacia ishte e bllokuar, nuk kishte ushtrinë dhe armët e saj. Ushtria jugosllave tërhoqi të gjitha armët e saj, përfshirë ato për mbrojtje civile. Nuk e di si quhej dhe atë e bllokuan.

Do të më duhej të mendoja mirë dhe të kontrolloja nëse kemi ndihmuar njërën apo tjetrën palë ndërluftuese si mjekë. Nuk ishte se ne na sillnin të burgosur, domethënë jo. Ndoshta aty-këtu ndonjë në kirurgji, por nuk jam i sigurt. Në atë fazë të hershme, kur u ngritën barrikadat nga serbët vendas rreth fshatrave me popullatë serbe (Tenjë, Dalj, Bello Brdo, Borovo Selo...), ndërsa këto bllokada ishin ende të kalueshme, kishte ende disa njerëz që jetonin në ato vendet që vinin pavarësisht barrikadave, vinin në Osijek. Vinin ata që ishin të punësuar në spital dhe ata që vinin për ndihmë, që ishin pacientë. Ishte spital rajonal, prandaj pacientët vinin në spital për ekzaminime, mjekime dhe kontrolle. Por më pas u bë gjithnjë e më pak. Ose nuk mund të vinin më sepse nuk i lejonin t’i kalonin barrikadat, ose qëndronin qëllimisht, kishin frikë ose vendosën të qëndronin në anën serbe, ose çfarë di unë, deri në ndarjen e plotë në zonat nën kontrollin kroat (aty ishte edhe Osijeku) dhe nën kontrollin serb dhe mbrojtjen e OKB-së - e ashtuquajtura Krahina serbe (Srpska krajina). Atëherë u ndërprenë të gjitha lidhjet, përfshirë telefonin.

Vajza dhe djali një kohë qëndruan me mua, por nga muaji 9 i vitit 91 filluan edhe zyrtarisht të evakuonin fëmijët nga Osijeku, shkollat e kështu me radhë. Atëherë djali im ishte në Austri. Ai shkoi atje te familja e babait të tij. Ata ishin aty. Ai shkoi në klasën e parë atje, dhe vajza shkoi te babai i saj në Gjermani. Unë qëndrova aty. Djali im u kthye mendoj në ‘92. Prisni. U kthye për vitin shkollor 1992/93. Të dy, dhe djali dhe vajza ishin jashtë Osijekut në mërgim për një vit.

Qendra për paqe, jo-dhunë dhe të drejtat e njeriut - fillimet

Ekzistonte lëvizja Fushata kundër luftës. Kjo është lëvizja për të cilën me siguri më shumë ju ka treguar Vesna Tershelliç, sepse ajo ishte pjesë e asaj lëvizjeje. Filluan në Zagreb në vitin 1990 ose 1991, dhe në Beograd u zhvillua një fushatë kundër luftës, u rrit, me sa kuptova, nga lëvizjet civile, qysh nga socializmi, lëvizjet feministe, anti-ushtarake, të gjelbra. Ata u mblodhën, të nxitur nga lufta, edhe pse ajo filloi më herët. Nga lufta u iniciua veçanërisht "Lëvizja 42" - për të drejtën e kundërshtimit të ndërgjegjes dhe shërbimit civil. Kjo ishte një pjesë e rëndësishme e asaj lëvizjeje kundër luftës. Unë nuk kam qenë në ato tubime fillestare dhe në themelimin e Fushatës Kundër Luftës, as në lëvizjet e mëparshme civile, siç e kam thënë tashmë. Megjithatë, kur formuam një grup paqeje në Osijek, u lidhëm me ta. Ne dolëm si një organizatë autentike lokale e paqes, e cila më pas u lidh me Fushatën kundër luftës. Ky shoqatë dhe bashkëpunimi i mëtejshëm me Fushatën Kundër Luftës ishte shumë i rëndësishëm, i dobishëm dhe fuqizues për ne. Kështu filloi te ne.

Ne u themeluam zyrtarisht në maj, 10 maj 92, por unë dhe miku im Krunoslav Sukiqi filluam të punonim diku në fillim të nëntorit 1991. Kështu për gjashtë muaj e zhvilluam idenë, menduam, kontaktuam me njerëz të tjerë dhe Fushatën kundër luftës dhe më pas patëm asamblenë themeluese në maj 1992. Ne u themeluam dhe u regjistruam si degë e Fushatës Kundër Luftës. Filloi, siç thashë, në nëntor të '91-shit, kur unë dhe Kruno Sukiqi u takuam. Ne jemi iniciatorët e grupit tonë lokal të paqes - Qendra për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut - Osijek. Para takimit tonë, si Kruno ashtu edhe unë kishim rrugën tonë përgatitore për këtë. U takuam në një takim të organizuar nga i ndjeri profesor Lauc. Ai ftoi intelektualët që mbetën në qytet pasi ra Vukovari, dhe Vukovari ra më 18 nëntor '91, atëherë shumë njerëz u larguan nga Osijeku, sepse pritej që Osijeku të binte shumë shpejt. Kështu që Prof. Lauc ftoi disa prej nesh që ai e dinte se nuk kemi shkuar, për të parë se çfarë mund të bënim. Në fakt, ai mendoi se mund ta ndalnim luftën, gjë që ishte një utopi e plotë, sigurisht, por ne u takuam atje, unë dhe Kruno. Që nga ajo mbrëmje, ne takoheshim çdo ditë, flisnim dhe mendonim - ku jemi, kush jemi, çfarë duam, çfarë mund të bëjmë. Kur kishim krijuar një koncept fillestar, atëherë Kruno lexoi në "Danas" për fushatën kundër luftës, pastaj shkova në Zagreb, ku u takova me Vesna Tershelliçin. Unë isha ajo që shkova në Organizatën kundër luftës në Zagreb nja dy herë, ndoshta tri herë për konsultime. Kur mblodhëm pesë-gjashtë veta rreth nesh, themeluam Qendrën për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut në Osijek, si një degë e Fushatës Kundër Luftës.

Konventa thotë, në mënyrë të përmbledhur: Pavarësisht nga lufta tani, do të vijë një moment kur do të duhet të ulemi në tryezë dhe kur do të duhet të biem dakord se si të vazhdojmë. Pas luftës do të duhet të ndërtohet paqja. Dhe për të qenë në gjendje të ndërtojmë paqen pas luftës, kjo duhet mbajtur parasysh edhe gjatë përshkallëzimit të konfliktit, dhe është e rëndësishme të qëndroni në komunikim me të gjithë ata që kujdesen për ndërtimin e një paqeje më të qëndrueshme në këto hapësira në të ardhmen. E dimë se nuk mund ta ndalim luftën, por duhet të ruajmë idenë e bashkëjetesës paqësore, komunikimin dhe burimet e atyre që duan të punojnë për paqen e përhershme në këto zona. Për më tepër, mendonim se çfarë lloj shoqërie, komuniteti politik duam të ndërtojmë pas luftës. pikërisht për Kroacinë, jo vetëm të pavarur, por çfarë Kroacie!? Pra, të vetëdijshëm për shpërthimin e dhunës së luftës, ne përcaktuam të ardhmen që duam, që është të punojmë në krijimin e një komuniteti/shoqërie

politike që do të jetë më rezistente ndaj zgjidhjes së problemeve me dhunë dhe më e aftë për transformimin jo të dhunshëm të problemeve dhe konflikteve – si me strukturat ashtu edhe me njohuritë, aftësitë dhe metodat. Natyrisht, kjo nënkuptonte në të njëjtën kohë që ne të mendojmë si parakusht që ai do të jetë një komunitet demokratik, shumëpartiak, politik, por përveç kësaj, të ketë edhe kapacitetin për të zgjidhur në mënyrë jo të dhunshme problemet që do të ekzistojnë gjithmonë. Ky ishte vizioni ynë.

Domethënë, kur u takuam unë dhe Kruno, para së gjithash ishte e dobishme për ne në njëfarë mënyre, terapeutike, që takuam një person tjetër që nuk është plotësisht në logjikën e luftës, në parim "nuk ka tjetër, tani është luftë, ose ata neve ose ne ata", që dikush do të mendojë se si ishte e mundur që të shpërthejë një dhunë e tillë dhe si të ndalohet, të depërshkallëzohet. Një mendim i tillë ishte si tradhti e lartë. Në atë kohë, nëse vetëm e mendonit kështu, ishte tradhti e lartë. Pra, po të takonim dikë që donte të mendonte përtej logjikës "ose ata ose ne", ishte shëruese, çliruese, emancipuese për ne.

Kështu që ne të dy folëm shumë. Së pari, ishim shumë të zemëruar me mësuesit dhe prindërit tanë që nuk na mësuan se lufta nuk është vetëm heroizëm dhe solidaritet, një mënyrë mbijetese që të bën pozitivisht agresiv. Në kuptimin, i mbijetova edhe kësaj edhe kësaj, por që sjell edhe një dozë shumë të madhe dhune shkatërruese ndaj të tjerëve dhe ndaj vetes. Dhuna bëhet kod: kodi i luftës është dhunë, lufta nuk është vetëm solidaritet dhe guxim, por ka elementë të krimeve kundër paqes, marrëdhënieve paqësore dhe njerëzve.

Pra, filluam të flisnim për atë vizion të së ardhmes, që duhej të ishte, siç thashë, një komunitet politiko-shoqëror, i cili do të jetë demokratik, i cili do të ketë një sistem shumëpartiak, i cili do të jetë i ndërgjegjshëm edhe sa u përket strukturave, kapaciteteve dhe metodave, si të zgjidhen problemet socio-politike, ekonomike në një mënyrë që redukton padrejtësitë dhe në mënyrë që të bëhet progres i vazhdueshëm dhe jo i dhunshëm drejt një shoqërie më të drejtë që do të respektojë të drejtat dhe liritë e çdo personi, të drejtat e njeriut, të drejtat grupore në kuptimin më të gjerë.

Kur ramë dakord për vizionin, atëherë bëmë një ose dy hapa prapa nga ai vizion dhe i shtruam vetes pyetjen "çfarë mund të bëjmë sot, në mes të luftës, për një të ardhme të tillë"? Po, derisa ne ende po punonim për vizionin, ne thamë këtë: ne do të donim jo vetëm një demokraci shumëpartiake, por një shoqëri të tillë, një komunitet të tillë politik, ku qytetarët kanë hapësirë për të marrë pjesë në vendimmarrje, jo vetëm në zgjedhje, por edhe ndërmjet zgjedhjeve. Pra, të kenë qasje në vendimmarrje edhe në mes të zgjedhjeve dhe ne kemi konsideruar që në atë rast qytetarët duhet të aktivizohen, politikisht dhe në aspektin shoqëror. Jo në aspektin partiak, por aktiv në aspektin shoqëror dhe politik, në mënyrë që ata, për shembull, të fitojnë njohuritë e tyre se ekziston një nevojë që duhet zgjidhur për të mirën e përbashkët, që kjo nevojë të njihet nga qytetarët e tjerë dhe në atë mënyrë të fitoj forcë për të marrë mbështetje politike. Pra, ne fakt po flisnim për rolin e shoqërisë civile, megjithëse ne atë kohe nuk e njihnim konceptin e shoqërisë civile, shoqatave të shoqërisë civile, nuk e kishim idenë, të paktën unë – diçka për këtë dinte Kruno sepse merrej me filozofinë dhe shkencat politike. Pra, si një element të rëndësishëm e kemi konsideruar idenë e pjesëmarrjes qytetare, kjo është ajo që donim.

Christof Ziemer, një pastor ungjillor, erdhi tek ne nga nevoja për t'u larguar nga mjedisi në të cilin ai kishte punuar si një nga udhëheqësit e rezistencës jo të dhunshme në Gjermaninë Lindore për disa vite, sepse ai në fakt ishte shumë i zhgënjyer me atë se si kishte përfunduar procesi i tyre. Ai ndau këndvështrimin e tij me ne - tha se i gjithë procesi deri në rënien e Murit të Berlinit synonte për vite me radhë pikërisht atë transformim jo të dhunshëm të shoqërisë dhe komunitetit politik, një numër i madh njerëzish u përfshinë në artikulimin e vizionin që ata duan në të ardhmen. Kishte sinergji dhe potencial për ndryshime shoqërore.

Kështu e përcaktuam misionin tonë në emrin tonë, si të thuash. Nëse vizioni është ai nga i cili ne po shkojmë, atëherë misioni ynë është të ndërtojmë paqen me metoda jo të dhunshme, të mbrojmë dhe avancojmë të drejtat e njeriut dhe të garantojmë të drejtat e njeriut. Këtu, ne e inkorporuam atë mendim në emrin e organizatës. Dhe pastaj bëmë një hap mbrapa, domethënë filluam të mendojmë "mirë, tani, ne e dimë se çfarë duam, por nuk dimë si ta arrijmë atë". Ne nuk e kishim një ide të qartë se çfarë është në të vërtetë veprimi jo i dhunshëm, dinim për Gandin, e dinim që nuk donim dhunë. Por si, çfarë do të thotë veprimi jo i dhunshëm, ishte ende mjaft e paqartë.

Për një apo dy vjet kemi pasur trajnime të shpeshta për anëtarët/et e grupit tonë. Këto trajnime ishin gjithashtu një vend për të reflektuar se çfarë do të thoshte veprimi jo i dhunshëm për situatën e luftës në atë kohë, çfarë do të thoshte për situatën tonë të luftës në Osijek në atë kohë, çfarë do të thoshte për p.sh. puna me të dëbuarit, çfarë duam/mund të bëjmë? Në këto trajnime ndërgjegjësuam, gjegjësisht ramë dakord, artikuluam aktivitetet tona të menjëhershme. Trajnimi dhe praktika shkonin paralelisht, ajo përvojë ndikoi edhe në qëndrimin tonë dhe në praktikën e ardhshme - se arsimi është një instrument i rëndësishëm i fuqizimit për ndërtimin e paqes, dhe Qendra për Paqe ka tridhjetë vjet që punon në fushën e edukimit për paqe.

Dhe tani do të doja t'i kthehesha përvojës në të cilën u hodhëm praktikisht kur ftuam mediat në kuvendin themelues, ne krejtësisht osijekasit e panjohur, për arsyen se morëm qëndrimin që si qytetarë mund të ndikojmë vetëm nëse veprimet tona janë publike. Ishte in medias res. Ndodhi siç pritej, por për ne të papërvojëve ishte e papritur. Ne i ftuam gazetarët dhe thamë se po krijohet Qendra për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut. U desh një javë që një artikulli të shfaqej në Glas Sllavonia, një gazetë lokale, dhe atë falë mbështetjes së një vullnetari që erdhi për të ndihmuar Glas Sllavonia sepse ajo ishte duke vepruar në një zonë lufte. Ai ishte një aktivist i gjelbër dhe tema ishte e afërt me të, dhe si redaktor mbështeti botimin e artikullit. Përndryshe, artikulli ndoshta nuk do ta kishte parë kurrë dritën e ditës. Kështu u botua një artikull, mbi të cilin një gazetare punoi për një javë dhe nën titullin "E drejta për diversitet", u themelua Qendra për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut në Osijek. Artikulli prezantoi në mënyrë korrekte se çfarë jemi dhe çfarë duam. Atë artikull e kemi në arkivin tonë. Mirëpo, në të njëjtën faqe, në këndin e djathtë, ose në këndin e majtë, ishte shpallur një intervistë e madhe me Branimir Glavashin, dhe ai ishte udhëheqësi kryesor i luftës lokale. Pra, ata e vendosën Qendrën për Paqe në kontekst. Edhe vizualisht, Qendra për Paqe ishte në kuadër të luftës. Dhe reagimi ishte kryesisht, nga shumica e njerëzve, nuk do të them negativ, por reagimi i parë i shumicës ishte "pra çfarë, sikur ne nuk jemi për paqe, edhe ne jemi për paqen! Por si do të flasim për paqe kur na sulmojnë, kur kemi agresion ndaj nesh, çfarë do të bëjmë tani. Edhe ne jemi për paqe, por jo tani! Tani duhet të mbijetojmë së pari, tani nuk ka vend për të folur për paqen!". Ja, ky ishte reagimi i parë, i pritshëm, dua të them se është diçka që ne e

dinim se do të ndodhte, në fillim. Tashmë kishte edhe disa reagime keqdashëse: “ata që flasin për paqe janë në fakt për serbët dhe për Jugosllavinë”. Ky ishte një lloj tjetër reagimi. Dhe e treta lidhej me të drejtat e njeriut. E treta, ne u kontaktuam nga njerëz të cilëve u cenoheshin të drejtat e njeriut dhe e katërta ishte se doli se kishte njerëz që janë po aq të pakënaqur sa edhe ne në një farë mënyre. Atyre nuk u pëlqen fakti që situata e luftës është radikalizuar aq shumë sa nuk ka alternativë tjetër veç “ose ata ose ne”, ekskluziviteti dhe satanizimi e palës tjetër, që hapi hapësirë për justifikimin e dhunës nga vet grupi. Fakti që dolëm, si të thuash, e bëri të qartë se ka njerëz që kanë të njëjtat konfuzione në kokë si ata, se gjithçka nuk është vetëm bardh e zi dhe se ka dikush me të cilin mund të flas për të gjëra të tilla.

Kështu, Qendra për Paqe u bë në një farë mënyre një ishull social. Na vinin njerëz që nuk u ndjenin mirë dhe pse kjo luftë po ndodh, dhe pse fqinjët janë kundër njëri-tjetrit dhe që po sheh se APJ dhe forcat serbe po bëjnë krime lufte, po dëbojnë, djegin fshatra dhe fshatarët po vijnë tek ne nga rrethina, të përzënë, që është një tmerr se çfarë po ndodh aty, nga Vukovari e tutje, ndaj nesh. Nga ana tjetër, këtu në Osijek shohim se serbët po dëbohen nga puna, po i dëbojnë nga banesat e tyre, veçanërisht ish-ushtarët e APJ-së, pra, gjëra të ngjashme po ndodhin edhe ndaj atyre që nuk janë tanët...

I gjithë grupi u pajtua që, edhe pse do të dëshironin të punonin për të drejtat e njeriut përmes arsimit, por tani situata është që ne duhet të reagojmë ashtu siç duhet të reagojmë, që duam të reagojmë ndaj saj, por që jo të gjithë anëtarët ishin të gatshëm të marrin pjesë drejtpërdrejt në terren, por të gjithë anëtarët qëndruan pas këtij aktiviteti. Le të themi, punonjësit në fakultet, kishim profesoresha nga fakulteti që mund të rrezikonte pozitën e tyre në punë, e edhe unë kam punuar në spital atëherë. Disa thoshin “nuk kemi guxim të shkojmë direkt në terren për të punuar me njerëzit”, por të gjithë ishim pro atij veprimi. Formuam një grup në të cilin isha unë dhe Kruno, dhe ishim rreth tetë veta. Ne shkuam dhe organizuam rezistencë jo të dhunshme kundër dëbimit të njerëzve nga banesat.

Pra, ishim me familjet në banesat e tyre dhe më pas dërgonim informacione, ankoheshim, lajmëronim policinë, policinë ushtarake, ministrinë, i shkruam Tuxhmanit, bëmë telefonata e kështu me radhë dhe mblidhnim dokumentacion për këtë. Kështu që ne, Qendra për Paqe, që në janar 1993 dhamë raportin tonë të parë, të cilin unë e redaktova, për dëbimet e dhunshme nga banesat, i pari në Kroaci.

Në të, ne dhamë një përshkrim të situatës. Nuk e di, “personi ky dhe ky, me këtë datë erdhi dhe tregoi se kishin ardhur tashmë pesë herë dhe e kishin kërcënuar se duhet të dilnin”, e kështu me radhë. Çfarë ka thënë ai person, pastaj çfarë gjetëm, nëse ishim të pranishëm gjatë dëbimit, kujt iu drejtuam dhe si përfundoi çështja, nëse personi ishte dëbuar apo jo. Nuk e di nëse ne, mendoj se kemi përmendur edhe emrin dhe mbiemrin e plotë të personave nga rastet në raport. Por duhet ta verifikoj, tani nuk më kujtohet më. Pas kësaj këtu në Qendrën për Paqe u formua një grup juristësh i cili merrej me çështje të të drejtave të njeriut. Kemi punuar kryesisht në këtë kuptim, sepse të tilla kanë qenë rrethanat në vendin tonë, që na kanë kontaktuar ata, drejtat e të cilëve janë cenuar nga pushtetarët tanë. Pra, nga autoritetet e atëhershme ushtarake në Osijek, të cilët e bënë atë. Më vonë, natyrisht, kemi punuar edhe në shkelje të tjera të të drejtave të njeriut. Edhe sot Qendra për Paqe funksionon me një program të ndihmës juridike falas, i cili doli nga ato aktivitetet e para. Ja, tani kanë marrë një kontratë nga ministria, tani financohet nga ministria dhe për herë të parë është një

kontratë trevjeçare e jo një.

Aktivitetet e Qendrës dhe riintegrimi paqësor

Në periudhën e hershme të pasluftës, ndihma juridike falas financohej nga organizatat ndërkombëtare, për më shumë se një dekadë nga UNHCR. Jemi përpjekur së bashku me organizata të tjera, por ishim një nga liderët për të drejtën e të gjithëve për të pasur qasje në drejtësi dhe në sistemin gjyqësor. Në vendet demokratike, shteti financon ndihmën juridike falas për shtresat në nevojë sociale të cilët nuk mund të paguajnë, por që të mund të shkojnë në gjykatë të kenë qasje në drejtësi. Së pari, ne punuam me vite që Republika e Kroacisë të miratonte një ligj për ndihmën juridike falas, kështu që ndoshta u deshën dhjetë vjet që rregulloret të miratoheshin. Tani ndihma juridike falas financohet nga ministria. Rastet që janë të ndryshme nga ato në periudhën e hershme të pasluftës, duke përfshirë dhunën ndaj grave, ligjin e familjes, ligjin e punës - të gjitha për kategorinë e cenueshme sociale. Dhe filloi me faktin se ne i shtuam "të drejtat e njeriut" në emrin e organizatës - Qendra për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut. Deri më tani, rreth 80 mijë klientë kanë shkuar në Qendrën e Paqes për ndihmë juridike falas, nga fillimi e deri më tani, pra janë 30 vjet. Ose sa, që nga viti '92, 31 vjet. Kështu që, ja ky ishte një segment i aktiviteteve të Qendrës për Paqe.

Më lejoni të theksoj se ndihma juridike falas ishte shumë e rëndësishme dhe e përfshirë në procesin e riintegrimit paqësor të Sllavonisë Lindore, Baranjës dhe Srijemit, përfundimit paqësor të luftës në Kroaci. Vukovari dhe e gjithë zona e përmendur ishte 5% e sipërfaqes totale të okupuar të Kroacisë. Prandaj, aty jepej ndihma juridike atyre që kishin nevojë të integroheshin në sistemin juridik kroat, pra serbëve që donin të qëndronin këtu dhe që ishin në pjesën që ishte nën kontrollin serb, dhe të kthyerve, pra të dëbuarve në realizimin e të drejtave të tyre kur po ktheheshin.

Në këto procese kemi bërë edhe ndërmjetësim në komunitet, sepse shumë shpesh në shtëpitë kroate ka pasur serbë, përkatësisht serbë që kanë ikur nga pjesët tjera të Kroacisë, ose janë dëbuar ose ikur nga lufta dhe kanë ardhur në këtë pjesë që ka qenë nën kontrollin serb dhe nën mbrojtjen e OKB-së. Pastaj ata ishin vendosur në shtëpi të zbrazëta kroate ose po ashtu i kanë dëbuar kroatët për të hyrë në shtëpi, tani kroatët tanë duhet të kthehen atje. Në këto situata kemi bërë këtë lloj ndërmjetësimi në komunitet. Në Qendrën për Paqe kishte anëtarë/e që ishin të internuar dhe u bënë aktivistë të paqes. Ata kanë shkuar për bisedime, ne organizuam vizita, që të dëbuarit tanë kroatë të vizitonin dhe të takonin serbët që jetojnë në shtëpitë e tyre. Edhe para procesit të riintegrimit paqësor, ne organizonim takime në vende neutrale, ishte një program vizitash. Më pas e lidhëm me procesin e kthimit të serbëve, të cilët duhej të ktheheshin në pjesët e tjera të Kroacisë prej nga kishin ikur. I kemi çuar p.sh në zonën e Okuçanit për të parë se si janë shtëpitë e tyre, a do të mund të kthehen atje... U punua shumë për ndërtimin e paqes së pasluftës, në kuptimin e ndërmjetësimit mes refugjatëve serbë dhe të dëbuarve kroatë, të cilët duhej të ktheheshin. Në këtë proces kemi punuar gati deri në vitin 2004.

Segmenti i dytë për të cilin fillova gjithashtu të flas ishte arsimi. Ne në fakt e kuptuam nga dora e parë që nëse doni të veproni në mënyrë demokratike dhe jo të dhunshme, nuk dimë si ta bëjmë këtë. Ne kërkuam dhe erdhën te ne për të bërë seminare për zgjidhjen e konflikteve jo të dhunshme, mbi avokimin, për rezistencën jo të dhunshme,

veprimet jo të dhunshme... Ne kishim pesë ekipe paqeje që punuan për integrimin e njerëzve për rreth pesë vjet më vonë pas përfundimit të mandatit të UNTAES për riintegrimin paqësor. Në terren, ata punuan në ndërtimin e paqes së pasluftës në bashkësitë lokale ku kishte edhe serbë edhe kroatë. Gjithashtu, qysh në fillim të aktivitetit tonë, kuptuam se sa të rëndësishëm janë të dëbuarit dhe mësuesit për ndërtimin e mëvonshëm të paqes dhe besimit. Të dëbuarit që prisnin të ktheheshin, nga u dëbuan, si do të kthehen. A do të kthehet ai si dikush që do të zgjidhë nevojën e tij me hakmarrje, apo dikush që do të jetë paqebërës në komunitetin e tij. Edukimi ka qenë gjithmonë i lidhur me praktikën e ndërtimit të paqes. Kjo mbivendosej shumë.
kontratë trevjeçare e jo një.

Po ashtu kuptuam shumë dhe punuam shumë me mësuesit. Fillimisht, filluam punën me të dëbuarit, me mësuesit e dëbuar nga këto vise rreth Osijekut, nga Vukovari dhe drejt nesh, sepse aty me ta ishin edhe nxënësit e tyre. Ata prisnin kthimin e tyre, ndaj ne vumë re dy gjëra. Së pari, ne mund t'i ndihmojmë ata si të trajtojnë, ta kalojnë më lehtë dëbimin dhe të punojnë me fëmijët që janë të traumatizuar dhe në dëbim. Së dyti, si do t'i përgatisim për të qenë ambasadorë të paqes, sepse dihet që një mësues është shumë i respektuar në komunitet.

Pra, kjo është në fushën, do të thosha të arsimit aplikativ që formon praktikues-akademikë, ndaj ne kombinojmë jo vetëm gjërat shkencore-teorike, por gjithmonë edhe praktike. Në fakt, ne mësojmë përmes praktikës dhe për praktikë. Kemi botuar trembëdhjetë-katërmbëdhjetë manuale, nga fusha të ndryshme, për shembull: vullnetarët në ndërtimin e paqes, si të përballemi me traumat e pasluftës me veteranët ushtarakë, ndërmjetësimin në komunitet, "dashësit e paqes" për punën e mësuesve me nxënësit, kurrikulën e lartpërmendur... Pra, gjithçka që bëmë në praktikë, kërkonim të bënim një manual-publikim për të. Në shumë prej tyre ose jam pjesërisht e përfshirë, ose jam redaktore. Kryesisht, Qendra për Paqe nxit dhe zhvillon programe edukative për veprim jo të dhunshëm dhe ndërtimin e paqes.

Tashmë kam përmendur dhe përshkruar segmentin tjetër të Qendrës për Paqe - ndërmjetësimi në komunitet dhe programet e vizitave. Ky është pikërisht ndërtimi i paqes. Pra, kjo është ajo që ne bëmë, veçanërisht ndërtimi i paqes pas luftës në zonën tonë, në Kroacinë lindore të shkatërruar nga lufta. E kemi nisur edhe para riintegrimit paqësor me përgatitjen e mësuesve, grave, të dëbuarve, "çfarë do të ndodhë kur të kthehen, kur të ndodhë një ditë". Le të themi një nga aktivitetet që ne disi e nisëm, dhe më vonë e bëri i gjithë rrjeti i organizatave të paqes, ishte që të dëbuarit tanë u takuan me njerëzit që kishin mbetur ende në zonën që ishte nën kontrollin serb. Ata takoheshin në shtëpinë e takimeve, në Hungari, në Mohacs.

Pra, ne po përgatiteshim për ndërtimin e paqes pas luftës dhe rivendosjen e besimit, dhe marrëveshja krijoi një kornizë reale politike për ta bërë të mundur, ata arritën vërtet një marrëveshje politike. Në këto rrethana të favorshme, ne mobilizuam të gjitha forcat tona për të mbështetur procesin e paqes. Në atë kohë ishte formuar jo vetëm Qendra për Paqe, por edhe Koordinimi i Organizatave të Paqes për Baranjë, Srijem dhe Sllavoninë Lindore. Ishin dhjetë organizata nga Kroacia dhe dy nga Serbia. Koordinimi u përgatit gjithashtu në takimet në Hungari dhe nëpër Kroaci. Ne shkruam menjëherë dhe ia paraqitëm Koordinimin gjeneralit Klein. Ai ishte mandatari dyvjeçar i riintegrimit paqësor i mandatuar nga OKB. Ai e mundësoi dhe lejoi të punonim në terren, në zonën e UNTAES. Pra, na hapi mundësinë për të qenë të pranishëm, për të

qenë të pranishëm, për të mbështetur riintegrimin paqësor. Do të thosha se ishte e rëndësishme që ne u prezantuam dhe se ai e dinte që tashmë kishim punë serioze pas nesh – ekzistonte edhe përvoja, projekti vullnetar Pakrac.

Përveç programit të dëgjimit dhe aktiviteteve që rezultuan nga programi dëgjimor, ne organizuam edhe punëtori të ndryshme dhe një program vizitash. Pra, fillimisht shkojnë aktivistët tanë të paqes, pastaj realizojnë një program dëgjimi që qetëson tensionet dhe hap linjën e parë të komunikimit; pastaj lajmërojmë, pastaj sjellim të dëbuarit, ose sjellim serbët në Osijek për t'u takuar me të dëbuarit. Pra, për t'u takuar njerëzit drejtpërdrejt, ky ishte hapi i dytë. Dhe hapin e tretë e bëmë vetëm pas dy vitesh, kur njerëzit u kthyen vërtet. Në atë kohë mandati zyrtar kishte përfunduar, nuk kishte më forca ndërkombëtare. Aktivitetet kishin për qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndëretnik për rindërtimin e bashkësisë lokale.

Tashmë kam përmendur se një rol të rëndësishëm kanë luajtur juristët që kanë ofruar ndihmë juridike falas në realizimin e të drejtave civile të fituara, gjatë misionit dyvjeçar të OKB-së - UNTAES procesit të riintegrimit paqësor të Sllavonisë Lindore, Baranjës dhe Srijemit, në gjuhën e folur kroate Anadunavës. Por edhe për periudhën pas përfundimit të misionit të OKB-së, procesin e kthimit të dëbuarve, integrimin e njerëzve dhe rikthimin e besimit në bashkësitë lokale multietnike - në atë kohë kishim ekipe paqeje në terren, edhe për tri vjet. Ekipet e paqes ishin në Vukovar, Tenjë, Bilje dhe Beli Manastir, Daljë, Berk, Okuçan dhe tre vende në Bosanska Posavina.

Në dhjetë komunitete lokale kishim ekipe paqeje që më pas ndihmuan njerëzit që u kthyen dhe ishin bashkë, hapën komunikimin e ndërsjellë, parandaluan incidentet e dhunshme dhe ranë dakord për bashkëpunim në rindërtimin e vendeve të tyre. Për shembull, njerëzit që ishin përfshirë në një klub të shkëlqyer shahu para luftës u lidhën në Tenjë. Ata së bashku e rindërtuan atë. Janë rënë dakord dhe zbatuar gjëra shumë praktike. Në Dardë thanë: "Pleqtë tanë janë të mjerë dhe kurrfarë, do t'u bënte mirë të shkonin në verim, ndaj organizuan një sërë verimesh njëditore në banjën e Bizovacit". Dhe aksione dhe aktivitete të tjera të ndryshme... Edhe shkollat i kemi përfshirë.

Dokumentimi

Në Qendrën për Paqe, ne fillimisht kishim procesin tonë të brendshëm të monitorimit të gjyqeve të krimeve të luftës. Pra, juristët tanë, dhe kishim një ekip mjaft të madh ligjor, nuk ishin të prirë të ndiqnin gjykimet dhe të merreshin fare me krimet e luftës dhe të merreshin me të kaluarën. Ata thanë se u mjafton kjo që Qendra për Paqe dhe ata po punojnë për ndihmë juridike për realizimin e të drejtave të fituara. Se është shumë stresuese për ta, edhe për kthimin e pronës, për kthimin e banesave, për të gjitha këto, se ata tashmë janë shumë të lodhur dhe se është shumë e vështirë për ta që tani ata të fillojnë dhe të merren edhe me krime lufte, se nuk kanë forcë dhe vullnet për këtë. Ne e kuptuam këtë që kjo është thelbësore për paqen e qëndrueshme. Nuk mund ta lini të kaluarën të pashpjeguar, të papërpunuar. Prandaj, vendosëm që Qendra për Paqe të marrë pjesë në themelimin e Documenta. Kështu, Qendra për Paqe, Komiteti Kroat i Helsinkit, Komiteti Qytetar nga Zagrebi dhe Qendra për Studime të Paqes, ne katër organizata themeluam Documenta - një qendër për ballafaqim me të kaluarën.

U themelua në vitin 2004. Qendra për Paqe dhe unë personalisht bashkëpunojmë me Documenta, edhe pse është një organizatë krejtësisht e pavarur - kështu është bërë me statut, që tashmë pas një viti Documenta të ishte plotësisht e pavarur. Qendra e Paqes nuk ka asnjë ndikim në punën e Documenta, por ne vazhdimisht bashkëpunojmë në projekte. E kemi në kuptimin që unë jam anëtare i bordit drejtues të Documenta-s që nga mbledhja e parë e në vazhdim, dhe që disi i përshtatet të gjithëve, edhe pse nuk përfaqësoj më Qendrën për Paqe. Përfaqësova Qendrën për Paqe për një vit dhe vazhdova sepse Documenta kujdeset që të ketë gjithmonë dikë në bordin e drejtorëve nga pjesa jonë e Kroacisë dhe për shkak të njohurive dhe interesave të mia.

Ne kemi dokumentuar, siç thashë më herët, ato shkelje të të drejtave të njeriut që kishin të bënin me dëbimin e njerëzve nga banesat dhe shtëpitë, dhe largimet nga vendet e punës etj. Ne e kemi dokumentuar këtë në njëfarë mënyre dhe e kemi ruajtur atë dokumentacion dhe në bazë të atij dokumentacioni kemi bërë kallëzim penal kundër kreut të Komisionit Ushtarak për Banim, Petar Kljajiq.

Pjesa e dytë që e kemi dokumentuar, por nuk e ruajtëm deri në fund, ishin rastet nga ndihma juridike falas dhe kanë të bëjnë me realizimin e të drejtave civile pas luftës, d.m.th., shpërbërjes së Jugosllavisë dhe krijimit të Republikës së pavarur të Kroacisë – lidhur me situatën e pasluftës për shtetësinë, pensionet, të drejtën e pronës private, gjithçka që u prish gjatë luftës.

Dhe e treta, kemi dokumentacionin e rreth 300 gjykimeve për krime lufte, të cilat i kemi monitoruar. Pra, ne kemi të gjithë dokumentacionin - nga aktakuza, procesverbalet nga secila seancë, aktgjykimi, ankesa, analiza dhe raporti i monitoruesit. Është dokumentacioni më i plotë i gjyqeve të krimeve të luftës në Kroaci.

Ishte e rrezikshme, ishte veçanërisht e rrezikshme kur ne “dolëm” dhe thamë se jemi Qendra për Paqe, Jo-dhunë dhe të Drejtat e Njeriut. E ceka më herët se si ka pasur jehonë në publik dhe çfarë lloj perceptimesh kemi pasur të përballemi. Por ka pasur edhe etiketime të qëllimshme - se ne që e themi kështu jemi në të vërtetë armiq të Kroacisë, se jemi për serbët, Jugosllavinë dhe se jemi kolumnist të pestë. Pra, në atmosferën e ndezur që mbretëronte në atë kohë, gjithmonë mund të na ndodhte diçka. Përvoja ime personale është se, derisa binin predhat që serbët dhe APJ-ja po i hidhnin në Osijek, sigurisht që ndjeva frikë - ke frikë, mund t’ju godasë. Por kjo është ndryshe nga ajo kur u ekspozova përmes punës sime në Qendrën për Paqe, atëherë ndjeva se isha një objektiv. Pra, të qenit viktimë e astësishme kur bombardohet Osijeku është ndryshe nga ajo kur dikush pikërisht më targeton mua. Pra, ishte gjithmonë shumë e rrezikshme. Për më tepër, kur ne ofruam rezistencë jo të dhunshme gjatë dëbimit të njerëzve nga banesat e tyre, atëherë vinin ushtarët kroatë të zemëruar me armë dhe në gjendje të ndryshme emocionale. Aty ishte gjithmonë e mundur që të gjuanin, të na godisnin... Një herë Kruno kapi dorën e një ushtari me armën e drejtuar nga ai. Çdo gjë mund të na ndodhtë. Gjithashtu, kur unë dhe Kruno ishim te Petar Kljajiqi, ai shefi i Komisionit të Strehimit Ushtarak. Na kërcënoi duke thënë “Dëgjo, unë kam 10.000”, apo nuk e di sa tha “ushtarë, po i lëshova, mbaruat”. Pra, ushtarët veçse janë të nxitur, le të kemi kujdes se çfarë bëjmë. Mua më kërcënoi drejtpërdrejt dhe më tha “Kujdes, e di, ju punoni në spital”. Pra, unë nuk u pushova nga puna, por më thirri shefi i departamentit tim dhe më tha: “Dëgjo, ndalo se do të pushohesh nga puna”. Më kujtohet gjithashtu që shkuam, për shembull, të takojmë serbët në Bilje, kur filloi riintegrimi paqësor. Njeri, të gjithë me armë, në një lloj shtëpize gjuetie “Kush jeni ju? Çfarë jeni

ju?", një amerikan, Herb Walters, erdhi në takim me ne në atë kohë - ishte si një lloj sigurie për ne. "Ndoshta nuk do...", e kështu me radhë. Isha me një grua në Sotinë që vizitoi varrezat. Ata e thirrën pas kësaj dhe i thanë "Ti dole 20 minuta para se ata që morën vesh se ishe atje, u nisën të të vrisnin". Tash po flas për përvojën time, por anëtarët-et e tjerë të Qendrës për Paqe kishin përvoja të ngjashme kur punonin në terren.

E lashë punën për të marrë pjesë me kohë të plotë në procesin e riintegrimit paqësor, sepse u ndërgjegjësova se ka mjekë të mirë, por që nuk ka shumë njerëz që duan të merren me kohë të plotë me procesin e paqes, i cili ka shanse të mëdha për t'u realizuar pa gjakderdhje shtesë. Kjo ishte arsyeja kryesore dhe ajo që e mbështeti vendimin tim ishte fakti që harxhoja gjithnjë e më shumë nga kapaciteti im mendor, emocional, intelektual dhe shpirtëror për punën e paqes. Dhe e dija se nuk do të mund të bëhesha një mjeke e mirë nëse do të merresha me paqeruajtjen dhe rrugës të jem mjeke. Nuk mund të bësh kështu, nuk do të ishte përgjegjëse.

Që nga fillimi dhe gjatë dekadave, bashkëpunimi ka ekzistuar - ai është imanent për procesin dhe veprimin e paqes. A mjafton, a ka mundur të jetë më shumë? Po. Shikoni, unë personalisht, le të themi, do të filloj me Kosovën, nuk kam qenë shumë e përfshirë me Kosovën. Pra, unë personalisht jam më shumë, për shkak të pozitës në të cilën jam, është se ne ishim në një zonë lufte dhe aty në të vërtetë punohej. Pra, thjesht, kapacitetet e mia më së shumti ishin të orientuara drejt "punës ku je". Por isha e lidhur, përmes fushatës kundër luftës, përmes Vesna Tershelliçit u takuam menjëherë dhe e dinim, e dija që nuk mund ta bënim të vetme. Pra, komunikimet hapeshin kudo që mundnin. Ne bashkëpunuam menjëherë me Gratë në të Zeza, kështu që ishte Jelena Shantiq ajo që themeloi dhe drejtoi organizatën e paqes të të ikurve serbë nga Kroacia, Grupi 484, kështu quhen ata. Bashkëpunuam me organizatën Tolerancija nga Bačka Palanka, pastaj unë bashkëpunova me Manda Prishing nga Sombori dhe atë menjëherë, qysh në fillim. Pastaj, kur Qendra për Paqe u themelua në Bilje, dhe organizatat lokale të paqes në Vukovar, kështu që vetë Qendra për Paqe përbëhej nga gra në shumicën dërrmuese! Për më tepër, ne kemi bashkëpunuar kryesisht me organizatat e paqes që vepronin lokalisht në zonën e luftës, të cilat janë gjithashtu kryesisht gra. Kam pasur më shumë (bashkëpunim) me Serbinë përmes, Natasha Kandiqit, Gratë në të Zeza, Shantiqkën e kështu me radhë. Sa i përket Bosnjës, personalisht nuk jam marrë shumë.

Ne ishim vazhdimisht në një lloj kontakti, por Vesna Tersheliçi dhe Fushata Kundër Luftës dhe ato organizata të grave ishin më të lidhura me njëra-tjetrën, si organizata të grave, por mendoj se ne ishim dhe jemi të hapur për këtë. Sa i përket Kosovës, Qendra për Paqe ka pasur një projekt para gjashtë apo shtatë vitesh, dhe më herët kemi pasur edhe mysafirë nga Kosova, ata kanë ardhur tek ne. Kam pasur kontakte me femra nga Kosova përmes Pax Christi International. Ata kanë pasur kontaktet e tyre në Kosovë, kështu që edhe unë kam pasur kontakte përmes tyre. Me Kosovën kemi pasur kontakte edhe përmes Fondit për të Drejtën Humanitare – përmes RECOM-it.

Çmimin "Krunoslav Sukiq", e themeluam pasi Krunoslav Sukiqi vdiq tragjikisht në një aksident trafiku në vitin 2009. Çmimi ka një emër shumë të ngjashëm me Qendrën për Paqe, sepse ne ndjemë se në fakt ishte diçka që ne e artikuluam. Cili është misioni i Qendrës për Paqe që ne e njohim si mision apo detyrë të atyre që përpiqen për paqe të qëndrueshme, ai është çmimi "Krunoslav Sukiq" për promovimin e paqebërjes, jo-

dhunës dhe të drejtave të njeriut.

Arsyeja ime e menjëhershme ishte në fakt një ndërgjegjësim shumë i papritur, mendoj se pikën e parë të kthesës e përjetova kur pashë që gjithçka po shkonte drejt luftës, se në fakt ishte një luftë rreth meje... Dhe me të cilën logjika e luftës totale dhe dhunës ("ose ata ose ne") po përhapet rreth meje, mbi mua dhe në mua... Sidomos kur arrita të kuptoja se ndoshta ishte pasiviteti im, se nuk doja të përfshihesha në politikë, se isha në anash, se kjo ishte pjesa ime e përgjegjësisë për faktin se kemi një luftë. Mendoj se kjo ishte pika e parë e kthesës në kokën time, dhe më pas fillova: "Tani do të doja t'i rregulloja të gjitha!" Pastaj vrapoja.

Doja ta bëja atë lokalisht, ngjashëm me Reihl-Kir, i cili, si shef policie, shkoi në negociata, kështu që doja t'i parandaloja vendasit, të cilët ishin miq dhe fqinjë deri tani, që të mos kishin ndonjë arsye, përveç ndoshta ndonjë të re ideologjike ose të vjetër ideologjike, për t'u rrahur dhe vrarë me njëri-tjetrin. Kam bërë një grup njerëzish që do të shkojnë në fshatrat përreth për negociata pajtimi: disa nga kolegët e mi mjekë, disa infermierë dhe doja të bashkëpunoja me priftërinjtë. Kështu, mblodha ekipin, përveç priftit. As prifti katolik as ortodoks nuk donin të "përziheshin në politikë". Megjithatë, ne kurrë nuk e hodhëm hapin për të shkuar diku, sepse gjithçka po ndodhte dhe po përshkallëzohej shumë shpejt.

Në këtë kuptim, ndoshta ishte edhe më mirë për mua. Atëherë fillova të mendoj dhe në fakt mora pozicionin se doja t'i dua armiqtë e mi ashtu siç do t'i donte Jezusi. Dhe nuk e di se çfarë do të thotë kjo. Lidhje nuk kam. Një qëndrim i tillë lutjesh kërkon proaktivitet. Ju duhet vazhdimisht të hiqni qafe mendime të ndryshme që ju vijnë, duhet t'i largoni në mënyrë aktive mendimet e tilla nga vetja dhe të dëgjoni atë që ju intereson urdhri, çfarë donte të thoshte me këtë, çfarë nënkuptonte me këtë, çka është ajo? Pra, nuk e kuptova drejtpërdrejt se çfarë do të thotë dashuri për armikun.

Por në një moment, pas afër një jave këmbëngulje lutjesh, u ndjeva e lirë nga logjika "ose ata ose ne", nga logjika e dhunës. A e shihni ndryshimin midis kësaj logjike dhe logjikës së konventës së Fushatës Kundër Luftës! Prandaj mund të thuhet: "ata, kriminelët janë tanët", ose prandaj dikush që është i dënuar për krime lufte thotë se do të bënte të njëjtën gjë. Pra, ose nuk është penduar ose mendon se në fakt është viktimë dhe hero, jo kriminel, sepse ka bërë atë që duhej bërë. E unë e di që nuk duhej bërë dhe nuk jam dakord që duhej bërë. Kjo është qartësia që fitova përmes procesit shpirtëror përballë dhunës rreth meje dhe brenda meje. Pra, në këtë kuptim, unë kisha procesin tim. Papritur, njëra pas tjetrës, shfaqeshin situata të reja për të cilat doja të kisha një qëndrim të qartë dhe të mos ndikohem nga ngjarjet. Le të themi, ishte situata që kur të bie Vukovari, do të binte edhe Osijeku. Dhe çfarë do të bëj tani? A do të shkoj në dëbim, do të iki apo do të qëndroj? Nëse qëndroj dhe serbët e pushtojnë Osijekun dhe e pushtojnë spitalin, dhe unë shkoj të punoj në spital. Çfarë jam unë, bashkëpunëtore e tyre? Kush jam unë? Si të vendosem? Pra, tek unë proceset shkonin në nivelin e vlerave themelore dhe përmes kësaj, tashmë i kisha kaluar të gjitha bashkë kur u takuam të dy, unë dhe Kruno, dhe më pas ishim një kombinim shumë i mirë. Kruno, ateist, humanist, kundërshtar i ndërgjegjes për arsye politike. Ai thoshte se nuk dëshiron të jetojë në një komunitet politik që i zgjidh gjërat me luftëra, që e konsideron luftën si një mënyrë legjitime.

Tani për tani po jetoj një jetë të plotë, të plotësuar, të gëzueshme. Jam në pension, formalisht, marr pension, ndaj nuk kam pse të shqetësohem për ekzistencën time. Fëmijët e mi janë të rritur, të gjithë kujdesen për veten e tyre, kanë familjet e tyre, janë në rrugë të mira, jemi shumë të ngjashëm në botëkuptim në çdo gjë, veçse unë jam besimtare, ata për vete thonë se janë ateistë dhe agnostikë, por po jetojmë mirë. Unë jam ende i angazhuar në punë paqësore dhe dy vitet e fundit jam përpjekur të punoj punë paqësore dhe veprim jo të dhunshëm, të cilën e kam provuar përmes praktikës në ndërtimin e paqes të pasluftës, për të provuar nëse është e mundur të zbatohet në arenën politike gjithashtu. Pra, unë jam një nga bashkëthemeluesit e Institutit për Edukimin për Paqe dhe Veprimin e Politikave kundër Dhunës. Pra, merremi me teorinë dhe praktikën e veprimit politik, jo të dhunshëm. Po ashtu, jam përfshirë edhe në politikën formale - jam këshilltare në Këshillin Bashkiak të qytetit të Osijekut, prej 2 vitesh, dhe aty provoj në praktikë se çfarë do të thotë veprim politik jo i dhunshëm. Ja, këtë po e provoj dhe është shumë sfiduese për mua, gjithashtu po m'i hap disa njohuri të reja dhe, natyrisht, pyetje.

THE RIGHT LIVELIHOOD

Etika dhe estetika e rezistencës

Staša Zajović është një nga figurat kryesore të aktivizmit kundër luftës në Serbi dhe një nga themelueset e organizatës “Gratë me të zeza”, që njihet për qëndrimin e fuqishëm kundër luftës dhe padrejtësive. Ajo lindi në Nikshiq, në Mal të Zi, në një familje punëtore dhe antifashiste, dhe ishte një nga gjashtë fëmijët. Pas përfundimit të shkollës së mesme në vendlindje, ajo i vijoi studimet për Filologji Romanike në Universitetin e Beogradit. E rritur në një mjedis me frymë antimilitariste dhe e ndikuar nga kundërkultura e viteve 1968, Staša u bë pjesë e lëvizjes antiluftë me pasion dhe devotshmëri.

Fryma partizane e familjes dhe vlerat e socializmit jugosllav ndikuan thellësisht në formimin e saj etik dhe moral. Po ashtu, shkollimi i saj, prirjet artistike dhe lidhjet me disidentët latino-amerikanë dhe aktivistët italianë të paqes, i dhanë formë qasjes së saj të fortë për veprime të guximshme performuese. Përmes organizatës “Gratë me të zeza”, Zajović ka udhëhequr vazhdimisht veprimtari kundër luftës dhe dhunës, duke nxitur ndërgjegjësimin shoqëror dhe duke përforcuar kauzën për paqe.

Ajo beson më shumë te veprimi sesa te fjalët e zbrazëta. Duke u përpjekur për të ndërtuar dialog mes vetë grave dhe për të fuqizuar viktimat e luftës, Staša kërkon gjetjen e dezertorëve dhe luan një rol aktiv në organizatën “Gjykata e Grave”. Kjo është jeta dhe veprimtaria e saj për drejtësi dhe paqe.

Staša Zajović

Familja dhe fëmijeria

Unë jam Staša Zajović, e lindur në vitin 1953 në Jugosllavi, në qytetin e Nikshiqit, në Mal të Zi. Fëmijërinë dhe vitet e para të jetës i kam kaluar në këtë qytet, i cili për mua mbart kujtime të veçanta. Në vitin 1972, u shpërngula në Beograd për të ndjekur studimet dhe që prej atëherë kam mbetur aty. Aktualisht, jetoj në Zemun, një vend ku ndihem si në shtëpi, ashtu siç ndihem edhe për qytetet e mia të prejardhjes, Nikshiq, Çetinje, si dhe shumë të tjerë që ruajnë një vend të veçantë në zemrën time.

Familja ime kishte rrënjë të forta punëtore dhe një vetëdije të theksuar proletare. Babai im ishte një burrë me dëshirë të madhe për emancipim. Ai u largua nga fshati në vitin 1940, duke thënë: “Nuk e dua fshatin, e urrej fshatin, dua të shkoj në qytet!”

Kur ai erdhi në qytet, filloi të punonte dhe u bë një punëtor i ndërgjegjshëm. Ai shumë shpejt u njoh me nënën time. Nëna ime vinte nga një fshat pranë Kollashinit dhe, pasi kishte humbur nënën e saj në moshën shtatë-vjeçare, shkoi të jetonte me tezen, e cila kishte një mënyrë të jetuari më konservatore. Tezja kishte plane që nëna ime të martohej me dikë nga zona, por nëna zgjodhi rrugën e saj, duke dalë në qytet, ku edhe njohu babanë tim në shëtitoret e famshme të korzës. Kjo histori dashurie ka mbetur për mua diçka magjike dhe gjithmonë i kam dashur fotografitë ku ata ecin bashkë. Jam e sigurt se tezja nuk e pranoi kurrë këtë zgjedhje, por prindërit e mi ishin të vendosur dhe të dashuruar.

Mendoj se ata ishin ideologjikisht shumë të ndryshëm. Tezja mendonte se nëna ime po përjetonte tragjedinë më të madhe, sepse babai ishte një proletar, një komunist. Them komunist, edhe pse ai nuk ishte anëtar i partisë, edhe pse atëherë ishte, por kjo nuk ka rëndësi. Kështu që ata u martuan në vitin 1940.

Kujtimet e mia të para janë të lidhura me atë lagje punëtore, që për mua është më shumë se një vendbanim – është një ëndërr romantike dhe fantastike, një vend ku të gjithë ne jetonim si një familje e madhe. Lagjja ime ishte një shoqëri e thjeshtë, pa hierarki e pa ndarje të veçanta shoqërore; nuk mbaj mend të kishim ndonjë person me pushtet apo ndonjë funksionar partie. Ishte një vend, ku të gjithë ishim të barabartë dhe kjo për mua përfaqëson esencën e asaj që unë e quaj “socializmi im” - “Jugosllavia ime” - një botë ku të gjithë jetonin në harmoni, së bashku, sidomos gratë që mbartnin fuqinë dhe përkujdesjen për të gjithë komunitetin.

Ishte diçka e mrekullueshme për mua të kisha tezen time, Ollgën. Në fakt, në jetën time kam pasur tri teze me emrin Ollga dhe lidhja jonë ishte e ngushtë dhe e mbushur me besim të ndërsjellë. Kur nëna ime dëshironte të shkonte për vizitë te të afërmit e saj, ajo ia linte fëmijët tezes me fjalët: “Olga, ja ku i ke fëmijët, kujdesu për ta”. Dhe kur tezja shkonte tek të sajët në Cetinje, ia linte fëmijët nënës sime. Kjo për mua ishte diçka magjike, sepse jetoja në një atmosferë, ku të gjithë kujdeseshin për njëri-tjetrin me dashuri dhe besim të plotë.

tranzicion mjaft i vështirë për mua, sepse kishim një kujdestare klase të mrekullueshme në shkollën fillore, që nxiste shoqërimin dhe unitetin. Kur mbaroi, kur erdha në shkollën e mesme, në një mjedis të ri, pikërisht ai tranzicioni ishte i vështirë për mua. Qaja, shkoja në shtëpi, në shkollë fillore, te kujdestarja e klasës, e kështu.

Ne ishim gjithmonë bashkë, burra dhe gra, e të gjithë së bashku shkonim për t'u larë në lumë. Babai im na shoqëronte dhe këmbëngulte që të gjithë të mësonim të notonim, duke thënë: "Vajzat, të gjitha duhet të dinë të notojnë."

Ishte një mjedis ku vajzat dhe djemtë trajtoheshin në mënyrë të barabartë; gjithçka bëhej bashkërisht, pa dallime. Nuk jam e sigurt nëse kjo vinte nga fryma e socializmit, apo nga fakti që babai im ishte një njeri shumë i emancipuar.

Ai gjithashtu më inkurajonte të shkoja në fushë për të luajtur futboll, sport të cilin e doja me shpirt! Për mua, futbolli në shkollën fillore ishte shumë më tepër se një lojë – ishte një mënyrë për të gjetur zërin tim dhe për t'u ndjerë e lirë.

Në atë kohë, askush nuk dallohej nga të tjerët, madje edhe kur dikush kishte një status më të lartë, kjo nuk ndikonte në marrëdhëniet tona. Mbaj mend një shoqe, që e kishte babain drejtor, por prindërit e saj e kishin mësuar që, nëse kishte më shumë para se ne, të blinte diçka për të gjithë dhe të thoshte: "Babi më ka thënë që duhet t'i ndaj të gjitha me shokët."

Nuk kam përjetuar trauma; familja ime ishte thellësisht partizane nga të gjitha anët. Tetot e mia kishin kaluar nëpër kampe italiane dhe burgje, ndërsa të tjerët kishin qenë luftëtarë të lirisë. Babai im kishte luftuar në shumë beteja dhe mbante një pozicion të lartë pas luftës, si shumë të tjerë, por nuk e ndihej si njeri pushteti. Ai kishte një shpirt rebel dhe guximtar, gjithmonë kundër padrejtësive. Ka shumë episode nga jeta e tij, veçanërisht gjatë vitit 1948, kur ai dhe të tjerët u internuan në Goli Otok.

Ai nuk ishte rusofil, edhe pse kishte dashuri për literaturën ruse dhe gjithmonë na inkurajonte të lexonim dhe të mësonim. Thoshte shpesh: "Lexoni Dostojevskin, Tolstoin, Xhek Londonin…". Leximi ishte i shenjtë për të, një rrugë drejt njohjes dhe formimit tonë. Gjithashtu, teatrot e qytetit ishin pjesë e jetës sonë kulturore dhe shpirtërore.

Në atë kohë, kjo gjë nuk përbënte problem as në shkollë dhe as në asnjë aspekt tjetër të jetës. Ndoshta për këtë arsye ishte më e thjeshtë për mua të merrja vendimin se kurrë nuk do të përfshihesha në pushtet.

Babai im, si të gjithë të tjerët që ishin në Goli Otok, mësoi të ndërtonte dhe shtëpinë tonë e ngriti vetë, me ndihmën e miqve dhe fqinjëve, përmes përkushtimit dhe ndihmës së ndërsjelltë, pa mbështetje nga shteti. Ai kurrë nuk kërkoi rehabilitim; thjesht jetonte me thjeshtësinë e një proletari të vërtetë, një internacionalist. Gjithë jetën punoi çdo punë, që i doli përpara dhe përfundoi duke punuar si mbledhës faturash në elektrodistribucion. Ajo që kishte më shumë rëndësi për të ishte edukimi i vetes – lexonte, punonte, dhe kthehej sërish te librat. Ishte një mënyrë jetese, që vinte nga përkushtimi dhe dashuria për dijen, jo nga ndonjë ide për punën si kult.

Në familjen tonë, të gjithë bashkëpunonim si një skuadër e vërtetë. Fryma e solidar-

itetit ishte e rrënjosur thellë tek ne. Që nga fëmijëria e kisha përgjegjësi timen të ndihmoja nënën. Babai kujdesej gjithashtu për disa nga shokët e tij që ishin në vështirësi; disa prej tyre ishin braktisur nga gratë dhe mbështeteshin në këtë ndihmë të ndërsjelltë, që për ne ishte mënyrë jetese. Mbi ta ishte ushtrua një presion i madh për t'u distancuar nga njerëzit e tyre. Disa përfunduan duke mbetur pa gra. Asnjëherë nuk do ta harroj njeriun që quhej Mosha, të cilin çdo të shtunë e shoqëroja me babanë tim me biçikletë, për ta ndihmuar të pastronte shtëpinë. Ishte një përvojë e dhembshme dhe traumatike, jo vetëm për të, por edhe për mua, pasi ai jetonte në kushte të papërballueshme dhe vajza e tij kishte vështirësi zhvillimi.

Ky ishte një mësim për mua që mikpritja dhe solidariteti nuk varen nga lidhjet e gjakut. Nuk u rrita në një mjedis, ku lidhjet familjare janë ato që vendosin gjithçka. Ajo që është e vërtetë dhe ka rëndësi, janë lidhjet emocionale dhe kulturore, ato që na lidhin dhe na bashkojnë si njerëz. Ndoshta po e idealizoj atë periudhë, por e bëj këtë sepse isha e lumtur dhe e kënaqur, sepse ajo periudhë për mua ishte e mbushur me liri.

Liri, sepse kurrë nuk pata kufizime nga prindërit, mund të shkoja kudo ku dëshiroja, në çdo kohë që dëshiroja. Kjo liri më udhëhoqi dhe më formoi, sepse më ishte dhënë një përgjegjësi dhe një mundësi për të vendosur vetë se si ta përdor atë. E mora lirinë, mora përgjegjësinë dhe e kuptova që mund ti bëja vetë zgjedhjet.

"Çfarë do të bëj tani, kur të kthehem në shtëpi?" pyesja veten. Dhe përgjigjia ishte: "Pse më pyet mua?". Ky ishte një moment besimi, dhe mendoj se ishte jashtëzakonisht i rëndësishëm, veçanërisht për një grua. Unë kam pasur pesë motra dhe një vëlla. Vëllai im kishte një emër të veçantë, emrin e heroit më të njohur malazez, Ljubo Çupiq, të cilin ne e quanim "Çe Gevara i Malit të Zi".

Duhet të theksoj se marrëdhënia ime me nënën ka qenë gjithmonë shumë e ngushtë dhe e veçantë. Kurrë nuk ka pasur tensione mes nesh. Nëna ime, si një grua nga fshatrat malore, ishte shumë e turpshme dhe shpesh e ngarkuar emocionalisht. Ajo kishte kaluar shumë vuajtje, duke përjetuar humbjen e një prej tre vëllezërve të saj, të gjithë partizanë, njëri prej të cilëve u vra nga çetnikët. Kjo dhimbje e thellë e shoqëroi atë gjatë gjithë jetës. Për më tepër, ajo kishte një lidhje të fortë me fisin e saj. Ajo më mësoi se fisi është vendi nga vijnë gratë, ndërsa atdheu është vendi nga vijnë burrat – kështu mendonte ajo dhe kështu e perceptonte lidhjen me familjen e burrit.

Një nga aspektet që më ka pëlqyer te marrëdhënia me nënën, ishte se ajo nuk kishte dëshirë të ndërhynte shumë në jetën time personale. Kjo nuk kishte të bënte me ndonjë ide teorike të emancipimit, por sepse ishte një grua e turpshme, që besonte se nuk kishte të drejtë të shkelte shumë kufijtë e intimitetit, të pyeste për çdo detaj, apo të më monitoronte. Ajo nuk më pyeste drejtpërdrejt: "Kush është ai djali, a ke të dashur, dëshiron të dalësh me të?".

Përkundrazi, ajo më shihte dhe përmes vëzhgimeve të saj të thjeshta, arrinte të kuptonte gjithçka, që unë nuk e thosha. Këto vëzhgime ishin të ngjashme me një lloj feminizmi të natyrshëm, që mua më ka ndihmuar shumë dhe më ka bërë ta ndjej veten të afërt me të. Ajo e dinte, që kisha shoqe, kisha motra dhe kështu me radhë. Për mua, kjo ishte një pozitë e shkëlqyer, e mbushur me besim të madh.

Një tjetër gjë e rëndësishme që kam mësuar ishte disiplina e punës në të cilën u rrita, duke përmbushur çdo detyre. Ajo na kishte caktuar detyra. Çdo të shtunë kishim një listë dhe e përmbushnim atë. Kishim detyra të tilla si: “Shko te teze Stana, shko te gjyshja Stana. Shiko nëse ndonjëra nga ato gra ka nevojë për diçka, dhe nëse është e nevojshme, bliji dhe pastroje”. Kjo ishte një gjë shumë e bukur dhe e vlefshme.

Dua të them se kemi detyrën për të analizuar dhe për t’i ndarë disa marrëdhënie dhe të mos i ngushtojmë ato vetëm në konfliktin që ndodhi, një konflikt që e di që shumë nga shoqet e mia e kanë pasur – një përplasje mes nënës dhe vajzës. Ashtu siç thotë Simone de Beauvoir: “Nuk është e drejtë që vajzat të kërkojnë shumë nga nëna, nga gratë”. Ai thotë: “Nëna të jep atë që mundet, që di dhe që ka”. Nuk më duhej shumë ajo, nuk kisha nevojë për mësime të veçanta prej saj. E rëndësishme ishte të kuptoja se çfarë nënkupton politika e fjalëve dhe çfarë nënkupton politika e veprave dhe si gjejmë balancën mes asaj, që themi dhe asaj që bëjmë. Më e mrekullueshmja tek nëna ime ishte se ajo nuk ndërpreu kurrë marrëdhënien me asnjë grua, me të cilën burri i saj ka pasur konflikte, apo me bashkëshortet e atyre që ai ishte përballur. Ky ishte një mësim i fuqishëm për mua, edhe pse kur isha e vogël, dhjetë vjeç, herë pas here ndihesha e zemëruar.

Më kujtohet një herë kur nëna ime shkoi te njëra prej Ollgave jashtë qytetit, pasi kishim tri Ollga në familje. Unë e takova rrugës dhe e pyeta: “Çfarë po bën, nënë?” Ajo m’u përgjigj: “Çfarë të duhet ty, unë nuk pyes me kë ikën ti”.

Në atë moment, mendova se po tradhtonte familjen, pasi bashkëshortët kishin dy vjet që nuk flisnin. Por, më vonë e kuptova thelbin e solidaritetit dhe joluajalitetit, dhe se çfarë do të thotë të jesh solidare në një kuptim më të thellë. Kur je solidare, duhet të jesh joluajale ndaj disa gjërave, ndaj fisit, kombit dhe shtetit. Ishte një mësim i jashtëzakonshëm që më dha nëna ime. Ajo më tha: “Çfarë mendove, se do t’i braktisja unë shoqet e mia?”

Gratë, në ato kushte të vështira jetese kanë qenë shumë të lidhura me njëra-tjetrën dhe ai ka qenë një mësim i çmuar që kam marrë. Nënës sime kurrë nuk i kam dëgjuar të thotë ndonjë fjalë të keqe për tezat e mia, madje as për gjyshen. Ajo gjithmonë ka treguar një respekt të thellë dhe ka ndarë një lidhje të ngushtë me to, pavarësisht vështirësive, që kanë kaluar. Ajo më ka mësuar, që nuk duhet të varesh nga askush përveç vetes, dhe se duhet të jesh e fuqishme, për të siguruar të ardhurat për familjen.

Një nga këshillat më të çmuara që më ka dhënë, ka qenë: “Mos u marto, por merr një diplomë”. Kjo ishte shumë e rëndësishme për të, sepse në sistemin socialist, ku arsimi ishte falas dhe mundësitë për të mësuar ishin të mëdha, ajo dëshironte që ne të ishim të arsimuara dhe të pavarura. Ajo vetë ishte shumë e angazhuar në organizatën FAG (Fronti Antifashist i Grave) dhe ka ndjerë zhgënjim të madh kur ajo organizatë u shua. Gjyshja ime më tha njëherë: “Kur mbyllën FAG-un, u trishtova, sepse atje shkonim dhe kur burrat ishin të pasjellshëm, i denonconim dhe i bënim ata të turpëroheshin publikisht”.

Për shkak se vëllai im ishte i vetmi djalë dhe babai im gjithashtu ishte vetëm një djalë, ky fakt kishte një rëndësi të veçantë, pavarësisht ndikimit në marrëdhëniet e familjes tonë. Çështja nuk qëndronte tek ndikimi i këtij fakti në jetën e vëllait tim, por ishte një çështje identifikimi pozicionesh, ashtu siç e shpjegon Simon dë Bovuar. Për djalin, për

Ljubën, gjithçka ka një dimension më të lartë, një nivel më të theksuar, që e bënte më të rëndësishëm. Megjithatë, duhet thënë se për babain tim ishte shumë e rëndësishme të kishte një djalë, pavarësisht gjithë kulturës proleteriane dhe internacionaliste që ai mbronte. Kjo ishte një dëshirë e thellë dhe e fortë, që e bënte këtë çështje edhe më të rëndësishme për të, përtej vlerave që mbante në nivel shoqëror.

Mendoj se nuk ka pasur ndonjë lloj favorizimi, nuk kam vënë re, që diçka e tillë ka ndodhur, madje kam disa shembuj në kundërshtim me këtë. Kam qenë më e suksesshme në shkollë sesa ai, sa babai im gjithmonë thoshte: "Jo, jo, jo" dhe më vonë, edhe në fakultet, ai thoshte: "Po shoh rezultatet" dhe i thoshte: "Motra jote është më e mirë se ti" Kjo ishte diçka që ai e shprehte publikisht.

Unë kam qenë shumë e afërt me motrat e mia, ato ishin shoqet e mia të ngushta. Ato ishin më shumë se thjesht motra, ato ishin të besuara dhe mbështetje për mua. Në këtë sistem patriarkal, e ndieje se nuk mund të mos e shqetësoje dikë, duke i kërkuar ndihmën apo përkrahjen, apo duke ngjallur reagim përveç se me shoqet, pasi ato mund të të kuptonin më mirë. Kështu, oborri ishte si një lloj kuvendi i vogël, si një agorë, sepse të gjithë jetonim aty. Të gjithë dëgjonin: babai im dëgjonte "Zërin e Amerikës" "Radio Moskva"-n, të gjithë dëgjonin dhe të gjithë diskutonim, flisnim vazhdimisht. Më pas, shkonim në anën tjetër të rrugës, ku jetonin disa oficerë të Ushtrisë Popullore Jugosllave. Ne ishim rritur me mendimin se, megjithëse ata ishin partizanë, nuk duhet t'i donim, e thënë ndryshe, nuk i doja.

Njëherë, një vajzë që mësonte në shkollë me mua më tha: "A mund të vij tek ti?" Unë i thashë: "Po, mundesh." Pastaj, të gjithë filluan të bërtisnin, të qeshnin, të flisnin dhe të diskutonin. Kur vajta tek ajo, ajo më ftoi: " Hajde tek unë" dhe aty gjithçka ishte shumë e qetë, të gjithë ishin të heshtur, të sjellshëm. I thashë: "Pse është kaq bukur dhe e qetë këtu? Askush nuk grindej, më pëlqente shumë. Aty tek ne, të gjithë grinden dhe askush nuk e dëgjon tjetrin". Kur flisnim vazhdimisht, gjithmonë futeshim në debate të mëdha.

Kishim shpesh detyra dhe angazhime shkollore. Kam mbajtur kontakte me atë shoqen, ajo jeton në Kotor dhe çdo herë kur shkoj atje, gjithmonë e vizitoj. Pra, kishte dy botë, njëra ishte ajo e oficerëve të Ushtrisë Popullore Jugosllave dhe tjetra ishte jona. Pikërisht atëherë, për herë të parë, m'u ndez një kulturë antimilitariste.

Babai nuk fliste për probleme të mëdha rreth tmerrit ose për ndonjë betejë, që ai e analizonte para vetes dhe e konsideronte si të humbur. Por, ai na fliste shumë për Sava Kovaçeviqin, një figurë e rëndësishme për lëvizjen partizane malazeze, një njeri nga baza, nga një familje e famshme me njerëz të arsimuar, por i rritur në fshat dhe kishte një dimension të lartë etik. Për mua, ai ishte një person i rëndësishëm, një figurë e veçantë. Sepse më vonë u njoha edhe me familjen e Kovaçeviqëve këtu. Shoqja ime më e mirë, për të cilën nuk e dija që vinte direkt nga kjo familje, ishte Biljana Kovaçeviq Vuço, një juriste dhe avokate e famshme, një figurë legjendare. Punonim shumë së bashku dhe ajo ishte nga kjo familje; babai i saj, Veljko Kovaçeviq, ishte një luftëtar legjendar i Luftës në spanjë, i cili, nga dëshpërimi në fillim të kësaj lufte, kreu vetëvrasje. Pra, ka shumë lidhje të ndryshme.

Ajo luftë vëllavrasëse në Mal të Zi ishte e tmerrshme dhe ende ekziston edhe sot, një ndarje e frikshme midis partizanëve dhe çetnikëve, që vazhdon deri në ditët e sotme;

ja, kjo është ajo që më ka formuar në jetë, një arsye e thellë deri në ditën e sotme. Dhe kjo nuk ishte aq traumatike, për cka tregonte babai im.

Babai im mbronte një ide të qartë, nevojën për një revolucion botëror, proletar. Kjo ide e tij ishte pa kufinj dhe pa kombësi; kjo ishte ideja e tij. Sepse ashtu e ëndërronte ai dhe mendoj, natyrisht, se kjo ide ishte e lidhur me Bashkimin Sovjetik.

Ne nuk kishim çerdhe për fëmijë, por gra punëtore; pra, kujdeseshim për njëra-tjetrën, dëgjova njëherë prej një shoqes time: " po çfarë çerdheje e zezë" ne nuk kemi statusin klasor që të kemi një çerdhe". Nuk di nëse babai im kishte tokë; mendoj se kishte ndonjë gjë në pyll, me siguri të vogël dhe jo shumë fitimprurëse. Mendoj se shiti diçka për të blerë një vend për shtëpinë.

Nikshiqi është qytet urban, proletar, një qytet që ka shumë forma të jetës qytetare, ka një shesh të madh e të gjerë, dhe gjithmonë ka qenë mahnitës fakti që ai shesh u projektua në vitet '20 të shekullit XX nga Josip Slade, një arkitekt çek. Edhe në ditët e sotme unë shkoj gjithmonë në atë shesh. Ka shumë pak gjëra të ndryshuara aty, është mirëmbajtur mjaft mirë; është një shesh me një agora. Mendoj, se çdo qytet, që është vërtet qytet, pra një "polis," duhet të ketë një shesh të rrethuar me kafene, me kafene qytetare, ku gjithçka është e njohur, ku shkohet për të dëgjuar lajmet, për të kritikuar pushtetin, dhe si çdo popull, që duhet të flasë, duhet të diskutojë dhe jo vetëm të punojë, për të plotësuar nevojën për bisedë, apo për të menduar.

Unë vij nga një familje ateiste, por në lagjen time kishte shumë njerëz që besonin të shenjtët dhe unë e doja këtë gjë. Të gjithë shkonim tek njëri-tjetri. Madje, kur ishim fëmijë shkonim shpesh në manastirin Ostrog, sepse ai ishte një monument kulturor, një vend i shenjtë ku shumë njerëz shkonin atje, sepse besonin se kishte fuqi shëruese.

E mbaj mend shtëpinë si një strukturë të madhe horizontale. Mami punonte në shtëpi. Mendoj se të gjithë punonim, po. Të gjithë duhej të kontribuonim në atë lloj atmosfere pune. Kishte shumë dhoma. Për shembull, tre, katër dhoma, mjaft dhoma dhe ishte horizontale. Për ne ishte e rëndësishme; po pse është e rëndësishme që shtëpia jetë horizontale? Nuk kishte kate. Të gjitha shtëpitë në atë kohë ishin horizontale, të shtrira kështu. Kjo më mbeti si një model: një arkitekturë horizontale. Të gjithë hanim jashtë, kishte shumë pemë, me tepricë, lisa, pisha, shumë, shumë, të shumta. Sepse jeta zhvillohej në një lloj agore të vogël. Të gjithë thërrisnin njëri-tjetrin para shtëpisë dhe të gjithë jetonin jashtë nga pranvera e hershme e deri në vjeshtë, nga muaj prill deri në vjeshtë, që është gjysmë viti. Në orën dy, më së voni hanim drekë, kur ishim bashkë e kur nuk ishim në shkollë gjatë verës. Duhej të hanim në dy, atëherë askush nuk mund të ishte jashtë, përveç grave, që e kishin përgatitur atë, pra fqinjëve. Nëse burri shkonte të flinte, ato uleshin dhe askush nuk guxonte t'i shqetësonte deri në orën pesë. Askush nuk guxonte t'i shqetësonte, dhe ato flisnin ose pinin kafe ngadalë.

Pra, ishte një lloj kontakti social; ose qëndronin në heshtje së bashku, ose bisedonin. Ne fëmijët nuk kishim të drejtë të dilnim, apo të flisnim me zë të lartë, sepse na dërgonin në çdo dhomë; unë, për shembull, isha në dhomën më të madhe dhe deri në orën pesë duhej të qëndroja vetë në errësirë. "Luani lojëra, bëni ç'të doni, por nuk duhet të na shqetësoni dhe nuk duhet të endeni vërdallë." Në fillim ishim të zemëruar, por

nuk duhet të na shqetësoni dhe nuk duhet të endeni vërdallë." Në fillim ishim të zemëruar, por më vonë lodheshim, flisnim, flisnim dhe qeshnim. Ishim në garë se kush dinte të qeshte më shumë e më mirë. Dhe shpiknim gjithçka, shpiknim çdo gjë, sepse nuk kishim lodra, dhe vazhdimisht shpiknim; ishte në fakt një metodë kreative pedagogjike.

Ne duhej të shpiknim lojëra. Duhet të shpiknim lojëra; sepse nuk e dinim çfarë do të thoshte të kishim lodra. Së pari, babai im nuk kishte mundësi për to, së dyti, nuk do të na lejonte, dhe thoshte: "Aha, nëse fëmijët mërziten, kjo është një tragjedi. Fëmijët nuk duhet të mërziten; duhet të shpikin." Kështu që nuk ishte e nevojshme të na blinte lodra. Kur binte shi, ne dilnim të bënim "kekë" në pellgjet e ujit. Pastaj, kur fillonte të pritej bari për kashtë dhe mbulohej kudo, gjenim mënyra për të luajtur. Bënim gara kur përrenjtë ktheheshin në lumenj të vegjël, ose dhe kur niste të shkrihej bora ne zhvillonim gara.

Ne thonim: "Aha, po shkojmë në park," por në park ishte shumë e rrezikshme nëse mund të prishje diçka. Kisha shumë frikë nga pylltari që ruante parkun. "Nëse bëje diçka, do të të vinte pylltari të të ndëshkonte" dhe thoja: "Kam bërë një vijë në atë stol." "Aha! Do të vijë tani të më ndëshkojë," jo po policia, jo po milicia; por të paktën ai park ishte një e mirë publike dhe duhej ta ruanim. Ndoshta unë e idealizoj, por kështu e shihnim atë. "Shkoni në park, mos shkruani asgjë, mund të shkoni edhe në varreza". Dhe varrezat na pëlqenin. "Shkoni në park, mos bëni asgjë dhe do të merrni akullore," natyrisht te Pelikani, që ishin shqiptarë, ose goranë. "Shkoni bashkë!"

Pastaj, me të rriturit shkonim në kinema të gjithë së bashku, kolektivisht; gjithë lagjja shkonte në kinema, të gjitha gratë. Ajo ishte një sallë e madhe që shërbente edhe për teatër. Ishte edhe një klub kulturor, shoqërinë këngëtare "Zahumlje," më e vjetra në Mal të Zi, ku shkonin motrat e mia për belkanto. Pra, kishte shumë pika dhe më e rëndësishmja për mua, kur fillova të lexoja intensivisht, të gjithë lexonim, ishte biblioteka. Ajo ishte si një tempull kulture për ne.

Arsimimi dhe rinia ime

Kam parë “Magjistarin e Ozit,” për shembull; “Magjistari i Ozit” ishte filmi im i preferuar në shkollën fillore… Luheshin edhe filmat me kauboj.

Në shkollë shfaqnin filma të tjerë, si “Oklopnjaça Potemkin” të cilin e pamë disa herë, si dhe filma partizanë. Ndërsa në qytet shfaqej një repertor perëndimor, filma italianë – shumë filma italianë. Sa për koncertet, nuk më kujtohet asnjë muzikë ushtarake, vetëm koncerte të ndryshme; madje nuk më pëlqejnë aspak lahutat.

Lahutat janë të huaja për mua edhe sot, nuk i pëlqej fare. Por, kishte shumë koncerte. Shkonim te Zahumlje për të parë koncerte belkantoje, kryesisht këtë lloj muzike. Kishte gjithashtu edhe koncerte, që grumbullonin komunitetin jugosllav, si koncertet e tipit “Kënga e verës.”

Për mua muzika më e rëndësishme ishte rock-u. Veçanërisht, muzika antiluftë dhe rebele që lindi me protestat e luftës së Vietnamit ishte më e rëndësishmja. Natyrisht edhe lëvizja hippie, por mbi të gjitha Bob Dylan dhe Jimi Hendrix – pra jeta dhe rinia ime u ndikuan nga ai qëndrim amerikan kundër luftës. Këta ishin heronjtë tanë, të paktën për mua dhe për disa njerëz, me të cilët shoqërohesha, ishin më të rëndësishmit. Por, na pëlqenin gjithashtu edhe këta në Bashkimin Sovjetik, sidomos ata që lexonin poezi në stadiume. Më linte mbresa të madhe kur Jevtushenko lexonte poezi përpara tridhjetë mijë njerëzve. Pastaj, mora një çmim për një poezi, nuk është diçka e rëndësishme – ishte në shkollën fillore, kur shkova në një përvjetor dhe çmimi ishte në emër të Desanka Maksimoviqit. Kur shkova në Valjevë, për herë të parë në Serbi, isha katërmbëdhjetë vjeç. Atje pashë sesi Desanka Maksimoviqi lexonte poezi në një stadium dhe për mua ishte një përvojë e mrekullueshme.

Kështu ishte Jugosllavia, nga njëra anë lart, ndërsa ajo shtetërorja – nuk ia kisha idenë se çfarë ishte, as që më interesonte çfarë bënin ata. Por, ekzistonte një frymë tjetër, kozmopolite, që kultivohej. Më pyesnin: “A nuk do të shkosh në parti, nuk do të shkosh në organizatën e rinisë?”

“Sigurisht, që nuk dua të shkoj në organizatën e rinisë.” Asnjëherë nuk isha pjesë e asaj organizate, vetëm tek pionierët, që ishte e detyrueshme.

“Më jepni shaminë”, kjo ishte e këndshme, por përndryshe, asgjë tjetër, asnjë formë tjetër. Nuk kisha aspak afinitet për këtë dhe nuk më pëlqenin njerëzit që shkonin në ato organizata, sepse ishin oportunistë. Nuk ishin shokë dhe shoqe të mira, nuk donin të solidarizoheshin me ne, për shembull, për ndonjë grevë të vogël, ndonjë ndërprerje në gjimnaz, dhe thonim: “Ne me ta nuk duam të shoqërohemi.” Ishte e rëndësishme të ishe kështu në atë sistem.

E mbaj mend ditën e parë të shkollës, ishte shtator, një ndjenjë e mrekullueshme – kujtoj një lloj militarizmi që ekzistonte, por mbi të gjitha kujtoj ekzaltim të madh kur blinim këpucë të reja, dhe ato këpucë i mbanim për një kohë të gjatë.

Eksitimi më i madh ishte kur takova mësuesen time, Dragica Draganiq; e adhuroja! Të gjithë e adhuronim. E vizitoja sa herë kthehesha në qytet. Më pas shkova në shkollë

fillore në veri të Malit të Zi, dhe për mua kjo ishte shumë e bukur. Motra ime punonte në një fshat, dhe unë shkoja në shkollë atje; gjithçka ishte e mrekullueshme. Shkova në Nikshiq dhe atë vit, kur motra ime, që sapo kishte përfunduar shkollën e mësuesisë, filloi punonte. Kur ajo lindi vajzën, burri i saj shkoi në ushtri dhe kështu unë shkova të jetoja me të.

Motra ime, Senka, ishte njëmbëdhjetë vjet më e madhe se unë dhe Tanja, vajza e saj, që ishte njëmbëdhjetë vjet më e vogël se unë – shumë e afërt.

Te motra ime ndihesha si në shtëpi, nëna vazhdimisht vinte për vizita. U lidhëm shumë me disa vajza nga ai fshat; nuk kam pasur fare probleme me komunikimin, sepse që nga fëmijëria të mësojnë se më vonë lodheshim, flisnim, flisnim dhe qeshnim. Ishim në garë se kush dinte të qeshte më shumë e më mirë. Dhe shpiknim gjithçka, shpiknim çdo gjë, sepse nuk kishim lodra, dhe vazhdimisht shpiknim; ishte në fakt një metodë kreative pedagogjike.

mund të mësosh të komunikosh vetë. Nuk mund të kërkosh mbrojtje nga mamaja dhe babai. Për shembull, nëse bëja një sherr me një djalë dhe i thoja: “Mami ai më goditi,” ajo do të thoshte: “Godite dhe ti atë.” Unë i thoja: “Me çfarë?” “Merr një gur.” Dhe kështu më mësonte: “Çfarë më thua ti? Nëse thua edhe një herë, do të të…” Nuk mund të ishte kështu, prindërit nuk mund të të mbrojnë vazhdimisht. Ishte një mënyrë tjetër edukimi, krejt e ndryshme.

Kam qenë tri vjet në shkollën “Braqa Ribar”, pastaj kalova një vit tjetër në veri te motra ime, por shumicën e kohës isha në Nikshiq, në krahinën time, afër shkollës “Braqa Ribar” dhe më pas shkuam në gjimnaz. Ishte po ashtu e mrekullueshme si në shkollën fillore.

Për mua ishte shumë e rëndësishme të kisha shumë seksione jashtë shkollës, jashtë mësimit të detyrueshëm; kisha seksionin letrar, seksionin e pikturës, seksionin për sport, dhe kështu me radhë. Dhe aty mund të gjeje njerëz që ishin të afërt me ty për nga interesat, me të cilët mund të shkruaje poezi, apo si dhe të lexoje poezi. Unë i njihja të gjitha shoqet dhe shokët e mi nga kjo krahinë dhe të gjithë ata që ishin pjesë e atij seksioni letrar. Ishte seksion i vogël, por shumë i dashur për ne. Ne ishim shumë krenarë për të shkruar, për të lexuar diçka dhe pastaj për të diskutuar mbi të. Kjo ishte e rëndësishme për ne, secili shkruante poezi dhe për mua kjo ishte ajo më e rëndësishmja. Mësuesi që e drejtonte atë seksion ishte shumë i hapur dhe mbështetës.

Më pas, ky sistem sportiv kolektiv ishte po ashtu shumë i rëndësishëm për mua. Më vonë vinin përgatitjet për “uljet” që zhvilloheshin çdo vit. Çdo qytet kishte uljet e tij dhe ishin më 25 maj. Ishte e rëndësishme që të bëje balet ritmik, gjimnastikë ritmike dhe kjo ishte gjithçka që kishte të bënte me një lloj bashkim, që nuk ishte një sport kompetitiv. Besoj që kjo ishte një vlerë e madhe, sepse sporti ishte i hapur për të gjithë për të zhvilluar shpirtin dhe trupin dhe kjo ishte fantastike. Ky koncept sportiv më pëlqente shumë.

Kam qenë gjithmonë anëtare e seksionit letrar. Pastaj, vazhdova të marr pjesë në seksionin e kulturës në gjimnaz dhe aty vazhdova të merrja pjesë në seksione. Ishte fantastike për mua, sepse nuk kishte asnjë lidhje me statusin shoqëror. Nuk kishte asnjë rast që dikush të mund të theksonte statusin e tij të klasës.

Në Nikshiq, gjithashtu gjimazi quhej Stojan Ceroviq. Unë ndoqa degën shoqërore-humaniste.

Jeta ime ndryshoi, sepse takova disa njerëz të rinj, shoqe të reja nga qyteti dhe shokë. Ata nuk ishin vetëm nga qyteti, por vinin edhe nga fshatra përreth Nikshiqit dhe kjo ishte shumë interesante për mua. Gjithashtu, fakti që ndoqa degën humanistike ishte diçka krejt ndryshe, nga sa do të kishte qenë në një degë teknike ose shkencore-matematike, sepse atje vinin nxënësit më të mirë, ndërsa ne, që ishim në degën humanistike, nuk ishim nxënësit më të mirë. Ne ishim ata që donim të endeshim, të shëtisnim në qytet, të shkonim në bibliotekë, të bënim protesta të vogla. Dhe asnjë nga ne nuk kishte pritshmëri të mëdha.

Ishte një lloj rebelimi i pafajshëm, nuk ishte një rebelim kundër mësuesve apo kundër shkollës, por një rebelim i këtij lloji: shoqja jonë Lidija ishte shumë e mërzitur, depresive, shumë e trishtuar, sepse ne e dinim që ajo nuk kishte shumë mundësi të dilte jashtë shtëpisë. Ajo nuk kishte lirinë të ecte në qytet kur të donte, të dilte në shëtitje, ndërsa unë kisha gjithë lirinë. Prandaj, unë e merrja shpesh me vete dhe e çoja gjithmonë përjashta. Disa shoqe të tjera nuk kishin po aq liri të dilnin në qytet sa unë, dhe atëherë i thoja: “O, kjo është e tmerrshme, Lidija është mbyllur nga nëna dhe babai, dhe unë e di që ajo është shumë melankolike,”. Prandaj i thashë: “E di çfarë, duhet të shkojmë ta kërkojmë aty në Zeta, afër lumit Zeta.” Dhe ata thanë: “Po, hajde shkojmë të gjithë.” Dhe kështu vepruam.

“Unë thashë do vi” dhe ai tha: “Nëse mundesh, ti gjithmonë ankohesh, kundërshtohet, gjithmonë kundërshtohet.” Kështu që ata gjithmonë të nxisin që duhet të kërkosh të drejtat e tua e për veten dhe të drejtat e drejtësinë për të tjerët. Ky është një akt normal, nuk ka asnjë problem nëse nuk duhet të mendosh për pasojat. Në shkollën e mesme isha shumë e kënaqur. Shkonim çdo natë në xhiro. Nuk kishim para, nëse ishte për kafe atëherë bashkë punonim, pastaj pinim. Pastaj, shoqja kishte më shumë para dhe ajo na çonte për kafe dhe kështu, na jepte dhe çokollata. Dhe tani me atë shoqen, ajo është në Podgoricë, komunikoj ende me të. Pra, duhet të them se atëherë nuk e shihja fare ndarjen klasore, statuset e ndryshme klasore, sepse gjithsesi ishte turp të shfaqej gjendja e pasurisë, megjithëse për mua kjo ishte shumë e qartë.

Në shkollë dëgjonim muzikë klasike. Muzikën klasike e dëgjonim në mësime dhe mësojmë për të dhe më pëlqente shumë. Edhe pse më pëlqente rock-u, muzikën klasike e dëgjoj më shumë, madje edhe në ditët e sotme. Kur profesori thoshte: “Hajde të dëgjojmë sot” ato pllakëza të mëdha longplay, nxënësit i përgjigjeshin: “Na është mërzitur, nuk duam ta dëgjojmë, është e mërzitshme”. Dhe unë i thoja: “Profesor, a mund ta marr me vete në shtëpi sepse askush nuk do ta dëgjojë.”

Në shtëpi kishim gramafon dhe unë thoja: “O Zot, çfarë muzike është kjo. Sa madhështore është kjo”, dhe kështu mora shumë nga ato pllakëza. Një natë u ngrita, dhe nëna më tha: “Ah! Sa e bukur është kjo muzikë.” “Këtë do ta dëgjojmë së bashku.” “E di,” thashë “kam lexuar,” kështu që ishte diçka e mrekullueshme. “Të dëgjojmë tani Shopenin, hajde të dëgjojmë tani Çajkovskin, hajde tani të dëgjojmë…”

Pra, ishte shumë e kënaqësi, që ekzistonte mundësia të vendosnim këtë lidhje të madhe me muzikën klasike, ashtu siç edhe motra ime, që kurdo që kishte koncert, shkonim gjithmonë sëbashku. Unë kam e dashur edhe muzikën tradicionale, çdo lloj, si muz-

ikën malazeze, shqiptare, indoneziane, nepaleze, peruane, është e njëjta gjë, di shumë rreth muzikës popullore tradicionale në përgjithësi".

"Përveç kësaj, letërsia e detyrueshme nuk ishte aspak kaq e rëndësishme. Unë shkoja në bibliotekë dhe bibliotekistja ishte shumë e rëndësishme për mua. Ajo quhej Vera Ceroviq. Ajo ishte e dashuruar me Mirko Kovaçin, shkrimtarin nga Nikshiqi. E dija ajo ishte e dashuruar me të, pasi gjithmonë na thoshte: "Do t'ju them çfarë duhet të lexoni…,". Ajo kalonte orë të tëra me çdo person që donte, ndoshta ajo shfrynte ndonjë dëshirë të saj, por mua më dukej shumë e mirë. Kështu që leximi ishte shumë i rëndësishëm. Motra ime më jepte libra dhe unë lexoja. Letërsia franceze ishte jashtëzakonisht e rëndësishme për mua, madje më e rëndësishme se ajo italiane, letërsia franceze, Flaubert, etj.

Letërsi të ndryshme, ruse, franceze dhe… Babai më thoshte: "Po mirë, duhet të lexoni edhe Xhek London." Unë i përgjigjesha: "Babi, unë nuk mund ta lexoj atë, më duket i mërzitshëm. Unë atë e kam lexuar në shkollën fillore". E rëndësishme ishte që kultura e leximit ishte shumë më e rëndësishme e televizioni nuk ishte kaq i rëndësishëm për ne". Radio ishte shumë e rëndësishme. Radio përdorej dhe jashtë shtëpisë, e vendosnin radion dhe të gjithë e dëgjonin atë. Por, më shumë se çdo gjë, ne donim dramat radiofonike, i ndiqnim me radhë. Pastaj, kishim disa emisione si 'Mbrëmja e Gëzuar'. Dramat radiofonike ishin ato që më pëlqenin më shumë, madje dhe tani i dëgjoj. Nuk mund ta imagjinoj dot, që dikush nuk ka një tranzistor, apo që tani nuk ka më nga ata tranzistorë si më parë. Pra, shumë më tepër vëmendje i kushtohej faktit që të mësoje, të mendoje, të krijoje, të shpikje dhe që gjithçka të mos të ishte thjeshtë e shërbyer, që gjithmonë duhej të fitoje dhe kështu me radhë.

Mendoj se cka ishte më e rëndësishme për mua, ishte internacionalizmi, gjithmonë më ka interesuar çfarë po ndodhte anembanë, p.sh., çfarë ka ndodhur në Vietnam. Akoma më shumë kur kishte uri në Bijafra, apo në Nigeri, gjë që më ka ka impresionuar shumë, pra më ka interesuar ajo që po ndodhte në planet. Mua më ka interesuar, duhet të them, pavarësisht nga fakti se ky internacionalizëm në ish-RFJ ishte imponuar nga lart, apo si dhe fakti që në një emision lajmesh dëgjon fillimisht çfarë po ndodhte në planet, qoftë për njëzet minuta ose diçka e tillë. Kjo zhvillonte horizonte të caktuara kozmopolite. Madje, përfshirë dhe lajmet nga Jugosllavia - kjo ishte pozita e tyre udhëheqëse. Unë nuk e kuptoja atë, sepse gjithçka ndodhte në nivelin e asaj partie dhe unë nuk kisha asnjë lidhje me të, nuk kisha pasur asnjë lidhje dhe shumë herët e kuptova që nëse nuk do, atëherë duhet të paguash një çmim të caktuar - rrezikun për ta marrë diçka.

Babai im e shante Titon gjithmonë, gjithmonë e shanin, flisnin me zë të lartë për të. Mua kjo nuk më interesonte, më interesonte më shumë çfarë po ndodhte në planet. "Si mund të mblidhen 300 mijë veta, aq sa ishin njerëzit në Woodstock, kjo ishte për mua gjëja më e rëndësishme, gjëja më e gjallë. Dhe isha shumë e shqetësuar, shumë e tronditur kur tanket shkuan në Pragë. Kur isha në klasën e tetë kisha një koleg të motrës sime, i cili kishte filluar të punonte në fabrikën e çelikut, Mirosllavi, një inxhinier nga Çekia. Ai vinte gjithmonë tek ne. Hante dhe jetonte dhe diku tjetër, në hotelin e punëtorëve, por ai vinte gjithmonë, nuk e di nëse ishte i dashuri i motrës sime, nuk e di vërtet, nuk kam asnjë ide. Por, ky Mirosllavi na u afrua shumë, si të ishte familje, pasi ai vinte pothuajse çdo ditë.

Dhe atë ditë Mirosllavi erdhi, ne e pamë, babai tha: “Ja, kjo është e tmerrshme, është e tmerrshme që tanket hynë në Pragë.” Më kujtohet, kjo më është ngulitur shumë në mendje; mendoja se ku do të shkojë tani Mirosllavi,… ose Gagarini kur shkoi në hapësirë - kjo ishte më herët: pra më interesonte gjithçka që ndodhte: ne ishim pjesë e planetit. Mua nuk më intereson nëse do të martohem, nëse do të punoj, nëse kam një të dashur.”

“Unë mund të dal ku të dua, si të dua, dhe më së shumti kam kaluar kohë me piktorët në shkollën e mesme. Pra, me ata që kishin përfunduar shkollën e artit në Hercegnovi dhe të gjithë ata pikturonin. Të gjithë ata më pas shkuan në akademi, nuk kishte ndërhyrje, por ishte në bazë të meritës, nuk ishin fëmijët e funksionarëve, kryesisht djemtë. Këta ishin shokët e mi përveç shokëve të shkollës, nga gjimnazi, ishim shumë të afërt, gjithmonë ishim së bashku. Dhe ishte shumë romantike, dhe duhet të them se aty ishin edhe mësuesit, disa prej tyre kanë pasur një ndikim të madh. Njëri prej tyre, Sllavko Bojaniq ka pasur ndikim themelor që unë të studioja filologji, duke u bazuar nga ajo që na mësoi ai njeri, historia dhe latinishtja. Ai ishte një figurë mahnitëse për mua, ishte gjithçka që duhet të ishte një mësues.

Ishte një gjetje e madhe për mua; ai më jepte vazhdimisht literaturë për të lexuar. Mendoja, të filloja të lexoja, të studioja latinishten, greqishten. Ai më thoshte: “Të lutem...” Ky profesor më tha: “Të lutem, të lutem, studio latinishten, studio gjuhët klasike”. Unë i thashë babait: “Po mirë, babi, unë dua të studioj gjuhën latine, gjuhët klasike”, dhe ai më tha: “E di, janë të bukura, por gjuhët klasike janë për ata që kanë para. Ata që mund të jetojnë vetëm me ato, por ti studio gjuhë, por disa gjuhë të gjalla”.

Zhvendosja në Beograd

Motra ime Jelka më çoi në Beograd për herë të parë në vitin ‘68, kur ajo kishte një udhëtim zyrtar dhe punonte në Fabrikën e Çelikut. Ajo më çoi dhe më tha se kishte shokë të saj që kishin ardhur nga Podgorica në Beograd dhe se do të shkonim tek ata. Ishte maji i vitit ‘68 dhe Beogradi ishte një qytet studentor, ku kishte shumë djem me mjekra, shumë njerëz të pazakontë, shumë djem. Nuk di ku kemi fjetur, ndoshta kemi udhëtuar, sepse nuk kishim para... Dhe atëherë kam parë shumë rebelë, ishte viti ‘68. Por, po, ajo që di është se ne i adhuruam ata të gjithë. Për babain tim, kjo ishte një revoltë me plot kuptimin, e zëshme. Ai tha: “Po, po, tani ata do t’i zënë kryet Titos”. Në vitin ‘68, unë isha në klasën e tetë dhe kjo atmosferë ishte shumë, shumë e rëndësishme. Më pëlqente shumë njëri nga ata shokët e mi, nga ata piktorët e pazakontë, i cili studionte pikturën, kishte flokë të gjatë, ishte shumë simpatik.

Fillimisht u mendova dhe i thashë: “Ej, hajde tek shtëpia ime”. Ai tha: “Si? Po shiko si dukem”.
Unë thashë: “Çfarë ka lidhje me pamjen tënde, kjo nuk ka asnjë lidhje”. I thashë: “Po të ishe i dashuri im, nuk do të të çoja në shtëpi, as që bëhet fjalë, kjo është qytetari”. Thashë: “Ti je shoku im, hajde me mua në shtëpi”. Dhe erdhi, babai tha: “Shiko sa flokë të bukur ka,” babai im i pëlqente këto, gjë që ishte shumë e rëndësishme gjithashtu.

“Nuk kam bërë pauzë midis gjimnazit dhe fakultetit, u regjistrova në filologji, po, në shtator të vitit 1972. Kam marrë kredi studentore. Nuk kisha nevojë ta kthej sepse përfundova në afat, dhe ata që përfundonin në afat nuk kishin nevojë ta kthenin. Dhe nga kredia studentore që ishte shumë e ulët, shumë më e ulët se, për shembull, kreditë studentore në Serbi, Kroaci, Bosnjë, sidomos në Serbi. Kjo kredi studentore ishte e mjaftueshme për gjërat bazë, sepse jetoja në konvikt studentor. Jetoja në konvikt, më së shumti në Qytetin Studentor, dhe kam punuar shumë përmes kooperativës studentore, dhe kisha shumë përvojë pune nga shkolla e mesme. Shkonim në det për të punuar, nuk mund ta përballonim që të shkonim me pushime.

“E dija që e doja këtë gjë. E dija sepse për mua kjo ishte vazhdim ose zgjerim i horizonteve të kozmopolitizmit. Nuk doja të shkoja për histori, edhe pse e dua historinë. Mendoj se historia është e rëndësishme. Nuk kam asnjë talent për shkencat natyrore, matematikën, fizikën, kiminë, asgjë. Pra, aty ishin gjuhët, që mund të më lidhnin me planetin sa më shumë, apo me njerëzit e tjerë. Po, dhe e dija menjëherë çfarë do të studioja, po. Dhe këtë për të studiuar gjuhë që kurrë nuk i kisha mësuar, pasi në shkollën e mesme kisha mësuar vetëm gjuhën ruse. U regjistrova për të studiuar gjuhë që nuk i kisha mësuar, italishten dhe spanjishten”.

“Kam pasur një shoqe nga qyteti i Zemunit, ajo studionte antropologji, ose etnologji, Radmilla quhej. Ajo ishte një kushërirë e largët, e një dhëndri, nuk ka rëndësi. U bëmë shoqe, sepse ajo çdo verë vinte në Mal të Zi, për mua Radmilla ishte fantastike, mendoja, dhe pak e çmendur, por tërësisht e veçantë. Ajo më tha që sapo të shkoja në Beograd të shkoja te ajo në Zemun. Ata gjithashtu ishin një familje malazeze, kolonë pas luftës, si babai i saj, ashtu dhe familja e saj. Kështu unë e njoha dhe qytetin e Zemunit.

Atje njoha menjëherë disa miq nga ajo periudhë, dhe tani kam disa miq nga Zemuni, disa prej tyre kanë ikur jashtë. Kjo ndodhi gjatë një kohe shumë të shkurtër, kur isha tek ajo, prandaj dhe zhvillova një afinitet të madh për Zemunin, ndoshta edhe për Evropën Qendrore e më tej. Pastaj kalova menjëherë në konviktin studentor, sapo krijova mundësinë të marrë një të tillë. Por gjithmonë mbaja lidhjen me të, dhe atëherë filloi jeta ime gjatë natës. Megjithatë, nuk dilja shumë në vitin e parë, sepse kisha nevojë të shihja nëse mund t'i jepja të gjitha provimet në kohë. Gjithë ditën kisha ushtrime gjuhësore në fakultetin e filologjisë. Isha shumë e disiplinuar dhe thashë se mund t'ia dilja.

Dhe kur pashë që i kisha kaluar të gjitha provimet në qershor, nuk prita deri në shtator, thashë: "Tani mund të bëjmë çfarë të duam". Dilja me Radmillën, se nuk më pëlqente ajo atmosferë, nuk më pëlqente atmosfera në Fakultetin e Filologjisë; më shumë më pëlqente të shkoja në Filozofik, atje ishte një grup tjetër njerëzish.

Në fakt, pashë që studentet e filologjisë ishin provinciale mendjengushta, ato vetëm mendonin si të martoheshin, dhe kjo gjë më dukej e neveritshme. Të kishe të dashur, ku e di unë, të shkonin në ahengje, ç'më duhej të shkoja në ahengje, unë doja të shkoja në diskotekë, as që bëhej fjalë ndryshe. Duke qenë se në Nikshiq nuk kishte diskotekë, për mua ahengu ishte sinonim i provincializmit, sidomos të flirtoje me djem, mendoja, sa gjë e kotë, të vallëzoje me dikë. Dhe pastaj zbulova sa bukur ishte të shkoje në diskotekë, dhe nisa të shkoja me Radmillën në të gjitha diskotekat, vizitova aq shumë diskoteka dhe më në fund gjeta diskotekën time, Cepelin.

Shihja turmën kur vinte, njerëz që e pëlqenin atë muzikë, shkonim në ditë të caktuara, ikonike, kur nuk kishte turmë, kur nuk shkoje për të shitur mend, kur askush nuk flirtonte me dikë tjetër, kur dëgjoje muzikën dhe ishe i përkushtuar. Ishin shumë njerëz në këtë qytet, të gjithë jashtëzakonisht të hapur, që nuk kishin aspak lidhje as me partinë, as me organizatat rinore, as me asgjë nga ato, dhe ajo që na bashkonte më shumë ishte muzika që donim. Unë nuk mund të vendosja për muzikën, më pëlqente më shumë të dëgjoja Stonët, ndërsa Bitëllsët më dukeshin si shumë të ëmbël, e kështu me radhë. Më pëlqente edhe soul, blues, Mik Xheger, kam shkuar në koncert. Pra, politikisht u përcaktova tek Bitëllsët, sidomos Xhon Lenon. Ato biseda ishin jashtëzakonisht të rëndësishme për ne. Miqtë e mi nga diskoteka Cepelin, djem e vajza, flisnin me orë të tëra se cili album ishte publikuar ku. Ishin çmendurakë të vërtetë pas muzikës, të gjithë studentë, të gjithë paksa të krisur. Për mua, ishte thelbësore që nuk ekzistonte ajo atmosferë e tensionuar dhe e erotizuar. E gjeja shumë të lodhshme. Flirtimi me njerëz më dukej aq i huaj. Flirtimi, të pasurit një të dashur, gjithë ai institucion i të pasurit një të dashur. Dhe pastaj mendon, prit pak, si është e mundur që ekziston ky institucion i të pasurit një të dashur, që në thelb do të thotë se, si grua, thjesht po përgatitesh për t'u martuar, dhe arsimi yt shërben që të bëhesh një mall më i vlefshëm.

Kur hasa në disa qarqe në Beograd, u trondita se sa patriarkale ishin ato; ishte aq tronditëse sa i thashë vetes: "Do të shkoj vetë." Nëse miqtë e mi nuk ishin të disponueshëm, shkoja vetëm. E dija çfarë po ndodhte, kështu që shkoja vetëm. Shkoje diku, dhe burrat rrinin aty duke të vështruar, kështu që vendosa të rrija dhe unë të shikoja. Por nuk shikoja askënd në veçanti, jo. Ishte çështje lirie, e kupton? Kisha lirinë të lëvizja ku të doja. Ai qytet, Beogradi, ishte me të vërtetë kozmopolit, vërtet. Shumë nga miqtë e mi, burra dhe gra, ose kanë ndërruar jetë ose janë larguar, por ajo kohë ishte

një thesar për mua. Disa janë ende gjallë, dhe mbaj kontakte me ata që kanë mbetur. Ai lloj pluralizmi kulturor ishte i jashtëzakonshëm.

E di, për mua rebelimi ishte i rëndësishëm, së bashku me refuzimin e asaj kornize patriarkale ku formoheshin institucione si martesa. Ku takon familjen e dikujt sepse je në një lidhje me ta, dhe të tjera gjëra të tilla; kjo më dukej tmerrësisht konservatore, jashtëzakonisht konservatore. Nuk shoqërohesha me atë lloj njerëzish në Beograd.

Një herë, një djalë me të cilin po dilja më tha: “Dua të të prezantoj me mamanë time.” U përgjigja, “Pse duhet ta takoj mamanë tënde?” Ai tha, “Çfarë do të thuash?” Unë i thashë, “Jo, jo, dhe nuk do të të prezantoj as me prindërit e mi.” Ai mbeti i habitur. I thashë, “Unë nuk shkoj të takoj prindërit e njerëzve.” Dhe kjo ishte e vërtetë sepse e shihja tepër konservatore. Por besoj se njerëzit me të cilët shoqërohesha në Beograd, dhe kur mendon çfarë qyteti ishte ai, një qytet-polis që njihte tjetrësinë, një qytet që hapte dyert e tij, ata ishin lloji i njerëzve që zgjodha të rrethohesha.

Kur mendoj se sa i hapur dhe i mrekullueshëm ishte ky qytet, është vërtet mbresëlënëse. Kalova shumë kohë në Suboticë, sepse motra dhe vëllai im ishin atje, kështu që Subotica u bë qyteti im i dytë. Ishte larg, dhe nuk mund ta përballoja të shkoja në Mal të Zi, por nuk kishte rëndësi, e kisha motrën në Suboticë. Edhe sot, Subotica është qyteti im.

Kur u diplomova, punova. Udhëtova me autostop nëpër Evropë. Bashkë me Radmillën, udhëtuam me autostop dhe punuam. Shkuam në Austri dhe punuam në një hotel të tmerrshëm, të mjerueshëm, fituam disa para dhe pastaj shkuam në Itali. Vazhdonim të udhëtonim kështu gjatë gjithë kohës.

Pasi përfundova shkollën, universitetin, kisha disa miq nga fakulteti, përfshirë disa nga Fakulteti i Filologjisë. Ishin gra vërtet të mrekullueshme, studente të shkëlqyera nga Beogradi. Pastaj mendova, e di çfarë, ato kishin para, nuk e di çfarë sfondi shoqëror kishin, vërtet nuk e di.

Më thanë, e di çfarë, meqë nuk mund ta përballosh të vazhdosh studimet si ne, për të bërë studime pasuniversitare, ato ishin gra me prindër të pasur dhe shumë para. Njëra prej tyre më tha: unë punoj në një agjenci të Amerikës Latine dhe dua që ti të punosh atje. I thashë, por unë nuk di spanjisht. Ajo u bë puna ime e parë; sapo u diplomova, në vitin 1977, shkova të punoja atje. Nuk dija as të shkruaja në makinë shkrimi apo ndonjë gjë tjetër. Ishte agjencia Prensa Latina dhe aty njoha një burrë kubanez. Ishte një nga përvojat e mia më të mrekullueshme; ende mbajmë kontakte, dhe ai ishte rishtazi në Beograd. Nëse mund ta them, ai ishte si një profesor për mua. Shumë i arsimuar, ishte një traditë në familjen e tij. Në një apartament të madh, më jepte mësime çdo ditë. I thashë, nuk e di, nuk mund ta bëj këtë punë, nuk e di gjuhën. E kuptoja pasivisht, por vetëm pak. Të jem e sinqertë, thjesht nuk mundem. Ai më pyeti, a dëshiron? I thashë, po, dua. Mirë atëherë, tha ai, do ta mësosh.

Në të njëjtën kohë, përfundova edhe një shkollë turizmi për t’u bërë guidë turistike. Punova si guidë e pavarur për grupe në Itali përmes agjencive të ndryshme. Kalova disa sezone në Spanjë përmes Jugoturs. Ishte një punë e përkohshme, rastësore.

Udhëtarët gjithmonë më lëvdonin, sepse studioja shumë, vizitoja një vend dhe më pas

duhej ta studioja, ta përktheja dhe të mësoja historinë dhe rëndësinë e tij. U dashurova me Kórdoban; u bë qyteti im. Edhe sot, kur shkoj në Spanjë, gjithmonë kthehem në Kórdoba dhe Andaluzi. Punova edhe si guidë turistike në Marok.

Por, përvoja më interesante ishte në vitin 1978, kur më dhanë gjashtë muaj për të punuar në Ishujt Kanarie. Ajo ishte një përvojë e rëndësishme kulturore dhe personale, dhe aty hasa një shtresë të shoqërisë jugosllave që nuk e kisha njohur më parë: burokracia në rritje.

Për disa vite, sa herë që kisha mundësi, punova në turizëm. Meqë nuk kisha kurrë një pozicion të përhershëm, më vonë kalova disa vite duke punuar në qendrën e shtypit me gazetarë dhe agjenci të huaja. Nuk kam punuar kurrë në një kompani jugosllave.

Nuk kam qenë kurrë pjesë e ndonjë institucioni. Gjithmonë kam punuar brenda kapitalizmit, gjithmonë kam pasur një punë. Vazhdimisht krijoja punë për veten time, kështu që kjo u bë një mënyrë jetese për mua. Punova duke përdorur italishten, pastaj në një agjenci spanjisht-anglisht, një agjenci të Amerikës Latine. Kam dhënë mësim edhe për diplomatët serbë; as nuk mund të kujtoj sa punë kam bërë. Ndonjëherë punoja deri në tre punë njëherësh. Gjithmonë qëndrova në Beograd, duke udhëtuar vetëm kur punoja si guidë turistike. Por, që nga ditët e mia studentore, përveç diskotekës Cepelin, vendi më i rëndësishëm për mua në Beograd ishte Qendra Kulturore e Studentëve. Ishte interesante që partia vendosi të krijojë një lloj "getoje" për njerëz si ne, që ishim ndryshe, në mënyrë që të na kontrollonin. Njerëzit vinin aty nga Zagrebi, Ljubljana dhe Prishtina. Por, ajo që më mahniste ishte se si flisnin kundër regjimit, si e kritikonin atë, dhe kush ishin këta mendimtarë. Të gjithë ata filozofë nga Zagrebi, as nuk kuptoja gjysmën e asaj që thoshin!

Deri në vitet 1987 dhe 1988, dhe madje që në vitin 1985, kisha filluar të ndiqja forumet politike. Aty takova shumë, shumë njerëz nga qarqet e solidaritetit ndërkombëtar, kryesisht latinoamerikanë dhe palestinezë. Kështu njoha kilianët; tani bëhen pesëdhjetë vjet nga 11 shtatori, përvjetori i pesëdhjetë i vrasjes së Allendes, dhe kjo hapi një horizont krejtësisht të ri për mua: të flas spanjisht, të mësoj spanjisht. Isha vazhdimisht me ta.

Na ofruan mësime falas. Të gjithë ishin të arsimuar, refugjatë politikë. Organizonin mbrëmje Solidariteti Ndërkombëtar me lëvizje të ndryshme çlirimtare: Guatemala, El Salvador dhe, sigurisht, Palestina. Më dukej gjithçka fantastike, dhe mendoja çfarë ishte kjo, si ishte e mundur. Kishte shfaqje teatrale avangarde dhe shumë të tjera. Thashë me vete, mirë, nëse është geto, le të jetë geto. Isha vazhdimisht me ta.

Nuk arrita të bëhesha pjesë e takimit të famshëm feminist në vitin 1978, Drug-ca, sepse asokohe isha në Spanjë, dhe më vjen shumë keq për këtë. Njoh shumë njerëz nga ajo periudhë, i takova më vonë.

Të gjithë miqtë e mi flisnin për të, duke thënë: oh, ishte e mrekullueshme, ishte fantastike. Dhe gjithçka ndodhi në Qendrën Kulturore të Studentëve.

Në atë kohë isha thellësisht e përfshirë në ato rrethe të Amerikës Latine, veçanërisht ato kiliane. Ajo ishte koha kur filluan krizat dhe mungesat e mëdha. Ajo që më tronditi më shumë ishte mënyra se si kombi përjetoi vdekjen e Josip Broz Titos. Ecja nëpër

qytet, duke menduar, kjo është ajo strukturë patriarkale e shoqërisë ku të gjithë vajtojnë për një figurë atërore që u kujdesej për ta. Në këmbim, ai kërkonte bindje, por gjithashtu siguronte një shkallë të caktuar lirie. Mendova, tani gjërat do të bëhen të tmerrshme. Isha e shkatërruar, duke parë pikëllimin e tyre. Besoj se ajo shënoi fundin e një periudhe prosperiteti dhe të drejtash njerëzore. Çfarë do të thotë të drejtat njerëzore, punë, të drejtat e punës? Tani mund të them që nuk ishte e njëjtë kudo. Kisha një baba që fliste për Kosovën.

Çfarë është kjo, çfarë strukture feudale është kjo, kush janë këta njerëz, të gjithë qajnë, të gjithë vajtojnë. Dhe pastaj fillova të qesh, dhe miqtë e mi më thanë, të lutem mos, do të na rrahin. A mund të ekzistojë vërtet një infantilizim kolektiv i tillë? Që të varësh nga ajo që të jepet si një akt mëshire, ja, kjo është për ty, ja dhe diçka tjetër, në këmbim të bindjes. Dhe ti do të jesh ai që merr atë që të nevojitet, por nuk të duhet as liria as përgjegjësia. Ishte shumë e vështirë për mua. Dhe pastaj, viti 1981 ishte veçanërisht i rëndë për mua. Babai im pësoi një goditje në tru më 26 shkurt. U shërua dhe pastaj erdhi të më vizitonte. Në atë kohë, jetoja me kilianët, dhe ai i dinte të gjitha për këtë. Tha, dua të flas. Kështu që folëm për politikë, dhe ai tha: Mbaroi për Jugosllavinë. I thashë, pse, Zhiko? Çfarë do të thotë që mbaroi për Jugosllavinë? Dhe ai tha, mbaroi, nuk ka më Jugosllavi, do t'i vrasin ata njerëz. E pyeta, cilët njerëz do t'i vrasin? Tha, tanket po shkojnë në Kosovë. E pyeta, çfarë tankesh? Ishte 26 shkurti 1981, kur tanket u dërguan për të shtypur kryengritjen.

Ai tha, e di çfarë, ky nuk është shtet proletar, nëse mendon se është. Ky është shtet nacionalist. Nuk është ajo që ti mendon se duhet të jetë një shtet. Mund ta shohësh që ajo që ka rëndësi në pozitat e pushtetit është se cilës kombësi i përket dikush. Për mua, kjo nuk ka rëndësi. Ajo që ka rëndësi është nëse ke vetëdije klasore, nëse ke një ndjenjë të përkatësisë klasore dhe nëse qëndron për internacionalizmin. Më vonë, fillova të lidhesha politikisht me një grup njerëzish në Beograd. Isha aktive në Qendrën Kulturore të Studentëve.

Kjo ndodhte nga fundi i viteve 1980, por para kësaj, isha e përfshirë me një grup njerëzish nga universiteti, Universiteti i Hapur. Disa tema ishin të ndaluara, dhe disa disidentë nuk lejoheshin të shfaqeshin. Gjillasi, për shembull. Disa miq më ftuan në një leksion të tij, i cili, në një farë mënyre, ishte ilegal. Ndjeva shumë tërheqje dhe thashë, po, do të vij, sigurisht. Ishte prill i vitit 1984 dhe Gjillasi erdhi.

Ishte në banesën e një miku, një apartament i vogël me qira. Tema ishte "Gjenezë e Nacionalizmit, Nacionalizmi në Lëvizjen Çlirimtare Kombëtare" dhe ai filloi të fliste për këtë. Rreth njëzet minuta më vonë, dhjetëra policë hynë me armë të drejtuara. Në atë kohë, disidentët vinin si nga e majta, ashtu edhe nga e djathta; grupi im ishte i majtë. Na arrestuan të gjithëve, ishte hera e parë që u arrestova.

Në vitin 1985, babai im ndërroi jetë. Marrëdhënia që kisha me të si një shok politik ishte shumë domethënëse për mua. Kisha lirinë të shprehja praktikat dhe pikëpamjet e mia politike. Ceremonia e varrimit ishte një ngjarje formale. Një burrë vdes, një burrë që jetoi ashtu siç dëshironte dhe në harmoni me veten. Momenti më dramatik për mua ishte kur motrat dhe unë ishim të gjitha të veshura me të zeza. Papritmas, disa burra mbërritën, gjithashtu të veshur me të zeza. Po i shikoja, dhe pastaj kuptova. E dija që në Mal të Zi është zakon që gratë të mbajnë zi dhe burrat të vajtojnë, një vajtim tradicional mashkullor. Ata thjesht u prezantuan, jemi shokët e babait tuaj nga Goli Otoku.

Nuk po e ndiqja nga afër atë që po ndodhte në Kosovë, ndoshta sepse ndjeja një farë shkëputjeje nga ajo që po zhvillohej. Megjithatë, babai im kishte mbjellë farën që më bëri të filloja të mendoja për të. Më vonë, fillova të diskutoja për këtë me disa nga miqtë e mi në Beograd, të cilët kishin orientime të ndryshme politike. Disa ishin pjesë e klasës tradicionale borgjeze në Beograd dhe organizonin festimet e sllavës. Për ta, kjo ishte një formë rezistence kundër regjimit. I pyeta disa prej tyre, a e shihni çfarë po ndodh? U trondita pak nga qëndrimet e tyre armiqësore. Diku, ndjeja diçka që më kujtonte masakrën e palestinezëve në kampet e Sabrës dhe Shatilës.

Përgatitjet për luftë, vitet '90, aktivizmi

Në vitet '80 ishte një tmerr, një makth i vërtetë. Shkoja në Shoqatën e Shkrimtarëve të Serbisë për të dëgjuar gjithçka, shkoja në çdo vend që mundja, sepse duhej të punoja vazhdimisht, të përktheja, të jetoja. Vendosa t'i ndihmoja kilianët. Dhe pashë që po vinte një shkatërrim, që tashmë po përgatitej; struktura partiake kishte monopolizuar të gjithë pushtetin. Ata i kishin të gjitha në duart e tyre dhe papritmas humbën gjithçka, ishte kredia. Jo, Tito nuk ishte më dhe nuk kishte më mënyra për të siguruar ato fonde. Si do ta ruanin pushtetin? Si do të vazhdonin karrierën e tyre? Nuk ishin më idealistë komunistë si partizanët apo luftëtarët e Spanjës.

Dua të them që legjitimimi i pushtetit të ri erdhi përmes elitës intelektuale, dhe për ta, Millosheviqi ishte ideal, figura ideale që do të realizonte vizionin e tyre. Ai shndërroi retorikën e stalinizmit më të keq në një nacionalizëm në Kosovë, në atë nacionalizëm-mitik. Kisha shumë frikë, edhe pse disa thoshin që nuk po përgatitej luftë, e dija që po bëheshin shumë përgatitje. Disa nga miket e mia shkrimtare vendosën të kundërshtonin publikisht. Dhe pastaj pashë se si filluan të shënjestronin njerëz në Beograd.

Njëherë isha me Biljana Jovanoviqin, isha shumë pranë saj, aty ishte edhe Radmilla Llaziqi. Më thane, eja, eja me ne, po shkojmë në Qendrën e Rinisë. Thashë, po shkoj, pse jo. Mendoj se ishte viti 1990, mendoj se ishte pranverë, atëherë filluan ata poetët e tmerrshëm. Millan Komneniq, poeti, dhe këta të tjerët me të, po kërcënonin njëfarë Aliu, as që e dija kush ishte ai njeri, një shqiptar. Dhe Biljana thotë: "Tani le të bërtasim 'Fashistë! Fashistë!'". Dhe Komneniq tha, shikoni këto budallaqe. Të gjithë u kthyen nga ne të tria dhe thane, shikoni çfarë po bëjnë këto budallaqe, duke mbrojtur shiptarët.

Në prill të vitit 1987, tensionet u ngritën dhe isha e interesuar t'i dëgjoja të dyja palët. Pas pune, shkova atje dhe përfunduam duke qëndruar gjithë natën. Pashë policinë, pesë kordone policore. Njerëzit nga Beogradi po pështynin mbi serbët. Epo, njerëzit erdhën për të na thënë diçka. Më thane, shqiptarët nuk janë problemi ynë, janë këta komunistët, ata nga partia. E kuptova që kishin një problem social. Gjithsesi, u ktheva në shtëpi, dhe në mëngjes dëgjova: nacionalistët serbë nxitën njerëzit nga Kosova, serbët dhe malazezët, dhe disa prej tyre u arrestuan. Hapësira për ata që vinin nga pozicione sociale dhe klasore po mbyllej. Problemet serioze ekonomike po injoroheshin, dhe gjithçka po shndërrohej në çështje etnike; ajo që po ndodhte ishte një manipulim i problemeve.

Kjo bëhej në koordinim nga partia, ushtria dhe Kisha Ortodokse Serbe, dhe e di këtë sepse ecja nëpër qytet. Ditën kur Millosheviqi tha para Kuvendit: "Arrestoni Vllasin...",

isha aty. Pashë që të gjitha grupet shoqërore ishin të bashkuara në urrejtje, të gjithë së bashku. Më kujtohet një grua me një pallto leshi, ishte dimër, nga fundi i marsit. Qëllimisht vura një emblemë të kuqe për t'i provokuar. Atë kohë udhëtoja shumë në Slloveni, preferoja Ljubljanën mbi Zagrebin, sepse Ljubljana më dukej më afër. Thashë, ndoshta dikush do ta vërë re emblemën dhe do të më godasë, por ata ishin në trans.

Kur thonë se lufta ndodhi thjesht, që nuk ishte e planifikuar apo e organizuar, kjo nuk është e vërtetë: lufta u përgatit në çdo nivel – intelektual, kulturor, ushtarak dhe politik. E kam jetuar atë kohë, periudhën kur thuhet se nuk e di që po digjesh kur fillon lufta. Siç thotë fjala e urtë, nuk e dimë kur fillon "para luftës" dhe pastaj, papritmas, ajo është aty. Isha pjesë e një shoqate letrare. Isha gjithashtu një nga themelueset e grupit Gratë dhe Shoqëria.

Pastaj udhëtuam në Zagreb për të vizituar miqtë tanë, dhe kështu u formua rrjeti feminist jugosllav. Isha shumë aktive në të. Madje shkova me një grua në një takim të rrjetit në Ljubljanë vetëm disa ditë para pushtimit, para se tanket të hynin në Slloveni. Asokohe, Teuta Arifi u bë shoqja ime. Më vonë, e vizitova atje. E pashë që ishte një romantike kombëtare, dhe kjo më dukej qesharake.

Më 1 maj 1991, shkova në Kosovë me një delegacion pacifistësh dhe parlamentarësh italianë. Kur arritën në Beograd, menjëherë thashë, dua të shkoj, dua të përkthej për ju, i thashë Aleksandër Langerit, i cili më vonë mori Çmimin Andrei Sakharov në Kosovë. Kur e pyeta, çfarë do të bëni në Kosovë, ai u përgjigj, do të kontrollojmë gjendjen e të drejtave të njeriut. E gjithë përvoja ishte traumatike. Të gjithë po na prisnin atje, përfshirë edhe minatorët nga Trepça. Por, ajo që më ka mbetur më shumë ishte kur vizituam fshatin Zhur. Aty pashë të rinj me shenja të tmerrshme torture. Kur u ktheva, Borovo Sello kishte ndodhur, dhe thashë, Aleks, gjithçka mbaroi.

Para luftës, isha pjesë e një grupi feminist dhe Universitetit të Hapur. Më interesonte më shumë dhuna ndaj grave, por nuk kisha prirje për të punuar në linjën telefonike SOS. Punova në të sapo u krijua, në vitin 1990. Linja e parë SOS në Evropën Lindore u themelua në Zagreb dhe unë shkova në trajnim pranë Zagrebit. Lidhjet tona përgjatë linjës Zagreb-Beograd-Ljubljana ishin të vazhdueshme dhe kurrë nuk u ndërprenë, gjë që është fantastike. Ata ishin miqtë e mi atëherë, dhe ende janë, si në Zagreb, ashtu edhe në Ljubljanë.

Sapo filloi lufta, për mua ishte e natyrshme të përfshihesha menjëherë me Qendrën për Veprim Kundër Luftës. Edhe para kësaj, kisha marrë pjesë në shumë aksione me disa miq nga grupi feminist, duke kundërshtuar ushtrinë. Shkonim në tubime dhe ngjisnim parrulla alternative që të na vinin re, pastaj iknim me vrap, ata na ndiqnin, dhe kështu me radhë. Shumë nga këto janë dokumentuar në Hartën e Rezistencës Kundër Luftës. Nga dëshpërimi, fillova të mendoja për mënyra për të bindur sa më shumë burra të mos shkonin në luftë. Kjo ishte gjëja më e rëndësishme për mua. Komunikoja gjithashtu me gra, veçanërisht me nëna. Kisha filluar tashmë të krijoja kontakte ndërkombëtare, veçanërisht përmes pacifistëve italianë, dhe më vonë u përfshinë edhe disa feministe.

Pastaj u themelua Qendra për Veprim Kundër Luftës, dhe për mua, gjëja më e rëndësishme ishte të ofroja mbështetje ligjore, emocionale, psikologjike dhe morale për burrat që refuzonin të shkonin në luftë.

Kurrë nuk kam menduar se feminizmi duhet të kufizohet vetëm në çështje strikte të grave apo burrave. Kjo ishte krejtësisht e papranueshme për mua. Për shembull, çështjet ushtarake janë gjithashtu çështje gjinore për mua, sepse ushtria merr para që mund të përdoren për kujdes shëndetësor, arsim dhe shkollim.

Gjithë kohën time e kalova duke marrë pjesë në lloje të ndryshme aksionesh në rrugë, të organizuara nga prindër që nuk kishin pozicione ideologjike të qarta, por thjesht kërkonin që bijtë e tyre të ktheheshin nga ushtria. Kjo ndodhte sepse JNA (Ushtria Popullore Jugosllave) po zgjaste shërbimin ushtarak, dhe prindërit ishin në dëshpërim.

Burrat po panikonin, të tmerruar nga mundësia që të etikoheshin si tradhtarë. Disa refuzonin të luftonin sepse kishin frikë, gjë që është normale, jo sepse ishin pacifistë. Ata thoshin, nuk dua të vras kroatë, ata janë vëllezërit e mi. Por, ishin tashmë të mësuar të shkonin në Kosovë.

Kjo tregonte gjithashtu sa ekskluzive dhe përjashtuese kishte qenë Federata Jugosllave. Kur dikush më thoshte, si mund të vras kroatë, epo, pse shkoje në Kosovë, dhe ata përgjigjeshin, epo, kjo është ndryshe. Ah, është ndryshe, domethënë… E kisha kuptuar këtë prej kohësh, por edhe atëherë mendoja, mirë, ja ku janë gratë që bëjnë të gjithë punën, edhe në kundërshtimin ndaj mobilizimit.

Por jo vetëm feministet; ishin gjithashtu ato nëna, ato grupe të ndryshme, të cilave u thoja, e dini çfarë, do të krijoj një grup, por do të ruaj një marrëdhënie të shkëlqyer me ju. Dhe kështu ndodhi. Gjithmonë kam pasur marrëdhënie të mira me njerëzit dhe kam qëndruar në raporte të mira me ta, edhe kur dikush na linte. Prioriteti im ishte të bëja të dukshme rezistencën e grave ndaj luftës. Dhe ne ishim të bashkuara nga kundërshtimi ynë ndaj mobilizimit.

Gratë në të Zeza

Pastaj u bashkova me Karavanin Ndërkombëtar, mora pjesë në shumë karavane dhe për herë të parë në jetën time shkova në Sarajevë, në koncertin e paqes YUTEL. Bosnja nuk më kishte interesuar kurrë më pare, pse do të shkoja atje, mendoja. E njihja Ljubljanën, por atë vend nuk e njihja fare, aspak. Pastaj pashë atë koncert të madh të paqes YUTEL dhe mendova që do të ishte diçka e çuditshme, ata njerëz nuk e kuptonin se çfarë po ndodhte në Bosnjë. Pastaj erdhën Gratë në të Zeza nga Italia dhe thane, sot do të qëndrojmë përpara katedrales. U thashë, me të vërtetë? Mirë, le të qëndrojmë përpara katedrales më 27 shtator 1991. Nuk do ta harroj kurrë atë ditë. Qëndruam atje dhe njerëzit na shikonin sikur po bënim ndonjë lloj performance. Këta njerëz nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh, më thanë gratë italiane. Stasha, këta njerëz nuk e kuptojnë se çfarë po ndodh. U përgjigja, çfarë doni të thoni? Do t'i pyes tani.

Kështu që pyeta njerëzit: A e dini që ka luftë në Vukovar? Njëqind kilometra larg nga këtu. Ata u përgjigjën, nuk do të vijë në Bosnje. U thashë: Nuk do të vijë në Bosnjë?! Ishte aq e pabesueshme.

Më pyetën, pse jeni të veshura me të zeza? Kjo është tradicionalisht ngjyra ortodokse. Dhe unë u përgjigja, do t'i japim kësaj ngjyre një kuptim dhe simbolikë krejt të kundërt. Do ta kthejmë përmbys, do ta bëjmë subversive. Duhet të përdorim simbolet e tyre,

por të përcjellim një mesazh krejt të kundërt. Do të shihni si funksionon, ata do të mendojnë se po u marrim përmbajtjen dhe formatin e tyre. Do të jenë të tërbuar, sepse mesazhi ynë është krejt i kundërt nga i tyrë. Dhe pikërisht ashtu ndodhi.

Pastaj qëndruam përpara Qendrës Kulturore të Studentëve dhe njerëzit gjithashtu menduan se ishte ndonjë lloj performance. E zgjodhëm QKS-në sepse aty ishte themeluar grupi i parë feminist. Ne as nuk njoftonim policinë për mbledhjet tona. Për dhjetë herët e para, policia nuk na kushtonte vëmendje. Pasi kuptuan që mesazhet tona ishin paqësore dhe pacifiste, "Duam paqe, nuk duam luftë," filluan të na regjistronin. Më vonë, u zhvendosëm në Sheshin e Republikës, dhe që atëherë kemi qenë aty, qëllimisht duke zënë atë institucion kombëtar.

Kur më thanë, Stasha, mos vish të zeza, u përgjigja, duhet të jenë të zeza. Dua të them edhe diçka tjetër, jam shumë e lidhur me atë kulturë dhe ato rituale simbolike, veçanërisht nga Mesdheu, nga Mali i Zi. Aty ka një ritual shumë strikt. Do të thotë që vishe një mënyrë të caktuar kur shkon të bësh homazhe, kur dikush vdes duhet të kesh një stil të caktuar; kjo është gjëja më e rëndësishme. E bën në një mënyrë performative.

Kishim shumë mesazhe për Kosovën, veçanërisht pas përfundimit të luftës në Bosnjë, por edhe më parë. Ato mesazhe dërgoheshin gjithmonë. Pastaj thamë, mirë, tani duhet të shkojmë direkt tek ata, duhet t'i përballojmë. Kjo na ndihmoi secilën prej nesh të mbijetonim, sepse ishte një situatë ku e kupton që ke pozitën e një të huaji, një të përjashtuari të plotë. Ata thoshin, Vukovari është i yni dhe ne thoshim, Jo. Ata thoshin, e çliruam Vukovarin dhe ne thoshim, jo, e pushtuat Vukovarin. Në parrullat tona shkruanim: "Po vrisni jetën." Dhe për gjithçka që ata thoshin, ne duhej ta ndryshonim, duhej ta ndiqnim atë që po thoshin për t'u përgjigjur menjëherë. Në shesh, duhej të përgjigjeshim. Dhe kjo është punë e madhe.

Vajtimi i vazhdueshëm, ankesat dhe pozicionimi si moralisht superior është thellësisht patriarkal. Thashë, tani kam një zgjidhje, do të punoj me artistë, do të gjej disa artistë. Një ditë, në nëntor të vitit 1991, ishim duke qëndruar aty, dhe dy djem të rinj u afruan. Ata kishin parë parrullën që mbështeste dezertorët dhe kuptuan që ne mbështesnim kundërshtarët e luftës. I pyeta, çfarë jeni ju, dhe ata thane, jemi artistë dhe jemi kundër luftës. U bënë të afërt me ne, i adhuroj. Madje krijuan logon tonë.

U thashë, ju do të na bëni një logo. Kjo ishte e para që bënë. Thanë, do ta bëjmë, do ta bëjmë. Janë artistë. Kështu që u thashë, e dini çfarë, unë vij nga kultura e '68-ës. Besoj se duhet të krijojmë përmbajtje, dhe të gjitha parrullat duhet të jenë të punuara me dorë. Çdo gjë e punuar me dorë, sepse tani kemi një kulturë të trupit. Ti del në shesh, dhe mund të shprehësh trupin tënd, fizikën tënde… Nuk di të shkruaj parrulla, kështu që ju do t'i shkruani. Shikoni sa e mrekullueshme është kjo. Ata thane, do ta bëjmë. Ata janë miqtë e mi edhe sot. Janë të famshëm, më krijuesit, më brilantët, më të zgjuarit, të gjithë filozofë.

Gjithmonë duhet të ndërtosh konsensus rreth disa gjërave. Një konsensus për të thyer konsensusin kombëtar, për të refuzuar luftën. Ti merr vendimin për të thyer konsensusin kombëtar, që do të thotë të refuzosh çdo diskurs patriotik. Mund të diskutojmë çështje të ndryshme të vogla, por jo nëse nuk ka konsensus mbi faktin se lufta po bëhet në emrin tënd, që po vrasin dhe po shpenzojnë paratë e tua; kjo është

themelore.

Ato tre momente, gjithmonë jo në emrin tonë, si të përcjellësh politika subversive. Dhe lidhja e vazhdueshme me minoritetet. Minoritete në çdo nivel, jo vetëm ato etnike, por edhe seksuale, kulturore dhe politike. Ajo bëhet komuniteti yt njerëzor. Dhe ai i riu zhvilloi këtë ide, e zhvilluam së bashku, dhe unë me të vërtetë besoj se është një figurë historike. Punova me ta për shumë vite, dhe tani disa nga ata të rinj janë profesorë të shquar. Por vendimi për të përqafuar tjetrin ishte kyç, sepse nuk është aq e thjeshtë të kuptosh dhe pranosh me të vërtetë atë tjetërsi.

Në radhët tona ishte një grup shumë i larmishëm njerëzish, jashtëzakonisht i larmishëm, në një hapësirë debatesh të vazhdueshme, argumentesh, mosmarrëveshjesh dhe reflektimesh. Për mua, kjo ishte kultura e '68-ës. Ajo shprehja e fizikës, kur nuk je më pjesë e një makinerie, punon me dorë, çdo gjë e punuar me dorë dhe transparente. Sfida e vazhdueshme ishte të krijoje, shpikje dhe prodhoje kuptim, sepse e di që nuk do të jesh kurrë pjesë e mainstream-it, dhe nuk dëshiron të jesh pjesë e rrymës së turmës. Kjo është ideja kyçe, nuk dua të jem me rrymën e turmës, nuk do të jem, dhe nuk kam talent për këtë. Ka njerëz të tjerë që kanë talent për këtë, dhe kjo është në rregull. Por unë nuk kam talent…

Ndoshta ajo pozita e përjetshme e disidentit është pjesë e traditës sime familjare, ideja që e vetmja qasje morale e pranueshme është statusi i të përjashtuarit. Nuk do të kesh të bësh fare me ta, por dëshiron të rreshtohesh me të internuarit, të deklasuarit, të humburit. Kjo është arsyeja pse edhe e kam më të lehtë të lidhem me veteranët e luftës, sepse ata e kanë përjetuar atë në radhë të parë. Njëzet mijë burra u dërguan në Kosovë, të mobilizuar nga Serbia. Udhëtova nëpër gjithë Serbinë për të parë se çfarë po ndodhte. Nuk ishte e lehtë në Leskovac, rrugët ishin të braktisura. Ishte një ndjekje për burrat, duke u përpjekur të gjenin mënyra për t'u fshehur. Në Beograd ishte më e lehtë, por jo në Leskovac apo Vlasotince. Prandaj duhet të kemi ndjeshmëri edhe për këtë.

Duhet krijuar një hapësirë për ata që të flasin, sepse në këtë vend ata janë plotësisht të margjinalizuar; ata janë njëkohësisht viktima dhe kryerës të krimeve. Duhet ta them që krimi i kryer kundër dezertorëve rusë përfaqëson një dështim të madh të së drejtës ndërkombëtare. Pse burrave që refuzojnë të shkojnë në luftë nuk u jepet e drejta humanitare për azil? Sepse është militarizëm i pastër, sepse prioriteti është shitja e armëve, prodhimi i armëve, dhe kështu me radhë. Një nga sukseset tona më të mëdha ishte sigurimi i të drejtës për refuzim me ndërgjegje: burrat të mos shërbejnë në ushtri nëse nuk duan. Kjo është arritja ime më e madhe në nivel të të drejtave.

Përmes militarizimit të së drejtës humanitare, ekziston një pritshmëri e vazhdueshme që burrat duhet të luftojnë në luftëra, dhe ata që refuzojnë etiketohen si frikacakë, ashtu si gratë që nuk duan të jenë nëna ose gra bashkëshortore shpallen tradhtare. Kjo është arsyeja pse për mua ishte e rëndësishme që gratë nga Serbia të dëshmonin, por ato më thane, Stasha nuk mund të flasim përpara grave të Srebrenicës, Vukovarit dhe Kosovës. Dhe ato thjesht qëndronin të heshtura, të heshtura dhe të heshtura. U thashë, duhet të flisni, sepse atyre u është thënë atyre se nuk ka pasur rezistencë në Serbi. Nuk bëhet fjalë vetëm për Gratë në të Zeza, edhe ju rezistuat. Rezistuat duke fshehur bijtë tuaj në kushte të pamundura, duke duruar gjykimin e familjeve tuaja.

Pastaj, ato shpërthyen në lot dhe thane, ha, kurr nuk e kemi dëgjuar këtë më parë. Madje edhe media, përfshirë median alternative, ishin të mbyllura për këtë lloj informacioni. Kishte dhjetëra kryengritje masive nga rezervistët në Serbi. Kjo është shumë e rëndësishme. Pse është e rëndësishme? Sepse, nëse vazhdon vetëm të përsërisësh viktimizimin ose vetëviktimizimin, ose epërsinë morale, në thelb po vazhdon një anë tjetër të retorikës nacionaliste. Në vend të kësaj, mund të prodhosh ide, mendime, përmbajtje dhe kuptim që janë të kundërta me të tyret.

Dezertorët më mësuan shumë, ashtu si edhe ato nëna, ajo grup i vogël nënash që qëndruan besnike ndaj parimeve tona; kjo kërkon guxim të jashtëzakonshëm. Nëna që thoshin se nuk donin që bijtë e tyre të bashkoheshin me ndonjë ushtri. Kam dëgjuar deklarata të pabesueshme, brilante dhe morale nga grate, nuk dua që djali im të shkojë në luftë, nuk dua që djali im të marrë pjesë në agresion. Ne kemi gjithçka të dokumentuar. Kjo nuk duhet të mbetet e padukshme. Një çështje tjetër është që ky shtet i përçmon këta njerëz. E megjithatë, pothuajse të gjithë janë viktima, ndërkohë që, në të njëjtën kohë, janë disa nga kryerësit më të mëdhenj të dhunës dhe femicidit në Serbi.

Gjykata e Grave

Ashtu si thonë tani, serbët janë një popull gjenocidal, është pikërisht ajo që Vuçiqi dëshiron të thuhet më shumë, por nuk është e vërtetë. Askush nuk ta ka thënë këtë, thjesht dëshiron të pretendosh se çdo person në Serbi ishte homogjen, se të gjithë ishin njësoj dhe se gjithçka ishte e njëjtë. Epo, nuk ishte. Pikërisht për këtë arsye ata fshehin rrobat e pista dhe gjurmët e tyre. Gratë në Serbi, nënat e dezertorëve dhe burrave të mobilizuar, paguan një çmim të tmerrshëm. Gjithçka është e dokumentuar; ky ishte çmimi më i madh, si moral ashtu edhe shëndetësor, dhe komuniteti ndërkombëtar imponoi një represion të tillë. Në asnjë marrëveshje paqeje, asnjëherë nuk janë përmendur gratë viktima të dhunës seksuale ose dezertorët, burrat që refuzuan të shkonin në luftë. Ata nuk do t'i njohin kurrë.

Gjykata e Grave bazohet pikërisht në krijimin e një lloj tjetër drejtësie. Kjo është arsyeja pse mendoj se, ndërsa drejtësia institucionale dhe Tribunali i Hagës kanë rëndësi historike dhe peshë, ato nuk janë të mjaftueshme. Nevojitet edhe drejtësia restauruese. Nuk po flas për pajtim, pajtimi është kryesisht çështje për institucionet dhe elitat, dhe nuk më intereson kjo. Ajo që më intereson është besimi, kalimi i kufijve dhe çmontimi i narrativave të luftës. E dimë kush mban përgjegjësinë më të madhe, por vetëm nëse hierarkitë hiqen. Dhe ne e arritëm këtë në një proces ku hierarkia midis viktimave u hoq. Kjo do të thotë të pranosh që të gjitha viktimat kanë të drejtë mbi dhimbjen e tyre, të shprehin vuajtjen e tyre dhe të kenë dinjitetin e tyre.

Kjo nuk do të thotë që një grua nga Kraljeva, djali ose burri i së cilës u dërgua në luftë, vlen më shumë se një grua nga Srebrenica. Nuk do ta them kurrë këtë dhe krahasime të tilla nuk mund të bëhen. Por kjo do të thotë që ato kanë të drejtë të qëndrojnë krah për krah, të kalojnë ato kufij dhe të refuzojnë të reduktohen në konceptin e viktimave ideale.

Organizuam takime me njerëz të nivelit më të lartë akademik dhe të gjitha gratë morën pjesë. Ato kuptuan se kapitali i tyre qëndronte në dijet dhe përvojat e tyre dhe se mund

të ishin subjekte të dijes së tyre, duke thyer barrierat gjatë këtij procesi. Nëse mendoj se një grua feministe duhet të flasë në emër të viktimave ose grave të tjera, kjo është diçka që nuk e toleroj dot. Jo, jo. Një viktimë do të flasë vetë për veten e saj. Ti mund të mësosh prej saj, por ajo nuk mund të formësohet për të përputhur tezat e tua.

Është ndryshe kur përmenden emra si Latinka Peroviq dhe Borka Paviqeviq. Latinka mori pjesë në Gjykatën e Grave. Gra si ato na dhanë njohuri; ishin gra fantastike, dhe shumica prej tyre ishin nga Serbia. Kjo është një gjë e mirë, sepse ne mbajmë përgjegjësinë më të madhe. Ajo që duam të përcjellim publikisht është solidariteti: ti më mëson mua, dhe unë mësoj nga ti.

Është jashtëzakonisht e rëndësishme të krijohet një komunitet i grave të dhimbjes dhe grave të forcës. Një element tjetër thelbëspr është kapërcimi i kufijve dhe sfidimi i statukuosë, që do të thotë edhe sfidimi i komunitetit tënd. Ajo që mësova nga këto gra, veçanërisht të vejat e luftës nga Bosnja, është se sa thellësisht mësuan të duan njëratjetrën. Më vjen keq që gratë rurale nga Kosova nuk mund të merrnin pjesë për shkak të barrierës gjuhësore.

Për pesëmbëdhjetë vite këto viktima i kanë kaluar verat së bashku. Kanë ndërtuar një lidhje solidariteti, Nënat për Paqe, Gratë e Vukovarit dhe disa gra nga Serbia. Gjithçka ndodhi krejt spontanisht. Pastaj u bë jashtëzakonisht e rëndësishme të fokusoheshim te arsimi. Besoj se arsimi është një gjë revolucionare. Do të thotë t'u ofrosh arsimim grave që nuk kanë pasur mundësi të mësojnë, veçanërisht atyre që janë bërë viktima dhe shihen nga të gjithë thjesht si viktima, sikur janë ngrirë, gurëzuar. U dhamë libra për të lexuar dhe madje nisëm disa biblioteka në fshatra në Bosnjën Lindore. Pse të mos lexoni, u them, pse të shikoni vetëm telenovela turke. Njëra prej tyre më thotë, epo, nuk kam lexuar prej shumë kohësh. I përgjigjem, atëherë merre tani një libër dhe lexo.

Latinka, ashtu si Zagorka Golluboviqi, ishte një nga mendimtaret më të mëdha, dhe këtu të gjithë i urrejnë. Por, ato ishin bashkëpunëtoret tona, shkonim bashkë në terren. E pyeta Latinkën, epo Latinka, pse rri deri në fund të festës, deri në dy të mëngjesit, pse rri... Disa ekspertë OJQ-sh vijnë, mbajnë leksionet e tyre dhe largohen. Për sa më përket mua, të tillë njerëz nuk do të ftohen kurrë më. Të mbash një leksion dhe pastaj të largohesh, kush je ti që të japësh një leksion dhe t'i braktisësh gratë në atë mënyrë. Dhe Latinka u përgjigj, prandaj dëgjoj, mësoj. E pieta, çfarë do të thotë 'mësoj'? Ajo tha, epo, mësoj nga ju, mësojmë së bashku. Dhe kjo është arsyeja pse gratë e duan më shumë atë, ashtu si dhe Rada Ivekoviqin.

Kjo është arsyeja pse arsimi është revolucion: arsimimi, dija cilësore që nuk është vetëm funksionale, por dije e vërtetë. Gratë thonë, ne i kemi mësuar të gjitha këto në grupet tona të diskutimit, I preferojmë grupet e diskutimit. Grupet nënkuptojnë të flasësh hapur dhe lirshëm, jo të shkosh atje për të thënë fjalën tënde dhe të përfundosh leksionin. Nuk funksionon kështu. Barazia do të thotë të jesh i sinqertë me to, t'u thuash atë që me të vërtetë mendon. Për shembull, të thuash, a mendoni me të vërtetë që pederët (siç i quajnë) nuk vlejnë? Thuajeni, por unë do t'ju them çfarë mendoj, dhe pastaj do t'i takoni ata…

Duhet të ekzistojë një dinamikë ku njerëzit thonë me sinqeritet çfarë mendojnë. Unë nuk mund të edukoj nacionalistët radikalë, por kam ndërtuar besim me shumë gra.

Për shembull, kur Fahrije Hoti ishte në Prizren, i kërkova me mirësjellje që të nënshkruante një formular pëlqimi dhe e kemi atë pëlqim. I thashë, është në serbisht, nuk e kam përkthyer në shqip. Dhe ajo u përgjigj, ç'rëndësi ka për mua gjuha. E pieta, ç'do të thotë kjo. Ajo tha, të besoj ty, ti më dhe fjalën tënde, dhe unë do ta plotësoj. Ja ku e ke, shtoi ajo. Mirë, i thashë, por lexoje. Ajo u përgjigj, nuk më intereson ta lexoj. Komunikoj me personin, jo me letrën.

Është e rëndësishme të plotësohet sfera psikosociale, kur bëhet fjalë për marrëdhëniet me viktimat, me arsimimin politik, arsimimin mbi dhunën, feminizmin dhe praktikat e ndryshme.
Arsimi që është i ndjeshëm, ndërsektorial dhe etik është një revolucion i madh për gratë. Në ish-Jugosllavi, shumë pak njerëz e kuptonin këtë qasje humaniste dhe holistike. Do t'ju tregoj se si funksionon procesi, them unë. Çfarë do të thotë feminizmi për ju, i pyes gratë që janë pjesë e programit tonë arsimor. Dhe ato përgjigjen, epo, e di, Stasha, na ndihmon t'u themi djemve dhe nuseve tona që kemi kohën dhe përgjegjësitë tona. Si kështu? Epo, nuk mund të vijnë thjesht në shtëpi dhe të thonë, jemi këtu, por si të doni…

Kjo do të thotë të njohësh mjetet konkrete dhe shumë gra kanë filluar të flasin hapur me familjet e tyre në këtë mënyrë. Në Serbi, megjithatë, asgjë nuk ka përparuar sepse as lufta, as krimet, as përdhunimet nuk janë pranuar. Ky është shteti më i tmerrshëm që ekziston. Kjo është arsyeja pse fillova të punoja me gratë në Foça për të adresuar krimin më të tmerrshëm të përdhunimit në Bosnjë dhe Hercegovinë. U trondita kur kuptova që pothuajse asgjë nuk ishte bërë për Foçën. Pastaj takova disa burra nga Foça, boshnjakë, dhe përmes tyre krijova kontakte në qytet. Një grup më i madh prej nesh shkoi atje në vitin 2018 dhe filluam të punonim me ta.

Kështu, le të përfundojmë me mënyrën se si organizuam nga Beogradi Gjykatën e Grave në Foça, dhe për mua, është një ngjarje historike, sepse ata donin që ajo të mbahej në Beograd. Pyeta: "Pse në Beograd?" "Sepse," më thanë ata.

Tani, në fund të muajit, fillimisht do të shkoj në Zenica për të vizituar Sabihën dhe pastaj në Sarajevë për të punuar me ta mbi dëshmitë. Nuk jam e sigurt nëse do të ketë më shumë Gjykata të Grave, është një përpjekje e jashtëzakonshme. Nuk mund të merrem më me këto fondacione. Nuk mund të dëgjoj më fjalët e tyre për pajtim. Nuk mund të përshtatem më në kornizat e grupeve të tyre të synuara. E di çfarë? Do të shkoj në ato fshatra, dhe sa më i vogël dhe më modest të jetë një projekt, aq më shumë më intereson. Ne punojmë me të gjitha ato gra në baza vullnetare, sepse është një lloj dëmshpërblimi për to dhe të tjera si këto. Kam panik nga këto megaprojekte. Për shembull, miqtë e mi nga Kreshevci punojnë me gra të jashtëzakonshme nga Mitrovica e Veriut, por më thanë që nuk do të punojnë me mua.

Unë marr pjesë në të gjitha konferencat ku kam detyrime ndaj miqve të mi, por besoj se kjo praktikë duhet të ndryshojë plotësisht, sepse ka shumë para që shpërdorohen. Besoj në një mijë hapa të vegjël dhe të qëndrueshëm që ndikojnë në ndryshim, ku njerëzit janë subjektet e asaj që bëjnë. Nuk i duroj dot ato konferenca të mëdha dhe performative. Gjithmonë duhet të debatoj me donatorët.

Tani është betejë për mbijetesë. Për shembull, kemi Gjykatën e Grave, monitorojmë gjykimet dhe shkruajmë histori alternative. Deri tani, kemi botuar rreth treqind libra.

Angazhohemi në aktivizëm me video dhe bashkëpunojmë gjerësisht. Organizojmë grupe të rregullta diskutimi dhe shumë aktivitete edukative. Mbështesim përpjekjet humanitare ukrainase. Ndihmuam një kamp refugjatësh; patëm fëmijë të rinj refugjatë, por ofrojmë edhe mbështetje të rëndësishme për aktivistët rusë kundër luftës. Ata shpesh mbajnë takime me ne dhe përballen shpesh me dhunë të rëndë. Shumë prej tyre u refuzohen lejet e qëndrimit, dhe duhet të jem e kujdesshme që kontaktet e tyre me ne të mos u shkaktojnë probleme shtesë.

Dhe çfarë tjetër? Kaloj shumë kohë në Bosnjë duke punuar në programe edukative; jemi shumë aktivë. Gjithashtu organizojmë diskutime mes Serbisë dhe Malit të Zi.

Vitin e kaluar, organizuam promovime të librit të Rade Radovanoviqit, Të qeshura nën shkallën e varjes – gjithçka që nuk e keni ditur për Kosovën, në dhjetë lokacione nëpër Serbi. Shkuam edhe në Preshevë dhe bëmë shumë punë me të rinjtë nga Presheva, veçanërisht me grupin Livrid dhe të tjerë. Por ata janë mjaft të lënë pas dore; nuk kanë një pozicion të fortë, as në Prishtinë as në Beograd.

Është kaq e trishtueshme. Shkoj në protesta sepse kjo jam unë, sepse besoj që nuk mund të rrish në anë duke parë dhe duke u sjellë sikur je superior. Shkoj sepse ka kaq shumë njerëz të mrekullueshëm që shkojnë për të njëjtat arsye si unë. Nuk është e drejtë t'u mbash leksione këtyre njerëzve ose të sillesh me mendjemadhësi. Vazhdon të vërtetohet se gjithçka shkon në rreth, gjithmonë me të njëjtin model si në vitet '90: një refuzim i plotë për të pranuar realitetin. Lufta është rikthyer, jo vetëm përmes Vuçiqit. Ka një refuzim për të pranuar që Kosova është e pavarur, që Srebrenica ishte gjenocid, që Vukovari u shkatërrua, dhe kështu me radhë.

Është po ashtu e vështirë për mua të shoh që një pjesë e madhe e popullsisë refuzon të pranojë që krimet e luftës me përdhunime tani reflektohen në Serbi si femicid, që përdhunuesit nga Vukovari, Gjakova dhe Foça nuk po lidhen me këtë dhunë të vazhdueshme. Kjo më shqetëson dhe më trazon, kjo paaftësi për të krijuar një analizë serioze politike që nuk është vetëm e bazuar në gjini, por përfshin edhe klasën, aspektet sociale, kulturore, ideologjike dhe të tjera.

Dhe ky është një problem shumë i madh. Mendoj se kjo nuk mund të ndryshojë gjendjen e këtij vendi. Nuk po flas për pajtim, nuk e përdor as atë fjalë. Absolutisht jo. Me kë të pajtohem, çfarë pajtimi? Le të pajtohet Vuçiqi dhe të tjerët. Unë ndihem si dikush që gjithmonë del jashtë radhëve, dhe kjo është një pozitë e vështirë, ajo e një të përjashtuari, një disidenti, në çdo kuptim. Megjithatë, njerëzit e duan pushtetin. Njerëzit duan pozicionet e rrymës së turmës, sepse ato janë më të lehta, më të njohura. Dhe ekziston një shqetësim i caktuar ndaj fuqisë alternative, sepse perceptohet si dobësi.

Por unë shqetësohem thellësisht... për shembull, kampi i Stajiqevos, kjo është diçka krijuese për mua. Të vendosësh një instalacion në kamp, e bëmë atë vitin e kaluar. Këtë vit nuk ishte e mundur ta vendosnim atje, por nuk do t'i lë të na ndalojnë. Kemi vetëm memoriale të lëvizshme, madje edhe për Srebrenicën, dhe ata vazhdojnë t'i shkatërrojnë. "Nuk do t'i shkatërroni çdo herë," e dini. Ja ku është, 8,372 dhe kështu me radhë. Më pëlqen më shumë të punoj me artistë, me kolektive artistike; ata janë thesari i dijes. Ata mishërojnë njëkohësisht etikën dhe estetikën.

Nga aktivizmi mjedisor në atë të paqes

Vesna Teršelič, e lindur në Lubjanë, është presidente e organizatës kroate Documenta, e cila, së bashku me Fondin për të Drejtën Humanitare në Beograd dhe Qendrën e Kërkimit dhe Dokumentimit në Sarajevë, themeluan REKOM-in, si një komision rajonal që do të merrej me ballafaqimin me të kaluarën dhe kulturën e kujtesës. Vesna Teršelič ka bërë një rrugë të gjatë nga aktivizmi mjedisor në vitet 1980 në Kroaci dhe Jugosllavi, deri tek aktivizmi i paqes në Fushatën Kundër Luftës në Zagreb dhe më vonë në Documenta, duke mësuar nga përvoja të ndryshme rreth aspekteve të përpjekjeve aktiviste.

E lindur në një familje jotipike në atë kohë, në të cilën nëna nuk pranoi të hiqte dorë nga liria dhe qyteti i saj me çdo kusht, si nxënëse e shkollës së mesme ajo u zhvendos në shtëpinë e babait të saj në Zagreb, ku mbaroi shkollën dhe përfundoi studimet universitare. Gjatë studimeve, ajo u përfshi në lëvizjen mjedisore, organizatën Svarun, e cila ndikoi në politikën bërthamore të Jugosllavisë. Në Fushatën Kundër Luftës në Zagreb, ajo avokoi për zgjidhje paqësore të konfliktit, por pasi lufta ishte e pashmangshme, së bashku me kolegët e saj, ajo reflektoi për të ardhmen, gjegjësisht situatën pas luftës. Kështu, të gjitha forcat u përqendruan menjëherë në arsim dhe seminare për mësuesit, si dhe në lansimin e Arkzinit, një revistë që përfaqësonte pikëpamje ndryshe nga ato të pushtetit.

Përveç mbledhjes së materialit mbi krimet dhe rezistencën me të cilën merret kryesisht Documenta, ajo beson se nevojitet të zhvillohet një kulturë e kujtesës, veçanërisht mes të rinjve. Është e nevojshme të vizitohen vendet e vuajtjes, jo vetëm nga lufta e fundit, por edhe nga ato të mëparshmet, për t'u përballur me trashëgiminë historike dhe për të mos lejuar që ajo të përsëritet. Për Vesna Teršeličin, trajtimi i temave të vështira mund ta bëjë jetën tonë më të lehtë sepse ne po ndërgjegjësohemi për traumat personale dhe kolektive. Rrëfimi i kësaj aktivisteje të palodhur duhet të shërbejë me të vërtetë si shembull.

Vesna Teršelič

Fëmijeria dhe familja

Quhem Vesna Teršelič dhe kam lindur në Lubjanë, në prill të vitit 1962. Kam jetuar në Lubjanë me nënën deri në klasën e gjashtë të shkollës fillore, së pari në qendër, në rrugën Čopova, dhe më vonë në rrugën Topnička. Fëmijëria ime në fakt ishte më shumë me prani të familjes nga ana e nënës sesa nga ajo e babait, meqë gjyshërit e mi jetonin afër dhe ne shpesh i vizitonim ata në fundjavë.

Unë vij nga një familje e klasës punëtore, megjithëse gjyshërit e mi vendosën të ktheheshin në fshat në vitin e pesëdhjetë e ca. Ndoshta mund të themi se kjo pra një rrëfim punëtorësh, a një rrëfim fshati. Në fëmijërinë time, në të vërtetë, nga njëra anë, gjurmë më la Lubljana, përkatësisht oborri mes Čopovas dhe rrugëve të tjera në të cilat jetonim në një apartament bodrumi, por edhe fundjavat gjatë verës në fshat në shtëpinë e gjyshërve të mi në Šmarje-Sap. Ishte një botë e veçantë në Sap me pyje, fusha, dhe do të thosha se u formova shumë nga përvoja e të gjithë atyre që hynë në atë botë në një masë të madhe si dhe nga koha që kalova me motrën e nënës sime, me fqinjët. Vitet e para i kalova në shtëpi, në moshën trevjeçare fillova të shkoj në kopsht, tezja ime Ivanka u kujdes për mua deri në moshën trevjeçare, dhe unë në fakt kam kujtime shumë të hershme. Një nga kujtimet e mia të para është një mbrëmje, në Sap, te gjyshërit e mi, sepse në mbrëmje lajmet dëgjoheshin gjithmonë në radio. Ishte e rëndësishme të dinim se çka po ndodhte. Atë mbrëmje, të gjithë ishin shumë të mërzitur sepse ishte dita kur u vra Kenedi. Në fakt më kujtohet ajo shushurimë, ai momenti kur u dha lajmi dhe kur qau gjyshja. E gjyshja ime lindi në Colorado, në Colorado Springs. Pra, babai dhe nëna e saj u larguan nga Sllovenia me mijëra emigrantë sllovenë dhe u vendosën në Amerikë, në Colorado Springs. Kështu, marrëdhënia e saj me Amerikën ishte e veçantë. Ata punuan atje, por ishte një kohë kur kushtet higjienike nuk ishin aq të mira, dhe babi, nëna dhe vëllai i saj më i vogël vdiqën të gjithë nga epidemia e kolerës. Më pas, në moshën 15-vjeçare, ajo dhe vëllai i nënës së saj u kthyen në Slloveni, dhe motra e saj mbeti të jetojë në Amerikë, kështu që kjo lidhje me Amerikën mbeti gjallë, dhe ajo u martua me një milioner. Ky është kujtimi i pari, një nga kujtimet e mia të para, i ngjyrosur me aktin e atentatit. Kujtime të tjera lidhen me nënën time, në atë apartamentin tonë të bodrumit, në atë apartamentin e bodrumit gjysmë të mobiluar, dhe me tezen Ivanka që më merrte për shëtitje gjatë ditës. Pas orës pesë, ajo largohej nga banesa, e cila ishte e errët gjatë dimrit, dhe unë isha ende në gjumë dhe pastaj, kur zgjohesha, Ivanka ishte tashmë aty. Dhe meqë apartamenti ishte bodrum dhe i errët, pjesën më të madhe të kohës e kalonim jashtë, përveç gjatë dimrit, natyrisht. Apartamenti ndodhej në ndërtesën ku ndodhet Banka Ljubljanska. Apartamenti i është dhënë gjyshit tim në përdorim, pasi ai ka qenë roje, kujdestar, në atë ndërtesë. Dhe më kujtohen shëtitjet tona në Tivoli, më kujtohet Ljubljanica.

Është një ndërtesë kolektive, ishte një apartament shumë i varfër në bodrum që në fakt kishte shumë pak mobilje. Ndërsa rritesha, nëna ime blinte disa gjëra. Gjyshërit e mi shkuan në fshat në vitin 1960, së bashku me vajzën e tyre më të vogël, motrën më të vogël të nënës sime. Në fakt, nëna ime ka qëndruar e vetme në banesë së pari, dhe shumë shpejt nëna bashkë me mua, sepse ajo u takua me babain tim rreth asaj

kohe, i cili vijonte akademinë ushtarake atje. Ata u takuan në një vallëzim dhe më pas më lindi mua.

Ajo kishte dy vëllezër, vëllain më të madh Jožen dhe vëllain më të vogël Marijanin. Pra, Jože, Marija, Marijani, Erna, kjo është renditja, pra dy vëllezër dhe dy motra. Jože nuk jetoi kurrë atje, ndërsa gjyshërit, nëna dhe tezja jetuan në atë apartament bodrumi. Ata jetonin në një apartament tjetër, në Zaloška cesta. Sot, të dy apartamentet ekzistojnë ende.

Gjyshi im ishte farkëtar, punonte në fabrikën Vega dhe para kësaj punoi... Pra, gjithmonë punoi si farkëtar. Zanati i tij ishte i farkëtarit. Është interesante se gjyshërit nga ana e babait dhe nënës, të dytë, ishin farkëtarë. Por gjyshi nga ana e nënës punonte në Vega, e gjyshi nga ana e babait punonte në fabrikën Gredelj në Zagreb. Para luftës, fabrika nuk quhej Gredelj. Gjyshi im filloi të punojë në Zagreb para Luftës së Dytë Botërore. Ajo që i lidh gjithashtu është se ata ishin si familje punëtore, me orientim të majtë, ndërsa Franc Teršelič, babai i babait tim, u bë anëtar i Partisë Komuniste. Ai ishte faktikisht simpatizant i komunistëve edhe para Luftës së Dytë Botërore, e tash pyetja është kur iu bashkua partisë. Sidoqoftë, ai iu bashkua partizanëve dhe mbeti anëtar i përjetshëm i Partisë Komuniste. Pra, gjyshja e nënës sime, ajo faktikisht fitonte para duke pastruar shtëpitë, ajo kurrë nuk mbaroi asnjë shkollë, dhe u kthye nga Anglia, e kam fjalën nga Amerika. Dinte shkrim dhe lexim, dhe në shtëpi gjithmonë vinte Delo, çdo ditë vinin gazetat Dnevnik, Delo, dhe ajo gjithmonë lexonte dhe gjithmonë dëshironte të fitonte bukën e saj. Donte të gjente punë, por meqenëse nuk kishte shkollë, kurrë nuk pati sukses. Kur u zhvendosën në fshat, jetuan në një shtëpi të madhe, e cila ishte e banueshme në katin përdhes dhe në një pjesë të katit, ndërsa kishte edhe një pjesë në nënkulm që mund të rregullohej, e që nuk u përfundua kurrë. Pra, ajo shtëpi kishte fasadë, por kishte hapësira që nuk u përfunduan kurrë.

Shtëpia është ndërtuar në vitet 1950. Ishte shtëpi e madhe. Por një shtëpi e madhe fshati, sepse ata lanë hapësirë në katin përdhes për depo të patateve dhe për gjithçka që ishte e nevojshme, për hambar e për pula. Pra, në katin përdhes kishte lopë dhe pula, dhe sipër ishte një kuzhinë, dhe dy dhoma, një dhomë gjumi për gjyshin dhe gjyshen dhe dhoma ku ishte tezja ime Erna.

I vizitoja shumë shpesh. Shkoja me mamin çdo fundjavë, dhe gjatë verës, dhe për këtë arsye disa nga kujtimet e mia të para janë të lidhura me fshatin, sepse kam kaluar një kohë fantastike atje. Pra, shtëpia ishte e rrethuar nga një kopsht, nga livadhe. Ishte shumë më bukur atje në fundjavë sesa në Lubljanë, sepse ishte lagësht dhe ftohtë në apartamentin tonë në bodrum.

Nëna ime ishte vogëlushe e përjetshme. Kurreshtare, shumë e lidhur me Lubjanën. Gjithë jetën e kaloi në Lubjanë. Fëmijëria e saj u karakterizua nga vitet e vështira të Luftës së Dytë Botërore, dhe koha kur vëllai i saj nuk ishte me ta, e gjyshi vendosi të martohej me gjyshen vetëm pasi kishte lindur nëna ime. Lindi djali i tyre i parë Jozhe, dhe gjyshja ime nuk mund të kujdesej për të, sepse nuk ishin të martuar, e ata nuk u martuan sepse gjyshi im nuk donte, ishte 16 vjeç. Ishte kjo dramë e madhe, kështu që ajo më pas pagoi gra për t'u kujdesur për fëmijën sepse duhej të punonte gjatë ditës, duhej të pastronte shtëpitë. Xhaxhai e dëboi nga shtëpia. Të kesh fëmijë të jashtëligjshëm ishte turp. Pra, kur lindi nëna ime, ajo hyri në atë kontekst. Këtu gjyshi im vendosi të martohej me gjyshen, por gjyshi nuk ishte shumë i interesuar për famil-

jen. Kur shpërtheu lufta, ai punoi si farkëtar. Pra, ai vendosi të merrej me atë zanat dhe nga të gjithë fëmijët ndoshta më së shumti e donte nënën time. Por aq sa mund ta donte. Në dashuri ishte koprrac. Dhe meqë unë linda si mbesa e parë dhe isha vajza e vajzës së preferuar, ne e kuptonim mirë njëri-tjetrin, por gjatë gjithë fëmijërisë, e dija se si ishte gjyshi im. Dhe se pi shumë, dhe se kur dehet e ndjek gjyshen time nëpër shtëpi, se është i dhunshëm, e dija historinë e dajës sim Jozhes, i cili kurrë nuk ia fali gjyshes sime që u rrit në shtëpi të huaja. Dhe daja im Marijani, i cili lindi si fëmijë i tretë, gjatë Luftës së Dytë Botërore, i cili madje nisi të pinte në kohën kur iu bashkua APJ-së. Pra, ishte kjo linjë e alkoolizmit që u bart nga një anëtar mashkull te tjetri. Dhe nëna ime ishte vajzë gjatë Luftës së Dytë Botërore, ajo shkoi në Shkollën Ursuline, dhe ishte gjithashtu në një shkollë me konvikt gjatë një pjese të fëmijërisë së saj. Edhe pse, fizikisht, Shkolla Ursuline nuk ishte larg nga Zaloška cesta, ku ata jetonin në atë kohë. Gjatë javës, ajo qëndonte në konvikt, ku murgeshat u mësonin aftësi të ndryshme, dhe pastaj vinte në Zaloška cesta vetëm gjatë fundjavës, sepse gjyshja ime punonte gjatë ditës. Pra, gjatë Luftës së Dytë Botërore, nëna ime kishte shumë kujtime dhe në fakt i mbante mend fashistët në Lubjanë. Së bashku me kushërirën e saj nga familja Bendeçiç, ajo u kap me afishe, me afishe të Frontit Çlirimtar. Kushërira e saj ishte 18 vjeç ndërsa fashistët e panë se sa e vogël ishte nëna, ajo lindi në vitin 1935. Atë e lanë të shkonte, i thanë të largohej, ndërsa Erna u arrestua dhe më vonë u lejua të vizitohej në burg, para se të ekzekutohej.

Atë e ekzekutuan. Pra, ajo doli nga lufta me disa trauma. Gjyshi im u arrestua në vitin 1942, në arrestimet masive të simpatizantëve të Frontit Çlirimtar, ilegalëve, partizanëve, lëvizjeve të rezistencës, dhe ai u burgos në kazermë së bashku me të tjerët, dhe më pas u dërgua në kampin fashist Gonars. Me gratë e tjera të të arrestuarve, gjyshja dhe nëna ime morën pjesë në protestat e grave. Gratë kërkuan t'i lironin burrat e tyre sepse me mijëra u burgosën. Ditën kur erdhi, ishte shumë i hollë, kishte humbur shumë peshë pas gjithë atyre muajve, dhe tha vetëm një fjali dhe kurrë nuk tha më asgjë për kampin. Dhe ajo fjali ishte: "Tani do të hamë, tani do të hamë patate." Kurrë nuk i tregoi askujt më për kampin. Për shumëkë nga Lubjana, dhe jo vetëm nga Lubjana, në të vërtetë nga krahina e Lubjanës, kampet fashiste ishin edhe në Kroaci, kryesisht nga rrethina e Čabarit. Ato ishin vende ku ata gjithsesi i panë disa nga shokët e tyre të ndërronin jetë.

Nëna ime vazhdoi të shkonte në shkollë dhe mbaroi shkollën pas Luftës së Dytë Botërore. Pas luftës, ajo pësoi një aksident ndërsa po ngiste biciklетën. E mori përpara një kamion dhe e tërhoqi nga prapa për një kohë, me çka vuajti nga disa probleme neurologjike gjatë gjithë jetës, për shkak të kësaj. Dhe ajo mbeti diku, do të thosha se në një pjesë të kohës së saj të vajzërisë, në një pjesë të personalitetit të saj ajo mbeti ashtu, ajo mbeti vajzë. Dhe fakti që më lindi mua, diku ia ndali të gjitha planet. Kishte një plan tjetër se ajo do të shkonte te tezja në Amerikë. Filloi të mësonte anglisht. Megjithatë, në atë kohë, tezja nga Amerika vdiq në një aksident automobilistik. Ky plan ra në ujë. Kështu, në vend se të shkonte në Amerikë, ajo qëndroi në Lubjanë, takoi babain tim dhe më lindi mua. Me mua, ajo u përball me shumë vështirësi financiare. Do të thosha se iu shtuan shumë obligimet. Në një farë mënyre ishte mbi 20 vjeç, por ishte sikur vajza të ketë lindur vajzë. Kur mbusha tre vjeç, fillova kopshtin. Pra, tezja Ivanka nuk mund të kujdesej më për mua sepse kishte nipin e saj, dhe kur fillova kopshtin, atëherë ne të dyja, diku pas orës 5 të mëngjesit, niseshim çdo mëngjes, unë në kopsht, nëna në fabrikë. Ishte shumë herët për mua, nuk isha shumë e lumtur që duhej të zgjohesha kaq herët, kështu që nganjëherë edhe më mbante. Por unë isha

e rëndë. Dhe, kur ndalej, kur mbaronte, punonte nga ora gjashtë deri në dy, dhe pastaj vinte të më merrte, dhe shkonim në shtëpi. Ishte kjo një pikë kthese totale në jetën e saj, kjo lindje. Pra, ajo arriti atë që nëna e saj nuk arriti të bënte – kishte punë të qëndrueshme, punoi nga mosha 16-vjeçare. Në fakt, ajo ishte ende në shkollë, kështu që përvoja e saj e punës u njoh që nga mosha 16-vjeçare kur ishte në shkollë të mesme për t'u bërë oftalmologe dhe ajo doli në pension relativisht herët, para moshës 60-vjeçare, por ishte me të vërtetë një jetë shumë e organizuar. Pra, fabrika nga gjashtë në dy; punë shumë e vështirë. E di sepse më vonë në shkollën e mesme shkova të bëja praktikë në atë fabrikë për një muaj. Pra, ai muaj ishte ferr i vërtetë, sepse duhej të punoje me lente, domethënë me kimikate, dhe kjo ishte sigurisht e dëmshme për shëndetin, jo vetëm për nënën, por për të gjithë punëtorët. Ajo ishte kontrollore dhe atje, epo, atje kaloi vitet më të mira të jetës së saj. Dhe në fundjavë qëndronte me gjyshërit e mi dhe punonte në bujqësi: bar, ara.

E merrnim trenin e mëngjesit për fundjavë. Zakonisht vraponim sepse për arsye të panjohura pothuajse gjithmonë vonoheshim, që do të thotë se e kalonim vrap pjesën e fundit. Trenat e parë që mbaj mend ishin ende lokomotiva me avull dhe pas një kohe filluan të lëvizin trena motorikë dhe më pas e kalonim fundjavën në shtëpinë e gjyshërve duke bërë punë bujqësore.

Ia kalonim shumë mirë! Ne të dyja më së shumti e kuptonim njëra-tjetrën, nëse nuk kuptoheshim, atëherë ziheshim, i bërtisnim njëra-tjetrës me zë të lartë, dhe disi të dyjat ishim shumë mirë deri në moshën 12-vjeçare. Së pari, ishim në Čopova. Isha fëmijë që sëmuresha shpesh deri në momentin kur u zhvendosëm nga Čopova, nga ai apartament bodrumi në Topniška. Ai apartament ishte shumë i lagësht. Në fakt kisha një lloj reumatizmi, krejt të pazakontë për fëmijë aq të vegjël, dhe shpesh kisha gjakderdhje nga hunda. Pra, sëmuresha gjatë gjithë kohës. Pra, kjo ishte një arsye shtesë që nëna të shqetësohej.

Kam lindur me ije të dislokuara në një kohë kur kjo nuk ishte situatë e lehtë për t'u zgjidhur. Megjithatë, nuk e di se si, kur ma hoqën gipsin që e kisha mbajtur me muaj, që ndryshonte ndërsa fëmija, ndërsa foshnja rritej, nuk e di për këtë, nëna më tregonte. Pra, se si nëna ime arriti të m'i bënte të gjitha ato ushtrime çdo ditë, është e vështirë të thuhet, por ajo ia doli. E donim njëra-tjetrën dhe kaluam kohë të këndshme së bashku. Nëna ime ishte padyshim baza ime. Ishim të rëndësishme për njëra-tjetrën, vetëm se shpesh ndryshonim në mendime, por nëna ime nuk u përpoq të më heshtë. Pra kur ziheshim, vërtet ziheshim. Pra, ajo nuk donte të më shtypte, por luftonim në mënyrë të barabartë. Dhe kjo është edhe fryma me të cilën kam shkuar në kopsht, si fëmijë jo shumë i socializuar, sepse nuk kishte shumë fëmijë në lagje dhe ai grup në kopsht ishte grupi më i madh i fëmijëve që kam parë ndonjëherë në vitin e tretë. Dhe në kopsht pashë një hierarki të qartë, sepse kishte ndarje të qartë mes fëmijëve më të varfër dhe atyre më të pasur. Pra, kur vinte fundi i muajit, gjithmonë ndodhte ai kalkulimi... A do të mund të blejmë diçka, a nuk do të mund të blejmë diçka, çka do të hamë, e kështu me radhë... Pra, udhëtimi ynë në fundjavë në fshat ishte gjithashtu i veçantë, në kuptimin që gjithmonë kishte shumë ushqim të mirë në fshat. Kjo ishte gjithashtu e mrekullueshme, e të mos flasim për oborrin, ku gjithçka që rritet dhe korret pastaj përgatitet, apo jo? Pra, më pëlqente shumë të shkoja në fshat, e në kopsht më duhej shumë kohë për të bërë shoqëri. Dhe në një farë mënyre, as nuk mund të them se kisha shoqëri në kopsht. Më vonë në shkollë bëra shoqëri. Shoqëria ime e parë ishte nga situata e ngjashme. Për shembull, Mojca Jozi ishte vajza e një nëne ve-

tushqyese. Dhe kur shkova në kopsht pas disa ditësh, dhe e pyeta nënën time, po sikur të më godasë dikush, ajo m'u përgjigj 'godite edhe ti', kështu që u bëra fëmijë shumë luftarak. Në fakt, kjo përvojë në kopsht ishte diçka që më karakterizoi më shumë në krijimin e një hapësire timen në të cilën mund të bëja atë që do të bëja. Shkollën e fillova në moshën 6-vjeçare dhe ishte pak problem edhe kjo, sepse disi, nuk isha gati për shkollë. Sapo mbusha 6 vjeç, dhe më zinte gjumi. Disi, u regjistrova me disa kushte, sepse fëmijët shkonin në shkollë në moshën 7-vjeçare kështu që m'u desh një kohë e gjatë për të vendosur se ishte punë e mençur të mësoja të lexoja, e kështu me radhë. Por nëna ime dhe unë i kaluam mirë të gjitha këto. Dhe kur mësova të lexoj, pra kur kuptova se nuk kisha ku të ikja më, sepse mësoja përmendësh faqen dhe pastaj thjesht i thosha ato që i mësoja përmendësh. Por kur mësova të lexoj, iu dhashë leximit marrëzisht. Pra, leximi më pushtoi plotësisht, e u bëra gjithë mend.

Babai nuk jetonte me ne. Ai mbaroi Akademinë në Lubjanë, dhe angazhimi i tij i parë ishte në Mostar, me faktin se, ndërsa ai ishte ende duke vijuar Akademinë, ai kishte atë statusin e praktikantit dhe në atë kohë ishte në Prishtinë për një periudhë, dhe nëna ime shkoi për ta vizituar në Prishtinë në atë kohë, dhe pastaj e vizitonte edhe në Mostar. Ai shumë rrallë merrte pushim. Pra, vinte për vizitë, por ishte një vizitor shumë i ëmbël, sillte dhurata e kështu me radhë, epo, krejt kjo ishte e këndshme dhe e mirë, por në të vërtetë nëna dhe unë jetonim vetëm, dhe kështu ishte gjatë gjithë kohës së shkollës fillore. Pra, jetova me nënën time deri në fund të klasës së gjashtë, dhe pastaj dy vjet me gjyshen time, dhe më pas shkova në Zagreb te babai im. Babai im ishte i huaj për mua, në fakt. Kisha dëgjuar se ai ishte pjesë e ushtrisë e mua nuk më pëlqenin njerëzit me uniformë që kur isha fëmijë. As policia, as ushtria.

Shiheshim mjaft shpesh, unë e dija se ai ishte aty, e doja, më donte, por vinte rrallë. Nëna ime më çonte te shtëpia e gjyshërve, ndërsa ajo shkonte ta vizitonte në Mostar. Unë nuk shkoja në Mostar. Kjo nuk vinte në konsideratë. Hera e parë, dhe ndoshta e vetmja herë që e vizitova babain tim ndërsa ishte ende në Mostar, ishte kur shkuam në bregdet, shpesh shkonim në bregdet në Hvar, në Jelsa, dhe pastaj kalonim nëpër Mostar gjatë kthimit. Dhe kjo ishte hera e vetme që isha në banesën e babait tim, por nuk e vizitova më.

Ai është njeri i butë, i hutuar. Për të komunikimi me njerëzit ka qenë gjithmonë sfidë. Ai është nga fshati Skopica, afër Brežice, gjithashtu në Slloveni, nga një familje që, sipas gjurmëve të shkruara, ka qenë në atë fshat që nga viti 1745. Familja Teršelič, në zona të ndryshme përreth atij fshati, jeton në shtëpi të ndryshme – kjo mund të gjurmohet përmes dokumentacionit. Pra, ai është nga ky fshat, gjyshi ishte farkëtar dhe gjyshja rrobaqepëse. Të dytë punonin, por ai jetonte më shumë me të ëmën, sepse gjyshi punonte në Zagreb. Ata filluan të jetojnë në Zagreb, dhe atje ishte shtrenjtë, dhe pastaj kur u lindi fëmija i tretë, babai im, ata vendosën që gjyshja ime të jetonte në fshat, në Skopice, dhe gjyshi im të vinte nga Zagrebi për fundjavë. Ata ishin dy motra dhe babai. Babai im shkoi në Zagreb pasi përfundoi shkollën e mesme, dhe atij i pëlqente të studionte, dhe ishte vërtet i mirë në studim. Shkoi në Zagreb për të studiuar në Fakultetin Ekonomik, por nuk ia doli. Njëfarë domosdoshmërie e tij është se e ka më të thjeshtë kur jetën e ka disi të organizuar nga jashtë. Duke qenë se nuk ishin shumë të pasur, kur e la fakultetin, gjyshi im i tha: "Nuk të shkollojmë më. Tash duhet të kujdesesh për veten. Këtë nuk e mbarove." Dhe babai im vendosi të shkonte në akademi, në akademinë ushtarake, sepse kjo ishte faktikisht e vetmja gjë në dispozicion që ishte falas. Kjo ishte shumë e përshtatshme për të pasi jeta e tij kështu u organizua, dhe ai

nuk kishte pse të vendoste vetë se çka do të bënte dhe si do t'ia bënte, gjithçka ishte e organizuar nga mëngjesi në mbrëmje. Dhe sapo përfundoi akademinë dhe filloi shërbimin, së pari në Mostar, dhe më pas në Maribor, ai mbaroi inxhinierinë elektrike, mbaroi magjistraturën në inxhinieri elektrike dhe u specializua në elektronikë. Pra, donte të vazhdonte të mësonte. Ai flet disa gjuhë: anglisht, gjermanisht, rusisht, frëngjisht – i shkonin mirë gjuhët.

Donte të përfundonte doktoraturën, por pastaj në ushtri pas transferimit të tij në Zagreb, ku jepte mësim në Akademinë Ushtarake, e urdhëruan të transferohej në Beograd, gjë që ai e refuzoi. Pra, e lanë pa doktoraturë – gjë që vërtet e mërziti dhe e mundoi – epo, rrugës për në doktoraturë, u ndal.

Në komunikim me babain, patëm probleme, si ai ashtu edhe unë. Meqenëse ai kishte vështirësi komunikimi gjatë gjithë jetës, dhe unë nuk jam kampione botërore në komunikim, ka pasur në mënyrë të pashmangshme keqkuptime. Dhe në Zagreb u shoqëruam për një kohë të shkurtër, ndërsa unë jetoja me të. Do të thosha se nuk ka dyshim se e duam njëri-tjetrin, por nuk u kuptuam shumë mirë. Shkova në shkollën fillore Ledina deri në klasën e gjashtë.

Pra, në fund të gjysmëvjetorit të dytë të klasës së gjashtë, më thanë se gjyshja ime ishte shumë e sëmurë, nëna e babait tim, se ajo ishte shumë e sëmurë, se duhej të bënte një operacion në stomak dhe se unë do të jetoja me të nga vjeshta. Disi nuk ndjeva se kisha shumë hapësirë për manovrim për të thënë jo. Në një farë mënyre, e pashë si një zhvillim të ri – pra, le të shohim se çka do të ndodhë.

Jo, në fillim, përkundër faktit që kisha baba dhe nënë, unë jetova me gjyshen time në fshat për dy vjet. Kjo është zgjidhje e çuditshme. Por, prindërit e mi kishin disa ide të pazakonta, disa zgjidhje të pazakonta. Pra, unë shkova të jetoj në fshat me gjyshen time, gjyshja ime u operua, dhe pastaj ishte në rekuperim. Në kohën kur gjyshja ime ishte në spital, për mua u kujdesën edhe fqinjët, dhe gjithçka funksionoi. Kisha edhe dhomën time; ishte kjo një përvojë e re. Pra, nuk është se kisha ndonjë përfitim, pasi nëna ime dhe unë jetonim në një apartament me një dhomë gjumi, por cilësia e asaj shkolle dhe disiplina ranë shumë. Në fakt, erdha në një shkollë ku kurrë nuk më duhej të mësoja asgjë. Pra, për dallim nga Ledina, e cila ishte shkollë e lidhur me akademinë pedagogjike, ku duhej shumë mund për të marrë një 4, në shkollën fillore "Brežice" nuk kisha shumë nevojë të mësoja. Brežice është në Sllloveni. Pra, gjyshja ime jetonte në Sllloveni, dhe në shkollë të mesme u shpërngula në Kroaci, në Zagreb. Më duhej shumë kohë për të bërë shoqëri. Dhe në një farë mënyre, as nuk mund të them se kisha shoqëri në kopsht. Më vonë në shkollë bëra shoqëri. Shoqëria ime e parë ishte nga situata e ngjashme.

Zhvendosja në Zagreb

Lexoja stripë dhe mësoja diçka prej tyre, dhe që nga klasa e katërt në Slloveni mësohej serbo-kroatishtja. Pra, diçka mësova përgjatë rrugës. Dhe në fakt dija njëfarë gjuhe. Sigurisht që nuk e dija 100%, ose nuk isha më e mira, kush e di se si flisja, por kuptoja atë që më thoshin, kështu që nuk kisha ndonjë problem me të kuptuarit në atë shkollë të mesme ku sapo shkova. Pra, ishte ky Gjimnazi i Dytë në Zagreb, kuptoja gjithçka. Pra, të kuptuarit nuk ishte problem. Por sigurisht ishte sfidë të filloja të jetoja me babain tim, nëna ime ishte në Lubjanë, ajo vinte në fundjavë, unë po kaloja nëpër pubertet, kishte llojlloj sfidash të tjera.

Në shkollën fillore, kam bërë shoqëri të parë. Shoqëria ime në kopshtit ende lidhet me rrethinën e apartamentit tonë. Por këta ishin djem mjaft të tërbuar, dhe është pak zor të flas për shoqëri të vërtetë. Këta janë djemtë që i njihja. Le ta themi kështu. E shoqet e mia të para lidhen me shkollën fillore. Ishte kjo gjithashtu një kohë e pasur për të mësuar, dhe mendoj se nëse do të kisha qëndruar në Lubjanë, jeta ime do të dukej krejtësisht ndryshe. Ky vendim për të shkuar në shkollën fillore në Brežice, dhe më vonë në shkollën e mesme në Zagreb, ma ndryshoi absolutisht drejtimin e jetës.

Në vitin 1974 shkova në Brežice, e në vitin 1976 shkova në Zagreb. Ishte ky viti i parë i shkollës së mesme në Zagreb. Në fillim, Zagrebi ishte qytet jo shumë i bukur, gri, me të cilin ngadalë u mësova, në shkollë u miqësova me Ksenija Briškin, dhe pas shkollës dilnim së bashku. E gjithë kjo lidhet me zbulimin e vendeve të reja. Pas atij viti të parë, në klasën e dytë, fillova një marrëdhënie të trazuar dashurie dhe këtu fillon një periudhë e trazuar pas së cilës kohë të tilla do të vinin rresht, njëra pas tjetrës, për vite me radhë. Është e vështirë të them se cila ishte më e keqe se e tjetra, kështu që nuk kam pse të mburrem me zgjedhje shumë të suksesshme, por koha e pubertetit ishte për mua agoni e përhershme në të cilën, sa i përket letërsisë, mbizotëronin ekzistencialistët, dyshimet për kuptimin e ekzistencës dhe jetës sonë. E kalova gjimnazin në atë gjendje shpirtërore. Dhe kjo pastaj u shtri deri në kohën e studimeve.

Shkova në gjimnaz, por në dy të ndryshme. Pra, së pari shkova në atë që quhej “Druga” ose “Qendra për Kulturë dhe Art”, sepse ishte një kohë e ndryshimeve në atë shkollë të mesme, dhe më vonë u zhvendosa në “Qendrën Edukative Matematiko-Informatike”. Para së gjithash, për shkak se grindesha pak a shumë me të gjithë profesorët, dukej se ndërrimi i shkollës do të ishte zgjidhja e vetme e arsyeshme e mundshme. Dhe shkova në shkollën që njihej si Gjimnazi VII. Në fakt, e kalova tërë vitin e tretë duke folur vetëm me një person me të cilin e ndaja bankën. Ajo quhej Sanja Vit, me tjetërkënd nuk fola. Nuk fola me askënd gjatë gjithë klasës së tretë të shkollës së mesme. Tek kur shkuam në klasën e katërt fillova të flisja me të tjerët. Pra, nuk mund të them se ishte kohë e lehtë për mua.

Lexoja gjithçka. Më kujtohet “Një mijë e një netë”. Gjithçka që ofronte biblioteka e shkollës, gjithçka që ofronte biblioteka lokale në Lubjanë, pasi nuk kishim para të mjaftueshme. Ajo që është interesante në familjen tonë është se babai nuk dërgonte para. Pra, edhe kjo është diçka që mund të jetë karakteristikë e asaj kohe, ndoshta jo, por në parim, mendoj se çmimi i lirisë së nënës sime ishte se ajo u kujdes për mua, dhe jetoi në Lubjanë, dhe babai im u kujdes për veten e tij. Pra, librat ishin luks i vërtetë. Që nga klasa e dytë e shkollës fillore, gjithmonë kam dashur libër për ditëlindje.

Pra, ishte dëshirë e madhe t'i mbush raftet me librat që mund t'i lexoja. Por nëna më lexonte kur isha e vogël. Ajo blente libra për fëmijë, dhe pastaj m'i lexonte. Pra, edhe para se të filloj shkollën, mësova të lexoja vetë, dhe tashmë kisha dëgjuar shumë nga këto rrëfime. Në fakt, lexova shumë tregime; ato ishin si hyrja ime e parë. Dhe pastaj lexova romane, gjithçka që hasja.

Ajo që dinim ishin luftërat nëpër botë. Pra, e njihnim situatën botërore. E situata këtu në Jugosllavi dukej normale dhe jo shumë stresuese. Deri diku, deri në njëfarë mase. Në vitin 1980, Tito vdes, kishte trazira para kësaj, por ato nuk dukeshin si diçka që mund të ndikonte në mënyrë dramatike në jetën tonë.

Të tetëdhjetat: fillet e aktivizmit

Në vitet 1980 fillova studimet. Studiova filozofi, letërsi krahasuese dhe fizikë në dy fakultete të ndryshme, sepse disi, doja të kuptoja më shumë si për botën fizike ashtu edhe për ngjarjet shoqërore. Dhe, do të thosha se gjatë asaj kohe, kjo çështje e kuptimit të ekzistencës dhe mundësisë së veprimit nuk m'u largua kurrë, kështu që në fakultet, gjatë disa viteve të mëvonshme, së bashku me të tjerët – jo vetëm nga Fakulteti Filozofik, por edhe nga Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Matematikës dhe Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike, pasi ishin pjesë e shkollës sime, shkollës sime të mesme, klasës sime në shkollën e mesme – studiuam inxhinieri elektrike dhe inxhinieri mekanike, dhe qëndruam në kontakt. Diskutonim shumë për atë që duhet bërë. Sepse koha nga viti 1980 e tutje, nga vdekja e Titos e tutje, është padyshim kohë trazirash. Dhe ja, ne po e kërkonim një vend tonin, një pikënisje, një vend të ri tonin, dhe filluam të bënim disa hapa drejt nismës që na çoi të gjithëve në Svarun, një grup pune për paqen, iniciativë e grave, shpirtërore dhe e gjelbër, një emër shumë kompleks. Dhe në vitin 1985, filluam një iniciativë që dukej si teatër rruge.

Pra, diku filluam t'i mendonim veprimet tona të dukshme, organizuam demonstrata boshe, organizuam disa ngjarje karnavalesh, organizuam një lexim publik të kushtetutës në tramvaj, ku nxorëm pjesë për të drejtat e njeriut dhe i lexuam në tramvaj, në nënkalimin në Zagreb. Patëm aksione të tilla në rrugë, dhe pastaj në vitin 1986 ndodhi Çernobili, dhe më pas u përqendruam shumë në veprimet kundër ndërtimit të centraleve bërthamore në Jugosllavi, sepse Jugosllavia kishte plan për të ndërtuar gati 20 centrale bërthamore. Dhe do të thosha se një iniciativë shumë e gjerë kundër ndërtimit të këtyre centraleve bërthamore me të vërtetë filloi nga lart, dhe ne organizuam protesta për nënshkrimin e peticioneve. Nuk ishte kjo vetëm diçka e jona, ishte diçka që filloi në Slloveni, në Bosnjë, në Serbi, kështu që bashkëpunuam shumë me kolegët. Por që nga viti 1980, veçanërisht në fakultetin siç është fakulteti i filozofisë, ne ishim të vetëdijshëm se në Kosovë kishte filluar një iniciativë e re, dhe meqë morëm pjesë në takimet e studimeve të filozofisë, fakultetet kishin takimet e tyre. Fakulteti i shkencave natyrore dhe matematikës kishin takimet e tyre, edhe fakulteti i filozofisë, dhe duke qenë se isha në dy fakultete, shkoja si në mbledhjet e fakultetit shkencor ashtu edhe në atë të filozofisë, dhe gjithashtu luaja shah.

Kjo është faktikisht disiplina që më çoi aty, jo aq seriozisht, por mjaft seriozisht për të qenë në ekipin e fakultetit. Dhe kështu u zhvillua filozofiada në Kosovë, në Brezovicë, pas protestave studentore në Kosovë, për herë të parë në territorin e Kosovës, dhe kjo ishte me të vërtetë një ngjarje formuese për mua duke marrë parasysh shqetësimin tim, grindjet që kisha me babain tim, sepse ai kishte veshur uniformë, dhe në përgjithësi, shqetësimi karshi njerëzve të veshur me uniforma, të cilëve nuk u besoja kurrë, ishte një situatë në të cilën ne në Brezovicë dhe gjithçka që bëjmë në të vërtetë ishte e kontrolluar, në një mënyrë mjaft të ngathët. Dhe më kujtohet qartë, isha në dhomë me Jadranka Žunan, u bëmë shoqe nga ai udhëtim. Më kujtohet se si para udhëtimin shkova në stacionin kryesor në Zagreb, dhe po qëndroja aty me disa studentë, disa i njihja, disa jo, dhe një grua e vogël erdhi tek unë dhe më tha: “A do të jesh në dhomë me mua?” Thashë, “Po.” Pra, u bëmë shoqe dhe e ndamë dhomën, dhe pastaj kthehesim në dhomë pas mëngjesit dhe aty ishte një burrë me kostum që thoshte se kishte ardhur për të ndërruar llambën. Pra, shërbimi i sigurimit të shtetit kontrollonte gjithçka, deri në atë masë sa ne vazhdonim të bënim shaka. Por për ne ishte e qartë se ekzistonte një bujë e madhe dhe se në të vërtetë po ndodhte diçka që ne nuk mund ta miratonim.

Diçka raportohej në media, dhe unë isha me kolegët që shkruanin për Poletin, ndonjëherë edhe unë shkruaja për Poletin, për Studentski list dhe shikonim me kujdes, me sa mundnim, a janë botuar të gjitha gjërat në gazetë, ndërsa situata po përkeqësohej. Dhe situata po përkeqësohej, dhe ne ngjiteshim në Malet e Sharrit, në Bjeshkët e Nemuna, derisa kufiri ishte gjithmonë vendi i vëzhgimit më të lartë të asaj që po ndodhte. Në parim, lëvizja normale në Kosovë ishte e vështirë. Dhe unë isha shumë e vetëdijshme për diskriminimin, sepse ndërsa udhëtoja... E kam fjalën, nuk udhëtoja vetëm nëpër Jugosllavi, udhëtoja edhe në Evropë, udhëtoja në të gjithë Evropën duke bërë autostop. Gjithmonë ishte e qartë se kudo që udhëtoja në Jugosllavi, se nëse, ta zëmë, ishte dikush nga Kosova në tren, në një kupe, policia gjithmonë i ngacmonte. Gjithmonë. Pra, policia hynte gjithmonë në trena, veçanërisht në trenat e natës, na kërkonin gjithmonë letërnjoftimet, ndonjëherë nga dy herë. Që nga viti 1980, që nga vdekja e Titos, dhe që nga kërkesat e para për Kosovën Republikë, thjesht e jepja letërnjoftimin, e shikonin, ma kthenin, e ata që ishin nga Kosova, shqiptarë nga Kosova, me ta biseda zgjaste. Ishte ngacmim i vërtetë.

Vitet 1980 janë, nga njëra anë, vite represioni në Kosovë dhe vite të demokratizimit gradual. Pra, kishim shumë shpresë dhe prisnim që gjërat të ndryshonin për mirë. Dhe angazhimi ynë që nga viti 1985, angazhimi i studentëve... Në vitin 1986 lansuam Svarunin, të cilin fillimisht duhej ta zhvillonim si iniciativë qytetare sepse nuk mund të bashkoheshim formalisht diku. Sepse ishte punë e madhe kur ke iniciativë qytetare, kur dëshiron të bësh diçka në rrugë. Nuk mund ta bësh. Duhej ta raportoje ngjarjen në polici, e nëse nuk je person juridik, nuk mund ta raportosh në polici. Vazhdimisht përpiqeshim t’i bashkoheshim ndonjë organizate rinore, gjë që kërkonte kohë shumë të gjatë, ishim në harresë për më shumë se një vit. Në fakt, mund të takoheshim në një lloj hapësire rinore socialiste, por nuk kishim ndonjë status legal, derisa nuk na ngushtoi konferenca universitare, domethënë rinia universitare. Pastaj u bë disi më e lehtë me këto veprime në rrugë, sepse situata ishte idiotike, në fakt. Oorganizonim peticione kundër armëve bërthamore dhe peticione për kundërshtim të ndërgjegjshëm të shërbimit ushtarak në Armatën Popullore Jugosllave, dhe policia na ndalonte çdo herë pas atij aksioni. Pra, nuk ishte ky represion i pastër, nuk ishte kjo fytyra e represionit që mund të shihej në Kosovë.

Ajo ishte diçka tjetër. Dhe gjërat u nxehën politikisht, do të thosha se Sllovenia mori timonin, pikëpamjet sllovene kundër represionit në Kosovë ishin më të qarta, por edhe ato erdhën shumë vonë, sepse represioni në Kosovë shkoi shumë larg. E kisha fare të qartë se sa e fortë ishte kjo linjë represive, kjo linjë policore, kjo linjë ushtarake. Meqenëse avokonim për kundërshtimin e ndërgjegjshëm së bashku me kolegët tanë nga Sllovenia, e kishim gjithashtu të qartë se ushtria është jashtëzakonisht represive ndaj të gjithë atyre që refuzojnë të mbajnë armë, që refuzojnë dhe nuk mund të mbajnë armë. Pra, unë tashmë isha pjesë e seancave gjyqësore ushtarake ku Dëshmitarët e Jehovait u gjykuan për refuzimin e mbajtjes së armëve. Ky është një tregim i errët për Dëshmitarët e Jehovait: ata refuzuan të dy rekrutimet, dhe shërbinim ushtarak dhe u dënuan me disa vjet. Pastaj ktheheshin, dhe pas nja dy javësh u dërgonin përsëri një thirrje, pastaj ata refuzonin përsëri, dhe më pas dënoheshin me disa vjet për këmbëngulje në veprën penale. Dhe këto janë gjërat që unë i dija.

Nga viti 1988, linja telefonike SOS për gratë dhe fëmijët viktima të dhunës u vu në funksion në Zagreb. Në fakt, me një forcë krejt vullnetare, një rreth grash, thjesht me telefon, së pari mbështetën gratë dhe fëmijët, dhe më vonë në të vërtetë krijuan strehë. Të gjitha këto ishin iniciativa; unë nuk isha vullnetare. Vlerësimi im ishte se, në fakt, nuk mund të ofroja mbështetje cilësore, sepse kjo lloj situate do të më zemëronte menjëherë. Pra, nuk mund të kishte shumë dobi nga unë, për sa i përket mbështetjes terapeutike, sepse dhuna më tmerronte. E dija që kolegët e mi po punonin, isha në ato qarqe, dhe Svaruni, grupi që i parapriu linjës telefonike SOS, një pjesë e diskutimeve tona i kushtohej gjithmonë barazisë. Unë në fakt u rrita në frymën e pavarësisë dhe lirisë. Pra, nuk mbaj mend ndonjë kohë që do të kisha pasur problem me këtë. E unë kam pasur përvoja jashtëzakonisht të dhunshme duke u rritur, gjatë shkollës së mesme, dhe thjesht e dija se, të themi, gjyshi im, babai i nënës sime, alkoolist, ishte njeri shumë i dhunshëm, dhe kjo nuk ishte diçka e çuditshme as për djalin e tij më të vogël, dhe këtë e kisha parë në shumë familje atje. Në fakt, dhuna më tërbonte. Pra, kur doni të mbështesni dikë që është në situatë të ngjashme, keni nevojë për një nivel qetësie, të cilën unë nuk e kisha në atë fazë. Dhe me atë telefon SOS, në të njëjtën hapësirë, që ishte edhe hapësira e Aleancës së Rinisë Socialiste të Qytetit të Zagrebit, filloi nisma e parë Lila, nisma e parë lezbike. Këto janë iniciativa, pra unë kam marrë pjesë në këto iniciativa dhe kam marrë pjesë në disa takime, megjithëse nuk kam qenë aq e angazhuar sa në Svarun. Do të thosha se pothuajse i gjithë aktivizmi im i përditshëm ishte i lidhur së pari me Svarunin, dhe më pas me Aksionin e Gjelbër. Në vitin 1990, gjithashtu lansuam Aksionin e Gjelbër kur iniciativa Svarun disi mori fund. Sepse në atë kohë u miratua një moratorium mbi centralet bërthamore në Jugosllavi.

Kishte iniciativa për shtigjet e bicikletave, kishte iniciativa për riciklimin e mbeturinave, kishte iniciativa të tjera. Kështu, thelbi i punës së Svarunit ishin veprimet në lidhje me mbrojtjen e mjedisit, disa çështje urbane derisa çështje e rëndësishme ishte kundërshtimi i ndërgjegjshëm. Kjo ishte çështje shumë e rëndësishme për ne, sepse ishte një çështje rezistence ndaj këtij regjimi të shërbimit të detyrueshëm ushtarak.

Ne ishim shumë të ngarkuar me diçka që ishte futur brenda nesh, në sistemin arsimor që, para se të veprosh, duhet të studiosh shumë mirë, të përgatitesh shumë mirë dhe ta zotërosh shumë mirë teorikisht. Deri në atë masë saqë në të vërtetë na bëri të paaftë në kuptimin praktik. Nëse koha që kemi kaluar në diskutime do të ishte e matshme, për shembull, do të na duheshin gjashtëdhjetë orë diskutime për gjysmë ore veprim, derisa kolegët tanë perëndimorë... Në atë kohë, diku në synimet tona libertar-

iane, ne ishim shumë të interesuar për iniciativa anarkiste, dhe ishim në kontakt me anarkistë nga vende të ndryshme. Ne ishim në kontakt me nismën që do ta jetësonte Parlamentin Qytetar të Helsinkit, që u lansua me një tubim të madh në Pragë në vitin 1990, në të cilin edhe unë mora pjesë, por udhëtova në shumë qytete, në Budapest, në Vjenë, për t'u takuar me kolegë nga vende të tjera, jo vetëm perëndimore, por edhe të Evropës Lindore dhe për të parë se ç'është ajo që na çon drejt demokratizimit. Ne faktikisht pamë tek ata, sidomos ata nga perëndimi, se ata bien dakord brenda disa orësh dhe pastaj veprojnë! Neve na dukej se ishim në njëfarë autostrade të demokratizimit, dhe në të njëjtën kohë filluan këto debate nacionaliste. Pra, edhe akademia, edhe Akademia Serbe... Unë isha shumë e vetëdijshme se një ushtri që është aq e madhe sa ajo e Jugosllavisë, dhe që ka aq shumë armë, lehtë mund ta vendosë veten në një pozitë për t'i përdorur diku. Përndryshe, pse aq armatim? Dhe ajo kornizë interpretuese socialiste "Partia Komuniste", sidomos ajo pjesë brenda Armatës Popullore Jugosllave kishte horizonte shumë të ngushta, dhe frikë shumë të madhe. Dhe aty mundësia e transformimit ishte shumë e vogël. Dhe nuk do të them se transformimi nuk ishte i mundur, mendoj se ishte i mundur, prandaj, nuk mendoj se shpërbërja e dhunshme e Jugosllavisë ishte e pashmangshme. Me shumë mbështetje nga jashtë, ndoshta mund të ishte negociuar diçka tjetër. Ndoshta. Nuk do të them se me siguri mund të kishte qenë ndryshe, sepse ajo mbështetje ishte e paimagjinueshme. Pse dikush nga jashtë do të shqetësohej aq shumë për transformimin tonë të suksesshëm, përderisa kërkesa e brendshme për pavarësinë e republikave ishte aq e fortë? Pra, kishte pak gjasa, por ajo nuk ndodhi, sepse është e lehtë të kapësh armë kur qëndrimet janë kaq të kundërta. Dhe më shumë se 130.000 njerëz u vranë. Ky është çmim tejet i lartë.

Lëvizjet politike artikulohen përmes ideologjive, nacionalizmi është gjithmonë i shfrytëzueshëm, është i lehtë për t'u kuptuar, i lehtë për t'u shpjeguar përmes koncepteve pozitive, dashurisë për atdheun, dashurisë për mëmëdhenë, dhe unë do të thosha se konflikti, e ne e harrojmë këtë shpesh, se konflikti është shumë i rëndësishëm në jetën njerëzore. Dhe e bën atë shumë interesante. Por në një kontekst shoqëror, në një konflikt ku anëtarët e një grupi fetar përplasen, pastaj një grup tjetër fetar, pastaj një etni, një etni tjetër, një komb, një komb tjetër, pasojat mund të jenë fatale. Dhe do të thosha se gjatë periudhës së socializmit jugosllav, nuk u kultivua një brez politik për të pasur aftësinë për ta paraqitur një proces kompleks tranzicioni. Dhe do të thosha se ka gabime të mëdha që lidhen me lëvizjet pas vitit 1968. Në Kroaci kjo ishte në vitin 1971, në Serbi ishte liberalizmi, domethënë mundësitë në të cilat mund të krijohej hapësirë për politikanët që do të ishin në gjendje ta realizonin një proces kaq kompleks transformimi. Vlerësimi i Titos ishte se ai duhej t'i hiqte qafe ato luanesha dhe luanë të rinj dhe ai thjesht i mënjanoi këta politikanë më të aftë, e unë di më shumë për Sllovenинë, Kroacinë dhe Serbinë dhe më pak për Kosovën. Ata ishin të gjithë në një pistë politike anësore dhe nuk ishin më në gjendje të vepronin. E tash, ata vendosën të bënin atë që bënë: Latinka Perović në Serbi vendosi të merrej me histori dhe të shkruante libra shumë të rëndësishëm. Dhe në hapësirën politike nuk kishte njerëz që do të kishin aftësinë t'i zhvillonin gjërat me marrëveshje, me dialog. Dhe çështjet që u shtruan në tryezë pas vdekjes së Titos ishin serioze dhe të rëndësishme, ato duhej të diskutoheshin. Dhe ajo që po ndodhte, unë e di shumë mirë se çka po ndodhte mes të rinjve, sepse kam marrë pjesë aktive në atë proces, dhe e di që komunikimi u ndal në nivelin e atyre që funksiononin brenda rinisë socialiste. Si ishin iniciativat nga Sllovenia dhe Kroacia, të cilat u kanalizuan përmes strukturës ekzistuese, e cila ishte një transmetim i Partisë Komuniste, por pranoi disa iniciativa të reja. Si u

përfshinë këto iniciativa në një farë mase në Sllloveni dhe Kroaci, dhe jo në Serbi dhe republika të tjera, dhe si u prish komunikimi. Pra, komunikimi i cili u prish në Kongresin Komunist në Beograd, në Sava Centar, u prish shumë kohë më parë mes të rinjve dhe nuk kishte më komunikim. Dhe të gjitha këto kanale u varrosën në të vërtetë nga ata që qëndronin në pozitat e interpretimit ortodoks të socializmit jugosllav, duke menduar se ata e zotëronin atë interpretim, dhe ajo që do t'u thosha njerëzve në rajonin tonë, në vendet post-jugosllave, në shoqëri, nuk është e panjohur. Dhe ky është një nga problemet me të cilin ne ende jetojmë, dhe në fakt është ai grup që së pari tha: "Ne jemi socialistë të vërtetë, ne jemi për Titon, për trashëgiminë e Titos (...)", gjë që mund të shihet edhe sot kur i shikoni videot, me aterime të hatashme për ditëlindjen e Titos, për Ditën e Rinisë në Beograd. Fakti që shtafeta u bart edhe shumë vite pas vdekjes së Titos është absolutisht magjepsës. Por ata që ishin interpretues ortodoksë të trashëgimisë së Titos ishin në të vërtetë shkurtabiqë politikë që sapo kishin hyrë në paradigmën nacionaliste dhe më pas shqyen gjithçka që u doli para. Bosnja dhe Hercegovina praktikisht u shkatërrua sepse ata më mirë nuk dinin. Sot, kur dikush shtron njëfarë këndvështrimi të përgjegjësisë për shpërbërjen e Jugosllavisë gjatë kohës së luftës, sigurisht që Slobodan Milosević bart një pjesë të madhe të përgjegjësisë. Dhe sigurisht, një përgjegjësi më e vogël, por patjetër e identifikueshme bie mbi Franjo Tudjmanin, i cili e udhëhoqi Kroacinë. Sllobo filloi më herët, Tudjmani filloi më vonë, por kjo nuk e justifikon atë. Por pastaj, pati edhe politikanë cilësorë. Milan Kučan, Sllovenia në atë moment, jo vetëm në atë moment, por edhe në fund të viteve tetëdhjetë, kur filloi transformimi, kishte negociatorë të mirë si Kučani.

Jo vetëm ai, por edhe njerëzit përreth tij. Dhe gjërat, natyrisht, me pak fat... Sepse përbërja kombëtare e Sllovenisë ishte dukshëm ndryshe, përbërja kombëtare e Kroacisë thjesht kërkonte gatishmëri negociuese shtesë. Pra, duhet ta kishim pasur një Kučan në katror, dhe nuk e kishim as në përqindje. Kështu, pra, ishin gjërat. Dhe politikanët që i udhëhoqën vendet në atë situatë ishin në përqindje të ndryshme. Ne ende jetojmë në shoqëritë që, në pjesën më të madhe, janë vërtet të gatshme për një demokraci pluraliste.

Dhe do të thosha edhe për vitet e '80-a, për të përfunduar, për t 'i rrumbullakuar, se shpresat e iniciativave qytetare në atë kohë dhe në gjithë Jugosllavinë ishin të mëdha. Ne vërtet shpresonim se po shkonim në drejtimin e duhur, se po krijohej një hapësirë e shtuar e lirisë, se ajo që po bënim në të vërtetë po krijonte mundësinë e veprimit në kuptimin politik, përmes një demokracie shumëpartiake, se po krijonim një hapësirë të lirisë së mediave në të cilën kishte gjithnjë e më pak mundësi për censurë, se po ndërtonim një hapësirë veprimi qytetar për tema të caktuara përmes veprimeve, se po ndërtohej një infrastrukturë mbështetjeje për viktimat e dhunës për t'u dhënë fund luftërave. Dhe se optimizmi që patëm në fund të viteve 1980 është diçka që nuk ka aspak ngjashmëri me situatën aktuale. Pra, është koha e viteve të tetëdhjeta, megjithëse ka pasur shqetësime dhe represione, ishte kjo kohë e pritjeve të mëdha. E vitet e nëntëdhjeta dolën të ishin shumë të zeza, por do të thosha se gjatë asaj kohe mësova me të vërtetë gjënë më të rëndësishme. Nëse doni ndryshim, filloni nga vetja, filloni nga ata që i keni më të afërt, nga familja juaj, miqtë tuaj, të njohurit tuaj dhe filloni t'i lansoni disa iniciativa me ta. Le ta marrim iniciativën për kundërshtimin e ndërgjegjshëm, me të cilën së pari filluan miqtë tanë nga Sllovenia, dhe pastaj ne e morëm përsipër dhe e hapëm këtë diskutim në Kroaci, dhe shkuam në gjyqet e kundërshtarëve të ndërgjegjshëm, dhe shpërndamë afishe në rrugë, dhe biseduam me shumë njerëz se çfarë do të ishte shërbimi civil, se ai duhet të jetë plotësisht jashtë Armatës Popullore

Jugosllave. Megjithatë, imazhi se ushtria duhet të jetë aty, thjesht, është ngulitur aq fort në kokat e tyre, sa nuk mund ta lënë pas dore ushtrinë, nuk mund të bëjnë, pra, veprime që do të ishin për të mirën tonë të përbashkët, të cilat do të synonin përmirësimin e të gjithëve, se ky shërbim duhet të ketë lidhje me ushtrinë. Jo, nuk ka pse të ketë lidhje me ushtrinë. Ky çlirim nga ushtria, që të paktën në këto qarqe të vogla ka ndodhur para viteve nëntëdhjetë, ka qenë shumë i rëndësishëm për ne. Ishte shumë i rëndësishëm për ne për të gjitha veprimet më pas, edhe kur u mbajt referendumi në Kroaci, edhe kur u hap debati për Kushtetutën e Republikës së Kroacisë, ne mund të dërgonim një letër të shkurtër me një propozim dhe të thoshim: “Kundërshtimi i ndërgjegjshëm duhet të përfshihet në Kushtetutën Kroate.” Dhe kishte mjaft mirëkuptim, edhe në HDZ, parti ekskluzivisht nacionaliste, për ta përfshirë atë, dhe pastaj ne i qëndruam pas gjatë gjithë viteve 1990. Por ai propozim u pjek gjatë viteve 1980.

Unë isha në Zagreb dhe në fakt u angazhova intensivisht në mbrojtjen e mjedisit. Shkrova disa artikuj mbi situatën e mbrojtjes së natyrës, parqeve kombëtare, mbrojtjes së mjedisit. Kjo është koha kur lansuam Aksionin e Gjelbër "Zagreb", i cili funksionon edhe sot e kësaj dite, do të thosha, si organizata më e madhe e gjelbër në Kroaci. Lansuam edhe Aleancën e të Gjelbërve të Kroacisë, dhe ajo verë ishte në fakt fillimi, për disa, do të thoshim, fillimi i luftës, dhe bllokimi i rrugëve me drurë rreth Kninit, dhe që nga ai moment, trafiku mes veriut dhe jugut të Kroacisë u ndërpre fizikisht dhe ishte e qartë për të gjithë se lufta po afrohej. Do të thosha se për shkak të marrëdhënieve me Armatën Popullore Jugosllave, ishte e qartë për ne në Svarun se mund të kishte luftë, por ne ishim një grup shumë i vogël. Në fakt, megjithëse ishim të shqetësuar, nuk dinim saktësisht se çka të bënim. Nga këndvështrimi i sotëm, njëfarë fantazie e jona ishte se me siguri ka njerëz që janë të kualifikuar dhe që negociojnë. Pra, ishte e qartë se qëndrimet brenda Kroacisë ishin të ndryshme, se qëndrimet mes përfaqësuesve në Parlament, përfaqësuesve të kroatëve nga pjesë të ndryshme të Kroacisë dhe përfaqësuesve të serbëve, ndryshonin. Ato muajt e verës së vitit 1990 kanë qenë sigurisht kohë e mirë për negociata, për dialog. Megjithatë, rezultoi se në të vërtetë nuk kishte negociata serioze, dhe ne me vonesë e nisëm Fushatën Kundër Luftës në verën e vitit 1991. Dhe më kujtohet se në atë kohë kishim idenë se sigurisht në disa konflikte, siç është konflikti në Qipro, nëse flasim për Evropën, dhe përndryshe në të gjithë botën, shumë njerëz punojnë me shkathtësi për të rënë dakord për disa gjëra politike para se të shpërthejë ndonjë konflikt i armatosur dhe luftë.

Fillimisht ramë dakord për një Kartë, mbi bazën e punës sonë, dhe u nisëm nga supozimi i thjeshtë se njerëzit në këto zona do të duhej të binin dakord, qoftë tash ose kur të mbaronte lufta, dhe ne thjesht zgjodhëm mospërdorimin e dhunës, për ndonjë kohë tjetër. Dhe në fakt e shpërndamë atë Karta në Kroaci në rrugë, dhe ishim në kontakt me miqtë nga Qendra për Veprim Kundër Luftës, nga Serbia, nga Beogradi. Madje kemi publikuar edhe disa nga tekstet e tyre sepse, përveç përpjekjeve për të tërheqë sa më shumë njerëz për të nënshkruar atë lloj Karte, ne kishim plane se çka do të bënim dhe si do t''ia bënim. Ne e kishim të qartë se një gjë shumë e rëndësishme ishte mbështetja e kundërshtarëve të ndërgjegjshëm për të gjithë ata që nuk mundnin ose nuk donin të mbajnë armë, ne e kuptuam se mbrojtja e drejtpërdrejtë e të drejtave të njeriut do të ishte shumë e rëndësishme, sepse krimet tashmë kishin filluar.

Ne filluam, dhe më pas njerëzit tanë në Rijekë, në Poreč, në Karlovac filluan paralelisht në disa vende... Kishim dëgjuar për disa iniciativa, për disa të tjera dëgjuam shumë vite më vonë, por ajo ishte një kohë kur kishte shumë iniciativa nga poshtë, shumë iniciativa kundër luftës nga poshtë, veçanërisht në zonat ku jetonin shumë popullsi të etnive të ndryshme, si në Pakrac, Lipik. Ne nuk ishim në dijeni për këto iniciativa. Požega. Katarina dhe Kruno nga Osijeku na kontaktuan, dhe ata në të vërtetë dëgjuan për Fushatën Kundër Luftës nga disa artikuj në të përjavshmen Danas. Diçka u botua në Vjesnik, diçka u botua në të përjavshmen Danas, dhe ishte e rëndësishme për ne që të lidheshim me ata që gjithashtu kërkonin kontribut potencial jo të dhunshëm. Sepse armatosja po lëvizte shpejt dhe ne thjesht nuk ishim në favor të kësaj. Pra, ne nuk e perceptonim luftën e armatosur si diçka tonën, dhe meqenëse kishim planifikimin tonë në gusht 1991, politika zyrtare kroate po e përdorte edhe atë gjuhë, siç do të thoshte Franjo Tudjman, të "paqebërjes". Pra, nuk ishte ende e qartë se çka

do të ndodhte, nuk ishte ende e qartë se cilën anë do ta mbante Armata Jugosllave, e cila shpejt mori anën serbe. Pra, në atë kohë, ne mblodhëm disa qindra nënshkrime për Kartën e Fushatës Kundër Luftës, jo vetëm në Kroaci, por edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, Serbi, Gjermani, Itali, kishte shumë njerëz që ishin të interesuar për mospërdorimin e dhunës, dhe ne gjithashtu u angazhuam në mënyrë strategjike për të mësuar rreth zgjidhjes së konflikteve. Këtë e bëmë në gusht të vitit 1991. Ne vendosëm, dhe megjithatë nuk e kishim idenë se si të vepronim në konflikt dhe si të mësonim për konfliktin, dhe meqenëse ishim në kontakt me War Resisters International, shoku ynë Marko Hren nga Lubjana, nga Lëvizja për Kulturë, Paqe dhe Kundër Dhunës, kishte kontakt me War Resisters International, ne u dërguam një faks, pastaj fakset u dërguan te njerëz nga Bund fur Soziale Verteidingung, gjegjësisht Aleancën për Rezistencë Sociale, nga Gjermania, dhe u kërkoi atyre të vinin dhe të na bënin një lloj seminari hyrës për zgjidhjen e konflikteve opa dhunë. E ata u përgjigjën me një faks të gjatë ku renditën rreth njëzet tema me pyetjen: çka na intereson vërtet dhe çka duam saktë. Ne i lexuam këto tema, absolutisht nuk pamë ndonjë dallim mes ndërmjetësimit, komunikimit jo të dhunshëm, dhe përgjigja jonë e mençur ishte se ne ishim të interesuar për gjithçka, na duheshin të gjitha, dhe brenda pak ditësh, megjithëse ishin të shpejtë, Christine Schweitzer dhe Konrad Tempel u shfaqën në Zagreb dhe mbajtën seminarin e parë për ne. Nga ai seminar, kuptuam se kishte shumë të ngjarë që aleatët tanë të parë të ishin mësues të shkollave fillore dhe të mesme, sepse atë vjeshtë klasat ishin të mbushura me fëmijë të dëbuar nga pjesë të tjera të Kroacisë dhe mësuesit vërtet po përballeshin me një situatë të re. Ata kishin situata krejtësisht të reja në Kroaci.

Ne ishim në të njëjtat shkolla, të gjithë mësonim në të njëjtat ndërtesa, me të njëjtën kurrikulë, kishim Institutin e Arsimit që merrej me përgatitjen didaktike dhe mbështetjen e mësuesve në mësimdhënie, dhe në të vërtetë shumë shpejt filluam të organizojmë seminare të Zgjidhjes së Konflikteve Pa Dhunë për mësuesit, për të cilat një numër vërtet i madh i profesorëve treguan interes.

Dhe atë shtator, atë shtator, doli numri i parë i Arkzinit. Ne e dinim se nuk do të na përcillnin mediat kryesore, dhe se duhet të kishim buletinin tonë, dhe më pas Akrzini filloi të dilte periodikisht. Në një moment, iu dha mundësia për t'u shitur nëpër kioskë. Kjo ishte e rëndësishme për ne. Pra, në fakt seria e seminareve dhe Arkzini filluan paralelisht, por me përhapjen e luftës, sidomos në kohën e rënies së Vukovarit, numri i atyre që ishin ende gati të thoshin: "E shoh veten në Fushatën Kundër Luftës" ra nën 20. Pra, ishim një grup shumë i vogël që punonim nga një zyrë e vogël e Aksionit të Gjelbër. Dhe Aksioni i Gjelbër në të vërtetë na nervozonte gjithnjë e më shumë, sepse me intensifikimin e zënkës, ndjenja e shqetësimit mes nesh u shtua. Dhe ishte kjo kohë e përçarjes familjare, e përçarjes mes miqsh. Një numër shokësh të mi ishin në fushëbetejë.

Se ne propagandojmë kundër dhunës – shumica e njerëzve nuk mund ta bënin lidhjen me mbrojtjen dhe me luftën e armatosur, dhe shumë njerëz na panë si tradhtarë. Dhe këtu edhe martesat u prishën, edhe miqësitë u prishën, dhe mbetëm shumë pak prej nesh. Në Aksionin e Gjelbër na thanë të kërkojmë një hapësirë tjetër sepse nuk kishte hapësirë të mjaftueshme për ne atje, dhe kështu u zhvendosëm në një hapësirë të re, nga Aksioni i Gjelbër, nga Radnička, në Gajeva 45, në Zagreb. Pastaj patëm një situatë shumë të pakëndshme në Gajeva, sepse vullnetarët ishin në hyrjen ngjitur me ne, dhe u pengonim. Dhe kështu, përpiqeshin të na demotivonin në Fushatën Kundër

Luftës. Diku rreth natës së Vitit të Ri 1991, u zhvendosëm në Gajeva 45, dhe gjatë vitit 1992 shkuam në Tkalčićeva, ku qëndruam në një apartament privat në katin e parë për disa vjet. Dhe këtu filluan iniciativa të shumta, si puna me refugjatët përmes Suncokret-it, si dhe organizimi i jetës së fëmijëve në kampet e refugjatëve. Nga aty filloi Qendra për Gratë Viktima të Luftës, në mbështetje të grave të mbijetuara të përdhunimit, dhunës seksuale, si në Kroaci ashtu edhe në luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë. Projekti vullnetar "Pakrac" filloi nga Tkalčićeva, ku vullnetarët ndërkombëtarë ndihmuan në rindërtimin social në Pakrac. Mirjana Bilopavlović më vonë u përfshi pak në Klubin e Grave "Pakrac". Këtu vepronte edhe Qendra për Mbrojtje Direkte, dhe këtu filloi Amnesty International për Kroacinë, këtu vepronte edhe Lëvizja Anarkiste e Zagrebit, domethënë ishim ne, uleshim në kokat e njëri-tjetrit, pra ishim shumë. Dhe ishte shumë e lodhshme kur e përgatisnim Akrzinin për shtyp, të gjithë gazetarët pinin duhan dhe punonin gjithë natën, pra ishte një situatë me aktivitete shumë intensive. Këtu filloi edhe Zamir, sistemi i tabelave të buletinit, i cili është pararendësi i internetit, në të cilin Zamiri ishte vetëm një pjesë e rrjetit transnacional. Zamir funksionoi në Lubjanë, Tuzla dhe më vonë në Sarajevë. Në fakt, Zamir mundësoi transmetimin e një numri të madh mesazhesh elektronike, sepse njerëzit në Sarajevë nuk mund t'i shfrytëzonin shumë lidhjet satelitore. Komunikimi ishte problem i madh në atë kohë. Pra, në rrjetin Zamir një nga rrjetet më aktive ishte Yugo Antiwar, në të cilin lidheshim dhe diskutonim me miqtë tanë në anën tjetër të luftës, si në Serbi ashtu edhe në Bosnjë dhe Hercegovinë, dhe ishte shumë interesante se si kishim pozicione të ndryshme, sepse në Kroaci realiteti se vera e vitit '91 ishte në të vërtetë bombardimi dhe domosdoshmëria e të kuptuarit se mbrojtja e armatosur është e nevojshme, por ne po e zgjedhim rrugën pa dhunë.

Pra, po bëjmë diçka që është komplementare dhe nuk po e vëmë në dyshim zgjedhjen e atyre që luftuan me armë në dorë. Pra, kur iu bashkova Fushatës Kundër Luftës, u përfshiva kryesisht në iniciativa mjedisore, dhe mendova se do të merresha me të gjatë pjesës tjetër të jetës sime. Dhe meqë mësuam diçka për organizimin në gjysmën e dytë të viteve '80 ajo që ishte e nevojshme në atë kohë ishte që disi të organizonim aksionin paqësor, dhe ne e bëmë këtë. E bëmë vetëm në Zagreb, në Osijek filloi Qendra për Paqe, miqtë tanë punuan në Karlovac, kështu që bashkëpunimi ynë për kundërshtimin e ndërgjegjshëm u intensifikua shumë, megjithëse kundërshtimi i ndërgjegjshëm u bë e drejtë e garantuar me kushtetutë, me miratimin e kushtetutës së 22 dhjetorit 1990. Megjithatë, nuk kishte udhëzime specifike se si të ushtrohet ky kundërshtim i ndërgjegjshëm, si të zbatohet kjo e drejtë, si të ushtrohet ajo. Për shembull, ishte shumë më e vështirë për ata që jetonin jashtë Zagrebit. Ratko Dujčinović ishte nga Karlovaci, i cili u mobilizua, dhe më vonë, më duket, ai kishte një rast gjyqësor sepse nuk donte të mbante armë, dhe e dërguan në vijën e frontit. Është fat që mbijetoi, por disi ne arritëm ta bëjmë rastin e tij të dukshëm përmes punës së disa iniciativave qytetare, dhe së shpejti filluan të na vinin gra që u dëbuan nga apartamentet e tyre që dikur ishin në pronësi të Armatës Popullore Jugosllave dhe u morën nga Ministria e Mbrojtjes. Për një kohë, as nuk mund të kuptonim se çka po ndodhte. Kur dikush vinte me vendim se duhej të largohej nga banesa, krejt çka mund të bënim është të rrinim me atë person në banesë dhe të përpiqeshim ta shtynim dëbimin sa më shumë që të ishte e mundur. Ishte kjo një betejë e madhe, veçanërisht në qytetet në Kroaci, ku kishte shumë anëtarë të APJ-së para luftës, dhe ata kishin shumë banesa. Së pari, nga banesat e tyre u dëbuan gratë me fëmijë. Sepse ishte më e thjeshtë. Për rastet e para morëm vesh kur ato tashmë ishin dëbuar. Në atë pikë, ne nuk mund të bënim asgjë më shumë, përveç se t'i këshillonim të raportonin në polici

gjithsesi, pra t'i shfrytëzonin deri në fund mundësitë e parashikuara me ligj. Më vonë filluan të arrinin vendimet për dëbimet, dhe më pas u përpoqëm t'i parandalonim dëbimet, dhe duke qëndruar me ta në ditët kur pritej dëbimi. Kishte shumë probleme me marrjen e shtetësisë, pasi në Slloveni më shumë se 25000 njerëz u fshinë në fillim të vitit 1992, dhe diçka e ngjashme ndodhi edhe në Kroaci dhe vende të tjera, republika të atëhershme, ose tashmë vende post-jugosllave, sepse kështu ishte politika e të gjitha autoriteteve. Pra, u bënë përpjekje që nënshtetësia të merrej vetëm në një vend, vetëm në shtetin e sapokrijuar. Dhe autoritetet në vende të ndryshme bënë gjithçka për t'i drejtuar njerëzit drejt kërkimit të shtetësisë së vetëm një vendi.

Ai u largua nga ushtria, nuk ligjëroi më në akademi dhe ishte i papunë. Dhe kjo ishte kohë shumë e vështirë për të. Sepse e humbi identitetin. Kjo i zgjati disa muaj, por më pak se një vit. Meqë nëna e tij ishte ende gjallë në atë kohë dhe gjyshja ime jetonte në Skopice, ai shpesh shkonte tek ajo në Slloveni dhe i ndihmonte me gjëra të ndryshme. Dhe kështu, në Brežice, ai takoi rastësisht kolegun e tij, i cili e pyeti "Eh, si je, si shkojnë punët, etj." Dhe ai i tha se ishte shumë e vështirë, se ishte i papunë, se nuk mund të gjente punë, sepse ata që ishin larguar nga Armata Popullore e Jugosllavisë pritej t'i bashkoheshin ushtrisë kroate. E ai nuk donte. Nuk donte, dhe kolegu i tij i tha: "Epo, së shpejti do të na duhet dikush që të ligjërojë shkencat kompjuterike." Babai im ishte profesor i elektronikës, dhe s'e kishte shumë problem, por natyrisht, i duhej pak përgatitje. Kështu, e punësuan në shkollë të mesme, dhe e zgjidhi problemin. Kishte vërtet fat. Nëna ishte tashmë në pension dhe shkonte kohë pas kohe në Zagreb. I kalonte një ose dy, tre javë, ndoshta një muaj, në Zagreb, dhe pjesën tjetër në Lubjanë. Gjithmonë e kalonte të paktën një ose dy javë në Lubjanë. Kjo ishte shumë e rëndësishme për të. Pra, ajo facto jetoi mes Zagrebit dhe Lubjanës.

Dhe në atë kohë, unë nuk diskutoja për punën time me babain. Ai nuk kishte shumë mundësi të mos pajtohej. Prindërit e mi dinin diçka, por jo, nuk dinin gjithçka. Një nga gjërat problematike ishte se ndonjëherë njerëzit telefononin në shtëpi, sepse numri i tyre ishte në librin e telefonit, dhe kështu gjërat u bënë më të dukshme, sepse në të vërtetë ajo që po bënte Fushata Kundër Luftës nga viti 1991, deri në fund të viteve '90 po bëhej më e dukshme. Kështu u shtuan edhe problemet edhe ngacmimet. Megjithëse nuk jetoja me babain dhe nënën, ai numër ishte në librin e telefonit, dhe njerëzit telefononin dhe ofendonin. Dhe ata nuk përgjigjeshin në telefon. Dhe kjo ishte pjesa e shëmtuar. Në fakt, nuk ishte e lehtë. Ndërsa filluan të vinin disa njohje ndërkombëtare, në vitin 1997, së bashku me Vesna Pesićin dhe Selim Bešlagićin, u nominuam për Çmimin Nobel për Paqe, të cilin gjithsesi nuk e morëm, dhe më pas kjo punë u bë e dukshme në mediat e mëdha. Dhe ato thirrje pastaj u bënë më intensive.

Gjatë viteve të para, ka pasur një aktivitet intensiv komunikimi dhe dokumentimi, dhe sa i përket dokumentimit, do të thosha se nuk ishim aspak të mirë. Aty, në fakt, më e mira ndër aktivet, brenda dhe rreth Fushatës Kundër Luftës, ishte Qendra për Paqe nga Osijeku. Ata ishin të parët që filluan të publikojnë raporte. Ne të tjerët ishim shumë më të angazhuar në aktivitetet tona të përditshme. Dhe pavarësisht se sa e kotë mund të duket, Qendra për Paqe ishte e para që prodhoi raportin dhe këto raporte janë ende në dispozicion, besoj, në faqen e tyre, pasi ata u themeluan në vitin 1992, mendoj se janë ende në dispozicion. Ata filluan t'i dërgojnë këto raporte në Komisionin Parlamentar për të Drejtat e Njeriut. Më kujtohet takimi që Katarina dhe unë patëm me kryetarin e Komisionit Parlamentar, që ishte i tmerrshëm! Sepse ai vazhdonte të na tregonte se si sistemi ligjor kroat e kishte zgjidhur garantimin e të drejtave të njeriut, ndërsa

gjithçka po shkatërrohej. Pra, lufta po vazhdonte dhe të gjitha shkeljet e mundshme, siç ishin dëbimet, ishin në vlugun e tyre. E ata bëheshin sikur nuk po ndodhte asgjë. Do të thosha gjithashtu se kolegët tanë nga organizatat ndërkombëtare, si Human Rights Watch dhe Amnesty punuan më shumë rreth dokumentimit në atë kohë. Ne kishim disa informata, por ato duhej të sistemoheshin.

Bashkëpunimi është fjalë e madhe për të Drejtat e Njeriut dhe Amnesty International. Pra, ato funksionojnë brenda procedurave të tyre, brenda organizatave të tyre. Kur ata e publikonin raportin, për ne ishte shumë e rëndësishme t'i përkthenim ato raporte. Ne, si Fushata Kundër Luftës, e përkthenim dhe e botonim raportin, që kjo informatë të ishte në dispozicion në Kroaci, që askush të mos mund të thoshte se kjo informatë nuk është në dispozicion.

Ne ishim ndër të parët që u mbështetëm nga të Gjelbrit nga Parlamenti Evropian me të cilët kemi qenë në kontakt për mbrojtjen e mjedisit, dhe më pas erdhi një grumbull iniciativash qytetare nga Gjermania, Italia. Ata mblidhnin fonde të vogla, dhe të Gjelbrit nga Parlamenti Evropian na e sollën kompjuterin tonë të parë. Dhe ky ishte kompjuter 'i nivelit më të lartë'. Pra, me të mund të bënim gjithçka, me të e përgatitëm Arkzinin. Pra, kishim makina me të cilat mund të bënim këtë e atë. Dhe shumë shpejt e patëm Zamirin, dhe kështu patëm edhe komunikim elektronik.

Unë isha gjithmonë në Zagreb, kjo nuk ndryshoi kurrë. Në kohën time të punës aktive në Fushatën Kundër Luftës, isha kryesisht në Zagreb. Udhëtova edhe nëpër botë, sepse bota na mundësonte të mblidhnim fonde. Pra, e kuptuam që në fillim se na duheshin para për atë që do të bënim. Do të thosha që në dy vitet e para arritëm të mbledhim shumë pak para. Pra, kishim një kompjuter së pari, pastaj të dytin, pastaj të tretin, ishte shumë e rëndësishme për ne që të prodhonim edhe tekste edhe Arkzinin, kështu që para Oluja-s, para Bljesak-ut, unë isha në Zagreb. Ditën që marshoi ushtria, një minutë pas orës 5 të mëngjesit, ra zilja e telefonit, më thirri miku im nga Karlovaci, Milan Medić, dhe më tha: "Ushtria u nis." Sepse dëgjuan, dëgjuan në Karlovac se po binin predha dhe se kishte filluar një operacion ushtarak. Shkuam për të parë situatën në terren. Ishte situatë e tmerrshme. Thjesht nuk kishte mbrojtje për civilët, dhe ndër-sa kalonim, fshatrat, shtëpitë po digjeshin, gjithçka ishte e shkatërruar, lopët, qentë endeshin përreth duke kërkuar ujë, ushqim...

Ishin këto situata të rrezikshme. Në Bosnjë, u futa mes zjarrit. Sigurisht se ishte e vështirë. Kur e kujtoj herën e parë që kaluam nëpër Bratunac, kur u nënshkrua Mar-rëveshja e Dejtonit; ne nuk punuam vetëm në Kroaci, por edhe në Bosnjë dhe Herce-govinë.

Në Potočari kishte mbetur vetëm një ndërtesë me ushtarë holandezë, në të cilën civilët nga Srebrenica u përpoqën të strehoheshin. Atje nuk kishte asgjë. Jo vetëm që nuk kishte asgjë. Ndaluam, pastaj u ndalëm për pak kohë pranë rrugës, më kujtohet saktë, mendova a do të jetë ndonjëherë e mundur të vendosim ndonjë gjë këtu – një lule, një qiri, një përmendore. Dukej shumë e pakapshme. Dhe sot në Srebrenicë, në Potočari ka një përmendore dhe një varrezë, e kam fjalën që e fituan nënat e Srebrenicës. Mund të mos kishte ndodhur asgjë aty. Aty mund të kishte mbetur një djerrinë, një lëndinë, pa përmendur asgjë. Dhe për këtë luftuan ato. Ato luftuan për një vend ku do të varrosnin eshtrat, dhe kjo mund të mos kishte ndodhur, megjithëse Bosnja dhe Hercegovina është shumë larg paqes. Pra, kanë kaluar më shumë se 30 vjet nga fillimi

i luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë dhe pajtimi nuk është as afër.

Do të thosha se në gjysmën e dytë të viteve '90 kemi punuar shumë në Bosnjë dhe Hercegovinë, madje jo si Fushatë Kundër Luftës, por në kuadër të Fushatës Kundër Luftës, kur nga projekti vullnetar "Pakrac" filloi Qendra për Studime të Paqes, e cila është aktive edhe sot. Qendra për Studime të Paqes organizoi seminare MIRamiDA, në të cilat mblodhëm njerëz të interesuar për ndërtimin e besimit, dhe këto seminare u organizuan në disa vende. Shumë nga ato u organizuan në Bosnjë dhe Hercegovinë, sepse kjo është koha në të cilën, për shkak të borxhit, për shkak të faktit se Lufta Myslimano-Kroate, Boshnjako-Kroate e vitit 1992, 1993, ishte jashtëzakonisht brutale, thjesht ndjemë se e kishim borxh të punojmë me kolegët nga Bosnja dhe Hercegovina. Sot ne jemi anëtare e Bashkimit Evropian, dhe është shumë e vështirë. Për shkak se Bashkimi Evropian nuk mbështet programe të ndërtimit të besimit nga të njëjtat burime brenda Bashkimit Evropian dhe jashtë Bashkimit Evropian. Kemi bashkëpunuar edhe me kolegët tanë në Serbi, bashkëpunimi nuk u ndërpre kurrë. Pra, në vitin 1991, udhëtova për në Beograd. Udhëtimet ishin shumë të vështira, por unë shkova nga një udhëtim ndërkombëtar në Beograd dhe mora pjesë në ndezjen e qirinjve për të gjitha viktimat e luftës. Në fakt ishim në kontakt me Qendrën për Veprim Kundër Luftës me Vesna Pesićin, ishim në kontakt me Nataša Kandićin, ishim në kontakt me Gratë në të Zeza. Ato lidhje nuk u prishën kurrë, se disa prej atyre lidhjeve i kishim që në kohën e Jugosllavisë. Disa i mbajtëm, disa i krijuam, në fakt, në fillim të luftës këto lidhje i ruanim vazhdimisht. Nuk mund të përgatitesh për luftë. Ushtria po përgatitej në mënyrën e vet të kufizuar. Por ne, civilët, ne jemi shumë të kufizuar. Pra, përvoja ime e luftës është se ne vetëmashtrohemi pa fund se edhe kur lufta zhvillohet praktikisht në rrugën matanë ne vazhdojmë të mendojmë se ajo nuk do të na kapë. Është shumë e vështirë të presësh diçka tjetër. Kjo është një nga arsyet pse dialogu parandalues nuk po përparon në botë. Në fakt, as disa masa të pasluftës që do të kontribonin në ndërtimin e besimit nuk po përparojnë. Fuqia e vetëmashtrimit është e madhe. Dhe në mënyrën se si ne e përqafojmë konfliktin, domethënë, si ne i fshijmë ata që mund të kenë qenë kolegët tanë ose fqinjët tanë deri dje, ne heqim dorë lehtë nga komunikimi. E këto janë probleme të mëdha. Një problem tjetër i madh pas përfundimit të luftërave të armatosura është se ne nuk e dimë me të vërtetë se çka do të bëjmë, dhe pritet shumë nga procedimet gjyqësore të krimeve të luftës, dhe kjo shpesh perceptohet si më e rëndësishmja. Procedurat gjyqësore, hetimet dhe veprimet parahetimore janë shumë komplekse. Mendoj, dhe ishte fat, meqë ishte luftë në Evropë, në vitin 1993, që u krijua Gjykata për Krime Lufte për ish-Jugosllavinë, e cila, do të thosha, u themelua relativisht herët. Megjithëse nuk arriti të kontribojë në ndalimin e krimeve të tmerrshme, siç është gjenocidi i Srebrenicës.

Vitet 2000: Documenta, REKOM dhe Ballafaqimi me të Kaluarën

Fushata Kundër Luftës kurrë nuk pushoi zyrtarisht së funksionuari. Kuvendin e fundit e kishim në vitin 2003 ose 2004, më duhet të shikoj, dhe vendosëm të mos e shpërbënim Fushatën Kundër Luftës. Në kuadër të Fushatës Kundër Luftës kishte më shumë se 20 organizata, shumë organizata janë ende aktive sot. Kur erdhi koha të mos përqendrohesha kryesisht në aktivitetin e paqes, disa nga këto organizata së bashku nisën Documenta-n ku jam edhe sot e kësaj dite, unë drejtoj Documenta-n. Dy organizata të paqes dhe dy organizata të të drejtave të njeriut e lansuan Documenta-n në vitin 2004. Sepse në atë kohë, në vitin 2000, ne si shoqëri, si votues, arritëm të zgjedhim dikë tjetër dhe jo HDZ-së, gjë që ishte përvojë çliruese për të gjithë ata që jetonin në Kroaci. Është shumë e shëndetshme në një demokraci që të mos qeverisë gjithmonë një parti, por dikush i ri. Dhe kjo solli një frymë të re dhe pak më shumë liri të mediave, kështu që pastaj mund të bënim disa gjëra të reja. Megjithatë, kjo është një kohë kur tashmë e kuptuam se një proces më i mirë, më intensiv, më i thellë i ballafaqimit shoqëror me të kaluarën do të jetë i nevojshëm. Dhe për tre vjet përgatitëm Documenta-n, për ta themeluar përfundimisht në vitin 2004, për të ruajtur materialin e mbledhur mbi krimet, por edhe për të ruajtur materialin mbi rezistencën. Hezituam për një kohë të gjatë sepse ka organizata në vende të tjera si, për shembull, Qendra për të Drejtën Humanitare, e cila merret vetëm me vitet e nëntëdhjeta. De facto, ne e mbulojmë shekullin XX, i cili është shumë i rëndësishëm për punën e Documenta-s. Në fakt, ne jemi angazhuar me vonesë në dokumentimin cilësor, në hulumtimin e humbjeve njerëzore.

Dhe mendoj se, për shembull, për të bërë kërkime mbi humbjet njerëzore është më mirë të mblidhen të dhëna siç bëri Qendra për të Drejtën Humanitare e udhëhequr nga Nataša Kandić. Ajo filloi të mbledhë të dhëna nga viti 1992. Dhe shumë shpejt pas kryerjes së krimit. Ata kanë një databazë me ato të dhëna. Edhe ne kemi disa prej atyre të dhënave. Për sa i përket gjykimeve të krimeve të luftës, ne i ndoqëm disa gjykime në vitet 1990. Por vetëm disa prej tyre. Që nga viti 2004 kemi filluar t'i ndjekim ato sistematikisht. Gjykimet janë burim serioz dokumentimi. Edhe nëse vendimi është shfajësues.

Vendet që janë ballafaquar me të kaluarën në botë janë shumë pak. Gjermania përmendet gjithmonë e para, por nuk do të doja të harroja Argjentinën, pra ka vende të tjera në kontinente të tjera që nuk janë keq në këtë fushë, ose Kili. Pra, ka disa vende që dinin ta bënin këtë, por ata nuk u mbështetën vetëm në procedurat gjyqësore. Në këtë proces, ata i kushtuan shumë vëmendje botimit, së pari Argjentina, e cila në vitin 1984 kishte Komisionin e saj të parë të së Vërtetës, dhe ai komision prodhoi raportin "Nunca mas", "Kurrë më", të cilin mund ta blini gjithmonë në Argjentinë.

Prandaj, në nivel rajonal, së bashku me Qendrën për të Drejtën Humanitare dhe Qendrën për Hulumtim dhe Dokumentim nga Sarajeva, partnerët tanë, partnerët e Documenta-s, këto 3 organizata: Documenta, Fondi për të Drejtën Humanitare dhe Qendra për Hulumtim dhe Dokumentim, filluam një iniciativë për REKOM, për Komisionin Rajonal, i cili si organ hulumtues do të përcaktonte fakte për krimet, për viktimat dhe do të jepte rekomandime se si të vazhdohet. Sepse të gjitha vendet post-jugosllave janë të ngarkuara me një interpretim nacionalist të së kaluarës dhe shikojnë –

veçanërisht në nivel zyrtar – nga një perspektivë shumë e ngushtë. Kjo nismë, për herë të parë kemi filluar të diskutojmë rreth saj në vitin 2005, dhe disi kemi filluar me konsultime, me konsultime në vitin 2006, kemi kaluar nëpër një proces shumë të gjerë konsultimi, në të cilin kanë dhënë mendimet e tyre më shumë se 5000 persona. Dhe vetë koalicioni për REKOM-in përbëhej nga më shumë se 2000 njerëz dhe organizata të shoqatave të viktimave, organizata rinore dhe organizata të grave, organizata të të drejtave të njeriut dhe disa veteranë dhe besimtarë. Kur u mblodhën nënshkrimet, u mblodhën më shumë se 500.000 nënshkrime, dhe në atë kohë presidentë të vendeve, si Presidenti i Kroacisë Ivo Josipović, Presidenti i Serbisë, Presidentja e Kosovës, Presidenti i Maqedonisë, e mbështetën nismën. Por nisma nuk mori kurrë mbështetjen e të gjithë Presidencës së Bosnjës dhe Hercegovinës, nuk mori mbështetjen e Sllovenisë dhe nuk mori mbështetjen e Qeverisë së Republikës së Kroacisë. Dhe një pjesë e atij vullneti politik, që ekzistonte gjatë presidencës së Josipovićit dhe Tadićit dhe presidentes Jahtjaga, nuk ekziston më. Do të thosha se nuk ka asnjë shans që kjo gatishmëri politike të shfaqet përsëri. Ne nuk kemi ndaluar së avokuari për REKOM dhe jam plotësisht e bindur se ky është propozimi më i mirë për një mekanizëm që do të ishte plotësues i gjykimeve. Nuk ka cilësi më të lartë të vërtetimit të fakteve sesa procedura gjyqësore. Ajo nuk është perfekte. Nuk do të them se gjykatat nuk gabojnë kurrë, por është procedurë e cila është zhvilluar mbi dy mijë vjet. Dhe meqenëse ne jemi të papërsosur si njerëz, edhe ajo është po aq e papërsosur sa ne. Dhe vënia në pikëpyetje e fakteve të caktuara të gjykatës do të duhej të ishte vërtet vrazhdësi, por nuk është. Nuk është në Kroaci, nuk është në Bosnjë e Hercegovinë, nuk është në Kosovë, sigurisht se nuk është në SHBA, nuk është në Bashkimin Evropian, dhe si qytetërim, në fakt kemi gjithnjë e më shumë probleme. Sepse shtrembërimi i fakteve – në vendin tonë i lidhur me vitet 1990 por edhe i lidhur me Luftën e Dytë Botërore, por edhe i lidhur me dhunën politike të socializmit jugosllav – është shumë, shumë i zakonshëm.

Komunikimi hapi disa dyer për të cilat kishim frikë se do të mbeteshin të mbyllura. Ndër konsultimet e para ishin ato me të rinjtë, pastaj me mediat, pastaj me artistët, pastaj me shoqatat e viktimave, sepse nëse të mbijetuarit nuk e pranojnë këtë ide, çfarë të ardhme mund të ketë ajo? Doli se kur i pyet njerëzit për mendimin e tyre, ata shprehin mendimin e vet, dhe se komunikimi ishte shumë i vlefshëm. Dhe transkriptet e atij procesi konsultativ janë në fakt vetvetiu, këto transkriptime janë një lloj monumenti. Dhe ato janë shumë të rëndësishme. Më duhet të them se shkuam të konsultohemi me veteranët me shumë frikë. Se kishim shumë frikë se çka do të ndodhte me grupe të ndryshme. Nuk ishte gjithmonë e lehtë. Por problemi më i madh është perspektiva etno-nacionaliste. Dhe ata që bëjnë politika, pra, ata që drejtojnë vende, në të vërtetë duan që një interpretim i ngushtë i historisë të jetë dominues në vendin e tyre, dhe ata nuk e duan atë pikëpamje anësore. Pra, ata nuk duan një pikëpamje që e shikon atë që ndodhi nga këndvështrime të ndryshme. Dhe kjo është pengesë.

Në gusht do të shënohet përvjetori i Oluja-s. Një pjesë e popullsisë së Kroacisë, do të thosha shumica, do ta shënojë si fitore. Eventualisht do të mendojnë shumë shkurt për ata që u vranë, e më shumë se 600 civilë u vranë. E të tjerët, nga Serbia, do të kenë një pikëpamje krejt tjetër, do t'i kujtojnë vetëm të vrarët dhe vetëm refugjatët. Dhe pyetja është se a është e mundur të lidhen fare këto dy pikëpamje. Unë do të thosha se më e mira që mund të shpresojmë është të marrim informata përmes një qasjeje shumëperspektivëshe që ka disa interpretime të ndryshme. Dhe për shembull, kur mësohet historia, nuk ka pse të jetë domosdoshmërisht histori, mund të jetë në letërsi,

në edukimin qytetar, në ndonjë lëndë tjetër. Kur flasim për historinë, të veçojmë disa fakte historike që janë ose të vërtetuara nga kërkimi shkencor, ose edhe të urdhëruara nga gjykata, por zgjedhja e fakteve është gjithashtu e ngjyrosur me një pikëpamje interpretuese. Të mos e injorojmë këtë. Edhe në nivelin faktik, tashmë po e shtojmë këtë ngjyrë interpretimi. Interpretimi, gjithsesi, është i pashmangshëm dhe sa më shumë që dimë për interpretimet e ndryshme të mundshme, aq më shumë i afrohemi ndërtimit të besimit.

Tash, faktikisht, pra, nëse i shikojmë faktet, nëse shohim se çka ka ndodhur në një vrasje, në një krim lufte, dhe nëse ajo përshkruhet, nëse ajo provohet në gjykatë, mund të themi: "Këto janë fakte të urdhëruara nga gjykata." Por sapo hyjmë në ritregim: "Çka i parapriu? Cili ishte shkaku?", ne futemi thellë në ujërat e interpretimit. Dhe këtu rrëfimi mund të ndryshojë në nuanca, dhe ndoshta këto dallime do të jenë shumë të mëdha. Pra, ne jemi vazhdimisht në kërkim të mënyrave për të tërhequr vëmendjen drejt momenteve më të vështira historike, sepse këto janë momentet kur ndodhin thyerje, kur trauma bëhet aq e pashmangshme sa njerëzit thjesht nuk mund ta injorojnë atë. Dhe shekulli XX në këtë rajon, pavarësisht se a flasim për Ballkanin, Evropën, Jugosllavinë, apo Istrinë, është aq i ngarkuar me këto kujtime të valëve të dhunës, saqë ne kërkojmë mënyrën për të folur për të sot, mënyrën që një lloj reflektimi mbi dhunën e së kaluarës të na ndihmojë të gjithëve t'i afrohemi më shumë mirëkuptimit, demokracisë, solidaritetit dhe tolerancës. Pra, si ta kthejmë një të kaluar të dhunshme në një burim për më shumë mirëkuptim.

Kjo është në fakt diçka që ne përpiqemi ta bëjmë në Documenta përmes shkëmbimeve rinore, përmes shëtitjeve përkujtimore. Pra, vazhdimisht po i shtojmë dhe po i digjitalizojmë informatat për vendet e ndryshme të vuajtjes dhe rezistencës që ato të shërbejmë vërtet si reflektim: "Si të vazhdojmë sot?" Unë do të thosha se shtrembërimi i fakteve për të kaluarën sot është problem në të gjitha nivelet, nga niveli individual në atë global, dhe ne e shohim atë kudo!

Së fundmi e kemi organizuar një takim të Rrjetit të Arkivave të të Drejtave të Njeriut. Kishim miq nga Argjentina, nga Izraeli, nga Shtetet e Bashkuara. Ishte një punëtori e vogël, ne jemi rrjet i vogël, pak i dukshëm, por ne po mësojmë nga njëri-tjetri dhe po kërkojmë mënyra për të mbrojtur më mirë dokumentacionin që e ruajmë, për ta bërë atë më të qasshëm dhe për të kontribuar tek autoritetet në vendet ku ne jetojmë për ta mbrojtur këtë dokumentacion, apo edhe për të investuar më tej në mënyrat e përfshirjes së një materiali të tillë në arsim. Jemi gjithmonë në kërkim të mënyrave të reja.

Kur e themeluam Documenta-n në vitin 2004, kishim parasysh se Documenta një ditë mund të bëhej institucion, që do të thotë se do të kishte një regjistrim sipas një ligji. Pastaj, faktikisht do të lidheshim me një lloj monitorimi të kësaj apo asaj ministrie, por mund të shpresonim për ndonjë financim në këtë apo atë tender që do të shpallej brenda Republikës së Kroacisë. Kështu rrallë marrim ndonjë mbështetje brenda Republikës së Kroacisë. Ndërkohë, nuk kam aspak shpresë se do të shoh gjatë jetës sime që Documenta apo ndonjë institucion i ngjashëm në Kroaci ta marrë këtë status. Sepse dëshira politike për të kontrolluar është aq e fortë sa që punën tonë do ta bënte vërtet të pakuptimtë. Pyetja është se a mund të themi se transferimi nga një brez në tjetrin tashmë është garantuar. Nuk mund të jemi të sigurtë. Pra, ne bëjmë shumë punë edukative, por larg asaj që duhet të bëjmë.

Ne si Bashkim Evropian nuk po përparojmë, por po zmbrapsemi. Brenda proceseve demokratike, regresi demokratik është fenomen normal. Edhe me këtë duhet të mësohemi. E kur do të vijë përsëri një kohë e përparimit demokratik, është e vështirë të thuhet. Në vende të ndryshme ajo kohë vjen në intervale të ndryshme, por në një nivel të caktuar ekziston një proces i përbashkët. Kjo nuk është kohë fort e lumtur për demokracinë, por kjo nuk i përjashton proceset në nivelin e arsimit, shkëmbimet individuale. Ajo që, për shembull, është tejet keq është se Kroacia nuk është pjesë e RYCO-s, dhe nuk ekziston mundësia e atij shkëmbimi rajonal për të rinjtë, megjithëse të rinjtë duan diçka të tillë.

Do të thosha se ajo që hap derën në kontekstin evropian, për sa i përket arsimit formal, është sigurisht edukimi mbi Holokaustin. Pra, ky është minimumi nga i cili nuk duhet hequr dorë. Dhe në rajonin tonë, në vendet post-jugosllave, sigurisht se do të duhej të kishte edukim për Holokaustin dhe gjenocidet e tjera, të cilat, përveç gjenocidit ndaj hebrenjve, do të mbulonin menjëherë edhe gjenocidin ndaj serbëve dhe romëve, që është një histori e përbashkët e të gjitha vendeve post-jugosllave.

Për shembull, rruga e shkatërrimit të trashëgimisë kulturore dhe fetare dhe restaurimi i trashëgimisë kulturore dhe fetare, rruga e njohjes së fatit të fëmijëve në luftë ka rezultuar produktive. Pra, ka rrugë që japin rezultate më të mira. Edhe pse e gjitha është e freskët, prapëseprapë nuk është aq e freskët. Kanë kaluar më shumë se 30 vjet që nga fillimi i luftës në Kroaci, që nga Lufta Atdhetare. Nuk kemi pse presim më. Dhe do të thosha se kur flasim për mënyrat për të përfshirë udhëtimet studimore që lidhen me vendet e vuajtjes dhe vendet e rezistencës në shekullin XX, duhet thjesht ta shikojmë të gjithë gamën dhe të mos i përfshijmë vetëm vitet e nëntëdhjeta, as vetëm Luftën e Dytë Botërore, por të përpiqemi ta mbulojmë të gjithë shekullin XX dhe të argumentojmë pse, le të themi, kjo zgjedhje lokacionesh do të ishte më e mirë, dhe t'i lokalizojmë të gjitha.

Unë jam në Documenta, unë ende e drejtoj Documenta-n, dhe tani jam në mandatin tim përfundimtar, i cili do të përfundojë në shtator 2026, dhe ne jemi organizatë në tranzicion. Besoj se kur të dal në pension në vitin 2027, dhe do të dal në pension, dua të vazhdoj të punoj në këtë fushë, me aktivitete përkujtimore dhe arsimore, por sigurisht jo për aq kohë sa po e bëj tani, dhe mendoj se është me të vërtetë koha për të pushuar së drejtuari organizatën në aspektin operacional.

Unë jetoj në Zagreb. Babai im është në Brežice, unë jetoj në Zagreb, dhe gjatë verës, shkoj ndonjëherë në Pula.

Thjesht do të doja të them se përmes angazhimit rreth temave që lidhen me të kaluarën, rreth temave të vështira, ne në fakt e bëjmë jetën tonë më të lehtë. Dhe se përmes kalimit dhe ndërgjegjësimit dhe reflektimeve mbi traumën, ne mësojmë të jetojmë më mirë. Dhe më duket se ka gjithnjë e më shumë njerëz që po hapen për të punuar me traumën e tyre, dhe kjo më bën optimiste. Hapi i parë është më i rëndësishmi. Dhe nëse mjaft njerëz e bëjnë hapin e parë, ndoshta kjo do të reflektojë mbi një komunitet më të gjerë dhe mbi shoqërinë në tërësi.

Ndërprerja me dhunë e një andrre

Një jetë e futur në një tregim, që sjell para nesh lumturinë fëmijërore të Norës, detaje nga historia familjare, dhembjet e rrugën e ndërtimit të personalitetit, edukimin dhe shkollimin. Një tregim që pikturon rritën e zhvillimin e një vajze me shpirt të lirë, me talent e me energji për punë, por edhe me guxim të madh.

Nora sot jeton thjesht me dijen dhe përvojën e vet, me punën e vet si konsulente e pavarur, në fushën ku ndjehet shumë okay, që ka t'bëj me të drejtat e njeriut dhe ballafaqimin me të kaluarën. Ka arritë të dalë jashtë kufijve të Kosovës dhe ta dëshmojë veten përkundër faktit që si kosovare e ka pasur shumë të vështirë të depërtojë.

Nora e ka fatin e tillë që gjithë jetën me u ballafaqu me sfida, por mu aty është më e fortë sepse ajo lufton me t'gjitha anët e forta të saj. Nuk dorëzohet dhe nuk ndalet. Gjithmonë mendon se përvoja duhet të shpërndahet, duhet t'u ndihmohet të tjerëve, t'u trasohet udha të tjerëve, që ata të kalojnë pak më lehtë se ajo. Ka arritur gjithçka me shumë mund, me punë, vetëmohim dhe me përkrahjen e prindërve. Pengesa ende ka, sikur që ka pasë gjithmonë. Po, sikur thotë ajo vetë, ajo është free, ajo është shpirt i lirë, ajo është mirë.

Nora Ahmetaj

Unë jom Nora Ahmetaj. Kam lindë me 6 shtator 1969 në Prishtinë. Jom fëmiu i parë në familje prej pesë fëmijëve sa jemi. Vajza e parë prej nënës Minire dhe babës Sylejman Ahmetaj. I kom edhe tri motra mbrapa meje edhe vëllaun.

Aktashi: Jehona e dashurisë

Kom lindë edhe jom rritë në Prishtinë. Kam banu në rrugën e Prizrenit. Si fëmijë, e maj në mend, që ka qenë Rruga e Sharrit, mandej një kohë të gjatë ka qenë Rruga e Prizrenit dhe tash së fundmi është Rruga Abdyl Frashëri. Gjithmonë e kom dashtë atë rrugë. Mendoj që është ndër lagjet më të mira në Prishtinë. Lagjja ka qenë multietnike. Tash normalisht jetojnë vetëm shqiptarë. Përndryshe, është rrugë e cila i përket një blloku që quhet Aktash, në mes të Qendrës dhe Bregut të Diellit. Një lagje shumë e mirë. Aty kom kujtime shumë të mira. Kemi kalu mirë edhe e kemi pasë një fëmijëri relativisht të lumtur deri sa s'kanë fillu turbulencat politike në vitet 80,. E di që edhe prindërit edhe fqinjët e tjerë kanë kalu shumë mirë. Bile edhe me fqinjët serbë që kanë qenë aty, kemi pasë shumë raporte të mira.

Kemi jetu në një shtëpi, e cila osht' ndërtu - e mbaj në mend babi thojke - kur kanë ardhë nga fshati Hogosht, komuna e Kamenicës, në vitin 1963. Kur kanë ardhë në Prishtinë thonte se krejt pjesa e Bregut të Diellit ka qenë fushë edhe sa herë është ndërtu diçka, jo vetëm te Salla e Sportit apo në lokacionin afër neve, po kudo që është ndërtu, thojke "O na kur kemi ardhë krejt fushë ka qenë e as ujë s'ka pasë, është dashtë s'di sa larg me shku me marrë ujë te ni bunar dikun". E maj në mend edhe kur ka qenë rruga e paasfaltume një kohë, por diku para moshës dhjetë vjeçare është asfaltu. Mandej tonë kohën kanë fillu ndërtime, ndërtime. Jom rritë me një shtëpi ku ka qenë edhe axha, vëllau i babit prej babës, Ibrahimi me tre fëmijë, dhe jemi rritë shumë mirë. Ata e kanë pasë hymjen tjetër, mirëpo ka qenë një shtëpi, e kemi pasë oborrin, bahqën...

Babin tim, prej kësaj pozite normalisht që e shoh si udhërrëfyes. Si fëmijë gjithmonë e kom pasë një lidhje shumë të veçantë me të. Bile kur u plak edhe pak para se me vdekë, edhe atij i kthehej kujtesa edhe gjithmonë ma përmendke një përvojë me m'tregu se sa babë i devotshëm ka qenë dhe sa më ka deshtë. Kur kam qenë fëmijë 2 vjeçar, nana në atë kohë ishte shtatzanë me motrën time të dytë, dhe unë sëmurem. Mjekët i thonë babit: duheni me dërgu vajzën jashtë Kosovës sepse dyshojmë që nuk ka veshka! Sipas tregimit të tij, nisemi me tren prej Prishtinës, prej Fushë Kosovës në Beograd, prej Beogradit deri në Zagreb. Edhe m'çon në "Institut za Majke i Djecu" sepse ai e ka kry shërbimin ushtarak në Zagreb. Edhe thotë, "Atje ke qëndru tri javë dhe normalisht diagnostifikohesh që e ke pasë fruthin dhe s'ki pasë kurgjo t'boj me veshka". Më tregonte shpesh se si në tren më ka majtë tonë kohën në krahë edhe thotë "Me një vend që ka qenë shumë ma i mbylltë, ma patriarkal, krejt udhëtarët në tren kqyrshin që një burrë pe mban fëminë qe sa orë në krahë". Dhuratat e babadimrit që i merrnim për Vitin e Ri, zakonisht i kemi marrë nga dy, sepse të dy prindërit punonin. Babi jurist, mami ekonomiste. Dhe natën e Vitit të Ri, kur flenim, në mëngjes zgjoheshim e në pandofle gjenim edhe nga një dhuratë tjetër. Babi ka qenë djali i

vetëm mes 5 vajzave dhe unë fëmiu i parë. Hallat kanë pasë fëmijët e tyre e një hallë ka qenë në Amerikë, kështu që e ki parasysh është djali i vetëm në familje edhe unë fëmija i parë e normalisht jom rritë me krejt dashninë e mundshme dhe ndoshta pak e privilegjuar.

Babi ka diplomu në gjeneratën e parë sapo është hapë Universiteti i Prishtinës. Mirëpo, në të njëjtën kohë, ka qenë edhe në marrëdhanje pune kur e ka regjistru fakulltetin. E ka përfundu në '74-tën. E di që e ka përfundu në afat dhe një kohë ka punu si stenograf në Fakultetin Juridik. Gjithmonë jemi rritë me fjalët dhe admirimin që ai e ka pasë për Profesor Gazmend Zajmin, sepse ai ka punu dhe ka qenë sekretar në Juridik dhe ka punu me të.

Me ne ka qene edhe gjyshja Xhemile. Ajo nuk ka ditë diplomaci edhe e ka thonë mendimin troç, nuk ka përdorë metafora. Ka folë turqisht, maqedonisht, edhe shqip. Shqip ka mësu me folë kur është martu. Me katër vjet shkollë, na thojke, "Mësoni guhët e huja, mos gaboni mos me i mësu, s'e dini sa ju hapin rrugë në jetë". Ka qenë jashtëzakonisht e pastër e pedante, edhe ka pregaditë shumë, shumë mirë ushqime. Kur e ka bo një punë, e ka bo kadal por perfekt. Na ka msu qysh me u ulë, qysh me folë. Na mësojke që kur të shkojmë diku dhe dalim prej asaj shpie, nuk guxojmë me përmend çka kemi pa edhe çka kemi dëgju në atë shpi. Na thojke 'nuk guxon me bajtë fjalë, nuk guxon me rrejtë, nuk guxon me vjedh. Nuk guxon me thonë 'Qyky njeri oshtë i varfun ose i pasun, sepse ti nuk e din pse njerëzit kanë dhe pse s'kanë". Ajo nuk ka jetu me ne, ajo ka jetu me djalin e vet poshtë. Ata kanë jetu në të njëjtën shtëpi veç ata tjetër kat dhe tjetër hymje.

Lagjja ka qenë e banume prej banorëve që kishin prejardhje ose nga Anamorava ose Gjakova. Kemi pasë, për shembull, profesor Esat Stavilecin, doktor Hysen Ukmatën dhe mami është shoqnu shumë me gratë e tyne. Normalisht, kjo lidhja me Gjakovë, ka qenë tezja Midije e Gjakovës, ka qenë vllau i Fehmi Aganit me të ndjerën, grunë e vet. Mami e ka majtë shumë muhabetin edhe lidhjen me këto kojshiket që kanë qenë të Gjakovës, por edhe më këto tjerat gjithashtu.

Si fëmijë, kena lujtë ndërmjet dy zjarreve në mahallë e në shkollë. Në sport jom konë shumë e mirë. Aty te Salla e Sportit kemi lujtë xhamias. Unë kom qenë shumë e vogël kur, për shembull, fëmijët e axhës ma të mëdhej se unë, kanë lujtë msheftas ose zhmurke me krejt fëmijët e mahallës, ku ka pasë serbë edhe shqiptarë bashkë. Sekuencat e atyne lojëve: rruga ka qenë me lloq, e pandërtume, edhe kanë qenë njo dy bullduzhera të prishtë, njoni i gjelbërt, njoni i verdhë, qaty ku osht' ndërtesa e OSBE-së tash, te kandi i rrugës. Dhe lujshim msheftas/zhmurke. Besa, Kujtimi, Afërdita, Naseri, Shpendi, Nikolla, Dushka, Olivera, Vesna, Neshka e kush tjetër u kone? Unë kom qenë dikun shtatë deri nantë vjeçare kur i maj në mend këto lojra. Unë hala e vogël kom qenë me m'shti n'lojë, por e kujtoj edhe qysh kanë folë shqip edhe serbisht krejt bashkë.

E mbaj ne mend teta Bellken që njeherit ka qenë mësuese e fëmijëve serbë në Vladimir Nazor, kur ka ardhë me pi kafe me nenen. Edhe gjyshen ose hallën që oshtë shoqnu me Dragicen, vajzën e teta Bellkes. Kur ka ardh Dragica me pi kafe edhe i kanë ndrru romanat. Jonë konë do romana si me thonë sot 50 cent, i blejshim në trafika. Hallat e mija i kanë lexu keto romane, edhe une ma vonë. Serbisht jonë konë romanat qe i qujshim ljubavni romana. Tash unë nuk e di thellësinë dhe sinqeritetin sa

kanë mujtë me bisedu për politikë në atë kohë, nuk e besoj që ka pasë shumë besim mes shqiptarëve e serbëve, por unë kom qenë fëmijë, nuk kam mujtë m'i ditë këto.

Mami ka punu në një ndërmarrje zhvillimore si ekonomiste, ka pasë shumë shoqe. E ka pasë Zoricën, edhe shumë të tjera shqiptare, turke që i përmenke dhe nuk është anku për dinamikën në atë organizatë. Po në atë 'periudhën e artë', kojshitë kanë shku për festa te njëri-tjetri dhe e kanë uru njoni-tjetrin. Gjyshja jeme edhe plot tjerë jonë përshëndetë, pirja e kafës ka qenë si ritual, ose kur ka vdekë apo o martu dikush, kanë shku e kanë ngushellu ose e kanë uru. Kjo ka ndodhë deri në '81-shin, kur fillojnë e ftohen marrëdhëniet.

Rrëfimi për babin, mamin dhe familjet e tyre

Babi ka lind në maj të vitit 1938, kështu që ka majt mend nëpër çka kanë kalu njerëzit në Kosovë gjatë viteve të '50-ta e '60-ta. Babi vjen prej një familje shumë të njoftun në Anamoravë, për shkak të aktiviteteve të gjyshit, babës, axhallarëve dhe familjes së gjerë. Në fshatin Hogosht, tregojke babi, që ka qenë një kohë, kur 42 anëtarë kanë jetu bashkë. Ka qenë mënyra si ka funksionu nukleusi familjar. Burrat kanë punu në ara dhe janë marrë me tregti, ndërsa gratë kanë qenë ato që e kanë kry punën në magje dhe i kanë rritjë e fëmijët. Tregojke babi, se axha i tij, Sadri Ahmeti, kish qenë personi i cili e ka menaxhu mirë një familje kaq të madhe, ndërsa gjyshi, rahmetlia, ka qenë ma shumë njeri i odave, me pritë mysafirë. Mbas luftës së dytë botërore kur pushteti ua ka marre krejt miellin në magje, meqenëse kanë qenë familje e madhe dhe kanë pasë prona, dera, oda e tyne, ka qenë e hapur dhe osht' njoftë si oda e Ahmet Agës në gjithë regjionin e Anamoravës. "Në disa momente edhe partizanët, vet Fadil Hoxha edhe shumë njerëz në atë kohë që kanë qenë udhëheqësa kanë zbarku edhe kanë fjetë në atë odë". Ajo ska qenë han, mirëpo ka qenë odë shumë e madhe.

I mbaj në mend vizitat në Hogosht, dimrat e ftohtë edhe burrat që lujshin filgjanash deri në orët e hershme të mëngjesit. E di që ka qenë një tepsi në mes me 9 filgjana të formave dhe dizajneve të ndryshme. Rreth sofrës uleshin deri në 10 veta, edhe e futshin unazën në njërin nga filgjanat dhe ai që e fshihte mbulohej me nje qarshaf të bardhë, që të tjerët mos ta shohin. Dhe krejt qëllimi ka qenë me gjetë unazën, se në cilin filxhan ishte. Ke pasë të drejtë 3 herë me provu dhe mandej ai që e gjejke e fillonte lojën prej fillimit. Ato lojë kanë zgjatë deri në mëngjes edhe ka qenë knaqësi me e pa harmoninë dhe adrenalinën në atë dhomë. Si duket ajo ka qenë mënyra e socializimit gjatë dimrave të ashpër.

Mbas darkës, hajshim pemë, dardha turshi, u thojshin dardha lonqe, dardha ujce, dardha kakiçka ose molla turshi. Hogoshti është i njoftun për ushqime të mira. Kemi pasë molla verore, molla që janë hangër vetëm dimrit, kumbulla të zeza e të verdha, të vogla dhe të mëdha dhe një lloj tjetër i kumbullës, i quajtun pozhega. E te ushqimi, m'ka bo përshtypje shumë paqa, mënyra qysh ata e bojnë paqen. E bojnë me petë të bakllavës edhe me lang të mishit edhe me mish të pulës. Edhe e bojnë njëfar sosi të bardhë me hudër. Dy motrat e mia dijnë me pregatite. Ajo ka qenë diçka sikur e vështirë me u bo, mirëpo sikur creme de la creme prej gjitha brumërave, ajo ka qenë ma përmbajtësorja. Është hangër rrallë, jo gjithkush e ka bo edhe jo gjithkush e ka servu.

Kur babi ka shku ushtar, i ka pasë 18 – 19 vjet. Atëherë mbetet gjyshja vetë me pesë vajza, pasi që gjyshi vdes në të ’57-ën. Halla e madhe martohet, halla e dytë e kryen shkollën e naltë në Shkup dhe martohet në Gostivar, e gjyshja me tri vajzat ma të vogla vendosë me ardhë në Prishtinë, njëjtë edhe axha. Babi ka lëviz prej Hogoshtit sepse ka dashtë mu shkollu. Ka pasë influencë t’madhe nga familja e gjyshes. Te daja në Gjilan, kanë pasë dhjetë, njëmbëdhjetë gjenerata jurista. Po në anën tjetër prej babës, gjyshin e ka pasë ndërmjetësus që ka pajtu familje dhe ka zgjidhë konflikte mes njerëzve, një njeri paqësor, i cili krejt konfliktet mes familjeve, jo vetëm në Hogosht, por krejt Anamoravën i ka ndihmu dhe është mundu me i zgjedh. Babi ka qenë shumë anti dhunës, anti luftrave... edhe me krejt ato çka kanë ndodhë në Kosovë, një herë nuk e kom ndëgju që ka thonë, “Luftrat jonë të mira”. Ose, “Duhet me luftu”. A din, gjithmonë “mirë kish qenë mos me përjetu luftën, të len pasoja, e bon qito, e bon qato”. Po thjesht, ka qenë i butë nga natyra.

Babi vendos me ardh në Kosovë bashkë me axhën. Kanë qenë vllazën prej babës, sepse gjyshi ka qenë i martumë edhe me një gru tjetër, Abën Zelë, të cilën ne shumë e kemi dashtë. Për me ardhë këtu, shesin pak tokë dhe e ndërtojnë shtëpinë. Ka ende shumë tokë në Hogosht që nuk është prekë. Hallat vazhdojne shkollimin në shkolla të mesme dhe babi fillon menjëherë me punu ne fakultetin juridik. Ka qenë i pari në familje po m’duket që regjistrohet edhe e krynë Fakulltetin.

E, nana, gjith m’duket që po i boj padrejtësi se qaq shumë me babin u morra. Gjithmonë mu ka idhnu se thojke, “Çkado që po bon pse mu kurrë nuk po m’thirr, gjithë veç babin”. Unë kom qenë fëmija i madh dhe prej natyrës kom qenë gjithmonë rebele dhe normalisht që e kom sfidu mamin shumë. Edhe tash kur mendoj, tash që jom në moshën e saj, më vjen keq. Me babin jonë dashtë shumë. Ajo ka qenë rahat me jetën e vet sa që asaj s’i ka interesu çka po ndodh rreth saj. Natyrisht i ka ndjekë proceset sociale e politike, por nuk është marrë me jetët e të tjerëve.

Familja e nanës janë t’Gjakovës, mbiemrin Krelani. Zejtarë kanë qenë. Gjyshi jem ka maru tirqi. Prej Gjakovës gjyshi shpërngulet në Ferizaj sepse atje e ka pasë ma lehtë me bo biznis. Mami ka lind në Gjakovë dhe është rritë në Ferizaj. Në të 70-at pastaj prap janë kthy në Gjakovë. Në Gjakovë e kanë pasë një shtëpi të bukur te rruga Bajram Curri, që shkon në Qabrat. Kemi shku atje pothujse çdo vikend, për pushime dimrore, për pushime verore me muaj të tanë kemi nejtë. Në njëfarë mënyre, jemi rritë në Gjakovë. Gjyshja ka punu me vek dhe figurën që kurrë s’e harroj osht’ kjo: e ka pasë një dhomë në atë shpi të vjetër të stilit otoman. Oborri ka qenë i madh me duda të zi t’bukur. Shtëpia njëkatëshe... arkitektura qysh jonë shtëpitë në Rrafshin e Dukagjinit, pak orientale. Parmakët i ka pasë shumë të bukur. Njona prej dhomave e ka pasë vekun edhe unë kur shkojsha si fëmijë, hisha në atë dhomë... verës ka qenë shumë fllad dhe silueta e saj, e gjyshes. Kisha dhonë gjithçka n’botë, me pasë mundësinë me fotografu qatë siluetë të saj nga mbrapa. Ajo, me qëndrim të drejtë punojke në vek. I punojke ato kumashet, ato kmishat e mëndafshit, ato ojnat që i bajshin gratë nëpër darsma. E admirojsha. Mirëpo tonë kohën punojke edhe zhurma e atij veku, kurrë nuk e harroj, sa madhështore mu ka dukë. Ajo e ka pasë emrin Zyhra, ne fëmijët i kemi thanë Nona e Dajës... ka qenë gru stoike, është dukë me vija të ashpra në fytyrë.

***

Babi dhe mami njoftohen përmes disa familjarëve ma të largët. Babi është dukë

shumë mirë, është veshë bukur, ka qenë i shkollumë, ka shku nëpër ato mbrëmjet, ballot, që jonë organizu në atë kohë. Babit ja propozon një familjare mamin edhe babi shkon në Ferizaj me taku. Mami ka qenë 19-20 vjeçare, jashtëzakonisht e bukur. Dhe shkon babi me u njoftu me mamin... mbetet pa tekst. Thotë, “Unë veç këto kom me marr edhe kërkon tjetër”. Edhe mami si duket ka qenë ashtu, dashuri në shikim të parë, shumë idilike. Por, i keni parasysh paragjykimet që kanë qenë atëherë, babi prej Hogoshtit, dhe nana e mamit thotë, “Kuku, me katunar me u martu nuk vjen në konsiderim”. Mami martohet me darsëm mirëpo familja e vet nuk i flet. Tre dajë edhe tezja nuk reagojnë. Duke mos pasë burrë gjyshja, ka qenë axha i mamit me autoritet e i shkollumë dhe i thotë gjyshes “Nuk bon kështu me bo”. Edhe mas gjashtë muje shtendosen marrëdhanjet.

Të lidhur nga dashuria

Unë kam tri motra, Mimozën, Albanën, Artën edhe vllaun Kushtrimin. Kur i kom pasë njëmbëdhjetë vjet, në vitin ’80, lind vllau. Bash kur kanë ndodhë demostratat në 81-tën ai e ka pasë ditëlindjen, e mami patë organizu me ardhë familjarët me ia festu. Shumica e anëtarëve patën pasë problem sepse na kemi qenë te rruga e Prizrenit, bash te Salla e Sportit ku kanë ndodh demonstratat, te shpija e Delibashiqit... sot e asaj dite, osht’ e zbrazët, e boshatisun.

Motrat janë pak ma ndryshe vëllau dhe na kemi qenë me karaktere te ndryshme, por shumë të dëgjueshme, përveç meje. Babi dhe mami kanë qenë të vetëmjaftushëm edhe ata jonë dashtë qaq shumë sa që na shpeshherë jemi ndi si të tepërta në dhomë. Kjo ndoshta ka ndiku që na kemi qenë të lidhuna ma shumë mes veti. Krejt në qatë konstalacion ka qenë edhe gjyshja si një balancë. Me gjyshen, prej krejt fëmijëve, unë kom qenë jashtëzakonisht e lidhun.

Me mamin s’kemi qenë në të njëjtat vibes e amplituda, Ajo e ngrata gjithmonë ka gjetë pak ma shumë mirëkuptim te motrat tjera, sidomos te motra e tretë. Kemi qenë e jemi natyra të ndryshme. Unë jom shumë ma euforike, kom qenë shumë ma impulsive, shumë ma direkte dhe më thirrke, “kuku erdh reja me breshën”, ndërsa motrës së tretë, Albanës, i thojke: ‘’Erdh shuhreti i shpisë’’. Ma vonë e kom analizu veten dhe mendoj që ky rebelizëm m’ka ardhë nga fakti që nuk e kom dashtë konformitetin dhe mënyrën e jetesës në Kosovë e kom pa me shumë kritikë. I kam pasë 9 vjet, kur më pat thanë babi, i cili ishte afër kuzhines: “Bjerma nje gote uje!” Unë i pata thanë: “E pse unë mu qu me ta pru ujin, që ti je afër qeshmes?”

Vllau, fëmiu ma i vogël, ka qenë jo i lazdrum. Gjyshja e ka pasë lazdru ma shumë. Po i ngrati, deri sa brenda në familje nuk ka pasë kurrëfar tretmani special si djalë, kur dilke jashtë ose në shkollë, normalisht shoqnia qysh është shoqni patriarkale te na, i thojshin, “Ti djalë i hasretit, ti duhesh mu kqyrë qeshtu ose qashtu”. Kështu që, pak vllaut e kom përshtypje që krejt i kemi hi në hak se nuk e kemi mbështet se ka qenë ma i vogli. “Hajt bre rri ti qaty, kush po t’vet ty ja bojshim’’.

Ne kemi qenë familje e hapun, shumë, shumë liberale e s’kemi pasë presione si për shembull, “Martohu” ose “Mos dil”, ose, “bone ato”. Të vetmen këshillë që e kom pasë prej babit kur kemi shku në Hogosht, na thojke, “Mos veshni pantolla të shkurtë, mos vesh maica pa mangë edhe keni kujdesë qysh po uleni”. Po ashtu m’patë thanë, “Nuk keni kurrëfar zori mu martu se koha s’ju ikë, krejt çka duheni me bo është me u shkollu, m’u pavarësu”. Kur i kom pasë thonë, “Po du me shku në Juridik”, m’patë thanë, “Jo”. Thashë “Pse? Në Juridik po du, me u bo juriste, po du mu bo gjykatëse, se po du me nda drejtësinë”. Në klasë të tetë jom konë, e ai tha “Jo, sepse drejtësinë e ndan ai që është ma i forti”. Edhe me vite të tana kom mendu çka ka dashtë me thonë me këtë konstatim. Këto këshilla i maj në mend prej babit.

Gjetja e qetësisë pas humbjes së prindërve

Mami vdiq e re, pak para se me i mbushë 68 vjet. Ajo e ka dashtë jetën shumë, nuk e ka pasë kohën me vdekë. Mirëpo vdekja nuk të pyetë. Për mamin na ka ra pak shok, edhe ndoshta për mënyrën se si ajo pësoi sulm të fortë në zemër dhe i mbet truni disa minuta pa ajër. Mënyrën se si ajo u përpjekë me jetën, brenda një muaji sa ishte në emergjencë, neve na dha kohë të mjaftueshme me u pajtu me faktin që në atë gjendje nuk mundet me mbijetu. Tash, prej përvojës po flas, m'kanë thonë të tjerët, kur të vdes prindi i parë është shumë ma shokuse, edhe e përjeton shumë randë. Po, kur shkon një anëtar i familjes edhe mandej të tjerët kanë me shku rend, qysh e ka secili fatin e vet. Vdekja e babit ka qenë vdekje si në shtratin e mbretit. Vdekja është e keqe edhe e ftoftë, mirëpo kur e jeton ciklin e jetës, se çdo ditë kom qenë me të edhe e kom përcjell çdo frymëmarrje të tij, ai ka shku i qetë në moshën 82 vjeçare. Unë kisha pasë dëshirë me vdekë ashtu si ka vdekë babi. Ai ka vdekë në paqe me vetveten, është përshëndet me krejt neve veç e veç, edhe ka thonë "Unë s'kom nevojë mo me jetu, kaq e pata". Vdiq në ditëlindjen e tij të 82-të, me 22 maj 2020. Nganjëherë thom, kom mujt me qëndru jashtë, kom mujt me jetu në Kanadë, kom mujt me jetu e punu në Amerikë. Ai me pat kthy prej Amerikës me fjalët: "Ti si vyn Amerikës kurgjo, Amerika ka plot Nora. Ti duhesh me ardhë me kontribu në Kosovë". Mendoj që të dytë e kanë pasë vdekjen të lehtë edhe pa vuajtje dhe kjo më qetëson.

Rruga drejt dijes: Nga publikja në sistemin paralel

Në '76-tën, kam fillu shkollën fillore në "Vlladimir Nazor". E kom pasë mësuesen gjakovare. S'kom pasë shumë respekt per te se i rrehke shumë fëmijët, sidomos ata të muhaxher-mahallës, që ishin fëmijë të varfun dhe nuk i bojshin detyrat. Atëherë me tetë vjet më është dukë padrejtësi, edhe i pata reagu mësueses me "Pse po i rreh kaq shumë ata fëmijë?". Në vitin e pestë, kujdestar e kisha Isak Simnicën i cili vdiq mas një kohe sepse e zuni orteku i borës në Brezovicë. Mendej e kemi pasë një kujdestar tjetër që jepke fizikë, Ismajl Kastrati, të cilin shumë e respektoj. Ka pasë arsimtarë të cilët i kom dashtë shumë dhe i respektoj shumë dhe kur i shoh në rrugë me knaqësi ju flas.

Për aktivitetet jashtëshkollore, m'pat qu babi si fëmijë në shkollë të muzikës me mësu pianon, "Hajde me shku në solfexho te mësuesja Drita, me msu pianon". Mësuesja Drita ka qenë gru e sofistikume, më pat thanë, "Hajde Nora, mas msimit". Shkolla ka qenë diku te pjesa e vjetër e qytetit, më duket se është qujtë Stefan Mokranjac. S'ma dojke hiç, me zor shkojsha. Regjistrohna edhe në sallë të sportit me çikat e mahallës me lujtë basket. Me kojshiken, Lumkën. Tash unë jom boll e gjatë per mesataren në Kosovë - në shkollë fillore m'kanë thirrë, "Gjirafë". Lumka hala ma e gjatë. Ajo lujke qendër e unë alo e djatht. O, si sot e maj në mend, Resmie Juniku, Serbezja, Stublla, etj. u bojke salla plot, plot, plot studentë me kqyrë tu lujtë çikat. O, çfarë atmosfere. Ajo për mu ka qenë, kuku, knaqësia ma e madhe. Veç e di që një vjet e tepër nuk kom guxu me u tregu prindërve që po shkoj në basket, se thojsha "kanë me m'mytë, 'Po shkon n'basket në vend se me msu piano?'". Por jo, kur i tregova prindërve kurgjo s'më thanë. "A po don?" "Po". Aktivitetet dhe basketin i kom pasë dashni.

Kom pasë problem me i msu vjershat përmendsh. Unë duhej patjetër me logjiku vetë, me zbërthy vetë në kokën teme, me kuptu një fenomen sepse përmendësh nuk kom mujtë me memoru. Vjershat i kom pas shumë problem me i msu. Përndryshe, poezinë edhe sot muj me thonë nuk e du, as skam ndonje afinitet për poezinë. Prozën e kom dashtë gjithmonë. Ka pasë libra që unë kom fjetë me vite të tana to. Ato libra i kom edhe sot, i mbaj ne bibliotekën teme. Jonë konë tri libra, në të cilat unë kom jetu: “Bardha e Temalit”, “Zgjimi” i Sterjo Spasses, “Skendërbeu” i Sabri Godos... por edhe Kështjella e Ismajl Kadaresë. Gjithmonë e kom dashtë realizmin, gjanat mirë të dokumentume, edhe aty ku ska nacional-romantizëm. Diku në shkollë të mesme, u frymëzova shumë nga profesori Nazim Lleshi, lexojsha edhe histori shumë, letërsi botërore. Historinë kom dashtë si rrëfim, nuk i kom dashtë datat. Nuk e kom dashtë metodologjinë, me t’cilën neve na është spjegu historia.

Kom pasë një periudhë kur ndoshta një lektyrë/libër brenda ditës e lexojsha. Mirëpo, saktësisht e kom ditë çka po du edhe çka s’po du. Ndoshta është dashtë me qenë pak ma shumë konformiste dhe e dëgjueshme edhe me i lonë gjanat me shku me rrjedhën e vet. Për moshën dhe kohën, kam qenë shumë e padëgjueshme për shoqërine ku kemi jetu, dhe mu më pëlqen kjo karakteristikë, edhepse është e vështirë me jetu me këtë lloj karakteri kudo në botë.

Kur e kam përfundu shkollën fillore edhe vendosa me regjistru shkollën e mesme, s’ke pasë në atë kohë shumë opsione. Në shkollë të mesme, në gjimnaz ke mujt me shku, ka qenë dy vjet plus dy. Unë kom vendosë me shku në “Ivo Lolla Ribar”. Si shkollat ma t’forta jonë konsideru gjimnazi “Ivo Llolla Ribar” edhe “Xhevdet Doda” dhe mandej dy vjet u dasht me u profilizu, ose me shku në mjekësi, në bujqësi, në ekonomi ose me shku në “Shtefën Gjeçov”. Ata që dojshin me shku në ndërtimtari, arkitekturë, maqineri, elektro ose në maqineri kanë shku në Normale. Në Normale kanë shku gjithmonë studenta të mirë. Ata që kanë qenë shumë t’fortë në matematikë në mjekësi, në “Shtefën Gjeçov”. Vitin e parë veç kom absorbu, kaq shumë mu patë doke ndryshe. Unë kom qenë klasa I17, kom pasë shumë fat me pasë kujdestar Gazmend Veliun, tepër profesor i mirë. Kom qenë shumë e pasigurtë, vitin e parë. Mirëpo, vazhdova me lujt basket edhe qajo me largojke prej realitetit te ri. Viti i dytë ka qenë ma ndryshe, ka qenë drejtimi shkencor. Atëherë klasa ishte shëndrru në një shtëpi të dytë. Vitin e tretë dhe t’katërt ke pasë mundësi me zgjedh pastaj dhe mandej kom shku në “Shtefën Gjeçov” me ambicie me qenë në arkitekturë.

Viti i parë në arkitekturë ka qenë përafërsisht si viti i parë në shkollë të mesme, diçka prapë e re. Diçka ndryshe, t’doket vetja që veç je rritë, t’duket vetja që je dikushi. Ka pasë obligime, përgjegjësi, ka pasë shumë punë. Ma e mira ka qenë pjesa që na është dashtë me vizatu, me netë të tana pa gjumë, që sot nuk e përjetojnë studentat e arkitekturës. Kishim afate edhe u duhshe me dorzu punime, kemi pasë ushtrime dhe studentat kanë bashkëpunu shumë. Unë isha në arkitekturë, motra, Mimoza, në stomatologji. Përveç që m’vyjke hapësira, me vyjshin edhe kushte ekonomike – studimi i këtij drejtimi ka qenë i shtrejtë. Në Greqi i kam ble rapitografat dhe mjetet tjera - se na kemi shku në pushime në Greqi deri në moshën njëzet vjeçare. Mu m’vyjke hapësirë shumë me studiu - m’vyjke tavolina e madhe.

Dy-tri vitet e para, e kemi pa që situata nuk ish mirë, sepse filloi një numër i madh i studentëve me ikë. Kur u hapë Universiteti i Prishtinës, ka pasë 18 mijë studenta. Në vitin ’90-’91, kur vjen Millosheviqi në pushtet, zbret numri në 12 mijë. Ata që kishin

mundësi, vazhdunë me studju në shkolla-shtëpi.

Ma e keqja osht' kur në '92-tën na largunë prej universitetit. Ka qenë ditë e martë dhe kemi shku te Fakulteti i Arkitekturës dhe dera e fakultetit e mbyllur. M'duket ka pasë një letër të vendosun në derë të fakulltetit dhe e di që s'kemi pasë mo të drejtë me hi brenda në fakulltet. Në arkitekturë ka pasë diskutime, "Pse këto masat e dhunshme? Arkitektura nuk osht' letërsi, nuk osht' histori". Fillunë masat e dhunshme nëpër ndërmarje dhe institucione. Mu m'i largunë të dy prindrit prej punës, ashtu qysh i largunë shumicën. Nëpër shkolla, filloi apartheidi. Fillunë masat e dhunshme, ku puntorve u ipej një fletë-dokument, ku shkruheshin disa masa të reja e të cilat do duhej të pranoheshin nga gjithë puntorët si kusht, për me vazhdu punën. Unë s'e kam pa atë dokument kurrë, por prindrit tanë po. Ka marr një vjet a ma shumë ristrukturimi dhe derisa u konsolidumë me i formu institucionet paralele. Para sistemit paralel, përparësi kishin financat, shëndetësia dhe sistemi i shërbimeve sociale. Për ato, "Nana Terezë" në atë kohë ka bo punë enorme, sepse i pat evidentu t'gjitha familjet në nevojë, pat bo spitalin "Nana Terezë", ka punu në regjistrat dhe është ditë sa njerëz kanë nevojë per ndihma. Me diasporën është punu shumë sepse është pa si the main income (të hyra financiare kryesore) që ka kontribuar me remitanca dhe 3%.

Mësimi në shkollat fillore është mbajtë në shkolla, por në disa shkolla, si ajo e Dardanisë p.sh. ka pasë apartheid. Bukfalisht, një grusht nxënësish serbë kanë mbajtë mësimin paradite dhe 99% e nxënësve shqiptarë kanë mbajtë mësim pasdite. Dhe kjo ka bërë që numri i orëve të zvogëlohet. Këtë e di sigurt ngase e pata hulumtu - ka pasë mur fizik që nxënësit shqiptarë dhe ata serbë të mos takoheshin, përkundër faktit që nxënës shqiptarë ka pasë shumë herë ma shumë.

Objekti i fakultetit të arkitekturës ka qenë në Dragodan. Ka qenë rruga që shkon për te Komuna, nga rrethi poshtë, diku i bjen rruga e tretë, apo e katërta, djathtas. N'qatë rrugë kanë qenë dy shtëpi të mdhaja, garazhat na i patën lshu për salla për me shku me i ndëgju ligjëratat. Me punu s'ke mujt sepse ka qenë garazhë me tulla edhe disa dërrasa përmbi tulla me u ulë. Gjithë e kemi ditë, që kualitet të mirë të studimit në ato kushte s'ka pasë. Një lloj improvizimi që e ka pasë efektin atëherë me vazhdu paralelisht dhe mos me humbë fillin. S'është dashtë m'u dorëzu, është dashtë me vazhdu. Kom pasë përplasje me vetveten, sepse thojsha "nuk mundesh me dalë arkitekt i mirë t'u studju në këto kushte". Shumë kolegë e kanë kry dhe kanë dalë arkitekta t'mirë. Unë kaniherë mendoj që ndoshta kom mujt edhe unë me vazhdu, edhe sot me qenë arkitekte. Po mendoj, ajo ka qenë edhe si shkas i arsyeshëm mos me vazhdu në ato kushte me studioju. Largimi i studentëve nga objekti dhe ndërprerja e studimeve ka qenë diskriminimi më i madh që e kom përjetu dhe kjo ka qenë sa traumë, po aq edhe shtytje me vazhdu tutje. Nuk e kom pranu lehtë rolin e viktimës, nuk mishrohna lehtë me viktimën. Jom luftarake prej natyrës, mirëpo kjo İloj traume e largimit me dhunë nga diçka që ke aspiru, ndërprerja e një andrre, ka lanë megjithatë pasoja te unë.

Ato çka i maj n'mend, sepse osht' reflektu në jetët tona, janë vitet prej '81-tës e deri sa eskalon komplet situata në '89-tën, kur Millosheviqi vjen në pushtet, kur suprimohet autonomia e Kosovës dhe na mbetemi pjesë e Republikës së Serbisë. Kjo periudhë ma ka determinu edhe punën me t'cilën unë sot merrna. Shpesh kur m'kanë pyet, "Pse merresh me 'Conflict Studies' [studime të konfliktit]? Pse të drejtat e njeriut? Me siguri pasioni edhe sensi për drejtësi sociale është imponu gjatë viteve kritike, të cilat në njëfarë mënyre ma kanë formësu edhe karakterin edhe pasionin. Nuk kom deshtë mu marr me konfliktin, konflikti është marrë me mu. E kom pasë qitë forcën e brendshme që m'ka shty me ditë edhe me gjetë vetveten. Gjithmonë jom konë pak ma e hapur dhe jokonformiste, kurrë s'i kam deshtë normat shoqërore dhe i kam pa pengesat që na shfaqen sidomos neve grave. Gjithmonë e kom sfidu traditën. Kurrë nuk m'ka pëlqy tradita. As sot nuk m'pëlqen.

***

Kjo pjesa ku kemi jetu në Aktash, Bregu i Diellit, karshi Sallës së Sporteve e pak ma poshtë është edhe menza e studentëve. Domethonë, një trekëndësh, në të cilën ngjarjet e '81-tës fillojnë. Kom qenë atëherë njëmbëdhjetë vjeçare kur kane ndodh demonstratat e 81. Në lajme të kanë bombardu, fjalori u përcjellke me fjalët "Iredentist, secesionist, separatist, nacionalist". Ti si fëmijë dhjetë, njëmbëdhjetë vjeçar fillon me pytë, "Çka jonë bre këto fjalë? Çka oshte bre ka ndodhë?" Lagjet tona kanë qenë të stërmbushuna me studentë dhe e di që ka pasë orë policore. E di ditën kur kanë ndodhë protestat. 3 hallat e mia kanë ardhë te na. Neve prindtë na kanë mshelë brenda. Bukfalisht, dera ka qenë e mbyllun. Tri, katër ditë s'kemi dalë prej shpisë. E mbaj n'mend, studentat kur jonë gjujtë me gurë me policinë, e policia me ato mburojat e plastikës. I kom pa përleshjet dhe gazin lotsjellës. Ka pasë shumë studenta prej Maqedonisë dhe ata u vrejshin prej të folunit. Për me i shpëtu gazit, shpërndajshin kepë. Autoblindat kalojshin kah rruga. E kur u liru, kur u zbut pak situata, kemi dal e kemi pa shpinë aty n'qosh, shtëpinë e Delibashiqit, nje serb i lagjes që kishte gjujtë me armë nga aty. Krejt përleshja qaty është bo.

E mbaj në mend babin kur e kanë ndalë policia edhe e kanë marrë në pyetje. "Fati që kom pasë kapelë a sheshir n'kry", thojke babi. Në kokë i ka hutu pak policët sepse paragjykimet kanë qenë shumë të mëdhaja. Si duket, policët kanë mendu që ata që mbajnë kapela, jonë serbë dhe ai ka kalu rrugës për në punë pa shumë pengesa.

***

E mbaj n'mend edhe atë kohën kur serbët, për shembull, jonë anku që shqiptarët kanë shumë të drejta dhe atë rastin e Martinoviqit. Po ashtu, ma vonë kur pasuan rastet me shqiptarët që ktheheshin nga shërbimi ushtarak të vrarë dhe në arkivole. Edhe procesin e pajtimit të gjaqeve. Ato e kom përcjellë shumë mirë edhe për shkak se kojshikja edhe shoqja jeme, Fehmie Gashi Bytyqi, ka qenë shumë aktive në këtë proces. Shuki Gashi ka qenë aktive po ashtu.

Një detaj tjetër që nuk e përmenda e që ka t'boj gjithashtu me edukimin rreth indoktrinimit, kur unë bojsha pytje në landën e historisë. Ishin do pytje për mbledhjet e AVNOJ-it, mbledhjen e Bujanit, që kurrë s'i kom kuptu shumë mirë. E pytsha babin, "Çka jonë bre qeto mledhjet e AVNOJ-it, pse po na pysin veç për data dhe s'po na shpjegojnë ma detajisht?" Unë dojsha ai me ma shpjegu me fjalë t'veta. Ai nuk ma shpjegojke me fjalë t'veta edhe m'patë thonë një herë, "Ti këto msime ki me i msu se t'vyjnë me marr notën e mirë. A po t'i lyp arsimtari? Msoji qashtu, por mos gabo me i besu". Shumë ma vonë, fillova me bisedu me sllovenë, me kroatë, me boshnjakë e me serbë me pa a i kanë msu edhe ata të njëjtat histori dhe ngjarje. M'thojshin, "Po". Po sllovenët edhe kroatët m'patën thanë, "Edhe neve na kanë thonë babat qeshtu, "Ti msoje këtu, merre pesshe, por mos harro se para se me qene jugosllav, ti je slloven dhe kroat". Sot e asaj dite, e përmendi edhe vetë si argument kur ligjëroj, sa mundet narrativi që merret si bazë me hupë orientimin dhe si me vetëdije me e deviju të menduemit kritik. Kjo mvaret edhe se sa je vetmohuse si person edhe don me hulumtu tutje edhe mos me besu qatë t'vërtetë si t'vërtetë cullake, por don prapë me marrë edhe informata nga burime tjera.

***

Në vitin 1989, pranohem në arkitekturë. Në krejt qato turbulencat politike, jeta vazhdojke. Sa isha në shkollë të mesme kanë ndodhë edhe këto turbullirat në Trepçë. Kanë ndodh pastaj këto ndrrimet rapide në lidershipin kosovar, sepse Millosheviqi vjen në pushtet. Nuk e kishim sigurinë e njëjtë. Megjithatë, na u mundojshim me jetu. Themelohet Lidhja Demokratike e Kosovës që krijoi njëfar homogjenizimi në gjithë Kosovën. Kjo ndodh mas suprimimit të autonomisë. Në korrik të vitit '92, ndodh shpallja e Republikës së Kosovës emandej u desht deputetët me e lshu Kosovën, sepse u përndjekën nga rezhimi i Millosheviqit. Njëni prej deputetëve, Feti Broçi, ka qenë daja i shoqes tem ma t'mirë - ai pat shku në Çeki, disa tjerë në Shqipni, disa ne vende tjera. Ti e dishe që historia e ka marrë një rrjedhë dhe ai lumi, qajo prrocka që filloi kadal-kadal me rrjedhë, veç shkojke t'u u fry, t'u u rritë e t'u u ba lum. Dhe, ti e dishe që qaj lumi ka me u derdh dikun, dikun ka me pasë një klimaks, por nuk e dishim ku dhe kur ka me dalë prej shtratit. N'fillim të '90-ve kur eskalon, kur fillon me u shkapërderdhë, fillon njëfar organizimi underground, i sistemit paralel. Në atë kohë ka qenë LDK-ja, ku të gjihtë kanë qenë LDK, dhe patën themelu nëndegët në secilën mahallë, lagje. Domethanë, sistemi, organizimi horizontal ka qenë par-eksellancë edhe unë e maj në mend që babi ka shku shumë në takime. Ato kanë qenë krejt punë vullnetare. Babi në të njëjtën kohë punon edhe në themelimin e Odës Ekonomike të Kosovës, dhe qato pak biznese që punojshin në Kosovë aspirojshin me i futë nën ombrellën e Odës dhe me i organizu ma mirë. Pas shëndetsisë, financave dhe arsimit, edhe institucionet tjera fillojnë të themelohen. Na e dishim që babi po bon diçka, por nuk tregojke. Dhe, në vitin 93, derisa ai edhe mami ishin të papunë, vjen i ndjeri profesor Rifat Rizvanolli në shpi edhe i thotë babit "Sylë, po na duhesh në Fakultet Ekonomik me ardh me punu". Në fakultet paralel. Ftesa nuk ka qenë veç me kry punën e sekretarit të fakultetit dhe administratorit, por underground janë bërë edhe shumë punë tjera organizative rreth çështjeve të mbijetesës së institucioneve në ato kushte të jashtëzakonshme. Babi e pranon dhe në të njejtën kohë punon edhe rreth themelimit të Odës Ekonomike Paralele edhe dikun në pranverën e hershme të '94 arrestohet, burgoset.

Hyni policia në mënyrë brutale në shpi, ia lidhën durtë dhe e morrën. Babi u pat emru Sekretar, derisa Kryetar i Odës Paralele ka qenë Ismail Kastrati. I treti ka qenë Ibrahim... s'po m'kujtohet mbiemri. Këta tre i burgosin sipas vertikales, udhëheqësia e Odës Ekonomike Paralele dhe i mbajnë në paraburgim. Babi ka pasë gjithmonë probleme me zemër dhe na e kishim frikën aty. Na ishim rritë me storjet se qysh e kanë malltretu dajën Metush. Na ishim rritë me storjet e brutalitetit që përdoret nëpër zyret e UDB-së, nëpër stacione të policisë dhe qajo ka qenë frika jonë që çka kanë me i bo. A ka me mujtë me duru? Ishim krejt pa punë, krejt studenta. Kjo o konë periudha ma e keqe, ma e vështirë, por nuk jemi ndi vetë, sepse ka pasë shumë solidarizim atëherë dhe as stafi i Fakultetit Ekonomik dhe as miq tjerë nuk na lanë në lloq. "Nana Terezë" po m'duket që na patë pru disa paketa me ndihma. E kanë mledh një fond. Halla prej Amerikës, jo dikush vike me u solidarizu me neve dhe na jepte njëqind a dyqind marka etj.

E mbaj në mend, kur kanë ardhë tre zyrtarë të UDB-së në shpi. Qajo u konë trishtim. Kanë hy me kpuca nalt i kanë thonë mamit, "na nevojiten disa barna edhe kanë kontrollu diçka në sirtarët e babit në dhomë të fjetjes". Mami i patë pytë, "çka po ju duhet?". Ata nuk folën shumë vetëm thanë 'mos u brengosni' në serbisht. Na u shashtrisëm, ku me ditë çka i kanë bo babit, mendojshim. Ata i morën barnat për tension, barnat për zemër, aspirina që i ka pi babi për çdo ditë. Ai nën hetime ka qenë 72 orë, mandej e dërgojnë në burg të Prishtines. Ai është burgosë në prill 94, mos gabofsha, dhe ka qëndru në burg deri në tetor apo nëntor, sepse e di që ka qenë shumë ftoftë kur ka qenë gjykimi i babit, edhe kur kemi shku me marrë pjesë në gjykim. I kanë majtë gjashtë muj në burg dhe i kanë liru të mbrohen në liri.

E maj n'men, paketat e ushqimit kur ia dërgojshim në burg. Babi nuk tregojke, nuk u shihke që osht' fizikisht i maltretumë, në ftyrë a kështu, e na nuk mujshim me ditë, por e maj n'mend kur patëm shku me vizitu me rend, nga dy veta. Një herë patë ardh halla prej Amerikës edhe ia çoj një paketë. Shkoi me e vizitu edhe n'burg. Kur pata shku me hallën, babi foli me to, unë s'disha çka me fol. M'tha, "A po mson? A po msoni? Çka po boni?" Mu m'interesojshin policët me i analizu qysh po sillen. Ai u pat duk mirë, stoik kështu me qëndrim. "Mirë jom, mirë. Mos bani gajle, mirë jom. Nuk osht' keq". Ai e dike me siguri që na brengosemi shumë.

Babi i ka pasë shokë të ngushtë avokatin Bajram Krasniqin edhe Destan Rukiqin. Nuk po m'kujtohet kush ka qenë gjykatëse, por e di që ka qenë gru. Axha Bajram u munojke me na thonë që ka gjasa që e lirojnë, me dënim me kusht. Mirëpo i dënun ata me dy vite e gjysëm me u mbrojtë në liri. Normalisht, kanë qenë në shpi, por s'kanë guxu me lëvizë. Kur dul babi prej burgut filloi me tregu qysh e kanë trajtu brenda. "Jo", thojke, "nuk m'kanë ngucë". Ama s'e di kurrë sa ka qenë i sinqertë me neve. Veç a di nga këta të burgosunit politikë se është me randsi sa stoik je dhe sa nuk jep informata kur je brenda. Qëndrimi brenda dhe mosdhania e informatave i ban me u ndi patriota dhe të fortë. Nejse, ai e ka pasë idol dajën Metush Krasniqi. Unë fëmijë kom qenë kur ai u konë pak para se me vdekë, i smutë, kur e kanë kuptu në burg, që mo s'ka jetë të gjatë, e patën liru në '85-tën. Dhe e maj në mend, kur vike dhe rrike i shtritë se s'mujke me nejt ulë. Si duket, qato kanë qenë ditët e fundit të jetës së tij. Ai u ka mbijetu shumë torturave në burg, deri sa ia dobsuan zemrën dhe vdiq, relativisht i ri.

Gjatë periudhës kur është futë babi në burg, na fillumë me punu. Motra e dytë e gjeti një familje që kishin nevojë dikush me u kujdesë për fëmiun e tyre parashkollor, ata

ishin mjekë të rinj. Mandej e gjeti nji familje tjetër, te Lule edhe Bujar Demjaha. Bujarin e kom pasë asistent në Fakultet të Arkitekturës. Bujari i thotë djalit të axhës t'vet, Agonit "Albana po vjen po kujdeset për fëmijët tanë". Agoni e Teuta m'thirrën mu "A po vjen edhe ti me u kujdesë për djalin, Dritëroin". Kështu që, na në '94-tën deri '95-tën, kur u vra Armend Daci, vrasja e parë në Breg të Diellit, dhe kur filluan protestat e para, kemi punu si kujdestare të fëmijëve për me i mbulu sadopak shpenzimet e fakultetit. E mbaj në mend, kur Sevdije Ahmeti bashkë me disa gra, iu bashkangjitën protestave. Unë kom qenë t'u u kujdesë për Dritëroin në atë kohë, edhe krejt ngjarja ndodhte qaty afër, në Breg të Diellit. Filloi pak qaj tensioni prej fshatrave me ardhë edhe në Prishtinë edhe ti e vrejshe që ka me eskalu veç ish në pytje kur.

Aktivizmi kundër shtypjes dhe shkeljes së të drejtave të njeriut

Në mënyrën qysh eskaloi situata dhe si populli ishte pshtetun për muri, unë mendojsha që duhet diçka me bo. Atëherë veç nuk kish organizata joqeveritare, ka qenë KMDLNJ-ja ku unë e kom pasë motrën që punojke vullnetarisht. Filluan, dy-tri organizata, si "Mercy Corps" e "Nana Terezë". Edhe thash "Kadal, se ndoshta nuk o keq unë me gjetë mënyrën me fillu me punu" sepse më interesojke çka po ndodh, unë s'jam qytetare pasive.

Në '95-tën motra fillon me punu si vullnetare në KMDLNJ dhe filloi me dalë në teren e me pa çka po ndodh dhe si po përdoret dhuna. Në periferi dhuna ishte brutale, e na nuk ishim shumë të informumë në Prishtinë. Mediat nuk kanë qenë bash-bash t'hapuna sa sot, dhe ka qenë 'Koha' dyjavore dhe gazeta e përditshme 'Bujku'. Dhe, t'u i ndëgju storjet e saj prej terrenit, fillova me shku në KMDLNJ me u njoftu ma për së afërmi me punën dhe aktivitetet, me ndihmu herëpasherë, në baza vullnetare. Në hapësirat e KMDLNJ-së kur për herë të parë kam shku, njerëzit që kanë punu aty kanë qenë Ymer Jaka, Sami Kurteshi, në atë kohë e udhëheqke. Ka qenë një pari intelektuale e vendit, antarë të KMDLNJ. Një përqindje e madhe e antarëve të LDK, filluan të antarsoheshin si vullnetarë në KMDLNJ. Në ato kohë, u themelu Partia Parlamentare e Kosovës e më vonë edhe UNIKOMB-i, që udhëhiqej nga Ukshin Hoti. Pastaj, Adem Demaçi filloi me iu kundërvy Rugovës me idenë e Ballkaniadës.

KMDLNJ-ja ka pasë bazën në Prishtinë edhe i ka pasë 29 nën-këshilla në 29 komunat e Kosovës. Secili nën-këshill ka pasë kryetarin, aktivistat dhe selinë. Mandej me kohë, ka pasë procedurë standarde të raportimit, por në fillim veç e kanë raportu, "Filan Fisteki e ka bo qito, qito, qito". Ma vonë kanë fillu me marrë fotografi, me i marr t'dhanat, "I lindun qitu edhe i ka ndodh qikjo, qikjo". Çfarëdo lloj identifikimi që ka mujtë me ardh, ata e kanë dhonë informatën në degë, nëndegë. E mandej, kryetari i nëndegës e ka qu informatën në Prishtinë. Nënkëshillat jonë mledhë çdo muj, kanë ardhë në zyrën qëndrore këtu dhe kanë majtë takime edhe i kanë shfaq problemet, sfidat, çka po shohin, çka s'po shohin, shkëmbimin e informatave, etj. Kanë qenë shumë të targetumë prej policisë, të malltretumë.

Kanë ikë. Policia s'ka pasë send që s'ka ditë. Saktësisht e ka ditë kush, ku po punon, ku e ka zyrën, me çka po merret, kush jonë aktivistat. Mos t'harrojmë se kanë pasë informatorë brenda fshatrave. Ti kurrë s'e ke ditë kush dhe ku po i jep informatat. Mirëpo, nënkëshillat kanë qenë krejt transparentë edhe qajo ka qenë qëllimi: me qenë transparent. Ti s'po bon kurrëfar krimi, ti veç po informon për abuzimet që po bohen prej rezhimit. Në të njëjtën kohë, të njëjtën gja e ka bo edhe LDK-ja. Bile në disa komuna të vogla, LDK-ja dhe KMDLNJ-ja i kanë pasë zyret brenda një objekti. Ose e kanë pasë naj parti tjetër, PLK-ja, LDK-ja ose Unikombi. Kështu që, edhe për policinë ka qenë shumë ma e lehtë me vëzhgu. Unë kom fillu me shku në KMDLNJ gjate '95,

Në maj të '96-tës jom punësu në Fondin për të Drejtën Humanitare. E, qysh ka ndodh anagazhimi im në Fond? E kanë pa që kom interesim me punu. E di që Natasha (Kandiq) i thotë Demaçit, "më nevojitet një hulumtuese nga Kosova", dhe në vend se hulumtuesit e FDH-së të vijnë në Kosovë nga Beogradi, ajo e sheh të udhës që dikush nga brenda me hulumtu. Demaçi ka pasë shumë raporte t'mira me Natashën, sepse në burg ka qenë me ish-burrin e Natashës, Lazar Stojanoviqin, një disident i burgosun në kohën e Titos. Në zyret e KMDLNJ-së vjen Antonella Riha, që është gazetare sot, për t'cilën kom shumë respekt edhe e kom shoqe shumë t'mirë. Ajo ishte aty dhe me thotë, "A mundemi me fol?" "Po", i them unë. E, thotë, "a je e interesume me punu me neve". Ata e kanë ditë që kjo punë ka nivel shumë të lartë të rrezikshmërisë dhe, a din, "Nëse ty t'pëlqën, mirë, nëse edhe neve na dukesh që ti përshtatesh, ne vazhdojmë bashkëpunimin". Ata zakonisht i kanë marrë informatat prej KMDLNJ-së. Mirëpo, Fondi e ka pasë metodologjinë e punës ndryshe. Mandej i kanë çu hulumtuesit, kanë dalë në terren. Kanë shku në mënyrë pak ma të detajume, i kanë marrë informatat në terren dhe pastaj të njëjtat i kanë analizu.

Kom pasë përkrahje nga babi, m'pat thonë "Duhesh me mësu shumë, me besu relativisht dhe me punu pa u ndalë. Ti këtë punë s'e ban veç për një rrogë, ti ke dyfish përgjegjësi, sepse kto informata na ndihmojnë për kauzën kombëtare". E përsëritke, "Qito çka pe bon, duhesh me bo sepse për me qitë një të vërtetë në dritë".

Ta kemi të qartë, ka qenë organizatë me bazë në Beograd. Në sytë e shumicës është qujtë organizata e Natashës. Atëherë, ma pak e kanë njoftë, po në '99-tën krejt e kanë njoft dhe e kanë ditë cka bon Natasha. Me Antonellën, kemi dalë në terren. Atëherë shumë akute ka qenë rrehja brutale e njerëzve, sidomos nëpër fshatra ma të thella, kinse për armëmbajtje pa leje. Dikush edhe ka pasë armë. Qaq brutale ka qenë policia, sa është dashtë njerëzit me dalë me ble armë e me i dorëzu, veç për mos me i rreh ma qashtu.

Në Mitrovicë kanë qenë disa raste që i kemi pas hulumtu, në disa fshatra të thella të Drenicës e në Ferizaj. Unë u hupa krejt nga kurioziteti dhe tmerret që i dëgjojsha e i shikojsha me sy të mi. Me Antonellën u ulshim nëpër oda. Ajo ka qenë gazetare fenomenale. Ma vonë, filloi me punu në '92-sh. Edhe Ivanka Kostiq m'kallxojke, për shembull, se si me marrë në pytje, disa teknika, si me reagu ne disa raste, se secili vend i ka specifikat kulturore. Fati që unë e kom qatëfar sensitiviteti dhe komunikoj me energji dhe mujsha shumë lehtë me prekë deri sa larg mundemi me shku kur flasim me viktima dhe familjarë të tyre.

E, për këtë proces, më është dashtë mandej me lexu literaturë, jo veç prej Fondit, por ka pasë edhe shumë konventa të të drejtave të njeriut. Për shembull, Nela m'i pruni

raportet e para që Fondi i ka publiku e ku i pashë edhe qysh e kanë monitoru themelimin e institucioneve paralele në Kosovë. Bile, edhe babi edhe këta të Odës Ekonomike ishin aty edhe i lexova unë krejt këto raporte. I kane mbledhë të dhanat prej shumë burimeve. Burimi i parë KMDLNJ-ja. "Bujku" ka qenë e vetmja gazetë si burim i dytë. Dhe, kanë dalë në teren e i kanë intervistu viktimat ose familjarët e tyne. Pastaj, LDK-ja ka pasë buletinin. Edhe Shërbimi Informativ i Kosovës, sepse i mbledhshin informatat edhe në formë të komunikatave i publikojshin dhe u dashtë qito tri burime t'para si desk research me i bo para se me dalë në teren. Mandej, aty-këtu ke shku e ke kqyrë a ka media të huaja. Normalisht, edhe serbët i kanë pasë mediat e veta, por ata nuk i kanë raportu incidentet, t'cilat i ka raportu "Bujku" dhe LDK-ja. E krejtë në fund, ke dalë në terren. Kur ke dalë në terren, osht' deshtë me hulumtu gjatë në fushën e të drejtave të njeriut, po ti nuk ke mujtë me shkru si p.sh. "Valla jom rreh brutalisht fizikisht nga policia edhe qaq…"

U dashtë me i ditë edhe cilat pyetje po i bon, të çfarë natyre. Për shembull "Çka është tortura? A ka torturë?" Edhe e lexon Konventën e Torturës. A e ka pasë Serbia të nënshkrume, se ne kemi qenë pjesë kushtetuese e Serbisë. A po përdorë dhunë? A po përdorë brutalitet? A ka torturë nëpër burgje? Çfarë lloj maltretimesh ka? A po lejohen hulumtuesit e huaj të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar ose Amnesty International me hy nëpër burgje me i monitoru? A po trajtohen sipas konventave të burgosurit? Krejt detajisht, detajisht është dashtë me i pytë.

Një metodë që kurrë s'e harroj, kur të arrestuarve ua kanë lidhë kambët, i kanë lidhë durët, i kanë shtri në formë horizontale edhe me dërrasa ja u kanë mshu nëpër taban të kambve qaq shumë, sa që ka ndodh kur shkojshim me i vizitu viktimat ose dëshmitarët, ata nuk mujshin me ecë se i kishin krejt kamët e ajuna prej goditjeve në shputa. Ose kur i kanë lidhë me pranga për radiatori edhe i kanë rreh. Një metodë që e kanë përdorë shumë në Ferizaj, u qujke "topli zec", kur në dy anët, kordonat e policisë, i urdhnojshin me kalu viktimat në mes të kordonit për me shku në qeli, edhe policët të mshojnë sa t'mujnë nga dy anët.

T'u punu për Fondin nuk kemi pasë qasje të lehtë në institucione, burgje, polici. Dhe, ka qenë shumë disadvatage sidomos kur na kanë ndalë në punkte policore, kur e kanë pa që je çikë e re, të hajshin me sy edhe policia, edhe njerëzit tanë. Ka ndodhë që, për shembull, kur e kemi kërku qasjen në burgje, ose kur pat kërku Natasha me shku te Ukshin Hoti, në burgun e Nishit, kemi pritë s'di sa për me shku. Edhe e kemi realizu tek në '97-tën, Mirëpo, ata e kanë ditë që jonë të monitorumë tonë kohën. Te dëshmitarët ke shku përmes nënkëshillave. Nuk ke mujtë te dëshmitari me shku veç qashtu. U dashtë ti me pasë dikond prej nënkëshillit ose është dashtë patjetër me e pasë një referencë. Unë jom kom çikë e qytetit, m'thojshin, "çikë e asfalltit", "Po shkon në katune, po don me marr informata". Me çfarë dyshime m'kanë kqyrë, dhe normalisht është dashtë me kalu ai procesi i verifikimit.

Në '98-tën veç eskalon situata. Deri në '97-tën jemi marrë me diskriminimin në arsim, jemi marrë me të kthyerit nga Gjermania, të cilët i malltretojke policia. Në momentin kur del UÇK-ja për herë të parë, aty janë ndier edhe ndasitë ideologjike, një anë LDK, e në tjetrën UÇK-ja. Ka ndodhë me pasë tensione sepse polarizohet pak skena politike në Kosovë në atë kohë. E sheh që krahu pacifist i qëndron besnik asaj që na nuk kemi kapacitet me e luftu Serbinë si një superfuqi ushtarake në rajon, në anën tjetër, e

sheh këtë krahun e demoralizumë, njerëzit e terrenit të cilët ose ikshin nga Kosova ose i merrnin armët me dalë në mal, sepse jeta e dinjitetshme ishte e pamundun. E shef me eskalimin e situatës, për shembull, punktet e policive sulmohen në disa fshatra apo lokacione si në Shipol, në Mitrovicë, në Deçan, ku gjujshin bombat, e policia filloi me reagu brutalisht, me u hakmarr. Pastaj, sulmet vazhduan me një punkt tjetër, në një stacion policor, në një pumpë të benzinës.

Në krejt këto kemi shku, kemi raportu. I kemi kërku viktikmat, dëshmitarët. Nëse ka ndodh, për shembull, një gjujtje e një granadës në një stacion policor, policia ka la lesh mandej në krejt katunin. Ka marr plot njerëz e në mënyrë brutale i ka malltretu. Na u deshtë me ditë shumë qysh dëshmitarët apo viktimat i ka trajtu policia? A iu ka dhanë një letër e cila ka shpjegu arsyen e bastisjes së shtëpisë apo marrjes në bisedë informative. Pastaj i pyetshim a u janë marrë informatat dëshmitarëve me dhunë, që në serbisht quhej Iznudjivanje Iskaza, apo në formë paqësore. Nxjerrja e informatës me dhunë është e kundërligjshme edhe ajo shkelje veç hynte në kategorinë e torturës.

U konë forma se cilat shkelje janë përfshi dhe ne e kemi ditë se çka duhet me pyet. Kur i ke marrë ti t'dhanat që jonë dashtë, je shku e ke bo incident report-in. Emri/ Mbiemri, data e intervistimit, vendi i intervistimit, i intervistuari ose viktima, ose dëshmitari, varet. Raporti mujke me qenë i gjatë pesë faqe, mujke me qenë i gjatë 15 faqe, varet prej incidentit, varet prej formës së dhunës që osht' ushtru në atë person. Dhe, ato mandej u duhke mirë me i analizu edhe me kqyrë nëse e kishe një grup të qasi raporteve ose një incident në fjalë që ka ndodhë, dhe në bazë të qatyne 10-15 dëshmitarëve të një incidenti, apo ma vonë edhe kur kanë ndodhë përleshjet me armë, ti është dashtë me bo analizë komplet.

Analizën e bojke ekipi, analistët të cilët kanë qenë eksperta në ligjin humanitar ndërkombëtar dhe ligjet e konventat ndërkombëtare, ato të cilat i ka nënshkru Serbia. Ato raporte, analiza kur kanë dalë, jonë shpërnda. Jonë bo si fletushka deri në dhjetë faqe ku lexohen ma shpejt.

Por ma vonë, kur filloi dhe eskaloi konflikti, i kemi bo në formë të raporteve. Përveç që jonë publiku, edhe jonë shpërnda përmes emailit, ato iu jonë shpërnda krejt organizatave humanitare, krejt ambasadave,. Ambasadat bukfalisht rrishin para dyerve të HLC-së se e dijshin që i kanë informatat, analizat e sakta dhe të përpiluara mirë.

Në '97-tën u hap zyrja e HLC-së në Kosovë. Në '96-tën, unë kom punu prej shpisë, kom dalë në terren, i kom marrë të dhanat, i kom përpunu, i kom dërgu dhe brenda pak kohe kom kalu në Beograd, deri sa i kom shkru dhe analizu ato të dhëna me kolegë. Në Kosovë në dy vitet e para kom qenë veç unë hulumtuese. Kur filloi lufta, KMDLNJ-ja filloi të ndihet e kërcënume nga FDH. U ndrru lidershipi në KMDLNJ dhe shpesh i bllokojke informatat. Me thanë troç, m'i bllokojke mu për mos me dalë, i urdhërojke nënkëshillat mos me komuniku me mu ose mos me dalë në teren me mu. Atëherë, unë shkojsha në LDK. I ndjeri Fehmi Agani e Abdyl Ramaj me thojke, "Hajde çika jem veç vazhdoje ti punën tone" edhe veç i urdhnojshin aktivistat e LDK-së në teren me m'hapë udhë.

Natasha vike shpesh, por jo në teren. Tjetër osht' kur vike Natasha me fol me Fehmi Aganin ose me Abdyl Ramën, të cilët na kanë ndihmu shumë, e tjetër me folë me mu. Por, me kohë u mësunë edhe me mu. Ka qenë sfidë edhe për mu, me ia spjegu Na-

tashës pse ndodhke diçka e tillë, sepse kur ajo vike në Kosovë, të njëjtit i shkyjshin kpucat me dalë në darka me të. Por, kjo thjesht ka ndodhë me disa në KMDLNJ, në një periudhë ndoshta ma pak se 2-vjeçare. Sepse, kur eskaloi situata në '98-'99, në trevat ku kish shumë shkelje masive të të drejtave të njeriut, atëherë kryetarët e nënkëshillave dhe aktivistat në rajone ku zhvilloheshin përleshjet e armatosura me qiri t'lypshin me shku në teren e me raportu, se krejt njerëzit e kishin në interes me shpërnda informatën sa ma larg që ishte e mundun.

Puna në dokumentimin e krimeve të luftës pat fillu në Qirez e Likoshan. Kur ndodhi ky rast, normalisht që së pari e dëgjon në lajme ose nëpër mjetet e informimit. Lajmin e parë që e merr është sa njerëz jonë të vramë ose masakruar. Qëllimi pat qenë, që sa ma shumë me ftu bashkësinë ndërkombtare me pa dhe me reagu, ne duheshim me ndriqu rastin tuj e hulumtu, me pa çka po ndodhë në Kosovë. Për shembull, informata thojke "Jonë të masakruar kaq veta. Jonë të torturuar kaq veta. Jonë të vrarë kaq veta". Eshtë deshtë me dalë menjëherë në terren, sa i ke pasë dëshmitaret okularë afër dhe me kujtesë të freskët dhe me i marrë dëshmitë e secilit.

Burimin e parë i kemi pasë lajmet. KMDLNJ e kishin informatën e parë. Për shembull, i thirrshin direkt gazetarët ose ma vonë na ftojshin edhe neve hulumtuesve të organizatave vendore e regjionale, por edhe p.sh. Human Rights Watch apo Amnesty International. Qasja jonë nuk ka qenë me bo lajmin, por me dokumentu. Na u kemi ikë senzacioneve e pompozitetit. Sa herë HLC-ja i ka ikë lajmit e ja kemi dhonë Human Rights Watch me plasu sepse atynëve s'kishin çka me ju bo.

Qirezi dhe Likoshani, ato dy masakra kanë ndodhë diku në të njëjtën kohë, gjatë shkurtit 1998. Aty ka ndodhë një vrasje makabre, ku kanë marrë pjesë edhe forca ushtarake, sepse ka pasë të shtëna edhe nga helikopterat dhe është gjujtë prej nalt. Vdes edhe një gru shtatzanë, t'u ikë edhe qajo ka qenë lajmi ma prekës.

Në filim, s'kemi pasë veturë dhe kudo kam shku me autobus. Një mori lajmesh, sa m'u parapërgatitë, i kom marrë në autobus, ose t'u ecë në kambë nëpër fshatra, deri te destinacioni dhe t'u u taku me njerëz. T'u i ndëgju, t'u i pytë kom msu shumë. I kom zhvillu edhe shqisat edhe mënyrën se sa larg mund të shkosh kur pyet. Megjithatë, kanë qenë disa specifika kulturore. E din, për shembull, kur osht' një gru e vetme çka të flet, kur është një gru me një burrë nuk folë ose rrallë folke pa e marrë aprovimin nga burrat e familjes. Kur jonë dy djemë ose djalë e çikë, djali flet e çika s'flet. E din, për shembull, kur o djali edhe baba, flet baba, djali s'flet.

Murat Musliut falë i kofsha, shumë e respektoj. Çka kom mbulu masakra krejt në Drenicë, Murat Musliu ka qenë alfa dhe omega. Pa ato, nuk kom dalë në terren. Dilke, m'pritke edhe shkojshim. Para Muratit ka qenë edhe Shaban Shala, ai ka vdekë. Me Muratin kom punu shumë, kom jashtëzakonisht shumë respekt për të. Ai ka pasë moral të lartë dhe kredibilitet. Ka pa shumë ma larg se sa politika ditore dhe e dike shumë mirë se si dhe pse ka ardhë deri te ngjarja dhe i dike gjithë dëshmitaret. Ka ndodhë, për shembull, i njëjti dëshmitar dy-tri herë ma ka dhonë informatën ndryshe. Ka ndodh për arsye të ndryshme. Njerëzit kanë qenë në traumë, panikë. Masi që të ndodhin incidentet - edhe kjo ka qenë njona prej arsyeve edhe prej përvojës e kom pa mandej - që në ato momente njerzit flasin me inercion. Në qat moment kur ndodhë incidenti, njerëzit edhe flasin ma shumë me emocion, por edhe si e shohin ngjarjen, po edhe janë të traumatizuar. Mbas një kohe të gjatë, ata e përpunojnë pak informatën.

Ndodh që edhe u këshillojshin nga ‘dikush’, “Qito nuk guxon, qito guxon me thonë”. Ka pasë dëshmitarë, që janë stepë dhe s’janë ndi të lirshëm me folë në situatat, kur gjatë intervistimit ka hy ndonjë person në odë, jo i veshun në uniformë, si civil, dhe krejt muhabeti ndrronte, krejt qasja e dëshmisë ndryshonte, sepse ai person është aludu ose autoritet ose pjesëtar i UÇK-së, ma vonë e merrshim vesh kush ka qenë. Jonë prezantu si UÇK. Ti ke mujtë me pa sepse e ke vrejtë që ka një pushtet tjetër në dhomë kur ka hy, edhe që njerëzit pak hezitojnë me thonë mendimin e vet dhe kjo ka ndodh në raste kur ngjarjet ose masakrat kanë qenë shumë makabre dhe ma sensitive.

Mu personalisht rasti që shumë, shumë m’ka prekë, ka qenë masakra në fshatin Obri. E di, që kur kom pasë ardhë në zyre, me zo pata kajtë. Ma shumë se rasti i Prekazit m’ka pasë prekë, sepse aty ka pasë të vramë gra shtatzanë, fëmi gjashtë muajsh, ka pasë dy gra, dy vajza të dhunume. Mënyra qysh ka ndodhë, qysh u masakru krejt ajo familje...

Po tash krejt i merr këto informata të detajizuara rreth vrasjeve, masakrës, torturës, vjedhjeve, dëmeve dhe e mëson edhe terminologjine që dëshmitarët e përdorshin. Ka qenë një ritual i përdorimit të fjalëve të ashpra dhe dhunës që është përdorë, por na nuk kemi guxu në atë mënyrë me shpreh edhe me e reflektu në raporte. Nëse dëshmojshin që NN personi, “është masakru”. Ti e din që masakër quhet veç vrasje e pesë apo ma shumë personave. “Na kanë torturu”. Tortura osht’ mënyrë brutale e dhunës fizike dhe specifikohet shumë mirë ne ligje dhe konventa. Ti i thu, “Qysh t’kanë torturu?” Ai thotë, “Vallahin ma mshoj një shuplakë edhe m’tha bjeri dokumentat”. Po, ti i ke marrë këto informata, po mandej i ke klasifiku. Ti nuk ke dialogu me viktimën as me dëshmitarin, veç ke marr sa ma shumë informata. Ose dëshmitari përgjigjet pas pyetjes që na ia parashtrojshim “A ia ke pa shenjat në uniformë?” “E pash vallahin, e pash një shenjë në uniformë një qen me dhomtë jashtë”. Ti e din që nuk ka uniforma me qen, por nuk reagon. Ti i dishe, për shembull, shenjat e uniformave edhe këto grupet paramilitare dhe ti e pytshe për me identifiku se çfarë njësish speciale kanë operu në atë rast, dhe pyetja shtrohej: “Çfarë shpeze a kafshe e kanë pasë stemën e uniformës në krah p.sh. policët, paramilitarët, çfarë ngjyre e kanë pasë uniformën.” Po, shpeshherë, edhe dëshmitarët pak nën traumë, pak edhe ndoshta mungesa e aftësive përshkruese, nuk përgjigjeshin saktë. Thjesht, nganjëherë ishin të stepun me këto pyetje, mendojshin që po bojmë hajgare ose po e teprojmë “Çka jonë këto pyetje?” Na e kishim shumë me randësi me ditë cilat grupe paramilitare kanë operu në atë rast dhe atë zonë. Cili zingjir komandues? Kush ju ka dhonë urdhnin? Se na mandej e analizojshim bashkë me kolegët në zyrën e Beogradit, se kush ka dhanë urdhër për atë operacion policor dhe çfarë forcash e armatimi është përdorë. Për shembull, cila strukturë në armatë? Cila polici? Se policinë e ka kontrollu Millosheviqi. Armatën nuk e ka kontrollu qaq lehtë Millosheviqi, e për këtë arsye, policët i kanë pasë duart e lira me bo çka të dojnë. Ndërsa ushtria, megjithatë ka hierarki dhe merr urdhra.

Na është dashtë shumë me filtru, tepër. Jo me e zbut, në asnjë mënyrë, por me e gjetë dhunën të cilën na e kemi pa që është perdorë në secilin rast. Qysh analizohet kjo dhunë karshi legjislacionit, cilat shkelje po ndodhin, se Fondi e ka mbledhë informatën dhe e ka analizu se cilat shkelje të randa, krime të luftës apo kundër njerëzimit po ndodhin. Në bazë të qatyne shkeljeve, ma vonë është bo aktakuza kundër zingjirit komandues të regjimit të Millosheviqit. Na është deshtë me qenë shumë seriozë dhe diligjent sepse këto informata jonë plasu në krejt botën.

Komunikimi është bo me telefon, po jo krejt kanë pasë telefona sepse sa kishin dalë në treg. Do toki-voki të mdhaja, të randa si tulla, telefona të mdhej. Ma vone u furnizuan edhe nënkëshillat në teren.

Numri i hulumtuese shkoi t'u u rritë. Në fund të vitit '97 na e punësumë një kolege edhe dy kolegë të tjerë sepse intenziteti i konfliktit u rrit dhe unë nuk mujsha me mbulu krejt Kosovën vetë. Na nevojiteshin edhe jurista me kry monitorimin e proceseve të montuara politike. Burra s'kemi pasë shume kohë. I patëm punsu dy kolegë, të cilët kishin frigë me dalë në teren. Dhe, e vërtetë është që ata ishin më të ekspozuar ndaj rrezikut. Dhe, kur e blemë veturën e zyrës, e kemi pasë shoferin burrë, për një kohë të shkurtër.

E, sfidat ma të mdhaja që i kemi hasë gjatë punës janë kanë deri sa i kemi kalu checkpoit-at njëherë. E ke kalu Komoranin, ke kalu në botën tjetër. Pastaj në Janjevë, pastaj atje në Zahaq, pastaj t'u shku për Deçan. Pastaj t'u shku në Gjakovë, po mendoj, krejt Kosovën e kom njoftë përmes checkpoint-ave dhe e keqja ma e madhe është që një kohë '98-'99, s'ka pasë shumë vetura që lirshëm kanë lëvizë nëpër rrugët magjistrale. Ishin rrugët e zbrazëta, edhe prej tenkave asfallti u pat prishë dhe, si sot e mbaj në mend, ishte tmerruese zhurma e rrotave të veturës se s'ka pasë vetura tjera. Ti i nijshe rrotat e veturës tone. Aty-këtu e ke pa ndonjë veturë të Kryqit të Kuq Ndërkombëtar dhe njëherë të KVM, e mandej të OSBE-së, që e monitorojshin kinse situatën. Në disa momente, jam ndi që jam në rrezik për jetë. Një herë në Gllogjan, pas sulmit të parë, në mars 1998. E dyta herë ka qenë kur na kanë ndalë policia, pasi ka ndodhë ngjarja e Qirezit dhe Likoshanit. U patëm nisë unë, Natasha, Lazar Stojanovic dhe Elmi Reçica, që ka qenë kryetar i KMDLNJ-së në Ferizaj. Kemi qenë në veturë t'u shku në Qirez, masi ka ndodhë masakra, në varrim të viktimave, dhe deri sa të tjerët kishin shku nga rrugët sekondare, andej ka Kroni i Mbretit e për Korreticë, për mos me kalu as ka Komorani. Policia e ka ditë që gjithë po shkojnë në varrim dhe për këtë arsye, njerzit i kanë ikë atij checkpoint-i. Na të katërtit drejt e në Komoran në drita të policisë. Nuk e di qaty qysh kemi pshtu. Policët që na ndalën s'kanë qenë të Kosovës, se e vrejshe prej aksentit që s'jonë serbë kosovarë. E thirri bazën, i tha "imamo ovde ekipu Bratstvo-Jedinstvo", (e kemi ketu ekipin e Vëllazërim-Bashkimit). Na majtën aty s'di sa minuta. Natasha dul prej kerrit dhe iu bërtitke. Iu kërcnunë Natashës. Lazari e majke qetësinë shumë mirë. Na u stepëm, unë e di që veç e kom pasë ulë qeshtu krytë edhe thojsha "Ja kanë me gjujt knej, ja kanë me gjujt anej". Pasi i morën instrukcionet me toki-voki nga Beogradi, policia na lëshoi me shku. E di që shkumë atje me vonesë, por mandej kur u kthymë, u kthymë nga rrugët dytësore, dhe jo kah Komorani.

Rasti i tretë, ka qenë kur m'kanë ndalë, kur ka qenë e rrethekume Gjakova, diku në pranverën e 1998, pasi ndodhi sulmi i forcave serbe në Rahovec. Na ka ndalë policia. Si sot e maj n'mend ftyrën e atij policit të gjatë, me sy të gjelbërt. E ka ndalë autobusin e aty ishim jo më shumë se 10 veta, kryesisht plaka me fëmijë e gra, dhe unë. Polici ma ka hallakat çantën. S'kom guxu me i kallxu që punoj për Fondin. M'i pa shënimet në bllok, dhe ma mori telefonin celular. Më pyeti "a je gazetare" dhe i thashë "po, jame gazetare për një radio suedeze". Kur i ka pa shënimet, të vizatume sukat/majet e kodrave, ku zhvilloheshin luftimet, ashtu qysh m'i patën dhonë dëshmitarët se ku osht' t'u luftu UÇK-ja, ku osht' policia, edhe ai polic dike pak shqip dhe më tha: 'Mirë i paske vizatu ku jemi na, e ku janë UÇK, po m'duket.

Situata tjetër ka ndodhë në Gllogjan, kur na kanë ndalë pas rastit të Gllogjanit, kur kom shku me hulumtu me kryetarin e KMLDNJ-së së Deçanit. Na kanë ndalë njerëz me maska, disa me çorape mbi kokë. Na kanë ndalë në qendër të fshatit e ne ishim tuj u kthy nga fshati Shaptej. Iu dukëm të dyshimtë e sidomos unë çka po lypi aty. Na pyetën pse kemi shku aty. Ka qenë një çikë, dikun moshatare e jemja, me uniformë të UÇK-së, edhe ajo ka qenë shumë brutale ndaj meje dhe kryetarit dhe fliste me tone të larta. Ai personi me maskë e ka marrë kryetarin, e ka futë dikund në një shtëpi/odë afër, nuk di çka kanë bo mrena, çka kanë folë ose a e ka rreh, veç e di që kur ka dalë kryetari i përcjellun nga personi me maskë, ka qenë shumë i tronditun dhe i zymtë dhe tha “Menjëherë duhemi me u largu prej ktuhit”.

Tjetër rast, kur kemi shku me Natashën gjatë bombardimeve, kur e murrëm lajmin që e kanë vra Fehmi Aganin. U nisëm për Dragodan. Te ura e Dragodanit, mu m’kanë nxjerrë prej kerrit, m’kanë thonë “hajde ti me neve”. Natasha filloi me bërtitë “ajo nuk shkon kërkund pa mu”. Mu më urdhnoi “Hin n’kerr”. Ata kanë qenë civilë serbë lokalë por të veshun policë. U nijshin krismat përreth, edhe Natasha ka qenë shumë e ashpër me ta. Iu tha, “Jo s’guxon, ajo s’vjen me juve. Merrmëni mu, jo ato”.

Fondi nuk u marr me format tjera të abuzimeve, përpos torturës, vrasjes e kështu me rradhë, po kemi hasë edhe në të përdhunimeve. Rasti ma konkret ai i Obrisë, i kanë pa dëshmitarët gratë edhe të përdhunume, të deshuna edhe të vrame. E kur kanë ndodhë raste tjera, që nuk kanë qenë në mandatin tonë, i raportonim. Po, unë kom qenë e trajnume me i hetu llojet tjera të krimeve, por jo me të përdhunuarat/it. Duhesh me qenë e trajnume, me i investigu ato krime. Shumica e rasteve të tilla kanë ndodhë ma shumë gjatë kohës së bombardimeve dhe pas. Ne nuk kemi pasë mandat apo kapacitete me i trajtu ato, por i kemi raportu t’paktën si raste. Janë raportu si dy të përdhunuara në rastin e Obrisë. Përveç masakrës, përveç vrasjes së një shtatzane edhe fëmisë gjashtëmuajshe, ka pasë edhe përdhunim... Bile njona prej motrave ka qenë, më duket, me aftësi të kufizuara.

***

Unë kom punu deri sa ka fillu bombardimi, edhe pak ma shumë, deri në fund të bombardimit, sepse kur kom dal prej Kosovës, kur ka ardhë Natasha Kandiq edhe m’ka nxerrë prej këtu, unë kom shku në Beograd përmes Bujanovcit. Edhepse, patëm tentu me ikë nga Maqedonia. Jemi nisë nga Prishtina, me 29 mars 1999, kur shkumë në kufi të Maqedonisë e pamë një lumë të gjatë të kerreve t’u pritë me hy e tuj u maltretu qytetarët nga grupe të ndryshme policore e paramilitare, jemi kthy mbrapa. Jemi nisë kah Bujanovci e që ka qenë shumë rrezik. Falë Savës, vozaqit, të cilin Natasha rasisht e ka gjetë edhe e ka pagu shumë për me ardhë deri në Kosovë, ne kemi shpëtu. Kemi shku në Beograd, kemi qëndru nja dy-tri ditë në karantinë në banesë të Natashës. S’kemi guxu me dalë, sepse atje ndryshe përjetohej lufta. Kur u vra Bajram Kelmendi me dy djemtë e tij edhe Fehmi Agani, ishte një sinjal lufte speciale që edhe të tjerët nuk kanë me kalu lehtë. Mandej kemi kalu në Mal të Zi, në Rozhajë. Aty kom punu me dëshmitarë, me viktima të Kosovës. Prej Rozhajës, jom kthy prapë në Beograd. Në zyren e Fondit në Beograd kom fillu me punu, por s’kisha fokusim. Mbas dy dite, ka ardh vojna policia, ka shku te Natasha, e ka kërcenu Stefanin, djalin e saj. Mandej, kanë ardhë në zyre. Çka ka folë me Natashën nuk e di, se s’më ka tregu kurrë, veç e di kur ka hi Natasha shumë e shqetësume n’zyre edhe m’ka bërtitë e m’ka dhanë urdhër që të njëjtën mbramje, me ikë me minibus për Budapest.

Në Budapest jetonte dhe punonte një ish koleg i yni. Ai punonte për European Roma Center. Natasha as nuk me jepke arsyetim, “veq dushesh me ikë”, me thonte. Unë atë natë në dymbëdhjetë të natës jom nisë për Budapest. Në Budapest, pak m’kanë bo problem autoritetet hungareze, sepse ka qenë një konsenzus i veçantë me vendet përreth që mos me lonë shumë kosovarë me ikë, për shkak të disbalansit demografik. Gjitha vendet fqinje, disi i frigoheshin depopullimit edhe destabilizimit. Dhe kom qëndru dy javë në Budapest. E kom ble biletën mas dy jave, se e disha që s’kom çka me bo në Budapest. Veç me i hulumtu serbët, që nuk dojshin me luftu dhe dezertojshin në Budapest. Aty e kom taku Ivankën, ish-kolegën teme.

Pas dy jave në Budapest, kom thonë “Po kthehna në Shqipni”. E kom ble biletën, jom shku n’Tiranë. Jom paraqitë te disa familjarë të babit, kusherinj t’largët. Jom paraqitë në AFOR. Me ata, pas gati një jave, kom kërku me m’futë në listë me shku në Kukës. Atje, ish situata kaotike, kish refugjatë shumë dhe s’dojsha me nejtë në Tiranë. Shkova te Elza Ballauri në Albanian Human Rights Center, me i ndihmu. “A mundesh me i ndëgju refugjatët nga trevat e ndryshme të Kosovës dhe me i transkriptu”, m’tha, se kish marr deklarata prej refugjatëve, prej zonës së Dukagjinit, por kish edhe prej Drenicës. Përmes trupave të KFOR-it arrita me shku në Kukës, me helikopter Appache. Për herë të parë hypa në helikopter dhe ka qenë një përvojë e bukur në krejt atë tollovi. Unë aeroplanat s’i du, por në helikopter ke shumë interesant.

Në Kukës kom filllu me punu me Paullin nga Amnesty International. Mandej, fillova me përkthy për një gazetare. Fred Abrahamsi më kish propozu një gazetare të New York Times, e cila quhej Elisabeth Bumiller. Ajo i kërkonte gratë e dhunume edhe asaj i kom ndihmu pak me i gjetë nëpër kampe, tri apo katër gra, por ka qenë shumë e vështirë. Deri sa ka ardh data 12 qershor, edhe kom pasë hy me trupat e NATO-s në Kosovë, në Prizren.

Ndjekja e dijes: Një (ri)kthim profesional

Gjatë bombardimeve, fatmirësisht telefoni kurrë nuk u ndal te na, për dallim prej shumë shtëpive tjera dhe meqenëse prindrit e mi edhe motra kanë qëndru në Prishtinë tonë kohën, ai telefon ka qenë m’duket shpëtimi i tyne. Saje atij telefoni, ata kanë marrë shumë informata dhe në të njëjtën kohë, i kanë informu të tjerët dhe mu. Unë i kom thirrë çdo ditë, edhe ata krejt çka kanë dëgju m’i kanë dhonë infot e dorës së parë. Bile e maj në mend, Albinin kur e kanë burgosë. Babi ka qenë shok shumë i mirë me Zaimin dhe Motra, Mimoza, më tregojke çka osht’ bo me Albinin e me familjen e tij. Gjithashtu, Adem Demaçi dilke shëtitke nëpër rrugë dhe shpesh i kanosej rreziku.

Babi kur m’patë thonë “Nora, e kanë marrë Albinin, duhesh me informu Annën, duhesh me informu Natashën”. Natasha sa herë ka ardhë në Prishtinë, gjatë bombardimeve, ka fjetë te Mimoza, te motra, dhe kështu që shkëmbimi i informatave ka qenë permanent gjatë gjithë kohës së bombardimeve. Kështu që, ai telefon ka shpëtu shumë jetë sepse Natasha reagojke menjëherë.

Para se me fillu bombardimet, unë veç pata apliku në shumë shkolla ndërkombëtare, me i vazhdu studimet. Qysh se kish fillu lufta në ’98-’99. Dhe, ato ditët e para të bombardimeve, smujsha me dalë në zyrë sepse gjithçka u blloku, s’kisha qasje në e-mail, as kurgjo. Anna më thirrke çdo natë, edhe i thom, “Anna, qiky osht’ fjalëkalimi i emailit

të lutem hyn aty çdo ditë dhe shih çka po më vjen". Ka qenë 27 mars edhe Anna atë mbramje po më thotë "I am going to read this". Edhe po ma lexon "You have been admitted to Harvard Kennedy School". Pata qajtë prej gëzimit, por ti e merr atë informatë po s'e dishe a ki me dale prej aty e gjallë, s'disha as me u gzu. Thojsha, "Çka ka lidhje që jom pranu" edhe plus çfarë scholarship-i ma kishin dhonë. Thojsha "Ska lidhje, unë kom me vdekë qetu".

E qajo po m'duket m'shtyjti edhe ma shume me i thanë Natashës, kur kom kajt ni natë, "Natasha ndoshta edhe unë kom me vdekë ktu". Ja bojsha "Po du diçka me bo". S'disha çka me bo me energji. Kur, ma ka bo "Nora, unë ty kam me t'nxjerrë prej aty, rri e qetë dhe ta dish që të du shumë". O kurrë bre, kurrë, s'kom me harru, shumë i kom borxh. Edhe prindrit i ka vizitu tanë kohën gjatë kohës së bombardimeve. Edhe prindrit e mi shumë kanë qenë falenderues ndaj saj dhe plot shoqeve të mia aktiviste, si 'Grate në të Zeza' në Beograd.

Në fund të gushtit kom shku në Amerikë e kam qëndru në studime atje një vjet e një muaj. Po mandej prej Harvard-it shkova edhe një summer school, në Krakov me New School University. Në Harvard, si profil i studimeve kom qenë e pranuar ne MPA, po mandej kom kalu në International Relations and Human Rights se qajo m'flejke edhe ka qenë përvojë e jashtëzakonshme. Para se me shku në Amerikë, gjatë verës së 1999 në Shkup, njoftohem me Samantha Power, që më kishte rekomandu Anna Husarske. Samantha pat ardhë për me bo një hulumtim për një gazetë dhe sa pat qëndru në Kosovë, ka fjetë te motra, Mimoza. Edhe në rekomandim, Samantha ma pat shkru, shumica i studiojnë shkeljet e të drejtave të njeriut, e ti i ke përjetu në kurriz-in tand dhe ti ke sjellë shumë ma shumë se që literatura mund të ofrojë. Ka qenë e jashtëzakonshme përvoja që e kam pasë nga tereni dhe gjitha ato frustrime të cilat pastaj i kristalizojsha përmes teorive të ndryshme e ku mundohesha me gjetë situatën në të cilën ne si popull jemi gjetë. Qajo konfidenca e terrenit, çka unë e kom msu sa kam punu ne Fond, unë thom edhe mos me m'pasë pagu Fondi kurrë hiç, ka qenë e mjaftueshme veç përvoja dhe dija që e kam nxanë. Ato që i kom msu në teren, nuk i mson ti në libra. As journals, as profesorat shumica s'i kanë përjetu.

Në 2001, filloi konflikti në Maqedoni. Atë nuk e kom mbulu, por kom punu pak me disa hulumtues e gazetarë. Mirëpo, nuk kom qenë e involvume brenda dhe mandej filloi konflikti edhe në Preshevë e Bujanovc. Në këtë kohë me një konferencë për Reconciliation që ish në Beograd, m'u afru një anglez e m'tha "Mu m'kanë caktu, Head of UNDP. Banka Botërore e ka dhonë një grant një milion dollarë për me e hap zyrën në Vrajë, me mbulu konfliktin atje. A mundesh me ardhë?" S'kish kapacitete, s'kish shoqni civile, s'kish media, s'kish kurgjo. Unë i disha gjuhët, të dyjat, edhe pranova. Ka qenë sfidë në fillim, por më vjen mirë që kom shku, sepse unë mendoj që jom gjindë mjaftueshëm qato dy-tri vjet sa filloi me u kriju njëfarë strukture e shoqërisë civile dhe medieve të lira tek shqiptaret e Preshevës e Bujanovcit.

Po mandej, prej atyhit sa herë kom qenë në terren, e kisha nevojën me u kthy në akademi. Akademinë, unë e kom pasë sikur me u strehu prej diçkafit. Si duket, terreni m'lodhke, m'u bo kjo shprehi. Hulumto në terren, kthehu mandej në akademi. E fitova bursën për këtë Masterin tjetër në Norvegji. Ajo në Norvegji ka qenë pak ma shumë se Master, sepse kom shumë ma shumë kredita se për Master. Plus, ka qenë me field work për katër mujë. Aty, m'u deshtë me ikë pak prej Ballkanit.

Gjithmonë e kom deshtë Lindjen e Mesme edhe gjithmonë kom dashtë me u marr e me bo comparative studies, mes Balkanit dhe Lindjes se Mesme. Edhe mandej, ika në Izrael për me hulumtu atje në lidhje me left social movements. Prapë kishte të bënte me lëvizjet shoqërore pas intifadës së dytë. Krahasimet kanë qenë, çka na ka shty neve, për shembull, me luftu, me çfarë ideologjie kemi protestu, cilat kanë qenë të përbashkëtat dhe të veçantat e lëvizjeve shoqërore dhe paqësore këtu te na në Ballkan, në përgjithësi, jo vetëm në Kosovë, me ato të Izraelit.

Prej Norvegjisë mandej prapë jom kthy. Kom punu nja dy vjet në UNDP, në një projekt interesant. Por ato dy vite m'u deshtën me marrë veten dhe me etablu vetën në një Kosovë t'pasluftës sepse gjithçka kishte ndrru. Ndërkohë Natasha m'bojke tanë kohën presion "Nuk ka kurgjo t'lehtë me bo" dhe duhesh me u kthy kah fusha jote. Ajo veç e kish mendu idenë e KOMRA-s dhe Drejtësisë Tranzicionale. Kom hezitu shumë se e kom ditë çka m'pret. Shumë kom hezitu, edhe nja dy vjet m'u kanë deshtë me e mendu se a jam e gatshme me i hy asaj avanture. Fillova me u angazhu rreth KOMRA-s që nga Forumi i parë që u mbajt në tetor 2009 në Prishtinë. Aty kthim mbrapa s'kishte. U ktheva prapë aty ku e kisha lënë. Vizioni ka qenë me formu një Komision Regjional që do t'i dokumentonte krimet e kryera gjatë luftërave në ish-Jugosllavi. Ideja ka qenë me mbulu të njëjtën periudhë kohore sa kanë zgjatë luftërat në ish-Jugosllavi, të njëjtën periudhë që e ka mbulu edhe Tribunali i Hagës, nga 1991 deri në 2001. Meqenëse viktimat e etnive të ndryshme nuk kishin besim në politikat e liderëve të vendeve ku jetonin, krijimi i një Komisioni Regjional do të rimëkëmbte dinjitetin e viktimave të luftërave dhe familjareve te tyre, njëherit do të krijonte regjistrin e humbjeve në njerëz dhe në dëme ekonomike.

KOMRA-n e kanë mendu, e pastaj inicu dhe themelu, Natasha Kandiq, Mirsad Tokaqa dhe Vesna Tersheliq. Këta kanë qenë tre, nga Beogradi, Bosna e Hercegovina dhe Kroacia. Unë kam ditë diçka, por nuk i kom ditë t'gjitha detajet. Natasha insistojke që "nevojitet mund, ka me qenë sfidë, por na vyjnë njerëz me përvojë". I dike deri dikund, kapacitetet që i ka ndoshta edhe mendojke që edhe unë mundem me qenë aset i mirë. Menjëherë në fillim të vitit 2010, nën presionin e shumë aktivistëve nga Kosova, por edhe të disa donatorëve, u pa e udhës që edhe Kosova të ketë një qendër që do të ishte e regjistruar në Kosovë e të merrej me drejtësinë tranzicionale, njëherit të ishte anëtare e KOMRA-s. Unë, jo me dëshirën time të plotë, mora këtë obligim ta themeloj Qendrën për Hulumtim, Dokumentim dhe Publikim, CRDP, dhe vazhdova të punoj rreth çështjeve të drejtësisë tranzicionale që prekin shoqërinë kosovare. Unë kam udhëhequr këtë qendër deri në 2016, dhe më pastaj, menaxhimi i saj është bërë nga kolegët e mi. Qendra ka ekzistuar deri në 2020.

.

Po, nuk jom distancu. Unë jom plotësisht e angazhuar, por tash jo vetëm në nivelin e Kosovës, tash punoj në aspekt pak ma të gjerë regjional edhe tutje. Punoj, nga perspektiva e hulumtimit, ma shumë në aspektin teorik, por edhe atë praktik. Mendoj që na kemi bo mjaftueshëm, por kjo s'do me thanë që s'duhet me vazhdu me punu dhe duhet me ditë që na po punojmë për gjeneratat e ardhshme. Na duhet gjithçka mirë me dokumentu dhe me lanë në letër për hir të gjeneratave të reja.

Por, a jemi në gjendje me u ballafaqu sinqerisht me të kalumën? A jemi në gjendje me pytë veten qata 2000 serbë dhe joshqiptarë qe kanë qenë të vramë, a jonë qytetarë të Kosovës? Po, pse na nuk lypim llogari, ata kanë qenë civilë. Pse na nuk lypim llogari për të zhdukurit serbë, por vetëm për shqiptarë? Po, ata, a jonë qytetarë të Kosovës dhe mbi të gjitha, kanë qenë civilë, kur janë privu nga jeta? Edhe ata dikush i ka kidnapu me dhunë. Këto jonë ato pytjet një million dollarëshe, që na si shoqni po hezitojmë me i shtjellu. Po sillemi rreth e rreth, por nuk po i prekim dhe këtu, thom, nuk po du me vnu faj, sepse na përgjegjës jemi krejt qytetarët, por mendoj që ndoshta ka mungu pak edhe guximi ma i madh i vetë aktivistëve për të drejtat e njeriut në Kosovë dhe këtu në radhë të parë flas edhe për veten.

***

Mendoj që njerëzit e kanë një lloj fati që iu prinë dhe që iu trason rrugën. Me siguri që me pasë qenë edhe koha normale, por edhe shkolla normale, edhe unë si plot miq të mi e kisha përfundu arkitekturën dhe nuk e di se ku kisha përfundu sot. Në atë kohë e pata besu shumë që një shkollë e mirë të çon përpara. Meqenëse unë kyçem në çështje shoqërore, të cilat, me apo pa deshirën time, më kanë përfshi, unë 85% kam qenë e fokusuar me vazhdu tutje dhe mos mu kthy mbrapa. Puna e mëtutjeshne, trajnimet dhe shkollat tutje që i kam përfundu, ma kanë konfirmu që unë kam pasë aftësi për të cilat nuk e kam ditë që i kam.

E, nëse e kisha përfundu arkitekturën, a isha konë qitu ku jam sot, në kuptimin e puns gjatë '95-tës, '96, '97, e din, kur thonë, "fati në fatkeqësi". Në atë rrjedhë të ngjarjeve brutale, rrjedha u ndrru për shkak të situatës politike dhe unë jom sot kjo ku jom. Unë si një 20 vjeçare, a 18 vjeçare, andërr nuk e kom pasë që kom me përfundu ktu ku jom sot. Por, ndërprerja me dhunë e një andrre që e kam pasë, ka qenë edhe motivi dhe inspirimi im kryesor me vazhdu tutje me u trajnu, shkollu dhe perfeksionu në punën që e bëj sot e 27 vite. Kur pyetja më bëhet për arkikteturën e ndërprerë, unë e mendoj që kjo përvojë mu më ka shty mos me u ndalë së shkolluari tash e gati 3 dekada. Pas luftës, gjithë semestrat dhe provimet e dhëna në arkitekturë, mu përkthyen në kredita në shkollat tjera ndërkombëtare që i vijova. Njëherë në Amerikë, pastaj në Norvegji, prapë në Amerikë, pastaj në Kanadë, etj.

Qiky ekspozimi i skajshëm, si me thonë, ndaj përvojave traumatike edhe dokumentimi që e kam bo, e impakti që ka pasë në mu, pikë së pari në formimin professional, po ashtu edhe në ato emocional. Një karakteristikë që e kam pasë dhe mendoj që ka ndiku që me qenë e paanshme dhe profesionale, është fakti që unë gjatë kohës së hulumtimit, kam mujtë me u shkëputë emocionalisht nga përkatësia etnike, në mënyrë

që me kry intervistimin, investigimin profesionalisht. Unë, kur kom bo hulumtime, komplet e kom zhveshë veten prej kush jom dhe çfarë përkatësie etnike kom. Kom hi pa emocion, edhe pa kurrëfar interesi politik me kry atë hulumtim, përkundër faktit që viktimat kanë qenë të përkatsisë time etnike. Jam mundu deri në asht më e zhvesh qatë fenomen, me e zbërthy atë fenomen dhe me i hulumtu edhe motivet pse ka ardhë deri te ajo që ka ndodhë. E, kjo m'ka bo shumë ma resilient. Përkundër faktit që unë jam impulsive edhe që kom shumë nivel të naltë të empatisë edhe që e ndjej kur njerëzit vujnë, prapë jam njeri, sa e ndieshme, po aq edhe e fortë dhe stabile. Në anën tjetër, si duket ka qenë mekanizëm mbrojtës ky, përndryshe s'kisha mujtë me qenë e suksesshme. Komplet, metaforikisht, ka qenë sikur me bo një premje. "Tash qatë Norën tjetër e len atje", edhe kur kom dalë, ka qenë një Norë tjetër. E kom marrë, e kom hulumtu rastin, e kom zbërthy, kom ardh në zyrë dhe e kom analizu. Kur e kom kry ato, mandej ia kom nis me kajtë, me vujtë, mandej m'ka ardhë keq, e kom vesh atë Norën tjetër dhe kam vazhdu tutje. Këtë aftësi e kom diskutu edhe me shumë sociologë edhe me shumë psikologë tjerë. Ky mekanizëm ndoshta mu ka zhvillu edhe si mekanizëm mbrojtës për me m'lanë me punu mirë në terren. Ama edhe shumë kom analizu. Tepër, gjithçka kom analizu, gjithçka, dhe jam mundu me reflektu dhe me punu pak edhe me ndjenjat e mia.

Ndërsa sot, Nora sot jeton thjesht me dijën dhe përvojën që e kom. Nuk muj me u anku sepse unë ja kom ofru vetit një lluks, nëse muj me qujtë, ku jetoj thjesht prapë duke punu si konsulente e pavarur, prapë jom në fushën ku unë ndihna shumë okay, që ka t'boj me të drejtat e njeriut dhe ballafaqimin me t'kalumën. Kam arritë të dal jashtë kufijve të Kosovës edhe me kapacitetin e përpilimit të dokumenteve që janë ma teknike si studime të fisibilitetit, strategji të ndryshme institucionale e organizative, hulumtime të natyrave të ndryshme, impaktet sociale, etj. Kom fillu me dalë prej Kosovës, përkundër faktit që ka shumë racizëm në regjion, por edhe në Evropë, përkundër faktit që si kosovare e kam shumë të vështirë me depërtu. Unë e kom fatin qashtu me u ballafaqu me sfida, por bash aty jam ma e fortë se luftoj me t'gjitha forcat.

Megjithatë, kadal po mendoj që unë nuk duhet me u dorëzu sepse e di që ka nevojë, ka nevojë dikush atje jashtë për një Nora Ahmetaj. Po m'duket që i vyej edhe Kosovës, por Kosova po mendon që unë s'pi vyej asaj. Megjithatë nuk ndalem. Gjithmonë mendoj që përvoja duhet me u shpërnda edhe duhet me u ndihmu të tjerëve, që me kalu pak ma lehtë se unë, me jau trasu udhën të tjerëve. Unë e kom bo gjithçka me shumë mund, me punë, vetëmohim dhe me përkrahjen e prindërve. Pengesa hala kom edhe kom pasë gjithmonë. Po lehtësia dhe pavarësia që unë e kom me komuniku me njerëz pa dorëza, ku kërkujt nuk i thom faleminderit për ndihmë, dhe ku e thom mendimin tem troç, nuk paguhet me asgja. Në një shoqni, ku gjithçka varet prej politikës dhe njerëzit bojnë kompromise të dhimbshme me mbijetu, unë jam e lirë nga ajo, se mbijetoj me punën dhe forcat e mia. Kështu që, kisha pasë dëshirë me pasë ma pak pengesa, por kjo është jeta. Kështu që, unë jam mirë.

Nga një fëmijëri dinamike te lufta për drejtësi dhe shërim në pasluftë

Në këtë intervistë të jashtëzakonshme, Feride Rushiti na flet për jetën e saj plot sfida dhe triumfe. Ishte rritur në një ambient ku kanë dominuar meshkujt, me pesë mixhallarë e dy vëllezër, por Feridja ishte e fortë, e pavarur, me shpirtin e lirë dhe me tipare lidereje, që nga fëmijëria.

Fëmijëria e lumtur e dinamike, edukimi dhe shkollimi i shkëlqyeshëm, por rinia e trazuar dhe e pasigurt, kalitën personalitetin e Ferides dhe e përgatitën atë për kohën e luftës së tmerrshme, por edhe për pasluftën e shërimit të plagëve e traumave të paimagjinuara, sidomos të gruas kosovare. Trazira, demonstrata, detyrim për t'u shkolluar jashtë vendit, pasiguri, luftë e tmerrshme, por dorëzimi nuk ishte opsion për doktoreshën Feride Rushiti. Prandaj, nga një vajzë rebele, e talentuar dhe me shpirtin e lirë, u bë një grua lidere, një grua luftëtare për kauza të mëdha, një grua model.

Me një frymë lidershipi dhe një dëshirë të pakufi për të ndihmuar të tjerët, doktoresha tregon për betejat personale dhe kolektive që formësuan rrugën e saj. Kjo intervistë është një portret frymëzues i një gruaje lidere, që qëndron si simbol i forcës dhe humanizmit.

Feride Rushiti

Fëmijëria

Unë jam Feride Rushiti, me profesion mjeke, e lindur më 12 shtator 1970. Kam jetuar në Gjilan deri në vitet ’90, pastaj vazhdova studimet në Prishtinë, në Fakultetin e Mjekësisë, deri në vitin 1993.

Si familje, jemi me origjinë nga Ramabaja, një fshat në komunën e Medvegjës, në Serbi, të njohur ndryshe si “muhaxhirë”. Familja jonë u shpërngul nga Ramabaja gjatë valës së dëbimit të shqiptarëve në vitin 1887. Në atë kohë, ata u vendosën në Gilan, që ishte kryesisht një vend moçalor dhe me tokë të papunueshme. Për të mbijetuar, u desh të shpërnguleshin në fshatra të ndryshëm, duke kërkuar kushte më të mira për të punuar dhe për të rindërtuar jetën nga fillimi. Pasi nuk gjetën mbështetje të mjaftueshme për shkak të mungesës së hapësirës në Sllakoc, ata u vendosën përfundimisht në Draganc. Aty linda unë, por në moshën tri vjeçare, u zhvendosëm në lagjen “Dheu i Bardhë” në Gilan, aty ku jemi vendosun na si familje bashkë me axhallarët po edhe kushëritë e afërt e, që vazhdojnë me jetu aty. Një lagje që edhe sot e kësaj dite ruan strukturën e rehatin dhe qetësin.

Gjyshi im, Bajrushi, ishte njeri i urtë dhe i qetë, jo tip që bënte zhurmë apo që përfshihej në konflikte. Nga ana tjetër, babai im ishte një figurë që gjithmonë mbështeste të tjerët dhe i ndihmonte kur ishte e nevojshme, megjithëse ishte i përmbajtur në fjalë. Ndërsa nëna, Habibja, ishte nga fshati Makresh i Ulët, që është afër Dragancit, por edhe familja e saj ishte e dëbuar nga trojet e tyre nga fshati Llapashticë e komunës së Medvegjës në Sërbi. Ajo ishte një grua që punonte shumë, fjalëpak dhe flijohej për të gjithë.

Në familjen tonë ishim tre fëmijë. Unë isha fëmija i dytë; vëllai i madh, Naseri (tani i ndjerë), ishte gjashtë vjet më i madh, ndërsa vëllai tjetër, Ylberi, ishte shtatë vjet më i vogël se unë. Naseri ishte i gjallë, dinamik dhe plot humor. Ai këndonte bukur dhe i binte çiftelisë, ndërsa më vonë u bë motorist dhe pasi i ndërpreu studimet, përfundoi jashtë vendit. Ylberi, në krahasim me Naserin, ishte më i tërhequr, me një natyrë të qetë, por gjithmonë i afërt dhe i dashur me të gjithë i cili më vone kreu stomatologjin. Baba ka punu në Perëndim dhe ishte nga të parët që ka marr rrugën e gurbetit në vitin 1969.

Fëmijërinë time e kalova në një mjedis ku dominonin meshkujt, duke qenë se në familje kisha pesë axhallarë dhe dy vëllezër. Kjo më dha një lloj përparësie për t’u ndjerë e barabartë me burrat dhe për të zhvilluar aftësi të forta komunikimi dhe bashkëpunimi. Pavarësisht nga këto rrethana, ne ishim një familje me mirëqenie ekonomike mesatare për standardet e asaj kohe. Shtëpija jonë dallohej, sepse dyert e saj ishte të hapura për 24 orë për këdo që kishte nevojë, qoftë për një filxhan sheqer, një biber, apo ndihmë tjetër.

Lagjja jonë ishte një vend i qetë, dhe marrëdhëniet me fqinjët ishin më shumë familjare sesa thjesht fqinjësore. Edhe sot, ajo lagje ruan të njëjtën strukturë. Si

fëmijë, ne ishim të lirë dhe të lumtur, duke pasur një jetë të thjeshtë, por të mbushur me aktivitete. Për shembull, për me luajt volejboll, e kemi përdorë telin e ziles në oborr si rrjetë. Në lagje, isha shoqe e ngushtë me Meritën, Fazilën, Fatlumën dhe Xhemilen. Gjithashtu, kam pas kushërina dhe shoqe të tjera në lagje.

Një moment që e mbaj mend qartë ishte përdorimi i telefonit në shtëpinë tonë, gjatë periudhës së ish-Jugosllavisë. Ai telefon, me numrat që duhej t'i rrotulloje, u bë një qendër komunikimi për të gjithë lagjen, sidomos për ata që kishin anëtarë të familjes jashtë vendit. Shtëpia jonë u shndërrua në një postë për thirrje, dhe kjo tregon frymën e hapur dhe ndihmën e pakushtëzuar që karakterizonte familjen time.

E gjithë kjo periudhë e fëmijërisë sime më formësoi si person dhe më dha bazat për të ndërtuar një jetë të suksesshme, të bazuar në vlera familjare, solidaritet dhe përkushtim ndaj të tjerëve.

Fëmijëria ime, më kujtohet si gjithmonë aktive dhe e angazhuar. Pothuajse tërë kohën isha në udhëheqësi të shkollës dhe në organizimin e aktiviteteve shkollore. Kam marrë pjesë në gara krahinore të ish-Jugosllavisë në lëndë si histori, matematikë, biologji dhe aktivitete të Kryqit të Kuq. Në histori, zura vendin e parë në Gilan dhe Prishtinë. Në Kryq të Kuq mora vendin e dytë në nivel krahinor, deri sa në klasën e shtatë, në biologji zura vendin e parë në gara komunale në Gilan dhe vendin e tretë në gara krahinore në Pejë.

Përtej mësimit të zakonshëm që ofronte sistemi shkollor, gjithmonë kam pas kërkesa që të zhvilloja veten më tej në fusha shkencore dhe organizative.

***

Në familje, shpesh kisha një rol dominant që nuk ishte i zakonshëm për moshën time. Mendimi im merrej parasysh, ndoshta sepse babai im shpesh më kishte privilegju. Kujtoj se isha ndryshe nga shoqet e mia që duhej të kërkonin leje për me dalë, unë vetëm njoftoja që po dal. Për shembull, kam udhëtuar në gara në Pejë dhe Deçan, një arritje e madhe për kohën, duke pasur parasysh vështirësitë e udhëtimit dhe kufizimet e asaj kohe. Kjo liri më dha një ndjenjë të hershme vetëbesimi dhe pavarësie.

Shkollën fillore e përfundova në "Selami Hallaçi", një shkollë e re në lagjen Gavran të Gjilanit. Fillimisht isha në një klasë tjetër, por më vonë u transferova në klasën e mësuesit Muharrem Nevzati, një figurë që më frymëzoi shumë. Ai nuk kishte fëmijë të tij dhe shpesh më merrte për dore duke biseduar gjatë rrugës për në shtëpi. Marrëdhënia mes mësuesit dhe nxënësit atëherë ishte shumë më e distancuar se sot, por ai ishte i përkushtuar dhe vlerësonte si nxënësja e tij. Vite më vonë, ai e kujtonte me krenari kohën kur isha nxënëse e tij.

Mësimi për mua ishte gjithmonë prioritet. Nga klasa e katërt deri në të tetën, mbaj mend të kem pasur vetëm dy mungesa. Biologjia ishte lënda ime e preferuar, por gjithashtu shfaqja interes të madh për matematikën dhe shkencat ekzakte. Kujtoj si mësuesja ime më notonte me "pesëshe me yll", një vlerësim që shkaktonte zili mes shokëve të klasës.

***

Në gjimnaz, isha pjesë e aktiviteteve të Kryqit të Kuq, ku vazhdova të arrija suksese. Grupi ynë gjithmonë zinte vendet e para në gara komunale dhe krahinore. Në një rast, kishim mundësinë të udhëtonim në Sllloveni për gara, por situata politike e kohës nuk na e lejoi.

Pas përfundimit të gjimnazit të përgjithshëm dyvjeçar, vendosa të vazhdoj në shkollën e mesme të infermierisë për dy vite, për t'u përgatitur për Fakultetin e Mjekësisë – ëndrrën time të vetme. Aktivitetet në Kryq të Kuq më ndihmuan të fitoja njohuri praktike, si për shembull lidhjet e plagëve dhe ndihmën e parë, të cilat i aplikoja edhe në lagjen time. Shpesh ndodhte që, para se të dërgoheshin te mjeku, njerëzit vinin te unë për ndihmë.

Një fëmijëri ndryshe dhe dashuria për librat

Biblioteka e qytetit ka qenë vendi ku kam kaluar shumicën e kohës, dhe kam lexuar pothuajse të gjithë librat që ajo kishte. Kujtoj kur në një Panair të Librit në Gilan, së bashku me vajzën e dajës tim, Fatushen, i blemë dy romane për të rritur “Heshtja e armëve” e Ramiz Kelmendit dhe “Pse” e Sterjo Spasses, dhe kur shitësi na tha se këto romane nuk janë për moshën tonë, ne i thamë se po i blejmë për motrën, e vetmja mënyrë që ne mund ti blenim këto dy romane.

Përtej leximit, zhvillimet politike të kohës ishin gjithashtu pjesë e jetës sonë. Demonstratat, përndjekjet dhe burgosjet ishin shqetësime që nuk kam mund ti injoroj. Nga gjyshja ime kam mësu shumë gjëra për të kaluarën e vështirë të grave gjatë pushtimeve. Ajo shpesh na tregonte përvoja tronditëse dhe na këshillonte të ishim të kujdesshme se si të dukeshim apo si silleshim, duke na mësuar mbrojtje për të cilën, më vonë, kuptova se kishte një histori të thellë dhe personale.

Këto kujtime dhe përvoja më kaliten si personin që jam sot, duke më dhënë forcën dhe qëndrueshmërinë që më ka shoqëruar gjatë gjithë jetës.

Në kohën kur jetoja në Gilan, qyteti ka qenë një qytet me industri të zhvillume. Shumë njerëz punonin në këto fabrika kolektive të ish-Jugosllavisë, ndërsa një pjesë tjetër e konsiderueshme kishin shku për me punu jashtë vendit. Kjo situatë ekonomike i jepte Gilanit një përparësi krahasuar me komunat e tjera.

Mirëpo, situata filloi me ndryshu pas suprimimit të autonomisë së Kosovës dhe diferencimit ideo-politik. Fabrikat filluan të mbyllen dhe njerëzit, përfshirë të rinjtë, nisën të shpërngulen masivisht jashtë vendit, veçanërisht për t’i shpëtuar rekrutimit të detyrueshëm në armatën e ish-Jugosllavisë. Në atë kohë, edhe njëri nga axhallarët e mi, më i vogli, iku, dhe pjesa më e madhe e të rinjve të familjes, përfshirë vëllanë tim të madh, ishin largua jashtë vendit. Babai, si vëllai më i madh në familje, u kthye për t’u kujdesur për të afërmit.

Adoleshenca e hershme dhe Fillimi i demonstratave

Rinia ime e hershme u zhvillu në një periudhë të trazume, kur filluan demonstratat dhe përgatitjet për luftë në vitet 1989-1990. Si aktiviste e Kryqit të Kuq, kisha rastin me ndihmu në organizimet për përgatitjet e luftës. Mjekët dhe vullnetarët mblidheshin në shtëpi të caktume, ku trajnoheshim për të dhënë ndihmë mjekësore, si injeksione apo ndërhyrje të tjera të nevojshme. Këto përgatitje kishin filluar që në vitet 1988-1989 dhe, ndonëse lufta do të vinte më vonë, ne ishim gjithmonë në gatishmëri.

Në atë kohë, lajmet e Zërit të Amerikës ishin burimi jonë kryesor i informimit për zhvillimet në Kosovë. Më kujtohet si sot greva tetëditore e minatorëve të Trepçës në shkurt të vitit 1989, kur edhe ne si nxënës u solidarizuam me ta duke hyrë në grevë urie nëpër shkolla.

Marsin e atij viti, të njohur si “Pranvera e Përgjakshme”, nuk do ta harroj kurrë. Demonstratat shpërthyen kudo, përfshirë edhe Gilanin. Ishte një ndjenjë e çuditshme; fillonin tre veta të protestonin dhe pa vetëdije, bashkoheshe me ta. Nuk mendojshim as për rrezikun e mundshëm, thjesht përziheshim me masën.

Kjo periudhë mori nga familja jonë një prej djemve më të mirë – Agim Rushitin, djalin e axhës së babës tim, me të cilin kemi qenë shumë të lidhur, masi nanat i kemi pas kusherina dhe po ashtu Agimi ka qenë gjeneratë me vëllaun tim Naserin dhe të dytë janë rrit bashkë, duke e pas boksin si sport të përbashkët. Agimi ishte një i ri i dashur, shtatlartë dhe atdhedashës. Atdhedashurinë e tij e shprehte përmes poezisë dhe përfshirjes aktive në demonstrata. Ai u vra tragjikisht me një plumb në ballë gjatë përleshjeve me policinë serbe, dhe ishte një ndër rastet e para të varrimit me shumë njerëz, sepse të vrarëve në demonstrata, varrimi u bëhej vetëm më anëtarët e ngushtë të familjes. Ndërsa regjimi serb përpiqej ta paraqiste si një vrasje nga shqiptarët, familja jonë dhe shoqëria e përjetuam rëndë këtë humbje.

***

Takimi im i parë me dhunën sistematike të ish-Jugosllavisë ishte gjatë helmimeve masive të nxënësve në shkollat e Kosovës, në vitin shkollor 1989-1990. Atë ditë që filluan helmimet e qova vëllaun Ylberin në infektivë. Pasi gjatë shkollës së mesme të mjekësisë e mbanim praktikën në repartin infektiv, e çova menjëherë atje, pa kalu nëpër procedurat e tjera të zakonshme. Aty pashë një situatë të jashtëzakonshme: spitali nuk kishte asnjë pacientë dhe stafi mjekësor nuk guxonte të konfirmonte asgjë.

Më kujtohet si sot kur i thashë stafit mjekësor: “Vëllai im është helmuar.” Ata nuk pranun as ta regjistrojnë rastin dhe nuk jepnin asnjë përgjigje të qartë. Pas matjes së tensionit dhe disa kontrolleve të shpejta, u detyrova ta ktheja në shtëpi. Spitalet në atë kohë ishin të menaxhume kryesisht nga serbët.

Në shkollë, ndonëse shihej që nxënësit po helmoheshin, drejtoresha serbe insistonte që gjithçka ishte në rregull dhe që nxënësit duhej të ktheheshin në klasa. Pas disa orësh, nisën rastet e para të helmimeve në ndërrimin e pasdites. Helmimi nuk ishte individual, por masiv, dhe nxënësit reagonin në grup me simptoma si humbje ndjenjash, të vjella dhe dhimbje të forta koke. Kjo situatë krijoi një panik të madh dhe ndjenjë të thellë pasigurie.

Këto ngjarje lanë një gjurmë të pashlyeshme në mendjen time. Ishin vitet kur fillova të kuptoja thellësisht padrejtësitë e mëdha që po i bëheshin popullit tonë dhe sikur fillova të ndieja përgjegjësi për me i ndihmu në çfarëdo mënyre që mundesha.

Sfidat tona nuk kan përfundu me kaq...,sepse vendi ishte i trazum dhe demonstratat n’qytet vazhdojshin.

Nga shkolla e mesme drejt fakultetit

Në vitin 1990 përfundova shkollën e mesme. Gjysmëvjetori i fundit ishte një periudhë intensive për përgatitjet për testin e pranimit në Fakultetin e Mjekësisë, që ishte jashtëzakonisht i vështirë. Në të njëjtën kohë, situata politike dhe sociale ishte kritike; atmosfera e luftës veç ndihej.

Arrita të kaloj testin e pranimit dhe pas regjistrimit në Fakultetin e mjekësisë u shpërngula në Prishtinë, ku mora një banesë në Breg të Diellit dhe fillova studimet. Por edhe këtu, atmosfera e luftës mbizotëronte.

Pas vitit 1991, Fakulteti i Mjekësisë u mbyll. Ishte koha e diferencimeve ideopolitik dhe spastrimeve të profesorëve nga Universiteti i Prishtinës. Pasi mbarova vitin e parë akademik, vendosa të shkoj në Zvicër te vëllai im Naseri, me shpresë që t'i vazhdoja studimet atje pasi edhe Naseri kishte shume dëshirë që te vazhdoja andej. Megjithatë, unë kurrë nuk e kam dashur jetën jashtë vendit dhe, sapo dëgjova për hapjen e Fakultetit të Mjekësisë përmes sistemit paralel, vendosa të kthehem në Kosovë.

Mësimet vazhduan në mënyrë ilegale, fillimisht në një shtëpi private në Aktash, ku studentët qëndronin shpesh ulur në dysheme. Ne gëzoheshim kur arrinim të kishim një ulëse, edhe nëse ishte prej druri. Profesorët ligjëronin nën kërcënimin e vazhdueshëm të policisë serbe. Më vonë, ligjëratat u zhvendosën në lagjen Vranjevc, te shkolla "Asim Vokshi", ku një pjesë e praktikës zhvillohej në ambulancat e Shoqatës Humanitare "Nënë Tereza".

Në këtë periudhë, bashkë me shoqet e mia Melitën dhe Suzanën, vendosëm të banojmë në këtë lagje, në shtëpinë e një teze të nënës sime, për me qenë më afër mësimeve dhe për të ndjekur ëndrrën tonë për mjekësinë.

Jeta studentore në Tiranë

Kur lëndët fillun të zgjerohen më shumë në mjekësi, e pashë se praktikisht nuk mund ta vazhdoja më në Kosovë. Atëherë mendova për herë të dytë të shkoja jashtë vendit, por ndryshe nga më parë, Shqipëria më tërhiqte më shumë. Në njëfarë mënyre, ai vend m'u duk si shpresa ime e vetme për të vazhdu ëndrrën për mjekësinë.

E thirra Melitën, cimeren time, dhe i thashë: "A po vjen?" Ajo pranoi, duke më thënë: "Baba jem e ka ni lidhje atje." Me të dhe prindërit e saj morëm rrugën për në Shqipëri. Fillimisht qëndruam te Salih Basha, i cili na ndihmoi të gjenim një vend për të banuar dhe vazhduar jetën andej kufirit.

***

Mbaj mend mirë përvojën e parë kur hymë në Shqipëri në verën e vitit 1993. Kishim idealizuar Shqipërinë si një "Zvicër të vogël," siç e kishim mësuar nga librat dhe këngët. Por kur arritëm në Elbasan, gjithçka dukej ndryshe: ndërtesat me qeremidet ishin mbulu nga bloza gri, për shkak të ndotjes nga metalurgjiku aty pranë. Ishte një

thyerje e madhe emocionale për mua.

Tirana ishte një botë tjetër. Në fillim, gjërat e vogla më befasuan, siç ishte shishja e prerë e Coca Cola-s e përdorur si vazo për lule mbi televizor. Shumë gjëra që për ne ishin normale, për shqiptarët e asaj kohe dukeshin si luks. Për shembull, në disa familje, banjoja përdorej për gjithçka: për t'u larë, për të gatuar pasul, madje edhe për të bërë raki rrushi. Rrugët nuk ishin të sigurta; shpesh ndodhte që të na ndalnin dhe të na kërkonin orët, xhaketat apo sende të tjera.

Megjithatë, solidariteti mes nesh, grupit të parë të studentëve kosovarë në Tiranë, na mbajti të fortë. Edhe pse çdo ditë dëgjonim lajme për vajza që zhdukeshin apo për raste të trafikuara, ne ia dolëm të qëndrojmë të lidhur dhe të ndihmojmë njëri-tjetrin.

Pas regjistrimit në vitin e tretë të Fakultetit të Mjekësisë, u vendosëm në Qytet Studenti. Në fillim, kushtet ishin të vështira. Dhoma jonë ishte shumë e vogël dhe dyshekët binin shpesh në dysheme, sepse krevatet nuk kishin korniza. Më vonë, arritëm të marrim një dhomë më të madhe, ngjitur me dhomën e drejtoreshës së konviktit.

Në atë kohë, vëllai im Naseri, i ndjeri, që sillte ndihma për Shqipërinë me një pilot zviceran, na solli dyshekët e parë dhe disa sende të tjera. Dhoma jonë u bë model dhe vajzat e tjera nga Shqipëria vinin për ta parë.

Jeta studentore në Tiranë ishte krejt ndryshe nga ajo në Kosovë. Marrëdhënia mes studentit dhe profesorit ishte shumë më e hapur. Profesorët pinin kafe me studentët dhe krijonin një qasje miqësore. Në Kosovë, profesorët ishin si mite: të paarritshëm dhe të distancum. Kjo mënyrë e re e komunikimit më mahniti dhe më motivoi të përqafoj më shumë lirinë intelektuale që ofronte Tirana.

Gjatë studimeve në Tiranë, sidomos në vitet e para, komunikimi me familje ishte shumë i vështirë. Në Kosovë vija duke përdor rrugët ilegale, qoftë nga Maqedonia apo Mali i Zi. Shumë herë gjatë ardhjes në Kosovë apo shkuarjes në Shqipëri, e zakonisht ndodhte dy herë në vit, kemi rreziku për vdekje dhe shumë herë të pavetëdijshëm çfarë rreziku bartnim. Pasi, në pasaporten time kisha vulën e kalimit të kufirit me Shqipninë, rruga e vetme me u kthy në Shqipëri ishin rrugët ilegale me shumë rreziqe. Më kujtohet një herë kur babai më la në duart e një fshatari nga Presheva, që transportonte cigare ilegale me gomar. I pagoi 50 marka për t'më ndihmu që të kaloja kufirin për në Llojan të Kumanovës. Rruga zgjati dy orë nëpër male, duke u fshehur nga policia. Ishte një situatë e rrezikshme, por e vetmja mënyrë për të kaluar kufirin.

Se di se si e ka përjetu familja ime largimin tim në këtë mënyrë, e sidomos baba, që më la në duart e një personi të panjohur.

Kur arrita në Tiranë, gëzimi im i madh ishte që mora me vete magnetofonin. Çdo mëngjes, në orën 6:00 ose 7:00, dhe çdo mbrëmje, në orën 18:00, dëgjoja "Zërin e Amerikës." Pse? Sepse dija që në atë moment, në Kosovë, nëna dhe babai im po e dëgjonin gjithashtu. Ishte si një lidhje e heshtur mes nesh. E kujtoj me emocion momentin kur dëgjova Ibrahim Rugovën duke thënë: "Së shpejti, kosovarët do të pinë kafe në Kukës brenda dy orësh." Ishte një moment shprese, që na motivoi të ëndërrojmë për një të ardhme më të mirë.

Komunikimi përmes telefonit ishte po ashtu i vështirë. Duhej të telefonoja vëllaun në Zvicër që ai t'i njoftonte prindërit se isha mirë. Por edhe mes këtyre sfidave, kishte momente të paharrueshme kur mblidheshim me studentë nga Shqipëria dhe Kosova për të diskutuar dhe ndarë përvojat tona. Debatonim për periudhën e Enver Hoxhës dhe për atë që po ndodhte në Kosovë. Këto çaste mbeten ndër më të vlefshmet e asaj periudhe.

Profesorët në fakultet na kuptonin edhe pse shpesh e kishim të vështirë të shprehnim mendimet tona në gjuhën standarde. Kishte një solidaritet të jashtëzakonshëm mes studentëve nga të gjitha viset shqiptare jashtë Shqipërisë, me organizime, manifestime dhe takime të ndryshme. Shokët dhe shoqet nga Shqipëria nuk harrohen kurrë për mbështetjen dhe ndihmën e tyre kurdoherë që kishim nevojë. Më kujtohet një pranverë, kur disa nga studentët kosovarë, që kujdeseshin për ne si për motrat e tyre, na hidhnin nga ballkonet tufa me lule mimoza dhe na ftonin për çaj, sikur të ishim pjesë e familjes së tyre.

Shtëpia e bacit Salih Basha ishte një vatër e përbashkët për të gjithë studentët e Anamoravës. Aty i ndanim hallet dhe gëzimet tona, dhe ajo shtëpi mbeti gjithmonë një simbol i solidaritetit mes nesh.

Gjatë studimeve në Tiranë, shpesh isha adresa e parë për ata që vinin nga Kosova për ndihmë mjekësore. Qoftë për të gjetur banesë, për t'i dërguar në spital, për t'iu gjetur mjekun e duhur, apo edhe për t'i përcjellë në aeroport, gjithmonë bëja çfarë mundesha.

Dhe për qudi, edhe tani në këtë kohë jam adresë e pare për ndihmë, për të afërmit e mij nga Gilani që vijnë në Prishtinë, biles telefonata ne orë vona të jan njëfar alarmi dikush është sëmuar e unë duhet ti bëjë një zgjidhje…

***

Po ashtu, aty takova ushtarët e parë të UÇK-së që stërviteshin në Milot. Ata ishin të përkushtuar për një kauzë më të madhe dhe shpesh ndaja momente me ta, duke ndjerë peshën e përgjegjësisë për atë që po ndodhte në Kosovë.

Demonstratat dhe periudha e revolucionit të vonuar

Demonstrata e parë që përjetova në Tiranë ishte më 1 tetor 1997. Ajo u organizua në mbështetje të lëvizjes studentore në Kosovë, të udhëhequr nga Albin Kurti dhe Unioni i Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Ne, studentët kosovarë në Tiranë, u bashkuam dhe organizuam tubime në sheshin Skënderbej, duke i kërku qeverisë shqiptare të ishte më aktive në raport me Kosovën.

Por 1997-ta ishte gjithashtu viti i anarkisë së paparë në Shqipëri, pas rënies së skemave piramidale. Ishte një kohë kaosi dhe pasigurie totale. Armët kaluan në duart e popullatës civile dhe më nuk kishte siguri. Për ne si studentë kosovarë, kjo ishte një periudhë e rrezikshme dhe e paqartë dhe bashkë me Melitën, vendosëm të largoheshim nga Tirana.

Rruga drejt Kosovës ishte e mbushur me vështirësi. Kaluam kufirin e Malit të Zi me dokumente të falsifikuara, duke u paraqitur si qytetare nga Fieri dhe Berati. Kur po linim Shqipërinë, ndjenja e pasigurisë dhe pamundësisë për të ditur çfarë do të ndodhte më tej na rëndonte shpirtin. Kur mbërrita në Gilan, familja ime ishte e tronditur për atë që po ndodhte në Shqipëri dhe për rrezikun që kisha kaluar.

Pasi situata u stabilizua disi, në vjeshtën e vitit 1997, u ktheva në Tiranë për të përfunduar studimet. Rruga për në Shqipëri kalonte nga Maqedonia, dhe kujtoj si sot ndalesat e frikshme në rrugën e Elbasanit. Policë të maskuar dhe të armatosur bastisnin autobusët dhe krijonin një atmosferë ankthi. Megjithatë, arritëm të riktheheshim në konvikt dhe t'i përfundonim dy provimet e fundit.

Diplomimi në vitin 1997 ishte një kulm i emocionit dhe gëzimit për mua. Ishte më shumë se një arritje akademike; ishte një triumf ndaj vështirësive dhe sfidave të pafundme. Më kujtohet që gjatë periudhës së diplomimit situata në Shqipëri ishte ende kaotike, me siguri të cenuar dhe frikë të përhershme. Fishkëllimat e armëve ishin të zakonshme dhe popullata civile ishte e armatosur.

***

Profesorët shqiptarë si Pandeli Qino mbeten në kujtesën time për mbështetjen dhe përkushtimin e tyre. Ai kishte një dashuri të veçantë për Kosovën dhe pas luftës erdhi të ndihmonte në Kosovë. Ishte një shembull i solidaritetit dhe i ndihmës pa kushte.

Gjuha standarde shqipe ishte një sfidë për ne kosovarët, por profesorët ishin të duruar dhe na ndihmonin të përmirësoheshim. Për ne, gjithçka kërkonte më shumë përpjekje dhe punë.

Pas diplomimit, dërgova dokumentet për nostrifikim në Serbi, për të vazhduar specializimin në Prishtinë apo Sarajevë, me qëllim të vazhdimit të specializimit. Por situata politike në rajon u përkeqësua dhe mundësia e Sarajevës mbeti e parealizuar.

Kështu u ktheva prapë në Tiranë, u pranova për specializim në ORL, por pasioni im i vërtetë ishte gastroenterologjia. Ishte një lidhje personale, ndoshta për shkak të gjyshit tim, që ishte mjek popullor dhe trajtonte sëmundjet e stomakut, apo për shkak të problemeve të dajës tim me stomakun. Edhe pse kisha ëndërruar kirurgjinë plastike, lufta dhe nevojat urgjente të njerëzve më bënë të ndryshoj drejtim dhe të përqendrohem në një fushë që kishte më shumë rëndësi për ta. Në fund, vendosa të vazhdoj në gastroenterologji dhe e fillova praktikën në Qendrën Klinike Universitare në Tiranë.

Angazhimi në Tiranë pasi shpërtheu lufta në Kosovë dhe puna si vullnetare në Shqipëri

Kur filloi Lufta e Kosovës, unë isha një mjeke e sapodiplomuar dhe në specializim për gastroenterologji në Spitalin Universitar të Tiranës. Rrethanat e asaj kohe kërkonin veprim të menjëhershëm, dhe unë u angazhova si vullnetare për të ndihmu në trajtimin e viktimave civile të luftës dhe të zhvendosurve nga Kosova. Puna ime vazhdonte në spital deri në orën 1:00 pasdite, dhe më pas angazhohesha në ndihmë humanitare.

Pas masakrës së familjes Jashari në mars 1998, situata në Kosovë u përkeqësua ndjeshëm. Dukej qartë se vendi po shkonte drejt një lufte të hapur. Ndihmat humanitare, kryesisht ilaçe, filluan të mbërrinin nga vendet perëndimore në Tiranë, por shpesh ato vinin në sasi të mëdha dhe të papërshtatshme për përdorim. Kjo krijoi një nevojë urgjente për t'i organizuar dhe shpërndarë furnizimet në mënyrë të përshtatshme.

Së bashku me një grup vullnetarësh, ndamë furnizimet mjekësore në doza më të vogla për t'u shpërndarë te paramedikët në terren ose për t'u futur fshehurazi në Kosovë. Disa prej ilaçeve i dorëzuam në Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QSHRT), një organizatë që ndihmonte shqiptarët e Kosovës të zhvendosur në Shqipëri. Ambientet e qendrës ishin modeste, me vetëm disa dhoma të vogla që shërbenin si ambulancë, sekretari dhe administratë. Aty lëmë dy pako me ilaçe për t'u shpërndarë atyre që kishin më shumë nevojë.

Në gusht të vitit 1998, pas dorëzimit të ndihmave, më kërkuan të angazhohesha si farmaciste, pasi qendra nuk kishte farmaci funksionale. Fillimisht, puna ime përfshinte vetëm menaxhimin e ilaçeve, por me rritjen e numrit të shqiptarëve të zhvendosur nga dhuna në Kosovë, roli im u zgjerua. Së bashku me shoqen time të dhomës, Melitën, e cila po specializohej për psikiatri, u përfshimë edhe në ofrimin e ndihmës mjekësore dhe psikosociale për të zhvendosurit.

QSHRT kishte një ndikim të madh për të mbijetuarit e torturës dhe viktimat e luftës. Shumë prej historive dhe pamjeve që dëgjoja më tronditnin. Fëmijë të plagosur, gra të traumatizuara dhe të moshuar që përballeshin me sëmundje të ndryshme ishin pjesë e përditshmërisë sonë. Por nuk kishte kohë për t'i përjetuar emocionalisht ato që dëgjoja; nevoja për ndihmë mjekësore dhe psikologjike ishte urgjente dhe e vazhdueshme.

Kur isha fëmijë, ëndrra ime ishte e thjeshtë dhe e madhe njëkohësisht: të ndihmoja njerëzit në nevojë, e admiroja Nënë Terezën dhe punen e saj humanitare. Netëve të gjata pa gjumë, e ndaja këtë dëshirë me shoqen e dhomës dhe kushërirat, duke imagjinuar se si një ditë do të bëja diçka për ata që kishin më pak fat duke menduar edher per të shkuar në Afrik. Nuk e dija se sa shumë jeta do të më shtynte drejt kësaj rruge.

Kur u gjenda në kampet e refugjatëve e sidomos në Kukës, ku dhimbja dhe vuajtjet dukeshin pa fund, ndjeva se ëndrra ime po merrte formë. Kukësi ngjante si një Kalkutë tjetër, me mijëra njerëz që kërkonin shpresë dhe ndihmë në mes të kaosit. Çdo ditë, përmes shërbimit për këta njerëz dhe angazhimit për të rikthyer një grimë dinjiteti dhe shprese, kuptoja pse e kisha nisur këtë rrugë.

Ajo që filloi si një ëndërr fëmijërore, tani ishte një mision jetësor. Përulësia dhe emocioni që ndieja, ndërsa dëgjoja historitë e tyre dhe mundohesha të bëja më të mirën për ta, më kujtonin se ndonjëherë, dhembja e të tjerëve është ajo që na bën më njerëzorë.

Deri sa punoja në QSHRT, Adrian dhe Kozara Kati, ishin një frymëzim për mua se si punonin me aq pasion me të dëbuarit nga Kosova. Ata vinin nga familje të persekutuara gjatë regjimit komunist dhe përkushtimi i tyre për të ndihmuar të tjerët më motivoi edhe më shumë.

Kur të plagosurit filluan të mbërrinin në spitalet shqiptare, shpesh i shoqëroja vetë për t'u siguruar që merrnin ndihmën e duhur. Kishte raste të plagosur rëndë, të rrahur brutalisht, apo të moshuar me sëmundje kronike. Ndonjëherë përballej me pengesa nga burokracia ose mungesa e burimeve, por gjithmonë përpiqesha të gjeja një zgjidhje.

Përvoja ime në atë kohë më mësoi se roli i një mjeku shtrihet përtej ofrimit të kujdesit klinik. Duhej të përfshihesha edhe në organizimin e furnizimeve, sigurimin e kushteve të banimit dhe ndihmën për ata që kishin më shumë nevojë.

Në dimrin e vitit 1998, shkova në Gilan për pushimet e fundvitit. Ishte një dimër i ashpër dhe bisedat në familje ishin të mbushura me shqetësime për luftën. Një ditë, ndërsa po pastroja borën në oborrin e shtëpisë, rrëshqita dhe lëndova rëndë klavikulën. Pavarësisht kësaj, kur më thirrën nga QSHRT për t'u kthyer, nuk ngurrova dhe në janar 1999, vetëm pak kohë pas masakrës së Reçakut, u riktheva në Tiranë. Atmosfera ishte e rëndë dhe plot zymtësi. Autobusët për Shqipëri ishin të mbushur me njerëz që udhëtonin në heshtje, e me lot në sy.

Pas rikthimit, fillova të punoja me orar të plotë në QSHRT. Puna me të zhvendosurit më mësoi rëndësinë e ndihmës gjithëpërfshirëse, që përfshinte kujdesin mjekësor, psikologjik dhe social.

Puna me refugjatët kosovarë në Shqipëri

Në fillim, angazhimi im ishte kryesisht në menaxhimin e ilaçeve. Por me rritjen e numrit të të zhvendosurve, fillova të merresha edhe me gjetjen e banesave për ta e ndimë shëndetësore. Në atë kohë, Shqipëria nuk i quante formalisht kosovarët "refugjatë," çka nënkuptonte se ndihmat ndërkombëtare ishin të kufizuara. Kjo e përkeqësonte situatën për ata që kërkonin strehim.

Me kontaktet e mia, përpiqesha t'u gjeja banesa dhe të siguroja që ndihma humanitare të arrinte tek ata që kishin më shumë nevojë. Ishte një punë e vështirë dhe shpesh ndihesha e mbingarkume, por gjithmonë më motivonte mendimi se ndihma ime bënte një ndryshim për këta njerëz të pafajshëm që kishin përjetuar kaq shumë vuajtje. Por fatëmiresisht në at kohe edhe vëllau Ylberi mu bashkangjit cfar ma letesonte punen ne teren.

Kjo përvojë ishte një thirrje për t'u përkushtuar plotësisht në ndihmën për ata që kishin më shumë nevojë dhe formësoji tek unë rëndësinë e mbështetjes mjekësore dhe sociale për viktimat e luftës.

Angazhimi gjatë rritjes së fluksit të refugjatëve dhe puna në QSHRT

Pas janarit 1999, fluksi i refugjatëve dhe të zhvendosurve nga Kosova u rrit ndjeshëm, dhe kjo krijoi nevojën për të zgjeruar ekipin tonë në QSHRT. Fillova të kontaktoj studentët kosovarë që ishin duke specializuar në Tiranë, për t'i rekrutuar dhe përfshirë në organizatë. Së bashku me refugjatët, erdhën edhe shumë mjekë nga rajoni i Gjakovës, të cilët gjithashtu u punësuan në qendër. Për ta, puna në organizatë ishte një mënyrë për të kontribuar dhe për të mos u ndier se kishin lënë vendin në një kohë krize.

Ekipi u rrit rreth 23 veta, ku përfshiheshin një farmaciste, disa infermiere dhe shumë mjekë nga Kosova. Nga Shqipëria ishin vetëm katër mjekë: një neurolog, një psikiatër, një gjinekolog dhe një mjek i përgjithshëm. Të tjerët ishin kryesisht kosovarë. Të gjithë ishin të përkushtuar dhe të motivuar për të ofruar ndihmë, në një periudhë kur kërkesat për ndihmë mjekësore ishin të mëdha dhe urgjente.

Në atë kohë, Pallati i Sportit "Asllan Rusi" shërbente si një qendër pritjeje për refugjatët. Vizitonim refugjatët, i referonim në organizatë dhe i ndihmonim sipas nevojave. Më pas, hapëm një qendër tjetër pranë kampit të të zhvendosurve te Liqeni Artificial, e cila u bë një nga pikat më të mëdha. Gradualisht, u krijuan edhe qendra të tjera në Rrashbull, Shkallnur dhe Shkozet në Durrës, duke u zgjeruar vazhdimisht hapësira dhe shërbimet.

Shërbimet psikosociale ishin të panjohura për shumicën prej nesh. Trajnimet e para në këtë fushë i morëm nga IRCT (International Rehabilitation Center for Torture Victims), përmes ekipit të drejtuar nga Dr. Jens Modvig. Ata na mësuan konceptin e stresit post-traumatik (PTSD) dhe mënyrat për të komuniku dhe ndihmu personat e traumatizum. Më pas, me ndihmën e UNICEF-it dhe përvojave të sjella nga kroatët, mësuam si të punonim me fëmijët dhe të ofronim mbështetje për ta dhe familjet e tyre.

Në këtë periudhë, e angazhova edhe Melitën, shoqen time të dhomës, e cila më vonë u bë pjesë e ekipit psikosocial.

Shumë refugjatë vinin të sëmurë, të ftohur, ose me dhimbje fizike dhe emocionale. Gradualisht, me rritjen e kërkesave, fillova të punoj si mjeke. Kujdesesha për matjen e tensionit, dhënien e ilaçeve dhe referimin e pacientëve për ndihmë më të specializuar në spital.

Shefi i qendrës, Adrian Kati, më ofroi një pagë prej 120 dollarësh, një shumë modeste por e mirëpritur, pasi deri atëherë punoja si vullnetare. Përveç punës mjekësore, u bëra koordinatore e programit shëndetësor dhe punoja ditë e natë për të siguruar që çdo person të merrte ndihmën e nevojshme. Ishte një periudhë e mbushur me punë të pandërprerë, ku shpesh kaloja ditë pa pushuar dhe me një dietë të kufizuar. Aty mesova për here të pare se si duhet punuar me kompjuter e si duhet përgadite raporte dhe menaxhuar ekipe.

Angazhimi në Kukës dhe sfidat personale

Pas trajnimeve të UNICEF-it, më kërkuan të angazhohesha në Kukës, që ishte pika kryesore e hyrjes së refugjatëve në Shqipëri ishte gjithmonë e hapur për refugjatët. Shpesh kishim deri në 30 persona që u ndihmonim ose u ofronim strehim të përkohshëm. Përveç strehimit, kujdesesha për ushqimin dhe organizimin e tyre drejt vendeve të tjera.

Puna me ushtarët e UÇK-së ishte gjithashtu e rëndësishme. Shumë herë i shoqëroja në spital për kontrolle shëndetësore dhe përpiqesha t'u ofroja sadopak mbështetje morale. Puna me ta ishte emocionuese dhe sfiduese, duke parë vendosmërinë e tyre për të shkuar në front.

Pavarësisht përkushtimit tim në Shqipëri, shqetësimi për familjen time në Gilan ishte gjithmonë i pranishëm. Çdo mbrëmje i kërkoja vëllait tim t'i bindte prindërit të largoheshin nga Kosova. Në shkurt 1999, ata më në fund erdhën në Tiranë, të lodhur dhe të trishtuar për shtëpinë që kishin lënë pas. Ishte një lehtësim i madh t'i shihja të sigurt, por shqetësimi për familjen e gjerë që kishte mbetur në Kosovë vazhdonte.

Kjo periudhë ishte ndër më të vështirat dhe më të rëndësishmet e jetës sime. Angazhimi për të ndihmu të zhvendosurit dhe refugjatët ishte një thirrje për të dhënë gjithçka që mundesha, si mjeke dhe si njeri. Përvoja më mësoi rëndësinë e solidaritetit dhe përkushtimit për ata që kishin më shumë nevojë. Kjo kohë formoi bazat e angazhimit tim të mëvonshëm për të ndihmuar ata që kanë përjetuar trauma dhe vuajtje të papërshkrueshme.

***

Me rritjen e numrit të refugjatëve dhe të personave në nevojë, sidomos grave dhe fëmijëve, UNICEF-i më kërkoi të angazhohesha në Kukës. Vendimi për t'u larguar nga Qendra Shqiptare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QSHRT) në Tiranë nuk ishte i lehtë, pasi isha në një pozicion kyç, por ndjeva një thirrje të fortë për t'u bashkuar me ata që kishin më shumë nevojë. Shkuarja në Kukës ishte edhe një mënyrë për t'u ndjerë më afër Kosovës dhe për të ndihmuar në terren. Ishte një vendim që shkaktoi shqetësim te familja ime, sidomos te nëna, por gjithashtu ishte një hap i domosdoshëm për mua.

Në fillim të marsit 1999, me një ekip prej tre vetash nga UNICEF-i, udhëtuam drejt Kukësit me helikopter, pasi rruga nga Tirana deri në Kukës merrte 7-8 orë për shkak të gjendjes së keqe të rrugëve dhe situatës kaotike. Fluturimi ishte një përvojë e veçantë, por ajo që na priste në terren ishte akoma më sfiduese.

Gjendja në Kukës

Kukësi ishte shndërruar në një qendër pritjeje për mijëra refugjatë që vinin çdo ditë nga Kosova. Familje të ndara, gra me fëmijë të vegjël, burra të plagosun dhe të moshuar të rraskapitur mbërrinin me traktorë, autobusë dhe mjete të tjera transporti. Çdo minutë sillte një histori të re dhimbjeje dhe tmerri. Shumë prej tyre kishin përjetuar skena të tmerrshme: ndarje familjare, humbje të më të dashurve dhe dhunë të paparë.

UNICEF-i kishte organizuar ndihmë për refugjatët, duke u fokusuar kryesisht në gratë dhe fëmijët. Grupi im u vendos pranë xhamisë së Kukësit, ku shumë gra dhe fëmijë ishin strehuar. Xhamia shërbente si një strehë e përkohshme, por kushtet ishin të vështira: nuk kishte ngrohje, ushqimi shpërndahej në mënyrë të improvizuar dhe nata ishte e ftohtë dhe e errët. Në fillim, tri ditët e para ishin më të vështirat. E ndieja se isha e mbingarkuar emocionalisht, duke u përballur me dëshmi dhe skena të papërshkrueshme.

Në atë kaos, u detyrova të përqendrohesha dhe të forcohesha emocionalisht. Ndihmoja në identifikimin e rasteve më të ndjeshme, si gra të veja dhe fëmijë të ndarë nga familjet e tyre. Shpesh ndihmoja në organizimin e ushqimit dhe akomodimin e tyre, duke përballuar motin e ftohtë dhe mungesën e kushteve bazike.

Një shef i UNICEF-it më tha një herë: “Këtu nuk kemi kohë për të menduar ose për të të ndihmuar emocionalisht. Shih çfarë po ndodh jashtë,” duke më treguar masën e refugjatëve që ishin shtrirë në tokë ose po qanin. Ky moment më ndihmoi të kuptoj rëndësinë e qëndrueshmërisë dhe përkushtimit tim. Gradualisht, e gjeta fuqinë për të vazhduar, pavarësisht nga vështirësitë.

Shumë prej refugjatëve vinin të sëmurë, të plagosur ose në gjendje të rëndë psikologjike. Shërbimet mjekësore ishin të kufizuara dhe shumë herë duhej të improvizonim. Pas orës 5:00 pasdite, bashkë me një italiane nga UNICEFI grua me përvojë, shkonim në kufirin e Morinës për të ndihmuar refugjatët që mbërrinin aty. Përvoja ishte tronditëse, pasi ballafaqohesha me histori të dhimbshme të njerëzve që kishin humbur gjithçka dhe ishin të paqartë për të ardhmen e tyre.

Në të njëjtën kohë, dëgjoja tregime për solidaritetin e paparë të shqiptarëve, si ata që ofronin ndihmë përmes skafeve për të kaluar refugjatët në Itali ose Greqi, duke paguar vetëm për karburantin. Ishte një shenjë se, në momentet më të vështira, humanizmi mbizotëron.

Tri ditët e para në Kukës ishin ndër më të vështirat e jetës sime, por më ndihmuan të forcohesha emocionalisht dhe profesionalisht. Puna në terren më mësoi rëndësinë e mbështetjes, solidaritetit dhe përkushtimit. Edhe pse situata ishte kaotike dhe e pasigurt, ndihesha e motivuar nga fakti që po bëja gjithçka që mundesha për ata që kishin nevojë.

Në Kukës dhe më vonë, puna ime si pjesë e ekipit të UNICEF-it dhe si mjeke më dha një kuptim të ri për profesionin tim dhe rëndësinë e ndihmës humanitare. Kjo përvojë formoi jo vetëm angazhimin tim profesional, por edhe qëndrimet e mia përballë sfidave të mëdha dhe përgjegjësisë ndaj njerëzve në nevojë.

Përvoja dhe angazhimi në Kukës gjatë luftës së Kosovës

Gjatë kohës sime në Kukës, situata ishte kaotike dhe jashtëzakonisht sfiduese. Punova si mjeke, duke u përballur çdo ditë me dhimbje njerëzore dhe situata ekstreme, ndërsa me padurim prisja të merrja lajme për axhallarët dhe dajët e mi që ende ishin në Kosovë.

Xhamia në Kukës shërbente si një strehë për gratë dhe fëmijët. Çdo natë, ajo mbushej plot, dhe në mëngjes disa grupe zhvendoseshin drejt Tiranës ose vendeve të tjera. Nanat e kishin jashtëzakonisht të vështirë të gjenin hapësirë për fëmijët. Ato i shtrihnin në dysheme të ftohtë ose i mbulonin me ato pak batanije që kishin. Përpiqesha t'u siguroja batanije, të paktën për fëmijët. Ato gra jo vetëm që mbartnin dhimbje fizike dhe shpirtërore, por gjithashtu përballeshin me frikën dhe pasigurinë për burrat dhe familjarët e tyre të mbetur në Kosovë.

Për t'i larguar fëmijët nga traumat e përditshme dhe për të krijuar një ambient më të sigurt, fillova t'i angazhoja në lojëra dhe aktivitete të thjeshta. Organizoja aktivitet nga fëmijëria ime, duke improvizu lojëra që kisha luajtur dikur. Fëmijët kënaqeshin dhe përkohësisht harronin dhimbjet e tyre, ndërsa nanat ndiheshin të lehtësuara për disa orë.

Kur vinte buka, shpesh në kamionë, shpërndahej në mënyrë kaotike. Ishte bukë e fortë, pashteta dhe ndonjë biskotë me vitamina. Kushtet ishin të vështira dhe mungesa e ushqimit të ngrohtë ishte e zakonshme. Për nevojat mjekësore, kisha një aparat tensioni dhe ilaçe për fëmijë, të ofruara nga UNICEF-i. Për të rriturit, fillova të bashkëpunoja me "Mjekët pa Kufij," të cilët ofronin ilaçe dhe ndihmë mjekësore.

Një ndër rastet që më preku më shumë ishte një vajzë e vogël, e cila u gjet e vetme dhe pa prindër. Fillimisht menduam se të dy prindërit e saj ishin vrarë. Shumë organizata dhe individë, përfshirë RAI 1 dhe RAI 2, kërkuan ta adoptonin, por unë vendosa që ajo të mbetej me një familje nga Rahoveci, që ishte strehuar në një kamp italian afër kufirit. Pas shumë përpjekjesh, ajo arriti të ribashkohej me familjen e saj në Shkodër. Sot, ajo është një nënë e lumtur dhe e martuar.

Një ditë, kur ishte e pranishme Carol Bellamy, shefja e UNICEF-it nga Neë York-u, ajo mbeti e mahnitur nga organizimi dhe qetësia e fëmijëve gjatë aktiviteteve që zhvillonim. Pas intervistës sime me të, të nesërmen mbërritën dy helikopterë plot me lodra, të cilat u përdorën për t'i bërë aktivitetet më të strukturuara dhe fëmijët më të angazhuar.

Historitë e dhimbshme dhe strategjia e luftës

Shumë gra dhe fëmijë kishin përjetuar skena të tmerrshme. Një ndër strategjitë më çnjerëzore të luftës ishte ndarja e familjeve në autobusë të ndryshëm për t'i traumatizuar dhe për t'i bërë të ndjehen të pafuqishëm. Shpesh takohesha me gra që ishin dhunuar, por që fillimisht nuk guxonin të flisnin. Gradualisht, përmes bisedave, arrija t'i kuptoja dhe t'i referoja për trajtim mjekësor apo edhe kirugjik. Ato ishin të heshtura ,nuk flisnin nga dhimbja dhe turpi që I kishte kapluar.

Në këtë periudhë të vështirë, puna ime shtrihej nga organizimi i ndihmës mjekësore deri te mbështetja emocionale për gratë dhe fëmijët. Përkushtimi dhe solidariteti ishin shtytësit kryesorë që më mbanin të fortë përballë sfidave të përditshme.

Përvoja ime në Kukës më vuri përballë një realitet të hidhur: dhunën seksuale dhe traumat që vinin prej saj. Për herë të parë, u përballa me gratë dhe fëmijët që ishin viktima të dhunës, dhe fillova të kuptoj dimensionet e thella të kësaj tragjedie. Si mjeke por edhe nga Kosova, më thërrisnin për të intervistuar gra që kishin përjetuar dhunë, pasi besohej se si grua do të isha më e afërt dhe do të mund të krijoja një hapësirë të sigurt për to.

Pasojat e dhunës seksuale të luftës

Ishte e dhimbshme të dëgjoje historitë e grave që tregonin për mënyrën se si ishin trajtuar. Dhuna seksuale nuk ishte vetëm akt fizik, por shpesh shoqërohej me tortura të tjera, si plagosje me thikë, djegie dhe lënia e shenjave në trup. Shenjat ishin qëllimisht të dukshme, me një mesazh të qartë: të linin një kujtim të përhershëm të tmerrit. Për gratë ishte jashtëzakonisht e vështirë të flisnin, pasi ndiheshin të turpërume dhe të stigmatizume. Shpesh, ato fillonin të flisnin vetëm pasi ndiheshin të sigurta dhe pasi kishin krijuar një nivel besimi tek unë.

Një rast që më preku veçanërisht ishte një grua që ishte strehuar në një kamp italian. Ajo kishte humbur burrin dhe një fëmijë. Ajo nuk mund të fliste qartë dhe përsëriste fraza për trupin e fëmijës së saj të lënë jashtë, të pambrojtur nga qentë dhe shiu. Ishte një gjendje e rëndë traumatike sa nuk e kisha të lehet dhe si ta menxhoja. Vetëm pasi nuk munda t'i përmbaja lotët, kur dëgjova se edhe burrin ia kishin marrë, ajo filloi të qante. Ishte në atë moment që zemra e saj u hap, dhe dhimbja, e mbajtur brenda për kaq kohë, nisi të shpërfaqej. Ajo filloi të shprehte ngadalë dhimbjen e saj, duke lehtësuar sadopak peshën që mbante mbi vete.

Në kampet e Kukësit, këto gra shpesh kërkonin ndihmë për fëmijët e tyre duke e harruar vete dhe nevojat e tyre. Fillova të kuptoj rëndësinë e krijimit të një hapësire të sigurt, ku ato mund të ndiheshin të dëgjuara dhe të mbështetura. Në bashkëpunim me UNICEF-in, punova për të krijuar këto hapësira dhe për të ofruar ndihmë mjekësore dhe emocionale.

Rrëfimet e refugjatëve ishin shpesh tronditëse. Një rast që më mbeti në mendje ishte ai i dy vëllezërve nga Bresalci, të plagosur rëndë. Ata kishin kërkuar ndihmë mjekësore nga mjekët serbë, por ishin përzënë dhe lënë pa trajtim. Për gratë ishte

edhe më e vështirë të tregonin për përjetimet e tyre, veçanërisht për dhunën seksuale. Shpesh duhej të prisja me durim derisa ato të ndihesh-in gati për të folur.

Intervistat dhe ndërgjegjësimi ndërkombëtar

Puna ime shpesh tërhoqi vëmendjen e mediave ndërkombëtare. Jepja intervista për CNN, BBC, RAI 1 dhe media të tjera pa qenë fare e përgatitur, duke treguar historitë e refugjatëve dhe përvojat e tyre. Ndjeja se kjo ishte një mënyrë për t'i dhënë za atyre që vuajnë dhe për t'i bërë botës të ditur për atë që po ndodhte në Kosovë.

Pastaj Kukësi u ba arenë e shumë vizitorve e mekanizmave të UN-te dhe me kujtohet kur takova Olara Otunnu, përfaqësues special i Kombeve të Bashkuara për fëmijët në konflikte. Ai u interesua për përvojat e fëmijëve në kampet e Kukësit dhe më vonë, në një takim në Gjenevë, i tregova për përvojat e tyre dhe për angazhimin tim pas luftës.

Mësimet nga kjo përvojë

Puna në Kukës më mësoi rëndësinë e krijimit të hapësirave të sigurta për viktimat e dhunës dhe traumave. Pa këto hapësira, ishte e pamundur për ta që të shprehin dhim-bjen dhe të merrnin ndihmën që u duhej. Ishte një periudhë që sfidoi gjithçka që dija deri atëherë dhe marizgjoj enderren e femires si dhe me maturoj si profesioni dhe si njeri. Përkushtimi dhe solidariteti me të cilin njerëzit punuan dhe ndihmuan njëri-tjetrin më frymëzoi që të angazhohem edhe më shumë në të ardhmen për ata që vuajnë.

Puna ime në Kukës kishte një rëndësi të veçantë, jo vetëm për ndihmën direkte që of-ronim, por edhe për rolin e transmetimit të së vërtetës për atë që ndodhte në Kosovë. Përmes historive të refugjatëve, u përpoqëm të ndërtonim një pasqyrë të qartë të situ-atës për organizatat ndërkombëtare. Ishte thelbësore të tregohej se çfarë po ndodhte realisht, duke sjellë dëshmitë e drejtpërdrejta të atyre që kishin përjetuar mizoritë.

Pavarësisht rrethanave të vështira, fëmijët shpesh arrinin të rimëkëmbeshin shpejt pas ndërhyrjeve tona. Solidariteti ishte një element i rëndësishëm në kampet e refugjatëve. Të rriturit kujdeseshin për më të vegjëlit dhe ndihmonin njëri-tjetrin për të përballuar vuajtjet. Xhamia e Kukësit shërbente si një qendër pritjeje ku fëmijët dhe familjet mbër-rinin për t'u sistemu përkohësisht, para se të shpërndaheshin në kampe të tjera.

Numri i fëmijëve ishte i madh – ndoshta mbi 200 në një kohë. Menaxhimi i situatës ishte sfidues, por meaq sa kishim mundesi ofronim ndihmë dhe mbështetje. Fëmi-jët merrnin pjesë në aktivitete të vogla që ndihmonin në përmirësimin e gjendjes së tyre psikologjike dhe fizike, benim edhe ekspozita arti nëpër xhembat e rrethojes së Xhamis.

Vendimi për t'u larguar nga Kukësi

Në fund të prillit të vitit 1999, më duhej të largohesha nga Kukësi dhe të kthehesha në Tiranë. Numri i refugjatëve po rritej dhe kërkesat për ndihmë ishin shtuar ndjeshëm. Në atë kohë, një menaxhere e re nga Holanda, Tinke Venekam, që sapo ishte bashkuar me organizatën, kërkoi që të rikthehesha për të ndihmuar në qendrat e refugjatëve në Durrës, Shkozet, Shkallnur, Tiranë dhe rrethinat e saj.

Gjatë kësaj periudhe, puna vazhdoi pa ndërprerje, duke u fokusuar në menaxhimin e krizave dhe dhënien e ndihmës së nevojshme për refugjatët. Në fund të qershorit të vitit 1999, pas përfundimit të bombardimeve të NATO-s dhe situatës emergjente, u ktheva në Kosovë. U nisa nga Kukësi dhe hyra në Kosovë, duke sjellë me vete përvojën dhe mësimet e fituara nga kjo periudhë e vështirë.

Kjo periudhë ishte një nga më sfidueset dhe më transformueset në jetën time. Përballja me vuajtjet dhe traumat e njerëzve të shpërngulur nga lufta, sidomos me historitë e dhimbshme të grave dhe fëmijëve, më ndryshoi përjetësisht. Dashni dhe përkushtimi i njerëzve për të ndihmuar njëri-tjetrin në situata kaq të vështira më dhanë forcë dhe frymëzim për të vazhdu punën time humanitare dhe profesionale.

Themelimi i QKRMT-së dhe përkushtimi për viktimat e dhunës seksuale

Qysh kur punoja në Qendrën Shqiptare për Rehabilitimin e të Torturuarve (QSHRT), kisha filluar të diskutoja për nevojën e krijimit të një organizate në Kosovë që do të merrej me trajtimin e traumave të luftës. Në banesën time në Shqipëri, kisha strehuar një familje të dëbuar nga Drenica dhe u kisha premtuar që, sapo të kthehesha në Kosovë, do të filloja punën pikërisht atje, duke ndihmuar ata që kishin përjetuar tmerret më të mëdha të luftës. E dëgjoja çdo ditë dhimbjen e tyre, veçanërisht të grave që nuk guxonin as të flisnin për përvojat e dhunës seksuale që kishin kaluar.

Në atë kohë, gjithashtu u njoha me Reshat Bajramin, një mjek i ri nga Kosova i cili erdhi në Tiranë per të me takuar e më vonë, pas disa vitesh, lidhja jonë u kurorëzua dhe krijuam familje.

Në fillim, të flisje për dhunën seksuale ishte pothuajse e pamundur në Kosovë. Të gjithë ata që i pyesja, refuzonin të ndanin përvojat e tyre. Si temë, kjo çështje nuk trajtohej në nivel shoqëror. I kujtoj bisedat me Adem Demaçin, kur i thashë: “Baca Adem, unë dua të punoj me krimet e luftës dhe të kërkojmë dëmshpërblime nga Serbia.” Ai më tha: “Ooo bacit, hala Gjermania nuk i ka larë me izraelitët dëmet, e këtu... uuu, larg ajo.” Këto fjalë më qëndruan gjatë në mendje.

Pra, fillova të trajtoja një plagë pa zë, të mbështjellë me turp dhe faj, një temë tabu për shoqërin tonë dhe në të njëjtën kohë edhe per te krijuar dhe zhvilluar shërbime që deri atëherë nuk ekzistonin fare në Kosovë.

Në atë kohë, intervenimi psiko-social nuk ishte një koncept i njohur e as i zhvilluar që më ra ta mesoja në rrethana lufte e kampesh. Shpesh ndihesha e vetmuar në këtë rrugëtim dhe pata shumë dilema. Por pata fatin të mbështetem nga Dinike Venekam, një kolege holandeze që kisha takuar gjatë punës në Shqipëri. Ajo punonte në Gjakovën e shkatërruar dhe më qëndroi pranë në hapat e parë të këtij rrugëtimi.

Formimi i QKRMT-së

Në Kosovë kisha nevojë për një platformë legjitime për punën time. Shkova te UNHCR për të regjistruar organizatën, por më thanë se duhej të shkoja në Beograd, çka mu duk shumë e çuditshme. Pastaj vizitova UNMIK-un, ku mësova se nuk kishte ende një departament për regjistrimin e OJQ-ve. Kur takova një doktor finlandez që punonte për UNMIK-un, ai më tha: “Ne as nuk kemi menduar për këtë.” Kërkesa ime shërbeu si nxitje për të krijuar Zyrën Ndërlidhëse për regjistrimin e OJQ-ve, dhe organizata ime, Qendra Kosovare për Rehabilitimin e të Mbijetuarve të Torturës (QKRMT), u bë ndër të parat që u regjistrua.

Fillimi ishte shumë i vështirë që e karakterizoi Kosovën e pas luftës. Nuk kishim as internet, as rrymë, dhe shpesh duhej të shkoja në kafene për të komunikuar me mentorin tim, Dr. Jens Modvig. Megjithatë, më 13 tetor 1999, inaugurimi i QKRMT-së u bë realitet. Bernard Kouchner, administratori i atëhershëm i UNMIK-ut, ishte pjesë e

ceremonisë. Ishte një moment historik për mua dhe organizatën time.

***

Në terren, shpesh ndeshesha me mure. Informacionet për viktimat e dhunës seksuale ishin të pakta dhe stigmatizimi ishte i jashtëzakonshëm. Kujtoj një rast kur vizitova një familje që supozohej të kishte viktima të dhunës seksuale. Reagimi i tyre ishte agresiv: "Çka? Çka don? Për çka ke ardhë?" Më kërcënuan dhe më thanë të mos kthehesha më. Ishte qartë e pamundur për ta që kjo çështje të dilte në sipërfaqe. Në atë kohë, ishte e paimagjinueshme që një familje të pranonte publikisht dhunën seksuale. Çdo përpjekje e tillë duhej të bëhej me shumë kujdes, pasi rreziku për gratë ishte shumë i madh.

Përballja me stigmat dhe heshtjen

Shpesh ndihesha e pafuqishme për të luftuar stigmatizimin që e rrethonte këtë çështje. Shumë nga gratë dhe vajzat që merrnin shërbime në QKRMT vinin me një frikë të jashtëzakonshme se mos familjet e tyre zbulonin pse kishin kërkuar ndihmë. Për të shmangur këtë, ato e justifikonin praninë e tyre me probleme të zakonshme shëndetësore, duke marrë ilaçe ose ndihmë që nuk i ekspozonte. Kjo periudhë e heshtjes dhe fshehjes zgjati për rreth një dekadë pas luftës.

Shoqëria jonë, gjatë atyre viteve të pas luftes i jepte rëndësi vlerësimit të të rënëve dhe nderimit të të zhdukurve. Ndërsa për të mbijetuarit e dhunës seksuale, ata shiheshin si pjesë e turpit dhe çnderimit të shoqërisë. Kështu, ato dhe ata mbetën pa zë, pa emër, të mbështjellë vetëm nga heshtja dhe turpi që i shoqëronte. Ky realitet më shtyu të punoj me më shumë përkushtim për të ndryshuar perceptimin shoqëror dhe për të kriju hapësira të sigurta për viktimat e dhunës seksuale me një ekip profesional dhe të dedikuar pëe të bërë tranformme shoqrore e që të krjuar hapësiren ëe jua takonte edhe atyre.

Si anëtare e Bordit të OJQ-ve në nivel qendror, të krijuar nga OSBE-ja ne vitet e para të pas luftës, u zgjodha bashkë me Rada Trajkoviqin si përfaqësuese e shoqërisë civile në Këshillin e Përkohshëm Administrativ (KPA), të udhëhequr nga Bernard Kouchner, administratori i atëhershëm i UNMIK-ut. Ky ishte një rol shumë sfidues, pasi kërkonte takime të rregullta me liderët politikë shqiptarë, përfshirë Presidentin Rugova, Hashim Thaçin, Ramush Haradinajn dhe përfaqësuesit ndërkombëtarë nga OSBE-ja, NATO-ja dhe UNHCR-ja.

Një moment i paharrueshëm ishte udhëtimi ynë i parë në Bruksel me këtë grup, ku përfshiheshin liderët politikë dhe përfaqësues të tjerë të komuniteteve. Për shkak të mungesës së vizave, na kërkuan të qëndronim në avion për rreth dy orë, derisa të na lejohej hyrja. Diskutimet dhe debatet në avion ishin të tensionuara, por njëkohësisht shoqëroheshin me humor dhe përpjekje për të koordinuar mesazhet që do të adresonim.

Në Bruksel, unë ngrita çështjen e fondeve për shoqërinë civile dhe rëndësinë e adresimit të traumave të luftës në mënyrë gjithëpërfshirëse. Përkundër divergjencave mes liderëve tanë, gjatë kthimit u arrit të përpilohej një deklaratë e përbashkët për mediat. Ky ishte një moment kuptimplotë që tregoi se, pavarësisht dallimeve, ekzistonte një qëllim i përbashkët për të ecur përpara.

Kjo periudhë ishte thelbësore për të kuptuar se sa e vështirë ishte të trajtoje plagët e luftës, veçanërisht ato më të padukshme, si dhuna seksuale. Por ishte gjithashtu një kohë kur mësova se për të bërë ndryshim duhej këmbëngulje, guxim dhe përkushtim. Pavarësisht sfidave, vazhdova të jem zani i atyre që nuk mund të flisnin dhe të punoja për krijimin e një shoqërie që i pranon dhe i mbështet viktimat si pjesë të saj. Kjo mbetet misioni im deri në ditët e sotme.

Në vitet pas luftës, puna ime në terren dhe angazhimi ndërkombëtar ishin të pandalshme. Përmes QKRMT-së, unë jam përpjekur të sjell përvoja ndërkombëtare dhe të ndërtoj një bazë të qëndrueshme për rehabilitimin dhe trajtimin e viktimave të luftës. Shpesh, kolegët më qortonin duke thënë se po i ngarkoja me shumë punë, veçanërisht me dokumentimin dhe zhvillimin e programeve që nga viti 2004. Ishte e vështirë të mbuloja terrenin, të zhvilloja organizatën, të paraqitesha në media dhe të sillja përvoja ndërkombëtare. Por e gjithë kjo bëhej e mundur falë angazhimit të palodhshëm të stafit të QKRMT-së, me të cilët ndamë shumë sfida, u rritëm dhe u zhvilluam së bashku. Sot, vazhdojmë të dëgjojmë rrëfime që nga ato më të trishtuara deri te ato që flasin për rimëkëmbjen dhe forcën përballë kësaj plage të thellë.

Në ato vite, Baca Adem Demaçi, si kryetar i bordit të QKRMT-së, më këshillonte shpesh: “Qyre bijo, ti po rrin nëpër aeroplan shumë… shqiptarë janë, nuk mundemi me u bë as gjermanë e as amerikanë, po vinë e po shkojnë me rregull… kadal kadale, mos i jep zor kësaj pune.”

Në vitin 2006, gjatë një takimi me Departamentin Social të UNMIK-ut, pashë një mundësi për të avokuar për njohjen e të mbijetuarve të dhunës seksuale të luftës. Kjo ishte një kohë kur rregulloret e UNMIK-ut po shndërroheshin në ligje dhe mendova se ishte momenti i duhur për ta adresuar këtë çështje. Së bashku me kolegët, krijuam një paragraf për të integruar pasojat psiko-sociale të dhunës seksuale në ligjin që po përgatitej për kategoritë e luftës. Fatkeqësisht, përgjigjja ishte zhgënjyese. Një zyrtar nga UNMIK-u dhe drejtori vendor na thanë: “Merruni me donatorët ndërkombëtarë, ata ju financojnë. Nuk ka hapësirë në këtë ligj për këtë grup.” Ishte qartë një stigmë, jo vetëm në shoqëri, por edhe në institucione.

Studimi për dimensionet e traumës dhe avokimi për viktimat

Për të kuptuar më mirë ndikimin e luftës në shoqëri dhe për të krijuar bazë për avokim, vendosëm të realizonim një studim mbi dimensionet e traumës së luftës. Studimi tregoi se niveli i çrregullimit të stresit post-traumatik ishte 25% në nivel të përgjithshëm. Ky rezultat na ndihmoi të dorëzojmë një raport te Agjencia për Barazi Gjinore e UNMIK-ut, ku theksuam nevojën për trajtimin e dhunës seksuale si një krim të luftës. Fatkeqësisht, as bashkësia ndërkombëtare nuk tregoi interesim të madh për këtë çështje në atë kohë.

Gratë që vinin në organizatë filluan të ndanin përvojat e tyre, por gjithmonë brenda një hapësire të sigurt dhe me shumë kujdes. Ne ofronim shërbime të jashtëzakonshme psiko-sociale dhe shëndetësore, por kjo ndihmë duhej të mbahej larg syve të publikut. Në atë kohë, ishte e pamundur të flisnim hapur për këtë çështje në media, sepse do të rrezikonim sigurinë e grave dhe do t'u mbyllnim derën e vetme të sigurt që ato kishin.

Në vitin 2012, bashkë me të mbijetuarat organizuam një kampanjë me sloganin "Dëgjo zërin tim" për të kërkuar njohjen dhe mbështetjen e viktimave të dhunës seksuale. Kjo ishte një thirrje për të ndërgjegjësuar shoqërinë dhe për të treguar se gratë dhe burrat që kishin përjetuar këtë dhunë ishin ende këtu dhe meritonin mbështetje. Në atë kohë, unë po kaloja një trajtim për shtazani pasi ne familjen tone nuk kishim shume këhë të mënduar për fëmij bashkë më shokun ishim shumë here në teren apo takime dhe mjekët më kishin këshilluar të pushoja, ishte momenti i fundit që të bëhësha nana. Por për mua, kjo kampanjë ishte prioritet, pavarësisht debateve me bashkëshortin dhe këshillave të mjekëve. Zoti deshi që pas një viti të bekohesha me vajzën time, Noa, që erdhi në jetën time si një rreze drite pas një viti të vështirë, kur familja ime kishte përjetuar humbjen e vëllait tim të madh, Naserit.

Ardhja e Noas ishte si një freski për shpirtin tim dhe për familjen time që kishte përjetuar një vit të zi. Ajo na solli emocione të reja dhe ndihmoi të rikthenim një ndjenjë gëzimi dhe qëllimi pas një periudhe të vështirë. Por edhe sot, çdo emocion i gëzimit shoqërohet me mallin dhe dhimbjen për mungesën e vëllait tim të dashur.

Vitet e punës sime në QKRMT dhe përvoja personale më kanë formuar jo vetëm si profesioniste, por edhe si një njeri që beson thellë në fuqinë e ndihmës dhe shpresës. Pavarësisht sfidave, mbetem e përkushtuar të jem zëri i atyre që nuk munden të flasin por edhe ti fuqizoj ato te flasin zëshëm dhe dokumentojn te vërteten dhe kërkojnë drejtësi.

Por për të bere levizje shoqerore e instiucinale natyrisht duhet gjithmon te gjinden aleat dhe bashkepunim me organizat të grave. Kështu, rrjeti i grave dhe organizata të tjera, filluam fushata të fuqishme si "Nuk duam lule, duam drejtësi," që dha një shtysë të madhe për ndërgjegjësimin e kësaj plage të shoqërisë sonë.

Në vitin 2012, filluam të ndjenim mbështetjen nga ambasadat e huaja, veçanërisht ato të Mbretërisë së Bashkuar dhe Shteteve të Bashkuara, që ndihmuan për të shtyrë agjendën para në Parlament. Megjithatë, nuk ishte aspak e lehtë. Gjatë debateve të para parlamentare, vetëm disa deputetë ishin të bashkëpunonin. Kujtoj shumë mirë mo-

mentet kur gratë e mbijetuara më telefononin të tronditura dhe të frikësuara nga fjalimet dhe kundërshtimet që dëgjonin në sallën e Parlamentit. Frika e tyre ishte e madhe, duke mendu se shteti mund t'i linte jashtë vëmendjes ose t'i fajësonte.

Në atë kohë isha në pushim të lindjes pas lindjes së vajzës sime Noa, por në asnjë moment nuk u ndala. Nuk kisha një pushim të zakonshëm të lindjes, pasi shumë herë, ndërsa ushqeja Noan, mbaja konferenca, takime dhe merrja pjesë në aktivitete. Gjatë kësaj periudhe, ndihmuam në krijimin e qendre në Drenas per Promovin e te Drejtave te Grave, që u bë një hapësirë e sigurt për gratë e zonës, duke ofruar shërbime rehabilitimi për traumën. Ishte një ndjenjë lehtësimi të dija që disa gra, që nuk kishin mundësi të vinin në Prishtinë, tani mund të merrnin ndihmën që u nevojitej afër vendbanimit të tyre dhe udheheqeje nga nje grua me plot motivë për punën.

Ndërkohë, Agjencia për Barazi Gjinore filloi të hartonte një plan veprimi për zbatimin e Rezolutës 1325 "Gratë, Paqja dhe Siguria." Unë isha aktive në këtë proces, duke kërkuar që gratë e mbijetuara të ishin pjesë e planit të punës. Fillova të bashkëpunoja ngushtë me ministren Vlora Çitaku, duke organizuar takime dhe duke sjellë mbi 50 gra në një takim ku ato ndanë historitë e tyre me ministren dhe Qendren e Drenasit. Ishte një moment i veçantë, pasi për herë të parë gratë takuan një përfaqësuese politike shqiptare, duke ndarë dhimbjet e tyre dhe duke bërë plane për të ardhmen. Këto takime ishin motivim për mua dhe gratë që filluan të ndjenin mbështetje institucionale.

Në prill të vitit 2014, arritëm të sigurojmë njohjen ligjore të viktimave të dhunës seksuale gjatë luftës. Ishte një moment që më bëri të reflektoj se, pavarësisht sfidave dhe barrierave të shumta, përkushtimi dhe puna e palodhshme mund të sjellin ndryshime dhe grat dhe burrat që kishin përjetuar këtë plage.

Institucionet filluan të vetëdijesoheshin. Fillova të bashkëpunoja me Zyrën e Presidentes Jahjaga, e cila krijoi Këshillin Kombëtar për të Mbijetuarit e Dhunës Seksuale. Ky ishte një hap i madh për të diskutuar dhe trajtuar këtë plagë në nivel shtetëror. Mandati i këtij këshilli, fillimisht njëvjeçar, u zgjat nga kërkesa e jonë dhe OJQ- të e tjera.

Por puna duhej të vazhdonte me qeverinë, ajo e cila duhet të lëvizte dhe krijonte mekanizma për veprim, por na është dashur kohë ta mobilizojmë qeverinë dhe akterët tjerë për të filluar të draftonim politikat për zbatimin e ligjit, duke u përballur me shumë sfida dhe kundërshtime.

Bekimi me një vajzë tjetër dhe motivimi për të vazhduar

Në këtë kohë, zoti më bekoj me një vajzë tjetër, Anën, e cila erdhi në jetën tonë si një burim gëzimi dhe motivimi. Gjatë shtatzënisë sime me Anën, isha ende aktive, duke mbështetur qendrën në Drenas dhe duke punuar për t'i siguruar një hapësirë më të madhe dhe më të përshtatshme. Burri im, Reshati, shpesh më thoshte se vajzën duhet ta quanim "Drena," pasi angazhimi im i madh në këtë qendër simbolizonte përkushtimin tim ndaj grave të asaj zone. Pavarësisht vështirësive, arrita të realizoja qëllimet e mia dhe të ndihmoja gratë të ndjenin një hapësirë të sigurt për shërim dhe rehabilitim.

Arritja e zbatimit të politikave për njohjen e statusit të viktimave të dhunës seksuale ka qenë një moment kyç në këtë rrugëtim të gjatë. Nëpërmjet një letre avokuese dhe

bashkëpunimit të ngushtë me qeverinë, kemi arritur të sigurojmë buxhet për të funksionalizuar Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të Viktimave të Dhunës Seksuale gjatë luftës. Vendosja e një pensioni prej 230 eurosh për këto gra dhe burra që mbajnë këtë barrë të rëndë për dekada ishte një hap drejt një lloj drejtësie sociale. Për shumë nga të mbijetuarit dhe familjet e tyre, kjo ishte një dritë shprese në fund të një tuneli të errët.

Dalja publike e Vasfije Krasniqi-Goodman

Një nga momentet më të fuqishme dhe historike në këtë kauzë ishte dalja publike e Vasfije Krasniqi-Goodman. Procesi i saj nisi vite më parë, kur familja e saj na kërkoi ndihmë për asistencë ligjore gjatë një gjyqi në EULEX. Por kulmi i këtij procesi ishte në vitin 2018, kur Vasfije vendosi të fliste publikisht. Në përvjetorin e 19-të të QKRMT-së, ajo ndau historinë e saj në një intervistë të drejtpërdrejtë në RTK. Ishte një ditë historike, kur një grua për herë të parë foli publikisht për këtë plagë të madhe. Puna për të siguruar që ajo të ndjehej e mbrojtur dhe e sigurt ishte intensive – që nga mbështetja e bashkëshortit të saj, përgatitja e psikologëve, e deri puna me Ramizen Murtezin gazetaren e RTK-se e deri te planifikimi i skenarëve alternativë, nëse ajo nuk ndihej gati të fliste.

Një vit më pas, bashkë me aktivistë, media dhe familjarët e saj, udhëtuam drejt vendit të ngjarjes në Babimost, Vushtrri. Vizita në vendin e tmerrit ishte emocionuese dhe tronditëse, por Vasfije arriti të shndërrojë dhimbjen e saj në forcë, duke e përkrahuar ate që të kërkonte njohjen e 14 prillit si Ditë Kombëtare për Viktimat e Dhunës Seksuale gjatë Luftës.

Ndërkombëtarizimi i çështjes së dhunës seksuale

Në vitin 2017, për herë të parë, historia e dhunës seksuale gjatë luftës në Kosovë u shfaq në një ekspozitë në Gjenevë. Duke qëndruar përkrah vendeve si Kamboxhia, Ruanda dhe Bosnja, Kosova më në fund u njoh si një vend ku ky krim kishte lënë plagë të thella. Përfshirja në rrjetin global SEMA dhe bashkëpunimi me personalitete si Dr. Denis Mukëege, Dr.Monika Hauser dhe Dukesha e Luksemburgut më dha ndjenjën se më në fund po i jepnim za kësaj plage, duke e bërë botën të dëgjojë dhe të veprojë.

Në vitin 2018, puna ime shumëvjeçare për rehabilitimin e viktimave të dhunës seksuale dhe parandalimin e torturës u njoh ndërkombëtarisht me çmimin “Gruaja e Guximshme” nga Departamenti Amerikan i Shtetit. Ky vlerësim nuk ishte vetëm për mua, por për gjithë kauzën që përfaqësoj dhe për çdo grua dhe burrë që ka mbijetuar këtë krim.

Përpjekjet tona vazhduan me Shyhrete Tahirin, një tjetër grua e mbjetuar e guximshme që, në përvjetorin e 20-të të QKRMT-së, publikisht dorëzoi rastin e saj në prokurori. Kjo inkurajoi shumë gra të tjera të kërkonin drejtësi dhe të bëheshin zëri i tyre.

Motoja dhe bashkëpunimi për ndryshime shoqërore

Motoja jonë “Bëhu zërin tim” u bë platforma jonë për të bashkuar përpjekjet me organizata të tjera si Medica Kosova, Medica Gjakova dhe Qendra për Promovimin e të Drejtave të Grave. Bashkërisht, këto organizata punuan pandërprerë për të mbështetur të mbijetuarit dhe për të shtyrë përpara kauzën tonë, duke luftuar stigmatizimin dhe duke kërkuar drejtësi për këtë plagë të rëndë shoqërore.

Kjo punë mbetet një testament i përkushtimit të përbashkët për të shëruar plagët e luftës dhe për të ndërtuar një shoqëri që njeh, respekton dhe mbron të drejtat e të gjithë qytetarëve të saj.

Në të gjithë këto vite pune në QKRMT, kemi krijuar një qasje të veçantë dhe praktika efektive për trajtimin e traumave të dhunës seksuale gjatë luftës. Këto përvoja nuk janë vetëm krenari për Kosovën, por janë shndërruar në modele që ndahen në arenën ndërkombëtare, sidomos me vendet që kanë përjetuar të njëjtat krime si armë lufte. Puna ime dhe e stafit të QKMRT-së shpesh herë kanë kaluar përtej orarit dhe pushimeve, me net pa gjumë dhe angazhime të pandërprera për të mbajtur këtë kauzë gjallë.

Kam udhëtuar nëpër botë për të marrë dhe ndarë praktika të mira. Shpesh më është dashur të lë pas vajzat e mia, duke ia besuar kujdesin e tyre bashkëshortit tim, Reshatit, i cili gjithmonë më ka mbështetur duke thënë: “Kur ti je larg, unë jam nënë dhe baba për vajzat tona.” Kjo ka qenë një sakrificë e madhe si nënë, por edhe një detyrim për të çuar përpara një kauzë që është shumë më e madhe se unë.

Kjo përplasje mes misionit tim profesional dhe jetës familjare ka qenë gjithmonë sfiduese, sidomos kur përballesha me telefonata emergjente për ndihmë, shpesh në orët e vona të natës. Përkushtimi ndaj punës, ndërsa ndahesha mes konferencave ndërkombëtare dhe emergjencave lokale, ishte i pashmangshëm për të arritur rezultatet që sot i shohim.

INTERNATIONAL
WOMEN OF COURAGE

STOP DHUNËS NDAJ
GAZETARËVE
DHE QYTETARËVE
STOP EGOIZMIT INATEVE
INJORANCËS
DHE ARROGANCËS
STOP TALLJEVE
DHE FJALËVE NEGATIVE
BËHU ZËRI IM
BE MY VOICE
BUDI MOJ GLAS
NË MBË

Përvoja e Kosovës si model ndërkombëtar

Kosova tashmë ka krijuar një koncensus institucional për njohjen e së kaluarës së dhimbshme dhe për trajtimin e të mbijetuarve të dhunës seksuale. Kjo përvojë është ndarë në konferenca ndërkombëtare si një model frymëzues. Kohëve të fundit, në Gjenevë, përvoja e Kosovës u paraqit përkrah vendeve si Kolumbia dhe Bosnja. Kosova tashmë ka hapur rrugën për reparacione adminstrativ dhe për ndërtimin e një sistemi që njeh dhe mbron të drejtat e të mbijetuarve.

Por sfidat mbeten. Aktualisht, po avokojmë që njohja ligjore e të mbijetuarve të dhunës seksuale gjatë luftës të jetë e paafatizuar, duke u mundësuar grave dhe burrave të prekur që, kur të jenë emocionalisht të gatshëm, të kërkojnë dhe të fitojnë të drejtat që u takojnë.

E ardhmja

E di që kauza ime nuk do të përfundojë kurrë plotësisht, dhe në pleqëri shpresoj që përvoja ime të mbetet udhërrëfyese për ata që do të vazhdojnë këtë rrugë. Siç më ka thënë një koleg një herë: “Ti mund të mos e marrësh këtë punë me vete, por puna jote do të shkojë kudo që të shkojë Kosova.” Në këtë frymë, do të vazhdoj të jap kontributin tim për të siguruar që çdo i mbijetuar të ketë hapësirën, drejtësinë dhe mbështetjen që meriton.

Lufta kundër stigmatizimit

Sabiha Husić, drejtoreshë e organizatës joqeveritare Medica Zenica, është një nga aktivistet më të njohura për të drejtat e njeriut, veçanërisht për të drejtat e grave, në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ajo është edhe avokuese e zjarrtë për drejtësinë tranzicionale dhe kulturën e kujtesës. Aktivizmi i saj filloi gjatë kulmit të luftës në Bosnjë dhe Hercegovinë, në Zenicë, ku, si studente ende e padiplomuar e teologjisë islame, ajo ofroi fillimisht ndihmë në kampet e refugjatëve në Zenicë dhe në komunitetin islam. Kjo përvojë e shtyri atë të punonte me gratë që ishin viktima të dhunës seksuale dhe përdhunimit. Si person i besimit fetar, ajo e pati më të lehtë ta fitonte besimin e atyre grave, duke i ndihmuar përmes ofrimit të mbështetjes psikologjike, punës dhe arsimit të saj të mëtejshëm, ndërsa organizata ofronte ndihmë mjekësore, materiale dhe të tjera.

Kjo grua e guximshme, së bashku me koleget e saj nga Medica dhe organizata të tjera të grave, ka sjellë përparime të rëndësishme në njohjen ligjore të grave që përjetuan përdhunim dhe dhunë seksuale si viktima lufte, por edhe ka ofruar ndihmë shumë konkrete për individët e traumatizuar. Ajo ka luftuar kundër stigmatizimit që përjetojnë gratë të cilat i mbijetuan dhunës seksuale, së bashku me fëmijët e tyre, në një shoqëri që, për fat të keq, mbetet thellësisht patriarkale, jo vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë, por në të gjithë Ballkanin.

Me prejardhje nga një familje tradicionale që e përqafoi fenë si pjesë e jetës së përditshme, ajo u orientua drejt studimeve të Islamit dhe fesë qysh në moshë të hershme. Ajo përfundoi Medresenë Gazi Husrev-beg dhe më pas Akademinë Pedagogjike Islame në Zenicë, si dhe Teologjinë Islame në Sarajevë. Ajo përfundoi doktoratën në Universitetin e Sarajevës, ndërkohë që vazhdimisht angazhohej në punë sociale të rëndësishme në kuadër të Medica Zenica. Sot, ajo punon për fuqizimin e grave që i kanë mbijetuar dhunës seksuale jo vetëm në Bosnjë dhe Hercegovinë, por edhe në rajon dhe në botë. Kjo është historia e saj.

Sabiha Husić

Familja dhe arsimimi në medrese

Unë jam Sabiha Husić. Kam lindur në Donja Veçeriska, afër Vitezit. Asokohe, mbiemri im ishte Haskiq. Jam e treta nga katër fëmijët dhe prindërit na rritën në atë qytezë. Shkollën fillore e ndoqa në Vitez, Donja Veçeriska është vetëm 2 kilometra larg. Nga perspektiva e sotme, mund të them se pata një fëmijëri të lumtur, përplot miqësi, mësim dhe lojë. Prindërit bënë gjithçka që mundën për të plotësuar nevojat tona, edhe pse si fëmijë nuk kishim shumë kërkesa përveç lirisë për të luajtur, për t'u shoqëruar dhe për të eksploruar. Isha nxënëse e mirë dhe e suksesshme. Gjatë shkollës fillore mora pjesë në gara të ndryshme, veçanërisht në fizikë, si dhe në garën popullore të asaj kohe "Rrugët e revolucionit të Titos". Kam kujtime të bukura nga ato çaste të fëmijërisë, sepse çdo ngjarje dhe garë, së bashku me shpalljen zyrtare të rezultateve, më sillnin gëzim të madh si fëmijë.

Pas përfundimit të shkollës fillore, vendosa të regjistrohem në Medresenë Gazi Husrev-beg në Sarajevë. Ishte shkollë fetare, e vetmja e atij lloji në Ballkan dhe pranonte vetëm 20 studente femra. Konkurrenca ishte e ashpër. Prindërit e mi, të cilët ishin tradicionalë në praktikën e tyre fetare, u habitën, madje u tronditën pak, kur unë, si një nxënëse e klasës së shtatë, shpalla se dëshiroja të ndiqja Medresenë. Në atë kohë, mora më shumë mbështetje nga babai im. Ai më tha ta mendoja me kujdes, duke më kujtuar se kishte shumë shkolla të tjera për të zgjedhur, por nëse ky ishte vendimi im, atëherë ishte në rregull. Nga ana tjetër, nëna ime e ndjerë nuk e pranonte aspak. Ajo mendonte se kishte ende kohë. Unë isha në klasën e shtatë dhe më priste klasa e tetë. Ajo besonte se do të gjente një mënyrë për të më shtyrë në një drejtim tjetër dhe se do të ndryshoja mendje. Por isha e vendosur dhe kur përfundova klasën e tetë... madje edhe disa nga mësuesit e mi të asaj kohe, sidomos mësuesi im i fizikës dhe mësuesja ime kujdestare, vizituan familjen time për të diskutuar vendimin tim pasi e morën vesh. Kur më pyetën në klasë, ua thashë hapur të gjithëve se planifikoja të shkoja në atë shkollë. Atëherë, të gjithë thonin, po çfarë shkollë është ajo, do bëhesh hoxhanicë, çfarë do bësh me atë shkollim, a do të martohesh, a do ta kesh jetën tënde, ndërsa të tjerë thonin edhe, nuk do të shoqërohemi më me ty, pasi ishin të mbushur me paragjykime për zgjedhje të tilla. As unë nuk i kuptoja plotësisht të gjitha atëherë, por e dija që doja të shkoja në atë shkollë. Doja të mësoja më shumë për ato të drejta, jo se i njihja si të drejta në atë kohë, por isha kurioze të dija çfarë ofronte feja ime, ajo në të cilën isha rritur dhe ushqyer, për mua si grua. A më shihte si të barabartë me një burrë? Përse prindërit, përfshirë të mitë, si dhe fqinjët, lejonin gjëra të caktuara për djemtë, por jo për vajzat? Këto pyetje më zinin mendjen dhe, edhe pse nuk kisha përgjigje të qarta, i doja, dhe i doja si një fëmijë, si një vajzë e re. Kështu që, kur mësuesit e mi dhe mësuesja kujdestare erdhën në shtëpinë tonë duke ofruar bursa dhe mundësi të ndryshme për të ndjekur shkolla të tjera, unë qëndrova e vendosur. Thashë jo. Doja të regjistrohesha në Medrese dhe në asnjë shkollë tjetër. Përfundimisht, edhe nëna ime e pranoi faktin që do të bëja përpjekje për Medresenë. Megjithatë, ajo besonte se konkurrenca ishte shumë e ashpër, sepse, në fund të fundit, pranoheshin vetëm 20 vajza dhe nuk kishte asnjë mundësi që unë të kaloja provimin e pranimit. Ajo thoshte, mirë, provo të japësh provimin e pranimit, do ta shohësh vetë. Po plani yt rezervë? Më pyeste gjithmonë këtë. Atëherë i përgjigjesha, do ta shohim,

nëse nuk është Medreseja, do të mendoj për diçka tjetër, por jam e sigurt që do të jetë Medreseja. Kur e shoh tani, vendosmëria ime në atë kohë mund të duket si kokëfortësi fëmijërore, por nga këndvështrimi i sotëm, ishte vendosmëria dhe besimi im se mund të arrija diçka që vërtet e dëshiroja.

Shkova me të vërtetë në provimin e pranimit, e shoqëruar nga babai im i ndjerë, e kujtoj shumë mirë. Kur pashë qindra vajza nga Ballkani që ishin mbledhur në Sarajevë për provimin në atë shkollë të mesme… Prindërit e tyre ishin ose imamë ose të arsimuar lartë në studimet fetare, dhe për herë të parë i thashë vetes, jo, nuk do ta kaloj këtë provim. Kur filluan të flisnin mes tyre, "babai im është kryeimam," ose "babai im është imam në këtë apo atë qytet," ose "i afërmi im është myftiu i madh," mendova me vete, nëse është kështu, unë nuk kam asnjë shans. Bëmë teste të ndryshme dhe gjithçka përfundoi. Mbaj mend që babai im i ndjerë më pyeti se si u ndjeva pas provimit. Për herë të parë i thashë, epo, shkoi mirë, por nuk do ta kaloj, babë. Ti nuk je imam, nuk ke lidhje me myftiun e madh apo me komunitetin islam, thjesht nuk do t'ia dal. Ai atëherë më tha, asnjëherë nuk i dihet, hajde të shkojmë në Vrello Bosne për të festuar, e more provimin, dhe do të shohim si do të shkojë. Kështu që shkuam në Vrello Bosne. Ishte e mrekullueshme për mua. Vrello Bosne në Sarajevë është mahnitëse, ajo bukuri, ai ujë dhe zogjtë që krijonin një melodi të veçantë vetëm për mua. Pas kësaj, u kthyem në shtëpi.

Nëna më pyeti si shkoi. I thashë. Epo mirë. Ajo më tha, nuk dukesh shumë e gëzuar, çfarë të zhgënjeu. Atëherë i thashë, epo, jam e zhgënjyer që ju nuk jeni imamë, që nuk keni lidhje me komunitetin islamik, si do ta kaloj tani, kjo do të më prishë mundësitë. Ajo tha, epo, ç'rëndësi ka, ka shkolla të tjera, pasi gjithmonë shpresonte që unë të zgjidhja një shkollë të mesme tjetër. Gjashtëmbëdhjetë ditë më vonë, gjatë javës së tretë pas provimit të pranimit, tani nuk i kujtoj shumë detajet...

Vëllai im, i cili punonte si shitës në një dyqan mobiljesh në Vitez, sapo kishte përfunduar shkollën tregtare dhe menjëherë kishte gjetur punë aty. Ai erdhi në shtëpi ndërsa ne ishim jashtë në oborr duke bërë disa punë. Nëna ime u befasua dhe e pyeti, Mujo, çfarë po bën këtu në këtë kohë. Mujo është emri i vëllait tim. Ai m'u afrua me një shprehje serioze dhe tha, eja këtu që të të puth, motër. E pyeta pse. Ai u përgjigj, je krenaria jonë, e kalove provimin e pranimit për Medrese. Vetëm atëherë pashë gëzimin e nënës sime. Ishte e mbushur me lumturi dhe më puthi edhe ajo. Sigurisht, lajmi u përhap menjëherë tek të gjithë, motra ime, xhaxhallarët tanë që jetonin afër, të gjithë e morën vesh menjëherë. Babai im ishte në punë në atë kohë, i punësuar në sigurimin e ndërmarrjes ushtarake Slobodan Princip Seljo në Vitez, e cila ishte aq afër shtëpisë sonë sa mund ta shihnim nga aty... Në atë çast, kuptova që të gjithë ishin me të vërtetë të lumtur. Nëna ime më tha, epo, dëshira jote u realizua, edhe pse nuk besoja as 1% se do të ndodhte. Dhe kështu filloi gjithçka.

E kalova atë verë në pritje, duke vrarë mendjen si do ta nisja shkollën e mesme, si do të shkonte gjithçka dhe nëse do të përshtatesha, pasi gjatë provimit të pranimit kisha vënë re se, edhe pse isha shumë e fortë në lëndët e përgjithshme, nuk isha aq e zonja në lëndët fetare. Një nga testet ishte mbi kiraatin, leximin e Kuranit dhe kuptova që nuk isha e mirë aty krahasuar me të tjerat. Shumë nga vajzat e tjera ishin përgatitur mirë nga prindërit e tyre për provimin e pranimit.

Shkova në mekteb, ku imami i atëhershëm, Hasan Efendiu, më shpjegoi se çfarë ishte në të vërtetë Medreseja, se ishte një shkollë e mesme që përfshinte lëndë laike dhe fetare, dhe më tregoi për kurrikulën fetare. Kaq ishte e gjithë përgatitja ime në aspektin fetar. Përveç kësaj, imami më solli disa materiale të vjetra të testeve për të më ndihmuar të kuptoja si do të ishin provimet dhe praktikuam leximin e Kuranit aq sa mundëm. Megjithatë, kjo përgatitje nuk ishte aspak në nivelin e bashkëmoshatareve të mia, të cilat kishin pasur më shumë mundësi për të studiuar dhe praktikuar intensivisht. Sa i përket lëndëve laike, shkëlqeva, duke marrë pikët më të larta në atë pjesë të provimit të pranimit. U pranova në Medrese, por periudha e përshtatjes ishte shumë sfiduese për mua. Ishte hera ime e parë larg shtëpisë dhe familjes, e përballur me një mjedis të ri ku takova vajza nga e gjithë Jugosllavia. Edhe pse në disa aspekte ishim afër, kishte dallime kulturore. Përveç kësaj, duhej të përshtatesha me disiplinën e rreptë, jetesën në konvikt dhe praninë e mbikëqyrësve. Viti i parë ishte veçanërisht i vështirë, por i thosha vetes, jo, duhet ta përfundoj këtë, duhet të arrij atë që dua dhe atë që kërkoj. Muaj pas muaji, u bë më e lehtë, dhe përfundimisht, e mbarova...

Kjo ndodhi në vitin 1986. Në Medrese ekziston një traditë dhe praktikë shumë e vlefshme, diçka që e vlerësoj thellësisht dhe mendoj se krijon baza të mira: studentët marrin pjesë në praktikën e Ramazanit. Kjo përfshin angazhimin me njerëzit, zhvillimin e diskutimeve si pjesë e aktiviteteve edukative dhe organizimin e jetës gjatë Ramazanit. Zgjat vetëm për muajin e Ramazanit. Jo të gjithë studentët shkonin në këto detyra, pasi bëhej përzgjedhje. Në vitin e parë dhe të dytë, dërgohej vetëm një numër i caktuar studentësh, por në vitin e tretë dhe të katërt kjo praktikë bëhej e detyrueshme. Që në vitin e parë fillova të marr pjesë. Praktikën time e kreva në Travnik dhe Velika Kladusha për dy vite. Më vonë, kur isha në universitet, gjatë vitit të dytë të studimeve, shkova për praktikë në Pljevlja, në Mal të Zi.

E përfundova Medresenë në vitin 1990 dhe më pas u regjistrova në fakultet, në Fakultetin e Shkencave Islame. Zhvillova dashuri të thellë për shkollën dhe studimet, pasi më zgjeruan horizontet dhe më ndihmuan të kuptoja vlerat e fesë. E kuptova se si feja mund ta bëjë jetën më të mirë, më cilësore, jo vetëm për individin, por edhe për të tjerët. Në të njëjtën kohë, kuptova se si interpretimi i disa mësimeve fetare, si ato nga Kurani apo Suneti, shpesh çon në keqkuptime ose përfundime të ndikuara nga perspektiva të tjera, stereotipe ose paragjykime.

Fillimi i luftës dhe kthimi nga Pljevlja

U regjistrova në universitet pak para luftës. Isha në vitin e dytë. Shkova në Pljevlja, së bashku me dy kolegë që ishin një vit përpara meje. Kur mbërrita në Pljevlja për t'u regjistruar, personi i parë që pashë ishte burri im i tanishëm. Ai nuk ishte nga Pljevlja dhe studionte në Prishtinë. Ai kishte përfunduar Medresenë, dhe në atë kohë ishte shumë e vështirë për të diplomuarit e Medresesë të regjistroheshin në universitet. Megjithatë, ai ia doli të pranohej për Studime Orientale dhe Histori në Prishtinë. Gjatë Ramazanit, pasi kishte pushim në studimet e tij, edhe ai aplikoi për praktikë në Pljevlja, dhe aty u takuam përsëri, edhe pse e njihnim njëri-tjetrin prej kohësh, pasi ai është nga Travniku. Ai muaj i Ramazanit kaloi shpejt. Para se të shkoja në Pljevlja, sapo kisha filluar të bëhesha e vetëdijshme që diçka mund të ndodhte në Bosnjë, por askush nuk fliste hapur për këtë. Fakulteti ynë na dërgonte në detyra praktike në të gjithë Jugosllavinë, kështu që nuk mund ta imagjinonim që lufta do të ndodhte vërtet.

Pastaj pashë në Pljevlja, dua të them, kurrë nuk më kishte shkuar në mendje se mund të kishte luftë në Bosnjë. Si mund të ketë luftë? Kush do ta fillonte luftën në Bosnjë? Por ja ku ishim. Fqinjët e mi më të afërt ishin Mira, Sllavko, Brano dhe të tjerë. Jetonim së bashku, luanim së bashku, rriteshim dhe festonim së bashku. Askush nuk fliste për luftë. Por, kur unë dhe dy kolegët e mi u nisëm të shkonim në fakultet, të tre u nisëm së bashku nga Sarajeva, pamë atje, në Jabuka, më duket, në pikën kufitare me Malin e Zi, që kishte barrikada. Unë qesha dhe thashë, çfarë është kjo. Thashë, çfarë është kjo dhe ata u përgjigjën, duket se mund të ketë luftë. Por jo, ndoshta disa ushtrime ushtarake. Po të kishte luftë, nuk do të na kishin dërguar jashtë. Kështu që ishim të bindur se ishin thjesht stërvitje ushtarake. Në barrikadën tjetër, u shfaqën ushtarë me uniforma. Ata kërkuan dokumentet e identifikimit, kështu që ne ua dorëzuam kartat e identitetit. Na pyetën ku po shkonim, pse dhe si. Ne shpjeguam se po shkonim për praktikën e Ramazanit. Ata na pyetën, çfarë do të bëni atje, kush ju ka dërguar. Ne nuk kishim shumë për të thënë. Mbërritëm në Pljevlja dhe kaluam një muaj të mrekullueshëm atje. Njerëz të shkëlqyer. Familja ku qëndrova ishte e pabesueshme. Gruaja, Sanja, ishte nga Sarajeva, ndërsa burri i saj, Behudin, ose Butko, ishte nga Pljevlja. Ata ishin absolutisht të mrekullueshëm. Kishim aq shumë për të biseduar dhe e shijuam kohën së bashku. Më mirëpritën si të isha fëmija i tyre, dhe unë fillova t'i shoh ata si familjen time. Po afrohej Bajrami. Sigurisht, rendnim nëpër dyqane për të blerë dhurata për Bajram.

Ceremonia qendrore për Jugosllavinë në atë kohë do të mbahej në Pljevlja, sepse çdo Bajram, ngjarja qendrore zhvillohej në një qytet të ndryshëm. Atë vit, ishte në Pljevlja. Kishin ardhur përfaqësues të Komunitetit Islam nga Sarajeva. Ata u kthyen të njëjtën ditë. Na thanë të ktheheshim shpejt, sepse diçka nuk ishte në rregull, kishte shumë barrikada. Ne thamë, mirë, do të kthehemi ditën e tretë të Bajramit, pasi donim ta kalonim ditën e dytë me miqtë që kishim bërë, me të rinjtë që kishim njohur dhe me të cilët kishim kaluar gjithë muajin. Ditën e tretë të Bajramit shpërtheu në Bosnjë. Kuptuam që nuk mund të ktheheshim. Në atë kohë, linjat telefonike ende funksiononin, kështu që telefonova familjen dhe i pyeta, çfarë po bëni atje në Bosnjë, këtu po thonë se ka filluar, se lufta ka filluar për shkakun tuaj, për shkak tone.

Media ishte përfshirë në propagandë masive. Ata thane, tani për tani, rri aty, mos u kthe këtu, sigurisht nuk mund të hysh, Sarajeva po digjet. Ata thanë se situata do të përshkallëzohej, Bosnja Lindore po digjej, njerëzit po vriteshin. Në atë kohë, nuk flitej menjëherë për përdhunime, por kishte vrasje, djegie, burgosje... Ne qëndruam aty dhe dëgjonim lajmet. Mund të kem folur edhe një herë tjetër me prindërit e mi. Pastaj linjat u ndërprenë dhe nuk kishte më mundësi për komunikim. Vazhdonim të shpresonim që lufta do të mbaronte shpejt, duke menduar se ishte vetëm një lloj keqkuptimi. Megjithatë, me kalimin e ditëve, shumë refugjatë nga Bosnja Lindore filluan të mbërrinin në Pljevlja, në Mal të Zi, për të vazhduar më tej drejt vendeve të tjera. Ishte atëherë kur vërtet u bëra e vetëdijshme se lufta nuk do të përfundonte shpejt. Familja ku po qëndroja pranoi një familje tjetër nga Gorazhde, një nënë me dy fëmijë. Burri i saj kishte qëndruar në Bosnjë, më duket, ose ishte burgosur që në fillim, nuk e kujtoj saktësisht më. Ata kishin një biznes të madh gastronomie, që ua kishin djegur menjëherë, të paktën kështu na treguan. Ata qëndruan aty edhe për ca kohë.

Pastaj në Pljevlji filluan të shfaqen ushtarë. Ndoshta nuk është mirë ta them këtë, por e vërteta duhet të dihet, nga perspektiva ime si një vajzë 21-vjeçare në atë kohë. Ata thanë se kishte çetnikë. Unë thashë, çfarë çetnikësh, ata ekzistojnë vetëm në libra, nuk ekzistojnë më, për çfarë po flisni. Një nga kolegët nga Pljevlja, me të cilin ishim njohur dhe miqësuar, tha, eja sonte të shkojmë të gjithë në një kafene. Në atë kohë, nuk mbaja shami apo diçka tjetër që mund të identifikonte se kush isha apo çfarë përfaqësoja. Megjithatë, ndonjëherë mund të na njihnin nga të folurit ose nga theksi. Ramë dakord të gjithë të shkonim, vëllai dhe motra nga Bosnja Lindore, që po qëndronin me familjen ku isha unë, unë, djali nga Pljevlja dhe dy kolegët e tjerë që ishin me mua për praktikën. Kur arritëm, vendi ishte mahnitës, pamja, nata dhe dritat i jepnin një dimension tjetër bukurie dhe romanticizmi. Po bënim shaka, po argëtoheshim. Por, kur hapëm derën e kafenesë dhe hymë brenda, nuk e dija ku isha. Kafeneja ishte e mbuluar me pasqyra dhe brenda ishin ushtarë, ata që e quanin veten çetnikë, të armatosur, me mjekra, të ulur rreth tavolinave... Besoj se ata e vunë re reagimin tonë, por nuk mund të ktheheshim dhe të largoheshim. Duhej të hynim dhe të porosisnim kafe apo çfarëdo që planifikonim të pinim. U ulëm. Ishim krejt të hutuar. Nuk mund të flisnim as mes nesh, çfarë kishte ndodhur. Në një moment, njëri prej tyre iu afrua tavolinës sonë dhe kërkoi çakmak për të ndezur cigaren. Të gjithë filluam të kërkojmë për çakmak, por nuk arritëm ta gjejm%. Megjithatë, mbi tavolinë ishin tre çakmakë. Ai moment zbuloi sa të frikësuar ishim. Ai na tha, çakmaku është aty. E ndjeva sikur po na e bënte me dije se e shihte frikën tonë. U larguam nga kafeneja dhe as na shkoi më në mendje për t'u kthyer aty. Pas tre ose katër muajsh, kolegët e mi nga Bosnja vendosën të largoheshin, ashtu si edhe familja që po qëndronte në Pljevlja. Në atë kohë, kishin filluar tashmë arrestimet dhe rrëmbimet e boshnjakëve që jetonin në Pljevlja. Ata më ftuan të largohesha me ta. U thashë, si mund të iki vetëm me një kartë identiteti, ku do të shkoj, çfarë do të bëj, nuk njoh askënd, thjesht dua të kthehem në shtëpi. Ata u larguan. Pastaj, ushtarët erdhën dhe morën kryefamiljarin e familjes ku qëndroja. Ai u zhduk për disa ditë. Gruaja e tij, Sanja, ngriti alarmin kudo për të mësuar çfarë kishte ndodhur me të. Babai i saj kishte post të lartë në Ushtrinë Jugosllave në atë kohë dhe ajo i telefonoi. Ai ndodhej në Sarajevë, por arriti disi të shkonte në Beograd me një nga fluturimet e para. Ai e siguroi duke i thënë, asgjë nuk do t'i ndodhë, është i sigurt. Megjithatë, Sanja këmbëngulte pa pushim. Pas disa ditësh, Butko, ose Behudini, u kthye në shtëpi. E kishin rrahur aq shumë, sa mezi e njohëm. Nuk kishte vend pa mavijosje, në çdo pjesë të trupit. Vetëm nga sytë dhe zëri mund ta kuptonim që ishte ai. Disa muaj më vonë, thashë që doja të provoja të largohesha nga Pljevlja, të përpiqesha të

kthehesha tek familja ime. Planifikova të shkoja në Tuz të Malit të Zi, ku kishim miq, dhe pastaj të vazhdoja për në Shkup. Nga Shkupi, mendoja se mund të arrija në Kroaci dhe më pas përmes Hungarisë ose ndonjë rruge tjetër, sepse nga Kroacia për në Bosnjë ekzistonte e ashtuquajtura “rruga e shpëtimit.” Kjo ishte një rrugë alternative deri sa ndodhën përplasjet me Këshillin e Mbrojtjes Kroate. Deri në vitin 1993, njerëzit udhëtonin nga Spliti në Bosnjë duke përdorur këtë rrugë shpëtimi. Familja me të cilën po qëndroja më lutej të mos largohesha, duke thënë, rri, çfarëdo që të na ndodhë neve, do të të ndodhë edhe ty. Por unë iu përgjigja, nuk mundem, e gjithë familja ime është në Bosnjë, dhe unë thjesht po rri këtu, duke pritur. Pas gjashtë muajsh, u largova nga Pljevlja dhe mbërrita në Tuz, ku gjeta një të afërmen time. Ajo dikur kishte qenë e martuar me një kushëririn tim në Vitez, por ishin divorcuar, edhe pse kishim mbajtur marrëdhënie të mira. Ajo u habit dhe tha, ç’të solli këtu tani, e dashur Sabiha. I shpjegova gjithçka që kishte ndodhur. Edhe ata më lutën të qëndroja në Tuz me ta. Këtu është e qetë, asgjë nuk do të ndodhë këtu, mos shko në Bosnjë, më thanë. Por unë iu përgjigja, jo, jo, e kam vendosur të iki për në Bosnjë dhe dua të shkoj. Ajo më ndihmoi të vazhdoja udhëtimin për në Shkup.

Në kufi, kufitarët hipën në autobus dhe nxirrnin jashtë autobusit këdo që ishte nga Bosnja dhe kishte vetëm kartë identiteti dhe i dërgonin mbrapsht nga kufiri. Ishte një vend pranë kufirit me Maqedoninë, më pas një zonë neutrale, e ndjekur nga kufiri me Malin e Zi, të paktën, mendoj se kështu ishte. Në realitet, na kthyen në kufirin malazez, ose ndoshta ishte kufiri serb... Serbia dhe Mali i Zi ishin ende bashkë atëherë. Ata ishin ende pjesë e Jugosllavisë. Atje takova një grua. Ajo po udhëtonte me dy fëmijët e saj dhe tha se po përpiqej gjithashtu të shkonte në Kroaci. Mendova, shumë mirë, do të shkojmë së bashku, dhe pastaj unë do të vazhdoj nga Kroacia për në Bosnjë. Burri i saj punonte për Merhametin në Kroaci në atë kohë. Kishte edhe të tjerë me ne. Qëndruam atje gjithë ditën dhe kushdo që përpiqej të udhëtonte për në Shkup, nëse ishte nga Bosnja, nxirrej nga autobusi. Njerëzit përgjegjës ishin të sjellshëm, por na thanë se ishte miratuar një ligj që askush nga Bosnja vetëm me kartë identiteti nuk mund të hynte më në Shkup, tani kërkohej pasaportë. Si mund të kisha pasaportë boshnjake? Në atë të gjithë kishim pasaporta jugosllave, por as nuk më kishte shkuar ndër mend ta merrja me vete, sepse po udhëtoja për në Pljevlja, që ende ishte pjesë e vendit tim. Dikush na këshilloi ta provonim sërish pasdite, këtë herë me taksi, vetëm ne dy gratë dhe dy fëmijët, duke menduar se ndoshta nuk do të na vërenin. Por, përsëri na nxorën nga taksia. Përsëri përfunduam duke pritur aty. Një nga rojet kufitare na sugjeroi, pse nuk provoni përsëri tani, ndoshta kjo linjë autobusi nuk do të kontrollohet kaq imtësisht. Provuam, por na ndaluan sërish dhe na thane, mos bëni lojëra dhe shkoni në Prizren. Mendova, çfarë të bëjmë në Prizren, nuk kam qenë kurrë në Prizren, tani duhet të shkoj atje, pse, çfarë do të bëjmë atje. Gruaja me dy fëmijët pyeti, çfarë ka në Prizren, ndonjë lloj strehimi për boshnjakët apo diçka tjetër. Ata u përgjigjën, nuk e dimë, thjesht shkoni atje, është 100% e sigurt për ju. Qëndruam aty teksa filloi të bjerë terri. Një civil u afrua dhe na pyeti, a jeni nga Bosnja. Ne iu përgjigjëm, po, po, jemi. Ai tha, nëse doni të kaloni kufirin... Më kujtohet qartë që na tha se do të kushtonte 50 marka gjermane për person. Ai tha, dikush do të vijë në orën 8 ose 9, dhe ata do t’ju tregojnë vendin ku do të kaloni kufirin. Mendonim se do të kalonim kufirin në mënyrë të rregullt. Megjithatë, kur pamë kamionin që mbërriti, me të paktën 30 ose 40 njerëz nga Bosnja brenda... na thanë të dorëzonim paratë. Ne ua dhamë paratë dhe ata thane, tani hipni në kamion. Dhe ne hipëm. Parë nga këndvështrimi sot, është e pabesueshme se sa dëshpërimisht një person thjesht dëshiron të mbijetojë, të arrijë destinacionin e vet, pa menduar për pasojat. Ata njerëz mund të na kishin lënë kudo, mund të na

kishin bërë çfarëdo gjëje... Na thane, duhet ta kaloni kufirin në një kohë të caktuar. Nëse nuk e bëni, do të duhet të ktheheni dhe ne nuk do të mund t'ju ndihmojmë më. Prandaj nuk mund të vonohemi. Pastaj thane, mos kini frikë, nëse fillojnë të qëllojnë me armë, nuk do t'ju vrasin, thjesht do të përpiqen t'ju trembin. Në atë rast, do të duhet të kthehemi mbrapsht. Dikur, arritëm ta kalonim kufirin dhe mbërritëm në Shkup.

Në Shkup jetonte motra e shoqes sime nga Tuzi dhe familja e saj. Ajo i kishte kontaktuar paraprakisht, duke i njoftuar se do të arrija dhe duke u kërkuar që të më ndihmonin. Ata vërtetë më kishin gjithë ditën, por nuk kishin arritur të më gjenin. Kishin pyetur secilin autobus që vinte. Burri i kësaj gruaje, të afërmes sonë, që kishte kishte qenë e martuar me kushëririn tim, tha se do të priste deri në mesnatë, sepse e dinte që ndonjëherë njerëzit arrinin me mjete të tjera transporti. Po flitej se boshnjakët po kthehesh-in mbrapsht dhe nuk mund të mbërrinin në Shkup. Nuk e dija kush ishte ai burrë, si dukej, as gruan e tij nuk e njihja. Kur mbërritëm, një burrë i madh, me flokë të zinj, m'u afrua dhe më pyeti nëse isha Sabiha. U tremba dhe e pyeta, si e dini emrin tim, ai tha, jam dhëndri i Bademit. Në atë moment ndjeva një lehtësim të madh.

Shkova dhe qëndrova me atë familje për disa javë. Pastaj u përpoqëm të merrnim disa dokumente. Sërish e njëjta gjë... ata më luteshin të qëndroja, të prisja edhe pak më gjatë. Megjithatë, isha e vendosur të largohesha. Më ndihmuan të merrja një dokument të quajtur patenta për të huajt, ashtu quhej. Ishte si një lloj pasaporte, por kishte kufizime, nuk të lejohej të ndaleshe në asnjë vend gjatë rrugës. Bleva një biletë dhe fillova udhëtimin tim për në Kroaci. Por, problemet filluan përsëri. Kudo që e shikonin atë dokument, askush nuk e kuptonte se çfarë ishte. Më duhej të paguaja tarifa këtu e atje, ndonjëherë shuma të vogla, ndonjëherë më të mëdha. Sa kohë që kisha para, paguaja. Në fund, na nxorën përsëri nga autobusi, mua dhe atë gruan.

Nuk mund ta kujtoj saktësisht se si u takuam përsëri. Kishim mbetur në kontakt, pasi ajo, si unë, po qëndronte në Shkup me dy fëmijët e saj. As ajo nuk kishte pasaportë jugosllave... Jo, nuk kishte. Edhe ajo po përpiqej të rregullonte dokumentet e saj, ashtu si unë. Qëndruam në kontakt dhe vendosëm të udhëtonim së bashku për në Kroaci. Fillimisht, blemë bileta autobusi, por na nxorën nga autobusi, as nuk e kujtoj më në cilin kufi. Pastaj vendosëm të udhëtonim me tren përmes Hungarisë. Në atë kohë, nuk kishte luftë në Kroaci. Plani im ishte të shkoja në Zagreb, pastaj nga Zagrebi në Split, dhe nga Spliti në shtëpinë time në Bosnjë përmes Rrugës së shpëtimit. Ndërsa ajo donte të arrinte tek burri i saj, i cili punonte me Merhametin në Zagreb, edhe pse ajo vetë ishte nga Sarajeva. Në Hungari, na nxorën dy herë nga treni dhe përfunduam të bllokuara në një stacion treni. Pastaj një burrë na u afrua, ishte me uniformë. Nuk e di nëse ishte nga sigurimi apo polic, por më kujtohet që ishte i veshur me uniformë. Ai na pyeti, çfarë po bëni, çfarë po përpiqeni të bëni, i treguam gjithçka. Ai e pyeti atë gruan, a ke burrë, ndonjë mik, dikë në Zagreb, ajo iu përgjigj, po, burri im është atje. Ai tha, atëherë, thuaji të vijë me makinë, do të uleni në makinë dhe do të kaloni kufirin pa asnjë kontroll. Kështu bëmë dhe arritëm në Kroaci. Qëndrova me familjen e saj për edhe dy ose tre ditë. Pastaj u nisa nga Zagrebi për në Split, mora një autobus nga Spliti për në Vitez, dhe më në fund, arrita në shtëpi.

Në fakt, për mua, befasia e vërtetë ishte kur fillova të pyesja veten, çfarë po ndodh këtu në të vërtetë, a ka me të vërtetë luftë në Bosnjë, nuk janë më thjesht fjalë. Kur morëm Rrugën e shpëtimit, kuptova që ajo ishte në fakt rrugë përmes pyjeve, jo përmes qyteteve. Në një moment, autobusi ndaloi në Nova Bila, pranë një taverne

të vogël... Nova Bila nuk është larg nga Vitezi, apo më saktësisht, nga Veçeriska. Më kujtohet që pashë një shofer taksie atje, me një stojadin të kuq. E mbaj mend shumë mirë atë makinë. Iu afrova dhe e pyeta nëse dinte ku ishte Veçeriska ose Vitezi... Ai u përgjigj, sigurisht që e di, është vetëm pesë minuta me makinë, dhjetë maksimum. Unë i thashë, a mund të më çoni atje, më duhet vetëm të marr disa gjëra që kam në autobus. Dhe ai tha se mundej. Kur pashë tabelën për Principqë është pikërisht në hyrje të zonës sime, mendova, më në fund, Principi, më në fund Vitezi, më në fund Veçeriska, ia dola vërtet. Shoferi i taksisë dukej se nuk mund ta besonte atë që dëgjoi dhe më pyeti, e di ku është Veçeriska, e di ku është Principi? Sigurisht që e di, i thashë, jam nga Donja Veçeriska. Ai më pyeti, e kujt je ti, e Omerit. Unë i thashë po. Ai tha, ah, ti je ajo, kushdo që udhëtonte nga Principi për në Split, më parë dëgjonte nga Omeri që u thoshte, nëse e shihni vajzën time, ndihmojeni, silleni në shtëpi, bëni çfarëdo që duhet. Natyrisht, ai donte t'u tregonte menjëherë prindërve të mi lajmin. Më tha, të lutem, a do të qëndrosh në makinë sa të trokas në derë, dua të shoh reagimin e tyre dhe nëse do ta besojnë. Sigurisht, qëndrova në makinë. Ai trokiti në derë, dhe vëllai im i madh, Mujo, dhe babai im dolën. Ata pyetën, ku është Hanifa, nëna ime. Doli që shoferi i taksisë ishte një i njohur nga një qytet tjetër, por unë nuk e kisha dalluar, ai u tha, hajde, filloni të bëni kafe, nxirrni ëmbëlsirat. Familja ime, babai dhe vëllai, ishin krejt të hutuar nga ato që po thoshte dhe e pyetën, çfarë ëmbëlsirash, për çfarë po flet. Nëna ime ndodhej në shtëpinë e hallës aty pranë. Ai tha, hë pra, Sabiha është këtu. Kur më panë, u rrëmbyen nga gëzimi. Por, kur shkuan për të marrë nënën time... Në dhomë ishte një tavolinë ku zakonisht uleshim si familje, dhe të gjithë u ulëm aty. Vëllai im shkoi për ta thirrur nënën time. Ajo erdhi, e pavetëdijshme për atë që po ndodhte dhe ai nuk i kishte thënë asgjë. Kur hyri dhe na pa ulur në tavolinë, unë po e shikoja për të parë nëse do të afrohej, për të parë reagimin e saj. Ajo pyeti, a është kjo Sabiha ime dhe pastaj thjesht u rrëzua pa ndjenja. Askush nuk mund ta kishte imagjinuar që vetëm disa ditë më vonë do të na dëbonin me forcë nga ai vend, duke luftuar për jetët tona.

Gjatë asaj kohe, prindërit e mi pranuan edhe familje refugjatësh nga Sarajeva. Ishte një zotëri i moshuar, gruaja e tij, dy rejat dhe gjashtë fëmijë. Prindërit e mi kishin dy shtëpi familjare, kështu që kishte hapësirë të mjaftueshme. Në atë kohë kishim edhe ushqim të mjaftueshëm, sepse në atë pjesë të Vitezit, ndërkohë lufta zhvillohej në Sarajevë dhe Bosnjën Lindore, jeta në Bosnjën Qendrore ishte ende relativisht normale, të paktën deri në vitin 1993, kur filloi konflikti me HVO-n, apo kroatët. Pastaj, më 16 prill, gjatë natës nisën të shtënat me armë. Më 15 prill, kisha qenë në shtëpinë e shoqes sime, Dragana Llovriqit. Ajo ishte fqinja jonë, dhe vetëm një gardh ndante kopshtet tona. Unë, motra ime dhe Dragana kaluam të gjithë ditën së bashku në shtëpinë e saj. Kur erdhi koha të kthehesha në shtëpi, ajo vazhdonte të thoshte, rri edhe pak, kur do të shihemi përsëri, kur do të takohemi përsëri... Shiko, Sabiha, ti ke munguar për kaq kohë, dhe kemi aq shumë për të biseduar, këtë, atë, gjithçka. Atë mbrëmje, filluan të shtënat me armë. Të shtënat vinin nga shtëpitë përreth. Madje edhe nga shtëpia e Draganës. Dhe ndoshta, teksa motra ime dhe unë ishim te Dragana atë ditë, në atë shtëpi kishte ushtarë që përgatiteshin për të hapur zjarr të nesërmen në mëngjes, rreth orës 5:17. Pikërisht atëherë filloi.

ARD MANET

Shpërngulja

Së pari, ia nisën duke djegur shtëpitë dhe duke qëlluar mbi njerëzit. Ne kishim një shitore ushqimesh, të madhe. Ata hynë në shitore, thyen xhamat dhe filluan të qëllonin. Thyen dritaret, pastaj qëlluan mbi to, mbi çati, mbi gjithçka. Disi, arritëm të zvarriteshim të gjithë në një dhomë, sepse ishte e vetmja dhomë me dritare të paprekura. Kur u dëgjuan të shtënat e para, nëna ime doli me vrap nga shtëpia. Kishim një dhomë që përdorej si strehimore që nga fillimi i luftës. Fqinjët vinin aty sepse e konsideronin vendin më të sigurt. Ishte pjesë e shtëpisë, në fakt një garazh më i madh, i mbrojtur mirë me mure të trasha. Nëna ime vrapoi jashtë duke thënë, nuk e di çfarë po ndodh, por po qëllojnë, po shkoj ta hap. Strehimorja ishte e mbyllur me çelës. Zakonisht, hallat tona më të moshuara ishin të parat që vinin aty sa herë kishte bombardime në Princip. Çfarëdo që ndodhte, gjithmonë kërkonin siguri në atë vend.

Sapo nëna ime doli, hapi derën e strehimores dhe u kthye në shtëpi dhe po bëhej gati të hapte derën e përparme kur një breshëri plumbash erdhi drejt saj. Ajo arriti të futej brenda. Brenda, pranë shkallëve, kishte një kolonë, dhe ajo u fsheh pas saj. Qëndroi aty për disa orë ndërsa të shtënat vazhdonin. Ne mund të dëgjonim zërat jashtë, “Po digjet!”, dhe lloj-lloj thirrjesh të tjera. Dëgjonim gjithçka, sepse gjithçka ishte shkatërruar dhe xhamat ishin thyer. Njëri prej tyre tha, por kjo është shtëpia e Omerit. Në atë kohë, ata e dinin saktësisht se e kujt ishte çdo shtëpi. Pas rreth tre orësh të shtënash intensive, një e afërmja jonë, Fatima, erdhi me vrap. Ajo po qante dhe po lutej, Omer, shpëto babain tim, ai ka humbur dorën, është plagosur, ndihmoje, shpëtoje! Rreshti i shtëpive tona ishte i rrethuar nga fqinjë kroatë boshnjakë. Por, babai im nuk mund të dilte jashtë, as ne nuk mund të dilnim. Po të dilnim në korridor, do të na vrisnin të gjithëve. Atëherë, një nga fqinjët tanë kroatë, i cili ishte me ushtarët, ndërhyri dhe tha, ndaloni, prisni, të shohim si mund ta ndihmojmë. Ata e bartën babain e saj me një karrocë dore, i mbuluar në gjak. Na thanë të shkonim në një zonë ku jetonin vetëm boshnjakë. Të gjithë u nisëm, së bashku me disa familje të tjera nga ato shtëpi, ndërsa ata na drejtonin se ku të shkonim. Gjatë rrugës, me sytë e mi pashë se si vranë kushërirën tim, Mehon. Thjesht e pyetën, si e ke emrin, ai tha Meho dhe ata Ata qëlluan një breshëri të tërë plumbash mbi të. Ata qëllonin mbi burrat ndërsa ne lëviznim, edhe pse fqinji ynë thërriste që të ndalonin dhe të linin njerëzit të kalonin. Përgjatë rrugës ishin pozicionuar snajperë. Pastaj përfunduam në zonën ku na kishin grumbulluar, të destinuar për myslimanët. Qëndruam aty për dy ose tre netë, dhe burrat përpiqeshin të rezistonin, por ishte thjesht e pamundur. Megjithatë, shpresa vdes e fundit, falë Zotit për këtë. Ishte e pamundur, sepse lagjja jonë ishte e rrethuar nga të gjitha anët: nga Principi, kompleksi ushtarak, nga tre anë, dhe nga ana tjetër ishte Gornja Veçeriska, ku jetonin kroatët. Nuk kishim asnjë rrugë shpëtimi. E vetmja mundësi që mbetej ishte të luftonim, që të siguronim se nuk do të na vrisnin të gjithëve.

Pastaj erdhi UNPROFOR-i për të vëzhguar çfarë po ndodhte, por në të vërtetë nuk ndihmonin askënd, përveç rasteve kur civilët ishin të plagosur. Pas natës së tretë, herët në mëngjes, vendosëm të përpiqeshim të largoheshim. Arritëm në Viteshko Polje, duke udhëtuar me makina, kamionë apo çfarëdo që dikush kishte mundur të përdorte për t’u arratisur. Por kur u përpoqëm të shkonim më tej, na ndaluan. Për shembull, nëna ime u ndalua së bashku me një grup në një vend të quajtur Grbavica, pranë Vitezit. Babai im, motra, vëllezërit dhe unë arritëm të shkonim më tej, sepse nuk po udhëtonim bashkë, dhe mbërritëm në fshatin Zabilje. Por edhe aty na ndaluan. Na

kthyen mbrapsht në shkollën në Zabilje, që ndodhej në një zonë kroate. Pavarësisht vapës, na mbajtën aty pothuajse gjithë ditën, duke u përpjekur të vendosnin çfarë të bënin me ne. Pastaj na thanë, mirë, të gjithë shkoni drejt Grbavicës, sepse Grbavica kishte një popullsi kryesisht myslimane-boshnjake. Kështu që u nisëm për atje. Qëndruam në Grbavicë për një ditë, mendoj. Njerëzit atje na ndihmuan të ndërroheshim, të laheshim dhe të hanim. Pas kësaj, nisëm udhëtimin tonë drejt Zenicës, por na duhej të udhëtonim natën për të shmangur që të na shihnin snajperët. Udhëtimi ishte jashtëzakonisht i gjatë dhe i gjithë në këmbë. Kur mbërritëm në Lupac, një vend afër Zenicës, qëndruam aty, dhe popullata lokale na priti shumë ngrohtësisht. Ishte kontrast i madh me disa vende të tjera, ku njerëzit thjesht na thonin, vazhdoni, mos qëndroni këtu, mos na sillni telashe, duke menduar se mund të shpëtonin nëse nuk na strehonin. Në Lupac, na vendosën nëpër familje të ndryshme, dhe jeta filloi të normalizohej disi.

Edhe në Lupac kishim disa miq, edhe një vajzë që kishte jetuar me mua. Ajo ishte regjistruar në medrese në vitin 1990, por nuk kishte arritur të rrinte në konvikt. Disa nga mësuesit e saj kishin sugjeruar që të qëndronte me mua. Në atë kohë, isha studente dhe kisha apartamentin tim. E mora dhe e ndihmova të përshtatej, duke ditur sa sfiduese mund të ishte ajo periudhë. E mbështeta me studimet dhe gjëra të tjera. Familja e saj mbërriti në Lupac dhe thanë, ju do të jeni mysafirët tanë. Qëndruam me ta për tre javë, ndoshta edhe një muaj. Pastaj kuptuam se nuk mundeshim thjesht të rrinim, duke pritur dhe duke diskutuar nëse lufta kishte mbaruar. Një ditë, motra ime dhe unë vendosëm të shkonim në këmbë në Zenicë, sepse kishim dëgjuar që shumë nga fqinjët dhe të afërmit tanë kishin mbërritur atje dhe po qëndronin në një kamp refugjatësh. Kampi ishte ngritur në një shkollë fillore aty pranë. Shkuam atje dhe vërtet pamë disa nga të afërmit tanë. Ishte një sallë e madhe me vetëm disa dyshekë të hollë në dysheme. Rreth njëqind njerëz jetonin aty, hanin së bashku dhe kishin vetëm dy ose tre tualete shkolle në dispozicion. Ushqimet siguroheshin nga një kuzhinë e përbashkët e komunitetit. Unë thashë, mirë pra, të flasim me mamin dhe babin për këtë, sepse babai im ishte plagosur gjatë udhëtimit. Gjatë largimit nga shtëpia, atë e kishin qëlluar. Ata më thanë, Sabiha, duhet të regjistrohesh këtu në qendrën e refugjatëve, tregoju për gjendjen tënde, që ke prindër dhe që babai është i plagosur. Ndoshta ata do të të ofrojnë një vend tjetër për të qëndruar. Ashtu bëra. Regjistrova të gjithë familjen dhe më dhanë karta për ta. Ata na caktuan edhe një shtëpi, një shtëpi serbe që ishte braktisur. Kur shkuam ta shihnim, kërkonte shumë pastrim...

Pastruam dhe pastruam për dy ose tre ditë dhe më pas u kthyem në Lupac për t'u treguar prindërve tanë. Por prindërit thanë, si mund të jetojmë në një shtëpi serbe, si mund të jetojmë në shtëpinë e dikujt tjetër, uk është shtëpia jonë, nuk mund ta imagjinojmë as ta bëjmë këtë. Ua shpjegova, ashtu siç ma kishin shpjeguar në qendrën e refugjatëve, kjo është situata tani, dhe me shumë gjasa dikush tjetër po jeton edhe në shtëpinë tuaj. Më në fund, arritëm t'i bindnim. U nisëm për në Zenicë.

Shkoja çdo ditë në kampin e refugjatëve. Rrinim, bisedonim dhe kalonim ditët aty. Një ditë, pyeta, çfarë do të thotë kjo, të flasim vetëm për atë që ka ndodhur në front, nëse dikujt i është kursyer shtëpia, kush ka vdekur, kush është plagosur, kështu do ta shkatërrojmë veten. Ndaj, bisedova me drejtuesin e kampit të refugjatëve, ashtu mendoj se quhej pozita atëherë, dhe e pyeta nëse mund të na jepte një hapësirë për të provuar ta normalizonim disi jetën tonë. Duhet të vazhdojmë të jetojmë, i thashë. Ai pranoi. Pastaj u organizuam. Ne, gratë dhe vajzat, bëmë një orar: çfarë do të bënim, kur do të takoheshim, çfarë donim të diskutonim dhe çfarë mund të mësonim nga

njëra-tjetra. Planifikuam edhe vizita në spital, sepse atje kishte shumë të plagosur, dhe vendosëm kë mund të vizitonim, duke ditur se për ta mund të kishte shumë rëndësi nëse nuk kishin më askënd që t'i vizitonte. Kështu filloi. Më vonë, vizitova Komunitetin Islamik dhe ata më ofruan një punë. E pranova. Nuk kishte rrogë, por ofronin pako ushqimore, të cilat ishin shumë më të vlefshme dhe të rëndësishme sesa paraja në atë kohë. Pavarësisht kësaj, vazhdova të punoja me gratë dhe vajzat në shkollën fillore "Musa Qazim Qatiq," ku ndodhej kampi.

Themelimi i Medica-s dhe përfundimi i luftës

Medica u themelua më 16 prill. Kur më vizituan, më pyetën çfarë po bëja, dhe unë ua shpjegova. Ata më thanë, pikërisht kjo është ajo që duhet bërë me gratë që kanë përjetuar këto trauma. Më ftuan t'i bashkohesha Medica-s dhe u impresionuan nga mënyra si isha organizuar dhe si komunikoja. Kur pashë gratë e mbledhura aty për të ndihmuar gratë e tjera, ishte sikur të shihja një Bosnjë të vogël: gra të etnive, nivelit arsimor, besimeve dhe prejardhjeve të ndryshme. Megjithatë, të gjitha kishin një qëllim të përbashkët: të ndihmonin gratë dhe vajzat gjatë luftës. Punova si vullnetare për rreth gjashtë muaj, ndoshta edhe më shumë. Kur panë si punoja, me një qasje të natyrshme, të ndjeshme dhe mbi të gjitha njerëzore, më ofruan një pozicion në stafin e tyre. Që atëherë, jam pjesë e Medica-s dhe vazhdoj të punoj aty edhe sot e kësaj dite. Sigurisht, ishte proces pune dhe mësimi. Më pëlqente të shkoja nëpër fshatra dhe të ndërtoja lidhje me gratë. E dija që gratë nuk do të dëshironin të flisnin për atë që kishin përjetuar ose parë. Doja, disi, të përcillja mesazhin se përdhunimi mund të kishte ndodhur edhe me mua apo me këdo tjetër. Kur na ndaluan jashtë shkollës, të gjitha jetonim me frikë, sidomos vajzat dhe gratë, duke menduar nëse do të na merrnin. Ata zgjidhnin dhe tërhiqnin kë të donin, duke bërë çfarë të dëshironin. Doja të thoja se kjo nuk ishte turp, nuk ishte diçka për t'u fshehur, sepse dikush na kishte shkaktuar dhimbje ose kishte tentuar të na poshtëronte, apo madje ia kishte arritur ta bënte këtë. Si pjesë e punës sime me Medica Zenica-n, propozova vizita në shtëpi. Thashë, si e diplomuar e medresesë, si një mualime dhe studente e teologjisë, mund të hyj në shtëpi dhe të flas me gratë për jetën e tyre.

Në ato çaste, nuk e kisha prioritet mbledhjen e të dhënave, e di. Më e rëndësishmja për mua ishte të hyja në shtëpinë e një familjeje, të tregoja interes të sinqertë për mënyrën se si jetonin, t'i informoja se kush mund t'i ndihmonte, çfarë nënkuptonte regjistrimi si refugjatë, si mund t'i ndihmonte Medicadhe çfarë ishte Medica. Nuk kishte protokolle strikte, por mbështetesha në atë që kisha mësuar gjatë arsimimit dhe në intuitën time. U afrohesha atyre ashtu siç do të doja që të tjerët të më afroheshin mua, duke menduar se çfarë do të më ndihmonte mua nëse do të isha në situatën e tyre.

Intuita ishte jashtëzakonisht, jashtëzakonisht e rëndësishme. Krahas arsimit formal dhe dëshirës për të respektuar dhe ndihmuar qeniet njerëzore, intuita më jepte ndjenjën se mund ta shpëtoja dikë, të paktën nga mendimet e tyre negative. Ai besim, që jeta duhet të vazhdojë, që sfidat vijnë dhe shkojnë, dhe që Zoti na jep forcën për t'i kapërcyer ato, e ndryshonin situatën. Më ndihmoi edhe të kuptoja se këto sfida na mësojnë diçka të re, veçanërisht për veten tonë. Edhe një pyetje e thjeshtë, që tregonte kujdes dhe shqetësim, kishte shumë rëndësi për kaq shumë njerëz: si je, si po e kalon kohën?

Në fillim, shkoja te fqinjët e mi nga qyteza e lindjes, e dija ku ishin strehuar. Vizitoja edhe miqtë e mi, pasi e dija se ku ishin vendosur. Dhe natyrisht, shkoja pothuajse në të gjitha pikat e refugjatëve. Prezantoja Medica-n, duke shpjeguar që Medica Zenica ofronte strehim për disa gra dhe fëmijë, aty kishte mbështetje mjekësore, kishte mundësi për biseda...

Sigurisht, gratë nuk flisnin menjëherë se kishin përjetuar përdhunimin, dhe nuk njihja asnjë grua që të kishte ardhur dhe menjëherë të thoshte, më kanë përdhunuar dhe dua të flas me ju. Pra, pasi prezantonim atë që ofronte Medica dhe shpjegonim se çfarë lloj organizate ishte, thoshim se gjëra të ndryshme po ndodhin në këtë luftë, siç e shihnim të gjithë, dhunë, dëbime, vrasje, djegie dhe i siguronum duke u thënë se gjithçka do të kalonte dhe do të fillonte një jetë e re, që veçse kishte filluar. Dhe pastaj pyesnim, çfarë është për ju më e vështira në këtë moment, kur mendoni për gjithçka që ka ndodhur? Kështu ia nisnim bisedave së bashku. Dhe pastaj, ngadalë, gratë nisnin të çeleshin dhe të ndanin tregimet e tyre.

Kështu nisën të shfaqen disa nga ato trauma, ngjarje të ndryshme traumatike shpërfaqeshin gjatë bisedave. Pastaj unë, por edhe koleget e mia, thonim, pikërisht për këtë duhet të flasim. Kjo është ajo që duhet të tregojmë, që ta nxjerrim nga vetja. Edhe kur gjeja kohën të flisja me to individualisht, gratë nuk tregonin menjëherë për përdhunimin. Në fillim, ato tregonin se si gra të tjera i kishin marrë dhe se kishin qenë bashkë gjatë atyre momenteve. Pas disa takimesh, gratë dalëngadalë ndërtonin besimin dhe kur me të vërtetë besonin se po i dëgjoje, apo po i kuptoje, fillonin të ndjenin lehtësim kur rrëfenin tregimin e vet dhe më në fund, thonin, epo merrnin njerëz... më morën edhe mua, edhe mua ma bënë.

Ndërkohë që unë punoja në Medica, babai im merrte trajtim mjekësor. Ai qëndroi me ne dhe nuk shkoi në luftë. Ishte me ne, me familjen. Dy vëllezërit e mi u mobilizuan. Vëllai im i madh u mobilizua menjëherë. Vëllai im më i vogël sapo kishte përfunduar shkollën e mesme dhe po mendonte për universitetin kur u detyrua të merrte armë në dorë. Të dy ishin në front. Babai im qëndroi me ne në shtëpi. Sa i përket vëllait tim, Mujo, gruaja e tij dhe vajza e vogël kishin shkuar për të vizituar prindërit e saj vetëm një ditë para se të dëboheshim. Kunata ime kishte shkuar në shtëpinë e prindërve të saj në një zonë të afërt të quajtur Riçice, pranë Bilës. Pas kësaj, vëllai im humbi kontaktet me to sepse komunikimi nuk ishte më i mundur. Sapo arriti të ribashkohej me to, HVO-ja e sulmoi atë zonë. Ata i grumbulluan burrat, si ta them, i ndaluan, dhe vëllai im ishte midis atyre që u kapën.

Por edhe në mes të së keqes, ka njerëz të mirë. Kështu, një nga fqinjët tanë, një kroat, e ndihmoi vëllain tim të lirohej, të largohej. Ai u lirua kur popullsia civile u dëbua nga ajo zonë. Ata organizuan dëbimin duke detyruar njerëzit të zhvendoseshin nga aty në një zonë tjetër boshnjake, më afër vijave të frontit. Përfundimisht, ata arritën në Han Bila. Pasi mbërriti në Han Bila, vëllai im duhej të kthehej sërish në vijën e frontit. Ndërkohë, prindërit tanë donin të qëndronin pranë mbesës dhe kunatës sonë, por gjithashtu kuptuan se duhej të luftonin për të siguruar ushqim. Ata gjetën një shtëpi të vogël dhe pak tokë atje dhe filluan të merren me bujqësi, duke rritur gjithçka që mundnin për të na ushqyer. Në mes të luftës, të shtënave dhe gjithçkaje tjetër, ushqimi mungonte dhe kishte kosto të lartë. Nëse kishte diçka për të blerë, njerëzit shkëmbenin para, ar, ose sende me vlerë për të. Për ne ishte lehtësim që prindërit tanë filluan të prodhonin ushqim në Han Bila. Ishte afër në distancë, por në atë kohë dukej aq larg. Motra

ime dhe unë ecnim nga Zenica në Han Bila, rreth gjashtë orë në këmbë. Niseshim herët në mëngjes për të sjellë çfarëdo që mundnim, si domate, patate ose disa perime, dhe ktheheshim në Zenicë po atë ditë.

Vëllain tim, Mujon, ushtria serbe e kapi përsëri, ndërsa kthehej nga vijat e frontit në Vllasiq. Ishte kohë jashtëzakonisht e vështirë, rreth 40 ditë nuk e dinim ku ishte apo çfarë i kishte ndodhur. Ishte dimër dhe pasiguria ishte e tmerrshme. Por sërish, kishte njerëz të mirë. Fillimisht, atë e ndauan në Kotor Varosh dhe më pas e transferuan në Banja Lluka, por ne nuk dinim gjë. Kryqi i Kuq Ndërkombëtar përpiqej të mblidhte informacione, por askush nga njësia e tij nuk dinte gjë për vendndodhjen e tij. Pastaj, një burrë... Në atë kohë, pas luftës në 1995, disa linja telefonike filluan të funksiononin përsëri deri në 1996. Dhe një burrë na telefonoi në linjën fikse, ishin ditët e telefonave fiks, nuk dimë as si, dhe tha, mos pyesni kush jam, çfarë bëj, apo nga po telefonoj, po telefonoj vetëm për t'ju thënë se Mujo është gjallë dhe ndodhet në Banja Lluka. Shkoni menjëherë dhe raportojeni këtë te Kryqi i Kuq Ndërkombëtar. Kurrë nuk e morëm vesh kush ishte ai njeri. Si duket vëllai im ia kishte dhënë numrin tonë të telefonit dhe ai vërtet u kujdes të na njoftonte. Kështu mësuam për Mujon, dhe pas kësaj filloi procesi i shkëmbimit të të burgosurve. Përfundimisht, ai u lirua dhe u kthye tek ne nga Banja Lluka.

Ajo çka vëllai ynë thotë për atë kohë është se pjesa më e vështirë për të ishte qëndrimi në izolim. Ai na ka treguar edhe si u kap: sapo kishte përfunduar ndërrimin e tij dhe po kthehej në këmbë. Kishte marë një rrugë më të shkurtër për të arritur më shpejt, por katër ushtarë e kishin rrethuar, i kishin bërtitur "Duart lart!" dhe, siç tha ai, i kishte pyetur, ç'është kjo lojë, sepse ata mbanin shenja të Ushtrisë së Bosnjës dhe Hercegovinës. Ai thjesht nuk dëshiron të flasë për atë periudhë të jetës së tij. Si motra e tij, kam provuar të bisedoj me të, tani që ka kaluar kohë, thjesht për të kuptuar çfarë ka ndodhur…

Ai thotë, nuk dua të flas për këtë, Sabiha. Ka ndodhur, le të mos ndodhë kurrë më. Dhe unë i them, por do të ndodhë, nëse nuk flasim për të. Duhet t'i dimë edhe pjesët e shëmtuara për t'i parandaluar. Ai ka kaluar nëpër kriza, sidomos menjëherë pas lirimit, gjatë kohës së tij në Zenicë e kështu… Megjithatë, kur u kthye në shtëpi, dukej sikur ishte pajtuar me faktin që kjo ishte pjesë e jetës së tij. Shumë shpejt gjeti punë në FIS, një nga kompanitë e para private që filloi të funksiononte në zonën e Vitezit. Ai e fitoi punën falë njërit prej fqinjëve tanë, një kroat, që e njihte mirë dhe i tha, Mujo, e dimë që ishe një tregtar i mirë, një njeri i ndershëm dhe vjen nga një familje e respektuar. Nëse të pëlqen, mund të fillosh punë në FIS. Më vonë, ai pati një vajzë tjetër. Vajza, të cilën e quajmë "fëmija i luftës," Mediha, u martua dhe lindi nipin tonë, Rejhan. Kështu, ai i dha formë jetës së tij përsëri.

Vëllai im më i vogël ishte tetëmbëdhjetë vjeç në kohën e luftës. Ai shpesh thotë, m'u desh të shkoja në luftë, askush nuk më pyeti, as nuk e dija çfarë ishte pushka apo si përdorej, dhe ata më dërguan në vijën e frontit, plotësisht të vetëdijshëm se mund të vdisja në çdo moment. Ai i kritikon shpesh politikanët. Edhe i kritikoj, edhe të tjerët kritikojnë, por kritikat e tij vijnë nga një pakënaqësi e thellë. Emri i tij është Omer, si i babait tonë, por ne e quajmë Dilber. Edhe sot, ai është ende i zemëruar. Ka një familje, drejton biznesin e tij, është sipërmarrës, por është i zemëruar, sepse i kanë marrë vitet më të mira të jetës së tij.

Motra ime e madhe tani është e martuar dhe jeton në Zenicë. Ajo ka dy fëmijë, një djalë dhe një vajzë. Djali ka përfunduar masterin në inxhinieri elektrike, ndërsa vajza është në vitin e dytë të studimeve në Sarajevë. Gjithmonë kemi pasur marrëdhënie të mira, por kur bëhet fjalë për tema si lufta, si ia dolëm dhe si mbijetuam, ato biseda shmangen. Duket sikur këto janë histori që njerëzit nuk duan t'i diskutojnë në këto kohë. Gjatë asaj periudhe, edhe ajo u përpoq të ndihmonte të tjerët duke punuar me një organizatë humanitare nga Katari. Jeta në atë kohë sillej vetëm rreth ndihmës për të tjerët, për të ndihmuar veten dhe për të besuar se jeta do të normalizohej përfundimisht. Ajo u martua teksa ende jetonte në Zenicë, ndërsa prindërit tanë ishin atje, përpara se ata dhe vëllezërit tanë të ktheheshin në Donja Veçeriska. Tani, ajo është e punësuar.

Përgjithësisht mund të them përgjithësisht se prindërit e mi ishin jashtëzakonisht punëtorë të palodhshëm. Ata kishin katër fëmijë. Nëna ime ishte shtëpiake, ndërsa babai punonte në një ndërmarrje ushtarake në sektorin e sigurimit. Ata punuan pa pushim për të siguruar sa më mirë të ardhmen e fëmijëve të tyre. Nëna ime kishte shpirt të gëzuar dhe gjithmonë buzëqeshte. Njerëzit ende flasin për mënyrën si u nda nga jeta, me buzëqeshje në fytyrë. Edhe gjatë momenteve të vështira, sepse çdo jetë ka sfidat e veta, ajo disi arrinte t'i përballonte të gjitha me një buzëqeshje. Ishte shumë e dashur në komunitet. Kushërinjtë tanë shpesh thonë se ishin të lumtur kur prindërit e tyre u thoshin se do tí kalonin pushimet e shkollës me ne, sepse e dinin që Tezja Hanifa do të përgatiste gjithçka që ata donin. Ajo e adhuronte gatimin. Ajo gjithnjë sigurohej që asnjë fëmijë të mos shkonte në shkollë pa i përgatitur gjithçka: ushtipka, kafe të bardhë, sanduiçe dhe shumë të tjera.

Babai im kishte një shtëpi. Më vonë, kur u rritëm, vendosi të ndërtonte edhe një tjetër. Ai donte të ndërtonte një shtëpi që do të kishte hapësira banimi dhe një hapësirë për lokal, me garazhe të rregulluara dhe më shumë dhoma, pasi tashmë ishim katër fëmijë. Kështu, ata vendosën të ndërtonin një shtëpi më të madhe familjare. Isha ende një vajzë e vogël, ndoshta në klasën e pestë ose të gjashtë, kur ndërtuan shtëpinë e re. Më vonë, kur vëllai im u martua... Isha në shkollë të mesme atëherë dhe ata vendosën të ndërtonin një shtëpi tjetër familjare. Kjo shtëpi tani është e vëllait tim, sepse kur e përfunduan ndërtimin, babai im donte që vëllai im dhe gruaja e tij të kishin një shtëpi të tyren. Të gjitha ndajnë të njëjtin oborr dhe kopsht të madh, por babai mendonte se ata duhej ta kishin shtëpinë e vet. Si familje, gjithmonë e kemi mbështetur njëri-tjetrin. Babai punoi shumë për të siguruar që secili të kishte një nivel rehatie dhe pavarësie, që është kaq i rëndësishëm dhe i vlefshëm.

Vitezi është një nga ato vende ku, për fat të keq, ende kemi dy shkolla nën një çati, me kurrikula krejtësisht të ndryshme, histori të ndryshme… Besoj se vizitat e mia të rralla në Vitez sot janë kryesisht pasojë e luftës. Aty ndodhi një e keqe e madhe. Pranë Vitezit është Ahmiqi. Në të njëjtën ditë, më 16 prill, teksa ndohnin mizoritë në Ahmiqi, edhe ne luftonim për të mbijetuar, pasi na kishin detyruar të largoheshim nga shtëpitë tona dhe të shkonim drejt pjesës boshnjake të zonës ku jetoj.

Kjo është pikërisht ajo që ndodhi në Ahmiqi, në orët e para të mëngjesit, civilët u sulmuan. Ata u masakruan. Hynë në shtëpi, morën njerëzit, i përdhunuan, i detyruan të hidheshin nga katet e treta ose të katërta dhe më pas qëlluan mbi ta me breshëri plumbash. Një nga miqtë tanë, një djalë, i mbijetoi masakrës në Ahmiqi, edhe pse pothuajse e gjithë familja e tij u vra. Në fillim, vranë vëllanë e tij. Pastaj e detyruan atë

të hidhej dhe qëlluan mbi të me një breshëri plumbash teksa binte. Ai ra, ndoshta nga kati i dytë. Disi përfundoi nën trupin e vëllait të tij dhe ia doli të rrinte aty gjithë ditën, duke qëndruar pranë trupit të pajetë të vëllait të vet. Më vonë, një fqinj kroat aty pranë, duke parë që diçka po ndodhte pasi ushtarët kishin lënë fshatin, i thirri dhe e pyeti, a je gjallë? Ai ishte vogëlish, ndoshta rreth dhjetë vjeç, ndoshta edhe më i vogël. Ky fqinj kroat e mori dhe e fshehu për disa ditë në shtëpinë e tij, duke e mbrojtur nga ushtarët. Përfundimisht, me ndihmën e UNPROFOR-it, fqinji arriti ta dërgonte djalin në Zenicë. Kjo ndodhi në Ahmiqi. Ndërsa në Veçeriska, të gjithë të moshuarit që kishin mbetur aty, përfshirë hallat, kushërinjtë e mi dhe disa të afërm të tjerë, u vranë, si civilë, në shtëpitë e tyre. Ata kishin qëndruar, sepse besonin se askush nuk do t'i dëmtonte, duke menduar se ata ishin fqinjët e tyre. Më vonë, pas përfundimit të luftës, trupat e tyre u identifikuan dhe iu bë varrimi i duhur.

U kthyem në Vitez, në shtëpinë tonë, në vitin 1998. Babai dhe vëllezërit e mi ishin të parët që u kthyen. Në shtëpitë tona jetonin kroatët. Njëri prej tyre madje kishte hapur dyqan në lokalin e shtëpisë sonë familjare. Shtëpitë nuk ishin djegur, por ishin dëmtuar rëndë. Kur më në fund morëm dokumentet që na lejonin të ktheheshim, babai dhe vëllezërit e mi, së bashku me të afërm të tjerë, filluan të shkonin çdo ditë për të pastruar, riparuar dhe rregulluar gjërat, që të mund të ktheheshim. Kroati që jetonte në shtëpinë e vëllait tim bëri një marrëveshje me të, duke thënë se i duheshin disa ditë për t'u larguar. Mirëpo, shtëpia familjare, që kishte edhe lokal, u bë problem. Fqinji kroat që jetonte aty e vonoi largimin dhe kërkoi para, sidomos për shitoren, duke pretenduar se pas luftës kishte investuar në atë hapësirë, e cila ishte dëmtuar rëndë pasi për një kohë ishte përdorur si një lloj barake ushtarake. Ai argumentoi se ajo ishte shkatërruar dhe se i ishte dashur të investonte për ta rindërtuar. Në fund, ai lejoi prindërit e mi të ktheheshin dhe të jetonin në katin e sipërm, por refuzoi të lironte dyqanin dhe këmbënguli që ata të paguanin 3,000 marka gjermane, pasi kjo ishte valuta e përdorur në atë kohë.

Në vitet 1997/98, kur prindërit e mi duhej të ktheheshin, u paraqit pronari i shtëpisë. Ai kishte jetuar jashtë, në Gjermani. Ishte një serb nga një fshat afër Zenicës. Kur u kthye, shkoi në stacionin e policisë, sepse nuk ishte i sigurt se si do të reagonim. Ai tha se dëshironte të shihte shtëpinë e tij. E di që aty jetojnë refugjatë dhe nuk dua të kem probleme… Policia më pas erdhi te dera jonë. Burri quhej Sllobodan dhe sot ai është mik i yni; lufta ka mënyrë të çuditshme se si i bashkon njerëzit. Në atë kohë, nuk e njihnim. Babai im doli jashtë, dhe polici dhe ky burrë po qëndronin aty. Polici pyeti, a A është kjo shtëpia juaj dhe babai im u përgjigj, jo, nuk është shtëpia ime. A e dini e kujt është kjo shtëpi? E di që i përket një burri që jeton në Gjermani, një serbi, por ai nuk ka kontaktuar kurrë me ne. Më pas, polici tha, ky është pronari i shtëpisë. Atëherë babai im tha, në rregull, atëherë, ju lutem hyni në shtëpinë tuaj.

Shtëpia ishte në Zenicë, në Zmajevac. Burri mbeti pa fjalë që një refugjat, në shtëpinë e tij, po i ofronte mikpritje, ndërkohë që ai kishte frikë se çfarë do të gjente, dhe po i ofronte një vend për të qëndruar. Ai tha se do të kthehej në fshat, por do të ishte në kontakt. Disi, u bëmë miq me të. Më vonë, babai im e ftoi atë në Veçeriska, ku ndodhet shtëpia jonë familjare. Me kalimin e kohës, krijuam një miqësi të sinqertë. Filluam të kalonim kohë së bashku, duke u shoqëruar. Gruaja e tij, e cila është gjermane, më në fund shprehu dëshirën të na vizitonte. Herën e parë që erdhi, ai erdhi vetëm, pa gruan, sepse nuk e dinte çfarë e priste. Ata u afruan sidomos me vëllanë tim, Mujon, dhe gruan e tij. Sa herë që vinin për të vizituar, pasi vëllezërit dhe prindërit e mi ishin kthy-

er në shtëpinë tonë familjare, rrinim të gjithë së bashku. Ata vinin gjatë verës, qëndronin në një dhomë, ndërsa ne qëndronim në një tjetër, pasi shtëpia kishte tre dhoma. Ata kishin edhe një djalë, i cili po ashtu kishte qejf të na vizitonte.

Kur prindërve të mi iu desh të ktheheshin, unë atëherë thashë se do të gjeja një apartament me qira. Punoja në Zenicë dhe nuk doja të kthehesha. Atëherë, Sllobodani tha, jo, nuk do të marrësh banim me qira, do të jetosh këtu sa të duash, pa qira. Pastaj i ofrova qiranë. Ai tha, jo, jo, asnjë qira, asgjë. Do të rrish këtu sa të kesh nevojë, ndjehu sikur të jetë shtëpia jote. Tani do të përgatis një kontratë, që askush të mos të shqetësojë. Dhe vërtet ai e përpiloi kontratën që më jepte të drejtën për ta përdorur shtëpinë, gjithçka që lidhej me atë shtëpi, duke transferuar të drejtën tek unë. Unë jetova aty deri në vitin 1999. Deri në vitin 2000. Pastaj, në vitin 2000, bleva një apartament më të vogël në një pjesë të Zenicës. Atëherë i thashë Sllobodanit se do të largohesha nga shtëpia dhe do t'ia dorëzoja shtëpinë, sepse e kisha blerë një apartament, por doja ta dorëzoja kur ai të ishte në Bosnjë, që të pranonte gjithçka dhe të shihte që gjithçka ishte ashtu siç duhej të ishte.

Isha në vitin e dytë të fakultetit kur filloi lufta. U shpërngula. Dhe kur erdha në Zenicë, asgjë nuk funksiononte. Pastaj u diplomova në Fakultetin e Pedagogjisë Islame këtu, asokohe quhej Akademia. Dhe unë tashmë i kisha plotësuar kushtet, dhe kur u bë e mundur të shkoja në Sarajevë pas luftës, menjëherë rifillova studimet dhe vazhdova të studioja duke punuar. Kështu që u diplomova, mendoj, në vitin 2000, 23 vite më parë. Kur përfundova universitetin, shkova në Amerikë për specializim, u diplomova dhe jam psikoterapiste e certifikuar, sepse kuptova sa shumë më duhej ajo pjesë e edukimit për të punuar me njerëzit. Më pas përfundova një master në menaxhimin e çështjeve shtetëtore dhe humanitare në Sarajevë. Në vitin 2019, përfundova doktoraturën në studime gjinore, po në Universitetin e Sarajevës.

Mendoj se, nëse feja interpretohet siç duhet, këtu po flas për Islamin, por kam mësuar edhe për krishterimin dhe fetë e tjera monoteiste, veçanërisht përmes studimeve, feja, për shembull Islami, në thelb mbështet barazinë. Në Kur'an, për shembull, ekziston një sure që quhet En-Nisa, Gratë. Ka aq shumë hapësirë dhe vend për një grua; nuk do ta dija këtë me siguri nëse nuk do të kisha vendosur të studioja. Gratë luajtën një rol kaq të rëndësishëm në jetën fetare të profetëve, aq sa nuk ekzistonin ato dallime për të cilat na flisnin gjatë jetës sonë. Prandaj, nuk kam gjetur askund në Kur'an që të flitet për nënshtrimin e një fëmije vajzë krahasuar me një fëmijë djalë. Jam e bindur dhe besoj, dhe e praktikoj që parimet feministe janë shumë komplementare me parimet e vërteta fetare, thjesht duhet t'i vëmë në pah dhe t'i interpretojmë ato siç duhet.

Mendoj se jam lindur që të më bezdisin stereotipet dhe rolet gjinore. Sot, kur punon me gra që kanë mbijetuar, është jashtëzakonisht e rëndësishme të kuptosh dhe t'i ndihmosh ato gra që janë rritur me bindjen se ato janë fajtore, se ato duhet të mbrojnë veten, se ato janë ato që mund të provokojnë të tjerët. Ishte shumë e rëndësishme t'u shpjegohej grave që kanë mbijetuar dhunën seksuale dhe përdhunimin se ato nuk janë fajtore, se kjo nuk ka të bëjë aspak me to apo sjelljen e tyre, dhe se ato, sidomos gratë që e konsideronin dhe identifikonin veten si besimtare, nuk janë më pak besimtare tani sepse kanë mbijetuar përdhunimin. Ishte diçka që ndodhi, jashtë kontrollit të tyre, dhe që mund t'i ndodhë kujtdo tjetër. Prandaj, në Bosnjë dhe Hercegovinë, pikërisht në Zenicë, ne kërkuam që komuniteti islam të shprehej për çështjen e grave të përdhunuara dhe të lëshonte një rregull fetar. Sepse kishte familje që nuk i pranonin ato gra. Kishte familje që thoshin, në rregull, do ta pranoj fëmijën tim, vajzën time, por nuk do ta pranoj fëmijën që ajo lindi si pasojë e përdhunimit. Në fakt, në Medica Zenica, shumica e grave me të cilat punuam gjatë asaj kohe ishin boshnjake, pasi numri më i madh i grave të përdhunuara gjatë luftës në Bosnje ishin boshnjake. Megjithatë, kjo nuk përjashton faktin që edhe gra të nacionaliteteve dhe grupeve të tjera etnike u përdhunuan. Sipas boshnjakëve, ishte një qasje sistematike ndaj përdhunimit, si një lloj arme lufte. Megjithatë, asnjë nga ushtarët që përdhunuan gratë boshnjake nuk u mbajt përgjegjës, ndryshe nga rastet që përfshinin ushtarë që përdhunuan gra kroate ose serbe, apo gra të etnive të tjera, disa prej të cilëve u sanksionuan edhe gjatë luftës. Kjo e bëri jashtëzakonisht të rëndësishme të kishim mbështetjen e Komunitetit Islamik, dhe për herë të parë në histori, u mor një qëndrim i tillë. Ato gra meritonin respekt, duhej të pranoheshin, dhe në asnjë mënyrë nuk duhej të fajësoheshin apo stigmatizoheshin, ato nuk ishin më pak të vlefshme apo të etiketuara. Nuk e di nëse ky ndryshim do të kishte ndodhur nëse ne në Medica nuk do të kishim këmbëngulur.

U bë publike. Ishte një hutbe. E dini, ne në Medica këmbëngulëm shumë. Avokuam pikërisht që kjo të përmendej gjatë hutbes së të premtes, kur në xhami vjen numri më i madh i burrave për xhuma. Këmbëngulëm që interpretimi të lexohej me zë të lartë, duke shpallur se këto gra dhe vajza duhej të konsideroheshin si shehide. Ushtar mban pushkë dhe lufton, ai mund të vrasë ose të vritet. Por gratë dhe vajzat që u përdhunuan nuk kishin asnjë mjet për të luftuar, ato u sulmuan vetëm sepse ishin gra dhe sepse i përkisnin një grupi të caktuar. Ishte jashtëzakonisht e rëndësishme që burrat ta kuptonin këtë, që nuk duhej të fajësonin gratë, vajzat ose motrat e tyre.

Sot flasim hapur për përdhunimin dhe dhunën seksuale. Janë miratuar disa ligje, jo sepse shteti ynë, Federata apo Kantoni dëshironin t'i miratonin, por sepse ne, organizatat joqeveritare të grave, këmbëngulëm që këto çështje të njiheshin në ligj, që t'u kushtohej kujdes dhe vëmendje grave dhe vajzave që kanë mbijetuar. Ky shtet nuk i mbrojti ato. Është thelbësore që atyre t'u jepet statusi i viktimave civile të luftës. Ato duhet të kenë kujdes të duhur për shëndetin e tyre mendor dhe fizik, mbështetje për fëmijët dhe familjet e tyre, si dhe ndihmën e duhur kur veprojnë si dëshmitare në gjykatë. Kush do t'i mbështesë dhe përgatisë ato para, gjatë dhe pas dëshmisë? Këto janë përparime dhe procese të rëndësishme që janë zhvilluar në Bosnje dhe Hercegovinë. Nuk mund të them që jam plotësisht e kënaqur, sepse ka ende shumë punë për të bërë. Por kjo temë ishte aq shumë tabu. Bosnja dhe i gjithë Ballkani janë thellësisht patriarkalë. Kjo nënkuptonte që ne duhej të luftonim në disa fronte një-

kohësisht, do të thosha.

Besimi im është burim i rëndësishëm i forcës sime. Besoja po ashtu se nëse e dalloja nevojë për të ndihmuar, duhej të ndërmerrja hapa, sado të vegjël, për ta trajtuar, për të filluar, sado të vogla të ishin ato hapa, ato mund të çonin në diçka, ndoshta në një rezultat ose edhe në një ndryshim më të madh. Dhe tani, kur pashë se sa shumë i ndihmonte gratë vetëm t'i dëgjoje, kur më bënin pyetje si: a kam bërë gjynah, Sabiha, a e sheh çfarë kam kaluar? Unë u përgjigjesha, pse mendon se ke bërë gjynah? Duhet të jesh krenare që ia dole dhe je këtu duke më folur për këtë sot. Kur i rikthen dikujt shpresën, kur ia kthen buzëqeshjen në fytyrë ose ia zgjon sërish dëshirën për të jetuar, kur dikush kupton se nuk është më për të ardhur keq apo për t'u turpëruar, se do të jetojë jetë normale dhe të ecë përpara, atëherë e di që ke kontribuar në diçka domethënëse, që ke ndihmuar vërtet dikë.

Ajo psherëtimë lehtësimi kur shikon qetësinë në sytë e dikujt të jep një motivim të ri për të vazhduar. Kam punuar shumë me familje që fillimisht refuzonin të pranonin fëmijët e lindur nga përdhunimi, pasi vajzat e tyre kishin lindur këta fëmijë. Shfrytëzoja çdo mundësi për të biseduar me ta, për t'u shpjeguar se fëmija nuk ishte fajtor, se fëmija ishte ngjizur në barkun e vajzës së tyre dhe se çdo fëmijë lind plotësisht i pafajshëm. Ne nuk sjellim në jetë kriminelë apo fajtorë; ne sjellim në këtë botë fëmijë të pastër dhe të pafajshëm.

Në Medica, organizova një ceremoni të veçantë për këta fëmijë. Tradicionalisht, ishte diçka që bënin imamët. Kur lind një fëmijë, i vihet emri, i pritet floku i parë dhe ftohen miqtë për të festuar. Unë thashë në Medica, pse të mos organizoj diçka të tillë me këto gra? Disa gra e pranonin fëmijën e tyre pas lindjes, por gjithmonë mbetej pyetja, a është vërtet fëmija im, si u krijua ky fëmijë? Atëherë u thosha, çdo fëmijë është i pastër, lind plotësisht i pafajshëm. Ai ka nevojë për dashuri dhe kujdes. Le të organizojmë dhe të festojmë lindjen e këtij fëmije me gëzim. Ftonim gratë që qëndronin në Medica të bashkoheshin, disa me fëmijë, disa pa. Pastaj njoftonim, sot në orën dy do të kemi një ceremoni për të festuar lindjen e fëmijës së kësaj apo asaj gruaje, edhe nëse fëmija ishte ngjizur përmes aktit të përdhunimit. Përgatisnim një dhuratë të bukur për fëmijën, diçka për nënën dhe një tortë. Recitoja diçka, një ajet nga Kur'ani, dhe bëja ikamatin-ezanin për fëmijën, sipas traditës. Pastaj thosha emrin e fëmijës tri herë dhe e merrja foshnjën nga nëna në krahët e mi, duke thënë, ky është dhurata më e bukur nga Zoti, një fëmijë plotësisht i pastër dhe i pafajshëm. Që nga sot, ky fëmijë do të quhet kështu, sipas dëshirës së nënës së tij. Pastaj foshnja kalonte nga një dorë te tjetra, ndërsa të gjithë në rreth recitonin një ajet nga Kur'ani ose salavate. Kur foshnja kthehej tek nëna, i thosha, dhe e besoja me gjithë zemër, që çdo fëmijë ndihet më i sigurt në krahët e ngrohtë dhe mbështetës të nënës së tij. Sot, kur flasim për proceset terapeutike dhe shërimin psikologjik, feja ose spiritualiteti njihet si një mekanizëm i fuqishëm dhe domethënës për të përballuar traumën. Është gjithashtu një strategji e fortë për të pranuar traumën dhe lindjen e një fëmije, duke ndihmuar nënat të vazhdojnë më lehtë në të ardhmen.

Kam punuar në kampet e refugjatëve. Dhe sigurisht, kjo ishte një mundësi për gratë që të ndanin lajme me njëra-tjetrën dhe, gradualisht, të fillonin të vinin në Medica Zenica. Filluan të merrnin pjesë në seanca këshillimi psikologjik dhe të bënin ekzaminime mjekësore. Në qendrën Medica, dëgjuam zërat e grave dhe, së bashku me themeluesen tonë Monika Hauser, dhe më vonë me drejtueset e mia Marijana

Senjak dhe Mirha Pojskiq, mbështetëm nisma dhe shërbime që i identifikuam si të dobishme për të mbijetuarat. Në Medica, ofrohej mbështetje gjithëpërfshirëse: gjithçka, nga kontrollet e përgjithshme mjekësore, ekzaminimet gjinekologjike dhe të mjekësisë interne, kujdesi psikosocial, mbështetja psikologjike, këshillimet individuale dhe terapia në grup, deri te ndihma ligjore, trajnimet profesionale, përfundimi i shkollimit dhe riintegrimi i vajzave që kishin ndërprerë shkollimin në arsimin e rregullt. Ajo që ishte thelbësore dhe e domosdoshme në atë kohë, sidomos në fillim, ishte bashkëpunimi me komunitetin ndërkombëtar. Megjithatë, po aq e rëndësishme ishte përfshirja e komunitetit lokal; nuk mund t'i linim ata jashtë. Kështu, ne në Medica Zenica nisëm hapat e parë në punën me komunitetin lokal.

Dhjetë vjet pasi Medica Zenica filloi punën, u organizua një tryezë e rrumbullakët për të diskutuar se çfarë do të vinte më pas për gratë që i kishin mbijetuar përdhunimit, si të mbështeteshin të mbijetuarat e përdhunimit dhe dhunës seksuale, si dhe fëmijët e tyre. Ngjarja paraqiti punën e bërë nga perspektiva të ndryshme: psikologjike, fetare, ligjore, mjekësore, kulturore dhe më shumë. Në atë kohë, si komunitetit lokal, ashtu edhe shoqërisë në tërësi iu bë thirrja për të marrë më shumë përgjegjësi për gjithçka që këto gra dhe vajza kishin përjetuar. Diskutimet u përqendruan në mundësinë e njohjes ligjore të këtyre grave, duke u garantuar atyre disa të drejta, edhe pse atëherë nuk dinim as si do të rregullohej kjo. Ishte viti 2003. Pas kësaj, vazhduam të ndërtonim vazhdimisht partneritete me institucione, me gra që mbështetën punën tonë dhe që më vonë hynë në politikë, dhe me gra deputete. Pikërisht atëherë na lindi një ide… Në atë tryezë të rrumbullakët ishte e pranishme edhe Jasmila Zhbaniq, atëherë një e sapodiplomuar në Akademinë e Arteve të Bukura, e cila shprehu dëshirën për të kontribuar në ndonjë mënyrë. Koncepti për filmin Grbavica në fakt lindi në Medica gjatë asaj tryeze, si pjesë e diskutimeve mbi mënyrat për të rritur vetëdijësimin e publikut. Të gjithë ranë dakord se ishte një përpjekje e vlefshme, por fillimisht nuk pati rezultate konkrete. Pastaj, Medica Zenica organizoi një fushatë për të mbledhur nënshkrime nga qytetarët, gra dhe burra, për të mbështetur njohjen ligjore të grave që kishin mbijetuar përdhunimin dhe dhunën seksuale gjatë luftës së viteve 1992–1995.

Para kësaj, Jasmila Zhbaniq e përfundoi filmin Grbavica, i cili fitoi Çmimin e Ariut të Artë në Berlin. Ne, në Medica Zenica, vendosëm ta shfrytëzojmë atë moment dhe të nisnim një fushatë për mbledhjen e nënshkrimeve. Qëllimi ynë ishte të mblidhnim të paktën 50,000 nënshkrime nga qytetarët për të shtyrë drejt një zgjidhjeje ligjore për këtë çështje. Kjo nismë çoi në një arritje të rëndësishme: përfshirjen e të mbijetuarave të përdhunimit dhe dhunës seksuale në ligj. Ligji përfundimisht u miratua në nivelin e Federatës së Bosnjë dhe Hercegovinës.

Mirëpo, në vitin 2006, tema e përdhunimit dhe vuajtjes së grave në Bosnje dhe Hercegovinë nuk ishte më prioritet për komunitetin ndërkombëtar apo për donatorët. Shumë prej tyre tërhoqën mbështetjen e tyre. Medica Zenica u përball me një krizë në atë kohë, duke vënë në pikëpyetje nëse do të mbijetonte, pasi financuesit e projekteve u larguan.

Medica është një pjesë e historisë nga këndvështrimi i grave, jo vetëm për Bosnjë dhe Hercegovinën, por edhe për rajonin dhe më gjerë. Disa bashkëpunëtorë qëndruan, ndërsa të tjerë, përfshirë ish-drejtueset e mia, u larguan për të gjetur mundësi të tjera, gjë që e kuptoj plotësisht, pasi kishin familje për të mbajtur. Në atë kohë, unë isha në një pozitë tjetër, isha disi më e lirë në kuptimin që mund të mbijetoja vetë. Mora mbi

vete një barrë të madhe për të punuar me gratë që qëndruan dhe që besonin tek unë, duke më besuar se mund të bëja diçka për të ruajtur Medica-n. Ato e panë që po përpiqesha ta mbroja atë pa para apo donatorë, e shtyrë vetëm nga vendosmëria, vullneti dhe ndjenja e përgjegjësisë. Por, ne kishim përvojën e asaj që ishte bërë dhe arritur. Prandaj, fillova të punoja sërish aktivisht me përfaqësues të Komunës së Zenicës, tani Qyteti i Zenicës, dhe me përfaqësues të Kantonit, sepse në atë kohë ishte thelbësore për donatorët që komuniteti lokal të të njihte si organizatë të rëndësishme, të mirënjohur dhe të angazhuar në punë kuptimplote. Nuk ishte aspak e lehtë, por arrita të nënshkruaj protokollet e para dhe të siguroj mbështetjen e parë simbolike financiare nga Qyteti i Zenicës, Komuna e Zenicës, që atëherë drejtohej nga kryetari i ndjerë Husein Smajloviq, si dhe nga Kantoni, për të aplikuar për projekte. Deri atëherë, kryesisht kisha punuar me të mbijetuarat, dhe doja të përqendrohesha te modeli i mbështetjes, shërimit dhe zhvillimit. Por, e gjeta veten në një situatë krejtësisht të re, duke mësuar si të siguroja fonde dhe si të prezantoja punën që kisha bërë, një punë që besoja se ishte e vlefshme dhe që duhej të vazhdonte. Ishte një periudhë sfiduese, përfshirë rreth tetë muaj punë pa pagë.

Puna me viktimat e dhunës seksuale

Pastaj, këmbëngula për domosdoshmërinë e zhvillimit të një metodologjie për situata të tilla që theksonte ndërtimin dhe ruajtjen e partneriteteve të forta me komunitetin, jo vetëm gjatë periudhave të krizës, por vazhdimisht, dhe që kjo ishte edhe përgjegjësia e tyre. E promovova këtë metodologji jo vetëm në Zenicë dhe në Kanton, por edhe më gjerë, në të gjithë Federatën. Në shumë raste, madje arrita ta bëj atë më të dukshme dhe të njohur nga institucionet dhe publiku. Megjithatë, vura re diçka shqetësuese: edhe pse ligji ishte miratuar, nuk po shihja zgjidhje dhe gratë nuk po aplikonin apo nuk po flisnin për të drejtat e tyre. Organizova një fushatë të quajtur “Edhe Unë Dua të Drejtat e Mia” së bashku me të mbijetuarat, për të rritur vetëdijësimin e publikut dhe, sidomos, për t’i informuar gratë e mbijetuara nga përdhunimi dhe dhuna seksuale për të drejtat e tyre, çfarë përfshinte statusi, si të aplikonin, në ç’mënyrë. Në fillim, Medica Zenica nuk kishte autoritet të lëshonte certifikata që vërtetonin se gratë ishin të mbijetuara nga dhuna seksuale. Kjo certifikatë ishte dokument thelbësor dhe i domosdoshëm. Vendosa të luftoja edhe për këtë, sepse besoja se nuk kishte asnjë arsye të vlefshme pse Medica nuk duhej të ishte pjesë e këtij procesi. Dhe sigurisht, pas një kontesti administrativ me Ministrinë Federale, arritëm të njihemi si një organizatë referuese e autorizuar për të lëshuar këto certifikata.

Doja që gratë të tregonin një anë tjetër të jetës së tyre, një anë që thoshte, ne mbijetuam, por ju jeni këtu me ne sot, shumë prej nesh kanë kaluar përmes traumës, dhe jemi gati të flasim, kemi të drejtën të shijojmë jetën, të jetojmë siç e zgjedhim. Gjatë një punëtorie me të mbijetuarat, planifikuam që për herë të parë në Bosnjë të shënonim 19 qershorin, Ditën Ndërkombëtare për Eliminimin e Dhunës Seksuale në Konflikt. Doja të lidhesha përsëri me të mbijetuarat, të dëgjoja çfarë donin ato, si e imagjinonin këtë ditë. Ishte jashtëzakonisht e rëndësishme kur gratë thanë, Sabiha, na ka ardhur në majë të hundës që na shohin si njolla nga e kaluara, ta përdorim këtë fushatë për të treguar që jemi të forta, që kemi mbijetuar dhe që kemi të drejtën për ngjyra të ndezura, për t’u veshur si të duam dhe për gjithçka tjetër. E organizuam me këtë frymë. Gjithashtu, kuptuam diçka të rëndësishme, se gratë dhe të rinjtë që ishin aty thanë se gjithçka ishte mirë, por nuk kishte të rinj të përfshirë për të folur për këtë çështje.

Pastaj, filluam t'i angazhojmë vullnetarët tanë, nxënës të shkollave të mesme dhe studentë universitarë. Organizova dhe moderova disa punëtori për të dëgjuar perspektivat e tyre. Shumë prej tyre e pranuan se nuk dinin shumë për këtë temë. Më pëlqyen pikëpamjet e tyre. Një student tha, shiko, ne nuk mësojmë për këtë, nuk dimë, si mund ta parandalojmë që të ndodhë në të ardhmen? Është e lehtë të jesh njeri i mirë në kohë të mira, por është thelbësore të jesh dhe të mbetesh njeri i mirë në kohë të këqija, kur gjithçka duket se lejohet, si gjatë luftës. Pastaj, ata u përfshinë aktivisht në fushatë. Gjatë këtij procesi, ata shpalosën dëshirë të sinqertë për të shprehur pikëpamjet e tyre për të mbijetuarat dhe për të ndarë mesazhe mbështetëse për to në një ngjarje publike në Zenicë, përpara grave boshnjake. Ngjarja mblodhi disa qindra gra, përfshirë të mbijetuara nga e gjithë Bosnja dhe Hercegovina. Të rinjtë u ngritën dhe dhanë qartë dhe me zë të lartë mesazhet e tyre për të mbijetuarat. Ka një video të shkurtër për këtë në YouTube. Gratë qanin, qanin shumë.

Pastaj, inicova krijimin e rrjeteve institucionale për të mbështetur të mbijetuarat dhe dëshmitarët e krimeve të luftës dhe dhunës seksuale. Filluam në Zenicë me Kantonin Zenica-Doboj. Pasi zhvillova metodologjinë, e testova atë në praktikë. Themelova rrjetin e parë të tillë institucional. Këto rrjete quhen "institucionale" për një arsye shumë specifike: ato përfshijnë krijimin dhe nënshkrimin e një dokumenti, një protokolli, që institucionalizon procesin. Në këto rrjete, përfaqësues nga ministritë përkatëse, institucionet, qendrat e punës sociale dhe organizatat joqeveritare ofrojnë mbështetje të drejtpërdrejtë, së bashku, përmes një procesi edukimi, përvetësimit të njohurive mbi këtë temë, sfidave dhe mënyrave për t'i kapërcyer ato. Ajo që ishte veçanërisht e rëndësishme gjatë këtij procesi dhe që kuptuam ishte se edhe vetë institucionet shpesh nuk i kuptonin përgjegjësitë e tyre. Kjo krijonte mangësi në sistem, duke i lënë të mbijetuarat pa njohuri për mbështetjen që mund të kishin realisht në dispozicion. Qëllimi ishte të sigurohej që njerëzit të ishin mirë të informuar, që përfaqësuesit e institucioneve dhe OJQ-ve të kuptonin situatën në terren, të njiheshin me rolet dhe përgjegjësitë e njëri-tjetrit, t'i dokumentonin këto qartë dhe të siguroheshin që, pavarësisht se ku ose tek kush drejtohej së pari një e mbijetuar, ata të mund të ofronin udhëzime se kush mund të ndihmonte, si dhe kur. Përmes kësaj metodologjie, u krijuan rrjete në Kantonin e Bosnjës Qendrore, Kantonin Una-Sana dhe, natyrisht, në Kantonin Zenica-Doboj...

Dëshira ishte të ofronim një model të fokusuar te të mbijetuarat e krimeve të luftës dhe dhunës seksuale, që synonte drejtësinë, arritjen e drejtësisë, bashkëjetesën dhe paqen. Besoj se ishte një mekanizëm i mirë, sepse i ndihmoi dëshmitarët dhe të mbijetuarat të ndiheshin më të sigurta. Ato fituan qartësi se kush do t'i ndihmonte, si mund të ndihmoheshin, çfarë lloj mbështetjeje mund të kishin në dispozicion dhe nga kush. Protokolli ndërkombëtar për dokumentimin dhe mbledhjen e të dhënave mbi të mbijetuarat e përdhunimit dhe dhunës seksuale ishte gjithashtu jashtëzakonisht i rëndësishëm. Me iniciativën time dhe me mbështetje nga Mbretëria e Bashkuar, ne i trajnuam këto rrjete institucionale se si të mblidhnin të dhënat në atë mënyrë që të minimizohej sa më shumë stresi shtesë. Edhe pse procese të tilla janë gjithmonë stresuese, ne u përqendruam në parandalimin e sa më shumë ngacmuesve të tjerë dhe të ritraumatizimit. Kur kishte mundësi për ritraumatizim, rrjetet ishin të pajisura me njohuri dhe mjete për të ofruar mbështetjen e nevojshme.

Nuk jam plotësisht e kënaqur me atë që kemi arritur, dhe shumë breza do të merren ende me këtë çështje. Ndikimet patriarkale janë ende thellësisht të rrënjosura, ideja e

hesht, mbaje sekretin, mos fol, ruaje nderin e familjes, shmange turpin, së turpit, çfarë do të thonë fëmijët nesër. Heshtja buron nga stigmatizimi. Nëse duam që gratë të flasin, që t'u japim lehtësim, dhe shumë prej atyre që kanë folur kanë thënë se ndihen të çliruara, atëherë duhet që t'i fuqizojmë familjet e tyre ta pranojnë se kjo nuk është e turpshme apo faji i tyre, që nuk i bën gratë më pak të vlefshme. Gratë nuk duhet të etiketohen, por të inkurajohen të vazhdojnë jetën e tyre. Duhet të flasim për stigmatizimin si institucione dhe ministri, si anëtarë të familjes dhe si të rinj.

Kështu dua të angazhohem me të rinjtë. Jam në procesin e zhvillimit të një doracaku që synon të folurit për traumën dhe për ngjarje të ndryshme traumatike, sidomos për traumën e përdhunimit dhe dhunës seksuale, për të diskutuar me nxënës të shkollave të mesme dhe studentë universitarë, si pjesë e edukimit të tyre të rregullt. Ky lloj traume lë pasoja afatgjata dhe të thella, jo vetëm për të mbijetuarën, por edhe për familjen e saj, komunitetin dhe fëmijët. E dini, fokusi do të jetë te përdhunimi dhe dhuna seksuale, duke trajtuar çështjen e stigmatizimit dhe çfarë është stigmatizimi. Kur pyeta të rinjtë, në vitin e tretë dhe të katërt të shkollës së mesme, ose edhe studentët e universiteteve që studiojnë psikologji, pedagogji dhe punë sociale, çfarë është për ta stigmatizimi, më besoni, shumica prej tyre nuk mund ta kuptonin konceptin ose si manifestohet dhe reflektohet në ditët e sotme.

Stigmatizimi vazhdon edhe sot e kësaj dite, dhe sjellja e grave që kanë mbijetuar ende vihet në dyshim. Edhe tani, shohim qëndrime negative ndaj të mbijetuarave, nën të vazhdueshëm për të parë nëse ato janë "fajtore", sidomos nëse kanë arritur ta normalizojnë jetën e tyre, të gjejnë punë, të ndërtojnë veten dhe të ecin përpara. Atëherë thuhet, me siguri ia ka patur qejfi, e ka kërkuar dhe të tjera fjalë të ngjashme. Ka ende raste... Kam këtë shembull, jam duke punuar me një rast në terapi që përfshin dy bashkëshortë, më shumë se tridhjetë vite më pas... Kur flasim për këtë temë, në një botë që tashmë ka njohur dhunën seksuale si një traumë, një nga shkeljet më brutale të të drejtave të njeriut, veçanërisht të drejtave të grave, dhe si një strategji lufte, partnerët dhe bashkëshortët shpesh nuk mund ta pranojnë kur mësojnë se gratë e tyre kanë mbijetuar përdhunimin, edhe pas 35, 20, ose 15 viteve martesë, dhe i lënë ato. Kjo tregon, mendoj, se sa thellë është ende e rrënjosur stigma. Gjithçka lidhet me këto stereotipe të vazhdueshme dhe ndikimet patriarkale. Besoj se kemi bërë përparime të rëndësishme, por ka ende shumë punë për të bërë. Shumë punë duhet të bëhet përmes edukimit, dhe të gjitha këto modele pune duhet të ndërlidhen disi.

Organizatat joqeveritare kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribut të jashtëzakonshëm, por institucionet dhe njerëzit që punojnë brenda tyre duhet gjithashtu të luajnë një rol kyç. Ata duhet të jenë të ndjeshëm, të vetëdijshëm dhe të çliruar nga paragjykimet. Nëse kemi një polic që nuk beson se përdhunimi është dhunë, ose që në çfarëdo mënyre përpiqet ta justifikojë atë, ose nëse hasim qëndrime të ngjashme në qendrat e punës sociale ose institucionet shëndetësore, si mund të presim që ata të ofrojnë mbështetje dhe mbrojtje të duhur për të mbijetuarat e përdhunimit dhe dhunës seksuale? Disa më thonë, hë pra, Sabiha, mjaft fole për këtë, ka kaluar. Po, për disa ka kaluar, por mijëra gra në Bosnje ende jetojnë me traumën e tyre, shkojnë në gjumë dhe zgjohen me atë traumë. Ato shqetësohen vazhdimisht nëse dikush e di apo nuk e di, dhe si i perceptojnë të tjerët. Shumë prej tyre, ndërkohë që ora biologjike ecën, kanë ndërruar jetë, duke marrë me vete traumën e tyre, të pathënë. Ato u larguan me dhimbjen, pa e ndarë historinë e tyre as me më të dashurit e tyre, nga frika se si mund të reagonin, nëse do t'i pranonin, do t'i braktisnin apo do t'i kuptonin. Disa

madje kishin frikë se fëmijët e tyre mund të stigmatizoheshin për shkak të traumës që ato kishin mbijetuar.

Kam dashur tí shqyrtoj këto modele mbështetëse joformale, çfarë i ndihmon gratë kur nuk kërkojnë ndihmë dhe mbështetje profesionale. Këtë e bazova në strategjitë BASIC-Ph për të përballuar situatat e vështira, stresuese dhe ngjarjet traumatike. E hulumtova këtë dhe vërtet pashë, kjo u demonstrua, e përmend edhe në librin tim, që këto modele duhet të jenë të njohura dhe të dukshme, në mënyrë që individët të gjejnë burimet e tyre të forcës, edhe nëse zgjedhin të heshtin. Por kjo duhet të jetë zgjedhja e tyre, jo diçka që detyrohen të bëjnë për shkak të shoqërisë apo stigmatizimit. Në hulumtimin tim, kam diskutuar posaçërisht këto modele mbështetëse joformale. Disa gra gjetën ngushëllim në marrëdhëniet sociale, duke e përshkruar këtë si, shoqet, unë shoqërohem, dal, kjo nuk është trauma ime 100%, unë mbijetova. Kjo tregon se ato, në një farë mënyre, e kanë zgjidhur vetë. Të tjera gra gjejnë strehë në besim, duke e përshkruar me fjalët e tyre, ndodhi, mbijetova, mbeta gjallë, por e pranoj si një sprovë, dhe Zoti më jep forcë të vazhdoj përpara. Nuk është e vetmja gjë që ka ndodhur në jetën time ose e vetmja gjë që kam mbijetuar. Disa thonë, besoj te njerëzit e mirë. Kjo u bë nga njerëz të këqij, por nuk dua të mendoj ose flas vetëm për këtë, më kujton vëllain tim. Ka njerëz të mirë atje, po eci përpara, thjesht po kthej një faqe të re. Disa gra riorganizojnë mendimet e tyre në mënyrë të vetëdijshme dhe thonë, po, më ndodhi, i kam organizuar të gjitha në mendjen time, i kam shkruar të gjitha, kam qarë me orë të tëra gjatë shkrimit, dhe disi, ndihem më e lehtësuar. Po vazhdoj përpara, si të kisha zbrazur një kosh mbeturinash. Të tjera thonë, në vend që të më konsumojë, në vend që të mendoj vetëm për këtë, lexoj, këndoj, dal për shëtitje, gjej mënyra për të ndihmuar veten.

Kur flasim për Bosnjën, i referohemi deri në 50,000 grave të përdhunuara, dhe statistikat thonë edhe rreth 3,000 burra. Ka statistika për sa prej tyre u përdhunuan, por për sa gra, vajza dhe të reja që u përdhunuan dhe më pas u vranë, vetëm Zoti e di. Për më tepër, nuk janë 50,000 gra ato që kanë kërkuar ndihmë. Po flasim për qindra. Të tjerat kanë gjetur mekanizmat e tyre për të përballuar situatën, por ne duhet të krijojmë një atmosferë dhe një mjedis mbështetës, dhe t'u lëmë grave mundësinë të vendosin vetë.

Është e domsodoshme të punohet me burrat, pavarësisht a kanë anëtarë të familjes që i kanë mbijetuar përdhunimit apo jo. Vetëdijësimi i burrave është jetik, në mënyrë që ata të mund të kontribuojnë në destigmatizim, ashtu siç mund të përtërijnë stigmatizimin. Diskutimet e hapura, bisedat. Nuk mjafton vetëm të kesh njohuri, duhet edhe të trajtojmë se si këto njohuri ndikojnë në qëndrimet e tyre, si mund të ndryshojnë pikëpamjet e tyre dhe si mund ta ndajnë këtë ndryshim me të tjerët për të frymëzuar transformimin e qëndrimeve. Për shembull, nëse organizojmë një punëtori ku marrin pjesë burra dhe gra së bashku dhe diskutojmë këtë temë, dhe më pas media e mbulon atë, tashmë po dërgojmë një mesazh për publikun. Po tregojmë se kjo është një çështje e rëndësishme, diçka që prek burrat, gratë, çdo qytetar dhe madje edhe median. Organizatat joqeveritare të grave kanë mbajtur një pjesë të madhe të kësaj barre, por kjo nuk mund dhe nuk duhet të mbetet vetëm përgjegjësi e grave apo organizatave të udhëhequra nga gra.

Kjo duhet të jetë përgjegjësi e të gjithë shoqërisë, përfshirë burra dhe gra, institucione dhe politikanë. Filluam me të mbijetuarat, ato që e përjetuan drejtpërdrejt këtë

traumë, por kuptuam se na duhej të punonim edhe me familjet e tyre. Pastaj pamë se duhej të angazhoheshim me komunitetin lokal dhe më pas kuptuam rëndësinë e krijimit të ligjeve, politikave dhe standardeve dhe më pas pamë se duhet edhe të monitorojmë se si këto zbatohen dhe si implementohen në gjithë Bosnjën dhe Hercegovinën, nga fshatrat deri te qytetet, e deri në nivelin shtetëror.

Medica ka punuar edhe me raste të fëmijëve që i kanë mbijetuar përdhunimit dhe dhunës seksuale gjatë luftës. Fatkeqësisht, raste të tilla vazhdojnë edhe në periudhën e pasluftës. Ajo që ne vumë re menjëherë në punën me fëmijët ishte se sa e vështirë ishte për ta të flisnin, të tregonin gjithçka ose të krijonin lidhje. Prandaj, u përdorën teknika të tjera adaptive dhe projektive. Vetëm më vonë, në shumë raste, pamë që këta fëmijë, nga 15 ose 16 vjeç, të cilët kishin qenë në Medica si fëmijë të vegjël, u kthyen gjatë adoleshencës ose pubertetit për të kërkuar mbështetje të mëtejshme. Dhe me pyetje të ndryshme, me probleme, vështirësi nga më të ndryshmet po përballeshin sërish me traumën e tyre. Kemi edhe një situatë, fëmijët që mbijetuan, rasti i një vajze 13-vjeçare që i mbijetoi përdhunimit... Ajo thotë se në atë periudhë nuk e di as si është ndjerë, as çfarë ka menduar, asgjë. Vetëm më vonë, kur unë filloi të flasë... Ajo filloi të fliste fillimisht me të atin për këtë. Më pas filloi të krijojë skica se kush ishte dhe si ishte. Sigurisht, kjo e ndikoi atë psikologjikisht. Ajo më vonë u përfshi në procesin e punës përmes asaj traume dhe bëri përparim të mirë. Mirëpo, trauma u rikthye kur u martua, kur lindi fëmijën e saj. Pra, disi, ajo vazhdimësi e kthimit në kujtimet traumatike dhe ripërpunimi në varësi të periudhës së jetës apo moshës janë disa nga përvojat e mia kur flasim për ata fëmijë.

Kam edhe një rast, është diçka tjetër, një djalë që u detyrua ta përdhunojë nënën e tij. Më pas ai përjetoi një krisje dhe nuk u kthye më në normalitet. Ai ishte rreth nëntëmbëdhjetë vjeç. Ishte në moshë të rritur. I shihte të gjitha. Ai u detyrua të shikonte gjithçka që i bënin nënës së tij. Por tani mamaja e tij e ka akoma një problem, jo me traumën e saj, siç thotë ajo, e zgjidha, e pranova, por trauma ime e përjetshme është djali im. Ndihem fajtore që fëmija im humbi jetën sepse ishte aty, që duhej të shikonte, në momentin kur u detyrua, kur u kërcënua se do të duhej të përdhunonte nënën e tij, kur u shty ta bënte. Ajo britma që dëgjova është trauma ime më e madhe. Që do të thotë, e gjithë jeta e disa grave do t'u kthehet përvojave traumatike, do të përpiqet të arrijë në një përpunim të caktuar të traumës, të zgjidhjeve, disa pasoja janë ashtu siç janë. Ajo thotë se djali im tani është në një institucion, sepse nuk mund të kujdeset as për veten. Shkaku im për traumën time është djali im dhe si mund ta heq atë shkas, çfarë të bëj në atë situatë. Më pas diskutojmë se çfarë mund të bëhet për djalin, çfarë është realiste dhe çfarë është e mundur. Nëna e tij e viziton, kujdeset për të, përgatit atë që i pëlqen të hajë dhe kalon kohë me të. Ajo thotë se kjo është një mënyrë si e trajton ngacmuesin e traumës së saj.

Në fillim, e quanim fuqizimin ekonomik si terapi pune. Sot e quajmë vetëm fuqizim ekonomik, sepse pamë, dhe gratë e treguan që në fillim... Kthehem te viti 1993, jo të gjitha ato që ishin nën kujdesin e Medica-s ishin të gatshme të flisnin, por ishin të gatshme të bënin diçka përmes punës, krijimtarisë, thurjes, qepjes, për të mësuar diçka të re, për të drejtuar mendimet drejt diçkaje tjetër, për të rimarrë forcën e tyre. Në sjelljen e tyre mund të vërehej një ndryshim. Më vonë, përmes kësaj terapie pune, ato filluan të flisnin, shiko çfarë thashë, ende ka forcë brenda meje, unë mundem, edhe pse... Dhe ato filluan fillojnë të flasin.

Mendoj se artistët dhe kultura kanë filluar të merren me këtë përmes dokumentarëve, filmave artistikë, teatrit, ekspozitave, e kemi këtë, është e pranishme. Ka pasur disa ekspozita të vetë të mbijetuarave në Sarajevë, gjë që është shumë mirë. Po, është një proces memorializimi, por na duhet një vazhdimësi. Nëse diçka ndodh vetëm një herë, harrohet. Si ta mbajmë të qëndrueshme. Filmi i drejtuar nga Jasmila Zhbaniq, Grbavica, është shumë i rëndësishëm për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe më gjerë, ashtu si edhe filmi Zgjidh një simbol, me regji nga Ibrahim Shishmani, si dhe filmi Fëmija i Padukshëm nga i njëjti regjisor. Gjithçka që regjistrohet duhet të jetë e disponueshme për publikun, në mënyrë që të mos ndodhë vetëm një herë dhe pastaj të harrohet disi.

Drejtësia tranzicionale

Sa i përket procesit të drejtësisë tranzicionale, përmenda rrjetet institucionale. Ne vazhdojmë të punojmë me gratë, së pari për t'i informuar ato, së dyti, u ofrojmë mbështetje psikosociale para se të shkojnë në gjykatë ose në prokurori. Gjithashtu u ofrojmë mbështetje ligjore, që të dinë cilat janë të drejtat e tyre, kur është e nevojshme dhe kur gratë ndiejnë nevojën, i shoqërojmë në gjykatë ose në prokurori për të qenë mbështetje emocionale për to. Gjithashtu, pas dëshmisë ose gjykimit, ne vazhdojmë kontaktin me gruan, sepse shpesh gruaja, dhe kjo ndodh me shumicën e grave, madje edhe me burrat, pasi edhe atyre u ofrojmë mbështetje, kur japin deklaratën e tyre në prokurori ose nëse thirren në gjykatë, pas asaj date të deklaratave, ndihen plotësisht bosh dhe mund të thonë, epo, nuk e di, tani ndihem më keq se më parë.

Dhe pastaj ne duhet ta ofrojmë përsëri atë mbështetje psikosociale. Fatkeqësisht, disa gra janë ende në një situatë të vështirë ekonomike, ndaj mundohemi t'i ndihmojmë nga ai aspekt. Më së paku kalojmë kohë në zyrën qendrore. Kaloj të paktën një ditë në vit në zyrë. Pra, ne shkojmë në terren, shkojmë te familjet siç thashë, flasim, ndjekim procesin pas dëshmisë dhe është veçanërisht e rëndësishme të jemi me gratë dhe t'i ndihmojmë ato kur të kuptojnë nëse autori ka qenë i dënuar apo jo. Në të dyja rastet, gratë kanë një reagim, zhgënjim dhe disa e kanë përjetuar sërish atë ritraumatizimin.

Në situata të tilla, ne zakonisht shkojmë direkt te gratë. Edhe organizohemi për gratë, sepse kanë nevojë dhe e kemi parë, të paktën tre herë në vit përfshijmë rreth njëqind gra të mbijetuara, nuk mund të bëjmë më shumë për arsye financiare, p.sh. për të siguruar që ato të shkojnë në një pushim të vogël, siç e quaj, diku në një hotel ku do të kenë masazhe, ku do të kenë mundësinë e një pishine, shoqërimit, pushimit. Ndaj, ato tre ditë të vitit kanë shumë domethënie për to, sepse është diçka ndryshe nga jeta e tyre, sepse diku kanë siguruar diçka konkrete për veten e tyre dhe janë të fokusuar vetëm te vetja. Ne gjithashtu pranojmë se shkëmbimi dhe biseda dhe shoqërimi i vetë të mbijetuarve është i dobishëm dhe i rëndësishëm.

Edhe sot kaloj nëpër shumë rreziqe. Kërcënimet janë shpesh të pranishme. Epo, gjatë luftës dhe pas luftës, kur u kaluan ata kufij, atëherë nuk e dini se kush do t'ju ndalojë, dhe çfarë do t'ju pyesin, dhe nëse do ta shfryjnë inatin mbi ju sepse punoni në një organizatë të tillë dhe ndihmoni. Ajo pasiguria, a po bëhet, po bëhet, po bëhet, por deri kur? Kur do të mund të themi se kemi arritur gjithçka që duam dhe të vazhdojmë të bëjmë diçka tjetër? Dhe gjithashtu kjo trazirë politike, nuk e dini kurrë se cili opsion politik do t'ju luajë lojëra mashtruese. Të bësh atë që bëjmë ne, atë që kam bërë për 31 vjet, është vërtet sfiduese. Ne jemi të fokusuar, unë fokusohem tek një burrë si burrë, tek

një grua si një grua, pavarësisht se ku jetojnë në Bosnje dhe Hercegovinë, dhe pavarësisht nëse janë të kësaj apo asaj feje, besimtar, jobesimtar, ateist, agnostik, absolutisht nuk më intereson. Unë besoj thellësisht në këto vlera universale, që një person është një person.

Burrin e kam njohur në shkollë të mesme, në Medresenë Gazi Husrev-bej në Sarajevë. Ai është më i madh se unë, por e kam njohur sepse ishte vëllai i profesorit tim dhe se është nga Travniku. Rastësisht, një shok i klasës, Mejr Rixhiqi, e njihte profesor Halimin, vëllain e Aladinit. Pastaj një ditë, na ftuan të vizitonim nusen te Aladini, Safian (Safan), gruan e Halimit. Nuk kam qenë kurrë mirë me ato role. Unë dhe shoku im i klasës ishim të ftuar, meqë ishim nga e njëjta zonë, të shkonim tek ata për kafe. Pra, ishte profesori im, domethënë në shtëpinë e profesorit dhe me gruan e tij. Shkuam për kafe dhe aty gruaja e profesorit e ftoi, duke thënë se kishin një djalë të mirë atje, kështu që pse të mos na bashkohej edhe ai për kafe. Ishim në vitin e dytë të gjimnazit, fëmijë, vajza të vogla. Dhe ai ishte në universitet. Ai u ul, dukej misterioz. Ndoshta nuk na tha më shumë se tre ose katër fjali para se të largohej. Dhe kaq ishte. Më vonë, ai arriti të largohej nga Pljevlja për në Turqi, së bashku me disa nga shokët e mi të klasës. U ktheva në Bosnje. Dhe pas lufte...

Ai erdhi me një nga shokët e tij, i cili është edhe koleg i fakultetit, Esad Pepiq, dhe pimë kafe. I them, më falni, por nuk kam kohe, kam shumë punë, më duhet... Pra mundemi pas pune? Punoja deri në orën tre. Nuk mundem, duhet të shkoj në Medica. Dhe unë nuk piva kafe me ta. Epo, më vjen mirë që ju shoh, suksese për secilin prej jush. Pas kësaj, nuk e di si, por përsëri Aladini u ndal në Zenicë për të më ftuar për kafe, por i thashë se isha shumë e zënë, herën e dytë, nuk kisha kohë për kafe. Pastaj ai thirri përsëri, por unë thashë kur të kem kohë do të të them dhe do të pimë kafe.

Pastaj erdhi Bajrami. Unë tashmë jetoja në apartamentin tim dhe po shkoja te nëna ime, por fillimisht doja t'i uroja të gjithë për Bajram. Dhe shtypa, nuk e di si shtypa, dëgjova zërin e Aladinit dhe e mbylla menjëherë, sepse nuk doja ta telefonoja. Nuk e di fare si ndodhi, por burri im ende nuk më beson, ai mendon që e bëra me qëllim. Pastaj thashë, oh sa turp, e thirra, tani duhet ta thërras atë njeri për t'ia uruar Bajramin, por edhe për t'i thënë që më vjen keq për herën e parë që ishte gabim. Dhe e bëj këtë dhe ai qesh, mirë, mirë, në rregull, a mund të pimë një kafe tani. I thashë, ndoshta nesër, sot po shkoj te prindërit e mi. Dhe ditën tjetër Aladini erdhi për kafe, pimë kafe, dhe në fund ai tha, më në fund ke kohë për kafe. Dhe kështu, pak nga pak, filluam të shoqëroheshim. Ia nisëm të argëtohemi, por nuk kisha durim, sepse nuk isha më në moshën për t'u argëtuar, sa andej-këndej, sepse vërtet nuk kisha kohë. Pastaj i thashë burrit tim, Aladinit, dëgjo, Aladin, kam bërë një listë me prioritet me njerëzit e mundshëm për t'u martuar dhe ti je një nga ata në listë. A do të martohesh? Kështu ndodhi. Dhe pastaj i them, e di çfarë, më duhet vetëm ta di nëse do të shkoj me ty me pushime apo me kolegen time Marijanën, nuk kam shumë kohë, kam aty-këtu ndonjë pushim vjetor, nëse mund të përshtatesh. Dhe Aladdini u përshtat, dhe kështu organizuam dasmën dhe u martuam. Dasma ishte këtu në Zenicë, në Fontana. Dhe pastaj shkuam në Turqi. Dhe pastaj ai thotë, kjo mund të ishte bërë shumë më herët, kur ishim në Pljevlje, por ti gjithmonë bëje diçka. Por unë kurrë nuk do të të besoj që telefonata e parë ishte gabimisht. Por, me të vërtetë ishte gabimisht.

Sot, Aladini punon në Sarajevë, është drejtori i Institutit Oriental dhe doktor i periudhës osmane të historisë. Ai ka diplomuar në Prishtinë, siç thashë. Masterin e ka bërë në

Sarajevë dhe doktoraturën në Zagreb. Ai vjen të premteve dhe largohet të hënave. Kemi dy fëmijë. Jetojmë të kënaqur, të lumtur dhe në harmoni. Shumë njerëz pyesin pse jetojmë kështu, pse nuk jemi në Sarajevë apo në Zenicë. Unë them se nuk kemi kohë të grindemi, dhe në Ballkan, është e rrallë të mos grindesh nëse je bashkë gjithë kohën. Duke njohur veten dhe atë, besoj se do të kishim patur qindra situata grindjesh. Por kështu, kur vjen e premtja, mendojmë vetëm për mënyrën si do ta kalojmë fundjavën, nëse jemi bashkë gjatë fundjavës, nëse ai nuk është zyrtarisht larg apo unë, prandaj për mua kjo është një zgjidhje e mirë. Thesari dhe forca ime më e madhe janë dy fëmijët e mi, Nexhma dhe Afani. U jam jashtëzakonisht mirënjohëse prindërve të mi, Mamës Hanifa dhe Babës Omer, që u kanë dhënë dashuri dhe ngrohtësi kur unë isha larg për ditë të tëra për shkak të angazhimeve të shumta. Sot, Nexhma dhe Afani bisedojnë me mua dhe Aladinin se si ishte jeta jonë, çfarë bënim, si luanim, por edhe çfarë është lufta, si fillon ajo, kush thotë të ndalet lufta, si mund të ishin njerëzit aq mizorë. Ata janë dëshmitarë të luftës sime për gratë, të të drejtave të tyre dhe për drejtësinë. Shpesh janë me mua në aksione në rrugë, shpërndajnë materiale promovuese dhe kjo më bën të lumtur dhe krenare. Mendoj se është e rëndësishme për ta të mësojnë, por edhe të përfshihen në aksione të ndryshme, të bëjnë pyetje dhe të kuptojnë se gjithmonë ka njerëz të mirë. Më pëlqen që ata disi po mësojnë për këto procese ndërsa janë ende të vegjël, mendoj se kjo u zgjeron horizontet dhe u përcjell atë që prindërit e mi më mësuan: të përpiqem të gjej të mirën te njerëzit. Kjo është ajo që do të thoja për fëmijët e mi.

Donja Večeriska, 05.10.2011.

Rëndësia e çdo hapi

Tea Gorjanc Prelević është drejtoreshë ekzekutive e OJQ-së Aksioni për të Drejtat e Njeriut dhe aktiviste nga Podgorica. E lindur në Beograd në një martesë jugosllave mes një sllloveni dhe një serbeje, ajo u mësua që në moshë të re të respektonte diversitetin dhe ndryshimin, si dhe mendimin dhe reflektimin e pavarur. Pas përfundimit të studimeve në fushën e së drejtës, ajo avancoi në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut nën syrin vigjilent të Vojin Dimitrijevićit, Davor Hiberit, Vesna Rakić Vodinelićit, Goran Svilanovićit. Pas përfundimit të magjistraturës në SHBA dhe pas martesës, ajo u vendos në Mal të Zi, ku fillimisht punoi në Qendrën për Trajnimin e Gjyqtarëve, dhe më pas, së bashku me burrin e saj, ajo filloi luftën e saj të suksesshme për dëmshpërblimin e familjeve të refugjatëve të dëbuar nga Mali i Zi në vitin 1992.

E rritur në frymën antifashiste jugosllave, ajo gjithashtu u edukua si aktiviste në luftën kundër regjimit të Sllobodan Milloshevićit, Tea Gorjanc Prelević, si avokate, e kuptoi rëndësinë edhe të hapit më të vogël në luftën për drejtësi. Megjithëse nuk ka kënaqësi të plotë për viktimat, vetëm me proceset e memorializimit dhe edukimit, mund të shpresojmë që tmerret si gjenocidi në Srebrenicë, vuajtjet e shqiptarëve në Kosovë, shkatërrimi i Vukovarit ose Oluja të mos përsëriten më. REKOM, anëtare aktive e të cilit është Tea Gorjanc Prelević, i ka pikërisht këto qëllime. Aktiviteti i saj në kuadër të luftës për të drejtat e njeriut dhe kulturën e kujtimit është i përhershëm dhe i vazhdueshëm. Rrëfimi i saj shërben si shembull i shkëlqyer.

Tea Gorjanc Prelević

Fëmijëria e hershme dhe familja

Quhem Tea Gorjanc Prelević. Kam lindur jugosllave, nga babai slloven dhe nëna serbe në Beograd. Në fillim kam vijuar kopshtin "Doktor Simo Milošević", pastaj shkollën fillore "Žarko Zrenjanin", pastaj shkollën e mesme të shkencave natyrore "Mihajlo Pupin". Pastaj jam regjistruar në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit, ku kam diplomuar në vitin 1995. Më pas, i kam kaluar dy semestra në Studimet Evropiane të Paqes (EPU - European Peace University). Kam magjistruar në vitin 1999, në të drejtën ndërkombëtare në SHBA në American University Washington College of Law dhe kam kaluar disa kohë atje duke bërë praktikë në organizatën joqeveritare CEJIL[2] - Center for Justice and International Law.

Pas kthimit, u ktheva në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut, ku kam punuar edhe para se të shkoja në Amerikë. Kjo Qendër gjithsesi ndikoi në rrugëtimin tim jetësor. Në shkollën për të drejtat e njeriut të organizuar nga Qendra me iniciativën e drejtorit të saj, profesorit Vojin Dimitrijevićit, takova edhe burrin tim Dragan Prelevićin, avokat nga Podgorica. U martova me të menjëherë pas zgjedhjeve të vitit 2000 (kur regjimi i Slobodan Miloshevićit u zëvendësua më në fund) dhe erdha të jetoj në Mal të Zi. Kjo është përmbledhja më e shkurtër e rrugëtimit tim jetësor.

Puna ime e parë në Mal të Zi ishte puna e drejtoreshës së parë ekzekutive të Qendrës për Trajnimin e Gjyqtarëve të Malit të Zi. Këtë e kam bërë nga viti 2000 deri në vitin 2004. Më vonë, fillova të punoj me burrin tim në zyrën e tij juridike. (Ndërkohë kam qenë edhe në pushim të lehonisë, por asnjëherë për shumë kohë. Kam katër fëmijë.) Në zyrën ligjore Prelević, kam koordinuar përfaqësimin e 200 personave nga Bosnja dhe Hercegovina të cilët ishin viktima të një krimi lufte të kryer kundër refugjatëve në territorin e Malit të Zi, i njohur si "Deportimi". Dhe duke punuar në atë rast, kuptova se kurrë nuk do të isha në gjendje të merresha me diçka që nuk ishte mbrojtja e të drejtave të njeriut, dhe mbi të gjitha, mbrojtja e të drejtave të viktimave të krimeve të luftës në vitet 1990.

Pastaj jo vetëm që e kuptova por edhe ndjeva se sa e nevojshme ishte së pari t'i zgjidhnim këto gjëra që të mund të ecnim përpara si shoqëri. Gjatë punës në kompaninë ligjore, kam marrë pjesë edhe në aktivitetet e OJQ-së Aksioni për të Drejtat e Njeriut, të themeluar nga bashkëshorti im me kolegët dhe miqtë e tij. Kjo organizatë ishte kryesisht e përfshirë në edukim dhe nuk kishte punëtorë të përhershëm. Megjithatë, vendosa të përfshihem më shumë atje dhe në vitin 2008 filluam me projekte të rregullta.

Në vitin 2006, u mbajt referendumi për pavarësinë e Malit të Zi dhe u shkrua Kushtetuta e shtetit të ri të pavarur. Këto ishin ngjarje shumë të rëndësishme, historike për zhvillimin e një shteti. Ne u përfshimë në të gjitha këto dhe filluan projektet e para të

2 Qendra për Drejtësi dhe të Drejtë Ndërkombëtare. Në prill 1989 Miloševići u tha serbëve të Kosovës në Fushë Kosovë "Askush nuk guxon t'ju rrahë!", duke premtuar se shteti i Serbisë do t'i mbronte nga përndjekja e pretenduar shqiptare.

Aksionit për të Drejtat e Njeriut. Që nga viti 2010, jemi bërë një organizatë me punëtorë të përhershëm dhe që atëherë kemi pasur projekte të ndryshme në fusha të ndryshme të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, megjithatë, në radhë të parë është drejtësia tranzicionale dhe avokimi për forma të ndryshme të dëmshpërblimeve për viktimat e krimeve të luftës. Përveç kësaj, Aksioni për të Drejtat e Njeriut gjithmonë është marrë me lirinë e shprehjes si parakusht për zhvillimin e demokracisë dhe mbrojtjes dhe të drejtave të tjera të njeriut, dhe ne gjithmonë kemi kërkuar të mbështesim dhe përfaqësojmë viktimat e torturës, viktimat e diskriminimit, sinjalizuesit, etj. Edhe sot e kësaj dite, unë jam Drejtoreshë Ekzekutive e Aksionit për të Drejtat e Njeriut dhe jam ende entuziaste për ndryshimet shoqërore.

Ndërtesa ku kam jetuar si fëmijë është ende e njëjtë dhe në të njëjtin vend, përballë rrugës nga Hotel Jugosllavia. Fasada e ndërtesës është bërë me guralecë nga lumi, nuk ka nevojë të ngjyroset, dhe sot duket siç u ndërtua në vitet 1970. Fëmijërinë time e kujtoj si periudhë shumë shoqërore. Të gjithë shoqëroheshim para ndërtesës, kalonim kohë jashtë kur i mbaronim detyrat, ktheheshim nga shkolla në shtëpi, i hidhnim çantat dhe dlnim vrap… Ishim të paktën tridhjetë vetë… Edhe sot e kësaj dite nëna ime jeton në atë ndërtesë, e vizitoj shpesh, megjithatë, nuk i shoh më fëmijët duke luajtur para ndërtesës...

Ne kërcenim e mësonim aty, kjo ishte e mrekullueshme; tani që e mendoj, ishte e mrekullueshme për trupin dhe shpirtin. Ishte shumë mirë që kaluam kohë jashtë – mendoj se fëmijët kanë më pak mundësi për ta bërë këtë sot… Unë kam jetuar me nënën dhe babain tim. Ishim familje e vogël treanëtarëshe.

Tash jetoj me burrin dhe katër fëmijët, dhe babai im fatkeqësisht ndërroi jetë ndërkohë. Pra, tani nëna ime është këtu, për fat të keq vdiq edhe babai i burrit tim, i cili ishte gjithashtu mik shumë i ngushtë dhe njeri shumë i rëndësishëm në jetën time. Por sot jetojmë me fëmijët tanë, nuk jetojmë me prindërit tanë.

Babai im Jakobi ka lindur në Sllloveni, në Kranj. Ai ka përfunduar akademinë detare në Bakar, Kroaci dhe mësoi të fluturonte në Sllloveni në aeroportin sportiv të Lesces. Në Vršac, në Serbi, ai punoi si instruktor fluturues me planer. Pas kësaj, u punësua si pilot në JAT (Transporti Ajror Jugosllav), ku doli në pension pak më herët se sa duhej për shkak të sanksioneve që ndodhën në vitin 1992. Avionët nuk mund të fluturonin më në rrugë ndërkombëtare për shkak të luftës në Kroaci dhe Bosnjë dhe Hercegovinë.

Ishte mjaft i ri, 22 vjeç. Kaloi shumë kohë së pari në Vršac, si instruktor fluturimi, dhe më pas u punësua në JAT. Unë kam lindur kur ai ishte 40 vjeç, kam edhe familje në Sllloveni që e dua shumë, me të cilën mbaj kontakte. Babai im kishte dy motra, dhe tre vëllezër, të gjithë përveç njërës motër kishin fëmijë, kështu që jemi shumë.

Babai im ka lindur në vitin 1933. Gjithmonë ka dashur të bëhet pilot. Gjyshja Marica, nëna e tij thoshte se ai gjithmonë thoshte se do t'i bënte të gjitha lodrat e tij të fluturonin… Dhe madje edhe para se të fillonte Lufta e Dytë Botërore, para se të fillonte lufta, ai thoshte se donte të bëhej pilot, gjë që në atë kohë ishte si të thoshe se doje të bëheshe astronaut, ma merr mendja. Nuk ishte ky profesion i zakonshëm. Për mua, ai ishte shembull i një personi që e dinte se çka donte të bëhej në jetë, unë nuk jam vërtet e tillë, por ai ishte. Ai e bënte punën e tij me shumë përgjegjësi, por në një farë mënyre, ai vazhdoi të lozte gjatë gjithë jetës.

Pra, e deshi, e kishte aspiratë, së pari mbaroi Akademinë Detare, lundrimi ishte gjithmonë shumë i rëndësishëm për të, ma ka thënë këtë shumë herë. Gjithçka që ai bëri ishte drejt përmirësimit të vetes, për të mësuar se çka i duhet për t'u bërë një ditë pilot. Ka një rrëfim tjetër interesant se si i mbijetoi luftës. Babai i tij ishte biznesmen i pasur dhe i suksesshëm në Kranj, kishte një sharrë, një hotel të vogël dhe makinë, dhe kur erdhën gjermanët, ia morën të gjitha. Dhe pastaj në Jugosllavi, e gjithë kjo u shtetëzua. Sllovenia në fund ia ktheu edhe pyjet edhe hotelin familjes sonë me anë të denacionalizimit, gjë që prindërve të mi ua bëri jetën shumë më të lehtë në pension.

Por ajo që doja të thosha ishte se kur filloi Lufta e Dytë Botërore, prindërit e tij me fëmijët e tyre u dërguan në një kamp, në një nga kampet gjermane, nuk e di saktësisht se cili, dhe ata u futën në një tren. Për fat të mirë, në atë tren, një oficer gjerman, i cili kishte veshur një pallto të bardhë, e njohu nënën e tij, Maricën. Ai ishte si personel mjekësor, mjek, ashtu disi, dhe ai e njohu atë dhe e pyeti në gjermanisht, "Marica, çka po bën ti këtu?" Ajo tha, "Epo, nuk e di, ata thanë se duhej të shkonim të punonim diku në Gjermani." Dhe ai thotë, "Jo, jo." Nuk e di saktësisht nëse ai tha kjo se nuk do të përfundonte mirë, por ai e njohu atë nga Vjena, ku ajo ishte në një shkollë hotelerie në rininë e saj. E ai ishte i biri i qiradhënëses ku ajo mori me qira një dhomë për ato dy vjet.

Nëna ime është nga Beogradi, dhe ajo është grua shumë e vendosur, shumë e pavarur, shumë këmbëngulëse në atë që bën, punëtore, shumë praktike dhe do të thosha shumë e vetëdijshme, dhe gjithashtu, jo false. Kjo është ajo që më ka mësuar gjithmonë, domethënë më ka mësuar që në moshë shumë të re të mos përsëris fraza dhe klishe, për shembull. Mbaj mend që një nga gjërat e para që mësova kur fillova shkollën ishte të mos shkruaja kot ato që dëgjoja gjë që do të ishte më e lehtë për mua, se sot është një ditë shumë e bukur dhe me diell sepse është Dita e Republikës, edhe pse po bie shi, dhe ajo thoshte – kjo është marrëzi. Duhet të shkruash, "Shkela në një pellg sot... por gjithsesi, ndihem mirë sepse të gjithë jemi të lumtur sepse është, s'e di, festë." Pra, ajo gjithmonë më ka mësuar të jem vetvetja dhe të them atë që është, të shkruaj atë që është.

Është fakt që prindërit e mi kishin një punë specifike. Të dytë fluturonin në transportin ajror jugosllav. Nëna ime ishte stjuardesë, babai pilot. Dhe ata vendosën se ishte më mirë të fluturonin së bashku, sepse po të kishte qenë ndryshe, nuk do të kishin qenë kurrë së bashku, por njëri prej tyre do të kishte qenë gjithmonë vetëm me mua, dhe kjo ndoshta nuk do të kishte funksionuar.

Sidoqoftë, isha goxha e vetmuar si e vogël, ende fëmijë i vetëm, gjithmonë kisha dikë tjetër që kujdesej për mua. Nuk më mungonin vetëm prindërit e mi, por edhe ajo shoqëri familjare. Më pëlqente shumë të shkoja te miqtë e mi, të cilët kishin vëllezër dhe motra, dhe kështu, kur të gjithë mblidheshin në shtëpitë e tyre, gjithmonë e kujtoj si një përvojë të veçantë. Besoj se kjo është arsyeja pse gjithmonë kam dashur të kem shumë fëmijë, dhe për fat të mirë, gjeta një burrë që donte të njëjtën gjë, dhe tash kemi katër fëmijë dhe jemi një familje që shpesh i ngjan një stacioni treni. Dikush gjithmonë shkon e vjen, e të mos flasim kur na vijnë të afërm e miq. Zakonisht jemi shumë dhe jam i lumtur për këtë, po.

Nëna ime është 12 vjet më e re se babai im. Ajo jetoi së pari me babain dhe nënën e saj, por për fat të keq babai i vdiq shumë shpejt, më duket se ishte vetëm pesë

vjeç kur mbeti pa të. Ai u sëmur dhe vdiq. Gjyshja ime më vonë u martua përsëri; ajo u martua për herë të dytë me një malazez në Beograd. Domethënë, një qytetar i Beogradit me origjinë malazeze dhe ai ishte avokat, Raša Grbović, Radomir Grbović, ai ishte gjyshi im. Kështu e quaja unë. Kurrë nuk e kam takuar babain e vërtetë të nënës sime. E Raša e pranoi nënën time absolutisht! Gjithmonë e mbështeti dhe e respektoi, kështu që... veç mirë. E mbaj mend si një burrë shumë të gjatë, të madh me shpatulla të gjera, por shumë të vëmendshëm, modest. Kur unë u rrita diku para se ai të vdiste, isha ende në shkollën fillore, ai u përpoq të më shpjegonte se nuk ishte gjithçka e kalbur në Jugosllavi, që kishte ekzistuar edhe para Luftës së Dytë Botërore. Ai mbaroi Fakultetin Juridik në Beograd në vitin 1936.

Nëna ime kishte një gjysmëmotër e cila lindi nga martesa e dytë e gjyshes sime. Ajo ishte tezja ime Vesna, e cila për fat të keq ndërroi jetë gjithashtu. Por mbaj mend që i kaloja fundjavat në Senjak, që është një pjesë e Beogradit ku jetonin gjyshërit, si një kohë super e hareshme. Ajo është zonë shumë e gjelbër dhe kishte të gjitha karakteristikat e një lagjeje, një lagjeje romantike. Kur shikoje përmes dritares së dhomës së tyre të ngrënies, shihje vetëm çati të vogla që disi shkrihen dhe kopshte, dëgjoje shushurima, të qeshura ose heshtje të përbashkët. Dhe të gjithë njiheshin, përshëndeteshin në rrugë. Në dimër, rrëshqisnim me saja, kishte një rrugë të pjerrët që ishte gjithmonë e mbyllur për saja, të gjithë fëmijët nga Senjaku vinin atje... Shkonim në park, kisha një shoqe të shkëlqyer të fëmijërisë Jelena, dhe shkonim në aventura të ndryshme me qenin e saj Gina, pra fëmijëria ime në Senjak ishte vërtet shumë e harshme dhe emocionuese. Kaq.

Nga kopshti në universitet

Kopshti ishte në hyrjen time, në hyrje të ndërtesës sime, kështu që ishte disi i pashmangshëm. Besoj se gjithmonë e kam ditur se aty ka qenë një kopsht fëmijësh, dhe se do të më duhej të shkoja aty. Dhe e di që nuk më pëlqente të flija aty, por duhej ta flija. Megjithatë, kisha shoqëri të mirë në kopsht, dhe atë e kam edhe sot, ajo është një nga shoqet e mia më të mira, Maša nga kopshti, nga një grup më i ri. Pra, të gjithë ishim në të njëjtin telashe, duhej të flinim, duhej të hanim një lugë të plotë vaj peshku, duhej të duronim një mësuese kopshti që na i kapte veshët kur bënim diçka të gabuar, dhe na i kapte faqet nga dashuria, ajo ishte mjaft e ashpër, e rreptë... Kur Desa që kishte flokë të kuqe e sy të kaltër vinte e i binte kitarës, të gjithë lulëzonim kur vinte, këndonim, kërcenim, kështu më kujtohet disi.

Nuk ishte e vështirë për mua, varet, ashtu si në jetë, varet nga njerëzit, por mendoj se kalova mirë. Duke shikuar nga kjo largësi, më duket se na bashkoi një ankth i përbashkët. Shkollën fillore e kam filluar në vitin 1979. Shkolla ishte shumë afër. Novi Beograd kishte kuptim, e kam fjalën, nuk mund ta them këtë për absolutisht të gjitha rajonet, por në parim është shumë mirë i planifikuar. Ishte një pjesë e re e qytetit që u ndërtua sipas disa trendeve të planifikimit urban që ishin të përshtatshme për njerëzit, përfshirë fëmijët. Gjithmonë kishte një shesh lojërash mes ndërtesave, një numër i caktuar ndërtesash duhej të kishin shkollë. Pra, shkolla jonë "Žarko Zrenjanin" ishte disi afër secilit prej nesh. Dhe nuk kishte shembuj të tillë në shkollat e tjera qendrore të Beogradit ku vijnë njerëzit, dhe fëmijët vijnë nga disa pjesë të tjera të qytetit vetëm për të shkuar në shkollë atje. Jo, ne të gjithë jetonim në një rreth koncentrik rreth asaj shkolle, dhe të gjithë vinim në shkollë lehtë dhe në këmbë, ecnim shumë, shkonim kudo edhe në kurset e anglishtes, në aktivitete të tjera.

Disa nga shokët e mi të kopshtit filluan më herët, disa më vonë. Unë e kam filluar shkollën në moshë më të re. Unë fillova kur isha gjashtë vjeç, zakonisht të gjithë fillonin kur ishin shtatë vjeç. Sinqerisht, nuk e di a ishte ky vendim i mirë. Për shkak se komuniteti, veçanërisht ai komunitet shoqëror i imponuar siç është departamenti, është si një inkubator që në mënyrë të pashmangshme – përveç nëse mësuesit dhe edukatorët janë tmerrësisht të përkushtuar për të qenë të ndryshëm – në mënyrë të pashmangshme është një formë e luftës sociale, një demonstrim shoqëror. Mund të jetë situatë mjaft e tendosur. Çdo ditë në punë me tridhjetë njerëz në një zyrë… Fëmijët me më shumë përvojë emocionale, më të qëndrueshëm, me më shumë vetëbesim sigurisht që kalojnë më mirë. Unë nuk kisha përvojë në këtë drejtim dhe në disa situata u trishtova.

Për shembull, në situata xhelozie, prekesha vërtet kur dikush ishte më xhelozonte, ose kur mësuesja ime më veçonte, më lavdëronte, dhe dikush thoshte hapur: "Pse ajo të pyeti ty dhe pse jo mua?" Gjithmonë jam ndjerë fajtore për këtë. Tash kur e mendoj, ndoshta po të kisha qenë më e madhe, do të kisha thënë, "Epo, kjo është e drejtë, po, e kam fjalën, unë isha më e mirë", por kjo më prekte, më dukej se isha fajtore... Eh, po, ndoshta kjo ndikoi në zhvillimin tim, ndoshta shkaktoi mungesë të ndonjë ambicieje më të madhe. Mbaj mend që kujdestarja ime në fund të shkollës fillore më tha, "Ti mund ta kishe mbajtur këtë klasë. Mund ta kishe drejtuar këtë shkollë. Ishe gjithmonë e shkëlqyer, por nuk e di pse nuk doje..." Dhe mendoj se shkolla fillore më mësoi shumë mirë se njerëzve nuk u pëlqejnë ata që dallohen. Mendoj se më ka bërë të kem ku-

jdes që të mos dallohem shumë, përveç kur me të vërtetë duhet.... Nëse mund të ndihmoj me diçka – do të ndihmoj, por jo të imponohem.

Në fakt, që në kopsht filluam të mësonim për të gjitha festat partizane, t'i shënojmë të gjitha datat e rëndësishme shtetërore si 6 Prillin, Bombardimin e Beogradit. Shqetësohesha, zemërohesha me prindërit e mi, pse ne nuk e shënojmë edhe në shtëpi, pse ne nuk kemi ndonjë gazetë muri në shtëpi dhe tortë për të gjitha këto festa, p.sh. për Ditën e Armatës, më 22 Dhjetor... Dita e Republikës, 29 Nëntori, ishte festë serioze, kishte pushim, udhëtime, festime...

Thashë se kam shkuar në kopshtin "Dr. Simo Milosević". Më duket se të gjithë e dinim se si quhej kopshti ynë, ndoshta na e kishin thënë, ndoshta atëherë m'u kujtua se ai ishte mjek, doktor, por sot kur lexoj më shumë dhe dua t'u shpjegoj më shumë fëmijëve për Luftën e Dytë Botërore e kuptoj sakrificën e vërtetë të pabesueshme të këtyre njerëzve që morën pjesë në Luftën Nacioinal Çlirimtare. Vitin e kaluar shkuam me familjen tonë në Tjentište, dhe atëherë lexova më shumë për Simo Simo Milosevićin, për partizanin i cili nuk ishte vetëm mjek, por edhe shkencëtar. Ai ka botuar punime shkencore në mjekësi para luftës, ka qenë profesor i Fakultetit të Mjekësisë, njeri shumë i shkolluar, dikush që me siguri ka pasur mundësi të largohej me kohë nga çdo luftë. Por jo, si shumë intelektualë të tjerë të kohës, ai mori pjesë në të gjitha këto ofensiva dhe në fund vdiq. Çetnikët e vranë së bashku me poetin Ivan Goran Kovačić në Sutjeskë.

E mbaj mend shumë mirë; ishte gjithçka shumë e shënuar dhe... Ne nuk vënim në dyshim asgjë, as betimin, as shaminë – thjesht bëheshe pionier, e jepje betimin që nuk ishte shumë ideologjik: "Sot, ndërsa po bëhem pionier, Jam fjalën e pionierit – se gjithmonë do të mësoj e do të punoj me zell, do t'i respektoj të moshuarit, dhe do të jem shok besnik e i ndershëm" – Nuk shoh ndonjë problem me këtë betim as sot. Kështu dukej pra.

Ne e festonim Krishtlindjen Katolike, Natën e Krishtlindjes, sepse është pjesë e traditës familjare të babait tim. Megjithëse ishte justifikim i mirë për prindërit e mi që të mblidhnin miq në Beograd kur ata ishin të lirë, sepse të tjerët i festonin Krishtlindjet Ortodokse dhe disa ende e bëjnë këtë, megjithëse më pak se sot, por sigurisht, Krishtlindjet Katolike zor se i festonte dikush. Në një nga ato Krishtlindje, kam një fotografi kur, siç thotë nëna ime, "Sapo të vesha, dhe u veshëm, ti the, 'jo, diçka mungon, diçka mungon' dhe më pas u shfaqe me kapelë të kaltër (titovka), dhe me shallin e pionierit dhe the, 'Eh tash, tash jam gati.' Ja, kështu ishte, në frymën e kohës…

Gjyshja ime sllovene, Marica, ishte jashtëzakonisht fetare. Katolike e devotshme, e përkushtuar ndaj kishës, prandaj babai im debatonte vazhdimisht me të. Në fakt, ai nuk e respektonte institucionin e Kishës Katolike dhe përfaqësuesit e saj, i kritikonte priftërinjtë, e kritikonte mbledhjen e detyruar të donacioneve për kishën, ai besonte se institucioni i kishës në të vërtetë po e kompromentonte besimin, se ata ishin të korruptuar, se ata po abuzonin me fëmijët, gjë që më vonë doli të ishte e vërtetë. Pra, gjatë pjesës më të madhe, ai vazhdimisht debatonte me të për këtë. Ajo vinte te ne çdo vit për Krishtlindje dhe kalonte të paktën një muaj në Beograd dhe shkonte në kishën katolike në Zemun.

Familja ime e ngushtë, babai, nëna, ata nuk e praktikonin asnjë fe, babai ishte ateist i hapur, e kam fjalën, ai ishte pilot, ai besonte në shkencë, teknikë, ai ishte darvinist në çdo kuptim. Pra, ai nuk besonte në Zot. Nëna ime nuk thoshte asgjë, por nuk besonte dhe nuk më detyroi në asnjë mënyrë, por ata i bënë lëshim gjyshes sime. Dhe kështu, u pagëzova në një kishë katolike në Beograd. Unë nuk jam rritur duke më çuar në kishë. E gjyshja ime nga ana tjetër, nëna e nënës sime, ajo ishte fetare, por në mënyrë të moderuar. Dhe kur isha në shtëpinë e tyre, për disa festa, p.sh. Pashkët, ajo më çonte në manastirin e Vavedenjes në Senjak dhe kjo ishte shumë interesante për mua sepse duhej të zgjoheshim në agim, që të mund të shkonim atje, dhe të gjithë njerëzit ecnin rreth asaj kishe të vogël me qirinj, ishte shumë interesante për mua, dukej shumë kinematografike, dhe nga këndvështrimi i sotëm ishte konspirative, sepse nuk kishte më shumë se ndoshta tridhjetë njerëz, as për së afërmi me turmat e sotme.

Megjithatë, besimi ishte i pranishëm në jetën time, kryesisht përmes gjyshes Marica, e cila ishte shumë fetare. Dhe në mbrojtje kundër babait dhe kritikave të tij, ajo gjithmonë tundte kokën dhe përsëriste se besimi i saj e kishte mbajtur gjallë, se kjo do të thoshte shumë për të. Ajo mbeti pa burrë në moshë relativisht të re. Shpesh e përmendte luftën, Luftën e Dytë Botërore, duke thënë se pa besim nuk do të mbijetonte, dhe se ishte shumë e vështirë, se duhej të fshiheshin në pyje, dhe në shtëpitë e njerëzve të tjerë, gjë që nuk ishte e lehtë me fëmijët.

Në shkollë, ishim ndryshe, absolutisht. Ishim një Jugosllavi e vogël brenda Novi Beogradit. Kishte fëmijë me mbiemra të ndryshëm, me origjinë të ndryshme. Kjo ishte normale për ne, për pushime shkonim te të afërmit në rajone të ndryshme të Jugosllavisë.

Gjithmonë më interesonte më shumë teoria sociale, gjithçka që po ndodhte në shoqëri. Përveç historisë dhe gjeografinë, nuk mund të them se nuk më interesonte edhe biologjia, apo kimia, pastaj e doja shumë fizikën. E gjitha varet shumë nga mësuesi. Ne ishim të vegjël, fëmijëve të vegjël u pëlqen lënda vetëm nga librat që mund t'i lexojnë. Unë kisha arsimtarë që përpiqeshin shumë të na zgjonin interesimin, të përçonin dashuri për lëndën e tyre. Në fund të orës, arsimtarja e matematikës na jepte të zgjidhnim enigma logjike për orën e ardhshme, arsimtarja e muzikës lozte Boleron e Ravelit njëqind herë, kjo ishte ajo që shumicës prej nesh u pëlqente, arsimtarja e gjuhës serbe na mësoi të shkruanim të paktën dy fjali nga çdo libër që e lexonim të cilat na linin përshtypjen më të fortë…

Kam kaluar nëpër faza të ndryshme, mendoja të studioja mjekësi, pastaj regji, më pëlqente teatri, sepse shihja shfaqje të shkëlqyera, tek të cilat na çonte shoqja e nënës sime, e cila vazhdimisht siguronte bileta "nga sindikata". Në fund të shkollës fillore, ishte e qartë se kisha më shumë interes për lëndët shoqërore. Por isha mjaft e mirë edhe me lëndët e shkencave natyrore dhe nëna pati ndikimin kryesor mbi mua. Ajo në fakt më urdhëroi se duhet të shkoj në drejtimin e shkencave natyrore, dhe më vonë, nëse dua, mund të studioj diçka shoqërore. Dhe me këmbënguljen e saj, mbarova gjimnazin e shkencave natyrore, në një shkollë të mesme e cila kërkonte shumë. Kishim matematikë 24/7, dy kimia, fizikë, astronomi, gjithçka. Mua nuk më interesonin fort të gjitha këto, por durova dhe i përfundova katër vitet.

Mbaj mend kur u ktheva në shtëpi, menjëherë e ndezëm televizorin, as nuk i ndezëm llambat, por ishte aq errësirë në banesë, askush nuk mendonte për llambat. Dhe ishin lajmet, isha me babain tim, dhe dëgjuam se Titoja kishte vdekur. U trondita, nëna

tregon se thashë: “E çfarë do të bëjmë tash që shoku ynë Tito ka vdekur,” dhe fillova të qaj. Por në një moment, vura re se babai im nuk po qante. Kjo më dukej mjaft e pazakontë. Ai ishte i brengosur. E mbaj mend këtë. Emocionet e tij ishin të rëndësishme për mua. Sot më kujtohen emocionet në fytyrën e tij, ishte mjaft i brengosur. Sikur po e shikonte humnerën që po na pret. Por nuk qau. Më vonë, e kuptova arsyen. Familjen e nënës së babait e kishin vrarë partizanët. Gjyshin e tij e vranë partizanët para gruas dhe fëmijëve, nuk e di kush e bëri dhe më vjen keq që faji nuk u vërtetua kurrë. Por kjo ishte ngjarje e tmerrshme, në të cilën drejtuesi i togut partizan nuk i besonte gjyshit të babait tim se nuk kishte drithë për t’u dhënë, sepse i vetmi drith që kishte ishte për mbjellje, ishte i mbushur me kimikate. Ata menduam se po ua fshihte atë drithë, disa prej tyre ishin helmuar prej tij, dhe pastaj e dënuan duke e pushkatuar para shtëpisë. Gjyshja e babait tim e pa dhe pësoi një krizë nervore nga e cila nuk u shërua kurrë. E gjithë kjo, bashkë me shtetëzimin e pothuajse gjithçkaje që krijoi babai i tyre para luftës – dhe nuk është çudi që askush prej tyre nuk qau për Titon.

Familja e babait kishte gjithmonë dyshime për komunistët. Por babai ishte antifashist në çdo mënyrë dhe familja ime është antifashiste, dhe ai më tregoi se si babai i tij u kishte ndihmuar partizanëve. Pra, ajo që u ndodhi atyre ishte krim lufte, dhe shtetëzimi ishte një formë padrejtësie që u korrigjua tek shumë vite më vonë. Është e qartë se ata nuk ishin dashamirë të mëdhenj të komunistëve, por unë nuk u rrita me ndonjë kundërshtim ndaj lëvizjes antifashiste, apo ndaj partizanëve si të tillë. Babai im kurrë nuk tha asgjë kritike në lidhje me luftën kundër nazistëve. Në fund të fundit, edhe babai i tij u dëmtua prej tyre, ata ishin të parët që ia morën shtëpinë, makinën dhe hotelin, etj. Është e vërtetë se ai më vonë vuajti edhe nga këto autoritete të reja, por kjo është e gjitha për shkak të rrethanave historike. Thelbi ishte se as gjyshi im, as ndonjëri prej tyre nuk ishin kurrë në favor të nazizmit, fashizmit e të tjera. Pra, kjo ishte arsyeja, të cilën e kuptova më vonë, pse babai im nuk derdhi lot kur vdiq Titoja, por ishte njeri i zgjuar, prandaj ishte i shqetësuar.

Tash më vjen ndërmend diçka tjetër – babai im ishte njeri i mirë, dhe ai e donte Serbinë në të cilën jetonte, ashtu si shumë të tjerë, pavarësisht nga origjina. Mbaj mend protestat e marsit 1991 të udhëhequra nga Vuk Drašković, kur opozita u ngjit në ballkonin e Teatrit Kombëtar, të gjitha u transmetuan në Studio B të asaj kohe. Dhe babai i xhiroi të gjitha në videokaseta. Më duket se edhe sot i kemi ato videokaseta që babai im i shënoi me bukurshkrimin e tij, por gjithmonë duke përzier đ dhe dž, dhe kështu ai shkroi “Radžanje nove Srbije.” Ai donte sinqerisht që Serbia të ishte shtet demokratik dhe qytetar edhe pas shpërbërjes së Jugosllavisë. Por Serbia ende është larg atij ideali.

Në atë kohë, me të vërtetë nuk e dija se disa të rritur ishin kritikë ndaj politikës së Titos, ku ta di, ndoshta në lidhje me Goli Otokun dhe shtypjen e lirisë së fjalës, etj. Por në përgjithësi, ai ishte figurë e preferuar në rrethin tim. Epo, babai im nuk qau, por mendoj se e dinte që pas vdekjes së tij nuk po shkruhej asgjë e mirë për Jugosllavinë, se po hynte të paktën në një kohë të pasigurtë, gjë që edhe ndodhi.

Nuk e mbaj mend se si reagoi nëna ime. Por në tërësi, ishte vetëm një periudhë trishtimi. Nuk kishte muzikë, ajo temë ishte gjithmonë në TV, prindërit e mi nuk më çonin në paradë në Parlament dhe Shtëpinë e Luleve, por më kujtohen ato rradhë dhe njerëz që shkonin për t’i bërë homazhet, gjithçka zgjati shumë, pastaj funerali, pastaj ai tren nga Lubjana në Beograd. Ishte kjo një periudhë që është gdhendur absolutisht

në kujtesën time. Atëherë isha shtatë vjeç.

Në gjimnaz, ishte e vështirë, na u sulën menjëherë, na i treguan dhëmbët që në fillim. Menjëherë pati marrje në pyetje, të gjithë u tronditëm nga ky ndryshim, pa mëshirë. E di që disa nga shokët dhe të njohurit e mi nga shkolla fillore u larguan nga ai gjimnaz dhe menjëherë shkuan diku ku ishte më e lehtë. E di që shpesh mendoja më pas nëse duhet të kisha ndjekur gjurmët e tyre, për t'ia bërë më të lehtë vetes sime... Por më pas e përjetova si një lloj prove dhe lufte që duhej ta fitoja, për t'ia dëshmuar vetes dhe të tjerëve se ende mund t'ia dilja, me shumë sukses.

Të nëntëdhjetat

Sa mirë do të ishte sikur të kishte ndodhur diçka krejt ndryshe. Në fakt e përcolla Vida Ognjenovićin duke e vënë në skenë dramën Kanjoš Macedonović në Budva, gjatë gjithë verës, për shkak të rrethanave. E rrethanat ishin të tilla që nuk mund të shkoja më nga Budva në Split me autobus. Sepse atë verë të vitit 1991, filluan të na legjitimonin. Në atë kohë, Kroacia dhe SIlovenia e kishin shpallur tashmë pavarësinë, këtë e di sot, megjithëse brezi im nuk i ndoqi të gjitha këto. Edhe pse isha gati 18, vjeç, e gjithë kjo më tmerroi dhe u përpoqa të mos i dëgjoja të gjitha lajmet negative. Ne as që e kishim zakon të lexonim, as të dëgjonim shumë lajme.

Atë verë të vitit 1991 punova në një pompë benzine, ku i pastroja dritaret me një shok. Ishte kjo një përvojë shumë e bukur për mua, nga ato të ardhura mund të shkoja dhe të paguaja udhëtimin tim në Budva dhe të kaloja dhjetë ditë në një dhomë me miqtë e mi atje. Pastaj plani ishte të shkoja në Solta, përtej Splitit. Prindërit e mi ishin tashmë atje, megjithatë, ata më informuan se kjo nuk ishte më e mundur sepse autobusët nuk shkonin më, dhe kështu faktikisht qëndrova më gjatë në Budva, në Mal të Zi. Dhe ndërsa e shikoja Vida Ognjenović-n duke bërë regjinë e Kanjoš Macedonovićit, mendova, "Këtë do ta bëj unë." Megjithatë, kur pyeta përreth, kuptova se nuk mund të studiosh thjesht regjinë, duhet të kesh bërë ndonjë regji më parë.

Pastaj mendova për gjëra të tjera që mund të bëja që ishin interesante për mua dhe kështu kuptova se kjo do të ishte gjëja e duhur për të bërë. Pas shkollës së mesme në drejtimin natyror, u binda se nuk mund të regjistrohesha në drejtësi, se nuk kishte asnjë mënyrë që të mund ta kaloja provimin pranues. Dhe kalova nëpër shumë telashe për t'u përgatitur. Mbaj mend kur dolën listat e atyre që kaluan, fillova të lexoj nga poshtë, sepse kështu jam unë, vetëkritike, gjithmonë mendoj se diçka nuk kam bërë sa duhet.

Dhe shikoj dhe nuk jam askund, nuk jam askund, dhe filloj t'i humb të gjitha shpresat... Doli se isha e katërta ose e pesta nga njëmijë që kaluan. Mendova se kjo ishte shumë e çuditshme. Të gjithë këta fëmijë nga shkencat shoqërore, isha e bindur se të gjithë do t'i zinin të gjitha ato vende… Aty kuptova se drejtimi shkencor me të vërtetë të mëson të jesh i thellë. Nëse ke nota të mira në shkollë ku nuk ka lëshime, do të kalosh mirë edhe në shkencat shoqërore - të paktën do të lexosh thellësisht.

Më kujtohet që në gjimnaz, në fund të viteve '80, flitej diçka për tubimin në Gazimestan , më 28 qershor 1989. Kishte disa "ngjarje popullore", disa protesta në lidhje me

me Kosovën. Në atë kohë, unë isha në vitin e dytë të shkollës së mesme, isha më pak se 16 vjeç, dhe disa nga shokët e mi të klasës nga viti i katërt bënë thirrje që të gjithë të dilnim para Kuvendit, të shkonim në protestë, të iknim nga shkolla, të kapërcenim gardhin, me shumë zell bënin thirrje për këtë. Ata ishin fëmijë të dashur; ata mendonin se duhet të ndihmonin kundër padrejtësisë dhe se kishin të drejtë të protestonin...

Për fat të mirë, prindërit e mi ishin ata që i shikonin lajmet nga të dyja anët e pasqyrës... Ata kurrë nuk i lajthiti Slobodan Miloshevići. Që në fillim, tek ai panë një rrezik të madh të nacionalizmit nxitës. Ata më ndihmuan të kisha kapërcim kritik të "ngjarjeve popullore". Të ndalesha dhe të shihja pse dhe si po ndodh. Dhe edhe nëse "ngjarja" nënkuptonte ikjen nga mësimi, gjë që ishte e mirëseardhur për të gjithë, të shohim megjithatë se për çka bëhej fjalë, kush ishte pas kësaj...

Ky ishte edukimi im në shtëpi. Nuk më lejonte të jem pjesë e tufës që ndjek dikë vetëm sepse është i mirë, sepse është mik, por të shoh se për çka bëhet fjalë në të vërtetë. Ajo periudhë pas Gazimestanit, qershor 1989, tërheqja e delegacionit slloven nga Kongresi i Partisë Komuniste të Jugosllavisë (janar 1990), dhe gjithashtu para referendumit në Slloveni për pavarësinë, dhjetor 1990, shpallja e pavarësisë dhe lufta në Slloveni në qershor 1991, atmosfera ndaj sllovenëve në Beograd ishte shumë negative. Papritur, një mëngjes pamë në kutinë tonë postare, "Derrat sllovenë." Nuk më kujtohet nëse ishin "derra sllovenë" apo thjesht "derra". Dhe e kisha të qartë se kjo ishte për shkak se mbiemri Gorjanc figuronte në kutinë postare. Kjo është hera e parë që përjetova se problemi ishte mbiemri im.

Pastaj erdhi edhe ideja e çmendur për t'i bojkotuar produktet sllovene. Pas një kontrolli të mëvonshëm, pashë se më 29 nëntor 1989, Serbia i shpalli luftë ekonomike Sllovenisë për shkak të ndalimit të udhëheqjes sllovene për të mbajtur një tubim pro-serb "Për të Vërtetën për Kosovën" në Lubjanë, kryesisht lëngje Fruktal, të cilat përndryshe ishin super të preferuara. Kjo nuk u prit me simpati nga familja ime, veçanërisht familja e nënës sime, domethënë pjesa serbe e familjes sime. Tezja ime nuk u mërzit fort, ajo u gëzua sepse tash ato lëngje u bënë më të lira meqë ra shitja.

Ndryshimet në Jugosllavi ranë drejtpërsëdrejti mbi mua së pari përmes urrejtjes ndaj sllovenëve këtu në Serbi, dhe shumë shpejt edhe ndaj kroatëve. Dhe sidomos për faktin se shokët e mi të klasës, të cilët ishin kryesisht gjenerata e vitit 1972, unë isha gjenerata '73, pastaj si ushtarë, nga shërbimi ushtarak, të transferuar në fushëbeteja në Kroaci në vitin 1991. Simptaia ime e parë dhe shoku i mirë nga shkolla fillore, ai më erdhi papritmas në derë, më kujtohet, nëna e mbajti për drekë, ai na tregoi se sa e tmerrshme dukej kjo luftë në frontin e Vukovarit, si u fut në një situatë ku duhej ta qëllonte dikë që ai të mos e qëllonte, si mendon se nuk do të mund të shërohet kurrë, dhe si shkoi në MMA për të folur me mjekun për PTSD, e ajo i tha, "Epo, fëmijë të dashur, çka mendoni, se mund t'ju dëgjoj të flisni kështu?" Dhe më pas i tregoi se ajo kishte qetësues në sirtar, të cilat i merr në fillim që të mund t'i dëgjojë të gjitha historitë e tyre.

Shpërbërja e Jugosllavisë ishte diçka e tmerrshme për mua. Unë kam lindur dhe kam jetuar në Jugosllavi. Familja dhe miqtë e mi ishin në të gjithë Jugosllavinë. Babai im është slloven, kam pasur shumë të afërm në Slloveni. Nga viti 1979, kishim një shtëpi buzë detit në Kroaci, të cilën e ndërtuan vetë nëna dhe babai, me ndihmën e Slavkos dhe punëtorëve të tjerë nga Bosnja dhe Hercegovina, të cilët unë i shikoja për vite me radhë ndërsa po e ndërtonin bashkë me babain, dhe të cilët më vonë vdiqën të gjithë

në atë luftë. Kjo ishte tmerrësisht e vështirë për mua. Kroacinë e kisha shtëpi të dytë. Çdo pushim veror e kaloja atje, nga fillimi në fund. Kisha miq atje, prindërit e mi kishin miq atje me të cilët këndonin mbrëmjeve. Dhe të gjithë kalonim çaste të bukura. E tash çka, duhet të vrasim njëri-tjetrin?! Kjo, natyrisht, ishte e papranueshme për mua. Përnjëherë shokët e mi të klasës duhet t'i vrisnin miqtë e mi nga Šolta?! Pastaj, në një moment filluan protestat në shatërvanin e Terazijes[4] në vitin 1991, pastaj përsëri në vitin 1992. Në vitin 1992, në tetor të atij viti fillova fakultetin.

Fatmirësisht, në fakultet, kisha profesorë, pedagogë të shkëlqyer, të cilët ndikuan shumë në formimin tim si juriste, por edhe si qytetare. Unë nuk kam përfunduar drejtimin shoqëror në shkollë të mesme, ku mund të kisha biseduar me njerëz që flisnin më shumë për tema sociale me nxënësit. Kjo nuk ishte aspak temë në shkollën time të mesme.

Por në universitet, kompensova gjithçka... Në një nga ligjëratat e para, për shembull, në Historinë e Shtetit dhe Ligjit, të cilën e ligjëronte profesor Dragoljub Popović, më vonë gjyqtar i Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, ai i kërkoi amfiteatrit të mbushur plot, disa qindra studentë, të ngrinin duart ata që kishin lexuar gazeta atë ditë. Dhe me turp, në një sallë të plotë, vetëm disa studentë ngritën duart, dhe unë nuk isha në mesin e tyre… Më vinte shumë turp. Pastaj pyeti, "E, kush i ka lexuar gazetat dje?" Dhe pastaj, nuk e di, ndoshta disa duar të tjera u ngritën. Dhe pastaj na e dha një mësim. Tha: "Ju jeni në fakultetin e drejtësisë. Drejtësia është shkencë shoqërore. Shteti bazohet në rregulla ligjore. Nuk mund ta kuptoni drejtësinë nëse nuk e dini se çka po ndodh në vend, dhe si aplikohet ajo sidomos në këtë moment historik…" Ishte viti 1992. Në prill u krijua një shtet i ri, Republika Federale e Jugosllavisë, dhe u miratua Kushtetuta e Žabljakut ,[5] si një formë e re e shtetit. "Ne duhet të flasim për historinë e shtetit dhe të drejtat, e ju nuk e keni haberin se çka po ndodh tash...".

Detyra ime është që t'i lexoj lajmet dhe kush çka ka thënë. Shpenzoj shumë kohë për të gjitha këto, dhe shpesh mendoj se sa më mirë do të ishte sikur ta kisha kaluar kohën që lexoj budallallëqe të ndryshme që thonë njerëzit për të lexuar klasikë të letërsisë dhe filozofisë që ende nuk kam arritur t'i lexoj.

Ne gjithmonë kemi diskutuar në familje. Bisedoja me nënën dhe babain dhe miqtë tanë të familjes. Dhe e kisha plotësisht të qartë kolapsin e nacionalizmit, shkatërrimin që po e shkakton kjo politikë nacionaliste qeverisëse serbe. Gjithmonë e lexonim gazetën Vreme dhe pastaj Naša borba dhe krejt ishte plotësisht, plotësisht e qartë.

Shkoja në protesta, nga ato që u zhvilluan në Beograd në mars 1991 e tutje. Në protestën e studentëve pranë shatërvanit të Terazijes, më kujtohet një moment vërtet prekës kur pashë Dragan Nikitovićin, komentatorin e famshëm sportiv të njohur në të gjithë Jugosllavinë. Ai nuk ishte gazetar politik. Ai ishte qytetar i Beogradit, i cili gjithashtu i kalonte pushimet në Maslinica, në Solta, si unë. Dhe kur e pashë, mendova se ishim si disa përfaqësues të Šoltas në atë protestë. Në fakt, të dy e dinim se politikat e Miloševićit po i shkatërronin marrëdhëniet ndërpersonale. Dhe ende nuk

4 Protesta kundër luftës nga studentët në shatërvanin e Terazijes në mars 1991.

5 Më 27 prill, 1992, Këshilli Federal i Kuvendit të RSFJ-së (në të cilën morën pjesë vetëm delegatë nga Serbia dhe Mali i Zi) mori vendim për shpalljen e Kushtetutës së parë të një shteti të ri: Republikës Federale të Jugosllavisë (RFJ). Atij shteti iu bashkua Republika e Serbisë dhe Republika e Malit të Zi. Pas shpërbërjes së RSFJ-së, këto dy republika vendosën të mos formojnë shtete të pavarura, por të formojnë një të përbashkët.

mund ta imagjinonim se çfarë lloj gjakderdhjeje do të ndodhte, me gjithë ato krime.

Pra, unë merrja pjesë në të gjitha ato protesta. Në një moment, prindërit e mi, ishim në Slloveni, ishte pushimi veror i vitit 1992. . Në tetor, duhej të filloja universitetin. Tezja ime, e cila jetonte në Gjermani në atë kohë, tha: “Është kohë e tmerrshme. Hajde, ta çojmë të mësojë gjermanisht, të largohet pak derisa të mbarojë lufta, është situatë e tmerrshme, duhet të bësh diçka për fëmijën, ta nxjerrësh nga aty…”. Unë nuk u ankova shumë, sepse atëherë pata mundësinë ta njoftoj kushëririn tim, djalin e tezes, i cili jetonte në Gjermani dhe që ishte shumë interesant për mua në atë kohë. Ai është më i madh se unë, lexonte më shumë libra, shumë muzikë, gjithçka. Ai studionte mjekësi në Hamburg.

Dhe kështu, shkova së pari te tezja ime në Shtutgart, dhe pastaj shumë shpejt në shtëpinë e tij në Hamburg. Dhe kjo ishte përvojë e shkëlqyer. I kalova tetë muaj atje. Sigurisht, duhej të bëja diçka. Për fat të keq, megjithëse kisha pesëshe në gjermanisht në shkollë, njohuritë e mia të asaj gjuhe nuk ishin aspak në nivel të mjaftueshëm për të qenë në gjendje të bëja ndonjë punë me të, madje as në ndonjë kafeteri, në dyqan a diçka të tillë.

Dhe pastaj ndodhi diçka interesante. Në Gjermani pati një fushatë shumë negative kundër Serbisë, kundër Slobodan Miloševićit. Megjithatë, meqë unë isha kundër, kjo ishte shumë interesante për ta. U dukej interesante edhe miqve të kushëririt tim, studentëve dhe të tjerëve. Një herë shkova me të për ta vizituar një mikeshë të tij, një ish-balerinë që u lëndua dhe u jepte mësime aerobie grave në një pjesë shumë elegante të Hamburgut. Ajo ishte në lidhje me një muzikant që luante në grupin e Frank Zappas – njerëz shumë interesantë. Ishte kjo një mbrëmje e mrekullueshme. Fola edhe për atë se sa e tmerrshme është situata në Serbi; sa e kundërshtojnë luftën dhe politikat e Miloševićit...

Të nesërmen, ajo shkoi në punë dhe tregoi se si u takua me një vajzë nga Serbia, por me një serbe të pazakontë që e kritikon qeverinë, e cila ka pikëpamje kundër luftës... Dhe njëra prej atyre grave tha, “Unë do ta punësoj, a dëshiron të punojë si dado?” Ishte në të vërtetë punë ideale, ku shërben si ndihmëse. Kjo nënkuptonte kujdesin për fëmijët, akomodim, ushqim dhe para. Dhe ajo thërret dhe thotë, “Po, po, thotë ajo, “është person vërtet interesant.” Tash kur e mendoj, e kuptoj se kjo grua, Alexandra, ishte me të vërtetë aktiviste në zemër, ajo mund ta kishte punësuar ndonjë angleze me super theks për t’u kujdesur për fëmijën e saj dhe për t’ua mësuar anglishten siç duhet. Por ajo tha, “Jo, kjo është vërtet interesante...”.

Mbaj mend kur ajo më thirri për të rënë dakord me kushtet prej një aeroplani... Nuk e dija se si dikush mund të bënte telefonatë nga aeroplani... Dhe kështu, kalova tetë muaj me këta njerëz, duke u kujdesur për fëmijën e tyre. Ata ishin familje shumë interesante. Ai ishte jurist, i cili merrej me ligjin e mediave, në fakt me të drejtën e privatësisë dhe përfaqësonte klientë si Carolina e Monakos. Më mori me vete disa herë në gjyq. Dhe Alexandra kishte kompaninë e saj për PR. Mësova shumë prej tyre për mënyrën e jetesës së shëndetshme. Çdo ditë fillonin me ushtrime, në fundjavë një qëndrim shumë i rëndësishëm në natyrë, shëtitje të gjata. Pastaj, shkon në kafene dhe kënaqesh. Por kjo gjithmonë paraprihej nga një shëtitje, diçka e shëndetshme për trupin dhe mendjen. Me pak fjalë – ato pak muaj jetese me atë familje të dashur gjermane patën shumë domethënie për mua.

Megjithatë, pas tetë muajsh të kujdesit për fëmijën, pas një pune shumë të përgjegjshme, vendosa të kthehem. Kisha shumë dëshirë të vazhdoja studimet, të përfshihesha, të mos mungoja më. U ktheva dhe diplomova në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit. Në fakultet, përveç profesorit tashmë të përmendur Popović, takova edhe profesorë të tjerë fantastikë, të cilët ishin gjithashtu aktivistë, njerëz shumë të vetëdijshëm që gjithashtu merrnin pjesë në jetën politike të Serbisë. Të gjithë ata, Dragor Hiber, Vesna Rakić Vodinelić dhe burri i saj Vlada Vodinelić, dhe Gaša Knežević, për të mos harruar dikë, Vojin Dimitrijević, natyrisht. Të gjithë ishin anëtarë të partisë politike Aleanca Qytetare, e cila ishte në kundërshtim me Partinë Socialiste të Serbisë të Slobodan Miloševićit. Ata konsideronin se kjo ishte detyra e tyre, dhe jo vetëm të teorizonin. Dhe sot i respektoj shumë për këtë.

Pra, ata nuk ishin predikues nga Olimpi. Së pari i ligjëronin kritikat e tyre për mungesën e sundimit të ligjit. Na mësuan për sundimin e ligjit në rastin e shkeljeve të të drejtave të njeriut, shkeljeve të kushtetutës, shkeljeve të standardeve ndërkombëtare. Këtë ua mësuan edhe qytetarëve përmes pak mediave të lira. Dhe pastaj luftonin për atë sundim të ligjit në arenën politike. Ata ishin shembull i vërtetë i asaj se çka do të thotë të jesh qytetar... Këta janë njerëz me të vërtetë të mrekullueshëm që ndikuan absolutisht në formimin tim në çdo kuptim, si avokatë dhe si qytetarë.

Goran Svilanović, i cili ishte asistent i Vesna Rakić Vodinelićit në lëndën e së Drejtës Procedurale Civile, më vonë shërbeu si ministër i Punëve të Jashtme të Serbisë, sugjeroi që unë të vijoja studimet pasuniversitar në të drejtën e paqes. Dhe për këtë i jam shumë mirënjohëse. Në vitin e fundit të Fakultetit Juridik, e kisha të qartë se nuk mund të përfshihesha në rrjedhat e sistemit juridik, gjyqësorit, derisa të zgjidheshin gjërat në lidhje me sundimin e ligjit.

Falë profesorëve të mi, kam fituar vetëdijen se pa pasur gjyqësor dhe prokurori të pavarur, domethënë zemrën e arritjes së drejtësisë, gjykimit të drejtë, nuk ka ligj. Të merresh me fusha të tjera të së drejtës së specializuar do të thotë të jesh i verbër dhe i shurdhër ndaj faktit se sistemi që duhet të zbatojë çdo të drejtë nuk është në të vërtetë i reformuar në thelbin e vet, nuk është i demokratizuar...



Në fakt kisha frikë. Çfarë do të bëj pas atij fakulteti? Ku do të shkoj – Doja të përfshihesha në disa reforma. Profesorët më ndihmuan të kuptoj se çka më interesonte dhe çka duhet të bëja. Së pari, Goran Svilanović më referoi në studimet e paqes, dhe më pas në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut me Vojin Dimitrijevićin, që u themelua në vitin 1995. . Për fat të keq, Vojin Dimitrijević nuk dha mësim në të drejtën publike ndërkombëtare në Fakultetin Juridik, sepse ai ishte në Norvegji atë vit. Më duket se e shkroi atë librin e famshëm për terrorizmin pikërisht atëherëJ. Por pastaj, më mësoi këshilltari i Slobodan Miloševićit, Milenko Kreća, i cili, kur fliste për të drejtat e njeriut, thoshte: “Kjo është e drejtë ’e butë’, e pazbatueshme...” Ai thoshte se këto nuk janë standarde reale ligjore, por vetëm disa deklarata... Fliste me përbuzje. Atëherë shkova në shkollën e të drejtave të njeriut të Vojin Dimitrijevićit. Kjo ishte shkollë alternative e Qendrës së Beogradit për të Drejtat e Njeriut, organizatë joqeveritare, në të cilën të gjithë mësuam se të drejtat e njeriut bazohen në traktate ndërkombëtare që shteti ynë, si dhe çdo shtet kontraktues, duhet t’i respektojë. Pra, jo ligj i butë, por çështje serioze ligjore. Aty m’u hapën sytë.

Natyrisht, studimet e paqes kishin shumë rëndësi për mua. Një semestër e kam kaluar në Austri në një vend të quajtur Stadtshleining dhe një tjetër në Spanjë, në Katalloni, në një vend të quajtur Benikasim. Këto studime më kanë hapur sytë në drejtim të teorisë së lëvizjeve të paqes, të shkencave politike, të aksionit shoqëror, të kritikës ndaj nacionalizmit. Me të gjitha këto nuk kam qenë në kontakt deri atëherë, sepse ligji është shkencë shumë ekzakte, nuk ka shumë teori sociale, përveç filozofisë së ligjit. Studimet e paqes më mundësuan të lexoj tekste të rëndësishme, të dëgjoj për Hannah Arendtin për herë të parë, të lexoj disa nga gjërat e saj e kështu me radhë.

Pas kthimit tim, shkolla në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut më hapi rrugën për t’i kuptuar të drejtat e njeriut, si një disiplinë ligjore që është shumë e zbatueshme, e aplikueshme, e cila mund t’u ndihmojë njerëzve, jeta e të cilëve rrezikohet nga arbitrariteti i autoriteteve shtetërore. Në atë shkollë, dëgjova për herë të parë për Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Për herë të parë, lexova disa gjykime të asaj gjykate që ishin shumë interesante për mua, si një skenar filmi me arsyetim dhe rezultat të drejtë. Pra, forma e atij vendimi, gjuha e përdorur, arsyetimi. Gjithçka është e qartë aty. Ndryshe nga verdiktet tona me brirë, me fjali kilometrike, të cilat fillojnë në faqen e parë dhe zgjasin deri në atë të fundit. Gjykata Evropiane nuk përdorte fjalime të mërzitshme, frazeologjike, administrative.

Pas një pune disavjeçare në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut dhe studimeve pasuniversitare në Fakultetin Juridik në Beograd, ku punova si koordinatore të studimeve evropiane, mora rekomandim nga Qendra e Beogradit për të Drejtat e Njeriut për një bursë nga Fondacioni Soros për qëndrim në Shtetet e Bashkuara, në Washington. Bursa përfshinte punën në një OJQ për të drejtat e njeriut dhe zhvillimin e karrierës gjatë një semestri në Fakultetin Juridik. Në fakultet më ofruan të punoja si asistente e një profesori, dhe gjithashtu mora asistencë për t’i vazhduar studimet gjatë punës dhe për të magjistruar atje.

Për mua kishte shumë rëndësi të punoja në një organizatë të të drejtave të njeriut që aktualisht merrej me Amerikën Latine – Center for International Law and Jus-

tice (CEJIL). Për një kohë ndava zyrën me një gazetar nga Kolumbia të cilin u përpoqën ta vrisnin tre herë dhe jetën e të cilit faktikisht e shpëtoi Viviana Krstičević, drejtoresha e CEJIL-it, person i mahnitshëm, e cila i mundësoi të kalonte kohë në Amerikë, në vend të sigurtë. Atje kuptova në veçanti rrezikun i cili u kanosej gazetarëve dhe më vonë e mbrojta me tërë fuqinë sigurinë e gazetarëve në Mal të Zi dhe hetimin efektiv të sulmeve ndaj tyre. Në fakt, çdo shembull i sakrifikimit të rehatisë dhe sigurisë për hir të së vërtetës dhe idealeve të tjera, siç është drejtësia, më lë përshtypje. Njerëzit që janë të gatshëm të bëjnë atë lloj sakrifice e bëjnë këtë botë më të mirë. Ata meritojnë të gjithë mbështetjen, dhe unë përpiqem t'ua ofroj, sa herë që mundem.

Gjatë qëndrimit tim në Amerikë, ndodhi edhe ndërhyrja e NATO-s kundër Serbisë dhe Malit të Zi për shkak të ngjarjeve në Kosovë. Megjithëse kisha informacion për atë që po ndodhte në Kosovë, gjithashtu e dija se ndërhyrja ishte bërë duke anashkaluar sistemin ekzistues të së drejtës ndërkombëtare, sepse nuk ishte kërkuar pëlqimi i Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Gjithashtu u mora me teorinë e ndërhyrjes humanitare, dhe shkrova një punim se sa viktima të konfliktit në Kosovë u raportuan nga OSBE-ja para fillimit të ndërhyrjes dhe më pas, dhe se kishte rritje të madhe të numrit të viktimave pas fillimit të ndërhyrjes. Në atë kohë, forcat ushtarake serbe u nxitën në veçanti dhe ndodhi spastrimi dhe vrasja më e madhe etnike e popullsisë shqiptare. Nuk mendoj se ndërhyrja e NATO-s i justifikon këto krime në asnjë mënyrë, por mendoj se qëllimi do të duhej të kishte qenë ulja e numrit të viktimave civile.

Nuk e kam pasur gjithmonë të mundur të shpjegoj se nuk jam as për Miloševićin as për ndërhyrjen e armatosur të NATO-s pa miratimin e OKB-së. Në Washington, në atë kohë, atmosfera ishte bardh e zi, ose-ose.

Pra, nëse nuk je absolutisht në anën e mbështetjes së ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, menjëherë refuzohesh si mbrojtës i politikës së Miloševićit. Megjithëse ishte e vështirë për mua, pashë përsëri se në këto situata ushtarake - në këto situata lufte hijet nuk kanë nuanca. Përjetova që profesori im i së drejtës ndërkombëtare, me të cilin kishim debate shumë të dobishme dhe parlamentare, i cili e dinte pikëpamjen time dhe kritikën time për politikën e Miloševićit, kur vjen puna për të kritikuar ndërhyrjen dyshoj se mund të kishte ndihmuar në shpëtimin e njerëzve në terren, vendosi të mos më ftonte në një panel diskutimi për këtë, por ftoi kolegen time shqiptare nga Shqipëria, e cila nuk ishte në lëndën e tij, e cila nuk mori pjesë në këto debate dhe e cila më tha se nuk dinte asgjë për situatën në Kosovë. Të them të drejtën, ai punoi si lobist për politikanët e Kosovës, e mora vesh më vonë, dhe e kuptova më mirë veprimin e tij.

Erdha në këtë diskutim, mora mikrofonin dhe thashë atë që mendova, askush nuk më ndaloi. Por më lëndoi, sepse nuk na ftoi të dyve, nuk deshi ta paraqesë edhe anën time. Gjithashtu mësova shumë për paraqitjet publike, sepse mora pjesë në disa diskutime jashtë fakultetit, kisha nevojë të merrja pjesë. Dhe nuk është e lehtë kur duhet ta kapërcesh atë pengesë që sapo të ngrihesh dhe të thuash se je nga Serbia, të gjithë të shikojnë me dyshim. Dhe pastaj nëse ngrihesh dhe thua se ke disa dyshime nëse ndërhyrja e armatosur ishte gjëja e duhur për të bërë, je menjëherë në favor të Miloševićit. Si person relativisht i ri, më është dashur të mësoj të flas shkurt, qartë dhe vazhdimisht duke pasur parasysh se si dikush mund të më keqkuptojë ose keqpërdorë atë që them.

Këto dallime mes rrethit në të cilin njerëzit jetojnë krejt natyrshëm, sikur asgjë nuk po ndodh, dhe qarqeve të tjera në të cilat lufta është një gjendje krejtësisht çnjerëzore – kjo është ajo që unë mendoj edhe sot, ndërsa ne rrimër këtu, njerëzit rrinë nën bomba në Ukrainë, në ato strehimore, kjo është totalisht, totalisht çmenduri, totalisht marrëzi.

Megjithëse ishim në studime në disa lëndë së bashku me studentët e juridikut të cilët, pasi diplomojnë, shpejt bëhen avokatë të gatshëm për të fituar shumë para, nuk kisha përshtypjen se po na mësonin si të bënim, si të fitonim para si avokatë. Para së gjithash, diskutohet etika. Për shembull, ata kanë etikë ligjore shumë të zhvilluar. Këto rregulla janë shumë më komplekse se ato që zbatohen nga odat tona të avokatëve. Një nga lëndët më të vështira në Fakultetin Juridik në Amerikë është etika, libër i trashë, lëndë shumë e vështirë me situata komplekse për të cilat nuk mund të japësh thjesht përgjigjen “nga koka”, pa i marrë parasysh aspektet e ndryshme. Ishte kjo zbulim për mua, përvojë shumë e dobishme.

Kam mësuar shumë, sidomos mënyrën e shkrimit të teksteve ligjore në anglisht, që nuk duron fraza të gjata, nuk duron fjali të gjata, kërkon që ju të shkoni në thelb të çështjes, to the point, dhe kjo gjithashtu më ndihmoi më vonë për aktivizëm. Nëse kam arritur të bind dikë për diçka, kjo është edhe për shkak se kam pasur përvojë të tillë – si të shprehem shkurt.

Qëndrova atje vetëm një vit dhe pastaj u ktheva në Beograd dhe në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut. Në ato vitet e fundit të sundimit të Miloševićit, ishte e nevojshme të mbroheshin njerëzit që ishin në opozitë. Pra, që nga fillimi i rënies së tij në vitin 1996, pas zgjedhjeve lokale në Serbi, të cilat ai i humbi, dhe iu desh ta pranonte atë humbje pas mbërritjes së misionit të OSBE-së të Felipe Gonzalesit, regjimi i Miloševićit e përshkallëzoi luftën kundër kundërshtarëve, profesorëve të pabindur, gjyqtarëve dhe mediave. U miratuan ligje, p.sh. Ligji për Informimin Publik, kur çdo media kritikuese sanksionohej në mënyrë të përmbledhur për gjithçka që njerëzit shkruanin, që thoshin dhe që autoriteteve nuk u pëlqente.

Gjyqtarë të shquar u shkarkuan nga gjyqësori, si Božo Prelević, i cili pas rënies së Miloševićit ishte ministër në qeverinë e Đinđićit, sot avokat dhe analist i shquar, dhe Rada Dičić, sot gjyqtare e Gjykatës së Apelit në Beograd, dhe Vida Petrović Škero, e cila më vonë u bë kryetare e Gjykatës Supreme, Gordana Vidojković [?]… dhe shumë të tjerë. U miratua edhe Ligji për Universitetin, i cili u hartua për të pezulluar zbatueshmërinë e kontratave të punës me të pabindurit, dhe lidhjen e saj me të tjerë, e që ishte arsyeja që profesorët e mi ta kundërshtonin atë dhe disa prej tyre të largoheshin vazhdimisht nga Fakulteti Juridik i Universitetit të Beogradit.

Ishte kohë e vështirë nën regjimin e Miloševićit kur aktivistët e të drejtave të njeriut kishin shumë punë. Punonim ditë e natë në Qendër. Detyra ime ishte të shkruaja buletine me raporte për shkarkimin e gjyqtarëve, profesorëve dhe ndëshkimin e mediave. Dhe pastaj erdhën këto zgjedhje vendimtare në vitin 2000. Ideja shumë e dobishme e Vojinit ishte të përfshihej në përgatitjen, në trajnimin e anëtarëve të komisioneve zgjedhore për të luftuar kundër vjedhjes zgjedhore. Unë shkrova një doracak me titull “Drejt zgjedhjeve të lira”, sepse të gjitha zgjedhjet e mëparshme dhe këto aktuale ishin organizuar në mënyrë mjaft të pabarabartë.

Megjithatë, është dëshmuar e mundur të ndërrohet qeveria edhe me zgjedhjet e tilla me të meta. Mendoj se gatishmëria e mirë e papritur, trajnimi i anëtarëve të komisioneve zgjedhore kontriboi ndjeshëm në këtë. E shkrova atë doracak ashtu që Vojin Dimitrijević më udhëzoi të flisja me njerëz që dinin të m'i shpjegonin abuzimet zgjedhore. Përveç doracakut, mbajtëm edhe trajnime për anëtarët e komisioneve zgjedhore për gjërat që nuk duhet t'i bëjnë, p.sh. të largohen nga qendra e votimit, nëse nuk kanë zëvendësim. Ne i kështillonim të mos ua hiqnin sytë kutive të votimit, të mos dilnin e të mos hanin, të ishin gati për çdo gjë. Ishte kjo linja e duhur e frontit për secilën votë. Dhe ata ishin të përgatitur mirë. Opozita e bashkuar kishte kontrollorë të zgjedhjeve; kishte anëtarë në pothuajse të gjitha komisionet zgjedhore. Kishte unitet, votuesit e opozitës ishin të etur të dilnin në votime dhe zgjedhjet përfundimisht u fituan.

Martesa dhe shpërngulja në Mal të Zi

Paralelisht po zhvilohej edhe jeta ime personale, dilja me burrin tim të ardhshëm, i cili nuk jetonte në Beograd dhe mezi prisnim të fillonim të jetonim së bashku. Ramë dakord të shkonim në Mal të Zi. Ai ishte avokat në Podgoricë, unë nuk isha e lidhur pazgjidhshmërisht me Beogradin, dhe planifikuam dasmën më 30 shtator 2000, duke pritur që rezultatet e zgjedhjeve do të shpalleshin zyrtarisht deri atëherë. Zgjedhjet tashmë kishin mbaruar dhe ishte tashmë e qartë se Miloševići i kishte humbur ato. Mund të shkoja qetë drejt një jete të re në Mal të Zi.

Megjithatë, doli që Miloševići nuk i njohu këto rezultate zgjedhore. Dasma jonë ishte disa ditë para protestës së opozitës së 5 tetorit. Atë ditë, tashmë kisha filluar jetë të re në Mal të Zi, dhe e pashë 5 tetorin në televizion. Dhe kaq. Që atëherë, nisi jeta ime në Mal të Zi. Sigurisht, mbajta kontakte sa më shumë që munda me miqtë e mi, dhe bashkëpunova me Vojin Dimitrijevićin sa më shumë që ishte e mundur, deri para vdekjes së tij në vitin 2012. Ai mori pjesë në një konferencë për lirinë e shprehjes që organizova për redaktorët e mediave malazeze dhe dha një nga intervistat e fundit për TV Vijesti në Podgoricë.

Edhe sot e kësaj dite vazhdoj të bashkëpunoj me profesorët e mi, me Vesna Rakić Vodinelićin, Dragoljub Popovićin. Është e parëndësishme se nga jemi; është e rëndësishme që të njohim ligjin dhe parimet e shtetit të së drejtës. Ata janë njerëz që e njohin mirë dhe mund t'u ndihmojnë të gjithëve në rajon, përfshirë Malin e Zi. Unë vetëm duhet ta jetësoj këtë.

Vrasjen e Zoran Đinđićit e përjetova tmerrshëm, si gjithë të tjerët. Me mosbesim, me tmerrim. Të gjithë ishim plot entuziazëm kur ndërroi regjimi i Slobodan Miloševićit. Besoj se është natyra njerëzore të mendosh se më në fund diçka është zgjidhur, se nuk duhet të shqetësohemi më për këtë, epo, Serbia ka ecur me shpejtësi të plotë përpara. E pra, tashmë ndjehej se Mali i Zi po mendonte të ndahej nga Serbia. Për mua, kjo ishte e natyrshme. Mendoj se duhet të kishte ndodhur në vitin 1991.

I ndiqja ngjarjet në Serbi. Ishte e qartë se e gjithë kjo pas ndryshimit të qeverisë nuk shkoi ashtu siç e prisnim. Duke filluar me faktin se njerëzit që ishin jashtëzakonisht të rrezikshëm, si Rade Marković, kreu i DB-së[6], u lanë atje për të shkatërruar doku-

6 Inteligjenca e Shtetit.

mentacionin, kryesisht për vrasjet politike të viteve '90 dhe kush e di se çka tjetër. Ishte e qartë se kjo nuk ishte punë shumë e pastër, dhe se kishte probleme serioze në bashkëjetesën mes Koštunicës dhe Đinđićit, por natyrisht nuk e prisja që kjo do të çonte në vrasjen e Đinđićit... Para kësaj, pati tentim atentati ndaj Vuk Draškovićit dhe Ivan Stambolićit, por disi, ne menduam se me ndryshimin e regjimit të Slobodan Miloševićit vrasjet kishin marrë fund.

E kam respektuar Đinđićin sepse ai u përpoq ta reformonte shoqërinë të paktën deri në një farë mase dhe nuk mendoj se i meritoi të gjitha kritikat të cilave u ishte ekspozuar. Pajtohesha vetëm me kritikat ndaj lëvizjeve të tij nacionaliste, kryesisht duke flirtuar me autoritetet kriminale të Republikës Srpska. Por fakti se ai bashkëpunoi me Tribunalin e Hagës ishte absolutisht kanun i reformës dhe gjithçkaje që duhej të ndodhte në Serbi shumë kohë më parë. Sikur të kishte jetuar, Serbia do të dukej ndryshe sot dhe ndoshta do të ishte edhe në Bashkimin Evropian.

Vdekja e tij na goditi të gjithëve. Ne e kuptuam se ku qëndronte Serbia në të vërtetë – se reformat nuk ishin të mjaftueshme, se ata ende nuk e kishin prekur vendin e duhur për ta parandaluar atë vrasje. E ndoqa, aq sa munda nga mediat, gjykimin e të akuzuarve për vrasjen e tij. Jam plotësisht dakord me familjen dhe avokatin e tyre, Srđa Popović, i cili këmbënguli të zbulonte sfondin e vrasjes, sepse është e qartë se këta autorë nuk vendosën thjesht, ashtu, ta vrasin Đinđićin. Duhej të kishte ndonjë sfond politik. Ka pasur shumë indikacione se ai ekziston dhe, siç ka ndodhur shumë herë më parë në botë, në Serbi dhe Mal të Zi, urdhërdhënësit nuk janë sjellë para drejtësisë. Dyshoj se kjo ende mund të ndodhë, por nuk duhet të harrojmë se nuk ka ndodhur.

Unë nuk e konsideroj veten eksperte të madhe, i njoh gjykimet kryesore. Nëse më duhet të jap një vlerësim të punës së asaj gjykate, do të përdor vlerësimin se Gjykata e Hagës nuk e dënoi aksidentalisht askënd. Të gjitha verdiktet janë të padiskutueshme. Problemi me atë gjykatë është ajo që nuk ka arritur të bëjë. Në aktakuzat që nuk arriti t'i ndjekë penalisht, në ato që nuk pati kohë t'i hetojë, në mbrojtjen që nuk mund t'u siguronte dëshmitarëve, u referohem në veçanti vendimeve diskutabile në lidhje me Kosovën, ku u vranë ose u frikësuan dëshmitarët. Mali i Zi i vogël u ka ikur plotësisht, askush nuk është ndjekur penalisht nga atje, asnjë krim nuk është ndjekur penalisht që mund të kishte përfshirë përgjegjësit në qeverinë në Malin e Zi, sepse kjo nuk ishte prioritet në dritën e krimeve të mëdha në Bosnjë, Kroaci dhe Kosovë. Gjithçka që kjo gjykatë ka dënuar është absolutisht e merituar.

Kishte edhe vendime të diskutueshme të shkallës së parë, të cilat më vonë u përmbysën. Kryesisht i referohem verdiktit ndaj gjeneralëve kroatë që u liruan nga procedimi i përbashkët penal në "Oluja", i cili është verdikti më i diskutueshëm i asaj gjykate, duke qenë se u miratua me shumicë të ngushtë. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se krimet kundër civilëve nuk janë kryer në këtë operacion nga ushtria kroate, gjë që shumëkush nuk e di. Sigurisht, pa Gjykatën e Hagës, ne kurrë nuk do të kishim arritur atë numër faktesh të përcaktuara për atë që po ndodhte në fushëbetejat e Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Kroacisë, si dhe shkallë të tillë të arritjes së drejtësisë për viktimat. Kjo arritje nuk është ideale, por është jashtëzakonisht domethënëse.

Dhe kur avokuam kohët e fundit në Mal të Zi për miratimin e një rezolute që dënonte gjenocidin në Srebrenicë, gjetëm se 46 gjyqtarë nga 23 vende morën pjesë në gjyki-

met se gjenocidi në të vërtetë ka ndodhur në Srebrenicë. Pra, këta janë dhjetëra njerëz nga dhjetëra vende, të cilët kanë shqyrtuar rreth 20.000 prova, është e pamundur të "manipulosh" gjithçka, t'i blesh... Kjo ishte absolutisht gjykatë ndërkombëtare, me ekspertë ndërkombëtarë, të cilët gjithashtu bënë shumë për zhvillimin e së drejtës ndërkombëtare humanitare. Aktgjykimet e asaj gjykate përdoren tani në praktikën e prokurorive dhe gjykatave në rajon dhe do të jenë të dobishme edhe për Gjykata Penale Ndërkombëtare. Ajo gjykatë ka trashëgimi të madhe dhe vetëm historia dhe shkenca juridike do të tregojnë se sa e madhe është ajo trashëgimi.

Erdha të punoj në Mal të Zi duke iu përgjigjur një konkursi dhe gjeta punë. U bëra drejtoresha e parë ekzekutive e Qendrës për Trajnimin e Gjyqtarëve të Malit të Zi dhe iu qasa kësaj pune me shumë entuziazëm. Më herët, kam punuar në Qendrën e Beogradit për të Drejtat e Njeriut me gjyqtarë që kundërshtuan Miloševićin dhe kësisoji humbën punën. Për mua, ndarja e drejtësisë është profesioni social më sublim dhe më i përgjegjshëm që mund të kesh. Kam respekt të plotë për profesionin si të tillë, por jo për të gjithë ata që e kryejnë atë, për ata që lejojnë veten të korruptohen për të mos e kryer atë siç duhet.

Absolutisht besoj se gjyqtarët meritojnë mbështetje, se ky profesion meriton mbështetje serioze dhe edukative dhe teknike sepse është kaq i rëndësishëm për shoqërinë. Dhe prandaj e doja aq shumë këtë punë. Dhe puna ishte e tillë që ne përcaktuam punën e Qendrës së Trajnimit të Gjyqtarëve, sistemuam dhe organizuam një program të trajnimit bazë dhe trajnimit të vazhdueshëm të gjyqtarëve. Më vonë, Qendra u zgjerua për të përfshirë prokurorët e shtetit. Kishte shumë entuziazëm.

Më kujtohet një situatë. Kur kam sugjeruar që secili gjyqtar të ketë dosjen e vet dhe të shkruajmë saktësisht trajnimin që ka kryer gjyqtari për të mundësuar të gjithë të marrin pjesë, kjo nuk kalonte për gjyqtarët e lartë në Bordin e Drejtorëve; "Jo, jo, në asnjë mënyrë, nuk do të kemi dosje për gjyqtarët..." thashë: "Mirë, është vetëm evidencë e trajnimeve," por nuk kalonte dot.

U tundova të përfshihesha, t'i komentoja gjërat dhe përpiqesha t'i ndryshoja ato. Pra, në një moment, kuptova se kisha përjetuar maksimumin tim në atë Qendër, se ishte koha për të bërë disa gjëra të tjera në një mënyrë tjetër. Kemi botuar disa libra të rëndësishëm dhe të dobishëm si Qendër. Libri i parë ishte përkthimi i standardeve ndërkombëtare për pavarësinë e gjyqtarëve. Kuptova se kjo ishte ajo që mungonte. Gjyqtarët kanë mundur të lexojnë për herë të parë standardet e përkthyera.

Aksioni për të Drejtat e Njeriut

Në verën e vitit 2003, po e shikoja një emision në televizion, të quajtur "Open", të gazetares Andrijana Kadija në Radio Televizionin e Malit të Zi, i cili ishte emision shumë avangard për atë kohë. Ajo ngriti me guxim shumë pyetje, pyetje të dhimbshme dhe njëra prej tyre ishte krimi i dëbimit të refugjatëve nga Bosnja dhe Hercegovina, i cili u krye në vitin 1992. Ata erdhën në Mal të Zi, kur filluan konfliktet serioze të armatosura në Bosnjën dhe Hercegovinën lindore mes Republikës së atëhershme të vetëshpallur serbe dhe forcave të Bosnjës dhe Hercegovinës. Në atë konflikt, popullata civile lokale vuajti shumë. Familje të tëra më pas erdhën në Mal të Zi.

Pikësëpari, sepse ishte afër. Së dyti, ishte vendi ku ata i kalonin pushimet. Të gjithë kishin disa përvoja të mëparshme të mira me Malin e Zi. Kishte disa vila të ndërmarrjeve ku ata punonin, kishin ku të qëndronin, etj. Asnjëri prej tyre nuk besonte se lufta do të zgjaste. Kjo është ajo që dëgjova më vonë nga Sarajeva dhe njerëz të tjerë nga Bosnja dhe Hercegovina. Të gjithë mendonin se gjithçka do të mbaronte brenda dy ose tre javësh. Se kjo marrëzi nuk mund të zgjasë. Për fat të keq, nuk ishte kështu.

Por t 'i kthehemi këtij emisioni. Ishim në Kroaci, duke shikuar një emision lidhur me këtë temë. I ftuar ishte Šeki Radončić – gazetar, publicist që e hulumtoi krimin. Një tjetër i ftuar ishte prokuror i shtetit gjatë viteve 1990. Dhe këtu u hap tema, u diskutua hapur. Šeki foli për hulumtimin e tij, çka ndodhi me të vërtetë atje. Mbaj mend të kem qëndruar në mes të dhomës duke shikuar, duke harruar as duhet të ulem. Dragan ishte aty, bashkëshorti im, avokat, i telefonova dhe i thashë, "Ky është krim lufte, që nuk vjetërohet, këta njerëz meritojnë drejtësi, familjet meritojnë dëmshpërblim, duhet të më ndihmosh…".

Burri im dhe unë u takuam në Shkollën e të Drejtave të Njeriut të Qendrës së Beogradit për të Drejtat e Njeriut. Ai ishte avokat i të drejtave të njeriut, që përfaqësonte viktimat në raste të rënda të torturës së romëve në Danilovgrad dhe një shtetase moldave S.Č, që ishte viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore në Mal të Zi. Përndryshe, ai mendon si unë, përveç se nuk ishte vërtet i interesuar t'i kërkonte këta njerëz dhe familjet e viktimave, t'i kërkonte, ndryshe nga unë, si një aktiviste. Menjëherë i thashë se duhej t'i gjenim, t'u ofronim ndihmë…

Kam punuar në gjetjen e familjeve të viktimave, në kontaktimin e tyre, në hulumtimin e asaj çështje nga ana ligjore, cilat ligje ishin të zbatueshme, si, kur, çfarë, cilat standarde ndërkombëtare mund të zbatoheshin, nëse ato ishin të zbatueshme në atë kohë. E hartova padinë e parë, dhe të parën e dorëzuam në vitin 2004, me shumë zell. Kur mbaruam padinë për një familje dhe e dorëzuam, nuk ishte gjë tjetër pos çështje e rregullt, administrative. Ndjemë edhe lehtësim, ngazëllim dhe pritje të asaj që do të ndodhte.

Ishte kjo një kohë e pabesueshme, në të cilën ky rast në Mal të Zi tërhoqi shumë vëmendje dhe madje edhe mbështetje të jashtëzakonshme nga mediat. Në veçanti, Vijesti ka shkruar më së shumti për të. Gjatë dorëzimit të secilës padi në gjykatë, gjithashtu i informonim mediat për këtë dhe Vijesti gjithmonë publikonte një tekst me një foto të asaj viktime dhe historinë e saj të jetës – si erdhi në Mal të Zi, çka ndodhi, çka kërkonte padia... Në këtë mënyrë, ata kanë ndihmuar që shumë njerëz të mësojnë për këtë dhe të ndihen keq, të rreshtohen në solidaritet me viktimat.

Na ndodhi një herë, kur po blinim gazetë në një kiosk, shitësja e njohu Draganin dhe i tha: "Nuk ka nevojë të paguani për gazetën, e keni dhuratë. Është dhuratë, që ju po i përfaqësoni këta njerëz të përvuajtur...". Ky është Mali i Zi. Gjatë katër viteve që zgjatën këto procedura, i prita të gjitha ato familje të të dëbuarve, të gjithë ata që erdhën për të dëshmuar para gjykatës në Mal të Zi për atë që u ndodhi dhe për atë që e kaluan.

Pothuajse të gjithë ata po vinin në Mal të Zi për herë të parë që nga ai krim. Dhe unë isha plotësisht e vetëdijshme për peshën e kësaj. Dhe përmes kësaj, edhe të përgjegjësisë sime. Ata u përfaqësuan nga Dragani dhe Radomiri, babai i tij, avokatë,

por unë i prisja, i kaloja mbrëmjet me ta para seancave gjyqësore dhe bisedoja me secilin prej atyre që vinin. Gjithsej ishin 200 njerëz, i takova pothuajse të gjithë që erdhën. Kam dëgjuar histori shumë të rënda, të gjitha përvojat e tyre në lidhje me vuajtjet që përjetuan në Mal të Zi, dhe në arrati pas kësaj, por edhe histori të paimagjinueshme për jetesën nën rrethim në Sarajevë, për ikjen nga gjenocidi në Srebrenicë… Pra, kam dëgjuar kaq shumë rrëfime origjinale për vuajtjet njerëzore, kam mësuar aq shumë për vuajtjet që u janë shkaktuar nga policia malazeze, për atë vendim të paligjshëm, të gabuar, të pamatur për t'i arrestuar baballarët, vëllezërit, djemtë e tyre pa asnjë bazë dhe për t'ua dorëzuar armiqve të tyre që kryesisht i vranë, natyrisht.

Nuk i incizova ato biseda, dhe më vjen keq që nuk i shkrova të paktën… Nuk ishte koha për ta bërë këtë. Ata erdhën për të dëshmuar në gjykatë, unë i prisja dhe i çoja në darkë, për t'u njohur me njëri-tjetrin, për të krijuar një farë besimi në një atmosferë jashtëzakonisht joformale, për t'i siguruar, për t'u thënë se si do të dukej i gjithë procesi në gjykatë e kështu me radhë. Po ta ndizja ndonjë mikrofon si ky, mendoj se do të krijonte pengesë për ta. Në atë kohë, qëllimi nuk ishte dokumentimi i historive të jetës, megjithatë të gjitha dëshmitë e tyre u paraqitën para gjykatës.

Qëllimi ishte përfaqësimi i tyre në procese gjyqësore. Tani, ndoshta për qëllime përfaqësimi, nuk ishte e nevojshme të flisnim me orë të tëra dhe të rrinim zgjuar gjithë natën e kështu me radhë, por kjo ishte diçka shumë njerëzore. Së pari, isha e vetëdijshme për nervozën dhe frikën e tyre të madhe. E keni parasysh, familjet e para që erdhën flinin në divanin tonë, në dhomën tonë. Ata kishin frikë. Për herë të parë pas luftës po vinin në Mal të Zi, në një vend që ua rrëmbeu burrat, baballarët, vëllezërit, fëmijët, këta njerëz kishin frikë.

Megjithëse e dinin se situata nuk ishte më e njëjtë, prapëseprapë Đukanovići ishte në pushtet edhe në vitin 1992 edhe kur ata u kthyen në vitin 2005, në vitin 2006... Ata kaluan nëpër ferr të vërtetë. Gjëja më e keqe që mund t'i ndodhë dikujt atyre u ndodhi këtu. Këtu i humbën më të dashurit e tyre. Dhe u ndjenë shumë keq, ishin nervozë, të frikësuar.

Pra, së pari duhej ta kapërcenim këtë, të përpiqeshim t'i bënim të ndiheshin sa më rehat në mesin e njerëzve të tyre, dhe pastaj ta kompletonim atë histori që ishte e nevojshme për gjykim. T'u shpjegojmë se ku do të jenë, çka do të ndodhë, si do të ndodhë, si do të duket gjithçka. Që të jenë të përgatitur dhe të mos zihen në befasi. Çka do t'i pyesin, çka pritet t'u thonë…

Çdo padi, natyrisht, përmbante fakte themelore se çka i ndodhur secilit dhe si, dhe çdo çështje, të cilën kompania ligjore e ka ende sot në arkivat e saj, gjithashtu përmban deklarata që ata i kanë dhënë para gjykatës. Pra, këto deklarata të tyre janë të dokumentuara në formën e procesverbaleve gjyqësore, jo saktësisht si rrëfime letrare, e kam fjalën të shkruara në gjuhë letërsie. Në fakt ato janë diktime të gjyqtarit për atë që thonë, për fat të keq. Këto janë fjali disi teknike, por kaq është – ajo pjesë e historisë mbetet për çdo familje.

Gazetari dhe publicisti Šeki Radončić botoi librin "Liria fatale" pikërisht me kohë, në vitin 2005. . Ai e bëri këtë që në fillim të këtyre gjykimeve. Këtë libër ia dorëzoi edhe Prokurores së Lartë të Shtetit të asaj kohe, Vesna Medenicas. Ai tha: "Ja ku e keni materialin për aktakuzë." Ai kishte absolutisht të drejtë, vetëm se ata nuk ishin të

interesuar, as nuk ishin ende nën presion të mjaftueshëm për t'u marrë me këtë në asnjë mënyrë. Ai i përshkroi këto histori jetësore të një numri të dëbuarish në mënyrë shumë të bukur. Aksioni për të Drejtat e Njeriut botoi kohët e fundit një libër me këto deklarata të dëshmitarëve në rastet e krimeve të luftës dhe një kapitull i referohet dëbimit. Pra, ne shtuam edhe disa nga ato dëshmi dhe tani ato mund të lexohen. Libri ynë përmban edhe dëshmi të dhëna para gjykatës nga zyratët e policisë që vetë i liruan pesë refugjatë. Këta janë shembuj të njerëzisë. Nuk janë të gjithë vrasës.

Dhe ka edhe histori të përmbledhura në aktgjykim. Vendimet janë publikuar nga Qendra për Edukim Qytetar. Pra, përmes tregimeve me këta njerëz, mësova shumë për luftën në Bosnjë dhe Hercegovinë. Dhe për jetën në Sarajevë nën rrethim, dhe për Srebrenicën dhe për atë se si dukej ai marshim i vdekjes në pyje kur po iknin nga ushtria e Ratko Mladićit. Pra, për herë të parë përmes rrëfimeve të tyre, në fakt mësova shumë për atë luftë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Ishte kjo përvojë që në të vërtetë vendosi që unë do të vazhdoja të ndiqja drejtësinë tranzicionale.

Nuk është rastësi pse e bëjmë këtë. Ne dimë më shumë se kushdo tjetër për këtë. Ndjeva obligim nga ajo që mësova. Nuk mund t'i harroja të gjitha rrëfimet e atyre viktimave. Do të ishte e pamoralshme t'i harroja. Do të ishte e pamoralshme në të kuptuarit tim të moralit dhe njëfarë përgjegjësie njerëzore. Nuk mund të jetoja pa vazhduar të luftoja që ajo të mos ndodhte më, dhe që ata, së bashku, të përjetonin një ndjenjë të vërtetë drejtësie.

Pra, qëllimi nuk është vetëm që shteti t'ju paguajë kompensim, të cilin arritëm ta bënim, por edhe që ai komunitet ta pranonte se ajo që u bë ishte e tmerrshme, se dhembi, se ishte padrejtësi e rëndë dhe e madhe. Dhe se shoqëria si e tillë angazhohet të bëjë gjithçka që kjo të mos i ndodhë askujt më. E kjo do të thotë të ndërtohet një monument, dhe të shënohet një ditë përkujtimi, dhe se shteti në të vërtetë të ketë njohuri për të. Dhe ta përfshijë në libra, në arsim, dhe vetëm atëherë mund të relaksohemi. Duke ditur se sistemi vazhdon ta ruajë kujtesën dhe të punojë me të, që gjëra të tilla të mos ndodhin më kurrë.

Por si u futa unë në gjithë këtë? Sigurisht, sfondi më ndihmoi, por në të vërtetë ky rast i dëbimit të refugjatëve dhe gjithçkaje përreth tij, fakti që të gjitha tregimet e tyre gjetën vend tek unë, më bëri të vazhdoj të merrem me këtë. Dhetaj pas katër vitesh gjykimi së bashku me presionin ndërkombëtar në të cilin kam kontribuar, në të cilin kam punuar si aktiviste, duke iu drejtuar të gjitha ambasadave të mundshme, duke iu drejtuar Këshillit të Evropës, kam ditur të përfitoj nga mundësia kur Mali i Zi duhej të pranohej në Këshillin e Evropës. Për të ndikuar te këta njerëz, për të shkruar... Te këta njerëz nuk arrita të ndikoj se gjyshin e kam President i Këshillit të Evropës, por sepse gjithmonë është e mundur, sepse gjithmonë ka mënyra. U shkruani njerëzve, puna e të cilëve është ta analizojnë Malin e Zi, ne u shkruam atyre, u thamë, "Shikoni këtë rast, duhet të ndërhyni ..." dhe kështu u tha vërtet.

Pra, ky rast dhe dëmshpërblimet për viktimat e këtij rasti ishte një nga kushtet e shumta që Mali i Zi kishte për t'iu bashkuar Këshillit të Evropës. Dhe kështu pra, ishte ky një aktivizëm i madh që përfundimisht e çoi shtetin të binte dakord për një zgjidhje në procedurat civile, të pranonte përgjegjësinë për atë krim dhe të paguante kompensim. Ky kompensim u ka ndihmuar shumë prej tyre. Si rregull, kompensim për dëmet morën gratë, bashkëshortet të cilat mbetën të veja me fëmijë të vegjël. Nënat, që mbetën pa

djem për t'i mbështetur në pleqëri. Motrat, të cilat mbetën pa vëllezër nga të cilët vareshin; si rregull, ata ishin vëllezër më të mëdhenj që i mbështesnin në jetë dhe do të vazhdonin të ishin të rëndësishëm për to. Dhe fëmijët, natyrisht, fëmijët që kanë humbur një prind.

Pra, kjo nënkuptonte diçka për ta. E di se disa gra arritën të pavarësohen dhe njëra – për çka jam shumë e kënaqur – themeloi kompaninë e saj të kontabilitetit. Deri atëherë, ajo punonte për një burrë që e shantazhonte, vuante, dhe mbeti vetëm me tri vajza. Ajo është shembull i mirë për mua se sa e rëndësishme ishte ta përmirësoje vërtet jetën e dikujt. Nuk ishin shumë para siç lexojmë se dikush nganjëherë merr në Amerikë për kompensim, dhe ua ndryshon jetën brezave, por 25-30 mijë euro që morën individualisht do të thoshte të bënin zgjidhje për strehim ose të kishin njëfarë lehtësimi, njëfarë pavarësie... E gjithë kjo nuk mund të krahasohet, natyrisht, me jetën e humbur. Dhe me gjithë atë që nënkupton jeta...

Dhe pastaj, përmes punës me këta njerëz, kishte edhe të mbijetuar. Jo shumë, por rreth dhjetë, dymbëdhjetë të mbijetuar që unë i takova. Eh, kjo është vetëm një përvojë që është gdhendur në kujtesën time. Një djalë e përshkroi më së miri, duke treguar, "Babai që pas kësaj është si një vazo e thyer, të cilën të gjithë u përpoqëm ta merrnim dhe ta ngjisnim." Këta janë njerëz që janë të ngarkuar me trauma, me ndjenja faji. Si ka mundësi që mbijetuan, e nuk mbijetuan të tjerë nëpër kampe... A mund të kishin bërë më shumë edhe për të tjerët, nuk e di. Traumat e tyre janë me të vërtetë, me të vërtetë të vështira. Mbaj mend sa e lumtur isha që i takova, që takova dikë që arriti të mbetej gjallë. Megjithatë, gjeta njerëz që nuk ishin të lumtur për shkak të kësaj. Ata janë shëruar disi, por kanë pasoja për tërë jetën, pasoja të cilat të gjithë ne, edhe me qëllimet më të mira, nuk mund t'i kuptojmë.

Pas kësaj zgjidhjeje, viktimat dhe familjet e viktimave morën këtë formë dëmshpërblimi. Megjithatë, duke i përfaqësuar ata, mësova shumë për të drejtën ndërkombëtare humanitare. Mësova për një dokument që më pas e përktheva dhe përhapa njohuri për të kudo në këto konferenca, dhe në REKOM[7], gjithandej. Është një dokument i miratuar nga Kombet e Bashkuara që shpjegon dëmshpërblimet.

Quhet "Parimet e përgjithshme të së drejtës për ilaç dhe dëmshpërblim për viktimat e shkeljeve të rënda të të drejtave të njeriut dhe shkeljeve të rënda të së drejtës ndërkombëtare humanitare". Dhe shpjegon se dëmshpërblimet nënkuptojnë drejtësi penale, dhe kompensim, por edhe masa të ndryshme dëmshpërblimi si përmendore, monumente, ditë kujtimi, futjen e njohurive për këto ngjarje në edukimin e brezave të rinj, por edhe në profesione të veçanta, si në polici, ushtri, gjyqësor, prokurori e kështu me radhë. Për të parandaluar që këto tmerre të ndodhin përsëri.
ndjenë shumë keq, ishin nervozë, të frikësuar.

Dhe pastaj vazhdova të avokoja për të gjitha këto në rastin e dëbimit të refugjatëve. Së bashku me kolegët nga Aksioni për të Drejtat e Njeriut, Anima nga Kotor - Qendra për Edukimin e Grave dhe Paqes dhe nga Qendra për Edukimin Qytetar. Dhe kështu, me mbështetjen e tyre, të gjithë kemi arritur në pikën që pas katërmbëdhjetë vjetësh të mbledhjeve të vazhdueshme çdo 25 maj, para Qendrës së Sigurisë në Herceg Novi, nga ku këta njerëz iu dorëzuan armiqve të tyre, ku u panë të gjallë për herë të fundit.

7 REKOM është akronim për Komisionin Rajonal të Gjetjes së Fakteve për Krimet e Luftës dhe Shkeljet e Tjera të Rënda të të Drejtave të Njeriut të kryera në territorin e ish-RSFJ-së nga 1 janari, 1991, deri më 31 dhjetor 2001.

Këtu e përkujtojmë atë krim çdo 25 maj. Dhe pas gjithë këtyre viteve të shënimit të përvjetorit të atij krimi, vitin e kaluar, për herë të parë, erdhën dhe morën pjesë katër ministra nga qeveria e Malit të Zi.

Dhe kjo ishte e para, më duhet të them befasi me të vërtetë, me të vërtetë e bukur që përjetuam sepse nuk besonim se do të ndodhte ndonjëherë. Ishte qeveri e re, do të thotë ndryshim.

Dhe me të vërtetë nuk mund të harroj, isha në makinë, po vozisja për në Herceg Novi, mbaj mend se se dëgjova se disa ministra do të vinin vërtet. Dhe pastaj kolegu më tha: "Jo, jo, jo, do të vijë edhe një tjetër!" Dhe kur erdha para ndërtesës së policisë, pashë se erdhi edhe ministri i katërt. U befasova vërtet. Erdhi edhe drejtori i policisë, i cili pastaj kërkoi falje historike në emër të policisë malazeze. Kjo ishte shumë, shumë e trishtë sepse aty ishte edhe Sejda Krdžalija, nëna e të ndjerit Sanin, një muzikant i ri me fizarmonikë që kishte ardhur në Herceg Novi, duke menduar se do të mund të fitonte diçka atje me atë fizarmonikë të tij, por ai u arrestua dhe u dëbua.

Ai u vra në kampin Foča në KZP në Foča. Aty u pa për herë të fundit në dritare. Dhe nëna dhe motra e tij tani ishin përsëri këtu, në Herceg Novi. Hera e fundit që familje të tjera ishin atje ishte dymbëdhjetë apo trembëdhjetë vjet më parë. Por ne nuk donim më t'i thërrisnim, t'i shqetësonim që të rrinin me ne pa asnjë rezultat. Sejda donte të vinte, dhe erdhi. Kur dëgjuam se do të vinte edhe një ministër, kishte kuptim, supozuam se ministri do të na drejtohej. Pastaj aty ishte Sejda, vajza e saj dhe përfaqësuesit e familjes Bajrović që jetonin në Mal të Zi dhe gjithashtu një kushëri i Suad Topalovićit, i cili kishte një vëlla në Herceg Novi, dhe ai u dëbua dhe u vra.

Pra, kishte përfaqësues të tre familjeve kur Ministri i Brendshëm shprehu kërkimfaljen e tij. Kjo ishte me të vërtetë shumë, shumë, shumë prekëse. Sejda gjithashtu përjetoi në Herceg Novi që iu afruan njerëz që erdhën në këtë tubim përkujtimor për të shprehur keqardhje, kjo kishte shumë domethënie për të.

Disa ditë më parë shkuam në një takim me presidentin e ri të shtetit në lidhje me këtë çështje sepse, megjithëse e ftuam, ai nuk iu përgjigj ftesës për të ardhur në memorial. I sugjerova ta ftonte edhe Alenin, djalin e të ndjerit Osman Bajrović, i cili ende jeton në Mal të Zi. Ai tha, "Sigurisht, mirësevjen." Dhe kjo ishte shumë e rëndësishme sepse ajo për të cilën folëm, në fakt treguam faktet, perspektivën ligjore. Megjithatë, mendoj se gjëja kryesore ishte prania e Alenit, i cili humbi babain. Dhe faktikisht, ata janë bashkëmoshatarë, ai dhe Presidenti Milatović. Dhe Aleni e vuri në dukje këtë, dhe më pas presidenti iu kthye dhe i tha, "Si ndodhi, Alen? Sa vjeç ishe ti? Sa vjeç…" Po bënte thjesht pyetje njerëzore.

Aleni tha gjithashtu se ai ishte me motrën e tij, se policët ishin aq të pakujdesshëm sa i lanë fëmijët vetëm, e arrestuan babain e tyre dhe i lanë vetëm në tarracë në atë shtëpi. Folëm për gjithçka, dhe në fund të bisedës, Presidenti Milatović iu drejtua Alenit dhe i tha, "Në bazë të Kushtetutës së Malit të Zi..." U trondita, çka do të bëjmë tani, çfarë Kushtetute? Thotë ai, "Unë kam autoritetin t'ju kërkoj falje të sinqertë në emër të Malit të Zi për gjithçka që ju dhe familja juaj keni vuajtur." Oh, e ne mendojmë se në aktivizëm dimë se çka duam, parashikojmë gjithçka, e zakonisht nuk e arrijmë, dhe jemi të kënaqur me disa thërrime...

Por këtë vërtet nuk e prisja, as nuk e planifikova, as nuk e parashikova. Pra, kjo ishte një nga ato dhuratat që përjeton papritur, dhe unë do ta mbaj mend këtë gjithë jetën time. Ishte një moment prekës. Dhe më pas lëshuan një deklaratë për shtyp pas atij takimi. Dhe kjo ishte gjëja kryesore. Ne kishim folur se si mund të bënim shpalljen e Ditës së Përkujtimit, për monumentet e kështu me radhë, për gjëra të ndryshme të tjera, por zyra e Presidentit vendosi që kjo falje do të ishte me të vërtetë lajmi i fundit nga ai takim, diçka vërtetë e merituar.

Po pra, kjo ndodhi. Shpresoj që tani me të vërtetë po i afrohemi shënimit të një dite të përkujtimit dhe një monumenti, dhe dua që ky Mali i Zi i vogël i cili me të vërtetë, kur e shikoni, është vetëm me 620 mijë njerëz, dua të them, është vend i vogël, por me të vërtetë mund të bëhet shembull i shkëlqyeshëm i ballafaqimit me të kaluarën, sepse ky rreshtim që ndodhi me 200 viktima është një shembull unik në rajon. Dhe mendoj se duhet të theksohet dhe të përdoret; vendet e tjera duhet ta ndjekin këtë shembull.

Ekziston edhe një anë e errët e kësaj, procedimi penal, i cili çoi në lirimin e të gjithë të pandehurve, bazuar në një keqinterpretim të së drejtës ndërkombëtare se askush nuk mund të mbajë përgjegjësi për atë krim lufte sepse Mali i Zi nuk ishte zyrtarisht në luftë në Bosnjë dhe Hercegovinë. Kështu doli. Dhe kjo është në thelb në kundërshtim me postulatet themelore të asaj të drejte ndërkombëtare, por kështu shkoi, për fat të keq. Megjithatë, me këto forma të tjera të dëmshpërblimeve, mendoj se Mali i Zi tashmë ka dhënë disa shembuj tashmë shumë të mirë që nëse të gjithë do t'i ndiqnin në rajon, mendoj se do të kishim vërtet pak arsye për t'u shqetësuar se dikush do t'i përsëriste krimet.

REKOM

Të gjithë e dimë se kush e inicioi REKOM-in. Nataša Kandić nga Fondi për të Drejtën Humanitare, Vesna Teršelič nga Documenta dhe Mirsad Tokrača nga Qendra e Dokumentimit nga Sarajeva. Ata dolën me idenë se vetëm këto përpjekje të përbashkëta, së pari, mund t'i dokumentonin viktimat e luftës. Gjë që mendoj se është me të vërtetë një nga prioritetet sepse çdo shtet në të vërtetë po ikën nga pranimi, jo vetëm të numrit të viktimave civile, por edhe të humbjeve njerëzore në përgjithësi.

Kështu, ata mohojnë dhe nuk duan që këto humbje njerëzore, veçanërisht humbjet ushtarake, të numërohen me saktësi. Dhe pastaj gjëja e dytë është kjo përpjekje megalomane, veçanërisht për Bosnjën dhe Hercegovinën, domethënë territoret ku u zhvilluan luftërat, si dhe Kroacia dhe Kosova. Pra, këto janë vendet që kishin përqindjen më të madhe të viktimave territorialisht. Serbia dhe Mali i Zi kishin viktima nga luftimet në territore të tjera, dhe viktimat që ndodhën në territorin e Malit të Zi janë me të vërtetë viktima sporadike, kishte shumë pak prej tyre. Shumica e tyre janë në Bosnjë, në Kroaci dhe në Kosovë. Dhe ky është një nga shtytësit.

Së dyti, natyrisht, është themelimi i një komisioni të së vërtetës… Është investuar shumë kohë në diskutime se si duhet të duket një komision i tillë, i ngarkuar për të prodhuar një narrativë të përbashkët historike për faktet për luftërat e viteve 1990 nga Sllovenia në Kosovë. Unë kam qenë në grupin punues për hartimin e rregullave të funksionimit të atij komisioni, gjegjësisht statutit të këtij komisioni. Dhe e kemi shkruar, Bogdan Ivanišević, avokat nga Beogradi, Marijana Toma, Pavleković, historian nga Rijeka, mendoj, ose Pula, një avokat nga Kosova, Teki Bokshi, një zotëri në moshë, i ëmbël.

Pra, ne ishim në atë komision, dhe punuam shumë. E di se isha shtatzënë me Vidën në atë kohë. Kur lindi Vida në vitin 2014, Marijana Toma mban mend se edhe nga spitali kur linda, iu përgjigja disa pyetjeve që mbetën të pazgjidhura për ne. Dhe kemi punuar mirë në të, kemi shqyrtuar statutet e dhjetëra komisioneve të së vërtetës dhe pajtimit që ekzistonin nga Guatemala, e deri tek Argjentina e Mauriciusi. E mira është se statuti që propozuam u miratua nga Kuvendi i REKOM-it, pra nga koalicioni për REKOM-in, dhe kur shkoi te presidentët e shteteve, eci mjaft mirë. Dhe ata sugjeruan disa korrigjime shumë të vogla. Nuk ishte asgjë domethënëse, asgjë e papranueshme.

Dhe megjithëse shoqëria civile në të gjithë territorin e ish-Jugosllavisë mbështeti krijimin e një komisioni të tillë, për fat të keq, të gjitha shtetet nuk e pranuan. Kishte gjithashtu ndryshim të qeverisë në Kroaci, në Bosnjë dhe Hercegovinë në nivelin e presidencës nuk kishte pëlqim, dhe kështu me radhë, pastaj edhe në Serbi. U humb një moment që mund ta kishim kapur, por, sidoqoftë, rrethanat politike nuk funksionuan dhe ai komision nuk u vu në jetë. Kjo nuk do të thotë se është tepër vonë. Mbetet për ca gjenerata të ardhshme. Pra, ne i kemi shkruar këto rregulla të angazhimit për atë se si mund të duken dhe çka duhet të bëjë REKOM-i. Për shkak se gjykimet nuk do të jenë në gjendje të realizohen për të gjitha krimet, nuk do të mund t'i mbulojnë. Thjesht, shumë kriminelë kanë vdekur. Rregullat e së drejtës penale janë të tilla që ju nuk mund ta gjykoni një person të vdekur.

Pastaj, vdesin dëshmitarët, zhduken provat, dhe problemi më i madh është se vdesin autorët e krimeve. Megjithatë, kjo nuk do të thotë se krimi nuk mund të dokumentohet në ndonjë mënyrë tjetër dhe të ruhet dëshmia për të. Se kjo ka ndodhur si një lloj shembulli negativ, si një nderim për viktimën. Njerëzimi duhet të mësojë diçka nga këto ngjarje. Ka shumë arsye për t'i dokumentuar të gjitha këto në formën e një raporti të përbashkët që më pas do të pranohej nga të gjitha vendet si një produkt i paanshëm multietnik që nuk është rezultat i një lloj pune shtetërore, individuale në një mjedis të mbyllur, por i një komisioni shumëkombësh që do të pranonte fakte të bazuara në prova që tashmë do të ishin në dispozicion të atij komisioni, që do të mblidhte, të rishikonte, e kështu me radhë. Sigurisht, aty ku nuk ka prova elementare për diçka, asgjë nuk do të përmendej. Ai duhet të jetë raport serioz. Dhe mendoj se do të ishte shumë shëruese për këtë hapësirë, dhe ishte ide fisnike. Por tash, për fat të keq, rrethanat politike janë ashtu siç janë, dhe ky komision nuk mund të krijohet, kështu që shpresojmë për më të mirën në të ardhmen.

Unë jetoj me bashkëshortin tim; jetoj me fëmijët e mi. Ata tash po udhëtojnë për të studiuar jashtë vendit, kthehen nga studimet, nuk e di se ku do të jetojnë përfundimisht dhe si. Por ne i edukojmë asisoji që ata të mund të ndihen me të vërtetë rehat kudo, të jenë qytetarë të botës. Të mos ikin nga njerëzit e tjerë që nuk e flasin të njëjtën gjuhë ose kanë zakone të ndryshme ose duken ndryshe. Kështu i kemi rritur që nga fillimi.

Në Podgoricë, kur po rriteshin dy të mëdhenjtë, isha në panik sepse nuk kishte shumë fëmijë që ishin, për shembull, me ngjyrë tjetër të lëkurës. Dhe pastaj pashë, më kujtohet, binjake, vajza të një diplomati nga Afrika. Ata erdhën në një qendër sportive. Vazhdimisht rrija atje me fëmijët e mi në pritje të ardhjes së tyre për të luajtur me ta sepse isha e tmerruar se nuk do të mësoheshin me diversitetin. Ja pra, kjo është e vetmja gjë që mund të dua më shumë për Malin e Zi. Të jemi më të ekspozuar dhe t'u japim fëmijëve më shumë mundësi për të udhëtuar, thjesht për t'u njohur me njëritjetrin. Dhe sot gjendja është e tillë që së pari duhet të sigurohemi që ata të njihen me njerëz nga ish-Jugosllavia me të cilët janë ende më të afërt, janë fqinjë, të shoqërohen më shumë me fqinjët, dhe pastaj me të gjithë të tjerët. Kaq.

Nuk fola për atë se si më kanë lindur fëmijët dhe si kanë qenë pjesë e përvojave tona. Më i madhi, Kozma, lindi kur Dragani po e përfaqësonte qytetaren moldave S.Č në atë rast të famshëm të trafikimit seksual. Në një pikë, nuk kishte shumë rëndësi për ne sepse ajo dëshmoi për ngjarjet në të cilat ishin të përfshirë përfaqësuesit më të lartë të autoriteteve. Dhe më pas e dërguam në Slloveni për disa muaj për të qëndruar me gjyshërit e tij. Kur lindi Ema, unë isha duke e mbaruar punën në Qendrën për Trajnimin e Gjyqtarëve dhe po përgatisnim paditë e para të dëbimit. Nuk mora pushim të gjatë lehonie, kështu ndodhi e gjitha.

Dhe më pas Mariana Toma ma kujtoi atë ngjarje nga materniteti. Kam filluar t'i harroj gjërat...

Kundër harresës

Ajna Jusić, tani tridhjetë vjeçe, është një fëmijë i mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës. Kjo grua e re e guximshme u rrit me një stigmë të cilën nuk mund ta kuptonte derisa u përball me të vërtetën në moshën katërmbëdhjetë vjeçare. Që nga ai moment, vendosmëria e saj për të luftuar për të drejtat e saja, por edhe të drejtat e tjerë të "fëmijëve të harruar të luftës", nuk pushoi. Në vitin 2018, së bashku me Alen Muhiqin, ajo themeloi organizatën Fëmijët e Harruar të Luftës, e cila bën gjithçka për të siguruar që edhe fëmijët e tjerë të marrin mbështetjen dhe mundësinë për t'i mbrojtur të drejtat e tyre. Dhe kjo nuk është e lehtë.

Vendosmërinë të cilën e posedon Ajna nuk është e rastësishme. Ajo padyshim e trashëgoi atë nga nëna e saj, e cila e jeton jetën me kokën lartë, në një shoqëri patriarkale të gatshme për të gjykuar. Siç e thekson ajo vetë, përkrahje të madhe ka marrë edhe nga Nusreti, njerku i saj. Pa ndihmën e tyre, ajo nuk do të kishte fuqi të tregonte publikisht historinë e saj dhe të ndiqte rrugën që mori, të mblidhte forcat për t'u përballuar me traumën e saj, por edhe më shumë se kaq, për t'iu ndihmuar të tjerëve ta bëjnë të njëjtën gjë.

Duke theksuar ndihmën që dhanë dhe po japin të mbijetuarat e dhunës seksuale gjatë luftës, duke kuptuar rëndësinë e punës në terren dhe punës në media, si dhe në rrjetet sociale, Ajna Jusiq po përpiqet që përmes Fëmijëve të Harruar të Luftës të luftojë për kushte më të mira në Bosnje dhe Hercegovinë, para së gjithash për të rinjtë, sepse siç e thotë vetë, si një e re po ndihet konfuze. Kjo është historia e saj.

Ajna Jusić

Fëmijëria dhe familja

Unë quhem Ajna Jusić. Do mbushi 29 vite në pesë ditë. Kam lindur më 23 shtator 1993 në Bosnje dhe Hercegovinë, më saktësisht në Zenicë. Unë kam lindur në Spitalin Kantonal ndërsa nëna ime në atë kohë si e mbijetuar e dhunës seksuale gjatë luftës, qëndronte në shtëpinë e sigurt të Medica Zenicës. Me profesion jam infermiere dhe psikologe. Sot jam anëtare aktive dhe kryetare e Shoqatës "Fëmijët e Harruar të Luftës", e cila u themelua në vitin 2016. Kam një qenushe Nani dhe një mace Britni. Kështu, unë kam lindur në Zenicë, jam rritur në Zavidoviqi dhe në vitin 2012 jam zhvendosur në Sarajevë, ku kam mbaruar universitetin, ku sot jetoj dhe punoj.

Epo, përgjithësisht, gjithmonë më pëlqen të them, gjithmonë e ndjej të tillë, që kam pasur një fëmijëri të bukur me prindërit e mi – me nënën dhe njerkun tim dhe me familjen që më rrethonte. Por mund të them se fëmijëria ime disi ishte mjaft e shpejtë - mjaft e shpejtë për të pasur imazhet më të qarta, kujtesën, sepse disi për një fëmijë kaq të vogël ajo ishte shumë, besoj se kishte shumë ndryshime në thelb. Nëna ime, nuk e di saktësisht tani, në vitin 2001 mendoj se u kthye nga Zenica, nga ajo shtëpia e sigurt, u kthye në vendlindjen e saj Zavidoviqi ku fillova shkollën fillore. Në atë periudhë, në shkollën e parë fillore, fëmijëria ishte më e ndërlikuar, të shprehem ashtu, duke qenë se mamaja atë kohë u kthye nga një qytet tjetër. Në moshën 22-vjeçare erdhi me një fëmijë pa burrë, pa shoqërues mashkull, të themi ashtu. Dhe ishte disi tronditëse, diskriminuese dhe paragjykuese, si ndaj saj ashtu edhe ndaj meje. Besoj se ishte shumë, shumë më e vështirë për të, veçanërisht rikthimi. Dhuna e mbijetuar, ritraumatizimi, integrimi, vet përfshirja e saj nuk e di sa mirë shkoi. Ajo që ndoshta ishte fatkeqësi tjetër në gjithë këtë, për ne ishte fat, por është fatkeqësi që mamaja punonte në një restorant, pas kthimit punonte kamariere. Dhe disi, po ju them, 22 vjeçe, kameriere, ka një fëmijë, nuk ka burrë, disi nuk ishte pamje që i pëlqen të shohë shoqëria. Shumë shpejt pas ca kohësh, ca vite që kalova në fshatin e saj të lindjes, nëna ime takoi babanë tim, njerkun tim. Unë e ndjej atë si babën tim, disi biologjia në këtë është krejtësisht e parëndësishme për mua. Ai është me të vërtetë engjëlli im, unë e quaj gjithmonë engjëlli im. Më pas shumë shpejt u shpërngulëm në një fshat tjetër, në fshatin e tij, kur u martua nëna ime. Pastaj ndryshova përsëri shkollën. Në atë periudhë të shkollës fillore, për shkak të problemeve, si të them, të caktuara apo përsëri të njëjtave probleme brenda komunitetit të vogël - komunitet i fshatit, mospranimit tim dhe të nënës sime, mospranimit tim në shkollë, na u dha mundësia duke iu falënderuar Nusretit - Nusret quhet babai im, që pikërisht kur të bëhet e vështirë, kur më nuk mund të durohet, të shkojmë dhe të jetojmë diku tjetër. Për disa muaj kam jetuar te një teze në një fshat tjetër, pastaj disa muaj kaluam në Kupres. Disi, gjithmonë në bazë të kësaj e kujtoj fëmijërinë time. Sa herë që vinte puna ngushtë, në kuptimin shoqërisë dhe raportit të shoqërisë me mua, raportit të shoqërisë me nënën time, ajo zgjidhte opsionin që të më dërgonte diku për pak kohë dhe pastaj të kthehesha përsëri. Kështu, mendoj se kjo është arsyeja e mungesës së kujtesës sime. Më kujtohet Zavidoviqi, vendlindja e nënës sime, por në njëfarë mënyre nëse e shikojmë përmes prizmit të identitetit tim si një fëmijë i lindur nga një akt dhune seksuale gjatë luftës. Mund të them se vulosëse ishin skenat me nënën time kur ajo ma fshihte fytyrën derisa

lëviznim nëpër qytet dhe ecnim, që sot kur flas me të, këtë e bënte sepse kryerësit dhe familjet e tyre ishin gjithashtu në të njëjtin qytet, dhe për të ishte e rëndësishme që të ma fshihte fytyrën sa më shumë që të mundej dhe disi ndoshta ishte mënyra e saj për të më ruajtur. Përgjithësisht përmes shkollës, nuk ka shumë për të thënë këtu. Unë nuk isha e diskriminuar në shkollë sepse kisha lindur si pasojë e përdhunimit në kohë të luftës, sepse atëherë nuk e dija as unë e nuk e dinin as shokët e mi të klasës. Me default[8], nga shoqëria isha e diskriminuar si kopile, fëmijë pa baba, fëmijë e kamerieres, fëmijë e një nënë vetushqyese. Ishim jashtë kuadrit të të gjitha standardeve dhe kjo ishte thjesht rritje e shënjuar, megjithëse nuk mund të them që nuk ishte e bukur, sepse kaloja edhe momente të bukura. Luaja futboll me djem, kryesisht luaja futboll me djem. Disi i kisha këto aktivitete normale; shkoj në verime; shkoja në xhami si të gjithë fëmijët që shkonin në xhami, në mejtef në fakt; në ekskursione. Nga ana e nënës sime, familja është e madhe – të gjitha motrat e nënës sime kanë nga katër, pesë, shtatë fëmijë – jemi një familje relativisht e madhe, kështu që pushimet i kaloja në atë lloj ambienti fëmijësh. Mami dhe Nusreti, disi ata të dy si çift kanë prirje drejt maleve dhe lumenjve, kështu që kisha rastin t'i vizitoja edhe ato gjëra. Por këto janë të gjitha fragmente dhe e gjitha zgjati për rreth tetë vjet para se të zhvendosesha e vetme në, ose para se prindërit e mi të më zhvendosnin vetëm në Zenicë përsëri në shkollën time të mesme, dhe aty veçse filloi Perëndimi im i Egër.

Kur erdha në Zenicë, nuk i kisha mbushur ende 14 vjet. Pra isha në vitin e parë të shkollës së mesme të mjekësisë. Ajo çfarë mbaj mend, për shembull, si e mbaj mend ndryshimin e shkollës, kur erdha në fshatin ku u martua nëna ime, atje ishte mësuesja Fikreta dhe mamaja u miqësua me të. Dhe në një farë mënyre këtë e bëri mami edhe në shkollë të mesme, unë e quaj këtë kapaku i artë i nënës sime. Ajo në një farë mënyre më siguroi kushtet me aq sa mundi që unë të jem rehat në çdo ambient. Dhe disi, starting points[9] të saj për këtë lloj sigurimi ishin mësueset. Kështu që, kur u transferova në këtë shkollën tjetër, mësuesja ishte Fikreta, e cila kishte një raport me nënën. Besoj se ajo e dinte historinë time dhe të nënës dhe e mbaj mend atë shkollë të dytë kryesisht për shkak të saj. E më pastaj edhe për shkak të mësuesit të edukimit fetar, i cili ishte kujdestari im i klasës, me të cilin nëna po ashtu kishte raport kualitativ, gjë që këtë ma tregojnë të gjitha problemet e mëdha që i kisha në shkollë, qoftë rrahjet, grindjet, kjo apo ajo, nëse ishte ndonjë lloj ngacmimi nga shoqëria, pikërisht si fëmijë e ndjen në radhë të parë se ndoshta je preferuari i një profesori, por kur rritesh e kupton se këta profesorë kishin për detyrë të të ruanin për shkak të kësaj historie, sepse nëna i kishte siguruar kushtet. Në mënyrë identike me default, në ditën e parë ajo më regjistroi në shkollë. Unë deri atëherë nuk e kisha parë certifikatën time të lindjes deri në moshën pesëmbëdhjetë apo gjashtëmbëdhjetë vjeçe. Ajo e mbante atë dokumentacion. Ajo më njoftoi me kujdestaren e klasës. Dhe disi, vite më vonë, ishte e qartë se kujdestarja e klasës qysh në fillim ishte i njoftuar për vështirësitë e mundshme që mund të ndodhnin. Por po them, njëjtë mendoj që pasoja e gjithë kësaj është se edhe sot në të tridhjetat e mia nuk kam asnjë shoqe. Kam vetëm një shok me të cilin kam shkuar në shkollën fillore. Ky është Jasmini im. Ne jemi miq, ja, që nga klasa ime e tretë, e tij e dytë. Dhe ai disi është një shok që qëndroi këtu, dhe disi jemi lidhur sepse edhe ai është zhvendosur në Zenicë, e më vonë në shkollë të mesme të mjekësisë. Dhe të gjithë këta njerëzit e tjerë që kanë qenë aty gjatë gjithë jetës sime,

8 Ang. Ajo që është e dhënë, ajo që merret si e nënkuptueshme. Për ta ruajtur vërtetësinë e deklaratës së Ajna Jusiqit, u vendos që në fjalimin e saj të ruhen anglicizmat, dhe të jepen shpjegime në fusnota në vende që duken të pakuptueshme. (v.r.).

9 Ang. Pikat fillestare.

qoftë në klasë, qoftë të afërm, të afërme të largëta me të cilat kam shkuar në klasë, janë njerëz me të cilët nuk kam asnjë kontakt. Kështu që mund të them se krijimi i miqësive të mia filloi në Sarajevë, sepse ky ishte qyteti i fundit në të cilin erdha. Nuk kam ku të shkoj tjetër në Bosnje, vetëm mund të shkoj në ndonjë shtet tjetër. Por kur vjen në kryeqytet, ajo është, je ku je. Mendoj se këto janë pasojat e disa gjërave, por duke pasur parasysh që sot kam ashtu, jam e kënaqur me jetën time sociale. E lumtur me miqtë e ngushtë që më rrethojnë, sepse disi nuk jam shpesh një person i thjeshtë, trust issue number one[10] gjithmonë qysh nga fillimi, me siguri kjo është diçka që mbetet. Dua të them, nuk ndjej ndonjë dëm. Kam miq. E tash, nëse do të kisha edhe dikë nga fëmijëria kaq e hershme do të ishte mirë por, ju thashë më herët, gjithsesi e kam familjen e madhe – dy klube futbolli gjithsesi me aq sa fëmijë jemi, kështu që është mjaft e plotësuar.

Nëna është një pyetje për të cilën përgjigja mund të ndryshojë disi nga viti në vit. Dua të them, një nënë është gjithmonë nënë, ajo është me të vërtetë shoqja ime më e mirë, disi ajo e ndërtoi marrëdhënien me mua për të qenë shoqja ime më e mirë. Dhe unë e konsideroj atë një grua të fortë dhe të guximshme, edhe pse gjysmën e jetës sime e kalova duke e shikuar dhe nuk kuptoja asgjë se çfarë po bënte, por besoja verbërisht në atë që bënte, çfarëdo që bënte. Sepse, dua të them, unë nuk e dija origjinën time deri në moshën pesëmbëdhjetë vjeçare, pra janë pesëmbëdhjetë vjet jetë që në thelb i korrigjuam në këto pesëmbëdhjetë të tjera. Mungonin shumë informacione gjatë gjithë fëmijërisë. Ndoshta ndonjëherë isha e inatosur me të kur isha e vogël sepse nuk e kisha të qartë. Dhe disi, shoqëria në mënyrë standarde të flet lloj-lloj gjërash, kështu që ti më pas mendon se ndoshta shoqëria ka të drejtë e jo nëna. Por, mendoj se bukuria e saj qëndron pikërisht në faktin se më mësoi se shoqërinë duhet ta vështroj përmes individëve, jo përmes grupeve. Dhe kjo është diçka që më ka mbetur e rrënjosur. Disi, gjithmonë[9] mësimi kyç ka qenë se nëse dikush bën diçka, nuk është fajtor i gjithë grupi të cilit i përket ai person. Kjo nuk kishte kuptim për mua, sepse isha gjithmonë në të njëjtat grupe, me të njëjtët njerëz. Sot mendoj se është edhe më e guximshme, duke pasur parasysh se pasi mësova të vërtetën, të cilën e mësova në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare në Zenicë, po mendoj për procesin e saj të artikulimit më të qartë të mesazhit të saj për mua. Sepse kur kuptova të vërtetën - ok, ishte një përvojë shumë e dhimbshme. Mendimi i parë si fëmijë është gjithmonë nëse ju jeni përkujtues i një gjëje të tillë sepse jeni rezultat i diçkaje të tillë. Ndërsa, nga ana e saj sërish ishte perspektiva se unë nuk do të turpërohesha, ose që nuk do të zemërohesha, se nuk do ta refuzoja, sepse në thelb nuk mund të anashkalosh faktin që jam rritur në një shoqëri që e refuzoi atë. Dhe mendoj se vërtetë në këtë reflektohet forca e saj se si me guxim doli para secilës përgjigjeje se përse kishte heshtur. Dhe disi, kur ajo tha pse kishte heshtur dhe pse kishte pasur frikë nga shoqëria, dhe kur tha se unë në fakt nuk isha një kujtesë për të, por një arsye për të jetuar, për të luftuar, atëherë disi të palosen të gjitha mësimet që more nga nëna. Dhe sot mendoj se ajo është më e guximshmja nga të gjitha. Sepse përsëri mendoj se heshtja dhe ajo vello e heshtjes ndaj dhunës seksuale në luftë është shumë e pranishme. Shumë gra ende janë të heshtura, që do të thotë se shumë familje jetojnë në një zonë të rreme komforti dhe nuk janë pjesë e një problemi të tillë, një traume të tillë. Ndërsa mami nuk e ka më atë zgjedhje, sidomos me paraqitjen time në publik, me punën time publike, fjalën, imazhin dhe punën time. E drejta e saj për privatësi i është hequr absolutisht. Dhe ajo që është e mrekullueshme për gjithçka është se vendimi për paraqitjen time publike është

10 Ang. Fillimisht, problemi me besimin.

marrë me konsensus mes meje, nënës dhe babait tim. Unë nuk do të mund të dilja nëse ata të dy nuk do të ishin dakord. Dhe sado e vështirë të jetë ndonjëherë për të parë efektet e asaj që bëjmë, ose për të parë efektet, nëna ime e sheh këtë në praktikë. Nëse ai ligj ka ardhur tani, çfarë do t'ju mundësojë ai ligj, a do të jetë më e lehtë ekzistenca juaj. Por ajo gjithashtu sheh efektin global se si njerëzit e përshëndesin kur vjen në Sarajevë, kur vjen kudo, dhe mendoj se kjo është e bukur, por është ende e ekspozuar. Kështu, unë mendoj se ajo mbahet me shumë guxim në ekspozimin në të cilin jetojmë, për të cilit kemi rënë dakord vullnetarisht. E sidomos i vjetri - ai po mbahet si burrë i vërtetë. Atë e mbajmë behind the scene[11] gjatë gjithë kohës, por ai në thelb është i përfshirë – pavarësisht se sa është behind the scene, ai është ende njëri nga personazhet kryesore të kësaj historie.

Dua të them, gjithë jetën, prej kur di për veten, kupton që familje do të thotë mami, babi dhe fëmija, pastaj kupton që diçka nuk shkon. E di kur erdhi Nusreti në jetën tonë. Kur erdhi, ai ishte një burrë i panjohur për mua - ashtu, i dashuri i nënës sime dhe gjithçka tjetër. Dhe kur gjithçka po shkonte drejt martesës, ata të dy biseduan me mua. Mami kishte frikë se si do ta pranoja. Ajo martesë - për mua ishte si një as në dhjetëshe. E kuptova si diçka që ja, kjo është ajo, kjo është fotografia tani, shkojmë tutje si mama, babai dhe fëmija, e përkryer. Fatkeqësisht, në praktikë nuk ishte aspak kështu. Thjesht, nuk ka moment në jetë kur nuk e di se diçka nuk është në rregull. Por nëna ime ishte e re. Domethënë, ajo më lindi në moshën njëzet e dy vjeçare. Justifikimet e saja përse babai i nuk është aty ishin me të vërtetë një stand-up komedi. Më kujtohet një herë kur ishim ulur në stacionin në Zavidoviqi në peron duke pritur autobusin për në Hajdaroviqe - ky është fshati ku u martua nëna ime, nuk e di nëse ishim në çarshi, nuk e kam idenë... Ishin disa romë në Zavidoviq, meqenëse ka shumë romë në Zavidoviq, ne rrimë me ta. Edhe unë luaja me ta në park kështu, dhe me një të voglin u rraha unë e ai filloi te me shante, ta bëfsha-ta kthefsha. Dhe të gjithë më njihnin, dikush më tha diçka për babin tim. Dhe e pyes nënën time atëherë në stacion – pashë Zotin nënë, ku është babi, këtë po ma thonë të gjithë? Nëse dikush të pyet, thuaju se je një bebe nga epruveta, pasi askush nuk e di se çfarë është epruveta, askush nuk do të pyesë më tej. Kështu ishte. Pastaj që ai u vra në luftë, duhet të jetë diku. Disi, ajo pyetje shtyhej gjithmonë në mënyra të ndryshme, por po e them përsëri, Nusreti është faktori kryesor këtu. Dua të them, diku nga mosha tetë, nëntë, dhjetë vjeçe, harrova fare se ajo ishte më një pyetje. Nuk e kuptoja mirë se si ndodh ajo, si vijnë fëmijët në botë. Por në njëfarë mënyre, pasi u shfaq Nusreti dhe pasi jetonim në mënyrë të thjeshtë, pyetja për babin ishte shumë më e panevojshme për mua. E vetmja gjë që asnjëherë arriti të zgjidhej brenda meje ishte se përse nuk e thirra kurrë Nusretin baba. Dhe tani pasi u rrita, unë ashtu i bëj lajka, i them ndonjëherë babush, babush, kur më duhet diçka. Po bëj shaka. Por është padyshim një moment që ka mbetur dhe do ta kujtoj gjithmonë – është kur pyeta mamanë, kur e pyeta nëse duhet ta thërrisja kështu tani, e ata më thanë se ishte vendim imi, si të dua unë. Nuno është nuno, nuno flips, smoki nuno flips. Dhe Nuno mbeti, thjesht Nuno. Për dikë baba, për dikë Nuno. Mendoj se çështja e babës më shpesh ndoshta imponohej se sa në një moment do të doja të dija.

11 Ang. Në prapaskenë, në sfond.

Mami më regjistroi në shkollë të mesme. Në fakt, mami dhe Nusreti morën vendimin që unë të shkoja në shkollën e mjekësisë. Unë nuk mendoja për ndonjë shkollë tjetër jashtë qytetit ku jetoja. Më pas ata më sugjeruan shkollën e mjekësisë që ndodhet në Zenicë. Nuk e di nga lindi ideja për shkollën e mjekësisë. Kur shkova atje me ta në shkollën e mjekësisë, për shkak të letrave dhe gjithçkaje në fakt që duhet të dorëzosh, nga certifikata e lindjes, emri i babait, atë, këtë. Thjesht duhet t'i jepni ato të dhëna kur regjistroheni dhe nëna e mori këtë përgjegjësi mbi vete. Më pas, shumë shpejt u bë e qartë për mua pse. Dhe sa i përket psikologjisë - më ka pëlqyer gjithmonë psikologjia, por e kam regjistruar për arsye të gabuara. Mendoja se po ta regjistroja, do të isha në gjendje ta ndihmoja mamanë time, se do të ishte disi e dobishme. Por nga ana tjetër, qysh ditën e parë e mëson se nuk mund të punosh me mamanë kur e kryen psikologjinë. Por padyshim që studimi i psikologjisë është diçka që hapi shumë këndvështrime të mia në atë botëkuptimin shkencor dhe mendoj se është një pjesë e rëndësishme e jetës sime dhe një pjesë e rëndësishme e të menduarit tim sot. Në Zenicë, fillimisht jetova për një kohë në një apartament me këtë zonjë, një praktikë e çuditshme ku gratë e moshuara u jepnin me qira një dhomë nxënëseve. Unë isha aty për një kohë. Dhe pastaj për shkak të ushqimit, gatimit, shoqërimit në përgjithësi, pasi mjaft nga këta njerëz që i njihja nga shkolla dhe që nuk ishin nga Zenica jetonin në konviktin e nxënësve. Më pas prindërit më transferuan në një konvikt të nxënësve sepse ishte më i lirë dhe më i mirë dhe disi më specifik. E doja jetën time në konvikt.

Momenti i realizimit

Është fakt se kur shkova në Zenicë, familja ime e mori vendimin për këtë, për shkak edhe të presionit në fshat dhe presionit në shkollë, ata thjesht menduan se do të isha më i lirë në një qytet më të madh, se do të isha më rehat, se do të mund të bëja një jetë më normale pa më pyetur gjëra të tilla, që kur të shkoj në Zenicë të them unë, nëna ime dhe Nusreti dhe kaq. Megjithatë, për fat të keq, në një shtet patriarkal kjo thjesht nuk është e mundur. Emri i babait ishte një send identifikues në këtë vend derisa ne nuk filluam të punojmë. Kështu që edhe në Zenicë, kërkimi im për të vërtetën filloi në një orë mësimore në shkollë të mjekësisë kur profesori më pyeti para gjithë klasës për emrin e babait tim, dhe kjo ishte sepse në ditarin e nxënësve shkruante Ajna X Jusiq - sepse fillimisht shkon emri, emri i babait, mbiemri. Në rastin tim ishte shkruar një X në mes, sepse emri i babait nuk ishte në certifikatën e lindjes kur më kishin regjistruar. Dhe unë i them se, kam njerkun Nusret dhe kaq, por jo, jo, më pyesin për babanë. Dhe unë u them nuk e di. Pastaj ai më pyeti nëse mamaja ime e dinte. Dhe pastaj mendoj se më shumë ndikoi e qeshura, tallja në klasë se ishte... Më vinte turp nga ajo e qeshur dhe të gjitha këto. Nuk doja që kjo të më ndodhte fare dhe të isha sërish në situatë të tillë, sidomos pasi kisha filluar në mënyrë të duhur. Dhe kjo pastaj më shtyu në kërkimin tim, në fakt, të pavarur, për të gjetur këtë emër. Arsyeja e vetme pse e kërkoja të vërtetën për origjinën është që t'ua them atë emër dhe që të gjithë të lënë rehat, që të mos më shqetësojnë më me këtë. Mirëpo, zbulimi i së vërtetës ishte si një oopsie. Nuk e di, njeriu mund të kishte marrë me mend gjithçka, duke përfshirë epruvetën, babin martir, babin këtë, babin atë, por kjo... Kjo nuk ishte aspak në mendje. Edhe pse e pata parë më herët atë filmin Grbavica dhe e kam ndjerë këtë, por thjesht nuk dëshiron të mendosh se kjo është ajo. Dhe disi, duke u rritur, nuk është sikur ne në Bosnje jemi rritur për të kuptuar se përdhunimi ka ndodhur dhe se ishte e tmerrshme. Dhe këtë gjithmonë e kisha burim të zemërimit tim ndaj shtetit - si ka mundësi që askush nuk më ka shpjeguar se çfarë është kjo? Sepse kur e lexova unë këtë, nuk mundesha, mendja ime nuk mundej... nuk mund ta pranoja kognitivisht, ta tretja, pasi e lexova dëshminë shumë të detajuar të nënës sime, dëshminë e saj në Medica të cilën e kishte dhënë në vitin 1993. Është një ndjenjë e tmerrshme dhe sigurisht pas kësaj nuk do të shkosh heroikisht në shkollë e të thuash eh, por disi do të mbetesh me atë informacion, do të heshtësh. Aq më tepër që kishe një nënë që heshtën për 15 vjet e mami e di gjithmonë më mirë.

Çdo herë e kaloja gjithë këtë sepse dikush tjetër e bënte pyetjen, sepse dikush tjetër donte përgjigje, dhe sepse ishte e rëndësishme për dikë tjetër, sepse nuk ishte e qartë për dikë tjetër. Për mua gjithçka ishte e qartë - unë, mami dhe Nusreti. Por disi nuk funksiononte. Por ja, unë nuk po zemërohem. Këtë e kam zgjidhur në psikoterapi - që nuk duhet të zemërohem. Dhe në fund, kur u rrita, kuptova se as njerëzit që më shtynin në të gjithë ato beteja, nuk kishin asnjë lidhje me atë që po ndodhte, veçanërisht jo shokët e mi të klasës, kolegët e koleget. Askush nuk e ka atë vetëdijen e pasluftës.

Dua të them, duke qenë se përmenda diku origjinën e filmit Grbavica - se ishte një fushatë globale e grave, organizatave të grave, të cilave iu bashkua zonja Jasmila, që në thelb t'u ofrohet grave dhe burrave që u mbijetuan dhunës seksuale gjatë luftës një hapësirë në ligjin për mbrojtje sociale, që të kenë disa të drejta. Nëna ime ishte gjithashtu pjesë e grave në Medica që jepnin dhe bënin intervista. Ajo që është

shumë e qartë për nënën time është historia me fëmijën, sepse unë kam lindur atje në atë shtëpi në Zenicë. Dhe kur doli filmi, në RS ishte i ndaluar, kurse ne fëmijët në shkollat e Federatës ishim të detyruar ta shikonim. Dhe kjo është një ngjarje specifike që më kujtohet vërtet. Në atë kohë u vendosëm në katin e epërm të shtëpisë, pasi kur mami u martua, të gjithë jetonim poshtë - unë, mami, Nusreti, gjyshja dhe gjyshi i ndjerë. Atë vit mami dhe Nusreti e mobiluan katin e sipërm të shtëpisë, ku ne ishim vetëm. Sidoqoftë, kur u nisa, e di që ajo ishte nervoze, se nuk ishte e njëjta përshëndetje, ashtu siç është kur shkoj diku. Por për atë film, ajo është gjëja më e pakëndshme që kam parë ndonjëherë dhe më e pakta që më pëlqen ta kujtoj në jetën time. Përballja ime me të shkuarën fillon nga ajo natë, në atë kinema, nga ai film. Sepse duke e shikuar atë film, ju thjesht e shikoni dhe shihni shumë ngjashmëri me jetën tuaj. Disi specifika të asaj skene, të cilën edhe e përmenda, është kur nëna dhe vajza po hanin në tavolinë, mendoj se po hanin peshk, dhe vajza kishte thonj të gjatë e të pistë në duar dhe nëna menjëherë i kërkoi të ngrihet dhe të shkoj për të rregulluar thonjtë e saj, në mënyrë që të mund të kthehet për të ngrënë. Disi, unë e jetoj atë jetë. Si fëmijë kam jetuar shumë me këtë problem me thonjtë, me duart, me sytë e mi – diçka që po ashtu u përshkua si segment në atë film, sepse nëna ime ka sy të kaltër. Për këtë nuk mund të them se nuk e dua, por nuk më pëlqen ta kujtoj, nuk më pëlqen ta kujtoj atë natë, nuk më pëlqen ta përpunoj shumë tani... Sidomos atë momentin kur ajo largohet, kur është kamariere - nënë në Grbavicë, pastaj kur shkon në punë, pastaj kur ai e godet në bythë, në të pasme, dhe ajo ia thyen shpuzoren për kokë. Në sfond menjëherë e ke idenë që nëna ishte kameriere në të njëjtën periudhë të jetës së saj, dhe më pas e shikon nëse ajo e përjetoi këtë, sepse disi ishte shumë e ngjashme. Dhe pastaj ajo paraqitje e Medica-s. E di që isha në Medica, vetëm se nuk e dija se për çfarë ishte Medica dhe pse ishte aty. Thjesht është shumë, është shumë... unë jam mirënjohëse për filmin si të tillë, sepse disi i solli shumë vendit edhe grave. Besoj se edhe në rrafshin ndërkombëtar, në rendin juridik, ka ndryshuar disa gjëra, por ajo që sot në këtë këndvështrim, në vitin 2023 nuk do ta them kurrë, asnjëherë, se ky është një film për gratë e mbijetuara, kurrë. Është një film për shoqërinë. Gjëja më e trishtueshme është se ne e jetojmë edhe sot këtë Grbavicën, njerëzit janë identikë ose harrestarë. Nuk di më se çfarë është më e vështirë – ky lloj tensioni ndëretnik apo kultura e harresës që ka filluar të mbretërojë aktivisht mes të rinjve. Disi, ndoshta të rinjtë nuk duhet të ngarkohen aq shumë me atë temë lufte, por ata duhet të dinë se çfarë ka ndodhur, jo vetëm të dinë se çfarë ka ndodhur, por të jenë në gjendje të kuptojnë se si të parandalojnë që ajo të mos përsëritet. Por ja, dua të them që Grbavica u shfaq këtë vit në Festivalin e Filmit Rinor, në rrugën Vilson. Unë po e ecja me Nanin, pikërisht në momentin që po fillonte filmi. Unë isha më e shpejtë se qenushi, vetëm për ta mos dëgjuar atë fillimin, sidomos qe mos ta dëgjoj atë pjesën hyrëse të filmit kur janë ato në atë rreth, kur e kanë seancën e tyre, terapinë e këto.

I thashë nënës sime se ishte i gjithi i çuditshëm, i vështirë dhe i paqartë për mua dhe sepse ishte shumë i ngjashëm me ne. Nuk më kujtohet saktësisht se çfarë më tha konkretisht në atë moment, por sigurisht ishte diçka për ta shtypur sa më shpejt ose për të kërkuar justifikimin më të mirë, ose që ndoshta Nusreti më premtoi se do të më blinte një biçikletë të re. Po ma përmende biçikletën, më bleve përgjithmonë. Më pas, ai film nuk u diskutua më, derisa unë... edhe kur filluam të punonim në shoqatën “Fëmijët e harruar të luftës”, isha sikur, punuam, jemi mbledhur për këtë. Ishte ndoshta dy vjet e gjysmë, tre vjet më parë, ndoshta po të hapja temën e atij filmi dhe të telefonoja mamin dhe ta pyesja. Pastaj e thirra drejtoreshën e atëhershme të Medica. Pastaj njerëzit që punonin në Medica atëherë. Pastaj i shkrova Jasmilës. Ishte mo-

menti i parë kur kuptova se duhet të ma thoshin këtë. Nuk mund të shkoj askund tjetër tani. Fakti që Grbavica fitoi Ariun e Artë nuk do të thotë asgjë për mua. Domethënë, edhe pse kam fragmente kujtimesh nga disa intervista që kishte bërë nëna ime... Një intervistë e kemi bërë një herë, do të jetë më vonë që ju tregova një foto, është një intervistë që është bërë te parku tek Elektro-distribucioni në Zavidoviq. Kisha një bluzë sipër, dhe pjesa e poshtme ishte si bardh e zi, por disi si ngjyra tigri. Dhe kur pashë atë foto në këtë article[12] që gjeta në internet, atëherë e kuptova se isha unë. Hajt nga karakteri dhe nga kjo, por motra e Nusretit ma solli atë set, atë veshje nga Amerika, askush në Bosnje nuk kishte një kostum të tillë si unë. Dhe atëherë e dija 100% se ishim ne.

E njëjta intervistë, të cilën më vonë e gjeta në PDF nga New York Times, foli për mënyrën sesi mbijetoi nëna, si është të jetosh me një fëmijë dhe ajo foli se sa i rëndësishëm ishte roli i Nusretit. E harrova si quhej ai në këtë artikull dhe unë dhe mami quheshim Esma dhe Sara. Se sa e rëndësishme ishte qasja e tij ndaj kësaj teme, pasi ai ishte thjesht ai njeri... Është teknik mekanik, por mënyra se si i qaset dhe e kupton këtë temë është disi plot ndjeshmëri, plot dashuri. Ai nuk është ekspert, por në fund të fundit është njeri. Disi, e gjithë mbështetja e tij e pakushtëzuar për nënën time dhe për mua është shumë e rëndësishme. Dua të them, sigurisht që mamaja ime bëri shumë gjëra për të për sa i përket sensibilizimit, kuptimit të temës, por kjo intervistë ishte kishte të bënte me këtë.

Ajo intervistë ishte një moment kur e dija tashmë, sepse kur e mora vesh të vërtetën, e kapa kur ishte në shkollë, sepse një fundjavë shkova në Zavidoviq. Familja ime doli nga shtëpia diku dhe unë po gërmoja nëpër letrat e nënës sime nëpër shtëpi për t'u përpjekur të gjeja atë informacion dhe gjeta një kuti që mbante të gjitha letrat e rëndësishme të nënës sime. Ndër të tjera, aty gjeta dokumentet e saj nga Medica; deklaratat e saj, përshkrimin e saj për gjithçka; disa gjëra nga policia; disa gjëra nga gjykata, jo nga gjykata por që kishte shkuar në SIPA për të dëshmuar; vendim nga Shoqata "Gratë viktima të luftës" të Bakira Haseçiq për statusin de facto; të gjithat i gjeta aty dhe i lexova të gjithat. Por mamasë nuk i thashë që i kisha lexuar për nëntë muaj të tërë.

Ka vend për fëmijët e dëshmorëve, të gjithë flasin për të; ka vend për fëmijët e të burgosurve në kampe; ka vend për luftëtarët e çmobilizuar; për këtë, për atë, për të gjithë. Të gjitha temat ishin normale. I përdora të gjitha këto tema për të gënjyer kur takohesha me njerëz të rinj – çka ndodhi me babin? Dëshmor. Kur thua dëshmor, askush nuk pyet asgjë më tej. Ne të gjithë disi, mendoj unë dhe nëna ime, ndoshta e kemi përdorur atë. Por kur dilni, hapni derën, shihni se ky identitet nuk ka vend dhe as ju. As nuk dija si ta përkufizoja. Një fëmijë i lindur si pasojë e dhunës seksuale gjatë luftës, dua të them...

Fillimisht, nuk e dija se çfarë ishte përdhunimi. E dija se çfarë ishte seksi, por nuk e dija se çfarë ishte në të vërtetë përdhunimi. Nëna ime u kujdes shumë për shëndetin dhe njohuritë e mia riprodhuese. Dhe kjo është gjithashtu diçka për të cilën i jam mirënjohëse. Disi ajo gjithmonë fliste shumë për këtë. Por ishte thjesht një identitet që nuk mund të artikulohej. Dhe sigurisht pas kësaj në ata nëntë muaj, çfarëdo problemi që mund të bëhej, unë e bëra. Shkova në Zenicë. Po, kisha shumë probleme. Nuk

12 Ang. Artikull i gazetës.

shkoja në shkollë. Dështova në matematikë, dështova në biologji. Kisha shumë mungesa në shkollë, ikja nga konvikti mbrëmjeve, zbrita përmes ulluqeve dhe shkova në qytet. Shkova në Ten, i cili ishte një klub në Zenicë në atë kohë. Nuk ishte diçka delikuente, por thjesht u lëshova, ndoshta si çdo adoleshent tjetër në atë moment, thjesht ndoshta e kalova kufirin. Dhe ajo çfarë ndodhi, besoni apo jo, më shkatërroi sistemi, më shpëtoi sistemi. Sepse në fund më shpëtoi shkolla. Drejtori thirri kujdestaren e klasës e cila padyshim tashmë kishte një informacion të caktuar. Dhe pastaj u ftova në një bisedë me drejtorin. Kujdestarja e klasës ishte pedagoge. Dhe kur mbështetesh për muri, çfarë të bësh, duhet të thuash çfarë po ndodh, cili është problemi. Atyre u kam përshkruar pothuajse gjithçka që ju kam përshkruar me teza të shkurtra. Dhe pastaj ke kushtet që të mos të të përzënë nga shkolla, të të arsyetohen orët. Një prej tyre ishte se unë në fakt shkoj te pedagogu për të biseduar. Shkova nja dy herë dhe ajo më tha në një moment... Nuk do të ndalem kurrë së kujtuari atë ngjarje. Në shtatë të mëngjesit thotë kështu, hajde para shkollës së mjekësisë. Erdha në shtatë dhe tha sot do transferohesh në Qendrën për Punë Sociale, poshtë për të shkuar në mbështetje psikologjike, në terapi. Dhe mbaj mend që shkojmë drejt urës poshtë përmes fushës Kamberoviq në Zenicë, kalojmë andej nga shkolla e mjekësisë dhe lëshohemi poshtë. Dhe e di që heshtte. Ajo kurrë nuk hesht, ajo pedagoge, mund të fliste gjithmonë. Dhe asgjë, ecja poshtë. Hyra në atë hapësirë. Isha në shok, unë vërtet e mbaj mend si një periudhë tronditëse. Dhe pastaj më dhanë psikologen poshtë. U ula me të dhe flisja, flisja dhe flisja. Ajo më pyeste, unë përgjigjesha, ishte më e vjetër. Dhe nuk e di sa kohë kishte kaluar kur nëna ime hyri në derë. Askush nuk më tha se do të vinte, as nuk e dija që do të ndodhte ky moment. Por sërish isha mirënjohëse për një lëvizje të tillë sistematike të shkollës së mjekësisë dhe Qendrës për Punë Sociale në Zenicë. Dhe kjo ishte ajo biseda jonë - a jam përkujtues, mos më gjyko, mos më braktis. Aty ishte edhe Nusreti, edhe ai qau atëherë. Ishte kështu, një moment vërtetë i vështirë për ne të tre. Por unë mendoj se është shumë e rëndësishme që në atë thyerje disi emocionale të ishte një person profesionist pranë që dinte se çfarë të thoshte. Ajo psikologe e njihte nënën time gjatë luftës.

Ende do të heshtja me siguri. Dhe këtu kuptova të vërtetën dhe kur disi ne, nuk është tani që unë dhe mami shkuam në shtëpi dhe biseduam për këtë duke pirë kafe. U desh shumë punë si për mua ashtu edhe për atë dhe për ne së bashku, dhe fuqizim. Mendoj se pika e kthesës së dialogut të hapur mes meje dhe nënës ndodhi në “Gjykatën e Grave” në vitin 2015. Këtë e kam përmendur në Novi Sad. Sepse erdhëm atëherë, ato dëshmi, ato gra, gjithçka që dëgjuam atje ishte tronditëse për ne. Atëherë e pashë për herë të parë pas kaq vitesh drejtoreshën e parë të Medica nga Zenica. Aty ishte edhe ajo. Dhe disi, kur e gjeni veten në një turmë prej treqind grave që flasin hapur për këtë, atëherë filloni edhe ju disi. Edhe sot, kur flitet për këtë, duhet të përgatitesh pak, nuk është vetëm të fillosh ashtu. Në fund, për sa i përket familjes së nënës sime, të gjithë e dinin. Dhe isha shumë i lumtur që të gjithë e dinin. Sepse atëherë, kur sillja kokën rreth vetes, shihja se çfarë marrëdhënie të bukur kanë ende të gjithë.

Asnjëherë nuk kemi biseduar për specifikat e asaj ngjarjeje në thelb. Më shumë kemi biseduar për atë që po ndodhte në qytet gjatë asaj periudhe; si shkoi ajo luftë; si jetoi ajo në atë luftë; si lëvizte, pse lëvizte; a ishte zonë e lirë, kur nuk ishte. Por përsëri, shumica e gjërave që më interesonin ishin nga Medica. Për shembull, një nga pyetjet e para - ku janë fëmijët e tjerë nga Medica? Kështu u takuam më vonë, i gjeta në Facebook, tani jemi miq, miq shumë të mirë. Ku janë ato femrat e tjera? Kështu ajo më tregoi fotot dhe më dërgoi poshtë në Maglaj për të takuar disa nga ato gra dhe

dhe fëmijë. Po ashtu ajo më çoi edhe në shtëpinë e parë të Medica Zenica. Folëm për gjithçka që nga koha kur kam lindur, jo për këtë më parë, jo aq shumë. E kishim një, ndoshta dy vjet më parë, një vit, po e rrumbullakojmë ndoshta një vit e gjysmë, kur folëm pak më hollësisht për marrëdhëniet e familjes me të, anëtarët individualë të familjes, si kush e trajtoi atë, si rrodhi, si luftoi me të. Kjo ishte interesante për mua të dija, pasi tani jam më i vjetër dhe mund të kuptoj disa nga këto family[13] marrëdhënie. Por thelbi është se ne nuk flasim për atë ngjarje konkrete dhe as nuk përmendim kryerësit. Unë kam qenë aktiviste që nga lindja, ishte shumë e rëndësishme për mua të dija se ajo e kishte raportuar. Kjo ishte disi shumë e rëndësishme për mua.

Në vitin 2008, ajo dha një deklaratë në SIPA. Dhe gjithçka që dinte për krimin e saj specifik të përjetuar të luftës dhe gjëra të tjera që ndodhën në atë çarshi gjatë luftës, ishte aq e rëndësishme për mua që ta di që ajo e përdori këtë të drejtë, megjithëse e shihni, askush nuk bëri asgjë për këtë. Së fundmi e pyeta pak për familjet e kryerësve dhe këto. Meqenëse mësova pak për disa gjëra. Prandaj po përpiqem të krijoj sërish lidhje me Zavidoviqët. E pyeta pak për ata njerëz dhe për këto, dhe më tregoi kush vdiq, kush është gjallë, kush ku u zhvendos. E cila përsëri më bën të kuptoj se ajo di gjithçka dhe po i ndjek. Epo, tani po ndjek edhe unë pak. Global information[14] nga Shoqata jonë me të vërtetë po ngritët kjo pyetje nëse kjo është safety issue[15] që ne të gjithë e ndiejmë në thelb, si ne ashtu edhe nënat. Dhe kjo është diçka që mund të thotë Aleni, diçka që mund të thotë çdo anëtar yni që vjen nga kjo kategori. Dhe ajo që është më tepër e përbashkët për të gjithë ne, që të gjithë kryerësit mbi nënat tona janë të lirë, nuk janë në burg, se ne nuk i njohim karakteret e tyre. Në thelb, mendoj se edhe ky është një faktor i madh dhe mendoj se vetë fakti që, mendoj se është një informacion shumë i rëndësishëm edhe për mamin, që i mora vesh emrat dhe mbiemrat, që i lexova. Kam shpenzuar shumë kohë duke kërkuar në google emrat dhe mbiemrat që lidhen me kryerësit dhe mund të kisha krijuar një bazë të dhënash me një mijë persona supozoj, por nuk e di personazhin dhe ky është një problem i madh. Por unë kurrë nuk do ta ekspozoja nënën time me shfaqjen e gjithë atyre personazheve, që ajo të më thoshte se cili është. Nuk do ta ekspozoja, madje as nuk jam i sigurt nëse dua ta shoh më, sepse nuk e di se çfarë do të më bënte. Nuk jam shumë e sigurt.

Unë kurrë nuk kam pasur pengesa në udhëtimet e mia, por kur u largova nga Zenica dhe mbërrita në Sarajevë, nëna ime më tha se vetë, ajo e dinte se kjo ishte ajo, se ajo nuk kishte më asnjë kontroll mbi mua dhe se tani do të bëja atë që Unë dua dhe atë që mendoj se është e nevojshme. Dhe që gëzoj besim të madh te ajo në vendimet e mija, por kishte pak...

Zavidoviqët janë kroatë dhe myslimanë, një pjesë e vogël e serbëve jeton atje poshtë, dhe kemi edhe romë, nuk jam i sigurt për hebrenjtë. Si fëmijë, si e re nuk shoh ndonjë problem. A e sheh nëna ime, a e shohin njerëzit më të vjetër se unë, po, me siguri. Mua kurrë, për shembull, kur doja të shkoja në Zhepç, që është qytet kroat afër Zavidoviqit, nëna ime nuk më ka ndaluar të shkoj. Por e di kur shkova në Banjallukë, kur shkova atje për dy ose tre muaj si vullnetare, dhe ishte ky momenti i parë në të cilin ajo tha a je e sigurt që dëshiron të shkosh në Banjallukë. I thashë se doja të shkoja në Banjallukë, se ishte e rëndësishme për mua si e re të shkoja në Banjallukë dhe t'i

13 Ang. Familja
14 Ang. Informacione të përgjithshme
15 Ang. Një çështje sigurie

jetoja ata tre muaj atje. Ishte bukur për mua në Banjallukë. Qëndrova pak më gjatë se sa ishte planifikuar. Kështu që ne thyem disa nga barrierat rreth kësaj dhe mendoj se efekti më i madh i disa prej udhëtimeve të mia në komunitete të ndryshme në Bosnje rezultoi gjithashtu në faktin se nëna ime, së bashku me disa gra të tjera që punuan në këtë ekspozitë Speaking Out, shkoi në Beograd për herë të parë pas luftës. Dhe ishte vërtet shumë bukur për ne. Ne vizituam Beogradin, patëm një ekspozitë, tregimet e tyre u ekspozuan, fëmijë. Po ashtu ajo më çoi edhe në shtëpinë e parë të Medica Zenica. Folëm për gjithçka që nga koha kur kam lindur, jo për këtë më parë, jo aq shumë. E kishim një, ndoshta dy vjet më parë, një vit, po e rrumbullakojmë ndoshta një vit e gjysmë, kur folëm pak më hollësisht për marrëdhëniet e familjes me të, anëtarët individualë të familjes, si kush e trajtoi atë, si rrodhi, si luftoi me të. Kjo ishte interesante për mua të dija, pasi tani jam më i vjetër dhe mund të kuptoj disa nga këto family marrëdhënie. Por thelbi është se ne nuk flasim për atë ngjarje konkrete dhe as nuk përmendim kryerësit. Unë kam qenë aktiviste që nga lindja, ishte shumë e rëndësishme për mua të dija se ajo e kishte raportuar. Kjo ishte disi shumë e rëndësishme për mua.

Katarza

Kur folëm ne dyja, mund të them se ndodhi një lloj katarsisi, po. Kjo ishte brutalisht e dhimbshme. Nuk u desh të flisnim shumë për të filluar, por vetë fakti që ky informacion është tani në tryezë edhe pse ne nuk flasim për të dhe shikojmë televizor. U desh shumë kohë dhe punë për të. Dhe askush nuk kishte guxim të fillonte temën. Dhe kthehemi sërish te Nuna si një faktor i rëndësishëm në gjithë këtë, e cili në atë moment e mori përsipër, unë e quaj gjithmonë doping të guximit dhe disi në atë periudhë të gjimnazit më përvijonte vazhdimisht atë çfarë më duhej të bëja në jetë në mënyrë që të gjitha këto të pushonin së ndodhuri, dhe gjithçka dërgonte në pavarësinë, pavarësinë e plotë nga kushdo, nga çdo gjë. Dhe tani nuk e di nëse ai e ka ekzagjeruar shumë në këtë, por me të vërtetë është rrënjosur tek unë - një pavarësi përfundimtare që ndonjëherë mund të çojë në vetmi në gjithë këtë. Unë kam probleme besimi, që më nuk është diçka që e fsheh. Por disi mendoj se ai luajti atë rol kyç që çfarëdo që bëj dhe si sillem me mjedisin, kështu do të më trajtojë mjedisi dhe se disi duhet të jem e pavarur, e fortë dhe e vendosur. Unë nga leksionet e tija kam zhvilluar aq shumë mekanizma, të cilat pasi isha e përfshirë në shkollë, gjeta një mënyrë për ta luftuar atë, fola hapur për këto tema me shokët e mi nga ajo klasë. Më pas, të njëjtën gjë i thashë edhe Jacës, shokut tim të shkollës fillore. Dhe ajo që ndoshta më shpëtoi aty ishte se askush nuk dinte asgjë për të, kështu që kishte disa nënpyetje, por të gjithë morën disa përgjigje. Dhe kaq ishte. Por jeta ndryshoi plotësisht pas kësaj, nuk ka nevojë ta mbështjellësh atë me ndonjë letër shumëngjyrëshe. Thjesht nuk është më ajo. Unë mbarova shkollën e mesme, shkova në ekskursion, pija me njerëzit, vazhdoja të ikja nga orët, shkoja në atë shkollën e mjekësisë dhe gjithçka, por thjeshtë ajo qëndron mbi kokën time sepse shkolla e mesme është vetëm një hap tjetër dhe pas atij hapi ka një tjetër hap. Kur mbërrin ditën e parë në kryeqytet dhe kur të kërkojnë fillimisht emrin e babait, atëherë ti thua oh dreq. Nuk ke ku të shkosh tjetër. Më pas, shumë gjëra rrotullohen rreth kësaj, shumë gjëra. A bën jetë normale, një jetë të vazhdueshme normale si çdo fëmijë tjetër, çdo i ri, ke një jetë, por në çdo sportel, konkurs bursash, çfarëdo, kjo të pret. Një herë mora një bursë, kështu që ata rastësisht gabimisht publikuan tabelën në të cilën thotë fjalë për fjalë një nënë e përdhunuar në luftë, kështu që shumë njerëz e panë atë turp. Pastaj, hajde le ta riparojmë pak.

Pastaj aplikon për bursa komunale, nuk ka, nuk mundesh. Plaku është një luftëtar i çmobilizuar, por unë nuk jam fëmija i tij si i tillë. Pastaj, një herë ishte një konkurs, më kujtohet BBI banka, ata shkruan një konkurs për fëmijët e viktimave civile të luftës, kështu që unë e mora atë bursë. Pastaj, zotëria, i ndjeri gjenerali Jovan Divjak, më dha bursë. Pastaj vjen sektori joqeveritar. E pranova me dy duar sektorin joqeveritar në kontekstin e formës, edukimit, fuqizimit joformal, forcimit, rrjetëzimit. Dhe pastaj vjen dita kur dikush ju pyet nëse doni të jepni një intervistë në mënyrë anonime. Dhe para se të dilja për të folur publikisht, dhashë dy intervista anonime. Njëra më pëlqen, tjetrën nuk e dua sepse nuk kanë qenë të drejtë me mua, si e kanë shpërndarë më tej. E kam dhënë edhe një intervistë po ashtu në vitin 2015 me nickname[16], e kisha atë foton me fytyrë të mbuluar. Ishte hera e parë që pashë që kisha mundësinë të tregoja historinë time dhe shkova në promovimin e këtij libri, askush nuk e dinte që ishte historia ime. Unë isha ulur atje, ata thjesht e kalonin atë, të gjithë thjesht e kalonin atë, vazhdimisht në çdo sektor ata thjesht kalonin mbi të. E kanë theksuar, por për shembull, hyrja i tregimit tim në 2015 ishte statistika për gratë dhe burrat që mbijetuan, për luftën, kur ndodhi lufta dhe kështu, por nuk kishte asgjë për fëmijët. Dhe pastaj njëherë e dëgjova emrin e Alen Muhiqit dhe pastaj e kuptova - ja ku është. Pastaj e shtova në Facebook dhe derisa më pranoi, ishte i njohur atëherë, bëheshin filma për të. Unë i shkrova një mesazh që të fshijë një mik dhe të më pranojë, sepse kam diçka për t'ju thënë. Kështu vendosëm kontaktin. Më pastaj u njohëm në 2016 dhe sonte më pret në Sarajevë. Ja, përveç mamasë, Nusretit dhe familjes sime, Aleni është me të vërtetë gjithçka në jetë për mua. Vetë paraqitja e tij ishte sikur, le të jemi që të mos jem vetëm. Pak egoiste. Por më vonë, bisedat me të dhe gjithçka që sapo ju thashë, ai do t'i përsëriste të gjitha në të njëjtën mënyrë, nga një kontekst tjetër si një fëmijë i birësuar. Por të gjitha këto pyetje, nënpyetje, qëndrimi i shoqërisë ndaj tij në Gorazhde, qëndrimi i shoqërisë ndaj meje në Zavidoviq, e gjitha kjo në të njëjtën mënyrë.

Në fillim të vitit 2016, nëna ime më telefonoi dhe më tha se ishte dëgjuar nga Medica-n, me Sabihën në Zenicë, dhe se është një mjeke nga Tuzla, një hulumtuese që dëshiron të bëjë hulumtimin e parë në temën e fëmijëve që kanë lindur si pasojë e luftës. Deri atëherë njoha vetëm Alenin dhe asnjë tjetër. E njihja një të vogël, nuk ka rëndësi se nga ishte, më vonë kuptova se ishte një peacekeeper baby[17], se babai i tij ishte afrikano-amerikan dhe kjo dukej nga ngjyra e lëkurës së tij. Atëherë gjithmonë pyesja veten, por nuk iu afrova kurrë dhe kaq, e parëndësishme. Më së shumti hamendësohesha për të. Dhe nëna më tha se ishte lajmëruar doktoresha Amra Deliq e cila donte ta bënte atë hulumtim dhe se i kishte mbledhur fëmijët dhe, nëse do të kisha dëshirë, nëse jam e disponueshme dhe e gatshme të takohem me të dhe ta bëja atë intervistë. E pyeta mamin nëse mundja. Dhe unë sapo studiova psikologjinë, e dija se sa të rëndësishme janë hulumtimet, sa e rëndësishme është gjithë kjo. U takuam në hotelin Hollywood në Ilixhë. Por, në një farë mënyre shfaqja e Dr. Amra ishte një pikë kthese e plotë për të mirë dhe më qartë. Kur erdha poshtë me të, u ulëm dhe biseduam. Ajo tha se tashmë e ka themeluar këtë shoqatë së bashku me disa mikesha të tjera dhe disa fëmijë të tjerë nga Tuzla; dhe se janë tridhjetë e tre në hulumtim dhe se unë do të isha njëra nga ta që do bëja atë hulumtim. Ajo më pyeti nëse isha gati që të bënim hulumtimin dhe të dëgjohemi përsëri më vonë për ta provuar; ajo ka disa para, disa miq në Sarajevë, dhe të përpiqemi ta mbledhim një grup fëmijësh. Unë e bëra atë hulumtim.

16 Ang. Me pseudonim

17 Ang. Fëmijë i një ushtari paqeruajtës

Më vonë u dëgjuam. Dhe asgjë, në fakt ndodhi shumë shpejt pas kësaj, ndoshta rreth prillit 2016. Ishte ende disi pa shije në Sarajevë, binte shi. Ishim në një shoqatë në Sarajevë. Hyra në sallë. Doktoresha Amra dhe e ndjera jonë Xhejna ishin atje. Pesëmbëdhjetë njerëz të panjohur, katërmbëdhjetë a pesëmbëdhjetë. Disa të shkurtër, disa të gjatë, disa të kuq, disa të kaltër, disa në qoshe, disa këtu, erdha edhe unë, e vesha një këmishë – thash me vete, më duhet të rregullohem... Pastaj na renditi doktoresha Amra, u ulëm në rreth. Unë para kësaj mora një detyrë nga doktoresha Amra, unë dhe një anëtare tjetër morëm për detyrë të përgatisim ushtrimin e lumit që bëhet në seminare. Ne e përgatitëm atë. Dhe ushqimi im i preferuar është ushtrimi. Ne e ushtruam atë dhe kështu filluam punëtorinë. Aty dëgjova për herë të parë për fëmijët e paqeruajtësve të OKB-së; ishte hera e parë që dëgjova për fëmijët e punëtorëve humanitarë; fëmijët e martesave të detyruara; dhe se baballarët janë nga Amerika, Norvegjia, Britania, nga kudo. Kur tregova disa nga pjesët e mia personale, fola se si ndihesha për diskriminimin, pasi doktoresha Amra e trajtoi atë me shumë profesionalizëm. Tash mund të flas sikur unë ty çfarë të dua për një orë, por kishte fragmente diskriminimi - çfarë është, dhe pastaj folëm për të. Dhe kur tregoja disa nga përvojat e mia të tilla, dhe që kam kuptuar të vërtetën në shkollë dhe të gjitha këto, dhe kur dëgjova Alenin të thoshte se ai e kuptonte, atëherë kur dëgjova një zë tjetër duke thënë se ai e kuptonte, ishte me të vërtetë thjeshtë një lehtësim, shkarkim, çdo pakuptimësi dhe vetmi u zhduk në atë moment. Në njëfarë mënyre, healing[18] mund të ketë filluar aty, me gjithë këta. Ishte gjithashtu një forcë dhe motivim i tillë për të vazhduar përpara. Doktoresha fillimisht na mësoi për tri grupe të të drejtave të njeriut, për origjinën e të drejtave të njeriut, për konventat. Pastaj ajo na mësoi për konventat për të drejtat e fëmijëve. Më pas ajo na mësoi për viktimat civile të luftës, termet, pak për Bosnjën dhe më pas na tregoi rezultatet e hulumtimit të pjesshëm, në mënyrë që të kuptojmë gjërat, çfarë është çdo fragment i përvojave tona, si quhet profesionalisht, problemet në lidhjen e marrëdhënieve shoqërore. Disi, sipas meje ishte e rëndësishme të kuptonim se fakti që kemi shumë probleme në krijimin e marrëdhënieve, që nuk është vetëm përgjegjësi e jona, se është edhe përgjegjësi shoqërore dhe se jemi disi të gjithë të barabartë në këtë. Dhe më pas, i gjithë procesi kur përmendëm tashmë Gratë në të Zeza, Jadrankën nga Fondacioni CURE, po ashtu të përfshira edhe disa gra nga sektori joqeveritar, u përfshinë nënat dhe thjeshtë ky tregim filloi. Ne u larguam, pas kësaj mbetëm të lidhur me shoqatën, sepse ne të gjithë bëjmë jetët tona private, shoqata është aty. Disa janë aktive në mënyrë anonime, disa janë aktive publikisht, disa janë në kuvend, disa jo, por megjithatë ai grup është thjeshtë aty. Vitin e kaluar kur po filmonim diçka, meqë po bënim një film me fëmijët e Luftës së Dytë Botërore, nënat norvegjeze, baballarët ushtarë gjermanë, pastaj fëmijët nga Vietnami, Uganda, Ruanda, Bosnja; dhe pas kësaj u ulëm në atë kafene, pimë pak, dhe pastaj kuptuam në fund sa njerëz bëmë bashkë dhe lidhëm, sepse papritur erdhi konferenca dhe të gjithë na shikonin si eksponate. Sa herë që dikush na bën një pyetje, nëse nuk e dimë përgjigjen, të jep mundësinë të mendosh për të, të dëgjosh ose të mësosh diçka tjetër ose të pyesësh. Ajo që mendoj se është e rëndësishme është që nënat ishin pjesë e atyre proceseve, që ishin aty për shumë aktivitete, rrinin ulur, shikonin, vëzhgonin, shikonin rezultatet, sepse edhe kjo ishte një mundësi për to, ashtu siç e kisha të vështirë të pyesja nënën time për përvojën e saj, ashtu e kishte të vështirë të pyeste për përvojën time. Ndonjëherë është më e t'i tregosh disa gjëra në një dhomë plot sesa në heshtje. Kështu që unë mendoj se ky është një faktor i madh.

18 Ang. Shërimi

Në Sarajevë e mësova gjuhën angleze, mësova disa teknika photoshop dhe kisha shumë më tepër akses. Unë gjithmonë, e këtë edhe e kam besuar, ashtu më kanë mësuar se dija mbron kokën. E kam vlerësuar arsimin formal dhe e vlerësoj disi edhe sot, por a besoj se duhet përmirësuar, duhet. Unë kisha fatin që studiova për psikologji, kështu që ndoqëm disa trende, por momenti që njoha... Sepse kur erdha në Sarajevë, nëna ime ma shkroi në një copë letër numrin e një shoqe të saj dhe më tha kur të vij në Sarajevë, nëse më duhet diçka, ta thërras atë numër dhe ajo do të më ndihmojë. Kur e thirra atë numër për herë të parë, ishte diku në vitin 2012/2013, u lajmërua Jadranka Miliçeviq. Ajo sot është drejtoreshë e Fondacionit CURE. Dhe disi, përgjithësisht me hyrjen në atë sektorin e aktivizmit, feminizmit, OJQ-ve, i shfrytëzova maksimalisht mundësitë e tij. Kam punuar edhe me fëmijë romë, kam punuar me fëmijë me Sindromën Down, kam punuar me shumë gjëra. Dhe disi mendoj se është ai momenti i asaj pjese në përgjithësi, ky është ndryshimi kryesor në fakt midis Sarajevës dhe Zenicës, dhe ndoshta mosha ime, por përsëri patjetër mundësive. Sarajeva ofron shumë, shumë më tepër mundësi në krahasim me të gjitha qytetet e tjera në Bosnje dhe Hercegovinë. Por Sarajeva ju jep edhe dy gjëra të tjera. Njëra është tepër informacione. U bëra shumë më e vetëdijshme se ku jetoj dhe si jetojnë njerëzit rreth meje. Sarajeva gjithashtu jep një pamje të normalitetit, jetës normale, disa lëvizjeve, mundësive, ka shumë turistë, ka shumë komunitet ndërkombëtar, gjithçka është në Sarajevë. Kur jetoni në Sarajevë për kaq gjatë, është shumë, shumë e rëndësishme që të mos harroni se Bosnja nuk është Sarajevë, por se Sarajeva është vetëm një pjesë e Bosnje dhe Hercegovinës. Çështja e shëndetit mendor, këtë do ta theksoj gjithmonë përveç studimit të psikologjisë, që disa qarqe feministe, të grave, aty disi kam lëvizur më shumë. Në fakt, rëndësinë e bisedimit dhe të folurit edhe me gra të panjohura apo të njohura, seminaret, forumet, seminaret.

Në konviktin e parë të nxënësve, në thelb, tashmë është një koncept tjetër, ishin njëqind, njëqind e pesëdhjetë fëmijë, bashkëmoshatarë të mi. Thjeshtë është një periudhë e bashkëmoshatarëve ku ju bëni gjithçka bëjnë bashkëmoshatarët tuaj, por në fund të ditës, ju thjesht rriteni. Kjo është një pjesë, siç mund ta quajmë, e rritjes në rrugë, që nuk besoj se ndonjë prind ka kontroll sesi do të rritet fëmija me praninë e moshatarëve dhe risive që ofron çarshia e re. Në fakt, pas ardhjes në Sarajevë përsëri jetova për një kohë në konvikt studentor, por vetëm shkurtimisht për një vit ose dy. Nuk e mbaj mend sa kam jetuar atje, por u ngopa shpejt me kolektivin. Dhe më pas u transferova për të jetuar me një mik, por jetuam ndoshta dy vjet së bashku. Pastaj fillova të jetoj vetëm. Por ku ta di, është thjesht ajo pavarësi për sa i përket fitimit të parasë, pasjes së parasë, gjindshmerisë, sidomos pasi mora vesh të vërtetën. Mami pushoi së mbajturi letra, ndjekjet, pastaj merr një tjetër detyrim në jetë, sepse vetë shkon të marrësh certifikatën e lindjes, vetë këtë vetë atë. Në thelb, unë e njoh shumë mirë këtë vend dhe si funksionon, dhe di ku të gjej gjithçka që më nevojitet. Sidomos tani që Shoqata është këtu, e kuptoj

Kisha një përpjekje për ta përfunduar atë master, por tregimi filloi me Shoqatën "Fëmijët e harruar të luftës" kur u organizua një simpozium i mbyllur në Sarajevë në vitin 2018, ku kolegët dhe koleget e doktoreshës Amra Deliq, hulumtues e hulumtuese të tjera punuan të njëjtin hulumtim një tjetër popullatë fëmijësh të lindur për shkak të luftës në botë. Dhe kjo ishte breaking point[19]. Realisht, ne ishim në atë konferencë dhe ata i prezantonin rezultatet aty. Aty ishte Monika Hauser, një nga themelueset e Medica. Unë dhe mami bëmë një panel aty, ishte hera e parë që pashë një panel, kinse po flasim pak. Aleni ishte aty. Atë ditë në atë konferencë ishte Darrel Touloni, të cilin e përmenda po ashtu, regjisori ynë, regjisori i shfaqjes "Në emër të atit". Eldin Haxhoviqi, gazetar freelancer. Eja të bëjmë një intervistë. Kështu i them mamit, duan të bëjnë intervistë. Ajo thotë, lëre, duhet fillimisht të verifikojmë kush janë, çfarë janë. Pastaj aty erdhi doktoresha Amra, kështu që u ulëm, pimë, nuk donim asgjë pa doktoreshën Amra. Ajo ishte për ne... vetëm asaj i besonim. Dhe pastaj ajo ngadalë punoi me ne. U njohëm me Darrelin, pastaj shkuam me doktoreshën Amrën dhe anëtarë të tjerë, shkuam unë dhe Aleni dhe ekipe të tjera nga shoqata. Pastaj shkuam në Birmingham, takuam historianë dhe hulumtues atje. Ajo ngadalë ndërtoi atë marrëdhënie me ne. Pas kësaj, ky Eldini, gazetari, mbajti lidhje me nënën dhe kur i erdhi me propozimin për ta xhiruar atë video fillimisht për Deutsche Welle-n, ishte me një fjalë dhe shkova në promovimin e këtij libri, askush nuk e dinte që ishte historia ime. Unë isha ulur atje, ata thjesht e kalonin atë, të gjithë thjesht e kalonin atë, vazhdimisht në çdo sektor ata thjesht kalonin mbi të. E kanë theksuar, por për shembull, hyrja i tregimit tim në 2015 ishte statistika për gratë dhe burrat që mbijetuan, për luftën, kur ndodhi video tre minutëshe që shpërtheu - kishte dy milionë shikime. Për herë të parë u publikua në gjermanisht, në Deutsche Welle atje. E pashë edhe unë, thashë le të shkojë, heshta. Në një moment kur pashë telefonin - atëherë isha në Alipashinë, mbaj mend që po ecja me japoneze me Nanin (këlyshin) dhe sapo ndjeva dridhjet e telefonit. Njëzet tag në Facebook, një mori mesazhesh, SMS, Viber, Whatsapp, gjithçka kishim në atë moment. I telefonoj mamit. E pyeta mamin, e përkthyen në boshnjakisht; ajo thotë se po. E thërras Alenin, i them e përkthyen; ai thotë se po, fiki telefonat. E dinim se do të kishte vëmendje, por që do të ndodhte në atë mënyrë, patjetër do ta mendoja vendimin tim shumë herë, shumë më gjatë dhe shumë herë më shumë. Nuk pendohem që i kam bërë të gjitha këto deri më tani, por në atë moment shpërthimi i gjithë kësaj ishte një tronditje ekstreme për ne. Përnjëherë, vetëm e kuptoj që njerëzit që i kam gënjyer në sy, të gjithë më vijnë para meje në mendje, çfarë i ke thënë kujt, çfarë je, kush je, nga je. Pastaj them, nuk më intereson. Dhe atëherë ishte thjesht momenti në të cilin kuptova se i kisha dhënë botës gjërat më të dhimbshme, më intime, dhe se kjo është kjo, that's it[20]. Ose unë e menaxhoj atë tani, ose bota do të bëjë atë që dëshiron të bëjë. Dhe kaq.

Unë dhe mami e bëmë atë intervistë bashkë, u përgatitëm bashkë për të, çfarë do të bënim dhe si do ta bënim. Unë e prisja që do ta shihnin, kupton, që do të publikohej dhe kështu, por o burrë, ka dy milionë shikime. Pas kësaj nuk kaluan as një muaj erdhën edhe gazetarë të televizionit ZDF nga Gjermania dhe Deutsche Welle, të cilët na lutën që të incizojmë më shumë. Ne ramë dakord për 26 minuta, me më

19 Ang. Pika e thyerjes

20 Ang. Kjo është ajo

shumë anëtarë, me më shumë fëmijë. Pastaj bëmë një mini-dokumentar që shpërtheu gjithashtu. Kur e hapëm për herë të parë atë incizim atje në ZDF, ai u përkthye në 15 gjuhë, dhe tani kur e hapni në YouTube ka mijëra komente, thjesht shkoi shumë larg. Sasia e mesazheve që morëm të gjithë në atë moment ishte shumë e madhe, ishte thjesht virale, nuk di si ta përshkruaj. Bombë, bombë. Pastaj papritmas mediat tona, N1, BHT, mediat serbe, kroate, malazeze - të gjitha, gjithçka ndodhi papritur. Transkriptet e deklaratave tona nga ai film në faqe; mesazhe në Facebook; është ai momenti new age i teknologjisë që thjesht, pavarësisht se kushdo kishte punuar me ne, askush nuk do mund të na kishte përgatitur që do të kanalizohej ashtu, që do të bënte kaq shumë jehonë. Pasi gjithë ajo mbaroi, në një moment ishim në Bosnje, e dhamë atë intervistë dhe shpërtheu, të nesërmen u zgjova në Nju Jork në Kombet e Bashkuara, po flisnim, shkoi Aleni, pastaj shkova unë. Ulem në atë Central Park në Nju Jork dhe them wtf[21], çfarë ka ndodhur? Është një tronditje e madhe, por nga e gjithë kjo sot, nga ky këndvështrim, unë me të vërtetë qëndroj me krenari pas kësaj shoqate dhe këtij tregimi; sepse vetëm kur mësoj sasinë e tronditjes, ankthit, paqartësisë, mungesës së anglishtes, mbi të gjitha që në fillim dhe çfarë u komunikua, çfarë u bë dhe ku arritëm... Përfundimi është ai udhëtim na solli këtu që ne të mund ta bëjmë këtë në terren. Sot kur më pyete nëse jam rehat me kamerën; pas asaj interviste, shpejtësisë së trajnimit dhe edukimit që kalova paralelisht ishte në mënyrë ekspresë - nga PR, te gjuha e trupit, të folurit në publik, prezantimit publik, qëndrimit të trupit, intervistës, filmit dokumentar, mësuam gjithçka menjëherë. Shkrimi i postimeve në Facebook, si, pse, kujt, si t'i përgjigjeni pyetjes. Do të ishte gënjeshtër të thuash se e gjithë kjo është thjesht një fenomen natyror, është punë e madhe, të paktën për sa i përket këndvështrimit tim personal... dhe disi prandaj qëndroj me krenari prapa të gjithave atyre të cilat i kam thënë në media apo kudo, sepse nuk ka ndodhur dhe kurrë nuk ka ndodhur që është manipuluar etnikisht, nuk ka hapësirë për këtë.

Mesazhet ishin në gjuhën angleze, gjermane, turke, norvegjeze, boshnjake. Kishte edhe mesazhe negative, nuk ka pse ta fshehim tani as këtë pjesë, ta shtyjmë nën tepih. Nënën e ke këso, nënën e ke aso. Unë e di këtë, unë e di atë. Kishte njerëz nga Zavidoviqi që shkruanin gjëra të këqija. Kishte bashkëmoshatarë. Shumica e mesazheve ishin pozitive dhe mbështetëse. Ajo që është motivuese është se shumica e mesazheve ishin të mira. Ajo që po ashtu natyrshëm ishte në favorin tonë ishte fakti se vetë tema ishte sexy and catchy[22] për mediat, por gjithashtu asnjë nga ato media deri më tani nuk kishte raportuar për këtë, gjë që me automatizëm tregonte për të gjitha këto medie, ku ne ishim shumë të qartë lidhur me këtë, se ato nuk dinë asgjë për këtë, dhe se në njëfarë mënyre me neve duhet të bëhet intervista pak më ndryshe, që ne të ua shpjegojmë se çfarë mendojmë se është problemi, kështu që ju na pyesni dhe ne do të gjejmë një gjuhë të përbashkët se si ta artikulojmë këtë më së miri, sepse ne ishim shumë të qartë në daljen tonë të parë në media - pse jemi të harruar, pse nënat janë fajtore dhe pse baballarët janë të lirë, si dhe ku është ligji? Katër pyetje themelore. Dhe që në fillim u thamë se nuk e dimë përgjigjen për asnjërën prej tyre. Disi mendoj se kjo na hapi një bashkëpunim të madh dhe shumë cilësor me median. Ne relativisht e menaxhojmë kur do të kemi komunikata për media dhe kur jo, por ende asnjëherë nuk ka ndodhur që të mos kemi mbështetjen e medias apo shoqërisë dhe tani ai grup i shoqërisë është mjaft i madh.

21 Ang. Çfarë dreqin? Në ferr.

22 Ang. Tërheqëse

Babi më ka thënë se ishte krenar dhe disi ishte e rëndësishme për mua që ai të mos ishte krenar vetëm për mua apo mamin. Ishte shumë e rëndësishme për mua që ai të ishte krenar edhe për veten. Dhe pastaj unë bashkë me nënën time u përpoqëm t'i tregojmë mesazhet që njerëzit i dërgojnë për të, të cilat ia shkruajnë, pasi ai nuk është në Facebook. Ishte vërtet e rëndësishme për ne që ai të shihte se njerëzit e vlerësojnë dhe respektojnë dhe se ata kanë një lloj perceptimi se sa i rëndësishëm është roli i tij në këtë proces dhe trajtimi i tij ndaj këtij procesi.

Ata të dy ishin njoftuar në restorantin ku punonte mami dhe u martuan më maj, 5 maj 2002. Dasma ishte standarde. Sigurisht, e mbaj mend atë moment sepse ishte muaji maj dhe shkolla mbaronte në korrik. Mua më duhej të qëndroja në këtë fshat tjetër për dy muaj derisa mamaja ishte atje lart, sepse më duhej ta mbaroja klasën. Atëherë isha shumë e zemëruar, por hej, shkoi mirë. Sepse ajo atëherë shkoi atje lart dhe më pas unë mbeta për ata dy muaj me gjyshen dhe dajën derisa e përfundova shkollën. Pastaj i zhvendosa letrat lart kur shkuam atje.

Po ju them, ai është një inxhinier mekanik dhe një gjuetar gjithashtu. Vitet e jetës dhe rinisë së pas luftës i ka kaluar në Itali, ka punuar në Itali, ka qenë edhe pica mjeshtër në një moment - gatuan mrekullisht. Por unë mendoj se ai është në thelb përgjigjja për këtë pyetje logjike që bëmë. Gjithmonë kam thënë të njëjtën gjë, nëse dikush ka përdhunuar dikë, si mund të jetë fajtor ai që i mbijetoi përdhunimit. Si është e mundur që kemi krijuar një paradigmë të tillë? Unë mendoj se ai është dëshmia e asaj se nuk duhet të jesh ekspert në diçka për të kuptuar logjikën e thjeshtë - çfarë është përdhunimi dhe kush është përgjegjës për të? Gjithashtu mendoj se ai është thyerës i paragjykimeve në çdo nivel, sepse fakti që një grua është kameriere dhe ka fëmijë, për të nuk ishte dhe nuk u bë kurrë pengesë. Thelbi i kësaj në fakt është që ai kishte vendosur të ndërtojë një marrëdhënie dhe një jetë me nënën, me atë çka ai sjell në atë marrëdhënie dhe me atë çka ajo sjell në atë marrëdhënie, dhe për të mos u futur në martesën e tyre - kjo është çështje e tyre private, por të dy kanë sjellë shumë me vete dhe në gjithë këtë në martesën e tyre e kishin të gjithë shoqërinë që u qëndroi aty. Unë mendoj se njëzet e tre a njëzet e katër vjet martesë janë një provë relativisht e madhe se është e mundur. A ishte e vështirë, po. A kërkonte shumë sakrifica nga të gjitha anët, po. Por që në asnjë moment nuk devijuan nga parimet bazë të vlerave njerëzore, për mendimin tim, ky është një tregues i martesës së tyre dhe kështu e shoh unë martesën e tyre. Janë të drejtat themelore të njeriut, parimet dhe dinjiteti që duhen kultivuar. Dhe disi i jam mirënjohëse jetës, universit, që nëna ime pati mundësinë të takonte një burrë të tillë dhe gjithashtu që ai pati mundësinë të takonte një grua të tillë, sepse ata plotësojnë njëri-tjetrin në shumë mënyra. Nga secili prej tyre, si nga ai, ashtu edhe nga ajo, kam marrë gjëra që më kanë forcuar, sigurisht që kam fituar edhe disa nga të metat e tyre, kjo është e natyrshme. Por mendoj se kam arritur të marr një full[23]paketë pavarësisht të gjitha pengesave, paqartësive dhe traumave, traumëzat, sido që t'i quajmë, gjatë gjithë jetës.

Ka pasur reagime pozitive nga familja e nënës sime, ato nuk kanë qenë reagime të menjëhershme, por kanë qenë pozitive, kur takoheshim dhe bisedonim. Sigurisht që mbështetja vinte nga motrat e mamit, sidomos në kontekstin e bisedës dhe gjithçka-je. Disi është edhe sot ajo, kur më shohin në televizion, më bëjnë foto, bëjmë shaka, flasim.

23 Ang. Plot

Mbështetja

Epo, mendoj se support-i[24] është i rëndësishëm mbi të gjitha në nivelin e mosgjykimit, ose nëse nuk flasim për paragjykime apo ndonjë diskriminim, mendoj se është vendimtare që të mos bllokohet dialogu apo monologu i dikujt për atë temë. Ndonjëherë kur dikush tregon historinë e tij, pala tjetër mund të mos ketë të njëjtën përvojë, por mendoj se të gjitha historitë duhet të dëgjohen. Unë nuk jam dakord dhe kjo është e profilizuar dhe e artikuluar qartë përmes shoqatës tonë, por në thelb secili ka zgjedhjen e vet, nuk jam dakord me faktin që duhet të kemi pesëqind histori të mbijetuarish, as nuk jam dakord që duhet të kemi pesëqind histori fëmijësh. Nuk e kuptoj pse njerëzit në mainstream[25] botën e sotme janë kaq të fiksuar pas vuajtjes dhe pse është kaq e nevojshme të flitet vazhdimisht për të. Kjo është arsyeja pse unë personalisht aktualisht po e mbyll atë rreth të dëshmisë personale, sepse nuk kam çfarë të them më shumë. Dhe gjithçka që kam thënë mund të përdoret si material për përpunim, ndërtim të çfarëdo gjëje më tej. A e pyeti ndonjëherë nënën time dikush nga e more atë fëmijë, ndoshta do të merrte një përgjigje. Kurse kështu nuk kishte asnjë rast që monologu i saj të dëgjohet në të vërtetë. Dhe mendoj se disi, për mendimin tim, ky është një support i rëndësishëm që duhet të ndërtojmë një klimë të tillë në shoqëri, veçanërisht tani me brezat e rinj dhe një klimë e tillë duhet të ekzistojë, që historia e secilit të ketë të drejtë të dëgjohet dhe që diçka mund të zhvillohet ose jo prej saj. Mendoj që në rastin tim ndihma profesionale është vendimtare. Disi një mirëkuptim overthinking[26], sidomos kur je ende në këtë pozicion të të folurit publik, qysh moti disi, duhet bërë një dallim i qartë mes nesh dhe meje, sepse ti nuk përfaqëson më vetëm veten, por edhe fëmijët e tjerë. Nga ana tjetër, në momentin që fole, nuk fole vetëm për veten, por fole për nënën, për Nusretin, për një familje, një familje tjetër, në të njëjtin moment fole për pesëdhjetë veta, dhe sigurisht nuk je konsultuar me të pesëdhjetët, por vetëm me dy. Kështu që kjo është disi, nuk e di, psikologu ruan kokën. Kjo është disi shumë e rëndësishme për mua. Ky peer support[27], support-i brenda të njëjtave grupe, karakteri i margjinalizuar është gjithashtu vendimtar. Peace keeping[28], një temë që definitivisht nuk ishte për mua, e dija si ishte, e dija si kishte ndodhur, çfarë kishte ndodhur në ato histori, por derisa anëtarët e Shoqatës..., dhe gjatë këtyre viteve të shoqërimit tonë, shkëmbimeve, hapjeve, pastaj e kupton më mirë se cili është problemi në peace keeping, cili është problemi në martesën e detyruar dhe thjesht gjithçka ndodh sepse dialogu nuk është i bllokuar, e as monologu i dikujt.

24 Ang. Mbështetje
25 Ang. Rrjedha kryesore
26 Ang. Mendimi i tepërt
27 Ang. Mbështetja e kolegëve
28 Ang. Paqebërje

Ishte e qartë - ose do të vazhdojmë, shfrytëzojmë këtë valë vëmendjeje, do ta shfrytëzojmë këtë që po ndodh, zgjimin. Dalja jonë ishte një zgjim nga fqinji i katit të dytë deri në Kombet e Bashkuara, ishte globale, të gjithë u zgjuan. Dhe ishte thjesht një vendim që ne mund ta bëjmë këtë, mund të shkojmë me të, ose mund të ndalemi këtu dhe të lëmë dikë tjetër të flasë për ne. Por mendoj, të gjithë kishin njëzet e pesë vjet për të folur, por nuk e bënë. Është një vendim që e merr brenda tridhjetë sekondave, sepse thjesht e kupton se ose ti, ose dikush tjetër, ndoshta në mënyrën e gabuar do ta bëj, sepse ata nuk kanë folur për këtë për njëzet e pesë vjet dhe ndoshta nuk e dinë gjysmën e asaj që ne dimë. Dhe ju thjesht shkoni go with the flow[29] - studion, punon, studion, punon, bie, ngrihesh, studion, punon dhe kështu vazhdon. Dhe sigurisht pas gjithë kësaj, në gjithë atë proces, ju mësoni të kontrolloni kohën, mësoni të kontrolloni vëmendjen që vjen nga jashtë dhe më pas filloni të strukturoni punën tuaj. Segmenti i parë ishte aspekti social. Ne fillimisht e bëmë aspektin social, një ngritje të vetëdijes sociale, sepse kjo ishte kështilla e parë që morëm nga gratë e mbijetuara - fillimisht punë me shoqërinë, pastaj me ligj. Ato e fituan ligjin, por nga shoqëria nuk i shpëtoi, ato ende ishin të diskriminuara në shoqëri, shoqëria ende nuk i kuptonte dhe nuk i pranonte. Kemi nxjerrë dhe kemi marrë prej tyre të gjitha gabimet e mundshme dhe gjithçka ka ndodhur në procese. Pra, ky ishte mësimi i parë. Para së gjithash, mësimi i parë ishte transparenca në punë. Pas kësaj u bë mësimi që të punohet fillimisht, strategjia e parë që të punohet fillimisht me shoqërinë dhe më pas që të punohet në ligj, gjë që edhe ndodhi ashtu. Njohja dhe dukshmëria sociale, dhe njohja me atë të çmendurin e vogël të ëmbël Darrel Toulon, regjisorin tonë me shfaqjen, me atë skenar të vogël për Alenin, atëherë u pati vendosur me ekspertë dhe të gjithë ishim dakord dhe të gjithë donim që arti të ishte një mënyrë për të ngritur ndërgjegjësimin shoqëror. Prej tyre dolën katër filma, katër ekspozita, dy shfaqje, eksponatet tona në disa muze anembanë botës. Dhe filluam me këtë. E kishim këtë prezantim arti, dhe nga ana tjetër, kishim këtë pjesë të dukshmërisë shtesë përmes dëshmive dhe përmes meje e Alenit, dhe atë që qysh në fillim e përdorëm si një rrugë të shkelur mirë – rrugë të shkelur i kishim thjesht e gjitha organizatat për të cilat nënat tona na treguan dhe që ne i njihnim, ku realisht u thoshim organizatave të na përfshinin në aktivitetet e tyre. Realisht e shkruan një panel, e vendos që ne do të themi diçka, kërkonim nga të gjithë hapësirën dhe të gjithë na e dhanë. Dy-tre vitet e para kemi punuar dhe kemi qenë shumë aktivë pa projekt. Nuk dinim fare të shkruanim projekte në atë moment. Vetëm menaxhonim pak financat bazë, në fund të vitit bilancin, gjendjen e suksesit, korrigjuam pak statutin, shkruam rregulloret, të gjitha këto me ndihmën e aktivisteve dhe aktivistëve të tjerë, por punonim dhe me ndihmën sigurisht të doktoreshës Amra, dhe me ndihmën e pavarur edhe të njerëzve të tjerë. Kishim ide të qarta dhe prezantime të asaj që donim të prezantonim. Kështu që kjo ndodhte në dy fronte, kjo dukshmëri sociale, që zgjati në 2018, 2019, 2020, për shkak të Covid-it të gjithë u ndalëm pak, por gjatë Covid-it përdorëm hapësirën online, viti 2021 ishte si i tillë një vit ende i përfaqësuar nga shikueshmëria sociale në nivel ndërkombëtar, por aty ngadalë filloi të flitej për ligjin, por më pas viti 2022, viti i kaluar është thjesht në përputhje me ndryshimin e situatës gjeopolitike, si dhe me situatën në Bosnje dhe Hercegovinë, zgjedhjet që u zhvilluan. Thjesht e dinim nga plani strategjik se ky ishte viti kur duhej të shkonim te ligji. Se do të jetë atëherë ose nuk do të jetë më për dhjetë vite, dhe kishim të dre-

29 Ang. Po anoni drejt rrjedhës kryesore

jtë. Thjesht Ukraina, gjithçka filloi disi shumë shpejt dhe gjithçka filloi të ndodhte, disi njerëzit u interesuan më shumë për çështjen tonë. Disa për shkak të qëllimeve të mira, disa për shkak të strategjive, disa për shkak të donatorëve, disa për shkak të kësaj, për shkak të asaj. Dhe ky ishte thjesht një momentum që ne e përdorëm qartazi, por gjithashtu ishim qartazi të përgatitur. Para kësaj, amendamentet tona ligjore që kemi bërë janë shkruar dhe punuar së bashku me gratë e mbijetuara nga shtatë kantonet e Federatës dhe Distrikti i Brçkos. Kemi bashkëpunuar me TRIAL international, kemi pasur një rrjet njerëzish dhe organizatash që tashmë punonin për këtë çështje. Nuk kishe pse të bëheshe këtu i zgjuar kur njerëzit tashmë e kanë hapur rrugën. Ne vetëm vinim dhe paraqisnim problemet tona, nevojat tona, dhe gjithashtu patëm mundësinë të prezantojmë atë që na u mohua – realisht atë nga dëshmia personale, për këtë nuk patëm mundësi, nuk e patëm mundësinë për këtë. Dhe për sa i përket njohjes sonë ligjore, do të ishte shumë e gabuar të thuhej se e arritëm suksesin vetë. Jo, ne nuk e arritëm. Shumë njerëz punuan për këtë, por ne u përpoqëm disi të kemi këtë forum të fëmijëve të mbijetuar, që këto forume dhe biseda ku flasim për ligjin dhe për gjithçka tjetër të shoqërohen me mbështetje psikologjike, që të shoqërohen disi nga juristë që mund të vijnë dhe të përkthejnë ligjet në fjalë normale që ne i kuptojmë edhe pse nuk jemi juristë. Ky normalizim dhe banalizim i gjuhës juridike ishte disi shumë i rëndësishëm për ne. Shumë aspekte të ndryshme të kornizave ligjore për të cilat ne nuk kemi menduar dolën disi nga kjo. Gjithashtu, në një hapësirë të tillë, ndryshimi ynë qendror që donim të arrinim në të gjitha frontet ishte dialogu. Sepse këtu dialogu duhet të jetë sërish i sinqertë, dialogu nuk është mjet. Në BdheH, dialogu është rezultati. Do të thotë, kur vini në atë pikë, ju keni arritur diçka. Gjithçka para kësaj është ecje deri te dialogu dhe për ne ndryshimi qendror ishte ai, vendosja e dialogut. Sigurisht që ia dolëm mbanë në atë pjesë. Hapi i dytë i ardhshëm, kemi shikueshmëri sociale, dialogu me shoqërinë është mjaft i mirë, në komunitete të ndryshme, si në BdheH, ashtu edhe në rajon dhe në botë, dialogu ligjor, dialogu juridik me përfaqësuesit e autoriteteve me ndihmën e të gjitha organizatave të tjera të lidhura apo të ngjashme të krijuara. Dialogu i radhës për të cilin ne përpiqemi dhe për të cilin po punojmë aktivisht është që ligji, që ta flasim me shoqërinë, me përfaqësuesit e qeverisë dhe sektorin joqeveritarë, që ligji është pika numër një.

Grupi ynë kyç i njerëzve, përfituesit përfundimtarë të punës së Shoqatës sonë janë fëmijët e lindur për shkak të luftës, të tria këto kategori. Por nënat dhe gratë e tjera dhe burrat e mbijetuar janë domosdo pjese e punës sonë. Dhe është thjesht një dhe e njëjta tavolinë, nuk mund të ndahet. Sidomos këtu në Brçko, një fëmijë nuk mund ta marrë statusin nëse nëna nuk e ka. Në Federatë mundet, por... thjeshtë kuptimi i pengesave të tyre ligjore... Dhe ne tani jemi të përkufizuar si viktima civile të luftës. Ne thjesht falë tyre dhe vazhdimësisë së tyre, nuk e di se nga e marrin gjithë këtë forcë për të gjitha çështjet tona, por janë ato që na udhëheqin në sistemin e Bosnjë-Hercegovinës. Janë ato që na tregojnë se ku duhet të kërkojmë ndryshimin, a është ministria, a është Qendra për Punë Sociale, nuk është që ne jemi ulur dhe kishim kohë të studionim strukturën politike të Bosnje-Hercegovinës - jo, nuk e kemi bërë. Kishim gra që realisht thoshin se nuk ka nevojë të shkosh në atë ministri, apo në tjetrën. Ajo e drejtë që kemi ne, ajo e drejtë nuk zbatohet, pyet për këtë, pyet për atë, pyet këtë. Pas këtyre tridhjetë vjetëve, gati tre dekada pas luftës, gratë janë eksperte, njeri. Dhe ato vërtet duhet të ftohen në seminare më shumë, vetëm për të folur për atë që mbijetuan. Ne ashtu punojmë me to dhe i pyetëm nëse do të bënin edhe seanca trajnimi për të rinjtë.

Është shumë e rëndësishme të dihet se nuk ka ndonjë proces konkret për fillimin. Ne nuk kemi një rregullore sipas së cilës pranojmë anëtarë të rinj apo dokumentojmë anëtarë të rinj. Baza e të dhënave fillestare dhe puna nga e cila filloi gjithçka janë participants[30] në hulumtimet e doktoreshës Deliq. Gjithçka tjetër që kemi arritur të mbledhim informacion ka ndodhur shpesh përmes Facebook-ut. Aleni pati rastin t'i lajmërohet një djalë nga Sllovenia. Unë kisha rastin ku më është lajmëruar një vajzë. Në një farë mënyre ky lajmërimi përmes rrjeteve sociale..., por kjo është diçka që nuk mund ta bësh... Ajo që ne kemi brenda, le të themi, bazës së brendshme të të dhënave, bazës sonë që është e rëndësishme për ne, nuk është e besueshme askund tjetër, është një listë dhe një fotografi e caktuar - emrat, mbiemrat, vendlindja, ku ka mbijetuar nëna, disa informacione bazë që kemi dhe që i ruajmë. Por, nga ana tjetër, kemi edhe disa informacione dhe disa raste të regjistruara ku dimë për fëmijët, por fëmijët eventualisht nuk e dinë ende origjinën e tyre. Ne kemi punuar në gjëra të tilla deri më tani. Ligji për viktimat civile të luftës në Federatë, ku jemi njohur, hyn në fuqi më 1 janar 2024. Ky do të jetë momenti ku do të duhet të kemi një politikë të qartë për hyrjen e kësaj. Është shumë e rëndësishme për ne dhe do ta theksoj. Është shumë e rëndësishme për ne që fëmijët e lindur për shkak të luftës që nuk janë pjesë e Shoqatës sonë, të cilët nuk janë anëtarë, të kuptojnë se FHL nuk është një organizatë në të cilën duhet të jesh anëtar për të marrë statusin, por që FHL është vetëm një shërbim që ata mund ta përdorin. Nëse në Federatën e BdheH aktualisht kemi rreth njëmijë e dyqind të mbijetuar të dhunës seksuale të kohës së luftës që po realizojnë statusin, kjo do të thotë që së pari këta njëmijë e dyqind persona duhet të marrin një letër direkt nga Ministria e Punës dhe Mbrojtjes Sociale që atje është një kategori e fëmijëve të lindur si rezultat i luftës dhe që procedura t'u shpjegohet se si ata fëmijë mund ta marrin statusin, sepse është grupi i parë thelbësor me të cilin duhet të punohet tani. Nëse hulumtimet kanë treguar metodologjikisht se në BdheH lindën dy mijë deri në katër mijë fëmijë nga akti i përdhunimit të luftës, kjo u bë realisht sipas statistikës bazë se sa gra lindën nga njëqind gra të përdhunuara. Unë disi besoj se në mesin e atyre 1.200 të mbijetuarve që kanë statusin, aty ka fëmijë, dhe se kjo duhet të jetë hapi i parë.

Në fakt, për fillim në një të ardhme të afërt, dy-tre vitet e ardhshme, është shumë e rëndësishme ngritja e infrastrukturës ligjore për realizimin e statusit. Dhe thjesht pas kësaj, i vetmi hap tjetër që na mbetet për këtë status është monitorimi i atij ligji, programi, presioni mbi institucionet kantonale, sepse secili kanton ka përgjegjësitë e veta dhe kjo thjesht duhet të trajtohet, në fakt, drejtimi i mënyrës se si duhet të publikohen dhe të aplikohet në programet për fëmijët e lindur për shkak të luftës, cilat janë nevojat e tyre prioritare dhe në çfarë drejtimi duhet të shkojnë. Besoj gjithashtu që shërbimi ligjor duhet të jetë i mobil, që nuk mund të jetë në një qytet, ai duhet të jetë i natyrës mobile. Kjo është sa i përket Bosnjë dhe Hercegovinës. Në nivel ndërkombëtar jemi të përfshirë në disa rrjete dhe komisione që merren me këtë çështje, dhe ajo që është specifike është se të gjitha këto komisione merren ekskluzivisht me një çështje, e ajo është fëmijët e lindur si pasojë e përdhunimeve të luftës. Ne do të mbetemi pjesë e saj, por është koha, mendoj dhe këtë do ta shohim, këtë do ta vendosë kuvendi, por foshnjat peacekeepers... Si një fëmijë i lindur si pasojë e përdhunimeve të kohës së luftës, pata mundësinë të përjetoj që, siç thuhet, e gjithë bota të ngrihet në këmbë sepse unë kam lindur kështu siç jam, sepse më është mohuar ajo që më është mohuar dhe sepse e mbijetova atë që e mbijetova dhe vazhdoj të përpiqem të vendos veten në këpucët, e nuk po

30 Ang. Pjesëmarrësit

mundem, të anëtarëve tanë që janë fëmijë të paqeruajtësve dhe punëtorëve humanitarë të OKB-së, nëse i kam njohur për kaq shumë vite, problemet dhe nevojat, paqartësitë dhe vështirësitë ligjore të të cilëve i kuptoj, si është në të vërtetë të vëzhgosh gjithë këtë. Si është në të vërtetë të vëzhgosh gjithë këtë që vetëm tri kategori, dhe ne të gjithë ishim në atë video njëzet e gjashtë minutëshe, të gjitha kategoritë përveç martesës së detyruar, të kenë mbetur përsëri të anashkaluar. Jo të anashkaluar, por aq më tepër, do ta marrë guximin të them, dhe e kam thënë tashmë, me synimin për t'i shtypur edhe më thellë se sa ishin. Kjo është diçka që do të vendoset nga parlamenti në një moment. Dhe për sa më përket mua, do të shohim. Unë do të mbetem gjithmonë në FHL, do të jem gjithmonë pjesë e FHL-së, por nëse FHL do të mbetet primare, këtë nuk e garantoj. Disi nuk mendoj se do të jetë. Por, si do që të jetë, kam kohë të mendoj dhe të shoh se çfarë do të ndodhë, dhe thjesht të jem e sinqertë me veten time dhe t'i vlerësoj kapacitetet, vullnetin, dëshirat dhe nevojat e mia për të ardhmen. Nuk mund të them se politika në Bosnje po më ndihmon për këtë për momentin.

Dhe sot...

Epo, unë jam ende këtu në Sarajevë. Mendoj se kam një jetë të bukur. Mendoj se disi në këtë moment... Mendoj se struktura e jetës sime në kontekstin e familjes, miqësive, punës, nuk është diçka që ka ndryshuar. Aty qëndron që një kohë në kuptimin që po shkoj, ende po endem në rrugën e misionit dhe vizionit tim të Shoqatës, dhe misionit dhe vizionit të jetës private. Në një farë mënyre ndryshimi më shumë po ndodh në atë, të cilën ju përmenda tani jetën private, tash a është për shkak të moshës, është për shkak të situatës, apo për çfarë. Ja tash ky viti 2023, përtej të gjitha gjërave standarde që po ndodhin, çka është e mirë, ajo që është pozitive, sukseset janë aty, pyes veten më shumë në pjesën private - a është kjo ajo, dhe a është kjo diçka që dua të bëj dhe sa është kjo që po bëj rraskapitëse për mua dhe sa forcë marr unë me të cilën mund ta mbuloj këtë gjë të mëparshme që më kishte rraskapitur? Për momentin jam, jo si fëmijë i lindur për shkak të luftës, por si një person i ri nga Bosnja dhe Hercegovina, jam shumë i hutuar, jam vërtet e hutuar. Sepse siç thonë - kush do të punojë, ka punë për të bërë. Që është e saktë. Por nuk mendoj më se arsyeja e largimit nga Bosnja është puna, por disi e gjithë kjo situatë. Nuk e di. Nuk më pëlqen aspak momenti në të cilin ndodhet Bosnja. Nga ana tjetër, nuk e artikuloj siç do të doja të ishte, sepse është e çuditshme, thjesht e çuditshme. Lëvizja e shoqërisë është e çuditshme, dhe disa nga lëvizjet politike janë të çuditshme. Dhe nuk më pëlqen drejtimi që po shkon shoqëria. Paksa po i frikohem e paksa jo. Por në përgjithësi po ju them se përveç kësaj standardes youth persion[31] si pyetje, jam shumë e kënaqur me marrëdhënien time me nënën time, me Nusretin. Madje, marrëdhënia jonë është thelluar. Ka disa gjera të tjera qe ndoshta nuk i kemi folur kurrë, dhe tani po i flasim por nuk kanë të bëjnë me këtë temë. Mendoj se është më cilësore dhe më i shëndetshme dhe se më në fund edhe ata e kanë pranuar që unë jam i rritur dhe se më në fund kam pranuar nevojat, vlerat dhe traditat e tyre bazë. Në aspektin miqësor në rregull, në aspektin e punës në rregull. Kjo është ajo. Edhe financiarisht ne rregull. Në aspektin e partnerit më pak në rregull, por do të ketë më shumë, do të ketë jetë.

31 Ang. Një i ri

Ajo që ndoshta gjithmonë në fund e përsëris, këtë ndoshta e kam thënë edhe në Novi Sad, e kam gjithmonë të rëndësishme narrativen e brezave të rinj të tanishëm, që ata të kuptojnë se sistemi me të cilin kemi jetuar deri më tani, të cilin ata e përdorin, aty ku jemi rritur të shfrytëzojnë disi, në fakt, të çojnë në gjithë këto vuajtje dhe dhunë, sepse dikush thjesht duhet të bëjë një kthesë, të mos bllokojë as dialogun, as monologun, që po ashtu është një gjë që është e rëndësishme të përsëritet. Dhe kaq. Nuk e di. Të rinjtë, të rinjtë, të rinjtë. Disi janë shumë të rëndësishëm për mua. E kam fjalën për ato personalisht të rëndësishme. Por disi nuk mund të kem një fëmijë në këtë lloj shoqërie, sinqerisht. Dhe në njëfarë mënyre do të doja që gjeneratat e reja apo brezat tanë ta ndryshojnë atë dëshirë tek unë dhe sigurisht te shumë të reja rreth meje, sepse nuk është e lehtë të marrësh një vendim të tillë. Është një mesazh i ashpër, ndoshta, por ja kur jemi në këto tema, dua ta them edhe këtë, mendoj që kjo po ashtu është një pyetje e madhe për momentin.

PASTHËNIE

Forca është tek gratë

Drejtësia tranzicionale nënkupton të gjitha ato procese me të cilat shoqëritë i përgjigjen trashëgimisë së shkeljeve të mëdha dhe masive të të drejtave të njeriut. Në ish-Jugosllavi, dhe në Ballkan, për fat të keq, ka shumë procese të tilla dhe nevoja për reagime të fuqishme është me të vërtetë e madhe, ndonëse shpeshherë nuk njihet nga strukturat në pushtet. Nuk është e nevojshme të përmendet se këto struktura janë kryesisht patriarkalë, mashkullore dhe heteroseksualë sepse kjo është norma në Ballkan. Narrativet mbizotëruese të cilat i njohin strukturat në pushtet kanë të bëjnë me viktimën, e cila gjithmonë është e jona dhe më e madhja, ndërsa ata që kanë vdekur nga duart tona janë të padukshëm ose të parëndësishëm. Kjo është ndoshta më e dukshme në shembullin e Serbisë, e cila nuk njeh dhe nuk pranon gjenocidin në Srebrenicë, në të cilin mori pjesë me bujari dhe me gjithë zemër, dhe i cili së fundi fitoi edhe Ditën e Përkujtimit në Kombet e Bashkuara.

Prandaj, nëse burrat refuzojnë të njohin viktimat që vdiqën nga duart e tyre dhe në emër të tyre, atëherë gratë luftojnë për dinjitetin e viktimave. Libri përmban dëshmitë e grave të guximshme nga Bosnja e Hercegovina, Kosova, Shqipëria, Mali i Zi, Maqedonia e Veriut, Kroacia dhe Serbia, të cilat me angazhimin dhe luftën e tyre arritën të kontribuojnë në drejtësinë tranzicionale, pra të përballen me të kaluarën dhe t'ua rikthejnë dinjitetin viktimave me veprimet e tyre, të cilin politika zyrtare u përpoq t'ua merr.

Këta narrativë përfaqësojnë të drejtën për të kujtuar. Shoqëritë më së shumti kujtojnë mënyrën si u lejohet, pra mënyra si u kërkohet. Ato rrallë ndryshojnë narrativat dominues. Nëpërmjet kujtimeve të këtyre grave ndërtohet një qëndrim tjetër ndaj kujtesës zyrtare, mësohen detaje që me vetëdije u shtynë nën tepih, dalin tema të cilat kujtesa sociale nuk dëshiron t'i trajtojë sepse e paraqet si të kompromentuar, të rreme. Prandaj është shumë e rëndësishme të lexohen këto tekste që shërbejnë si kujtim për mundësinë e një narrativi tjetër historik, që do t'i jepte të gjithëve të drejtën për të vërtetën dhe të vërtetës të drejtë.

Intervistat e realizuara me mjeshtëri nga Korab Krasniqi nuk trajtojnë vetëm aktivitetet e këtyre grave të rëndësishme në kuadër të drejtësisë tranzicionale. Ato shkojnë shumë më larg në të kaluarën, pra, përpiqen në mënyrën më të mirë të historisë gojore të dëshmojnë kohën në të cilën janë rritur, kanë ndërtuar identitetin e tyre dhe janë bërë luftëtare të palodhshme për të drejtat dhe dinjitetin e viktimave.

Nëse do të kërkojmë një emërues të përbashkët për këto heroina, atëherë do të ishte mbështetja e padyshimtë brenda familjes dhe rrethit, që ato morën për guximin e tyre. Natyrisht, ato vetë duhej të përballoheshin me kufizimet të cilat para tyre i kishte vendosur patriarkati dhe shoqëria e organizuar sipas rregullave që ato kundërshtonin, por pa bërthamën e shëndoshë prej nga vinin, dhe me këtë nënkuptohet grupi i vlerave që i morën me vete që nga fëmijëria e hershme, ato nuk do t'ia dilnin dot në luftën që

ende vazhdon. Pavarësisht nëse është një qëndrim thellësisht fetar ndaj botës (si me rastin e Sabiha Husić apo Katarina Kruhonja) apo internacionalizmi i propaganduar në Jugosllavi gjatë viteve të shtatëdhjeta dhe tetëdhjeta (me Staša Zajović, Vesna Teršelič dhe Sonja Biserko), të gjitha këto gra kanë një të përbashkët, që i vendosin të tjerët para vetes të bindura se kjo është e vetmja mënyrë për të jetuar me etikë. Ndjenja se diçka nuk shkon me botën kur ajo prodhon viktima thjesht nuk u jep qetësi, i detyron t'i rezistojnë çmendurisë vazhdimisht, t'i rezistojnë shtypjes, t'i rezistojnë patriarkatit.

Ato kanë edhe një gjë të përbashkët, e kjo është këmbëngulësia. Suksesi në punën që ato bëjnë është relativ. Ballafaqimi i përhershëm me pengesa, rezistimi i përhershëm i strukturave patriarkale në pushtet për të vënë në veprim më në fund gjithçka që ato përfaqësojnë, madje edhe kur premtohet, duke shmangur dhe vështirësuar qëllimisht bashkëpunimin, dhe në fund kërcënime shumë të prekshme; asgjë nga këto nuk i dekurajon, sepse vetëm përmes luftimit ato e shohin kuptimin e ekzistencës së tyre dhe ekzistencën e organizatave që kanë ndërtuar. Sigurisht që është arritur shumë, por ato këmbëngulin, nuk reshtin së avokuari që të zbardhet e vërteta, që secilës viktimë t'i kthehet dinjiteti që iu mor, që më në fund të bëhet dëmshpërblim i drejtë dhe, më e rëndësishmja, që ajo që ndodhi të mos përsëritet më kurrë.

Këto dëshmi gojore të grave të guximshme nuk janë vetëm një peng për të ardhmen dhe një pasqyrë e karrierës së patëmetë të luftëtarëve për të drejtat e njeriut, por edhe një dëshmi e historisë. Historitë e tyre tregojnë se sa e vështirë është të qëndrosh drejt në kohë të vështira dhe të gjithat që duhen për këtë. Ato dëshmojnë se zgjedhjet e duhura janë të mundshme edhe kur duket se të gjithë janë kundër jush. Dhe nëse "Historia magistra vitae est", atëherë ne kemi diçka për të mësuar nga këto narrativa. Ato janë historia e guximit, historia e një shpirti të ndërgjegjshëm individual që e di se çfarë dëshiron dhe e di se cilën anë duhet të mbajë. Është gjithmonë ana e të shtypurve, të shkelurve, të atyre që nuk janë as fajtorë e as të detyruar të jenë nën mokrën e historisë.

Puna në këto histori personale ishte një nder i madh dhe një kënaqësi e jashtëzakonshme. Jo vetëm që pata mundësinë të mësoja diçka, por m'u mundësua të përballesha me veten, zgjedhjet dhe paragjykimet e mia dhe nëpërmjet shembujve të narrativave personal të tetë grave të guximshme të kuptoja thellësinë dhe peshën e përvojës, jo vetëm të tyre, por edhe atë që kaluan viktimat. I jam mirënjohës për besimin e treguar forumZFD programi në Kosovë, dhe veçanërisht Korab Krasniqit dhe Vjollca Islami Hajrullahut, të cilët më mundësuan të mësoj nga këto rrëfime dhe t'i admiroj ato.

Vladimir Arsenić
Redaktor dhe lektor

Katalogimi në botim – (CIP)
Biblioteka Kombëtare e Kosovës "Pjetër Bogdani"

172.4-055.2(497.1:496.5)(083.94)

Rezistenca : gratë e paqes dhe të drejtësisë në ish-Jugosllavi dhe Shqipëri / drejtues të projektit Korab Krasniqi, Rina Kadiri, Vjollca Islami Hajrullahu ; transkriptimi Alma Hamza ... [etj.]. - Prishtinë : Forum ZFD, 2024. - 278 f. : ilustr. ; 22 cm.

1. Krasniqi, Korab 2. Kadiri, Rina 3. Hajrullahu, Vjollca Islami 4. Hamza, Alma 5. Susuri, Anita 6. Behluli, Donjet 7. Dinić, Miona 8. Begolli, Renea 9. Nikjari, Xherardo

ISBN 978-9951-775-21-2

Realizuar nga:

forumZFD – (Forum Civil Peace Service / Forum Ziviler Friedendienst e.V)
Nisma e të Rinjve për të Drejtat e Njeriut - Kosovë (YIHR KS)

Mbështetur nga:

Ministria Federale për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (BMZ)

ISBN 978-9951-775-21-2

Prishtinë 2025